

PËRVJETORË

90-VJETORIN E LINDJES SË
AKADEMIK MARK KRASNIQIT



Besim BOKSHI, Kryetar i ASHAK, Prishtinë

PËR 90-VJETORIN E LINDJES SË MARK KRASNIQIT

Të nderuar të pranishëm, zonja e zotërinj,

Jemi mbledhur sot për t'i shprehur të gjithë së bashku urimet tona të përzemërta akademik Mark Krasniqit në 90-vjetorin e lindjes. Është një ditë e gëzuar, e hareshme për ne, një ditë feste për Akademinë tonë, sepse edhe profesor Mark Krasniqi, pas profesor Idriz Ajetit, qëndron me ne i shëndetshëm e energjik edhe pas nëntëdhjetë vjet jete. Një jete të fisnikëruar me veprimtari të dalluar krijuese shkencore e letrare e me veprimtari po aq të dalluar patriotike. Ky jubile i jetës së Mark Krasniqit është edhe jubile i përpjekjeve frytdhënëse kundër së keqes në kushtet e rënda të jetës në Kosovë.

Nga lartësia e këtij përvjetori kujtimet zbresin në kohën e fëmijërisë, kur e përjetoi trajtimin robërues të popullit të tij dhe që atëherë ndaj kësaj gjendjeje njerëzisht poshtëruese iu brymos ndjenja e kundërshtimit e mospajtimit, të cilin e ktheu në aktivitet të përhershëm kundërshtues e me synim për të ndihmuar ardhjen e një kohë tjetër. Kujtimet shkojnë pastaj në Padova, ku qëndroi dy vjet si student i letërsisë dhe vijojnë pas diplomimit në Beograd, kur filloi ta orientonte energjinë e tij krijuese në shkencën e gjeografisë dhe të etnologjisë si asistent e bashkëpunëtor shkencor në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, ku punoi njëmbëdhjetë vjet me momente të nëpërkëmbjes, për shkak të veprimtarisë së tij shkencore, që filloi e pandarë nga detyra intelektuale për të mbrojtur me guxim e me trajtim të mirëfilltë shkencor të vërtetat për popullin e tij, të hidhej energjikisht kundër shtrembërimeve qëllimkëqia të fakteve për popullin shqiptar. Shkojnë kujtimet në kohën kur u detyrua ta mbronte tezën e doktoratës në Lubjanë e jo në Beograd. Vijnë pastaj kujtimet e shumta e të shumëllojshme të njëzet vjetëve (1961-81) që i kaloi si profesor në Fakultetin Juridik-Ekonomik, si prodekan e dekan i këtij fakulteti, duke qëndruar gjithnjë profesor sugjerues për një qëndrim aktiv të studentëve ndaj çështjes kombëtare. Si i tillë Marku u përjashtua nga Fakulteti, në vitin e madh 1981, kur shpërtheu revolta madhështore e rinisë. Më parë kujtimi ndalet në vitin 1966, kur brutalisht iu bënë kërcënime të rënda në një mbledhje publike në Prishtinë ku u sulmuan

qëndrimet e tij shkencore në doktoratën e botuar pesë vjet më parë ngase ishin në kundërshtim me trajtimet joshkencore të çështjeve shqiptare të studiuesve serbë. Na kujtohet teksti i shkëlqyer i Markut në përgjigje ndaj akuzave, tekst që u lexua masivisht duke na e ngjallur ndjenjën e krenarisë që kishim që në atë kohë shkencëtarë të zotët që e demaskojnë pseudoshkencën e drejtuar kundër nesh.

Kujtohet koha e udhëheqjes së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, e udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe zgjedhja anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por mbi të gjitha koha e themelimit të Partisë Demokristiane të Kosovës dhe e drejtimit të saj për më se pesëmbëdhjetë vjet. Renditen kujtimet që dalin nga kontributi i kësaj partie e mbi të gjitha kontributi i kryetarit të saj Mark Krasniqi dhënë Lëvizjes sonë për pavarësi.

Dhe krahas këtij aktiviteti permanent shoqëror, Marku që i pandarë nga krijimi shkencor e letrar. Edhe shkencën edhe artin ai i vuri në shërbim të interesit të popullit të tij. Temat e studimeve shkencore janë zgjedhur e trajtuar në funksion të këtij qëllimi, siç tregojnë veprat: *Ndryshimet bashkëkohore gjeografiko-shoqërore në Kosovë e Dukagjin; Gjurmë e gjurmime, Studime etnografike; Lugu i Beranit, monografi etno-gjeografike; Rugova, monografi etno-gjeografike; Nga gurra e traditës, studime etnografike; Rrënjët tona etnike; Toleranca fetare në traditën shqiptare; Mikpritja në traditën shqiptare* e disa të tjera.

Me këto radhiten edhe veprat publicistike: katër libra me tituj *Qëndrime e reagime* dhe vepra voluminoze me titull *Përpjekje për Kosovën* si dhe referati i mbajtur në Senatin belg më 1992 me titull *Kosova sot*, i përkthyer në anglisht e gjermanisht. Ka publikuar trajtesa të shumta shkencore në organet autoritative shkencore në ish- Jugosllavi e jashtë saj dhe ka marrë pjesë aktive nëpër konferenca, simpoziume e kongrese shkencore ndërkombëtare, gjithnjë aty ku duhej të dëgjoheshin të vërtetat për popullin tonë.

Kështu Mark Krasniqi është ndër personalitetet që iu nevojitën kohës sonë për të hapur shtigje drejt një jete të dinjitetshme njerëzore. Dhe ja tani me të drejtë qëndron pranë nesh krenar për atë që bëri për shkencën e për popullin e tij. Ai si intelektual i orëve të para ndër ne, me ndjenjë të fortë individualizmi, qëndroi brenda synimit kolektiv për emancipim dhe prosperitet të popullit shqiptar. Ai eci nëpër jetë me ndjenjën e theksuar të përgjegjësisë shoqërore kombëtare, me guximin e këmbënguljen për të ndihmuar realizimin e aspiratave për liri. Me tërë veprimtarinë e tij të një vlere të lartë shoqërore Marku çmohet si një nga figurat tona më të shquara të gjysmës së dytë të shekullit të

kaluar. Ai arriti ta lërë të qëndrueshëm emrin e tij në rrjedhat e shkencës sonë kombëtare e të kulturës dhe të jetë njëri nga veprimtarët e ndritur patriotë të kohës sonë, që hynë në kujtesën e kombit. Mark Krasniqi la një të përmendur të vijueshëm, një përmendore për vete e për kohën e tij.

Mark Krasniqin dëshirojmë ta kemi edhe më tutje të shëndetshëm dhe energjik, të pandalshëm në aktivitetet shoqërore e në shfrytëzim të energjisë së tij krijuese. Urime edhe një herë! Rrofsh edhe shumë vite!

Lus sekretarin e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Pajazit Nushin, që ta marrë fjalën!

Pajazit NUSHI, ASHAK, Prishtinë

AKADEMIK MARK KRASNIQI DHE VEPRIMTARIA E TIJ SHKENCORE

KUD 008(=18)

929(496.51) Krasniqi, Mark

Ditëlindja e akademik Mark Krasniqit u bë shkak që Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës sot i jep vetes dhe të nderuarit Mark edhe një vlerë: me shënimin e përvjetorit të 90 të lindjes së Akademik Mark Krasniqit ASHAK nderon dhe respekton personalitetin, i cili me krijimtarinë e tij në fushën e etnografisë, të gjeografisë, të letërsisë dhe me veprimtarinë shoqërore e politike është ndër të parët që ka vënë gurthemelin e zhvillimit të mendimit kulturor e shkencor ndër shqiptarët e Kosovës dhe më gjerë.

Edhe mua më është bërë nder i veçantë nga ana e ASHAK-ut dhe e akademik Mark Krasniqit, që, ndonëse diç më i ri, sepse jam mburrur dhe jam krenuar me entuziazmin studentor, kur profesori i filozofisë akademik Dushan Nedelkoviqi, më foli për “shqiptarin studiues”, për Mark Krasniqin, të cilin më porositi ta kisha model të punës intelektuale, kur Marku ynë punonte në Akademinë Serbe të Shkencave.

Edhe për këtë shkak ndihem i nderuar nga ana e ASHAK dhe e kolegut tonë që më ofruan mundësinë të flas para Jush për njërin nga hijerarkët e parë të mendimit krijues dhe, para së gjithash, të themelimit të institucionit të këtij mendimi në Kosovë.

Në podiumin e institucionit kulturor dhe shkencor të njerëzve të shkencës dhe të artit që i ka dhënë kulturës së popullit të vet dhe gjenit e thelbit të të qenit shqiptar, ka qenë ngritur me kohë burri i vlerave të spikatura njerëzore e kombëtare, mik i përhershëm i zhvillimit të mendimit shkencor dhe i krijimtarisë letrare si dhe i veprimtarisë shoqërore e politike për çlirim të këtij mendimi dhe përgjithësisht për liri njerëzore dhe kombëtare të popullit të vet.

Ky burrë sot ka pas vetes së tij një korpus të çmuar që, thënë me gjuhën e numrave, përbëhet prej 11 veprave shkencore gjeografiko-etnologjike, 3 teksteve shkolllore të gjeografisë, 10 veprave letrare, 9 përkthimeve nga letërsia dhe 6 shpalosjeve publicistike.

Që në bankat e Gjimnazit Serb të Prizrenit, sidomos në vitet '30 të shekullit njëzet, akademik Mark Krasniqi diti të kapte dhe të përpu-nonte atë që është e përjetshme dhe që do të mbetet gjithmonë e këtillë – thelbin njerëzor dhe kombëtar të zhvillimit të shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë duke u lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe me zhvillimin e krijimtarisë letrare e shkencore. Prej asaj kohe si intelektual gjithmonë ka iniciuar, përqaftuar dhe për-krahur mendimin më të avancuar për zhvillimin e Shqipërisë, të Ko-sovës dhe të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Për këtë është radhitur në rreshtat e parë të elitës së inteligjencies shqiptare.

Si shkencëtar ka mbajtur një barrë të madhe mbi shpatullat e tij për krijimin e institucioneve arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë dhe jo vetëm këtu. Si politikan gjendet ndër ata të paktë që janë përpjekur t'i zgjidhnin problemet e shumta e të llojllojshme me halle të mëdha të shqip-tarëve duke iu referuar vazhdimisht të drejtës dhe të vërtetës së popullit të Kosovës, lumit të gjakut të të vrarëve, të të dëbuarve dhe të të humburve e të zhdukurve si dhe lumit të lotëve të të gjallëve.

Ndjenja e dhembshurisë ndaj tragjikës së popullit të vet u bë motiv i dalluar, sidomos në krijimtarinë letrare, i angazhimit të pakursyer të tij. Vërtet Kosovën e ka në shpirtin e tij secili qytetar i saj, secili shqiptar i vërtetë, secili qytetar i njerëzishëm, por Marku ynë Kosovën e deshi, e do dhe e adhuron, u angazhua si intelektual, shkencëtar e punëtor shoqëror e politik për ta shkukur nga dhëmbët e atyre që kërkonin ta bluanin dhe ta zhbënin. Prandaj, mesazhet e veprimtarisë së tij shkencore e letrare e ato të fjalës publicistike i përkasin qëndresës, bashkimit kombëtar dhe të vërtetës për gjeografi, histori, etnografi dhe për shpirtin karakteristik të shqiptarëve.

E përbashkëta e intelektuale, e shkencore dhe e aktivitetit shoqëror e politik e akademik Mark Krasniqit është tërësorja e integruar e synimeve, e objektorëve dhe e zhvillimeve kombëtare e njerëzore. Kjo tërësore ka nxitur angazhime intelektuale dhe krijuese në emancipimin kulturor, poli-tiko – social dhe shkencor të shqiptarëve, nga të cilat Akademik Mark Kra-sniqi nuk është ndarë edhe në moshën 90 vjeçare.

Akademik Mark Krasniqi ishte ndër prijtarët e veprimtarisë intelek-tuale, kulturore dhe shkencore dhe prijatar i zhvillimit të mendimit shkencor në disiplinat e shkencave shoqërore dhe humaniste. Kjo ishte koha kur mje-disi i Kosovës ishte në shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik, social e politik, sepse, në vitet e rinisë së tij, përkatësisht ndërmjet dy luftërave botërore, në Kosovë dominonte popullsia e pashkolluar dhe analfabete. Që nga ajo kohë, sidomos pas përfundimit të Luftës II Botërore, akademik Mark Krasniqi u

shqua si studiues objektiv dhe i mirëfilltë i së vërtetës shoqërore e gjeografike të Kosovës dhe të historisë politike të shqiptarëve të saj.

Deri në paraqitjen e akademik Mark Krasniqit dhe të pak bashkëkohanikëve të tij gjeografinë, historinë dhe etnografinë e shqiptarëve të Kosovës e shkruanin të tjerët, në rend të parë studiuesit serbë. Ata e parashtronin këtë në kuadrin e gjeografisë, të historisë dhe të etnografisë së Serbisë e të shtetit të saj, me mjaft gjysmë të vërteta dhe të pavërteta. Në këto shkrime mbisundonte qasja aktropogjeografike e Jovan Cvijiqit, që, siç ka konstatuar me të drejtë akademik Hivzi Islami në shënimin e përvjetorit të lindjes së akademik Mark Krasniqit, para dhjetë vjetëve, “kishte pikëpamje të bollshme antishqiptare”.

Akademik Mark Krasniqi u vu në gjurmim të argumentimit të identitetit të popullit, të etnisë dhe të kombit shqiptar. Secili studiues kërkon përcaktimin e identitetit për të krijuar përkatësi të të tjerët dhe rend në zhvillimin kombëtar. Nevoja e këtillë është imediate në përcaktimin e gjendjes sociale, ekonomike, historike, gjeografike dhe të sistemit të vlerave të shqiptarëve. Në këtë levë të jetës dhe të veprimtarisë së tij te Mark Krasniqi dallohet çështja e vetës së parë të tij, kjo është: çfarë të bëj unë në kushtet, në rrethanat dhe në raportet e dhëna, kur të huajt shkruajnë historinë, gjeografinë, etnologjinë dhe psikologjinë e shqiptarëve? A vlen ajo që bëj? Si të angazhohem me të tjerët për të ndryshuar në të mirë rrjedhën e proceseve politike, ekonomike e sociale të kohës së errët për shqiptarët?

Në këtë fushë e hasim akademik Mark Krasniqin me studimin e gjërë të viteve ‘60 të shekullit të kaluar, që u botua me titull *Ndryshimet bashkëkohore gjeografike-shoqërore në Kosovë*, në studimin *Gjurmë e gjurmime* të botuar më 1979, te *Lugu i Baranit – monografi etnogjeografike* e botuar më 1985, në studimin *Rugova – monografi etnogjeografike*, që u botua më 1987, në shumë trajtesa shkencore, nga të cilat dallojmë trajtesën *Migrimi i popullsisë si fenomen shoqëroro-ekonomik*, të botuar më 1965, *Urbanizimi i venduanimeve dhe i popullsisë me vështrim të posaçëm në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit* të botuar më 1962, *Krahinat etnografike të Kosovës*, të botuar më 1977 dhe në shumë punime të tjera, disa prej të cilave u botuan në serbishte dhe në shqipe, si edhe në gjuhë të tjera.

Në thelbin e këtyre punimeve qëndronin relacionet e gjykimeve popull i përvuajtur, i përndjekur dhe i vrarë në perandorinë otomane e i shtypur me shumë vite nën thundrën sllave, por i gjalluar në familjen shqiptare me doket, zakonet dhe me vlerat e veta, që familja, farefisi e mjedisi shqiptar i mbolli dhe i kultivoi vazhdimisht. Në këto punime vërehet se shqiptarët e Kosovës, të lugjeve, të fushave e të përrenjve, të tokës së tyre, të burgosur dhe të përndjekur pandërprerë, jo vetëm

që kanë identitetin e tyre, por këtë e kanë ruajtur dhe kultivuar me shekuj, e që ky popull nuk është analfabet, por ka dhënë edhe bejtexhinj, shkrimtarë, artistë e shkencëtarë, që Kosovën dhe kombin shqiptar e kanë bërë realitet të pavdekshëm, ku e vërteta dhe qëndresa triumfuan mbi mitet e kohës së car Lazarëve, të projekteve të tipave të Čubri-
lovićit, të qasjeve studimore të qenësisë dhe të identitetit, të autenticitetit të shqiptarëve në frymën e qasjeve të Jovan Cvijićit, të shpirtëgjër-
sirave të tipit të Slobodan Miloševićit, etj.

Akademik Mark Krasniqi, autor i veprave të triumfit të mendimit të lirë dhe të arsyes, u bë edhe vetë realitet dhe triumfues bashkëkohanik i zhvillimit të pavarur, realitet i gjallë që sot kërkon të vërë ura lidhjeje e bashkëpunimi ndërmjet popujve liridashës të Bashkësisë Evropiane dhe të sofrës njerëzore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara..

Tipar i posaçëm i studimeve të akademik Mark Krasniqit është mbledhja e fakteve, sistemimi dhe shpjegimi empirik dhe teorik i rrënjëve të etnikumit shqiptar. Në këtë rrafsh dallojmë akribinë e tij në gjetjen e argumenteve të lashta në nyjën gjeografike, etnografike, historike dhe shpirtërore të shqiptarëve. Sistemin e argumentimeve të këtilla e hasim sidomos në veprat: *Gjurmë e gjurmime*, të botuar më 1979, *Nga gurma e traditës* e botuar më 1991, *Aspekte mitologjike – besime e besëtytni* të botuar më 1997, *Mikpritja në traditën shqiptare*, të botuar më 2007, si edhe në shumë referate e trajtesa të kumtuara në tubime shkencore në vend dhe jashtë, si: *Kula u Metohiji – Prilog proučavanju narodne arhitekture – Kulla në Rrafshin e Dukagjinit – kontribut në hulumtimin e arkitekturës popullore*, *Shtëpia shqiptare në Kosovë*, *Funksioni i dhomës së miqve në Kosovë në epokën e Lidhjes së Prizrenit*, *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike* dhe në shumë të tjera. Në kuadrin e kësaj veçorie mund të thuhet se qenësorja në këto vepra, në monografi, në trajtesa, etj. është hulumtimi gjeografik i pandarë nga hulumtimet etnografike, gjeografia e ndryshuar e kombit shqiptar dhe zakonet, tradita e sistemi i qëndrueshëm zhvillimor i karakterit etnologjik të shqiptarëve.

Në relacionet e nyjës tërësi gjeografike, histori, gjeografi e histori politike e ndryshuar dhe qëndrueshmëri në zhvillimin e gjuhës shqipe, të traditës dhe të sistemit zakonor të shqiptarëve, akademik Mark Krasniqi argumenton tërësinë burimore të shqiptarëve në tokat e betejave dhe të kështjellave, në rrugëtimin ekzodik të shqiptarëve të gjallë, të cilëve varret e paraardhësve të familjeve dhe të farefisit u shkonin mbrapa tyre.

Akademik Mark Krasniqi është mbrojtës me ngulm dhe me guxim i argumenteve të shpjeguara dhe të botuara. Në këtë drejtim, mendimi ynë ndalet në polemikat e njohura, siç janë: *Naučni rad i naučne publikacije na*

Kosovu i Metohiji – Puna shkencore dhe publikimet shkencore në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit botuar më 1966, *Prapavija qëllimkeqe e një kritike – Përgjigje rreth reagimit të Dr. Boshkoviqit* botuar më 1966, *Politikantski pamflet umesto nauke – Pamflet politik në vend të shkencës* botuar më 1983, etj.

Angazhimi shkencor në afirmimin e së drejtës kombëtare e njerëzore të shqiptarëve në kohën e zhvillimit të operacioneve luftarake në Kosovë është tipari tjetër i aktivitetit politik të akademik Mark Krasniqit. Këtu e dallojmë sa në frontin e gjerë të pajtimit të gjaqeve, sa në debatet e shumta në Prishtinë, në Beograd, në Ulqin, në Senatin e Parlamentin Belg, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. Në këtë kuadër me të drejtë është theksuar nga ana e të ndjerit akademik Jashar Rexhepagiq para dhjetë vjetëve se “e pamundur është të kuptosh veprën e Mark Krasniqit dhe kontributin e tij në shkencë, në letërsi e në fusha të tjera, ndaras prej ngjarjeve më të rëndësishme dhe fatit që përjetoi populli shqiptar dhe Kosova gjatë tetë dekadave të shekullit njëzet”.

Me këtë kontribut akademik Mark Krasniqi ka nderuar në rend të parë veten dhe të gjithë ne, vendlindjen – Gllaviçicën, përkatësisht Shëngjonin e Pejës dhe të Dukagjinit, Kosovën, Shqipërinë dhe gjithë kombin. I rritur në traditën familjare të bashkëjetesës katoliko-islamike, i kalitur në arsimin e rreptë të shkollës serbe, i pajisur me përvojë etno-patriotike, i profesionalizuar për marrëdhënie etnokulturore të gjeografizuara të trojeve shqiptare dhe i ngritur në raportet subtile të metodave hulumtuese të Akademisë Serbe të Shkencave, akademik Mark Krasniqi zbriti edhe fizikisht në Kosovë në fundin e vitit 1961 si personalitet kompleks i profilit të etnografit, të gjeografit, të krijuesit letrar dhe të publicistit, të intelektualit të kërkuar për zhvillimin e institucioneve të larta arsimore, universitare dhe shkencore të Kosovës së viteve ‘60 të shekullit njëzet.

Kur u kthye në Kosovë nga institucionet e hulumtimeve etnografike jashtë Kosovës, tashmë kishte hapur shtigje për zhvillim të mendimit shkencor në fushën e gjerë të shkencave shoqërore dhe humaniste dhe kishte lënë pas vetes trajtesa dhe vepra të mirëfillta shkencore. Aktivitetin e tij krijues e vazhdon në truallin amënor të Kosovës duke qenë i angazhuar paralelisht në gjurmime shkencore dhe në vende udhëheqëse të institucioneve universitare dhe shoqërore-politike të Kosovës plot kundërtënie të gjysmëshekullit të kaluar dhe të viteve të para të shekullit njëzet e një. Në këtë front të gjerë betejash doli ngadhënjimtar.

I gëzofshi Ju dhe ne këto të arritura. Për të gjitha këto, neve na mbetet që akademikut Mark Krasniqi t’i urojmë pleqëri të shëndetshme, të mbarë dhe, si gjithmonë, të ndershme dhe të bukur.

Xhevat SYLA, Prishtinë

KRONIKË E KOHËS QË JETUAM

KUD 821.18.09

Kur kemi parasysh kontributin që Mark Krasniqi i dha letërsisë sonë në përgjithësi e veçmas asaj për fëmijë, pastaj kontributin që i dha shkencës, arsimit dhe publicistikës, si dhe kur kemi parasysh vitalitetin me të cilin e priti 90-vjetorin e lindjes dhe rolin që luan edhe në këtë kohë për kombin dhe vendin e vet, s'kemi si të mos besojmë dhe të jemi mirënjohës se këtë privilegj e kënaqësi e kemi në saje të përkujdesjes së Zotit për të dhe për ne. Ndaj, s'kam si të mos ndihem i privilegjuar dhe i lumtur në këtë rast gëzimi, t'i them disa fjalë për krijimtarinë letrare të këtij krijuesi të vyeshëm, të njërit nga prijsit e letërsisë sonë për fëmijë në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe të njërit prej atyre që bënë hapat e parë në këtë pjesë të letërsisë sonë në përgjithësi. Mark Krasniqi është emër i dashur dhe i respektuar nga breza tanë të shumtë, të cilët janë rritur me krijimet e tij letrare. Librin *Përrallat e gjyshit* ai e botoi në vitin kur u botuan edhe dy libra të tjerë të parë për fëmijë në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore – *Gjethet e reja* i Rexhep Hoxhës dhe *Vjersha të zgjedhura për fëmijë* i Mehmedali Hoxhës dhe Lutfi Rusit. Që të tre këta libra lexuesit shqiptar të kohës i erdhën nëpër shkolla, nëpër librari dhe nëpër bibliotekat e pakta si thesare të veçanta. Libri *Përrallat e gjyshit* është e para vepër letrare e Mark Krasniqit, e cila doli pas disa poezive të tij të botuara në periodikun e kohës, si paralajmërim i një pene të re dhe shumë premtuese në poezinë tonë në përgjithësi, e veçmas në atë për fëmijë. Kjo vërtetohet me faktin se Mark Krasniqi, në planin letrar, mbeti poet i mirëfilltë, duke na dhuruar nga viti në vit vepra të reja. Tri vjet pas librit *Përrallat e gjyshit*, më 1956, ai botoi librin tjetër me vjersha për fëmijë *Drita e parë* si dhe librin *Borëbardha*, pastaj librin e tij të njohur, do të thosha librin emblematic si të autorit ashtu edhe të letërsisë sonë për fëmijë në përgjithësi *Posta e porositun*, botuar më 1959, e ribotuar disa herë me plotësime, pastaj librat *Lepuri analfabet* (1974), *Postieri i maleve* me zgjedhje dhe mbarshtrim të Vehbi Kikajt e parathënie të Agim Devës, *Kulla e buburrecit* (1989), dhe *Vjersha të zgjedhura për fëmijë* zgjedhje për lektyrë shkollore (1998). Ndërkaq poezitë për të rritur Mark Krasniqi i

përmbloodhi në vëllimin *Jehona e kohës*, botuar më 1972 e ribotuar disa herë pastaj.

Si e priti e si e përjetoi lexuesi veprën poetike të Mark Krasniqit?

Nga armata përditë në shtim e shkollarëve në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore krijimet e para letrare të Mark Krasniqit u përjetuan si krijime të një Rilindasi të Kosovës së Re, e cila, ndonëse me dhembjet nga plagët e pambyllura në trup, kishte nisur udhën kah drita. Me krijimet e veta dedikuar fëmijëve, Mark Krasniqi u dhuronte atyre edhe kënaqësi, edhe mësim nga përvoja njerëzore, duke shfrytëzuar për këtë qëllim sa pasurinë nga trashëgimia jonë popullore, po aq edhe fantazinë e tij të bujshme.

Poezinë e tij për të rritur lexuesi e priti si një vazhdimësi të asaj të poetëve të Rilindjes sonë kombëtare. Kjo përshtypje del sidomos nga poezitë e hershme të Mark Krasniqit, të shkruara dhe të botuara në periudhën para Luftës së Dytë Botërore apo gjatë saj, kur ai shkruan për Kosovën, për fatin e saj, për përpjekjet për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi, për vendlindjen së cilës i këndonte me mallin e rilindasve tanë për të. Kjo vërehet sidomos nga poezitë *Çou djemni!* (1937) *Shqiponjat e Shqipnisë* (1943), *Kosovës* (1942), *Mbas flamurit* (1941), *Rrnoftë Kosova* (1941), *Lulja e ime* (1938), *Përpara, o trim i ri* (1949), *Dialog me bylbylin* (1938 etj.), të cilat ai i përfshiu në botimin më të ri të librit *Jehona e kohës* të vitit 2006, e të cilat më parë i kishte lënë jashtë tij për shkak të, siç e thotë vetë, përmbajtjeve të tyre të papranueshme për kohën ose edhe për shkak të vlerave modeste artistike që kishin. Përndryshe, poeti Mark Krasniqi në librin e tij me poezi për të rritur *Jehona e kohës*, qysh në botimin e parë të vitit 1972, solli edhe prurje të reja artistike, një shprehje të avancuar poetike.

Poezitë e Mark Krasniqit, sidomos ato që ua dedikoi të rriturve, preokupim kanë njeriun tonë, fatin e tij nëpër kohë, atdheun dhe luftën për çlirimin dhe mirëqenien e tij. Këtë mbase poeti e thotë më së miri në këngën për vargjet e tij:

Vargjet e mia kanë mbirë në këtë tokë

Me bar e hithëra, me lule e ferra;

Ato jetojnë si përroi n'bokë,

Si ftoit të vjeshtës u vjen era.

Në botimin më të ri të librit *Jehona e kohës*, Mark Krasniqi përfshin gjithë krijimtarinë poetike për të rritur, që nga shkrimet e para të rinisë së tij të hershme apo të periudhës së para Luftës së Dytë Botërore e deri te poezitë e shkruara viteve të fundit. Strukturimi i këtillë i librit, me poezi të ndara nëpër cikle sipas temave e motiveve që trajtojnë, jep rrugën e zhvillimit të Mark Krasniqit si poet, kon-

sekuencën, misionin e poezisë së tij, stilin origjinal që në pjesën më të madhe të krijimeve poetike del si një shprehje e avancuar popullore, por edhe artistike. Edhe stili, edhe temat e motivet kanë objektiv komunikimin poetik me shtresat më të gjëra të njerëzeve, si me fëmijët, ashtu edhe më të rinjtë e të rriturit, si me lexuesit me ngritje më të lartë intelektuale, ashtu edhe me ata që atë e kanë në shkallë më të ulët. Në këtë libër është me rëndësi që poezitë, sidomos ato më të hershme, kanë të shënuar edhe datën e shkrimit apo të botimit të tyre.

Botimi më i ri i librit *Jehona e kohës* vjen i konceptuar dhe i realizuar si libër i jetës, i jetës së vetë autorit, por edhe i jetës sonë kolektive, me baticat e zbaticat e saj, në të cilën jetë subjektin krijues e shquan guximi në qëndrimet e tij, jeta me fatin e popullit, shpresa dhe angazhimi për një të ardhme më të ndritur, mosdorëzimi para vështirësive, angazhimi për mosdorëzimin para skamjes, dhunës së pushteteve të ndryshme okupuese dhe angazhimi e shpresa për lirinë si ëndërr dhe synim i përhershëm, të cilës, në meditimet e tij poetike, ndër të tjera, poeti Mark Krasniqi i thotë:

*Për ty' liri, u hapën miliona varre,
po ti kurrë nuk vdiqe.*

Mark Krasniqi edhe si poet, edhe si shkencëtar e veprimtar për çështje të atdheut, kombin e pati dhe e ka përherë mbi ndasitë fetare, ndërkaq kufijtë e hapësirës të cilën ai e njeh si atdhe të tij më së miri i paraqet në vargjet:

*Vendlindja ime s'është veç një fshat,
Ajo është vatër e gjerë e gjatë
Që nga Preveza deri n'Tivar –
Gjithkund kam motra e v'llezër shqiptarë.*

Gjendjen sociale të njeriut tonë Mark Krasniqi e paraqet në vjershat si Duajtë e drithit, ku bëhet fjalë për shfrytëzimin e bujkut punëtor me tatime të rënda nga pushteti, por edhe nga hoxhë e priftër, pastaj në poezinë *Sharraxhinjtë*, në të cilën, sikurse edhe Esat Mekuli, i këndon djersës së punëtorëve shqiptarë nëpër rrugët e podrumet e Beogradit për të fituar bukën e gojës për fëmijët e mbetur fshatrave të tyre. Në këso situatash të rënda të skamjes, njeriu ynë jo rrallë merr rrugë mërgimi në vende të tjera, ndaj një vendi të tillë të cilit ia mësyn ai, Amerikës, poeti i thotë:

*Emri yt lind ëndrra e dëshira
Për bukë të bardhë*

E një mijë të mira,

duke bërë kështu një përshkrim rrëqethës të largimit të malësorëve nga trojet e tyre, me ç'rast dëgjohet edhe zëri i ndërgjegjes që u vjen si ushtimë nga arat, fushat e shkëmbinjtë, nga varret për mosharrimin e vendit, të gjuhës, të indentitetit të tyre.

Përveç poezive të tij të hershme, në botimin më të ri të këtij libri Mark Krasniqi përfshin edhe krijimet tij më të reja poetike, të cilat flasin se ai vazhdon të jetojë si poet dhe nëpërmjet poezisë t'i përjetësojë në vargje frymëzimet, idetë dhe qëndrimet e veta, siç bëri për shembull me poezinë alegorike *Përralla e vjetër*, në të cilën vë në spikamë portretin e satrapit të Beogradit dhe të ndihmësve të tij servilë. Edhe në këtë poezi, ngjarjen e së cilës e vendos në kohë të pacaktuar e si vend merr Indinë e largët, ai shpreh mënyrën e tij të krijimit apo misionin e poezisë së tij, me vargjet:

Këtë përrallë ma tha një plak flokëthirë

Para shumë vjetësh, kur isha fëmi'.

Ai m'porositi ta mbaj mend mirë

Dhe t'ia përcjell unë brezit të ri...

Një motivim i këtillë për krijimtari na del edhe në disa poezi të tij si për fëmijë, ashtu edhe për të rritur. Kjo del si nevojë e tij që begatinë dhe përvojën e njeriut tonë nëpër kohë t'ua përcjellë brezave si mësim që do t'u nevojitet në jetë.

Vargjet e Mark Krasniqit ngërthejnë në vete bukurinë e këngëtimit poetik popullor, por krahas kësaj, ato sikur të shëtisin ngapak edhe nëpër atmosferën e poezive të rilindasve tanë, në atmosferën e vargjeve të bashkëkohanikëve të autorit, si të Migjenit, Esat Mekulit, Martin Camajt, por edhe të poetëve të njohur të letërsisë botërore si Sergej Jesenini. Gjuha është e qartë, e kohës dhe e mjedisit, e lexuesit me të cilin komunikon, me frazeologjizma, me fjalë të urta dhe në të shumtën e rasteve me stil e me shprehje nga begatia ligjërimore e popullit tonë.

Një shprehje më të avancuar poetike poeti Mark Krasniqi sjell sidomos në poezinë për fëmijë. Prurjet e reja në artin letrar për fëmijë, në kohën kur u botuan veprat e para të këtij poeti, shprehen para së gjithash me përshkrimet e gjalla të ambientit, të kushteve e rrethanave në të cilat jeton pjesa më e madhe e popullatës sonë, nga gjallon ajo bashkë me faunën e atyre ambienteve, si me shtazët e buta të koteceve, të oborreve e të stallave, ashtu edhe me ato të egrat të zabeleve, të fushave e të maleve të pashkelura. Pra, kemi një ambient sa përrallor, po aq edhe real, në të cilin edhe personifikimet dhe animizimet e per-

sonazheve përjetohen reale dhe bëmat e tyre dalin me funksion në edukimin dhe mësimin e fëmijëve. Personazhet e poezive të Mark Krasniqit jetojnë në ekzotikën e truallit të tij, pikërisht andej nga shumë lehtë do t'i pranojë imagjinata e lexuesve të vegjël, pikërisht andej nga e çonin jetën edhe vetë fëmijët, duke mësuar, duke lozur, duke ruajtur bagëtinë, duke ndihmuar prindërit në punët e fushës apo andej nga i kishin imagjinuar ato ambiente nga përrallat e legjendat që kishin dëgjuar nga gjyshërit e tyre.

Veprat e tij për fëmijë, me sharmin dhe bukurinë e tyre, me përmbajtjet atraktive, me ngrohtësinë e rrëfimit, me mësimet që japin në mënyrë fare të paimponueshme u përqaftuan nga lexues të moshave të ndryshme në Kosovën e atëhershme të etur për dije e zhvillim, duke mos u lëshuar nga duart e vocërrakëve po edhe të të rriturve, odave të kullave e shtëpive të vogla, mbi bankat e shkollave e nëpër klasat të cilat ajër kishin vullnetin, përkushtimin dhe dashurinë për punë të mësuesve tanë, të prindërve që po përqaftonin frymën e re, të nxënësve që si bletët thithnin nektarin e dijes. Pikërisht këto vlera bëjnë që krijimet për fëmijë të Mark Krasniqit të jenë përherë aktuale dhe përherë tërheqëse jo vetëm për fëmijët.

Derisa poezia për të rritur e Mark Krasniqit, në një mënyrë, është kronikë e kohës të cilën e jetuam, poezia e tij për fëmijë është libër mësimi e argëtimi. Nga ai libër fëmijët do të mësojnë për botën e faunës e cila i rrethon, me veprimet interesante, shpeshherë të përshkuara edhe me humor, i cili i bën fëmijët të kënaqen duke mësuar apo të mësojnë duke u kënaqur. Mësimet merren kryesisht nga bëmat e personazheve të cilët ata i njohin qoftë nga përrallat, qoftë nga jeta e tyre e përditshme. Nuk ka nxënës që ka kaluar nëpër bankat e shkollës gjatë këtyre gjashtë decenieve, e të mos i kujtojë me dashuri vargjet me të cilat e fillon Mark Krasniqi postën e tij të porositur:

*Lepur-postieri rrallëherë pushon,
Me çantë nën sqetull pyllit vrapon,
Shkresa zyrtare sjell me rëndësi
Prej rafshit – në male,
Prej malit – në vërri.
Letra, përshëndetje, lajme ekspres
Lepur-postieri ka plot një thes:
Ujku i shfaq deles dashuri pa masë,
Arusha bletës – t'fala me thasë...*

Festën e 90-vjetorit të lindjes së shkrimtarit e shkencëtarit tonë të mirënjohur Mark Krasniqi, siç e theksuam që në fillim të këtij shkrimi, na e bën shumë madhështore fakti se autorin e kemi midis nesh, plotësisht aktiv në jetën tonë kulturore e politike, në misionin e tij jetësor – t'i kontribuojë vendit dhe popullit të vet përherë me vepra të reja; duke qenë mburojë e tij në rastet kur dikush na nëpërkëmbë apo e thotë të pavërtetën për ne, ashtu siç kanë bërë gjatë gjithë historisë, dhe duke u kujdesur që me artin e tij letrar të ndikojë në edukimin estetik e moral të fëmijëve tanë. Dëshmi e kësaj pune dhe e këtij përkushtimi është edhe libri më i ri i tij *Mos fol gojë pa nevojë*, i cili po sheh dritën pikërisht këto ditë, në 90-vjetorin e lindjes së tij, duke na dhënë, ndër të tjera, artistikisht, nëpërmjet vargjeve, shpjegime për shumë xhevahirë të frazeologjisë sonë popullore, si kuptimin e shprehjeve *lepuri në bark*, *miza në kapuç*, *peshku në zall* etj., por edhe me rrëfimet e tij në vargje për rolin dhe rëndësinë që kanë organet e trupit të njeriut për mbajtjen e tij në jetë. Vlerat e këtij libri, rrëfimi poetik plot muzikalitet, urtësia e mendimeve dhe porositë, vitaliteti i këtyre vargjeve na bëjnë të presim edhe krijime të tjera e edhe libra të tjerë nga pena e shkrimtarit tonë Mark Krasniqi, na bëjnë që me arsye jo vetëm të dëshirojmë por edhe të presim që Mark Krasniqi të na gëzojë me vepra të reja edhe në 100-vjetorin e lindjes së tij.

NË 80-VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIK BESIM BOKSHIT



Hivzi ISLAMI, nënkryetar i ASHAK, Prishtinë

NË 80-VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIK BESIM BOKSHIT

Të nderuar kolegë dhe miq,

E nderuara familje Bokshi

Zonja dhe zotërinj,

Jemi mbledhur sot për të shënuar 80-vjetorin e lindjes së profesorit dhe akademikut Besim Bokshi, përvjetor ky që e gjeti në krye të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Interesimi i shkencëtarëve, intelektualëve, punonjësve publikë dhe miqve të profesorit për të marrë pjesë në këtë përvjetor sot ishte i madh, por në mungesë të hapësirës, pa fajin tonë, dolëm refuzues. Arritëm t’ia siguronim një vend kryetarit të komunës së Gjakovës, dr. Pal Lekajt, i cili para 10 ditësh, për kontributin në zhvillimin arsimor, kulturor e kombëtar, e dekoroi akademik Bokshin me çmimin Nderi i komunës së Gjakovës”. Në emër të Akademisë e përshëndes dhe e falënderoj kryetarin Lekaj për këtë dekoratë.

Akademik Bokshi bën pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj këto 6 dekadat e fundit, ku la gjurmë të pashlyeshme, veçanërisht në gjuhësinë shqiptare, duke u gjendur sot në majat e saj. Punën e tij e filloi në Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku ushtroi funksione të ndryshme në arsim e kulturë në vitet e ‘50 e ‘60 të shek. të kaluar, për të arritur deri te bashkëpunëtori shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, profesori i UP-së dhe anëtar i rregullt i Akademisë dhe kryetari i saj. Edhe sot e gjithë ditën vazhdon të kontribuojë në fushën e shkencës gjuhësore dhe albanistike në përgjithësi, duke zgjeruar opusin e tij të tërësishëm shkencor me botime të reja. Për këtë dëshmon edhe studimi i tij i fundit, me titull “Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes” të cilin e kemi sot në dorë. Vepra e tij shkencore në sferën e gjuhësisë do të mbetet pa dyshim burim reference për brezat e sotme e të nesërme.

Referuesit që do të flasin sot për personalitetin e prof. Besim Bokshit shpresoj se do të nxjerrin në dritë të dhëna dhe fakte të panjo-

hura ose më pak të njohura për rrugën jetësore, intelektuale, shkencore-hulumtuese dhe publike të tij.

Para se të flasim kompetentët, akademikët Ismajli, Ajeti, Aliu, Lika, Topalli dhe profesorët Mansaku e Badallaj, më lejoni që, së bashku me të gjithë ju të pranishëm, Kryetarin tonë të nderuar, Akademik Besim Bokshin ta falënderojmë për gjithë atë që ka bërë në fushën e gjuhësisë dhe të dijeve albanologjike, për afirmimin e vlerave kombëtare e kulturore-civilizuese të shqiptarëve dhe në organizimin e institucioneve shkencore-kulturore të Kosovës, t'i urojmë shëndet të plotë, jetë të gjatë dhe punë të frytshme krijuese. Uroj gjithashtu që së bashku me profesorin të gjendemi edhe në 90-vjetorin e tij, jo në këto lokale, por në objektin e ri.

Faleminderit!

Rexhep ISMAJLI, ASHAK, Prishtinë

ALBANISTI DHE INTELEKTUALI I SHQUAR BOKSHI

KUD 811.18-26

929(496.51) Bokshi, Besim

Më 12 nëntor 2010 u mbushën 80 vjet të lindjes së akademik Besim Bokshi, personalitet i shquar i shkencës dhe kulturës shqiptare në disa drejtime: me ndihmesat e tij të dorës së parë për studimet albanistike, si gjuhëtar nga më të veçantit dhe gjithsesi nga më të rëndësishmit; me krijimtarinë letrare poetike dhe me veprimtarinë intelektuale publike e arsimuese.

I lindur në Gjakovë më 1931, i diplomuar në albanologji në Beograd më 1958, i doktoruar në shkencat filologjike me specializim në fushë të historisë së gjuhës shqipe në Prishtinë më 1978, profesor dhe drejtor i gjimnazit në Gjakovë, profesor dhe Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjakovë, profesor dhe Shef i Degës së Gjuhës Shqipe në Fakultetin Filozofik/ Filologjik të Universitetit të Prishtinës, i zgjedhur anëtar korrespondent (1989) dhe anëtar i rregullt i ASHAK (1996), nënkryetar i ASHAK 2002-2008 dhe kryetar nga viti 2008, pjesëmarrës aktiv dhe bashkëhartues i Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe i Kongresit të Drejtshkrimnit, drejtues i Komisionit për Gjuhë i ASHAK, Kryetar i Komisionit në formim për Etikë dhe Integritet Shkencor, është i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, të qetë dhe me gjurmë të shënuara në veprimtarinë kulturore, shkencore e arsimore-shoqërore shqiptare qysh nga vitet '50 të shekullit 20. Dhe prania e tij në këta lëmenj të jetës shqiptare do të mbetet e shënuar me ndihmesa thelbësore, me rezultate që çojnë peshë.

Në veprimtarinë e tij shoqërore Besim Bokshi ishte gjithnjë i lidhur me fushën e arsimit, ku arriti autoritetin e njeriut të dijshëm, të thellë dhe të drejtë, dhe pikërisht në bazë të një autoriteti të tillë ishte kërkuar nga ai të angazhohej në funksione të ndryshme shoqërore, nga deputeti i Kosovës në fund të viteve '60 e deri te Kryetari i Partisë Socialdemokrate të Kosovës në vitet '90 të sh. XX.

Në letrat shqipe emri i Besim Bokshit ndeshet qysh në vitet '50 me ciklin e poezive me ngjeshje të madhe semantike e emocionale në tamën e poezisë refleksive e shoqërore, shpesh me vulën e protestës së nënkuptuar, me metaforikën e thellë e me simbolikën kombëtare, poe-

zi që nuk mbështetet në proliferimin e fjalës, po zhytet në thellësitë dhe degëzimet e simboleve, të kuptimeve. Qysh në vitet '50-'60 të sh. XX atë e shquante ikja nga folklorizmi drejt refleksionit të përqendruar. Në poezinë e Besim Bokshit edhe tematizimet sociale marrin vulën e refleksionit, shprehen me një figuracion të kursyer, por të thellë.

Shkëlqimin madhor të mendjes krijuese akademik Besim Bokshi do ta shënojë në studimet për gjuhën shqipe, ku qysh sot vlen ndër autoritetet më të mëdha. Me hulumtimet e tij frymëgjata e të thelluara në fushën e lingistikës, në fushën e strukturës gramatikore të shqipes dhe zhvillimet nëpër të cilat do të ketë kaluar ajo nga fazat më të hershme deri në gjendjen e sotme, me vërtetimet e rëndësishme për strukturat gramatikore të gjuhëve të Ballkanit, akademik Besim Bokshi ka sjellë dhe po vazhdon të sjellë kontribute me vlerë të jashtëzakonshme. Ndhimesat e tij për studimet e zhvillimeve gramatikore të shqipes zënë vend të veçantë për origjinalitetin e mënyrës së hulumtimit, për rezultatet e shumta, për thellimin krejt të veçantë, për vështirimin sistemor e struktural të ri në këto studime, për orientimin e përgjithshëm të tyre drejt horizonteve të reja, për krijimin e një koncepti koherent dhe konsistent për rrugët e zhvillimeve morfologjike, në ndërlidhje me zhvillimet e tërësishme strukturore të shqipes. Këto arritje të tij janë shtrirë për një pjesë dhe në studimin e strukturave gramatikore të gjuhëve ballkanike. Me monografitë serioze të tij, akademik Besim Bokshi u ka dhënë studimeve albanologjike një ndihmesë të rendit të parë dhe me këtë një shtysë për zhvillime që do të jenë të frytshme në të ardhmen. Duke i integruar studimet për strukturën gramatikore të shqipes në rrjedhat studimore të kohës, duke i shpënë ato ndjeshëm përpara dhe modernizuar në metodën e studimit për të sjellë rezultate të ndjeshme, akademik Besim Bokshi e ka rritur kredibilitetin e studimeve albanistike shqiptare në komunitetin e studiuesve të gjuhës dhe ka krijuar një model për të ndjekur nga të rinjtë.

Në studimet albanologjike Besim Bokshi me rezultate të veçanta u paraqit më 1971 me studimin për atë kohë befasishëm të thellë për tipat e temave nominale në gjuhën shqipe. Në vazhden e atij studimi, që mund të ishte dhe baza interesante për periodizimin e historisë së shqipes duke u mbështetur në argumente thjesht gjuhësore, më 1978 Bokshi përfundoi monografinë *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Në atë monografi dalin në shesh tërësisht cilësitë kryesore të linguitit Bokshi: orientimi rezolut diakronik, por prandaj me vështirim të thelluar në funksionimin sinkronik të sistemit gjuhësor – ku shihen mirë bërthamat e lëvizjeve të mundshme të hetuara në proceset e mëvona apo rezultatet e të mëparmeve. Në studimet e gramatikës historike të shqipes,

që tashmë kishin një traditë, me atë vepër nëpër derë të madhe futeshin metodat gjuhësore mbisunduese të shekullit XX, ato që gjuhën e shihnin si sistem dhe që për bazë të shpjegimeve kishin strukturat e rrafshëve të ndryshme të gjuhës. Konceptimi i tërësishëm i sistemit nominal të shqipes në zhvillimin e tij dhe jo në zgjidhjet e veçanta e parciale, sado të rëndësishme që mund të jenë ato, ishte baza e gjerë e shtruar në atë libër të rëndësishëm të studimeve të historisë së shqipes që bëri të mundshme pastaj shumë zgjidhje konkrete e të veçanta. Në kërkimet e tij vend me rëndësi zinte hulumtimi i arsyeve funksionale të njësisë të ndryshme të fleksionit nominal të shqipes së sotme dhe ngjitja pastaj nëpër shkallët e zhvillimit duke kaluar nëpër fazën e dokumentimit të parë te Buzuku, përmes rindërtimit të huazimeve latine e greke, deri në një fazë të mugët të rindërtuar e të supozuar të dalë nga gjendja indoeuropiane në bazë të krahasimit të gjuhëve të tjera. Kështu ai qysh atëherë kishte thënë: "...ndriçimi i rrugës nëpër të cilën kaloi (sistemi nominal) nuk mund të arrihet duke zbuluar etimologji inkompatibile e inkoherente të elementeve të tij, ...por duke zbuluar totalitete sinkronike si transformime suksesive të këtij sistemi".

Nuk është vështirë që edhe nga fragmente si ky të hetojmë gjurmë të traditës së studimit struktural gjithsesi jo shumë të begatshëm në fushë të historisë së gjuhëve. Në tërësinë e tyre, konceptimet linguistike të Bokshit ndjekin vijën funksionale të gjuhësisë strukturale, por shpesh u drejtohen dhe konceptimeve distribucionaliste. Ndërkaq, dijet teorike të këtij horizonti janë vetëm në funksion të hulumtimeve të thelluara të këtij autori për strukturën dhe për zhvillimet e shqipes, ashtu si dhe të gjuhëve ballkanike.

Kjo monografi e Besim Bokshit mbetet një nga veprat me rëndësi themelore për studimet në fushën e zhvillimit të strukturave nominale të shqipes dhe të gramatikës historike të shqipes në tërësi. Idetë për ndryshimet themelore në strukturën fleksionale të sistemit indoeuropian për pasojë të veprimit të theksit dinamik në një fazë shumë të hershme në shqipen, për zhvillimet që e kanë krijuar sistemin e ri eptimor në këtë fushë, ashtu si dhe shpjegimet e shumta për detaje të panumërta që dalin si rezultat i shpjegimit të zhvillimit sistemor, në këtë vepër kanë gjetur interpretimin më të plotë, më të thellë dhe më largvajtës.

Rezultatet e studimit monografik për fleksionin e sotëm nominal të shqipes fare natyrshëm shërbyen si mbështetje e sigurt për të kaluar në një shkallë tjetër të studimeve diakronike – në shpjegimin e çështjeve me interes ballkanologjik, fushë në të cilën shqipja zë një vend qendror.

Prapavendosja e nyjave në gjuhët ballkanike është një libër tjetër me vlerë i Besim Bokshit, këtë herë jo vetëm për albanologjinë, po drejt-

përsëdrejti për ballkanologjinë. Në të ai është marrë me shpjegimin e arsyeve dhe të proceseve të krijimit të nyjave nga dëftorët, të shkaqeve dhe të kohës së prapavendosjes dhe të aglutinimit të tyre në gjuhët shqipe, rumune, maqedone e bullgare. Me librin e Bokshit hipoteza për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në shqipen, dhe kjo mbështetet me argumente të gjera të zhvillimeve strukturore fonetike, morfologjike e sintaksore, duke mos lënë anash as vështrimet e gjera për zhvillimet në gjuhët e tjera, pra kjo hipotezë vjen e bëhet një teori e rëndësishme, refutimi i së cilës tashmë nuk është gjë e lehtë.

Në albanistikë ka mbisunduar mendimi se nyja shquese, ashtu si dhe prapavendosja e saj, është e lashtë, prandaj është parë ose si e ardhur nga substarti paraindoeuropean, ose si zhvillim i një rruge indoeuropiane në shqipen. Albanistë të ndryshëm e kanë respektuar tërësisht idenë e Holger Pedersenit për lashtësinë e nyjës dhe të prapavendosjes së saj në shqipen. Bokshi, në vijim të studimeve të tij të thelluara për tërësinë e sistemit nominal, i pezullon etimologjitë përkatëse dhe bashkë me to edhe tezën e lashtësisë së nyjës së shqipes në këtë trajtë. Ai nisat nga vlerësimi i Norbert Joklit se aglutinimi i nyjës do të ketë ndodhur brenda periudhës së huazimeve latine, për të nxjerrë përfundimin se aglutinimi ka ndodhur “pas përfundimit të huazimeve latine e para përfundimit të rotacizmit që neve na del të ketë pushuar së vepruari në sh. VIII”. Kështu atij i del e papranueshme edhe teza se nyja e prapavendosur me origjinë nga dëftori enklitik është e lashtë, ndërsa e paravendosura dhe ajo e mbiemrit dhe e dëftorit e re. Teza se nyja shquese në shqipen ka qenë e përparme autorit tonë i del e drejtë në mbështetje të analizës së sintagmës nominale dhe të grupit nominal ashtu si e bën ai vetë. Të gjitha këto ide dalin në pajtueshmëri me idetë për kohën e krijimit të nyjës shquese në gjuhët europiane – romane e gjermanike.

Trajtime të thelluara të natyrës morfologjike, por edhe të zhvillimit fonetik, përveç për shqipen, Bokshi ka bërë edhe për rumanishten e për bullgarishten. Fillimin e kapërcimit të shqipes nga struktura sintetike drejt strukturës sintetike-analitike e më tutje drejt analitizmit, për pasojë të veprimit të theksit dinamik, qysh në veprën e parë, Bokshi e kishte parë të kishte ndodhur në kohën e huazimeve greke të lashta dhe latine të hershme. Atë kohë, pra kohën e analitizmit, ai e kishte parë si kohë të krijimit të nyjës shquese në shqipen, e cila deri te aglutinimi përfundimtar i nyjës kishte kaluar nëpër tri faza. Ky aglutinim kishte ndodhur para mbarimit të rotacizmit (para sh. VIII). Vetëm para se të bëhej aglutinimi atij i del e mundshme që shqipja të ketë pasur mundësi të ndikonte në

rumanishten, përkatësisht në latinishten popullore: "...shqipja nuk do të ndikonte që *homo ille* të përgjithësohej e të fitohej nyja postpozitive në rumanishten, jo vetëm pse kjo renditje, siç u pa, nuk mund ta shpjegojë fenomenin në këtë gjuhë, por edhe pse shqipja në kohën e ndikimit nuk e kishte renditjen emër-nyjë (pus-i). Shqipja ka ndikuar në latinishten përkatëse vulgare në kohën e kalimit të saj në rumanishte. Atëherë ajo e ka pasur topikën *trim i djalë, i thellë i pus* në grupin nominal të plotë dhe *i pus* në grupin nominal pa mbiemër, kështu që ajo do të ndikonte në latinishten të favorizohej topika *bonus ille homo* dhe *ille homo*". Dhe një mundësi të ngjashme do ta ketë rumanishtja në raport me sllavishtet e jugut, mendon Bokshi.

Në vazhden e ideve dhe të metodës shkencore të përdorur nga Bokshi në dy librat e parë del krejt e natyrshme të presim shpjegime kështu koherente dhe konsistente për pjesët e tjera të sistemit joverbal të shqipes. Dhe këtë ai më duket se tashmë po e kërkon për përemrat. Por më parë ai na ka dhënë një monografi të re të rëndësishme për një segment të strukturës morfologjike të shqipes që na shpie drejt shpjegimeve edhe të sistemit foljor po me këto rrugë e procedime: monografinë *Pjesorja e shqipes*.

Për të arritur një rezultat me peshë, B. Bokshi, në rrugën e tij fryt-dhënëse të studimit të aspekteve diakronike të sistemit emëror të shqipes, të formave dhe të kategorive të ndryshme, pasi të kishte veçuar aspektet formantike, bën së pari rindërtimin e përndarjes së formave të ndryshme participore të shqipes, me këtë dhe të funksioneve, dhe pastaj depërton më thellë në identifikimet e burimeve në rrafsh krahasimtar indoeuropian.

Studimin e vet Besim Bokshi e ka ndërtuar sipas një rrjedhe të sprovuar mirë nga ai: raportim sistematik dhe kritik i studimeve të deritashme në këtë fushë, analizë e pikave problemore, rindërtim i tërësisë, formantike dhe funksionale, në të cilën kanë ekzistuar ato formante. Ky konceptim eksponon dhe një vështirësi të tij për strukturën gjuhësore në tërësi – njësitë morfologjike nuk shihen të veçuara nga funksionet e tyre sintaksore.

Në këtë libër ai ka shtruar një varg problemesh që lidhen me pjesoren e shqipes në rrafshin morfologjik, aktual dhe historik, në rrafshin e zhvillimeve fonetike, në fushë të etimologjisë, në fushë të funksioneve të pjesores në raport me format e tjera foljore dhe me kategoritë e tjera, në rrafshin e rindërtimit të formanteve dhe të funksioneve të participeve të shqipes, duke i krahasuar ata me ato të simotrave indoevropiane. Analiza e veçantë, me mbështetje në përndarjen (distribucionin) si çelës për identifikim të funksioneve dhe të formave, i ka sjellë atij një varg përgjigjesh

jo vetëm për çështjen e pjesores, po edhe për çështjet që lidhen me të.

Në tërësi, librat linguistikë të Besim Bokshit paraqesin një ndihmesë me vlerë të jashtëzakonshme për studimet diakronike të shqipes. Shquhen me depërtime të veçanta në analizat dhe interpretimet e tij për albanologjinë, rezultatet e kapshme në fushat përkatëse, me nivelin kulminant shkencor, me diskutimet e gjalla dhe modelet e analizave të pabëra më parë.

Depërtime të ngjashme të Bokshit në studimet e strukturës gramatikore të shqipes në zhvillimet e saj ndeshim dhe në studimin me interes *Për vetorët e shqipes*, ndërsa kërshërinë tonë të madhe e zgjon sidomos libri i tij i fundit *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes* që sapo ka dalë nga shtypi. Në këtë vepër sintetizuese në njëfarë mënyre për idetë e tij në këtë fushë dhe për tërë periodizimet e propozuara deri tash mbi bazë të fakteve gjuhësore, Bokshi është marrë së pari me ndryshimet që kanë shënuar ndarjen e proto-shqipes nga para-indoeuropianishtja dhe me ndryshimet e epokës paraballkanike dhe ballkanike të shqipes deri në sh. V para Epokës së Re, kur mendon se do të kenë filluar kontaktet me greqishten e vjetër. Në atë epokë ai vendos reduktimin e temave emërore, që e sheh si fillim të pavarësimit të proto-shqipes, me gjininë të gramatikalizuar, me vectorë të diferencuar, me lëvizje në fushën e pjesoreve dhe në fazën e dytë me formimin e theksit dinamik dhe me lëvizjet në fushën e rasave. Këtë fazë të parë ai e ndan nga faza vijuese që shkon deri në sh. V të epokës së re. Në vijim ai veçon katër periudha:

I. Periudha që shkon deri nga fundi i sh. V, me rënien e fleksionit të mbaresave rasore dhe përfitim të njës shqese, pastaj me krijimin e formave analitike të foljeve jotransitive, të paskajores me *me* dhe të futurit me *do* e me *kam*;

II. Periudha që shkon nga sh. VI deri në sh. VIII, kur shqipja transformohet nga gjuhë analitike në gjuhë sintetike e analitike, kur vendoset nyja e parme e mbiemrit e gjinore, rivendoset sistemi i mbaresave rasore, merr fund metafoia dhe palatalizimi, formohen paradigma të reja të shumësit, krijohet optativi dhe merr fund rotacizmi;

III. Zhvillimet që ndodhin midis sh. IX dhe XII: formimi i sintagmave parafjalore të dhanores e të rrjedhores; formimi i optativit; formimi i pronorëve të rinj; përdorimi i zanoreve mbështetëse; formimi i prefiksive deiktikë; unifikimi i temës së emërores sipas shumësit; formimi i formave kompletive pa theks të shumësit *u*, *i*, *na*; kalimi i pjesores pësore e tashme në pjesore pësore e shkuar; zhdukja e përdorimit të pjesores me *me* + *forma e pjesores* në tosk., etj.;

IV. Zhvillimet midis sh. XIII e XV, me formimin e tri shkallëve të gjatësisë së zanoreve, me singularizimin e formës së shumësit e krijimin e temës emërore paroksite me *-e* për femërorët; me sintagmën parafjalore të emërores dhe aglutinimin mekanik të nyjës në akuzativ (*ndë dorëtë djathtë*) dhe të sintagmës gjenitive (*mish lopet të mirë*); me formimin e formës së lidhore-habitores; me ambigjeninë e emrave; me zhvillimet divergjente midis dy dialekteve në sistemin rasor, etj.;

V. Zhvillimet midis sh. XVI e XX: Kjo fazë trajtohet si shqipe e sotme, prandaj edhe po e lëmë më pak të zbërthyer.

Me këtë libër B. Bokshi ka bërë dhe një hap tjetër me rëndësi, duke bërë sintetizimin e ideve të tij lidhur me periodizimin e shqipes dhe duke vënë kështu një rend që mund të prodhojë ide të reja më tej në fushat përkatëse.

Me peshën e rezultateve të tij të punës, me thellësinë, me refleksivitetin prej të urti, me vendosmërinë dhe guximin prej hulumtuesi të përkushtuar, me lirinë dhe dritën e mendjes dhe me afërsinë njerëzore, akademik Besim Bokshi na ka bërë të ndjehemi krenarë që e kemi koleg dhe shok në Universitet, në Akademi, në institucione apo jashtë tyre, në tërë këto dekada. Me butësinë dhe dashamirësinë e tij, me përmbajtjen dhe respektin ndaj tjetrit, ai rrezaton qetësi dhe siguri tek rrethi.

Zoti Nënkrjetar, më lejoni që në këtë ditë të shënuar, kur akademik Besim Bokshi mbush 80 vjet dhe na vjen këtu me librin më të ri *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, t'i shpreh shkencëtarit të shquar, dijetarit të urtë, kryetarit të Akademisë sonë, akademik Besim Bokshit urimet më të përzemërta dhe t'i dëshiroj shumë vite të mbara e ndriçime të reja të mendjes së tij, për ta begatuar më tej dijen dhe botën tonë me ndihmesat e tij krejt të veçanta.

Veprat e Besim Bokshit:

Në pritje, Jeta e re, Prishtinë, 1966. Ka pasur dhe disa botime të zgjeruara më vonë te Rilindja, Prishtinë. Botim i dytë, te Rilindja, Prishtinë, 1978.

Në pritje, poezi e zgjedhur, Poetët Akademikë, ASHAK, Prishtinë, 2006, ff. 98, Parathënia R. Ismajli: *Poezia e Besim Bokshit*, ff. 5-14.

U oçekivanju, poezia, përktheu E. Mekuli, Bagdala, Kruševac, 1969.

Hijet e këputura, aforizma, Bibl. Rozafa, Dukagjini, Pejë, 1996, ff. 105.

Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë, 1980, ff. 395. Botimi II te ASHAK, Prishtinë, 2005, ff. 509.

Prapavendosja e nyjeve në gjuhët ballkanike, Rilindja, Prishtinë, 1984, ff. 260. Bot. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009.

Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1998, ff. 218.

Për vetorët e shqipes, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, ff. 195.

Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2010, ff. 256.

Idriz AJETI, ASHAK, Prishtinë

NË 80-VJETORIN E BESIM BOKSHIT

KUD 811.18-26

929.496.51(496.51) Bokshi, Besim

Sot Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shënon 80-vjetorin e lindjes së akademikut dhe Kryetarit Besim Bokshit, e unë kam kënaqësinë, që shkurt, si e do puna në raste të këtilla, t'i them di-sa fjalë për jubilarin, për shkencëtarin e shquar dhe të veçantë në fu-shën e albanistikës.

Në një intervistë të dhënë për *Koha ditore* më 20 dhjetor 2008, akademik Bokshi flet për hapat e parë në studimet gjuhësore, në metodat e reja të cilat deri atëherë nuk i kishte përdorur kush tjetër pos tij, për formulën e suksesit të tij. Por unë nuk mund t'i iki kërkesës, siç dikton praktika, që, biografinë e Bokshit, mos ta nis nga koha e rinisë së tij.

Gjakovë 1930, mësoi në Gjakovë e Prishtinë, studioi albanologji në Beograd. Mbrojti disertacionin e doktoratës në shkencat filologjike në Pri-shtinë (1977). Profesor gjimnazi në Gjakovë, profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike, profesor i historisë së gjuhës shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës, drejtor gjimnazi (1962-63), drejtor i SHLP-së (1969-74), Kryetar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës (1993-96), anëtar korrespondent i ASHAK-ut 1991, anëtar i rregullt-akademik më 1996. Më 2002 u zgjodh Nënkryetar i ASHAK-ut. Fitues i Çmimit të Dhjetorit (të Kosovës) për Shkencë (1980).

Përpyekjet e Bokshit për formimin e tij si një linguist modern, i cili i zotëron metodat e reja të linguistikës. Bokshi thekson edhe vetë se qysh i ri tregonte se kishte afinitet ndaj gjuhës. Dija që kishte marrë në studime në shkallën e tretë – siç pranon edhe vetë, megjithëse nuk i mungonte baza e fituar, nuk i mjaftonte që të merrej me gjuhësi, pran-daj, shton akademik Bokshi, iu desh t'i studionte vetë metodat e reja të cilat në studimet gjuhësore shqipe nuk ishin përdorur deri atëherë, por, siç thotë Bokshi, atij i dolën në glosematikën dhe distribucionalizmin.

Veprat kryesore të Besim Bokshit:

Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes; botim i dytë, 2005. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike (1984)

Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik) 1998

Për vetorët e shqipes, 2004

Periodizimi i ndryshimeve morfologjike i shqipes (2010)

Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes është vepra e parë kryesorja e paraqitur si temë disertacioni e doktoratës, punuar 7 (shtatë) vjet të plotë, pjesë të së cilës të prekura, por atëherë jo të trajtuara gjerësisht e në mënyrë të plotë, siç dolën vepra në vete në kohën që do të vinte.

Në paraqitjen tonë atëherë thoshim: mbi mbështetje të realizimeve të përkorta, episodeke, të kryera në këtë fushë studimesh, në lëmin e morfologjisë historike të gjuhës sonë, duke nisur me Boppin në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar dhe duke qenë, me të drejtë, i pakënaqur me rezultatet e arritura në këtë truall studimesh, Bokshi ka marrë dhe ka shtruar të gjitha ato probleme që janë të domosdoshme në sistemin nominal të shqipes.

Ky trajtim i hapët i gjithë inventarit gjuhësor të fleksionit nominal të shqipes, përveç një ecurie të rreptë shkencore që është zbatuar, shquhet në mënyrë të veçantë për ndjekjen e një rruge të re, sepse të gjitha çështjet e hetuara, janë parë brenda sistemit në tërësinë e tyre, duke pasur për qëllim zbulimin e totalitetit sinkronik si dhe ndryshimet që sistemi në rrjedhë të kohës ka pësuar.

Duke u mbështetur në rrafshin metodologjik që B. Bokshi ndoqi fund e krye, në këtë vepër të cilën atëherë e quanin studim disertacioni, ai rezultatet e derisotme në fushë të studimeve morfologjike i revidoi në një masë të madhe dhe bëri vlerësime të reja që nuk pajtohen me ato të studiuesve më parë, përkundrazi këto u bien ndesh atyre. Ndonjë analizë e bërë mbi materialin e shqipes, s’jemi të sigurt – thoshim atëherë, ta kenë vërtetuar qëndrueshmërinë e skemave të huaja gjuhësore.

Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike (1984).

Në këtë vepër a punim qysh e quan autori, i cili thotë: “ne jemi përpjekur të përcaktojmë burimin e postpozicionit ballkanik e të përhapjes së tij në bazë të rezultateve të reja që kemi arritur gjatë shqyrtimit të zhvillimit historik të nyjës në gjuhën shqipe”. Këto mendime të thëna, pra, nga studiuesi, profesor Besim Bokshi, pas përpjekjeve të

një lagjeje studiuesish t'i hetonin dhe gjenin burimin e postpozicionit në gjuhët ballkanike të mbetura supozime.

Pas dy të parave vijnë edhe tri vepra të tjera që janë: *Pjesorja e shqipes, një vështrim diakronik*, ka gjetur zgjidhjen më të saktë të mundshme. (1998)

Për vetorët e shqipes botuar më 2004 në Prishtinë

Periodizimi i ndryshimeve morfologjike i shqipes, 2010

Duke përfunduar këtë vështrim krejt të shkurtër dhe të thatë që u përpoqëm ta japim për profesorin, akademikun, për njohësin e vërtetë të historisë së gjuhës shqipe me problemet e ballkanistikës, në mënyrë të veçantë, për hetuesin dhe gjurmuesin e problemeve në morfologjinë e gjuhës shqipe, për problemet e formimit të fleksionit nominal të gjuhës sonë, për prapavendosjen e nyjës në gjuhët ballkanike, për pjesoren e shqipes, për vetorët të përfshira në pesë vepra të shënuara sipër, ne e përshëndesim (Profesorin-akademikun) dhe e përgëzojmë për arritjet e shumta me urime që plot shëndet të na japë edhe ndonjë vepër tjetër – motërmë e të parave.

Postscriptum: Profesor e akademik Besim Bokshi – një filolog i spikatur, i ngritur në filologjinë shqiptare në një kolos të veçantë, me shokë gjithashtu të veçantë për çka pesë veprat sipër të dhëna flasin e janë dëshmia më e besueshmja, më e forta. Për ata që mund të shprehin mendimin se numri i veprave shkencore të tij do të pritej të ishte më i madh, përgjigjja jonë që do t'i qetësonte ishte kjo: ne do t'i drejtohem shkencëtarit të madh gjerman Albert Ajnshtajn (Einstein) për mendimin a fjalën e urtë të tij që është: “mos u përpiq të bëhesh njeri që ka sukses, por përpiqu të bëhesh një njeri që ka vlera”.

Kolec TOPALLI, Akademia e Shkencave, Tiranë

RRUGA E SUKSESSHME E NJË SHKENCËTARI

KUD 811.18-26

Një përvjetor i 80 i jetës është i lakmueshëm prej të gjithëve. Disa e festojnë brenda familjes, disa brenda farefisit e miqve. Por ka disa përvjetorë që i kapërcejnë kufijtë e shtëpisë e të farefisit, madje edhe të shtetit. I tillë është përvjetori që na ka bashkuar, një përvjetor i tërë trevave shqiptare, i tërë kombit. Atë e bëjnë të tillë veprat që ka botuar autori, veprimtaria e dëndur patriotike, shkencore, kulturore e artistike në shërbim të kombit, të albanologjisë dhe të letërsisë shqiptare.

Punimet shkencore të albanologut Besim Bokshi janë një kontribut i vlefshëm për fushën e rëndësishme të gramatikës historike, studimi i së cilës zë fill para më shumë se 150 vjetësh, kur njëri nga themeluesit më në zë të gjuhësisë krahasimtare, Franz Boppi, botoi të parin studim me vlerë për historinë e gjuhës shqipe, “Përmbi shqipen dhe lidhjet e saj farefisnore”. Pas tij, një varg gjuhëtarësh nga vende të ndryshme hodhën hapa të tjerë në këtë rrugë të vështirë, në të cilën, duke filluar me gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, krahas të huajve, filluan të ecin edhe studiuesit shqiptarë. Njëri prej tyre, që vjen me duar plot në 80-vjetorin e lindjes, është akademiku Besim Bokshi.

Të punosh në fushën e historisë së shqipes, veç përgatitjes së thellë, dijeve të gjera e njohjes së gjuhëve, kërkohet edhe vullnet e këmbëngulje, përkushtim e atdhetarizëm, të cilat asnjëherë s’i kanë munguar këtij dijetari. Këto cilësi janë reflektuar në të gjithë punën e tij shkencore, që karakterizohet nga përpjekjet për të dhënë shpjegime sa më të sakta, të mbështetura në materiale të gjera e në argumente të shëndosha. Duke ndjekur hullinë e paraardhësve që punuan në këtë fushë, akad. Bokshi me përpjekje shumëvjeçare ka paraqitur shpjegime e zgjidhje të reja për shumë nga problemet e historisë së shqipes, që vijnë si përfundim logjik i hulumtimit të kujdesshëm të materialit gjuhësor. Në analizën e fakteve të shqipes gjenden të gërshetuara të dhënat e morfologjisë historike me ato të fonetikës e të sintaksës. Një vështirësi i tillë i gjithanshëm i dukurive dhe fakteve i bën përfundimet e analizave më të qëndrueshme e më bindëse.

Tematika e punimeve të këtij dijetari është e lidhur me çështjet më problemmore të morfologjisë së gjuhës shqipe, siç janë krijimi i sistemit rator, ndryshimi i strukturës së temave emërore, formimi i nyjave dhe evolucioni i tyre, origjina dhe zhvillimi historik i paremrave, të formave të pashtjelluara etj. Me këtë tematikë ai përpigjet të depërtojë në thelbin e strukturës morfologjike të shqipes për të zgjidhur aspektet më të vështira të sistemit të saj gramatikor, ato që i japin fizionominë e veçantë, duke e dalluar nga gjuhët e tjera të familjes indoevropiane. Këto tipare të punës së tij gjenden në të gjitha veprat gjuhësore, ku shkalla e pjekurisë shkencore paraqitet e njëjtë.

Për të konkretizuar veçoritë e metodës dhe metodologjisë së punës së këtij dijetari, po hedh një vështrim të shkurtër mbi veprën “Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike”. Në të mund të shihet një shfrytëzim racional i të gjitha tezave, mendimeve dhe shpjegimeve të dhëna rreth kësaj dukurie, që ka përfshirë thujajse të gjitha gjuhët ballkanike, ndërsa vetë dukuria përbën aspektin më tipik, por edhe më të vështirë të gjuhëve të këtij Gadishulli, ku shqipja mban një peshë kryesore.

Për hulumtimin e kësaj dukurie, autorit i është dashur të përshkojë të dhëna të shumta nga degët e veçanta të shkencave gjuhësore, si nga ballkanistika, ilirologjia, romanistika, helenistika, trakologjia, sllavistika etj., meqenëse hipotezat e hedhura për këtë dukuri, që e kalojnë numrin dhjetë, lidhen me të gjitha këto fusha. Substrati, adstrati a superstrati me burim gjuhët ballkanike, ilire, trake e deri paraindovropiane, ndikime nga greqishtja, latinishtja apo edhe nga armenishtja e frigishtja, zhvillime paralele a ndikime reciproke të gjuhëve të veçanta, janë disa nga tezat, para të cilave është ndodhur dijetari ynë, duke kërkuar edhe një përgjigje prej tij. Është një qerthull i tërë hipotezash e supozimesh, të hedhura prej më shumë se një shekulli nga shkencëtarët e shumë vendeve të Evropës, që nisin me indoevropianistët Brugmann e Schuchardt, ballkanologët Sandfeld, Weigand, Georgiev, Skok e Miklosich, për të vijuar me romanistët Tagliavini e Pisani, rumunologët Graur, Rosetti, Hasdeu e Pușcariu; sllavistët, Seliščev, Mladenov, Piotrovski e Koneski dhe me albanologët Meyer, Pedersen, Jokl, La Piana, Çabej, Riza etj. Pas një vështrimi kritik të të gjitha këtyre tezave, me një hulumtim të thellë e të argumentuar, autori i veprës vë në plan të parë me objektivitetin e duhur shkencor rolin e shqipes në formimin e kësaj dukurie, që me të drejtë është quajtur çështja më e ndërlikuar e gjuhësisë ballkanike.

Por krahas problemit të origjinës, jo më pak e koklavitur është edhe kronologjia e kësaj dukurie, me të cilën është ndeshur çdo gjuhëtar, që është marrë me këtë çështje, e cila veç faktorit të kohës përfshin në vetvete edhe atë të raportit kohor që paraqesin ndërmjet tyre dy variantet e nyjave në gjuhët ballkanike, nyja e përparme dhe e prapme. Për të gjitha këto probleme, gjykimet e dhëna janë luhatur në periudha shumë të gjata kohe, që e kanë zanafillën në periudhën parahistorike e vijnë deri në Mesjetën e hershme. Në këtë mes, duke dhënë gjykime të matura, kohën e formimit të tyre autori e vendos në periudhën e hershme latine, duke lënë kështu mënjane si të paargumentuara sa duhet tezat që e shikojnë formimin e tyre në një kohë tepër të lashtë parahistorike, ashtu edhe ato që e shikojnë këtë dukuri të formuar në kohë relativisht të vona, në periudhën e Mesjetës.

Vepra sjell një kontribut të çmueshëm jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe, për morfologjinë, fonetikën e sintaksën e saj, por ajo përmban vlera edhe për historinë e gjuhëve të tjera ballkanike, si një përpjekje e re për të sqaruar njërën nga dukuritë më të lashta, por edhe më të vështira të këtyre gjuhëve. Kjo rrjedh edhe nga mënyra e studimit të kësaj dukurie, për të cilën autori ka shprehur konsideratat e tij për secilën nga gjuhët e arealit ballkanik. Për këtë arsye, kjo vepër do të zërë më shumë vend e hapësirë jo vetëm në studimet albanologjike, por edhe në ato të ballkanistikës.

Në mbyllje të fjalës sime nuk mund të lë pa përmendur një fakt të hidhur në jetën e këtij dijetari. Tragjedia e luftës së fundit që pësuan shqiptarët e Kosovës nuk la pa prekur edhe shtëpinë e tij, e cila u dogj e u shkrumbua bashkë me bibliotekën, që ishte pasuria më e madhe, e mbledhur me përkushtim gjatë një gjysmë shekulli. Por ata që dogjën librat e gjuhës shqipe nuk mundën të vrasin e të shuajnë vullnetin e këmbënguljen e dijetarit për ta vijuar punën e nisur para shumë vjetësh, që tashmë ka arritur kulmet e saj.

Kjo ditë jubilarë na bën të ndjehemi krenarë për brezat e kaluar e të sotëm, për albanologët e nderuar të Kosovës martire, të Kosovës trime, që ka derdhur shumë gjak për liri e dije, arsim e kulturë, dhe u ka dhënë shkencave shqiptare njerëz të ditur e të përkushtuar, si Selman Riza, Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli e shumë të tjerë, emra të nderuar që qëndrojnë krahas emrave po aq të mëdhenj të albanologjisë së ditëve tona, si Eqrem Çabej, Mahir Domi, Martin Camaj, Shaban Demiraj etj.

Dhe kështu përvjetorët shkojnë e vijnë, por një gjë mbetet e përhershme: mbetet rruga e formimit të fleksionit nominal, mbetet ny-

ja në gjuhët ballkanike, mbetet pjesorja, mbesin përemrat vetorë. Për ata që merren me këto fusha, librat e Besim Bokshit janë libra tryeze, njëlloj si fjalorët, gramatikat, enciklopeditë.

Me bindje në gjallërinë që u fal puna njerëzve që e duan atë, i urojmë akademik Bokshit edhe shumë vite të tjera jete e pune, në dobi të shkencës, atdheut e kombit; dhe në këtë përvjetor të 80 të jetës së tij më lejoni t'i drejtohem me fjalët: “Mos e përfill peshën e viteve, se ke edhe shumë vite të tjera jete e pune për të kaluar, se mendja e kthjellët e njerëzve në moshën tuaj premtan punë të mëdha”.

Seit MANSAKU, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

STUDIUES I SHQUAR I HISTORISË SË GJUHËS

KUD 811.18-112

Së pari, dua të falënderoj Akademinë e shkencave dhe të Arteve të Kosovës që na ftoi të marrim pjesë në këtë ceremoni të gëzueshme të organizuar me rastin e 80-vjetorit të njërit prej intelektualëve, gjuhëtarëve dhe filologëve të shquar të hapësirave shqiptare dhe na dha mundësinë t'i urojmë atij drejtpërdrejt në këtë mjedis të nderuar vëllazëror, shoqëror e shkencor jetë të gjatë e shëndet të mirë për vete, për familjen dhe për shkencën e kulturën shqiptare, së cilës ai i ka kushtuar të gjitha energjitë e tij intelektuale dhe i ka dhënë asaj një varg veprash themelore, por që ka edhe shumë për t'i dhënë. Është një gjë e gëzueshme që ai vjen sot në këtë 80-vjetor të lindjes me një bilanc të pasur veprash shkencore e letrare, me vepra që presin të urohen sot dhe me të tjera që presin të përurohen në të ardhmen.

Rrallëherë qëllon që të bashkëjetojnë harmonishëm tek i njëjti personalitet poeti dhe shkencëtari, ndjesitë e holla të poetit me rreptësinë shkencore të studiuesit, emocionet poetike me gjykimin racional e të ftohtë, përthyerjet e gjuhës poetike me koherencën e tekstit shkencor në një fushë të vështirë siç është gramatika historike etj.

Akademik Besim Bokshi me punën e pandërprerë sistematike, me talentin dhe pasionin e tij të spikatur e ka krijuar prej kohësh fizionominë dhe profilin e vet shkencor intelektual e njerëzor si studiues i shquar i historisë së gjuhës shqipe dhe si intelektual e veprimtar i dalluar për çështjet kombëtare. Fusha themelore e veprimtarisë së tij shkencore është gramatika historike në kuptimin e gjerë të kësaj discipline. Ai është marrë në mënyrë ballore me problemet më themelore dhe më të mprehta të morfologjisë historike të shqipes, me sistemin e fleksionit të emrave, me sistemin e nyjave, me sistemin përëmëror dhe me sistemin foljor dhe në të gjitha këto fusha ka bërë studime të thelluara dhe ka sjellë kontribute të reja në metodë dhe në rezultate konkrete që janë pasqyruar në disa vepra themelore.

Për sa i përket metodës, akademik Besim Bokshi është i pari gjuhëtar shqiptar që ka zbatuar me sukses metodat e gjuhësisë strukturaliste passosyriane të gjysmës së dytë të shekullit XX, në fushën e

studimeve diakronike të shqipes, kryesisht në fushën e gramatikës historike. Kjo është një nga risitë më të shënueshme në rrafshin teorik dhe në arritjet konkrete po të kemi parasysh se studimet tona të historisë së gjuhës qëndrojnë përgjithësisht mbi themelet e gjuhësisë historike krahasuese të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX. Pra me studimet e tij ai hodhi një hap të ri përpara për të sjellë në gjuhësinë shqiptare metodat e reja të gjuhësisë diakronike europiane, të distribucionalizmit, të gjenerativizmit dhe të glosematikës të pazbatuara më parë te ne. Zbatimi i metodave të gjuhësisë strukturaliste në studimet për gramatikën historike të shqipes e ka çuar autorin domosdo edhe në zbatimin e teorisë së sistemit, në vështirimin sistemor e tërësor të kategorive të ndryshme të strukturës gramatikore të shqipes në rrafshin diakronik. Përdorimi i një metodologjie të re shkencore ka sjellë edhe disa përfundime të reja të rëndësishme që vënë në dyshim mjaft teza të mëparshme për evolucionin historik të strukturës gramatikore të shqipes. Kështu p. sh. që në vitin 1980 autori në veprën themelore: *Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes*, Prishtinë 1980, ka arritur në përfundimin e përgjithshëm se gjuha shqipe e kishte humbur sistemin e mbaresave nominale të trashëguara nga indoeuropianishtja që në prag të huazimeve nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja, një përfundim që autori e nxjerr nga shqyrtimi i mënyrës se si janë përshtatur e integruar në gjuhën shqipe elementet e huazuara nga dy gjuhët klasike. Nga ky shqyrtim autorit i rezulton se në kohën e kontakteve të para me greqishten e vjetër dhe me latinishten, shqipja ishte larguar nga sistemi i fleksionit indoeuropian dhe kishte kaluar në struktura analitike. Në këtë kohë ishte krijuar edhe nyja shqese, së cilës autori, siç dihet, i ka kushtuar një vepër të gjerë me titull: *Prapavendosja e nyjës shqese në gjuhët ballkanike*, Prishtinë 1984, një vepër e rëndësishme jo vetëm për gjuhësinë tonë, por edhe për gjuhësinë ballkanike.

Nga përfundimi i përgjithshëm se shqipja e ka humbur qysh herët sistemin e mbaresave nominale, si korolar të tij nxjerr një përfundim tjetër të rëndësishëm për tipologjinë historike të shqipes, përfundimin se struktura analitike e shqipes është e lashtë dhe se shqipja hyn në gjuhët e para analitike indoeuropiane. Këtë tezë akademik Besim Bokshi e ka shtjelluar dhe argumentuar edhe në veprën: *Pjesorja e shqipes – vështirim diakronik*, Prishtinë 1995. Në këtë studim autori e vështiron këtë trajtë foljore duke u mbështetur në metodën distribucionaliste, në gjithanshmërinë e saj, në marrëdhëniet, siç i quan ai, homosintagmatike dhe heterosintagmatike, me funksionet e saj foljore, mbi-

emërore dhe ndajfoljore, në sistemin e formave analitike të foljes, në përbërjen e trajtës së habitores dhe në tërësinë e formave të pashtje-lluara, të përcjellores dhe të paskajores së tipit *me punue, për të punuar*, të trajtave *pa punuar, me të ardhur, një të ardhur* etj. Duke u mbështetur në gjendjen e trajtave analitike të së kryerës në gjuhë të tjera indoeuropiane dhe në shqipen autori nxjerr dy përfundime lidhur me kronologjinë e tyre: së pari, për shqipen është e qartë se dy të kryerat analitike (*me jam* dhe *me kam*) janë të lashta, sepse që të dyja janë përfutur para se të krijoheshin mbiemrat e nyjshëm, d.m.th. para se participi në funksione mbiemërore të bëhej i nyjshëm, proces që, sipas autorit, ka ndodhur disa shekuj para përfundimit të huazimeve latine, gjithsesi para shekullit IV.¹ Së dyti, në gjuhën shqipe perfekti analitik pësor është përfutur më herët se perfekti respektiv vepror², duke u pajtuar kështu me një mendim të shprehur më parë nga Selman Riza sipas të cilit “në historinë e shqipes pjesorja e partashme, ...dikur pati shërbyer për ndërtimin e trajtave të pathjeshta vetëm të diatezës pësore e ...pastaj shërbeu për ndërtimin e formave po të pathjeshta edhe të veprorës...”³, ndryshe nga Shaban Demiraj, që ka mbrojtur mendimin e kundërt sipas të cilit tipi vepror i së kryerës është përfutur më herët se tipi jovepror⁴.

Për origjinën e këtyre trajtave, Besim Bokshi, ndryshe nga E. Çabej dhe B. Havránek e përjashton mundësinë e ndikimit të latinishtes ballkanike pikërisht për shkak të vjetërsisë së tyre në gjuhën shqipe.

Një veçori tjetër e rëndësishme e veprës së Besim Bokshit në pikëpamje të metodës është fakti se ai i ka dhënë përparësi historisë së brendshme të gjuhës duke shfrytëzuar në radhë të parë burimet e brendshme, tekstet e vjetra, të dhënat e dialekteve, të të folmeve etj. dhe duke bërë të vetin parimin se evolucioni morfologjik rrallë e shterron tërësinë e trajtave (rasteve) mbi të cilin mbështetet, se krahas formave të reja që ai prodhon, në të mbijetojnë shpesh një numër i madh formash të vjetra që vijojnë të përdoren. Kështu që në çdo stad të evolucionit të saj gjuha ruan disa mbetje të gjendjeve të vjetra që lejojnë të bëhet lidhja ndërmjet fazës së sotme dhe periudhave të mëhershme mesjetare, antike dhe prehistorike indoeuropiane.

Edhe elementet e huaja në gjuhën shqipe janë vështruar nga më-

¹ Besim Bokshi, **Pjesorja e shqipes, (vështrim diakronik)**, Prishtinë 1998, f. 89-90.

² Po ai *Po aty*, f.91.

³ S. Riza, **Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore**, Tiranë 1994, f. 249, cituar sipas B. Bokshit, *vep. cit.* f. 91.

⁴ Shaban Demiraj, **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**, Tiranë 1987, f. 811, 812.

nyra sesi janë integruar në sistemin e saj leksikor e gramatikor dhe krahasimet me gjuhë të tjera janë përdorur për të sqaruar çështje të ndryshme të strukturës gramatikore të shqipes, të përcaktimit të kronologjisë së zhvillimeve të reja dhe të humbjes së dukurive të hershme të saj. Kështu, p. sh., duke studiuar mënyrën e përshtatjes dhe të integritetit të emrave të latinishtes në gjuhën shqipe, autori nxjerr përfundime të rëndësishme për krijimin e tipave të ndryshëm të lakimit të kësaj gjuhe, ose nga mënyra e theksimit të elementeve nga greqishtja e vjetër në gjuhën burimore dhe në gjuhën marrëse, autori vjen në përfundimin se theksi dinamik i protoshqipes ishte krijuar para shekullit III para erës sonë dhe se ka qenë theksi dinamik që ka çuar në ndryshime largvajtëse në sistemin e fleksionit të gjuhës shqipe.

Një vëmendje të veçantë u ka kushtuar autori edhe problemeve që lidhen me periodizimin e gjuhës shqipe duke sqaruar hap pas hapi aspekte të ndryshme të kësaj çështjeje për të arritur në një vepër të veçantë që po përurohet sot në mjedisin tonë.

Si përfundim do të thosha se vepra e akademik Besim Bokshit në fushën e gramatikës historike shënon një hap të rëndësishëm përpara që synon t'i pasurojë studimet në këtë fushë me zhvillimet teorike e arritjet praktike të shekullit XX, për ta përgatitur për shekullin tonë.

Ethem LIKAJ, Akademia e Shkencave, Tiranë

PËR NJË JETË AKADEMIKU

KUD 811.18-26

811.18:929(496.51) Bokshi Besim

Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës!

Në këtë takim nderimi të jubileut të lindjes së Akademikut tonë të nderuar, Besim Bokshi, 80 vjetët e jetës së tij nuk i çmojmë dhe i festojmë si vite që ikën, por si vite që mbeten dhe do të mbeten, sepse ato nuk janë kohë, por një vepër e çmuar.

Gjuhësia shqiptare tanimë ka plot vepra, të shkruara nga të vjetër dhe të rinj, vendës dhe të huaj. Janë arritje të mbërritura nga një fillim i mirë, falë një gjenerate që, kryesisht, u formua në tokë të shëndoshë, në mendje dhe në dije të shëndosha dhe të mbara. Ajo gjeneratë është emblemë e gjuhësisë më të mirë shqiptare, prandaj ne shpesh e kthejmë kokën pas, jo vetëm për t'i kujtuar me respekt, por edhe për të jetuar me veprën e tyre. Dijet e Rizës, Çabejt, Domit, Ajetit mbeten elitare.

Por sot ne nderojmë me respekt, me dashuri dhe kënaqësi një gjuhëtar pasardhës sqimatar në kuptimin e mirë të fjalës; një gjuhëtar që nuk zgjedh e shkruan për çdo gjë e për gjithçka, por për çështje “mendjemëdha”.

Akademiku Besim Bokshi, siç dihet dhe siç u përmend edhe nga parafolësit, ka shkruar disa vepra të plota, si: “Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike”, “Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes”, “Për vetorët e shqipes” dhe “Pjesorja e shqipes”. Në këto vepra nuk kërkoi vetëm vende bosh në studimet historike të shqipes, por, në radhë të parë, probleme të vështira të shqipes. Aty kërkoi, krijoi dhe ndërtoi; ndërtoi mbi të vjetrën, por ndërtoi edhe të reën.

Të gjitha janë vepra të merituar dhe të vlerësuara. Këtu ka mbërritur jo vetëm falë formimit, gjerësisë së dijeve, vullnetit dhe këmbënguljes, por edhe falë metodave të studimit e të kërkimit, herë të vetme e të veçanta, herë të kombinuara e të integruara. Nuk e ka pasur metodën e re kryesisht si qëllim të një “modernisti”, as të kërkuar për hir të së resë, por të zgjedhur për lëndën që ka përpara. Prandaj edhe kthehet dhe rikthehet.

Natyrisht, për çdo diakronist, si vepër për breza edhe nga vëllimi, edhe nga zgjidhjet, edhe nga problematika është “Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes”. Vepra i ka tejkaluar pikësynimet e autorit; ka shkuar shumë më tej, sepse gjatë rrugës së krijimit të “Rrugës së formimit...” ka trajtuar e zgjidhur edhe çështje të ndërlikuara e problematike, siç janë: problemi i nyjave të shqipes, problemi i pronorëve të shqipes, problemi i formimit të gjinorës me nyjë etj.

Është një vepër që ka ngritur shumë probleme, ka dhënë përgjigje, ka zgjidhur shumë çështje dhe përsëri ka shtruar shumë pikëpyetje. Ka vlera të mëdha për problemet që zgjidh, por ka edhe vlera të tjera të mëdha, se është shumë intriguese për çështjet që shtrun për zgjidhje.

Nuk është vendi të bëj analizën e kësaj vepre, sepse ka pasur analiza e vlerësime të mëparshme. Vetëm dua të theksoj atë thelb të metodës së veprës - që mendoj se ishte dhe mbetet, edhe për sot, edhe për nesër - pikërisht trajtimin e sistemit emëror të shqipes jo si një hallkë, por si një varg; jo thjeshtë emrin si emër, por emrin si një segment të një vargu suksesiv fjalësh, që shpesh tejkalon edhe sintagmën. Kjo zgjedhje, që e shikon gjuhën së pari nga larg e të tërë, e pastaj nga afër si pjesë të së tërës, sintaksën e sjell te morfologjinë dhe morfologjinë te sintaksa, duke forcuar më tej një bindje të mjaft gjuhëtarëve diakronistë se morfologjia e sotme pasqyron një sintaksë të djeshme.

Trajtimi i lëndës së shqipes sipas kësaj metode, në mënyrë të natyrligje e çoi te rimarrja dhe mbështetja e një teze shumë të guximshme se “shqipja në një fazë mjaft të thellë kishte mbetur pa fleksion dezinencial rasor dhe se mbaresat e sotme të rasave burojnë nga segmente të caktuara brenda grupit nominal të sintaksës nominale.”

Kjo tezë e shtuar, por më shumë e mbështetur fort me lëndë e argumente nga autori, vërtet është çmuar dhe çmohet, por duket se më shumë me qëllim harrohet.

Sistemi rasor i shqipes, përgjithësisht, është zhvilluar dhe zhvillohet si edhe në gjuhë të tjera evropiane, me prirje drejt analitizmit të mëtejshëm. Edhe para syve tanë po zhvillohen prirje të këtij lloji. Mjaft të themi se në lakimin e shquar, mbaresat e së pashquarës janë asnjënjësuar thujse krejt. Me një kompromis gjuhësor, ato janë marrë si pjesë të mbaresave të së shquarës; dhe nuk dihet si do të ishte përfundimi i mëtejshëm, në qoftë se nuk do të ishin përfutur nyjat shquese.

Duke lidhur çdo zgjidhje me metodën, theksoj edhe më tej se edhe burimin e disa formave të pronorëve dhe të formave emërore të

paraprirë nga nyja e ka gjetur, sipas meje, me mjeshtëri, me metoda të paemërtuara si matematike, por të zbatuara si të tilla. Kështu - sa për të kujtuar – burimin e nyjës së përparme para emrave të vjetër të farefisnisë e shpjegon me reduktimin e një gjymtyre që përsëritet te sintagma *i tij bir, e saj bijë*, si një përsëritje e panevojshme dhe e ndodhur; e kërkuar fillimisht nga sintaksa, por më tej e panevojshme për morfologjinë. Fillimisht ndoshta në këtë sintagmë ka ndodhur po ai proces që ndodh sot te format e së ardhmes me *do (do të punoj)*, ku pjesëza *të* fillimisht ka pasur vetëm vlerë formuese burimore, por sot, brenda këtyre formave, ndihet si e panevojshme.

Vendi që zënë nyjat në vepër është i gjerë edhe si sasi, edhe si zgjidhje, sepse ato burimisht dhe në vazhdim ka qenë elemente gjuhësore periferike të doemosdoshme të emrit dhe të mbiemrit. Studimeve të mëparshme këtu nuk u është shtuar origjinaliteti i burimit të saj, por rruga konkrete e përfuturit.

Të nderuar kolegë e pjesëmarrës, këtu sot vetëm po rikujtoj diçka nga vepra; për të është thënë mjaft, por ka edhe shumë jo thjesht për të thënë, por për të mësuar dhe vlerësuar.

Por në këtë rast jubilar është radha, së pari, për t'i uruar jetë të gjatë dhe plot shëndet Akademikut tonë të nderuar.

Me shumë respekt e mirënjohje për gjithçka!

Ali ALIU, ASHAK, Prishtinë

POEZIA E BESIM BOKSHIT

821.18-1.09

Poezitë e para të Besim Bokshit, në shtypin e atëhershëm të Kosovës, u shfaqën nga fundi i viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar dhe më pas, përkatësisht më 1966 të bëra bashkë u botuan libër më vete, me titullin *Në pritje*. Bëhet fjalë për një kohë, më saktësisht, për dhjetëvjetëshin kosovar brenda të cilit u ushtrua një terror nga më të egërtit mbi popullatën shqiptare të kësaj hapësire.

Në letërsi ndërsa, veçmas në poezi, veprat e botuara deri atëherë ende nuk e arrinin numrin e gishtave të dorës. Aktualiteti, lënda që e frymëzonte atë poezi, ishte ende nën peshën e jehonës së LNÇ-së, edhe pse krahas atij entuziazmi, ndjeshëm po penetronte në të, në poezi, tema e himnizimit të vendlindjes, të natyrës, të njerëzve të vendlindjes - e që ishte një hap përpara drejt emancipimit të saj.

Vepra poetike *Në pritje* e Besim Bokshit ndërsa, e bëri hapin tjetër të madh drejt modernizimit të poezisë shqipe në Kosovë, sidomos drejt poezisë refleksive. Prandaj libërthi *Në pritje* edhe pas gjysmë shekulli vjen dyfish historik: shënoi kthesën e madhe në rrjedhat e poezisë shqipe, duke shënuar njëkohësisht artikulum majash në të - dhe i hapi udhë brezit poetik të Azem Shkrelit, brez që do të prekte kulmet e poezisë shqipe të shekullit njëzet.

Vargjet e poezive të veprës *Në pritje*, siç janë *Lumi i thellë*, *Tim Et*, *Nata kriminele*, *Të mërkurën*, *Pranvera dritarja ime* etj., sjellin, pos talentit të shquar të autorit, edhe dëshminë: ai, autori i tyre, kishte formim dhe informim letrar, kishte mbështetje në traditën më të artikuluar të poezisë shqipe, veçmas atë të gjuhës aludive dhe ironike si dhe prurjet e trendeve të përgjithshme poetike dhe kishte shqetësimin dramatik për atë që ndodhte në Kosovë gjatë atyre viteve.

Brenda hapësirës të mbërthyer të terrorit, Besim Bokshi solli vargje moderne, gjuhë ezopike që rrezaton reflekse sa të kohës që i lindi ato, sa universale. Ato vënë në ngasje vizione komplekse mbi ekzistencën e njeriut, kënaqësi të përhershme estetike. Edhe përballë censurës ndëshkuese, vargjet e librit *Në pritje* mundën të jenë dëshmi e kohës së vet, të jenë dhembja dhe ëndrra e trullit. Hapësira shqip-

tare e Kosovës ka pasur një ëndërr të madhe, që poezia e Besim Bokshit e artikulon edhe përmes lumit të thellë që rrjedh dhe, në rrjedhë e sipër mbledh dhe mëkon plagët e hapura - por edhe ëndërrën për një kthesë të madhe, për një katarakt. Do t'i besojë kësaj ëndërrë dhe do të presë ardhjen e saj poeti.

Reflekset që rrezatojnë nga vargjet e kësaj poezie janë të përhershme: po vjen e pritura, e ëndërruara ashtu e plotë, e tëra, apo e cunguar, e vonë, me kohë apo pa kohë, e shëndoshë a e sëmurë, e pastër a me vese - hamendje dhe shqetësime që mund të mos i ndjente intuita e zgjuar në vigjilime të përhershme e poetit. Janë përgjërimet e tilla të vargut bokshian që na bëjnë të mendojmë thellë, jo pa shqetësim edhe në ditët tona, do të thotë me të drejtë në një tekst të vetin mbi poezinë e Bokshit R. Ismajli.

Imri BADALLAJ, Universiteti i Prishtinës

MBI VEPRËN GJUHËSORE TË PROFESOR BESIM BOKSHIT

KUD 811.18-26

Është kënaqësi dhe nder i madh të flasësh për profesor Besim Bokshin, për këtë personalitet fort të shquar të shkencës dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi, i cili në fillimet e veprimtarisë së tij, publikut shqiptar i dhuroi një tufë poezish, të cilat i karakterizonte, siç thotë profesor Rexhep Ismajli, “pesha e tematizimeve, ngjeshja e madhe semantike e emocionale e thënieve në vargje, përdegëzimi tematizues i refleksive shoqërore, shpesh vula e protestës së nënkuptuar, metaforika e thellë, simbolika e zhveshur dhe zhytja në problematikën e trysnive të egra mbi njeriun tonë”.¹

Profesor Bokshi do të shquhet edhe me një vepër tjetër të titulluar *Hijet e këputura*, në të cilën përmbledh aforizma, që shprehin refleks për kohën, të përshkuara me një humor, sa të lehtë, aq edhe therës dhe domethënës.

Mirëpo, suksesin më të madh profesori ynë e shënon në mënyrë të veçantë në fushën e studimeve gjuhësore, duke treguar arritje kulmore të rezultateve.

Po përmendim veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (Prishtinë, 1980), duke u pasuar nga studimet e tjera, siç janë: *Prapavendosja e nyjës në gjuhët e Ballkanit* (Prishtinë 1984), *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, *Për vetorët e shqipes* (Prishtinë 2002), *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes* (Prishtinë 2010) etj.

Pa dyshim nga vetë titujt shihet qartë, se këto vepra gjuhësore janë të një karakteri monografik dhe si të tilla kapin temat dhe problematikat gjuhësore nga më të rëndësishmet për albanistikën dhe për gjuhësinë ballkanike.

Që nga monografia e parë e këtij karakteri autori ka arritur të krijojë individualitetin e tij, duke përdorur një metodologji të gjuhësisë strukturale, por duke mos lënë anash edhe gjenerativizmin.

¹ Rexhep Ismajli, *Për veprën dhe personalitetin e Besim Bokshit*, **Studime**, nr.11, f. 319, ASHAK, Prishtinë, 2005.

Profesor Bokshi vazhdimisht dhe suksesshëm depërton në çyshtjet fort problematike të historisë së gjuhës shqipe, të gjuhësisë ballkanike dhe të gjuhësisë krahasimtare, duke hedhur hapa në ndjekjen konsekuente të teorisë së sistemit, që pa dyshim për të arritur në një zgjidhje të drejtë është dashur kërkime dhe hulumtime të pandërprera në të gjitha sferat e gjuhësisë. Kjo mënyrë e studimit, profesorin e ka detyruar, që shumë teza të paqëndrueshme të pararendësve t'i rishikojë dhe t'u japë sqarime dhe shpjegime të qëndrueshme, siç është rasti me studimin *Ruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, në të cilën janë studiuar dhe shqyrtuar në imtësi, jo vetëm çështjet e fleksionit të segmentit nominal të shqipes, por shpesh dhe dendur janë rrahur edhe jo pak çështje të fonetikës historike, siç është rasti i kuantitetit të vokaleve të shqipes së dokumentuar, që për këtë dukuri mbron mendimin se ky është fenomen i një zhvillimi të brendshëm i vetë shqipes, duke mos e lidhur me ndonjë fazë të hershme indoeuropiane.

Në monografinë *Prapavendosja e nyjës në gjuhët e Ballkanit* profesor Bokshi thellësisht merret me çështjet e ballkanologjisë, që gjithsesi edhe në këtë studim e përmbledh gjithë problematikën e nyjave në gjuhët e Ballkanit, çfarë tregon se kjo vepër gjuhësore është e rëndësishme për një spektër shumë më të gjerë. Diskutimet, që janë bërë në këtë vepër janë të mbështetura në shpjegimin e arsyeve dhe të proceseve të krijimit të nyjave nga dëftorët, që me rrjedhën e kohës janë prapavendosur dhe janë aglutinuuar, proces ky, që i ka ndodhur jo vetëm shqipes, por edhe gjuhëve të tjera të Ballkanit, siç është rasti me rumanishten, me bullgarishten dhe me greqishten. Gjykimi dhe mendimi i profesor Bokshit mbi hipotezën për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në shqipen. Këtë tezë e mbron, duke u mbështetur në fakte dhe argumente të zhvillimeve strukturore fonetike dhe morfosintaksore.

Mirëpo, profesor Bokshi gamën e studimeve të tij nuk e kufizon vetëm në sferën e sistemit nominal, sepse menjëherë pasi e pa dritën publikimi i monografisë të zënë ngoje më sipër, publikon monografinë e rëndësishme në sferën foljore, që mban titullin *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, ku autori këtë trajtë foljore e shqyrton dhe e shpjegon cep më cep, duke u mbështetur në metodën distribucionaliste për t'i shpjeguar marrëdhëniet dhe relacionet homosintagmatike të formanteve të pjesores dhe relacionet heterosintagmatike të pjesores me funksion foljor, mbiemëror dhe ndajfoljor në sistemin e formave analitike të foljes dhe në tërësinë e trajtave të pashtjelluara, sidomos me një theks të veçantë për pjesoren brenda trajtave të admirativit.

Duke ndjekur të njëjtën metodë studimore më 2004 profesor Bokshi në edicionin e ASHAK – Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, boton

monografinë *Për vetorët në gjuhën shqipe*, temë kjo që ia kishte tërhequr kërkuesin me mote të tëra, e cila nuk bën fjalë vetëm për përemrat vetorë, siç ndodh me gramatikat tona tradicionale, por në këtë studim të thellë dhe mjaft të thukët, diskutohen e shpjegohen edhe kategori të tjera, që kanë shënjuar të kategorisë gramatikore të vetës, të pronorëve, të nyjave të përparme tek emrat e farefisnisë, mbaresat vetore të foljes e ndonjë çështje tjetër gramatikore.

Edhe kjo monografi cilësohet për një studim shumë të vëmendshëm dhe me rezultate. Sidomos shquhet për një vështrim kritik, gjithnjë duke mos iu larguar argumenteve dhe vlerësimeve të qëlluara shkencërisht.

Pra, marrë në përgjithësi vepra gjuhësore e profesorit tonë është e madhe, e qëndrueshme dhe kryesisht e drejtuar në shumë çështje të gramatikës historike, fushë kjo, e cila prek pikat më të ndjeshme të trungut gjuhësor, që gjithsesi për të arritur në përfundime të drejta dhe të sakta, duhej dije, durim dhe mund, që pa dyshim për profesor Bokshin, janë tipare që e spikasin, si njeri, si gjuhëtar dhe intelektual me përmasa fort të mëdha. Këtë më së miri e dëshmon penda e tij, e cila kudo që nguli, u shqua për thellësinë dhe gjerësinë e rrokjes së problemeve, për fuqinë e analizës dhe të sintezës së çështjeve, për konkluzionet bindëse, për kriteret e rrepta shkencore, që ka zbatuar dhe zbaton në rezultatet e arritura në fushën e kërkimeve dhe të hulumtimeve të gjuhësisë shqiptare dhe ballkanike, që shumë çështjeve të pazbërthyeshme dhe të pazgjidhura u hap udhë të reja për të arritur në përfundime shkencore, që pa u luhatur do t'i qëndrojnë shtrëngatave dhe dhëmbit të kohës.

E gjithë vepra shkencore e profesor Besim Bokshit përshkohet edhe nga një frymë e vështrimit kritik, por gjuhëtari ynë nuk është i një karakteri refuzues, nënçmues dhe përbuzës, përkundrazi ky arrin në interpretime e përfundime, që u japin vullë tezave të marra në shqyrtim.

Në fund të kësaj fjale, mund të them lirshëm dhe me bindje të thellë se profesor Bokshi me seriozitetin dhe objektivitetin e një studiuesi dhe shkencëtari e pedagogu universitar të devotshëm, me një kulturë e dije të thellë gjuhësore, me një mendje të kthjellët, që shënon gjykime e konkluzione, që pa u trembur fare do t'i qëndrojnë moteve i ka krijuar vetes një vend të denjë në majat e shkencës. Prandaj, nga zemra ia uroj 80-vjetorin e lindjes, duke i dëshiruar edhe 80 vite të tjera me një pleqëri sa të mbarë aq edhe të rehatshme.

Besim BOKSHI

FJALA FALËNDERUESE NË 80-VJETORIN E LINDJES

Ju falënderoj kolegë e miq për nderimin që më bëtë me pjesëmarrjen tuaj në këtë ditëlindje time të tetëdhjetë e për urimet tuaja. E çmoj lart praninë e Kryetarit të Komunës së Gjakovës zotit Pal Lekaj. Falënderoj Komisionin për organizimin e këtij solemniteti: nënkryetarin e ASHAK akademik Hivzi Islami, sekretarin e Seksionit të Gjuhësisë e të Letërsisë akademik Mehmet Kraja dhe akademik Rexhep Ismajlin. U jam shumë mirënjohës miqve të mi Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kolec Topalli, Ethem Lika, Seit Mansaku dhe Imri Badallaj për trajtimet e veprës sime shkencore e letrare me dashamirësi e me kompetencë shkencore që është më e larta për kohën. Natyrisht, në këto raste solemne të jetës së një krijuesi lejohet një shkallë më e lartë lavdërimi, të cilën vepra e sjell vetë në përmasa reale.

Kuptohet se asnjëri nga ne nuk do të mund të ishte ai që është në studimet e shqipes pa u pasë nisur nga kontributet e albanologëve pararendës, pa rezultatet e punës së tyre, kështu që edhe në veprat tona, të studiuesve të sotëm të shqipes, është edhe energjia krijuese e tyre. Përgjegjësinë për një ecje përpara të shkencës sonë, në kohën tonë, e kemi të gjithë së bashku, prandaj çdo kontribut të tjetrit kemi arsye ta konsiderojmë të përbashkët. Me llojllojshmërinë e temave në degët e ndryshme gjuhësore, me diversitetin e trajtimit të tyre e me mundësitë tona krijuese mendoj se i kemi begatuar rezultatet e albanistikës së kohës sonë. Si shpërblim i punës sonë të mundimshme shkencore është gëzimi që na e jep mendimi se kemi zbuluar ndonjë të vërtetë, se kemi ndriçuar ndonjë proces, se kemi avancuar një mënyrë vështrimi, ai gëzim që është tepër i veçantë, sepse vjen bashkë me krenarinë për aftësinë tonë krijuese. Këto çaste gëzimi e krenarie na e lehtësojnë ndjenjën e dyshimit për saktësinë e disa përfundimeve tona studimore.

Si çdo vepër tjetër edhe vepra ime shkencore do të shtyhet në kohë të shkuar e do të zërë vendin e saj në zhvillimin e mendimit albanistik. Ajo do të imponojë që veprat e reja nga morfologjia historike t'i tejkalojnë rezultatet e saj me nivele më të larta shkencore. Kështu ajo do të përmbushë edhe funksionin e saj nxitës për arritje të reja shkencore.

Siç u tha edhe këtu, fillimi i krijimtarisë sime ishte në poezi. Më vonë m'u dha mundësia të shoh se edhe studimet e gjuhës japin kënaqësinë e krijimit në shkallë po aq të lartë sa edhe krijimi poetik. Dhe u binda se në trajtimin e temave nga morfosintaksa listorike e shqipes mund të arrija rezultate më të larta se në poezi, kështu që nuk besoj të kem gabuar që iu përkushtova më shumë gjuhësisë, megjithëse disa miq poetë kanë menduar se kam gabuar. Pas një pauze të gjatë unë iu ktheva poezisë për disa vjet nga viti 1983, një poezie po ashtu kryesisht politike, por tani me një shprehje postmoderne, e dominuar nga poezia Jubiletë e mia. Një kohë u kushtova edhe aforizmave të tipit humoristik.

Për punën time shkencore dua të falënderoj dy personalitete të shkencës sonë: profesor Idriz Ajetin dhe profesor Rexhep Ismajlin. Profesor Idriz Ajetin për vlerësimin e lartë të punimit tim të parë për *Zhvillimin e strukturës së temave emërore*, mendim që bëri të mundur dhënien e temës së doktoratës pa magjistruar dhe për kënaqësinë që ndjeu për nivelin shkencor të doktoratës, që si të tillë u angazhua ta botonte në ASHAK. Profesor Rexhep Ismajlin për vlerësim publik të pandërprerë të veprave të mia, me tone përkrahëse e dashamirëse të punës sime. Dua që në këtë ditë jubilarë të jetës sime para jush të falënderoj edhe bashkëshorten time Muhamedije për durimin ndaj punës sime, për krijimin e kushteve për punë, për përkrahjen e veprimeve të mia, për përballimin e shqetësimeve e për kurajon që më dha për të vazhduar veprimtarinë krijuese.

Kolegë e miq të dashur, vëllimi i veprave të krijuesve në Kosovë nuk mund të çmohet realisht pa e vështuar në relacion me kushtet e jetës që herë pas here ishin të pafavorshme për krijim, pa e vështuar në relacion me kohën e kaluar me aktivitet të nevojshëm shoqëror si detyrë intelektuale për të ndihmuar zhvillimin e proceseve pozitive shoqërore.

Në këtë moshë të shtyrë koha e humbur, duke u marrë me punë të parëndësishme jetësore, ardhka e u bëka dhembje e rëndë.

Në 80-vjetorin e lindjes jam i kapluar nga malli për shokët që s'janë më në jetë, për shokët që ma begatuan jetën me dashuri e më dhuruan gjithë atë dashamirësi kurajodhënëse.

Ju falemnderit të gjithëve!

STUDIME, ARTIKUJ

Hivzi ISLAMI, ASHAK, Prishtina

LE KOSOVO: DE LA COLONIE CLASSIQUE SERBE À L'INDÉPENDANCE* ¹

KUD 323.1(496.5)

Introduction

Les questions géopolitiques dans les Balkans ont une histoire très complexe. Les Balkans et le Kosovo non plus ne peuvent pas respirer sans histoire. Depuis longtemps le Kosovo est le nœud le plus névralgique géopolitique dans les Balkans: c'est un espace de complexité nationale, linguistique et religieuse. Les historiens Albanais et Serbes sont en désaccord sur du droit ethnique et historique de leurs peuples au sujet ce territoire. L'Europe et le monde entier sont fatigués avec les Balkans et leur mentalité. Sir W. Churchill (1874-1965) avait dit que "Les Balkans produisent beaucoup de problèmes qu'on ne peut en résoudre".

Nëpër Luginën e Preshevës kalojnë rrugë të rëndësishme ndërkombëtare, automobilistike dhe hekurudhore, pjesë të të ashtuquajturit Korridori 10,¹ njërit prej më të rëndësishmëve në kuadër të Sistemit Panevropian të Korridoreve Transportuese – P E Tr C. Përmes këtij korridori realizohet lidhja më e shkurtër dhe më e efikase në mes regjioneve të mëdha të Evropës me hapësirat mesdhetare të Azisë, Afrikës dhe më gjerë.



Figura 1: Korridoret transportuese në Evropën Juglindore dhe pozita e Luginës së Preshevës në Korridorin X

¹ A. Ejupi, **Resurset natyrore në Luginën e Preshevës**, Masteri, Prishtinë, 2009, 9.

Përpos Korridorit 10, nëpër Luginën e Preshevës, në saje të parakushteve relievore, si grykat lumore dhe qafat malore, kalojnë rrugë të rëndësishme të drejtimit transversal. Magjistranja nëpër Grykën e Konçulit dhe Qafën e Livadhit të Sheit janë rrugë të tjera të rëndësishme që rrisin vlerat e pozitës gjeokomunikative dhe gjeostrategjike të Luginës së Preshevës.

Gjeografi serb Jovan Cvijić, Luginën e Preshevës e quan “Bërthamë të Ballkanit”. Sipas tij “hapësira e Shkupit dhe e Preshevës ka rëndësi të posaçme për shkak të lidhjeve të lehta e të sigurta në të gjitha drejtimet dhe mban në vete çelësin e komunikimit gjatësor më të rëndësishëm, si dhe linjat tërthore të komunikimit”. Për shkak të gjitha këtyre veçorive hapësira e Shkupit dhe e Preshevës bëhet qendër, prej së cilës më së lehti mund të udhëhiqet (sundohet) pjesa dërmuese të Gadishullit Ballkanik dhe prej ku mund të zhvillohet një shtet i fuqishëm në brendësi të tij². Ky konstatim i Cvijićit qëndron edhe në ditët e sotme: Lugina e Preshevës konsiderohet “hapësirë kritike” në aspektin gjeostrategjik nga e cila mund të udhëhiqet dhe sigurohet me sukses pozicioni strategjik përballë faktorëve gjeopolitikë fqinj.³

Pozita gjeopolitike e një regjioni ose shteti paraqet elementin më dinamik e konstituiv të pozitës gjeografike duke përfshirë faktorët natyrorë, ekonomikë dhe politiko-gjeografikë. Ajo ndërthen në vete vlerësimin kompleks të potencialit natyror, proceseve demogjeografike dhe realiteteve bashkëkohore kulturore-politike. Në thelb, ajo bazohet në analizën e faktorëve fiziko-gjeografikë dhe antropogjeografikë si dhe në lidhjet kauzale në mes tyre. Ndryshimet e tyre në aspektin gjeopolitik për një popull, regjion dhe shtet, shpeshherë kanë pasoja të drejtpërdrejta ekzistenciale. Ajo në fokusin e vet ka ndikimin e faktorëve gjeografikë në proceset historiko-politike dhe paraqet faktor me rëndësi që kushtëzon zhvillimin e një regjioni ose shteti dhe mundësinë e kyçjes së tij në integrimet politike, ekonomike dhe të sigurisë.⁴

Nga definicioni i pozitës gjeopolitike të një regjioni shihet se

² J. Cvijić, **Osnove za Geografiju i Geologiju Makedonije i Stare Srbije**, Knjiga III, Beograd, 1911.

³ D. Sekulović, *Geostrateški položaj i značaj geopratora Vranjsko-Bujanovačke kotline*, **Globus**, vol. 37. 2006, Beograd, 2001, f. 7.

⁴ M. Grčić, **Politička Geografija**, Geografski Fakultet Univerziteta u Beogradu, Beograd, 2000.

ekziston një grup i faktorëve që kushtëzojnë pozitën gjeopolitike, si faktorët fiziko-gjeografikë, antropogjeografikë, historiko-politikë etj. Këta faktorë në rastin e Luginës së Preshevës janë favorizues të pozitës gjeopolitike. Mirëpo për të analizuar dhe shpjeguar në mënyrë të hollësishme pozitën gjeopolitike të Luginës së Preshevës, duhet bërë një vështrim në kontekstin e rrjedhave aktuale politiko-gjeografike në kuadër të shtetit të Serbisë si dhe pozitën gjeopolitike të saj në kuadër të trojeve etnike shqiptare.

Pozita gjeopolitike e Luginës së Preshevës në kontekstin e rrjedhave aktuale politiko-gjeografike është mjaft e ndjeshme dhe komplekse. Kjo situatë mbretëron sidomos pas viteve '90 kur luftërat dhe dezintegrimi i Jugosllavisë e shëndrruan Serbinë në një shtet kontinental pa qasje të drejtpërdrejtë në det. Kështu, ajo i orientoi tendencat për të ruajtur edhe më tej pozitën privilegjuese në skenën gjeopolitike të Gadishullit Ballkanik kah përparësitë që i ofron pozita e saj qendrore dhe kalimi i Korridorit 10 nëpër territorin e saj.

Kur bëhet fjalë për Luginën e Preshevës, faktori demografik është përcaktues i rëndësishëm i pozitës gjeopolitike, përveç atij fiziko-gjeografik. Numri i popullsisë, dendësia e banimit, strukturat e popullsisë, karakteristikat religjioze, vetitë etnopsikike formojnë një tërësi të karakteristikave kuantitative dhe kualitative të cilat ndikojnë si në proceset gjeografike-politike, ashtu edhe në pozitën gjeografike të regjionit ose shtetit të caktuar.⁵ Në rastin e Luginës së Preshevës nga karakteristikat e lartpërmendura duhet cekur sidomos popullsinë, jo për nga numri, sa për nga struktura etnike me shkallë të lartë të homogjenitetit, ku dominojnë shqiptarët, shtrirja territorialisht kompakte e elementit etnik shqiptar, kontinuiteti etnodemografik me trungun gjeoetnik shqiptar në Kosovë dhe në Maqedoni, karakteristikat religjioze dhe gjuhësore, proceset integruese me hapësirën mbarëshqiptare në fusha të ndryshme, si në kulturë, arsim, shkencë, shëndetësi etj., të cilat kanë filluar të intensifikohen kohën e fundit.

Me qëllim të ndryshimit të kompozicionit etniko-demografik në Kosovë dhe viset e tjera tnike shqiptare Serbia përpiloi projekte dhe elaborate fashistoide e gjenocidiale, të cilat përfunduan në luftërat e

⁵ D. Sekulović, L. Gigović: *Činioci geopolitičkog položaja Srbije*, **Zbornik radova**, Geografski Institut, J. Cvijić, SANU, Beograd, 2007, f. 53

armatosura në fund të shekullit XX. Këto luftëra sollën çlirimin definitiv të Kosovës nga Serbia, kurse konfliktet e armatosura në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës sensibilizuan faktorin ndërkombëtar për gjendjen e padurueshme të popullsisë shqiptare në këto shtete.

Ndarjen, ose si thonë ata “fragmentimin” e përkohshëm të Kosovës si dhe konfliktin e armatosur në Luginën e Preshevës serbët e shohin si tendencë për keqësimin e pozitës gjeopolitike të Serbisë. Kosova së bashku me hapësirën etnike të shqiptarëve në Luginën e Preshevës graviton nga drejtimi i Vardarit-Egjeut, që në konstelacionet eventuale gjeopolitike të fuqive në Gadishullin Ballkanik mund të ketë rëndësi parësore ushtarako-strategjike për Serbinë. Prandaj, për Serbinë është çështje ekzistenciale gjeopolitike ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit mbi këtë pjesë të territorit. Me logjikën e ngjashme Serbia e vlerëson edhe rolin e superfuqisë më të madhe botërore, SHBA-ve në skenën gjeopolitike të Ballkanit. Sipas autorit serb D. Sekulović, Luginë e Preshevës në jug të Serbisë, së bashku me bazën ushtarako-strategjike Bondsteel në Kosovë, paraqesin pika vëzhgimi të gjeopolitikës amerikane në Ballkan, që përmes Korridorit X synojnë t'i realizojnë interesat gjeostrategjikë në Ballkan dhe pjesën evropiane të Euroazisë. Dislokimi ushtarak amerikan në Kosovë dhe interesimi i shprehur amerikan për situatën aktuale dhe ngjarjet në Luginën e Preshevës ka për synim zvoglimin e rëndësisë së Korridorit X, duke i dhënë përparësi Korridorit 8, me të cilin tentohet të krijohet një korridor energjetik dhe i sigurisë i përbashkët për Turqinë, Bullgarinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë, të ndahen Serbia dhe Greqia dhe të ndërpritet bashkëpunimi i tyre.

Pozita gjeopolitike e Luginës së Preshevës në kuadër të trojeve etnike shqiptare në rrethanat aktuale gjeopolitike është paksa e hendikepuar për shkak të pozitës periferike në raport me bërthamën e trungut gjeoetnik shqiptar. Mirëpo kalimi i Korridorit 10 dhe rrugët e drejtimit transversal, homogjeniteti mjaft i lartë i strukturës etnike, vazhdimësia e pandërprerë me trungun gjeoetnik shqiptar në përfundim me Kosovën dhe në jug me trojet shqiptare në Maqedoni, e përmirësojnë dukshëm pozitën gjeopolitike të saj në kuadër të trojeve shqiptare.

Prandaj me të drejtë mund ta marrim në konsideratë në aspektin gjeopolitik dhe gjeostrategjik Korridorin 10; me këtë rritet edhe më tepër atraktiviteti i pozitës gjeopolitike të trojeve shqiptare. Nëpër trojet shqiptare kalojnë dy korridore transportuese: Korridori 8 dhe Korri-

dori 10. Duke qenë plotësisht të bindur mbi rëndësinë jetike që ka lidhja komunikative e Kosovës me Shqipërinë përmes ndërtimit të autostradës Durrës-Kukës-Merdar me çka Kosova siguron dalje në Korridorin 8 dhe portin e Durrësit, mendojmë se nuk duhet të anashkalohet, po duhet të punohet intensivisht për përmirësimin e lidhjeve infrastrukturore edhe me Luginën e Preshevës, kryesisht përmes Grykës së Konçulit. Në këtë mënyrë Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në rrethanat e reja gjeopolitike që do të vijnë, do të sigurojnë një qasje direkte edhe në Korridorin 10. Kjo do të bëjë të rritet edhe më tepër atraktiviteti i pozitës gjeopolitike të trojeve shqiptare në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti. Dalja e trojeve shqiptare në Detin Adriatik dhe në Detin Jon, në njërën anë, kalimi i Korridorit 8, si dhe qasja direkte në Korridorin 10, pikërisht përmes kontaktit me Luginën e Preshevës, paraqesin faktorë shumë të rëndësishëm për forcimin e pozitës gjeopolitike dhe gjeostrategjike të trojeve shqiptare duke i shëndrruar ato në aktor mjaft të rëndësishëm në skenën gjeopolitike të Gadishullit Ballkanik.

Lugina e Preshevës në rrethanat aktuale gjeopolitike dhe ideja për shkëmbimin e territoreve

Përfundimi i luftës në Kosovë (1999) dhe i konfliktit të armatosur në Luginën e Preshevës (2001) nuk shënojnë edhe zgjidhjen e çështjes shqiptaro-serbe. Pjesa veriore e Kosovës, pse *de jure* është në kuadër të shtetit të Kosovës, *de facto* mbetet jashtë kontrollit institucional të Kosovës, duke u mundësuar institucioneve serbe të instalojnë një pushtet “paralel”, i cili zbaton urdhërat e Beogradit. Në anën tjetër, konflikti i armatosur në Luginën e Preshevës përfundoi me Marrëveshjen e Konçulit në mes të faktorit ndërkombëtar, qeverisë serbe dhe faktorit ushtarako-politik shqiptar për çmilitarizimin e Luginës së Preshevës. Në të vërtetë kjo ishte dhe mbeti një marrëveshje e panënshkruar nga palët, çka na bën të kuptojmë se qëllimi parësor i saj ishte ndërprerja e konfliktit përmes çmilitarizimit të njësiteve të armatosura shqiptare, kurse nuk e obligonte palën serbe për përmbushjen e detyrimeve të saj, të dala nga po ajo marrëveshje. Sidoqoftë, çmilitarizimi kishte të bënte me pjesëtarët e UÇPMB-ës, ndërsa marrëveshja parashihte largimin e forcave të shtuara ushtarake dhe policore serbe. Vazhdimi i pranisë së këtyre forcave në zonën e konfliktit dhe përbërja e

tyre me pjesëtarë të policisë e ushtrisë, të cilat kishin marrë pjesë në luftën e Kosovës, stacionimi i tyre afër vendbanimeve, defilimet provokuese, jo vetëm që nuk krijojnë kushte të favorshme për kthimin e popullsisë së shpërngulur, por i ndihmojnë shpërnguljes së mëtejshme.

Qeveria e Serbisë e udhëhequr nga Zoran Djindjić adoptoi një plan për zgjidhjen e krizës pas konfliktit të armatosur në Luginën e Preshevës, të njohur si “*Plani i Čovićit*”, i cili kishte për qëllim integrimin e shqiptarëve në sistemin shoqëror-politik dhe qeveritar të Serbisë, duke nënkuptuar këtu përfshirjen e tyre në polici, gjyqësi, shëndetësi, edukim dhe institucionet komunale në proporcion me numrin e tyre. Për këtë qëllim qeveria serbe formoi të ashtuquajturin “Trup Koordinues për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë”. Përpos projektit të krijimit të policisë multietnike, i cili ishte bërë në bashkërendim me OSBE-në, ku është arritur një progres evident, “*Plani i Čovićit*” dështoi në të gjitha pikat tjera.

Edhe pse ishte miratuar në Parlamentin e Serbisë, “*Plani i Čovićit*” nuk e kishte fuqinë e ligjit, andaj mund të paraqiste një brengë serioze nëse qeveria e tij nuk do të fitonte përkrahjen në zgjedhjet e ardhshme.⁶ Kështu edhe ndodhi, pasi që në rrethanat e reja politike në Serbi, në pushtet erdhi partia e V. Koštunica-s, që devijoi nga diskursi politik i kampit të dikurshëm të opozitës demokratike në Serbi, duke kaluar në pozita të partisë nacionaliste me urrejtje të hapur si ndaj shqiptarëve dhe popujve të tjerë joserbë ashtu edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare.

Marrëveshja e Konçulit i dha fund konfliktit të armatosur, por nuk do të thotë edhe përfundim i krizës, sepse territori i Luginës së Preshevës vazhdon të mbetet tejet i militarizuar, me praninë e madhe të strukturave ushtarako-policore serbe. Gjithashtu vazhdon të mungojë vullneti i mirë i pushtetit serb për përmirësimin e situatës në fusha të ndryshme të jetës. Nga kjo që thamë më lart me të drejtë mund të konstatojmë se veriu i Kosovës dhe Lugina e Preshevës vazhdojnë të mbeten vatra gjeopolitike të krizës në Gadishullin Ballkanik për të cilat duhet gjetur zgjidhje.

Kohën e fundit plasohen ide të reja (të vjetra), për zgjidhjen e krizës në këto hapësira. Njëra ndër këto ide është edhe “shkëmbimi i

⁶ ICG Balkan Reports, *Peace in Presevo: quick fix or long term solution?*, No 116. Pristina/ Belgrade/ Brussels, 2001, f. 11.

territoreve” në mes Luginës së Preshevës dhe Veriut të Kosovës. Këto ide pikënisjen kryesore e kanë tek faktori demografik, ku veriu i Kosovës është i banuar kryesisht me popullsi serbe, kurse Lugina e Preshevës me popullsi shumicë shqiptare. Të dyja këto regjione, përpos elementit demografik kanë edhe specifika tjera gjeopolitike, të cilat bëjnë që për shtetet të cilave u përkasin, Kosovës dhe Serbisë, të paraqesin hapësira me interes parësor gjeostrategjik e gjeopolitik. Veriu i Kosovës është hapësirë e pasur me resurse minerale që paraqet një bazament për zhvillimin industrial dhe ekonomik të Kosovës, kurse nëpër Luginën e Preshevës kalon njëri prej korridoreve më të rëndësishme transportuese në Evropën Juglindore – Korridori 10. Andaj shkëmbimi i territoreve për shtetet e Serbisë dhe të Kosovës do të nënkuptonte hendikepim të pozitës gjeopolitike e gjeostrategjike, në një rrafsh, dhe përmirësimin e saj, në rrafshin tjetër.

Përfundim

Gjithnjë duke marrë parasysh anët pozitive dhe negative të një zgjidhjeje të tillë, mëndojmë se një projekt i tillë vështirë mund të realizohet për arsyet e poshtëshënuara:

Në rrethanat aktuale gjeopolitike dhe me një pozitë gjeografike kontinentale, Serbia është jetësisht e interesuar që zhvillimin e vet ta mbështesë në përparësitë që ofron Korridori 10. Lidhja e shtetit të dikurshëm të Jugosllavisë me botën dhe tregëtinë botërore përmes Detit Adriatik dhe Kanalit të Otrantos, shërben si sinonim për lidhjen e Serbisë me botën përmes Korridorit 10.

Kosova si shtet i ri i cili është ende në fazën e promovimit dhe të anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare, nuk është në gjendje të jetë aktor i barabartë gjeopolitik në Gadishullin Ballkanik sa të imtonojë dhe gjejë zgjidhje të cilat nuk e dëmtojnë pozitën e saj gjeopolitike. Zgjidhja e tillë nuk përkrahet edhe nga bashkësia ndërkombëtare, sepse shkëmbimi i territoreve do të jetë një model i “shkëlqyeshëm” për skenarin e Bosnjes, në të cilën edhe 16 vjet pas përfundimit të luftës kemi kontestim të shtetit boshnjak dhe tendenca dezintegruese nga faktori serb. Gjithashtu do të shkaktohej zhvendosja e popullsisë me elemente të pastrimit etnik, një imazh të cilin evropianët nuk duan ta shohin në kontinentin e vet.

Andaj mendojmë se është interes jetik i shtetit të ri të Kosovës të mbrojë integritetin e vet territorial në kufijtë shtetëror ekzistues, duke i garantuar popullsisë serbe në të gjithë Kosovën të gjitha të drejtat dhe liritë njerëzore sipas konventave ndërkombëtare. Ndërsa zgjidhja e krizës në Luginën e Preshevës duhet të bëhet duke i dhënë asaj një status të posaçëm politiko-teritorial në kuadër të të cilit shqiptarët do t'i realizonin të drejtat e tyre qytetare e kombëtare, me çka do të ruhej identiteti i tyre etnik, gjuhësor e kulturor dhe do të pengohej shpërngulja dhe asimilimi⁷. Statusi autonom i këtij regjioni do t'i mundësonte popullsisë shqiptare lidhje të posaçme, në ç'mënyrë do të realizohej pjesëmarrja aktive në kuadër të hapësirës unike kulturore, arsimore dhe shkencore të të gjithë shqiptarëve kudo që janë dhe do t'i zgjidhte problemet e deritashme në arsim, kulturë, informim dhe shkencë, por edhe integrimin ekonomik me trevat e tjera etnike shqiptare në kuadër të integrimeve më të gjera ballkanike dhe europiane.

⁷ A. Ejupi, *Aspekti gjeopolitik i krizës në Luginën e Preshevës*, **Kërkime gjeografike**, XIV, Prishtinë, 2008, f. 76

Arsim EJUPI, University of Prishtina

GEOPOLITICAL DIMENSION OF THE PRESHEVA VALLEY ISSUE AND THE TERRITORIAL EXCHANGE IDEA

Summary

The geostrategic and geopolitical position is the result of the quality of physical-geographical and mathematical components of a region or state having certain impact on its demographic, social, economic, political and historical development. Presheva Valley is distinguished by a very favorable geostrategic geo-communicative position. With its extension in meridional direction, it is located in the central part of the Balkan Peninsula, especially in the contact area between the Morava Valley in the north and Vardar Valley in the south. These two valleys constitute the most important natural corridor for the shortest connection of Europe with South West Asia, Near East and North Africa. The most important point in the Presheva Valley is watershed that divides the catchment area of the Black Sea and Aegean Sea. Low elevation of this watershed (460m) is "joining" rather than "splitting", so as a result, an important natural corridor is created, which is known as the primary meridional axis in the Balkans. In the new geopolitical circumstances created after the independence of Kosova and Serbian tendencies for separation of the former's northern part, new (old) ideas of the exchanging territories with Presheva Valley have been presented .

Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Instituti Albanologjik, Prishtinë

DY SARKOFAGËT E PUNUAR NË MERMER TË HUAJ NË DARDANI NGA *VENDENISI* DHE *ULPIANA*

KUD 903/904 (=18:496.51)

Abstrakt

Në këtë punim bëhet fjalë për dy sarkofagë të kualitetit të lartë artistik nga *Ulpiana* dhe *Vendenisi* të punuar në mermer të huaj, të cilët zënë një vend me shumë rëndësi në mesin e monumenteve të punuara në këtë lloj mermeri gjatë antikitetit në pjesën qendrore të Dardanisë (Kosovë).

Sarkofagu nga *Vendenisi* (Gllamniku) i takon tipit me kapak në formë çatie në dy ujëra. Është i punuar nga prokonez (i bardhë me rrema gri), prej nga u eksportua si bllok vetëm me kontura, ndërsa në vend – *in situ* nga një mjeshtër i huaj në gjysmën e parë të shek. IV filloi përpunimi i tij lokal vetëm në kapak me motivin e tjegullave, duke paraqitur një ekzemplar unik në tërë Dardaninë.

Sarkofagu nga *Ulpiana* i takon tipit me kapak-kline (në formë shtrati) dhe paraqet vepër plotësisht të kryer vetëm me jastekun e skalitur në kapak. Është i punuar në mermer të bardhë kristalor të kualitetit të lartë. Sipas analizës petrografike del se 42,8% është i provinencës së ishullit Paros. Si lloji i mermerit, ashtu edhe përmasat e mëdha dhe punimi i përkryer flasin se është vepër e njëres nga qendrat më të njohura të punimit të sarkofagëve aty rreth vitit 250.

Të dy këta sarkofagë me vlerat e larta artistike dëshmojnë lidhjet tregtare të *Ulpianës* dhe të *Vendenit* me qendrat e njohura të gurove dhe të punëtorive të sarkofagëve.

Fjalët çelësa: *Dardania, Kosova, antikiteti, dy sarkofagë, Ulpiana, Vendenisi, importi, Prokonezi, Parosi.*

Në mesin e monumenteve të punuara në mermer të huaj gjatë antikitetit në pjesën qendrore të Dardanisë (Kosovë), krahas ekzemplarëve të tjerë të punuar në skulpturë, një vend me rëndësi e zënë edhe dy sarkofagët e kualitetit të lartë artistik nga *Ulpiana* dhe *Vendenisi*. U përkasin punëtorive të ndryshme. Nga ta njëri paraqet import të gatshëm, kurse tjetri punim lokal, e po ashtu edhe sipas karakteristikave tektonike-strukturore, përkatësisht trajtës së kapakut, u takojnë tipave të ndryshëm, duke përfaqësuar që të dy tipat kryesorë të sarkofagëve.

*

Sarkofagu nga *Vendenis*-i antik (Gllamniku i sotëm), i cili nga

viti 2010 gjendet në Muzeun e Kosovës, u gjet rastësisht në vitin 1968 në potesin Polanicë, ku shtrihej nekropoli i këtij vendbanimi dhe stacioni i kohës romake¹. Është i punuar nga mermeri kristalor me ngjyrë shkëlqimisht të bardhë me rrema gri dhe i takon tipit me kapak në formë çatie në dy ujëra (Tab. I. fig. 1a, 1b). Është i ruajtur në tërësi në të dy pjesët: arkë (215 x 98 x 50 cm.) dhe kapak (220 x 98 x 50 cm), pos disa dëmtimeve të vogla dhe një të çare të thellë të pjerrtë në mesin e pjesës së sipërme të kapakut, me siguri të shkatuar me rastin e gjetjes. Arka është e papërpunuar, pos bazamentit dhe kurorës të profiluara në tri anë. Ndërkaq, kapaku është i pajisur me akroterët e mëdhenj këndorë, prej të cilëve vetëm njëri në njërin faqe anësore është i zbukuruar me motivin e gjysmëpalmetës së stilizuar dhe tjetri i skicuar me këtë motiv (ky skicim nuk mund të dihet se ku u krye), ndërsa në faqen tjetër ata nuk janë të dekoruar. Në të dy këto faqe, brenda fushave trekëndëshe të profiluara është skalitur nga një rozetë, ku vetëm njëra është e përfunduar, kurse njëra anë e tij është e zbukuruar me motivin e tjegullave harkore, të skalitura pa brinjën e zakonshme në mes, e të renditura në formë luspash (*squamae*), duke përfunduar me një brez të ngushtë të dekoruar me një motiv gjeometrik, ndërsa ana tjetër së bashku me akroterë është e papërpunuar, çka të jep përshtypjen se nuk është e kryer ose nga kjo anë sarkofagu nuk ka qenë i dukshëm për shikuesin.

Kapaku-çati me akroterë në kënde është trajta më e shpeshtë e të gjitha grupeve lindore të sarkofagëve, është një e mirë kulturore shumë e lashtë dhe e përhapur e Mesdheut.² Për këtë arsye sarkofagët e këtij lloji i takojnë të ashtuquajturit tip oriental ose të Azisë së Vogël, me të cilin kaherë është marrë studiuesi G. Rodenwaldt³. Ky tip mbisundon në Lindje, por ndeshet shumë shpesh edhe në Perëndim, kështu që është i zakonshëm edhe në provincat e Ballkanit, ku dominon.⁴ Po ashtu edhe në Dardani, pos dy ekzemplarëve, të gjithë të tjerët i takojnë tipit çati.⁵

¹ Njoftimi për të vetëm me foto e të dhënat e vendgjetjes e të përmasave është dhënë pas gërmimeve të para arkeologjike të nekropolit më 1980 nga S. Fidanovski, 1985, f. 101. Interpretimi nga E. Dobruna-Saliu, 2008, ff. 171-173, fig. 1; ajo, 2009, ff. 195-196, fig. 2 a, b.

² N. Cambi, 1975, ff. 77-78.

³ G. Rodenwaldt, 1943, f. 3 e tutje.

⁴ Khs. T. Gerasimov, 1969, f. 60 e tutje, ku jep një pasqyrë të sarkofagëve të Odesit; N. Cambi, 1982, f. 97.

⁵ Khs. E Dobruna-Saliu, 2003-2005, ff. 794-797, nn. 285-292, fig. 245-251; Ajo, 2008, ff. 169-177, nn. 1-9, fig. 1-3.

Nga të gjitha rastet e sarkofagëve të trevës dardane me dekorime në reliev të ruajtur në tërësi, apo vetëm të kapakut, kapaku është i dekoruar. Mirëpo ky dekor është i një natyre krejt tjetër. Kështu, derisa motivi dekorativ i përbërë nga rozeta dhe gjysmëpameta akroteriale haset edhe tek ekzemplarët e tjerë,⁶ motivi i tjegullave haset për herë të parë, prandaj ky sarkofag si i tillë paraqet një ekzemplar unik në këtë trevë. Ndërkaq, ky motiv, që imiton kulmin e shtëpisë, është i pranishëm si te sarkofagët atikë, ku paraqitet rregullisht, ashtu edhe tek ata të Azisë së Vogël. Dallimi ndërmjet tyre, sipas studiuesit të njohur të sarkofagëve të kohës romake G. Koch, qëndron në formën e tjegullave, ku tjegullat në formë gjetheje, si në rastin tonë, janë karakteristike për ekzemplarët atikë, ndërsa tjegullat e ngushta e të gjata dhe *imbricis*-et e mëdhenj e të sheshtë për ata orientale⁷. Por marrë në përgjithësi, sarkofagët me një dekorim të tillë të kapakut flasin se ata kanë të bëjnë me modelet atike, apo orientale⁸. Duke u nisur nga fakti se kjo mënyrë dekorimi u përvehtësua edhe nga punëtoritë vendëse, këta sarkofagë i hasim në shumë treva të Perandorisë qoftë si prodhime lokale, qoftë si import (*Athens, Thessalonica, Antiochia, Ephesus, Berytus*, qendrat e Italisë së Veriut, etj.)⁹, në mesin e të cilave edhe në ato ilire. Kështu, në provincën e Dalmacisë janë të pranishëm kryesisht në Salonë (*Salona*, Solini në Kroaci), të punuar në mermer prokonez apo gurë vendës,¹⁰ ndërsa një ekzemplar është nga Dilunti (*Diluntum*, Stolci në Bosnje) në brendi të kësaj province, i punuar në gur gëlqeror.¹¹ Në pjesën perëndimore të provincës së Maqedonisë dhe në pjesën veriore të provincës së Epirit (Shqipëri) kemi katër sish: dy nga Dyrrahu (*Dyrrhachium*, Durrësi), një nga Butroti (*Butthrotum*, Butrinti) dhe një nga Fenike (*Phoenice*, Finiqi), që i takojnë im-

⁶ E. Dobruna-Saliu, 2003-2005, ff. 794-796, nn. 285, 286, 289, figg. 245, 246, 249; ajo, 2008, ff. 169-170, 173-174, nn. 1, 2, 5, 6, fig. 2a.

⁷ G. Koch – H. Sichtermann, 1982, f. 371; G. Koch, 1988, ff. 73-74.

⁸ N. Cambi, 1975a, f. 173.

⁹ Khs. W. Altmann, 1902, f. 59, fig. 22; G. Koch – H. Sichtermann, 1982, f. 366, fig. 454 (Athinë); f. 352, figg. 384-385 (Thesalonikë); për ata në Azi të Vogël dhe qendrat tjera në Lindje shih.: N. Himmelman, 1970, TT. 6,15 (Antakjë); G. Koch – H. Sichtermann, po aty, fig. 509 (Efes); fig. 562 (Bejrut – import atik); për ekzemplarët e Italisë së Veriut shih.: H. Gabelmann, 1973, TT. 26, 27; ai 1977, f. 201, fig. 1.

¹⁰ F. Bulić, 1907, ff. 99-101, TT. 5-6; ai, 1910, f. 54; N. Cambi, 1975a, f. 408; E. Višić-Ljubić, 1999-2000, f. 459 e tutje, fig. 1.

¹¹ D. Segejevski, 1934, ff. 23-24, n. 36.

portit atik të gjysmës së dytë të shekullit II.¹² Ndërkaq, si prodhime lokale, të punuar në gurë gëlqerorë, këta sarkofagë janë të pranishëm edhe me dy ekzemplarë nga Sirmi (*Sirmium*, Mitrovica e Sremit në Serbi) në Panoninë e Poshtme.¹³

Rreth çështjes së prejardhjes së ekzemplarit tonë – gurores nga e cili u shfrytëzua mermeri dhe vendpunimit të tij – lloji i mermerit dhe arka me sipërfaqe të vrazhdë, e papunuar fare, tregojnë se ky sarkofag duhet të jetë punuar nga mermeri prokonez që nxirrej në guroret e njohura të *Proconnensus*-it antik (ishullit të Mermerit në detin Marmara), prej nga u eksportua si bllok vetëm me kontura, ndërsa në vend – *in situ* filloi përpunimi i tij lokal.¹⁴ Kjo u arrit më shumë në kapak, kurse nga arka vetëm bazamenti dhe skaji i sipërm me profile. Një eksport të tillë të sarkofagëve prokonezë të papërpunuar, qoftë vetëm të blloqeve me kontura, qoftë vetëm me motive të skicuara, që pastaj punoheshin në punëtoritë lokale, e hasim në gjithë Perandorinë Romake.¹⁵ Një numër i madh i tyre është eksportuar në pjesën bregdetare të provincës së Dalmacisë, me qendër në Salonë. Në bazë të gjendjes në të cilën janë bartur ata merren si prodhime lokale¹⁶. Ndërkaq, shikuar nga stili i punimit të pjesëve të kryera, që janë të një cilësie të lartë, ky sarkofag më parë duhet të jetë punuar nga një mjeshtër i shkathët i huaj, i cili, sipas të gjitha gjasave, me kërkesën e porositësit kishte ardhur së bashku me sarkofagun e papërpunuar për ta punuar në vend, që, sipas studiuesit të sarkofagëve prokonezë J. B. Ward-Perkins, praktikohet te sarkofagët e tillë.¹⁷ Sipas formës së tjegullave, ky mjeshtër para vetes duhet të ketë pasur një model të sarkofagut atik, për çka flet edhe brezi i zbukuruar, që haset shpesh te sarkofagët e kësaj qendre.¹⁸ Në rastin tonë motivi i këtij brezi është

¹² G. Koch, 1988, ff. 73-74, nn. 13-14, figg. 27-28; f. 76, nn. 22-23, figg. 41-42. Te sarkofagu nr. 13 ka gjasë që tjegullat të jenë punuar në vend në imitim të atyre të Azisë së Vogël, khr. f. 73.

¹³ A. Cermanović-Kuzmanović, 1964, f. 101, n. 30, fig. 25a,b, f. 102, n. 33, fig. 280 b; e njëjta, 1965, f. 102, nn. 30, 33, TT. 8, 9, figg. 25 a, d, 28 a; V. Dautova - Ruševljan, 1983, f. 198, T. 26, 1A, T. 27, 1A.

¹⁴ Për këtë konstatim gojarisht më ka ndihmuar prof. dr. G. Koch-u të cilit me këtë rast i falënderohem.

¹⁵ Khs. H. Wiegartz, 1974, f. 369; G. Koch, 1988, f. 39; i njëjti, 1989, f. 160.

¹⁶ N. Cambi, 1988, f. 15.

¹⁷ J. B. Ward-Perkins, 1969, f. 109 e tutje.

¹⁸ Khs. G. Koch – H. Sichtermann, 1982, TT. 419, 429, 460; G. Koch, 1988, ff. 73-74, n. 13, fig. 27, f. 76, n. 23, fig. 42, f. 77, n. 29, fig. 51.

vendës. Sipas modeleve atikase është punuar shumica e sarkofagëve të tillë nga mermeri prokonez apo nga guri gëlqeror vendës edhe në provincën e Dalmacisë.¹⁹ Modellet atikase u përvetësuan edhe nga disa punëtori të Azisë së Vogël.²⁰ Sarkofagë që kopjojnë dekorimin e një qendër tjetër që s'ka të bëjë me qendrën nga e cili u shfrytëzua mermeri kemi edhe gjetiu. I tillë është një sarkofag atik gjysmë i gatshëm nga Dyrrahu, tek i cili gjatë përpunimit të kapakut në punëtorinë lokale, në skatitjen e tjegullave janë imituar kapakët e Azisë së Vogël.²¹

Megjithëse sarkofagë prokonezë të papërfunduar – me pjesë të pakryera apo të papunuara – hasim edhe gjetiu, çka lidhet me aftësitë e punëtorive lokale,²² në rastin tonë shkaku i mospërfundimit të sarkofagut duhet të jetë i lidhur me përdorimin e tij të parakohshëm. Koha e punimit të tij, në bazë të stolive të gjetura në sarkofag,²³ duhet t'i takojë shekullit IV. Ndërkaq, në provincën fqinje të Dalmacisë, sarkofagët e këtij dekori të punuar nga mermeri prokonez hasen në gjysmën e parë të shekullit III, kurse përdorimi i tërësishëm i sarkofagëve të këtij eksporti kap intervalin kohor prej fillimit të sh. III deri në fund të sh. VI.²⁴

Përkitazi me pjesën tjetër të provincës së Mezisë së Epëme, jashta Dardanisë, të evidencuar kemi vetëm edhe tre sarkofagë të importit prokonez: një nga Viminaci (*Viminacium*, Kostolci në Serbi) dhe dy nga Ratiarja (*Ratiaria*, Arçari në Bullgari), të cilët janë të një kohe më të hershme (shekujt II-III) dhe të dekoruar me girlanda, si dhe të eksportuar si vepra të gatshme me disa plotësime nga mjeshtrit provincialë lokalë.²⁵ Ata në këto dy qendra, ashtu si në të gjitha trevat danubiane, janë bartur me rrugë lumore nëpër Danub (*Danubius*).²⁶ Kjo duhet të vlejë edhe për

¹⁹ Shih shën. 10.

²⁰ G. Koch, 2010, f. 154, fig. 7 (nga Dokimeioni në Firence), f. 162, fig. 27 (gjysmëfabrikat i Prokonezit në Muzeun e Efësit).

²¹ G. Koch, 1988, ff. 73-74, n.13, fig. 27.

²² Po aty, f. 69; N. Cambi, 1988, f. 67 (sarkofagu "Dobrog pastira").

²³ Khs. F. Peja, 1995, f. 71.

²⁴ N. Cambi, 1975a, ff. 407, 516-518.

²⁵ S. Ferri, 1933, ff. 365-368, figg. 494-497; G. Rodenwaldt, 1943, f. 17; J. B. Ward Perkins, 1969, f. 135, fig. 5; G. Koch – H. Sichtermann, 1982, ff. 334-335, figg. 355-357. M. Tomović, 1991, ff. 61-80, figg. 1-2. Importin prokonez të këtyre sarkofagëve të parët e kanë konstatuar G. Rodenwaldt dhe J. B. Ward Perkins, madje J. Ward Perkins është i mendimit se të këtij importi janë edhe disa sarkofagë të tjerë nga Viminaci.

²⁶ Mbi transportin e sarkofagëve të tillë nëpër Danub khr. J. B. Ward Perkins, 1969, f. 135; ndërsa mbi transportin e mermerit prokonez në përgjithësi khr. i njëjti, 1958, f. 400 e tutje.

bllokun me kontura të sarkofagut tonë, i cili prej andej ka arritur me siguri përmes lumit Marg (*Margus*, Moravë Jugore) deri te Naisi (*Naissus*, Nishi), për të vazhduar në Venden me rrugë të tjera lumore apo edhe tokësore (magjistralen për në *Lissus*). Përndryshe, eksporti i sarkofagëve prokonz ka përfshirë një hapsirë të madhe: Mesdheun Lindor, brigjet e Pontit, provincat danubiane me koncentrim në Traki, brigjet e Adriatikut dhe të Gadishullit Apenin me koncentrim në Dalmaci dhe Italinë Veriore²⁷. Bartja e tyre, ashtu si edhe të tjerëve të gatshëm apo në blloqe nga guroret dhe punëtoritë e mbarë Masdheut, është bërë me anije speciale (*lapidaria navis*) për të cilat flet Plini²⁸.

Sarkofagu nga Ulpiana është gjetur në vitin 1955 në ndërtesën e varrit, të ashtuquajtur “*memorie*” të nekropolit verior, ku gjendet edhe sot.²⁹ Është i punuar në mermer të bardhë kristalor të kualitetit të lartë me kokrriza të mëdhenj dhe paraqet një punë mjaft cilësore. I takon tipit me kapak-kline (Tab. II. fig. 2a, 2b). Është i tëri dhe, pos dëmtimeve të vogla në arkën e përmasave të mëdha (236 x 128 x 121 cm) dhe të skajeve të kapakut (256 x 149 x 60 cm), ishte i ruajtur deri në marsin e vitit 2008, kur iu thye kapaku që u renovua pas dy vitesh. Ai qarkohet nga një kornizë e gjerë e profiluar dhe në të tri anët është i rrethuar me një shirit të gjerë konkav, që ngrihet mbi bazamentin e tij, duke formuar brenda një hapësirë në trajtë shtrati, në njërën anë të të cilit është skalitur jasteku. Arka e ka bazamentin të gjerë dhe të profiluar, që, sipas konstruktit, i përgjigjet atij të sarkofagëve me kapak çati. Një gjë e tillë tregon se arka dhe kapaku nuk i takojnë njëri-tjetrit, meqenëse arka pa dyshim u mbarua për kapak-çati, por më vonë atij iu dha forma kline. Sarkofagë të tillë hasen edhe gjetiu.³⁰

Ky tip sarkofagu me kapak-kline është i përhapur në treva të ndryshme të botës antike, në Azi të Vogël, Maqedoni, Eube, Etruri, ku

²⁷ Khs. punimet e J. B. Ward Perkins dhe H. Wiegartz.

²⁸ Plin. Nat. hist. XXXVI 2.

²⁹ Publikimin e tij vetëm me të dhënat e vendgjetjes dhe foton e ka bërë E. Čerškov, 1956, ff. 322, 324, fig. 4. Interpretimin E. Dobruna-Saliu, 2008, ff. 178-179, fig. 4; e njëjta, 2009, ff. 196-197, fig. 3 a, b.

³⁰ Te tipi i sarkofagëve me kapak-kline arka transformohet nga ndërtesa në mbajtëse shtrati, duke u ngritur nga toka me mbajtës të shkurtra – këmbë. Mirëpo lidhur me ndryshimet e përgjithshme në arkë, duke u nisur nga fakti se ato nuk aplikohen rregullisht, këta sarkofagë nga aspekti formal janë edhe të përzier, khs. G. Koch – H. Sichtermann, 1982, ff. 371-372.

kemi edhe ekzemplarët më të vjetër. Kjo është arsyeja që këtu kërkohet prejardhja e tij.³¹ Në Romë nisin të paraqiten në fillim të periudhës Perandorake, e më të shpeshtë janë nga koha e Hadrianit.³² Në Athinë paraqiten më vonë, nga viti 180, rreth vitit 200 bëhen të zakonshëm.³³

Është karakteristike se ekzemplari ynë nuk ka kurrfarë paraqitjeje figurative apo dekorative në arkë dhe kurrfarë figure të skalitur në kapak, ku zakonisht është i shtrirë një person apo çifti bashkëshortor.³⁴ Prandaj në pamje të parë do të mendonim se sarkofagu është i pakryer, sidomos kur në një anë, siç pamë, sarkofagët nga guroret dhe punëtoritë e Prokonezit eksportoheshin edhe si gjysmëfabrikate me motive dhe skena të skicuara, e pastaj nga aftësitë e punëtorive vendëse varej përfundimi i motiveve dekorative dhe i skenave figurative³⁵. Sarkofagë të tillë praktikonin edhe disa gurore dhe punëtori, në mesin e të cilave shquhen ato të Afrodizisë (*Aphrodisias*) në Azi të Vogël³⁶. Në anën tjetër, edhe te sarkofagët e eksportuar atikë portetet në kline zakonisht vetëm janë skicuar në punëtori, kështu që në shumë raste kanë ngelur në atë gjendje³⁷. Mirëpo në mesin e këtyre sarkofagëve ka edhe sish te të cilët në kapak, pos jastekut, nuk është skalitur kurrfarë figure. Nga trevat e afërta, një ekzemplar të tillë nga shekulli III vjen nga Salona, i cili gjendet në Muzeun Arkeologjik të Splitit³⁸, kurse nga trevat e largëta na është i njohur një sarkofag i cili ruhet në Muzeun Shtetëror të Bejritit,³⁹ me ndryshime në trashësinë e kapakut dhe të zbukurimeve relievo në arkë – te i pari me paraqitje figurative, ndërsa te i dyti me një motiv të thjeshtë gjeometrik. Në bazë të analogjive me këta ekzemplarë mund të konstatojmë se sarkofagu ynë nuk paraqet vepër të papërfunduar, por është plotësisht i kryer, meqë skalitësi nuk e ka skalitë me qëllim në shtrat figurën apo figurat e zakonshme, ashtu si edhe dekorimin në arkë, aq më shumë kur nuk ka kurrfarë shenjash të motiveve, përkatësisht figurave të skicuara,

³¹ W. Altmann, 1902, f. 31, figg. 9-12.

³² Po aty, 41; H. Wrede, 1977, f. 395, figg. 70, 109, 110.

³³ G. Koch – H. Sichtermann, 1982, f. 371; N. Cambi, 1988, f. 24.

³⁴ G. Koch – H. Sichtermann, po aty, f. 371.

³⁵ H. Wiegartz, 1974, f. 369; N. Asgari, 1977, f. 329 e tutje; G. Koch – H. Sichtermann, po aty, ff. 382, 486; G. Koch, 1988, f. 69.

³⁶ G. Koch – H. Sichtermann, po aty, f. 495 e tutje; N. Cambi, 1988, f. 16.

³⁷ G. Koch – H. Sichtermann, po aty, f. 373; N. Cambi, po aty, f. 26.

³⁸ I. Lokošek, 1989, f. 109, figura në faqen e parë; N. Cambi, 1993, ff. 77-85, TT. 30-33.

³⁹ G. Koch, 1993, f. 152, fig. 53.

meqë ato kurrë nuk kanë qenë të parapara të skaliten, po përkundrazi, sipërfaqja ka një zmalt të theksuar.

Përkundër krahasimit me këta dy ekzemplarë sarkofagësh të importit atik, lloji i mermerit nuk flet se kemi të bëjmë me një import të tillë, por sipas vlerësimit të G. Kochut duhet të jetë import i Azisë së Vogël⁴⁰. Mirëpo sipas analizës petrografike të mermerit të realizuar nga prof. dr. i gjeologjisë ekonomike Walter Prochaska nga Departamenti i Gjeoshkencës dhe Gjeofizikës së Univerzitetit të Leobenit në Austri, del se 42,8 për qind ky mermer është i proveniencës së ishullit Paros në Greqi (Tab. III, Tab. IV)⁴¹, që paraqet rastin e vetëm jo vetëm në Dardani, por edhe në të gjithë provincën e Mezisë së Epërme. Te ky sarkofag një gjë është e evidente - me llojin kualitativ të mermerit, përmasat e mëdha dhe punimin e përkryer paraqet vepër monumentale aty rreth vitit 250. Po ashtu paraqet ekzemplarë të rrallë me kapak-kline në Dardani, ku kapak të tillë duhet të ketë pasur vetëm edhe sarkofagu i fragmentuar nga Naisi (*Naissus*, Nishi) që i takon importit atik, i cili nga zbulimet e deritashme paraqet rastin e dytë në Dardani⁴². Prandaj mund të themi se ky tip sarkofagu në këtë trevë ka arritur vetëm me anë të importit. Me anë të importit ka arritur edhe në pjesën veriore të Mezisë së Epërme, ku sarkofagu prokonez nga Viminaci e paraqet ekzemplarë të vetëm⁴³.

Sa u takon bartësve të këtyre sarkofagëve, për atë nga Vendeni, stolitë e kualitetit të lartë të punuara në ar dhe gur gjysmë të çmueshëm flasin se kemi të bëjmë me një vajzë të re, që u varros së bashku me to, duke dëshmuar se ajo i takonte shtresës së lartë qytetare. Edhe për sarkofagun e Ulpianës, megjithë plaçkitjen e mëhershme, për ç'arsye çifti bashkëshortor i varrosur në të u gjet pa stoli, kualiteti i lartë i punimit dhe përmasat flasin se kemi të bëjmë me përfqësues të shtresës së lartë qytetare. Mirëpo etniteti i tyre në të dy rastet nuk mund të dihet në mungesë

⁴⁰ Pa analizën petrografike të mermerit në punimet e mëhershme sipas sugjerimit të prof. dr. N. Cambit jemi orientuar për import atik, khs. shën. 29. Kurse mendimin e vet prof. dr. Kochu e ka dhënë në Simpoziumin Ndërkombëtar në Grac në korrik 2008, ku prezantova sarkofagët e Dardanisë.

⁴¹ Falënderoj prof. dr. W. Prochaska-n, i cili pati mirësinë të më dalë në ndihmë në realizimin e analizës petrografike të mermerit nga një fragment i ofruar në Marburg të Gjermanisë me rastin e Simpoziumit Ndërkombëtar të Sarkofagëve në tetor 2010, ku isha pjesëmarrës.

⁴² F. Kanitz, 1892, f. 76, fig. 52. Interpretimi: G. Koch, 1978-79, f. 17, fig. 3; G. Koch – H. Sichtermann, 1982, f. 332, shën.3; E. Dobruna - Salihu, 2008, f. 179, fig. 5.

⁴³ Khs. shën. 25.

të mbishkrimit, i cili te sarkofagët me dekorime në relief zakonisht duhet të ketë qëndruar në arealin e varrit ose në një vend tjetër të dukshëm.⁴⁴

Shikuar në tërësi, të dy sarkofagët me vlerat e larta artistike paraqesin monumente mjaft të vlefshme në gjininë e skulpturës të punuar në gurë gjatë antikitetit jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë Dardaninë. Njëherësh me veçoritë e tyre përbëjnë edhe ekzemplarë unikë në këtë trevë, të cilët së bashku me pesë realizime të tjera skulpturore – në skulpturë të plotë dhe relief – të kualitetit të lartë artistik nga Ulpiana: një shtatore, një fragment relievi i nimfës dhe tri koka si pjesë shtatoresh (një kokë gruaje, një kokë mashkulli – maskë pa analogji në të gjithë Perandorinë – dhe një kokë erosi)⁴⁵ përbëjnë një thesar shumë të çmueshëm të koleksionit arkeologjik të antikitetit në Kosovë dhe të rrallë në tërë Dardaninë. Si të tillë dëshmojnë për dy fakte me rëndësi: praninë e klientës së pasur në arealin e Ulpianës, e cila me blerjen e këtyre sarkofagëve të shtrenjtë (të gatshëm apo të papërpunuar) e realizonte edhe qëllimin e diferencimit të saj shoqëror dhe, aq më shumë, së bashku me pesë realizimet e tjera skulpturore punuar në mermer prokonez dhe atik për lidhjet tregtare – si të vetë qytetit, ashtu edhe të Vendenit – me qendrat e njohura si të guroreve, ashtu edhe të punimit të sarkofagëve, përkatësisht të skulpturës në Azi të Vogël dhe në Greqi.

Përkitazi me rrugët përmes të cilave është zhvilluar kjo tregti gjatë antikitetit në Kosovë, do të theksonim se gjithsesi fjalën kryesore e kanë pasur dy magjistralet transversale, që kryqëzoheshin në Ulpianë, të ndërtuara që në kohën e Augustit,⁴⁶ për të mbërritur kulminacionin në kohën e Trajanit dhe Hadrianit.⁴⁷ Njëra, e njohur *Naissus* - *Lissus* (Nish- Lezhë) – ku gjendej stacioni Venden – që është ndër rrugët më vjetra në të gjithë Mezinë e Epërme, që jo vetëm që lidhte Dardaninë me Adriatikun Jugor (pjesën jugore të provincës së Dalmacisë),⁴⁸ por përmes Naisit, në një anë, me anë të magjistrales Serdikë (Sofje) - Kontantinopol (Stamboll) dhe, në anën tjetër, me anë të rrugës për në Ratiarë për të vazhduar nëpër Danub, e lidhte edhe me Azi

⁴⁴ N. Cambi, 1988, f. 65.

⁴⁵ E. Dobruna - Salihu, 2009, ff. 197-198, figg. 3, 4; e njëjta, 2011 (punim në shtyp).

⁴⁶ Domaszewski, 1904, f. 9.

⁴⁷ Čerškov, 1969, ff. 43-44, harta.

⁴⁸ Čerškov, 1957, ff. 66-78; i njëjti, 1969, ff. 44-47.

të Vogël.⁴⁹ Tjetra magjistrale, me piknisje në pjesën veriore të Adriatikut, duke kaluar nëpër Bosnje, Novi Pazar – Mitrovicë – Ulpianë – Skup - Tesalonikë, në veri e lidhte Dardaninë me pjesën veriore të provincës së Dalmacisë dhe në jug me Maqedoninë e Greqinë.⁵⁰ Nëpër këto magjistrale, krahas importit, ka pasuar edhe eksport të resurseve natyrore nga minierat e pasura të kësaj pjese dardane, para së gjithash atyre të qendrës antike *Municipium DD* (te Soçanica afër Mitrovicës), prej nga është bartur argjendi në Dalmaci dhe Itali,⁵¹ transporti i të cilit, sikundër edhe i xeheve të tjera, hekurit, plumbit, bakrit, si edhe i punimeve prej ari për të cilat flet Plini, ka filluar që herët.⁵²

Këto dy magjistrale njëherësh ndikuan që Ulpiana, ku gjendej edhe stacioni i doganës ilire (*station vectigalis Illyrici*), ashtu si edhe Naisi dhe Skupi, të bëhet qendër e njohur tregtare.

Shkurtesat

AA – Archäologischer Anzeiger. Beiblatt zum JDAI. (Berlin)

BASD – Bulletino di archeologia e storia dalmata. (Split)

BJ – Bonner Jahrbücher (Bonn)

GCBI – Godišnjak. Centar za balkanološka ispitivanja ANUBiH. (Sarajevo)

GMKM - Glasnik Muzeja Kosova i Metohije (Buletini i Muzeumit të Kosovë-Metohisë), Prishtinë 1 (1956) – 9 (19); Glasnik Muzeja Kosova (Buletin i Muzeut të Kosovës). (Prishtinë 10 (1970-))

INMV – Izvestija na Narodnija muzej v Varna. (Varna)

RM - Mitteilungen des Deutschen Archäologischen Instituts. Roemische Abteilung. (Mainz am Rhein)

ZborFFB – Zbornik Filozofskog fakulteta u Beogradu. (Beograd)

ŽA – Živa antika. (Skopje)

⁴⁹ Khs. P.Petrović, 1976, f. 89.

⁵⁰ Khs. shën. 47.

⁵¹ Dušanić, 1971, f. 127; Mirković, 1971, ff. 269-270.

⁵² Plin. XXIII 3, 12.

Literatura

- Altmann, W., 1902 – *Architectur und Ornamentik der antiken Sarkophage*, Berlin 1902.
- Asgari, N., 1977 – Die Hallfabrikate kleinasiatischer Girlandensarkophage und ihre Herkunft, *Zweites Symposium über die Antiken Sarkophagreliefs*, AA 3, 1977, 329-383.
- Bulić, F., 1907 – Due coperchi di sarcofagi marmorei trovati a Salona, *BASD* 30, 1907, 99-101.
- Bulić, F., 1910 – Escavi nella necropoli antica pagana di Salona detta Hortus Metrodori negli anni 1909 e 1910, *BASD* 33, 1910, 3-66.
- Cambi, N., 1975 – Antički sarkofazi iz Like, *Arheološka problematika Like*, Znanstveni skup, Otočac, 21-23. rujna 1974, *HAD* 1, Split 1975, 75-84.
- Cambi, N., 1975a – Sarkofazi na istočnoj Jadranskoj obali (3-7 st.), (Diss.), Zagreb 1975.
- Cambi, N., 1982 – Sarkofag iz Šipova, *GCBI* 20/18, 1982, 91-109.
- Cambi, N., 1988 – Antički sarkofazi na istočnoj obali Jadrana, Split 1988.
- Cambi, N., 1993 – New Attic Sarcophagi from Dalmatia, *Grabeskunst der römischen kaiserzeit*. Herausgegeben von Guntram Koch, Mainz am Rhein 1993, 79-90.
- Cermanović-Kuzmanović, A., 1964 – Jedna grupa rimskih sarkofaga iz Sirmijuma, *ZborFFB* 8/1, 1964, 99-111.
- Cermanović-Kuzmanović, A., 1965 – Die dekorierten Sarkophage in den römischen Provinzen von Jugoslawien, *Archaeologia Jugoslavica* 6, Beograd 1965, 89-103.
- Čerškov, E., 1956 – Ulpiana, *GMKM* 1, 1956, 320-327.
- Čerškov, E., 1957 – Oko problema komunikacija i položaja naselja na Kosovu i Metohiji u rimskom periodu, *GMKM* 2, 1957, 65-85.
- Čerškov, E., 1969 – Rimljani na Kosovu i Metohiji, Beograd 1969.
- Dautova-Ruševljan, V., 1983 – Rimska kamena plastika u jugoslovenskom delu provincije donje Panonije, Novi Sad 1983.
- Dobruna-Salihi, E., 2003-2005 – Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake 1-2, *Prishtinë* 2003-2005.
- Dobruna-Salihi, E., 2008 – Kaiserzeitliche reliefgeschmückte Sarkophage aus Dardanien, Thiasos. *Festschrift für Erwin Pochmarski zum 65. Geburtstag*, Wien 2008, 167-183.
- Dobruna-Salihi, E., 2009 – Glavni trgovački antički putovi Kosova u svetlu kamene plastike, *Routes and Trade from Prehistory to the Early Middle Ages*, International Archaeological Symposium, Pula, 27-29 November 2008, *Histria Antiqua* 17, Pula 2009, 193-201.
- Dobruna-Salihi, E., 2011 – Sculpture of foreign marble in the central part of Dardania (present day Kosova) during Antiquity, *Interdisciplinary Studies on Ancient Stone*, IX AS-MOSIA International Conference, Tarragona, 8-13 June 2009 (në shtyp).
- Domaszewski, A. v., 1904 – Le stazioni dei beneficiarii e le reti stradali romane nell'Illyricum, *BASD* 27, 244, 2-17.
- Dušanić, S., 1971 – Novi Antonijev natpis iz Metalla Municipii Dardanorum, *ŽA* 21/1, 1971, 241-259.
- Ferri, S., 1933 – *Arte romana sul Danubio*, Milano 1933.
- Fidanovski, F., 1985 – "Poljanice", Glavnik, Podujevo – rimska nekropola, *Arheološki preglad* 24, Beograd 1985, 101.
- GABELMANN, H., 1973 – Die Werkstattgruppen der oberitalischen Sarkophage, *Beihette der BJ* 34, Bonn 1973.
- Gabelmann, H., 1977 – Zur Tektonik oberitalischer Sarkophage, *Altäre und Stelen*, *BJ* 177, 1977, 199-222.
- Gerasimov, T., 1969 – Antični sarkofazi ot Odesos, *INMV* 5 (20), 1969, 49-69.

- Himmelman, N., 1970 – Der “Sarkophag” aus Megiste, Akademie der Wissenschaften und der Literatur, Abhandlungen der Geistes-und Sozialwissenschaftlichen Klasse 1, Mainz-Wiesbaden 1970.
- Kanitz, F., 1892 – Römische Studien in Srbien 2, Denkschriften der kaiserlichen Akademie der Wissenschaften – Philozophisch-historische Classe 41, Wien 1892.
- Koch, G., 1978-79 – Ein Sarkophagfragment mit dem Kampf bei den Schiffen in Malibu, Journal J. Paul Getty Museum 6-7, 1978-79, 103-110.
- Koch, G., 1988 – Sarkophage der römischen kaiserzeit in Albanien, RM 95, 1988, 235-256; Monumentet 1, 1988, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë 39-81.
- Koch, G., 1989 – Grabdenkmäler der römischen kaiserzeit in Albanien, Iliria 19/2, Tiranë 1989, 151-159.
- Koch, G., 1993 – Sarkophage der römischen kaiserzeit, Wissenschaftliche Buchgesellschaft, Darmstadt 1993.
- Koch, G., 2010 – Sarkophage der römischen Kaiserzeit in der Türkei. Ein Überblick (mit einer Bibliographie), Adalya 13, Antalya 2010, 111-183.
- Koch, G. – Sichtermann, H., 1982 – Römische Sarkophage, Handbuch der Archäologie, München 1982.
- Lokošek, I. 1989 – Solin (Salona), Arheološki pregled 1987, Ljubljana 1989, 106-111.
- Mirković, M., 1977 – Beneficiarna stanica kod Novog Pazara, ŽA 21/1, 1971, 263-271..
- Peja, F., 1995 – Disa zbulime arkeologjike të periudhës antike në luginën e Llapit, Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit, Materiale nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 6-17. nëntor 1993, Prishtinë 1995, 67-76.
- Petrović, P., 1976 – Niš u antičko doba, Niš, 1976.
- Rodenwaldt, D., 1943 – Sarkophagprobleme, RM 57/1-2, 1943, 1-26.
- Sergejevski, D., 1934 – Rimski spomenici iz Bosne, Spomenik Srpske kraljevske akademije 77 (60), Beograd 1934.
- Tomović, M., 1991 – Prokonoski sarkofag sa girlandama iz Viminaciuma, Viminacium 6, Požarevac 1991, 69-80.
- Višić-Ljubić, E., 1999-2000, Poklopac sarkofaga od prokoneškog mramora iz Salone, Opuscula Archaeologica 23-24, Zagreb 1999-2000, 459-464.
- Ward Perkins, J. B., 1958 – Roman Garland Sarcophagi from the Quarries of Proconnesus (Marmara), Smithsonian Report for 1957, Washington 1958, 400-.
- Ward Perkins, J. B., 1969 – The Imported Sarkophagi of Roman Tyre, Bulletin du Musée de Beyrouth 22, 1969, 109-.
- Wiegartz, H., 1974 – Marmorhandel. Sarkophagerstellung und Lokallisierung der kleinasiatischen Saulensarkophage, Mélanges Mansel 1, Ankara 1974, 345 sqq.
- Wrede, H., 1977 – Stadtrömische Monumente. Urnen und Sarkophage des Kliententypus in den beiden ersten Jahrhunderten n. Chr., AA 3, 1977, 395-431.

Sarcophagus from ???


Analytical results:

MgC


O ₃	Fe ppm	Mn ppm	Sr ppm	Li/Na	Cl/Na	K/Na	F/Na	Br/Na	I/Na	SO ₄ /Na	d ¹⁸ O (PDB)	d ¹³ C (PDB)
0,82	35	10	145	0,182	1290	790	9,6	3,7	8,2	244,4	-1,11	3,18

Results of the multivariate analysis:

sample	variables	distance	abs.probability	rel.probability.	provenance	rel. probability.	provenance
		1. choice				2. choice	
Sarcoph.	DS, Mg, Fe, Mn, Sr, Li/Na, Cl/Na, K/Na, I/Na, $\delta^{18}\text{O}$, $\delta^{13}\text{C}$	1,7	42,8	99,5	Paros II	0,4	Prokonnesos



Microphotos of the marble of the sarcophagus



Provenience of the marbles is from Paros (Paros II) with an absolute probability of 42,8 %.



Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Institute of Albanian Studies, Prishtina

TWO SARCOPHAGI MADE OF FOREIGN MARBLE IN DARDANIA (FROM VENDENIS AND ULPIANA)

Summary

Two artistic high quality sarcophagi from Ulpiana and Vendenis take an important place among the antiquity monuments which were made of foreign marble in the central part of Dardania (Kosova). They belong to different workrooms; one of them was imported while the other one was made by local people. They belong to different types also as regards tectonic-structural features or more concretely as regards the cover, representing two main types of sarcophagi.

The sarcophagus from Vendenis (village of Gllamnik) was made of crystal marble which was a white shining colour and green inscriptions and belonged to the type with cover in the form of a gable roof (fig 1 a-c). The coffin is intact, except its pedestal (plinth) and the crown in three profiles. The cover which contains big angular acroteria, out of which only one is completed, was decorated with the motif of arched tiles ranked in the form of squamae, while the other side together with acroteria is intact. This motif, which belongs to Attica and oriental models, presents a unique exemplar throughout Dardania.

The type of the marble and intact sarcophagus show that this sarcophagus was made of "prokonessos" marble which was exported in the form of blocks only with contours, mainly through river transport (Danube and Margut). Its local processing in situ by a foreign master began during the first part of IV century based on Attica's model. The sarcophagus from Ulpiana was made of white high quality crystal marble with big granules and it belongs to the type with cover (fig. 2 a-c). There is no figurative or decorative feature in the coffin, except the pillow; no engraved figure on the cover where usually lies a person or couple. However, it presents a full completed work, since there are no signs of sketched motives or figures. It is difficult to find out precisely the exact place where this exemplar was made without petrographic marble analysis. According to the assessment of the well-known expert in sarcophagi, G.Koch, it was imported from Asia Minor. However, it is clear that the huge dimensions and perfect mastership indicate that it was a work of one of the most known centers in which were sarcophagi made (around the year 250). It also represents a rare exemplar with cover in Dardania, or the second exemplar. That's why we can come to the conclusion that it was imported. In general, both sarcophagi with their values indicate two important facts: the presence of rich clients in the area of Ulpiana and trade relations - in the city itself, but also trade relations between the city and other well-known centers of quarries and workrooms where the sarcophagi were made.

Shpresë SIQECA, Universiteti i Prishtinës

VESHJET QYTETARE TË PRIZRENIT NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

KUD 391/2(496.51)

Abstrakt

Në punimin “Veshjet qytetare të Prizrenit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX” bëhet fjalë për veshjen e burrit, të nuses dhe të gruas së re të Prizrenit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Punimi u hartua duke u bazuar në ekzemplarët e veshjeve të vendosura në Sektorin Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, koleksionet private, një gravure të vitit 1876, të dhënat gojore dhe të udhëpërshkruesve të huaj, fotografive familjare etj.

Veshja qytetare e Prizrenit ishte punuar prej cohe, pambuku, mënda-fshi, kadifeje, lëkure, pëlhure të fabrikuar, argjendi, ari dhe çeliku. Ajo ishte punuar me teknikën e qepjes, të endjes, të qëndisjes, të punimit me grep dhe në mënyrë industriale. Dekorimet në veshje dhe aksesore kishin motive florale, gjeometrike, zoomorfe dhe spiraloide. Veshja ishte punuar kryesisht nga mjeshtrit vendorë argjendarë, terzinj, kazazë e këpucëtarë, ndërkaq ndonjë aksesori i veshjes ishte importuar nga jashtë.

Veshja qytetare e burrit i takon tipit të veshjes me shallvare, ndërkaq ajo e nuses dhe e gruas së re tipit të veshjes me dimi. Këto veshje u zëvendësuan me veshjen evropiane “alla franga” në fillim të shekullit XX.

Fjalët çelësa: Prizren, veshje qytetare, shallvare, dimi, dollama, xhybe, xhamadan, terzi, filigran, qostek.

I. Veshja qytetare e burrit

Burrat shqiptarë, myslimanë e katolikë të Prizrenit mbanin veshje unike, me pak dallime /Fig.1/. Veshja e burrit përbëhej prej këtyre pjesëve: shallvaret,¹ këmisha, brezi,² mitani,³ xhamadani, dollama, qyrku, çorapët, këpucët,⁴ fesi⁵ dhe stolitë.

¹ Në koleksionin e Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhen dy palë shallvarë, nr. i inv. 180 dhe 94.

² Nr. i inv. 387, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

³ Në koleksionin e Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhen dy mitanë, nr. i inv. 134.

⁴ Në koleksionin e Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhen pesë palë këpucë, nr. i inv. 683, 686, 687 dhe 688.

Burri veshte shallvarë me ngjyrë të kuqe, të kuqe të mbyllët, ngjyrë uthulle etj. Rreth xhepave dhe në këmbëza zbukuroheshin me disa rende gajtanësh të zinj. Këmisha ishte e qepur prej pëlhure pambuku me ngjyrë të bardhë. Ajo e kishte jakën e vogël në formë të një rripi të ngushtë që mbërthehej me një pullë të vogël.

Fig. 1. Veshje burri



Brezi prej mëndafshi të importuar “tarabullus” ishte me ngjyrë të bardhë, me vija të zeza vertikale e me katrorë me ngjyrë të verdhë e të zezë. Në dy skaje kishte thekë prej fijeve të mëndafshit me ngjyrë të bardhë e të zezë.

Mbi këmishë vishej mitani. Mitani qepej prej pambuku ose mëndafshi. Mitani prej pambuku ishte me ngjyrë të kuqe të mbyllët, me vija të

⁵ Në koleksionin e Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhen dy fese, nr. i inv. 389.

bardha. Në pjesën e brendshme, ajo veshej me pambuk me ngjyrë të bardhë. Kapakët e mitanit mbërtheheshin njëri mbi tjetrin dhe kapeshin me katër mbërthyes prej gajtani të zi. Mëngët ishin të gjata e të ngushta. Ato ishin të prera në fund dhe mbërtheheshin me nga gjashtë pulla të vogla. Rreth jakës, mëngëve dhe bërrylave, mitani zbukurohej me gajtanë të zinj. Mitani prej mëndafshi të “shamit” ishte me ngjyrë krem, me vija të zeza. Në pjesën e brendshme veshej me pambuk me ngjyrë të bardhë. Kapaku i majtë kishte një xhep të vogël për orë. Mëngat ishin të ngushta e të gjata, të prera në fund. Në bërryla, mitani ishte i zbukuruar me gajtanë. Rreth jakës dhe në mëngë kishte dekorime në formë të vijave të bardha e të zeza.

Mbi mitan vishej xhamadani. Xhamadani qepej prej kadifesë ose cohës. Xhamadani prej kadifesë ishte me ngjyrë të kuqe të mbyllët.⁶ Zbukurrohej tërësisht me fije gajtani të zi e të shpeshtë. Kapakët kishin ornamente në formë të vijave të drejta e të valëzuara, ndërsa shpina kishte ornamente në formë të rrathëve spiraloidë që kanë të bëjnë me kultin e diellit. Në të dy kapakët kishte nga njëzet sumbulla të zbukuruar me rruaza të kuqe. Xhamadani prej cohe ishte me ngjyrë të kuqe.⁷ Pjesa e përparme rreth hapjes dhe mëngët rrethoheshin me një shirit të zi. Kapakët qëndiseshin me fije ari dhe zbukurroheshin me gajtanë leshi me ngjyrë të gjelbër, me motive florale e rrathë të vogla spiraloidë. Xhamadani kishte njëzet sumbulla vërtet në kapakun e majtë. Xhamadani tjetër prej cohe kishte dekorime ta pasura të punuara me gajtanë me ngjyrë uthulle, me motive spiraloidë. Kishte sumbulla në të dy anët e kapakëve.

Mbi xhamadan vishej dollama e qepur prej kadifeje ose cohe me ngjyra të ndryshme. Dimrit, mbi xhamadan vishej çyrku, i qepur prej lëkure me ngjyrë të kaltër të mbyllët. Jaka dhe rrethi i mëngëve ishin me ngjyrë të zezë. Burri mbathte çorapë të bardha pambuku dhe këpucë të zeza prej lëkure. Burri në kokë vinte fesin e kuq me xhufkë të gjatë me ngjyrë të kaltër të mbyllët.⁸

Prej stolive burri përdorte qostekë për orë, zinxhirë kraharori, unaza, çibukë, kuti duhani etj. Qostekët për orë punoheshin prej ar-

⁶ Nr. I INV. 385, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

⁷ Nr. I INV. 53, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

⁸ Nr. I INV. 389, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

gjendi. Ato përbëheshin nga zinxhiri i trashë, sumbullat dhe motivet në forma të ndryshme, me nga një gurë në mes. Ndërkaq, orët e xhepit me zinxhirë⁹ kryesisht e kishin kapakun e praruar mbi të cilin ishin punuar me gravurë lule e gjethe.¹⁰ Kutitë për duhan punoheshin prej argjendi me teknikën e filigranit, të gravurës /gërvishtjes/ e të savatit. Këto kuti shquheshin për nga finesa artistike. Çibukët ishin kryesisht prej qelibari. Ato zbukuroheshin me filigran, copa sedefi të vegjël dhe skalitje me savat. Në ornamente dominonin motive florale.¹¹

Veshja qytetare e burrit të Prizrenit është e ngjashme me veshjen e burrit të besimit fetar katolik të Shkodrës.

II. Veshja qytetare e nuses dhe e gruas së re

Në Prizren veshjen e tipit me dimi “alla turka” e përdornin shqiptaret e besimit fetar mysliman dhe katolik, ndërmjet të cilave kishte disa dallime.

1. Veshja qytetare e nuses dhe e gruas së re të rritit fetar mysliman

Veshja e nuses dhe e gruas së re të besimit fetar mysliman përbëhej prej këtyre pjesëve: dimitë,¹² këmisha,¹³ përparësja /Fig. 2/, brezi, xhamadani,¹⁴ mitani,¹⁵ xhybja,¹⁶ dollama, këpucët,¹⁷ nallat, shamitë e kokës /Fig. 3/, stolitë, terliku, peqeja dhe xhari.¹⁸

⁹ Ekzemplar i importuar nga jashtë, nr. i inv. 1358, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁰ SIQECA Shpresa /1998/: Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në *Libri shkollor*, Prishtinë, f. 26.

¹¹ SIQECA Shpresa /2002/: Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, në *Perlat e etnisë shqiptare në Prizren*, Gjeçovi, Dukagjini, Pejë, f. 63.

¹² Në koleksionin e Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhen dy palë dimi, nr. i inv. 161.

¹³ Nr. i inv. 386, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁴ Xhamadani është blerë në vitin 1976, nr. i inv. 993, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁵ Mitani dhe disa shami janë blerë prej Batisha Hajdarit, nr. i inv. 636 dhe 534, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁶ Xhybja është blerë në Pejë, nr. i inv. 63, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁷ Këpucët janë blerë prej Byranedin Zhubit, nr. i inv. 685, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

¹⁸ Xhari është blerë me 28.XII.1976, nr. i inv. 645, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



Fig. 2, Fragment i përparësës



Fig. 3, Shamitë e kokës

Dimitë ishin prej mëndafshi njëngjyrësh, prej pëlhere të hollë “xhanfes“ me ngjyrë roze, dimi “hare”, dimi “jun“ prej leshi me ngjyrë krem me lule ose ngjyrë kafë, dimi prej sateni me ngjyrë të kuqe etj. Ato ishin kryesisht të gjata e të gjera, me këmbëza që përfundonin me pala të dendura.¹⁹ “Ship” çitjanet për dallim prej të tjerave ishin më të ngushta dhe kishin këmbëza prej kadifeje me ngjyrë të kuqe, të qëndisura sipër me fije ari e argjendi. Rreth xhepave dhe në pjesën e përparme e të pasme ato kishin rripa prej kadifeje të kuqe të cilat ishin gjithashtu të qëndisura me fije ari e argjendi. Dimitë shtrëngoheshin në brez me ushkurin prej mëndafshi. Dy skajet e ushkurit qëndiseshin me fije ari.

Këmisha endej prej mëndafshi në formë të shtrirë ose të rrudhur, me ngjyrë natyrore. Ajo kishte mëngë të gjata dhe shumë të gjera. Mesi i mëngëve kishte një rrip prej mëndafshi. Rripat kishin formën e katërkëndëshit të zgjatur. Qëndiseshin me fije ari e mëndafshi me shumë ngjyra, me motive florale-lule e gjethe. Kishin edhe disa ornamente të punuara me gjilpërë, të cilat ishin në formë katrore dhe me ngjyrë të kuqe e të kaltër të mbyllët. Rreth jakës së këmishës, grykës e mëngëve punohej dantella “oja” me penj mëndafshi.

Përparësja endej në vek prej mëndafshi dhe qëndisej në dy skaje me fije ari, me teknikën e mbushjes.

Brezi endej në vek prej mëndafshi të prodhimit shtëpiak ose prej mëndafshi të importuar “tarabullus“. Gratë e pasura përdornin brezin prej ari apo argjendi.

Mbi këmishë nusja dhe gruaja e re veshte xhamadan²⁰ ose mitan.²¹ Xhamadani ishte pa mëngë, ndërsa mitani ishte me mëngë të gjata. Xhamadani dhe mitani qepeshin prej cohe ose kadifeje me ngjyrë vishnje të mbyllët, të kuqe, të kuqe të mbyllët dhe ngjyrë vjollce të mbyllët. Ata ishin të shkurtër e të ngushtë.²² Në pjesën e përparme, kishin 8, 10 apo 11 sumbulla të mëdha, të zbukuruara në maje me gurë koral të kuq “merxhane“. Ata qëndiseshin rreth jakës, në kapakë, në mëngë dhe në shpinë

¹⁹ Nr. I INV. 161, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

²⁰ Xhamadani është blerë në vitin 1976, nr. i inv. 993, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

²¹ Mitani është blerë prej Batisha Hajdarit, nr. i inv. 636, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

²² Gjatësia e tyre sillet rreth 28 apo 35 cm., ndërsa gjerësia rreth 37 cm.

me fije ari, argjendi apo gajtani me ngjyrë të zezë ose me ngjyrë të njëjtë si trualli. Dekorimet kishin motive florale e gjeometrike /vija të drejta e të lakuara dhe rrathë të vegjël/. Në kapakët dhe në shpinën e xhamadanit paraqitej motivi i diellit në trajtë spiraloide.

Xhamadani dhe mitani “nautli” qepeshin prej cohe ose kadifeje me ngjyrë të kuqe të mbyllët, vjollce të mbyllët etj. Ata qëndiseshin me fije mëndafshi të trashë me ngjyrë portokalli. Miss Edith Durham, e cila e vizitoi Prizrenin rreth viteve 1909-1910 shkroi me admirim të posaçëm për xhamadanët dhe qëndisjet prizrenase: “Qëndisjet me ar që shihen aty, nuk i gjen dot gjëkund; dyqanet e rrobaqepësve të marrin sytë me shkëlqimin e ngjyrave dhe të dizejnove. Jelekët e xhamadanët janë të punuara bukur me fije mëndafshi të trashë ngjyrë portokalli”.²³

Xhamadani dhe mitani “hare” qepeshin me ngjyrë krem apo ngjyra të tjera, prej materiali të njëjtë si dimitë. Ata kishin jakën në formë të rrumbullakët, skajet e së cilës mbaronin me pala të imëta, të gjata rreth 2 cm. Ndonjëri prej tyre rreth jakës kishte një dantellë të bardhë të punuar me grep. Mëngët e mitanit ishin shumë të gjera dhe mblidheshin në kapakë. Mitani kishte ornamente florale e spiraloide.

Nusja dhe gruaja e re veshte xhybe e dollama prej kadifeje e cohe me ngjyrë të gjelbër, të kuqe, të kuqe të mbyllët, të zezë, ngjyrë vishnjeje, ngjyrë vjollce etj.²⁴ Xhybja ishte pa mëngë, ndërsa dollama kishte mëngë të gjata që vareshin në supe. Ato ishin të gjata gjer në fund të këmbëve dhe të hapura në pjesën e përparme me tërë gjatësinë. Mjeshtrit qëndistarë i qëndisnin xhybet e dollamatë me fije ari ose argjendi, me tehri e bukme, gajtanë e shirita ari dhe rruaza shumëngjyrëshe. Ato qëndiseshin në tërë fushën ose rreth jakës, përgjatë hapjes së kraharorit, në pjesët e poshtme të kapakëve, rreth prerjes së xhepave dhe mëngëve. Qëndisjet kishin kryesisht motive të mëdha florale, gjeometrike e spiraloide.

Njëra prej xhybeve ishte punuar në fund të shekullit XIX.²⁵ Ajo ishte qepur prej cohe me ngjyrë të zezë. Ishte e gjatë gjer në fund të këmbëve. Qëndisej me fije ari dhe zbukurohej me gajtanë e shirita.

²³ Durham Edith /1998/, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët, Naum Veqilharxhi, Tiranë, ff. 188-189.

²⁴ Siqeca Sh., Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 44.

²⁵ Xhybja është blerë në Pejë, nr.i inv. 63, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Vlen të përmendet një xhybe tjetër e cila ruhet në një familje pasanike prizrenase. Xhybja ishte e qepur prej cohe me ngjyrë të kuqe të mbyllët. Në tërë sipërfaqen ajo ishte e qëndisur me fije ari. Ajo i ka takuar shtresave të pasura qytetare.

Në dimër vishej qyrku prej cohe ose brokati të mëndafshhtë me ngjyrë krem, roze të mbyllët apo vjollce të mbyllët. Qyrku ishte i veshur me lëkurë të dhelprës, prej së cilës ishte edhe jaka, rrethi i kapakëve, i mëngëve dhe fundi. Qyrku ishte i gjatë gjer në gjunj ose mbi gjunj. Ai kishte mëngë të gjata e të ngushta.

Nusja dhe grua e re mbathte këpucë lëkure.²⁶ Në shtëpi ajo mbathte papuçe e nallëna. Shtresat e pasura qytetare mbathnin papuçe prej sahtiani të butë. Ato zbukuroheshin në pjesën e epërme me fije ari, me motive florale. Shtresat e gjera popullore mbathnin nallëna druri, pa zbukurime, ndërsa shtresat e pasura mbathnin nallëna të zbukuruara me argjend ose me inkrustim me sedef. Një ekzemplar i tillë, i cili i takon fillimit të shekullit XX ndodhet në një shtëpi private në Prizren.

Në kokë nusja vënte fesin e vogël i cili ishte në formë të rumbullakët. Fesi ishte me ngjyrë të kuqe të mbyllët. Rrethohej me monedha të vogla dhe një monedhë të madhe në mes. Kjo shihet në një gravurë të vitit 1876²⁷ si dhe në gravura të tjera të kohës. Në kokë grua vënte shaminë “përlenta” të endur prej mëndafshi me ngjyrë natyrore. Në bordurat /anët e shamisë/ punohej dantella me gjilpërë oja. Oja kishte zakonisht motive florale të luleve e të gjetheve me lule.²⁸

Nusja dhe grua e re prizrenase përdornin unaza, vathë, byzyzkykë, broshe, zinxhirë kraharori, paftë brezi etj.²⁹

Grua kur delte jashtë shtëpisë veshte terlik e peqe. Terliku (çarçafi) ishte kryesisht i zi. Shtresat e pasura qytetare veshnin terlik prej atllazi me ngjyrë të kuqe të mbyllët ose të kaltër të çelët. Pjesa e poshtme e terlikut ishte i gjatë dhe i drejtë, ndërsa pjesa e epërme ishte i gjerë dhe e mbulonte kokën. Grua e mbulonte kokën dhe fytyrën me peqe të zezë e të tej-

²⁶ Këpucët janë blerë prej Byranedin Zhubit, nr. i inv. 685, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

²⁷ Gjergji Andromaqi /1998/, Veshjet shqiptare në shekuj, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f. 58.

²⁸ Siqeca Sh., Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 44.

²⁹ Shih më gjerësisht: Siqeca Shpresa, Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, Perlat e etnisë shqiptare në Prizren, ff. 59-74.

dukshme.³⁰ Terkliku me peçen janë veshur deri në vitin 1950.

Në vend të terlikut gruaja gjer vonë veshte "xharin" të përbërë prej dy pjesëve: fundit të gjatë gjer në gjunj dhe pjesës së epërme e cila e mbulonte trupin dhe kokën.³¹ Xharin e përdorte kryesisht gruaja e moshuar.

Fig. 4, Veshje e gruas e besimit fetar katolik



2. Veshja qytetare e nuses dhe e gruas së re e rritit fetar mysliman

Veshja e nuses dhe e gruas së re e besimit fetar katolik përbëhet prej këtyre pjesëve: dimive, këmishës, përparësës, shamisë, brezit, xhybes, dollamës, çorapëve, këpucëve, stolive, terlikut dhe mbulesës së kokës /Fig 4 dhe 5/.

Dimitë ishin prej mëndafshi ose brokati të bardhë. Këmbëzat zbukuroheshin me "harçe"-gajtanë të verdhë e ngjyrë kafeje. Këmisha e nuses dhe e gruas së re endej prej mëndafshi me ngjyrë natyrore. Ajo ishte e gjatë gjer në brez. Mëngët ishin të gjata e shumë të gjera. Rreth jakës, grykës e mëngëve punohej me gjilpërë dantella e imët "oja" me penj prej mëndafshi shumëngjyrësh.

Përparësja "boshçe" endej prej mëndafshi me dy fletë pëlhere,

³⁰ Shpresë Siqeca, Veshjet popullore shqiptare në Prizren në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Perlat e etnisë shqiptare në Prizren, f. 036.

³¹ Xhari është blerë në vitin 1976, nr. i inv. 645, Dokumentacion i Sektorit Etnologjik të Komplexit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

të cilat lidheshin në mes me dantellën "ojat e midisit". Dantella punohej me gjilpërë ose me grep, me fije mëndafshi të bardhë e ngjyrë krem. Përparësja kishte motive të endura në gjithë sipërfaqen, të vendosura në linjë horizontale.

Në vend të brezit, nusja lidhte tri shami: një në formë të trekëndëshit në brez dhe dy që lëshoheshin në ije. Brezi "shall" endej në vek me dy fletë pëlhere, prej fijesh mëndafshi me trashësi të ndryshme. Kishte stolisje në formë të katrorëve me ngjyrë portokalli, të gjelbër, të bardhë e të zezë.

Fig.5, Fragment i xhybes



Mbi këmishë vishej xhybja ose dollama. Xhybja e dollama ishin kryesisht ishin prej cohe ose kadifeje me ngjyrë të kuqe, të kuqe të mbyllët apo ngjyrë vishnje të mbyllët. Xhybja ishte e gjatë deri përfundi gjunjve. Ajo qëndisej me fije të hollë të arit, me motive të pasura. Dollama ishte e gjatë deri në fund të këmbëve. Ajo i kishte mëngët të gjata, të varura në

supe. Në dollama të nuses paraqiteshin motive të mëdha florale si dhe figura e dragoit.³²

Çorapët ishin prej pambuku me ngjyrë të bardhë. Qëndiseshin sipër me penj me ngjyrë të kuqe dhe me rruaza. Qëndisjet ishin në formë të luleve të imëta. Këpucët ishin të zeza dhe kishin një fjongo të kuqe në pjesën e sipërme.

Nusja vënte në kokë kësulën “tasfes” të zbukuruar me monedha dhe paftë argjendi të punuar me të derdhur dhe filigran /Fig. 6/. Gruaja vënte në kokë marhamën e kokës “valle”. Dantellat e kësaj marhame si dhe të këmishës i punonin gratë shqiptare myslimane. Marhama vihej në kokë, e lidhur anash, pas veshëve. Gruaja e re mbante marhama me ngjyra të çelura, ndërsa gruaja e moshuar mbante marhamë prej mavesi, të punuar me oja.³³



Fig. 6, Kësulë nuseje “tasfesi”

³² SIQECA Shpresa, Veshjet dhe tekstilet e femrave katolike prizrenase në fillim të shekullit XX, Perlat e etnisë shqiptare në Prizren, f. 42.

³³ SIQECA Shpresa, Mjeshtëria e endjes dhe qëndisjet në tekstilet prizrenase të fillimit të shekullit XX, Perlat e etnisë shqiptare në Prizren, f. 49.



Fig. 7, Stoli grash

Vathët punoheshin me përshtatjen e monedhëve dhe zbukuroheshin me filigran dhe gurë me ngjyrë të kaltër, të cilët besohej se i mbronin nga syri i keq. Stolitë tjera ishin varëset në formë zemre, të kryqit, medaljonet me figurën e shenjtëreshës Shën Maria, unazat, byzylykët, gjilpërat e kokës, broshet etj. /Fig. 7/ Në stolitë e nuses dhe të gruas së re paraqiteshin motive gjeometrike, florale, zoomorfe, antropomorfe dhe religjioze: kryqet, varësja me uruza, varësja në formë të hajmalisë etj. Motivi i kryqit punohej në formë natyrore dhe të stilizuar.

Kur delte jashtë shtëpisë nusja dhe gruaja e re veshte terlik, ndërsa në kokë vënte mbulesën “dysHEME koke”. Terliku ishte i qepur prej pëlhure me ngjyrë të zezë. Ishte i gjatë gjer në gjunj. Zbukurohej me gajtanë me ngjyrë vishnje të mbyllët, me motive florale.

Mbulesa e kokës “dysHEME koke” ishte prej pëlhure të bardhë mëndafshi ose prej pambuku të endur në vek. Kishte formën e katërkëndëshit të zgjatur. Në stolisje paraqiteshin lule e gjethe, figura antropomorfe me motivin e “pemës së jetës”, motivi i palloit dhe i zogjve³⁴ etj.

³⁴ Aty, f. 045.

Bibliografi

Siqeca Sh, **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, Libri shkollor, Prishtinë, 1998.

Siqeca Sh, **Perlat e etnisë shqiptare në Prizren**, Gjeçovi, Dukagjini, Pejë, 2002.

Durham E, **Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët**, Naum Veqilharxhi, Tiranë, 1998.

Gjergji A, **Veshjet shqiptare në shekuj**, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1988.

Shpresa SIQECA, University of Prishtina

PRIZREN'S COSTUME AT THE END OF THE XIX CENTURY AND THE BEGINNING OF THE XX CENTURY

Summary

The paper "Prizren's costume at the end of XIX and beginning of the XX century" deals with costumes, that were worn by men, brides and young women of Prizren at the end of XIX and the beginning of XX century". Man's costume can rarely be found today because it is completely out of use. Bride's and young woman's costume is used nowadays at weddings and ceremonial occasions. Today's costumes with "dimi" (pantaloon worn by Moslem women) differ from the XIX century costume as regards the material used, but its form has remained more or less the same. The costume with "dimi" is worn in the villages of Prizren, especially in Opoja and Anadrini regions and less in the region of Prizren's Has. Nowadays, a bride wears a white dress and veil. She keeps the costume and the jewelry for her daughters or daughter-in-law. In this way, the costumes and jewelry were inherited from generation to generation. Artisanal loom works, embroideries made of delicate silk threads and filigree jewelry, are rarely seen nowadays. Therefore, Prizren's costume and jewelry still preserve their own aesthetic and museum values but these traditional handicrafts are on the edge of extinction.

Pajazit NUSHI, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

SEMANTIKA E TEORISË SË PSIKANALIZËS DHE SHQIPËRIMI I KONCEPTEVE TË SAJ

KUD 159.964.2

Abstrakt

Pas përkthimit shqip të veprave kryesore të Zigmund Shlomo Frojdit (Sigmund Schlomo Freud, 1856 – 1939) konsiderojmë se u themelua “Biblioteka e psikanalizës” edhe për shqipfolësit. “Biblioteka e psikanalizës” në shqip u bë burimi i rëndësishëm i njohjes së metodës psikanalitike, të teorisë së psikanalizës dhe të metapsikologjisë. Kjo bibliotekë po pasurohet me përkthime të veprave të studiesve të psikanalizës të kohës më të re (Çarls Bremen: “Themelet e psikanalizës”) madje edhe të disidentëve të pikëpamjeve të Z. Frojdit të Alfred Adlerit (1870 – 1937), të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) dhe të neopsikanalistëve, në rend të parë të përfaqësuesve të Shkollës së Frankfurtit në krye me Erih Fromin (Erich Fromm 1900 – 1980), si edhe të të tjerëve (Karen Hornaj, Hari Saliven, etj.).

Me këtë varg përkthimesh të veprave të psikanalizës shqiptarët, në rend të parë shqiptarët e Shqipërisë, bënë të mundur kompensimin e kohës së humbur prej më se pesë dekadash të injorimit të psikanalizës në mjediset shqiptare dhe njëkohësisht ofruan lëndë të çmueshme për korrigjimin e disa pikëpamjeve të gabuara të shqipfolësve, por jo vetëm të tyre, për mendimin psikanalitik mbi natyrën shpirtërore të njeriut dhe të zhvillimit të tij.

Z. Frojdi me ligjërimin e mrekullueshëm të psikanalizës konsiderohet se është i paarritur në gjuhën e shpjegimit shkencor të dukurive të ndërlukuara psikike. Në këtë kuadër konsiderojmë se ai njëkohësisht është prijtar i zhvillimit të terminologjisë së psikanalizës, e cila sot ka arritur të marrë përmasa të qëndrueshme në shumë gjuhë duke i kontribuar sidomos zhvillimit të terminologjisë së psikologjisë dhe të psikiatrisë.

Përkthimi në shqipe i veprave të Z. Frojdit vështirë se është i nivelit të gjuhës origjinale, por gjithësesi është i dobishëm dhe me rëndësi të posaçme për zhvillimin e mendimit shkencor ndër shqiptarët mbi jetën psikike dhe zhvillimin e saj. Përkthimi është kryer në dëm të terminologjisë së psikanalizës dhe me refleksione të mundshme negative në terminologjinë e psikologjisë dhe të psikiatrisë si edhe të disiplinave të afërta me psikologjinë.

Termt kryesorë: *pavetëdija, paravetëdija, vetëdija, idi – ajo, ego – uni, superego – mbiuni, shtytësi, libido, erosi, tanatosi dhe ëndrrat.*

Konceptet e psikanalizës dhe termtat e tyre

Psikanaliza e Z. Frojdit ka rreth njëmijë termta me vlera domethënëse të veçanta që mundësojnë të kuptuarit e thelbit të mendimit

psikanalitik dhe të saktësisë domethënëse të termave të psikanalizës. Domethënia e termave të koncepteve të metodës psikanalitike përbën një klasë termash, ajo e teorisë së psikanalizës përbën klasë tjetër dhe ajo e metapsikologjisë, megjithëse buron prej dy të parave, sajon klasën e veçantë të termave psikanalitike. Termat e këtyre klasave konceptesh psikanalitike përbëjnë një sistem terminologjik, tashmë të njohur dhe të afirmuar në shumë gjuhë; ky është sistemi i termave të psikanalizës, i cili në gjuhën shqipe dallohet nga përkthimi i veprave të Z. Frojdit dhe i të tjerëve. Në kuadrin e sistemit të koncepteve dhe të termave të psikanalizës dallohen grupe termash të veçanta të koncepteve a nocioneve psikanalitike, të cilat dalin nga strukturat tematike të veçanta të mendimit psikanalitik.

Këto terma përbëjnë njësinë minimale hulumtuese të teorisë së psikanalizës; synimi për t'i bërë sa më njësore përmbajtjen e këtyre termave përbën detyrën e këtij hulumtimi.

Termat e tematikave të veçanta të këtij sistemi mund të klasifikohen sipas parimeve të ndryshme. Këto mund të ndahen sipas përmbajtjes, sipas zhvillimit dhe sipas evoluimit të mendimit psikanalitik. Sipas përmbajtjes këto struktura tematike termash të psikanalizës janë: termat e entiteve psikopatologjike (neurozat, psikozat e psikoterapia), të personalitetit (të strukturës, të dinamikës dhe të zhvillimit të personalitetit) dhe termat e psikanalizës zbatuese (psikanaliza e krijimtarisë, psikanaliza e edukimit, psikanaliza e religjionit, etj.). Ndarje e veçantë e termave të psikanalizës është ndarja e termave sipas pikëpamjes së strukturore dhe zhvillimore të dukurive dhe proceseve psikike normale dhe jonormale. Sipas kësaj pikëpamjeje dallohen konceptet topike, dinamike dhe ekonomike. Sipas zhvillimit të sistemit të mendimit psikanalitik konceptet a nocionet psikanalitike dhe termat e tyre mund të ndahen në terma të psikanalizës klasike (të Z. Frojdit para vitit 1925 dhe pas këtij viti deri më 1939) dhe në terma të neopsikanalizës (të Erih Fromit, të Henri Marit, të Karl Roxhersit, etj.).

Termat e koncepteve themelore të psikanalizës klasike me shkallë të lartë të dendësisë së përdormit gjenden më tepër në ndarjen e koncepteve dhe të termave të tyre sipas pikëpamjes topike, dinamike dhe ekonomike të zhvillimit të dukurive e proceseve psikike normale dhe jonormale të personalitetit.

Analiza sasiore e koncepteve dhe e termave të teorisë psikanalitike

Siç përmendëm, sasia e termave të psikanalizës është relativisht e madhe, por disa sosh janë të atillë, që përbëjnë bazën e kuptimit të psikanalizës. Nga termat bazë ose kryesorë u zhvilluan termat e koncepteve të tjerë, të cilët mund të kuptohen në varësi nga domethënia e termave të koncepteve a nocioneve kryesorë. Duke u nisur nga parimi i vlerës domethënëse kryesore të termave të psikanalizës zakonisht dallohen rreth 50 terma të koncepteve kryesore të psikanalizës. Por, në grupin e këtyre termave ka asosh që janë më të rendësishme për nga vlera domethënëse e rëndësia e tyre dhe të mjaftueshme për sqarimin e raportit ndërmjet semantikkës së psikanalizës dhe shqipërimit të koncepteve të saj. Në kuadrin e këtij raporti dallohen këto terma: *pavetëdija, paravetëdija, vetëdija, idi, ego, superego, shtytësit a shtysat e brendshëm, libido, shtypja, rezistenca, trauma, erosi, tanatosi dhe regresioni*.

Analiza strukturore e koncepteve dhe e termave të teorisë psikanalitike për personalitetin

Në teorinë e strukturës së personalitetit, Z. Frojdi ka dalluar pikëpamjen topike, dinamike dhe ekonomike të përbërësve psikikë të personalitetit.

Pikëpamja topike me konceptet dhe termat e veta të psikikës së njeriutnë ka të bëj me vendin, përkatësisht me termat e koncepteve të strukturës psikike, të cilat Z. Frojdi i ka përdorur për të emërtuar përbërësit e aparatit psikik dhe pozitën e këtyre përbërësve gjatë përpunimit teorik të këtij aparati para vitit 1925 dhe pas këtij viti. Në historinë e mendimit psikanalitik dallojmë dy lloje konceptimesh dhe emërtimeve përkatëse të aparatit psikik të njeriut: konceptimi topik i parë i aparatit psikik i përket viteve 1900 – 1925, kur Z. Frojdi e ka zbërthyer konceptimin e këtij aparati sipas vendit që kanë zënë termat dhe konceptet *e pavetëdijës, të paravetëdijës dhe të vetëdijës*. Konceptimi topik i dytë për strukturën e aparatit psikik Z. Frojdi e përpunoi gjatë viteve 1926 – 1939. Sipas këtij konceptimi aparatit psikik të njeriut e përbëjnë tri instanca psikike, të cilat kanë zënë vendet e tyre sipas këtij rendi: *idi ose es-i, ego dhe superego*, përkatësisht instanca *ajo, uni dhe mbiuni*. Këto tri instance dallohen njëra nga tjetra në bazë të pozicionit, të origjinës, të mënyrës së funksionimit dhe të raporteve ndërmjet tyre. Sipas pozicionit, të origjinës dhe të funksionimit të këtyre instancave Z. Frojdi, përpos termave të koncepteve a nocioneve

të pavetëdijës, të paravetëdijës, të vetëdijës, të idit, të egos e të super egos, i përpunoi termat e këtyre koncepteve a nocioneve themelore: karakteri, konfliktet psikike dhe mekanizmat mbrojtës të jetës psikike të njeriut

Pikëpamja dinamike sjelljet e përgjithshme psikike të njeriut, sjelljet normale e jonormale i shpjegon në bazë energjisë psikike dhe të sasisë së saj të investuar në zhvillimin e tyre. Sjelljet e këtilla të njeriu zhvillohën në raporte harmonike ose në raporte joharmonike. Sasia e energjisë së tyre zhvillohet reciprokisht duke nxitur zhvillimin e njëra tjetrës ose duke penguar njëra tjetrën. Dukuritë psikike normale dhe jonormale shpjegohën në bazë të konflikteve ndërmjet afekteve dhe shtysave të brendshëm, të dëshirave e të synimeve dhe pengesave të brendshme dhe të jashtme në procesin e plotësimit të tyre. Termat e koncepteve kryesore të pikëpamjes dinamike janë: *shtysat a shtytësit, synimet, konfliktet, frustrimet, afektet, libidoa, frika, agresiviteti, shtypja dhe rezistenca.*

Pikëpamja ekonomike ka të bëjë me shpjegimin e zhvillimit të sjelljeve të njeriut në bazë të raporteve të sasisë së energjisë psikike të investuar në aktet psikike të ndryshme, përkatësisht të sasisë së energjisë së shtytësve a shtysave që shkaktojnë lloje të ndryshme të veprimtarisë së njeriut. Këto veprimtari dhe sjelljet e njeriut mund të zhvillohën në sjellje normale kur sasia e energjisë së shtytësve të brendshëm është e mjaftueshme dhe në harmoni me plotësimin e tyre, por kur sasia e energjisë së shtysave të brendshëm ka përmasa vepruese të çrregullta atëherë zhvillohen sjellje me përmasa konfliktesh psikopatologjike. Në kuadrin e kësaj pikëpamjeje u zhvilluan këto terma kryesore të koncepteve a nocioneve të tyre: *trauma, fiksimi, kënaqësia, kateksi, hiperkateksi, kontrakateksi, regresioni, toleranca dhe pragu i tolerancës.*

Pavarësisht nga ndarja e këtyre koncepteve a nocioneve dhe e termave të tyre, konceptet a nocionet e këtyre pikëpamjeve janë të shumta dhe së bashku përbëjnë një sistem konceptesh e termash të ndërlikuar. Nga ky sistem ne morëm në shqyrtim vetëm ato koncepte me termat e tyre, të cilat i quajmë koncepte a nocione kryesore. Koncepte a nocione kryesore i quajmë vetëm ato, njohja e drejtë e të cilëve kushtëzon kuptimin e saktë të strukturës psikike të njeriut, pozitën e relacionet e këtyre strukturave si edhe zhvillimin dhe dinamikën psikike të njeriut.

Konceptimi i aparatit psikik dhe struktura terminologjike e koncepteve të tij

Për shpjegimin e organizimit të sjelljeve psikike Z. Frojdi e ka marrë për model domethënien e termit të latinishtes “apparatus” – “pajisje” me strukturën dhe funksionin e përbashkët të të cilit kuptohet aktiviteti psikik i njeriut dhe format e realizimit të tij. Përndryshe, Z. Frojdi aparatit psikik e ka konceptuar “mjet të cilit i është besuar zotërimi i shqetsimeve, të cilat, përndryshe, do t'i ndienim me dhembje ose do të ndikonin në mënyrë patogjene”. Në konceptimin e këtyllë të aparatit psikik në metapsikologji Z. Frojdi ka dalluar termat e koncepteve të strukturës, të dinamikës dhe të sasisë së energjisë të përbërësve të këtij aparati.

1. Termat për konceptet themelore të strukturës së personalitetit

Z. Frojdi ka bërë fjalë për strukturën e personalitetit, të cilën e ka zbërthyer në tri komponente të konceptuara dhe të emërtuara me termin *pavetëdiqe, paravetëdiqe dhe vetëdiqe*.

Pavetëdiqa është termi i konceptit themelor të psikanalizës, por jo i zbuluar nga Z. Frojdi. Këtë e ka pranuar edhe Z. Frojdi kur thotë: “Shkrimtarët e filozofët para meje (para Z. Frojdit, si Platoni, Shën Augustini, Lajbnici, Niçe, Hartman, Grodek, etj., P. N.) e kanë zbuluar të pavetëdiqshmën, ndërkaq, atë që unë e kam zbuluar është metoda shkencore me të cilën e pavetëdiqshmja mund të hulumtohet”. Metoda e këtyllë është në rend të parë metoda e asociacionimit të lire të përfytyrimeve, të mendimeve, të ideve, etj. Në bazë të zbatimit të kësaj metode Z. Frojdi e ka hulumtuar përmbajtjen e mendjes së pavetëdiqshme dhe dinamikën e së pavetëdiqshmes. Për këtë, por më tepër për shkak të rëndësisë së madhe të akteve të pavetëdiqshme në aktivitetin e gjithëmbërshëm psikik të njeriut, psikanalizën e kanë quajtur *psikologji mbi të pavetëdiqshmen*.

Përmbajtjet e pavetëdiqshme i përkasin disa nga format e veprimeve të pamundshme të vetëvëzhgohen në momentin e dhënë siç janë: lajthitjet, ëndrrat, mekanizmat mbrojtës disa nga përvojat emocionale negative të njeriut kur këto nuk mund të kontrollohen nga ana e tij, etj.

Përmbajtjet e pavetëdiqshme janë të disallojshëm dhe manifestohen në forma të ndryshme. Ndër to dallohen impulsset e shtytësve a

shtysave të lindur, në rend të parë impulsat e shtytësit seksual, dëshirat e kujtimet e shtypura dhe energjia e shtytësit a shtyesit agresiv të individit. Energjia e shtysave dhe e strukturave të tjera të pavetëdijshme nuk mund të depërtojnë lirshëm në vetëdijën e njeriut, rrallë arrin deri në paravetëdijë dhe nga kjo diç mund të arrijë në vetëdije, por vetëm në kushte të veçanta, kur procesi i censurimit e lejon depërtimin e tyre në vetëdije.

Termi *pavetëdije* në psikanalizë përdoret më tepër në trajtë të mbiemrit. Të këtillë e hasim në formën shprehëse *gjendje e pavetëdijshme, mendje e pavetëdijshme, motiv i pavetëdijshëm, veprim i pavetëdijshëm, harresë e pavetëdijshme*, etj. Për shkak të rëndësisë së madhe të akteve të pavetëdijshme në aktivitetin e gjithëmbarshtëm psikik psikanalizën e kanë quajtur psikologji mbi të pavetëdijshmen.

Paravetëdija është paradhoma e vetëdijës, të cilën e sajojnë kujtimet që nuk gjenden në vetëdijën e njeriut, por këto mund të depërtojnë lehtë në vetëdije, sepse censura ndërmjet paravetëdijës dhe vetëdijës vepron jo aq me rigorizitet në kontrollimin e përmbajtjeve të paravetëdijës. Në shqipe zakonisht përdoret termi nënvetëdije, por termi nënvetëdije në literaturën burimore të psikanalizës haset shumë rrallë.

Vetëdija është struktura psikike e njeriut, e cila përbëhet nga tërësia e aktiviteteve mentale të njeriut (të dhënat shqisore, përfyrimet, kujtimet, mendimet, ndjenjat, veprimet, etj.), të cilat njeriu është në gjendje t'i vetëvëzhgojë, t'i kontrollojë dhe t'i përshkruaj e shpjegojë. Deri në paraqitjen e rezultateve hulumtuese të Z. Frojdit psikologjia është marrë me studimin e përmbajtjeve të vetëdijshme, kurse më pas ajo u morë me studimin e përmbajtjeve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme.

Pavetëdija, paravetëdija dhe vetëdija në veprat e Z. Frojdit janë përkthyer drejtë, por nuk u zbatuan në mënyrë të qëndrueshme gjatë përkthimit të veprave të Z. Frojdit. Ka raste kur termi vetëdijë është përkthyer me termin ndërgjegje. Përveq kësaj ka raste të tjera, kur termi vetëdije, i (e) vetëdijshëm është përkthyer me termin koshiençë, përkatësisht me termin e cilësorit koshiente “mendime koshiente”.

Termat e koncepteve themelorë të strukture psikike, përkatësisht të aparatit psikik të njeriut pas vitit 1925 ndryshojnë nga ato të pikëpamjes së parë mbi të pavetëdijshmen, të paravetëdijshme dhe të vetëdijshmen. Në pikëpamjen e dytë për strukturën psikike të njeriut

Z. Frojdi pas vitit 1925 strukturën psikike të personalitetit, përkatësisht aparatit psikik e ndanë në tri instanca. Kjo është pikëpamja strukturore e aparatit psikik e përbërë nga tri koncepte a nocione dhe tri terma specifike të këtyre koncepteve. Këto janë konceptet me këto terma emërtuese: *id* ose *es*, *ego* dhe *superego*. Derisa termi i parë – termi *id* ose *es* në përkthimet e veprave të Z. Frojdit ka ngelur i papërkthyer, termat *ego* dhe *superego* në shqipe janë përkthyer me termat *uni* dhe *mbiuni*. Përkthimi i instancës *ego* dhe *superego* me termat e shqipes *uni* dhe *mbiuni* është përkthim i përshtatshëm gjuhësisht, por domethënia psikanalitike e këtyre dy termave të përkthyer nuk përputhet plotësisht me domethënien në shqipe të unit dhe mbiunit. *Uni* dhe *mbiuni* në shqipe ka domethënie më të gjerë nga domethënia psikanalitike e tyre. Në shqipe *Uni* është tërësia e tipareve që përbëjnë thelbin e njeriut si individ i caktuar dhe për të cilat ai është i vetëdijshëm, qenia e vet, vetvetja në botën që e rrethon njeriun”. Në këtë kuptim termi *unë* është term me domethënie të gjerë. Termi *ego* në psikanalizë është vetëm një pjesë e aparatit psikik, përkatësisht e strukturës së personalitetit, që kryen funksionin e komunikimit të individit me realitetin, kontrollon shtytësat dhe energjinë e tyre, si edhe regullon raportin ndërmjet *idit* dhe *superegos*. Në strukturën e *egos* funksionojnë mekanizmat mbrojtës të njeriut, por këta kanë karakter të pavetëdijshëm. *Egoja*, sipas psikanalizës, nuk ka energji burimore të veten. Domethënia e termi *ego* në psikanalizë dhe e përkthimit të këtij termi me termin *uni* në shqipe ka dallime nuancash të vogla, por nuancash të rëndësishme për të kuptuar mendimin psikanalitik. Për këtë shkak termi *ego* në shqipe do të ishte më mirë të ngelë i papërkthyer.

Gati i njëjti dallim domethënës ekziston edhe ndërmjet termi *superego* dhe *mbiuni*. Në psikanalizë *superego* është instancë e fundit e zhvilluar e personalitetit që e paraqet ndërgjegjën e njeriut - bartëse e parimeve dhe e normave morale, e vlerave kulturore, regullator i sjelljeve të individit ndaj të tjerëve dhe mbikqyrës i veprimtarisë së *egos*.

2. Dinamika e së pavetëdijshmes dhe termat e koncepteve themelore të saj

Personaliteti i njeriut për Z. Frojdin është sistem unik i ndërlikuar strukturash psikike të vetëdijshme dhe të pabëtdijshme me energjetikën e tyre. Në këtë sistem unik dallohen konflikte ndërmjet fuqive të ndryshme të pavetëdijshme të shtytësve: shtytësi seksual, ai i jetës, i destruksionit, etj. Këtyre shtytësve të brendshëm dhe energji-

së së tyre u kundërvihën kërkesat e egos dhe ato të superegos me energjitë e zhvilluara në bazë të të mësuarit. Në kuadrin e raporteve ndërmjet energjisë së shtytësve dhe të sistemit energjetik të personalitetit janë përpunuar disa koncepte a nocione me termat e tyre themelorë, ndër të cilët dallohen: *shtytësi seksual, shtytësit e egos, konfliktet, shtypja, rezistenca ose qëndresa dhe mekanizmat mbrojtës*.

Shtytësit a shtyesit (ang. *dreiv*, gjer. der *Treib*, frën. *pulsion*, rus. *vlečenje*, serbkr. *nagon*) janë struktura energjetike biopsikologjike, të cilat e shtyjnë organizmin e njeriut në veprimtari të posaçme drejtë plotësimit dhe kënaqjes së kërkesës së tyre. Shtytësit, sipas Z. Frojdit “janë reprezentues të kërkesave trupore që i drejtohen jetës shpirtërore”. I këtillë mund të jetë shtytësi seksual, i cili e shkakton veprimtarinë e individit ndaj partnerit të gjinisë së kundërt, shtytësi i vetëruajtjes nga ngacmuesit e dëmshëm dhe shtytësit e ruajtjes së llojit të qenies njerëzore me funksionin kryesor - plotësimi i nevojave individuale dhe i atyre të përgjithshme për gjininë njerëzor sipas parimit të kënaqësisë së tyre. Shtytësit e jetës ose, siç i quan Z. Frojdi, *erosi* u kundërvihën shtysave të destruksionit të organizmit dhe shkatërrimit të tij, përkatësisht *tanatosit*, i cili ka tendencën e këthimit të njeriut në gjendjen e pajetë. Pra, derisa qëllimi i shtytësit të jetës ose erosit është krijimi dhe zhvillimi i një tërësie organike të zhvilluar, qëllimi i shtytësit destruktiv është shkatërrimi i kësaj lidhjeve e tërësie. Ky sistem energjetik i brendshëm i njeriut me drejtim veprimi të kundërt nuk është sistem i veprimeve instinktive, sepse veprimet instinktive kanë natyrë tjetër dhe, rrjedhimisht, termi veprime instinktive ka domethënie tjetër.

Instinkti është veprim i stabilizuar, karakteristik për llojin e caktuar të kafshëve, që bartet prej parardhësve të atij lloji kafshësh të pasardhësit e tyre me anë të rrugëve gjenetike të trashëgimisë. Veprime instinktive janë të ushqyerit e balenave, të bërit e qerdheve të dallandysheve, vetëmbrojtja e ujqëve, etj. Këto veprime janë karakteristike për të gjithë anëtarët e llojit të balemave, të dallandysheve, të qejve, etj. dhe janë veprime, që fare pak ose aspak nuk ndryshojnë prej një anëtari të atij lloji te anëtarët e tjerë të po atij lloji të kafshëve. Veprime të këtilla të njerëzit në kuptimin e mirëfillët të termit “instinkt” nuk kemi. Vërtetë të gjithë kemi uri, etje, nevojë për veshëmbathje, për pushim, etj., por njeriu është i vetëdijshëm për këtë ne-

vojë, për mënyrën e shijën e plotësimit të urisë, të etjes, të veshëmbathjes, të pushimit, etj., për mjetet e përdorura për arritje deri në plotësim të tyre, etj. Në plotësimin e nevojave të këtilla të njerëzve nuk ka veprime të njëtrajtëshme, ka dallime të mëdha ndërmjet mjediseve kulturash të ndryshme, madje ka edhe dallime individuale ndërmjet njerëzve të mjediseve të njëjta, etj. Vërtetë struktura biologjike e urisë, e etjes, e seksit, etj. lind, por plotësimi i tyre te njerëzit varet shumë nga kultura e mjedisit ku zhvillohet dhe rritet njeriu, si edhe nga disa tipare psikologjike e sociale të tij. Struktura biologjike e urisë, e etjes, e seksit, etj. dhe energjetika e tyre lind e zhvillohet te njeriut, por objekti, procesi, mjetet, koha, vendi, mënyra, etj. e plotësimit të tyre mësohen dhe ndryshojnë jo vetëm prej një mjedisi në tjetrin, por edhe ndërmjet anëtarëve të të njëjtit mjedis. Struktura biologjike me energjetikën që e prodhon kjo strukturë te njeriu gjendet në pavetëdijën e njeriut, në id-in ose në es-in e tij. Kjo strukturë biopsikologjike është e emërtuar me termin psikanalitik të gjermanishtes *Der Trieb*, që në shqipe bën të përkthet me termin *shtytës* dhe *shtysë*.

Për termin *shtytës* a *shtys* në domethënien e sipërpërmendur në përkthim të veprave të Z. Frojdit janë përdorur disa terma. Termi *shtytës* u shqipërua me termin pasion, instinkt, prirje, impuls dhe dëshirë. Kapitulli 32 i veprës *Hyrje në psikanalizë*, Vëllimi 3, ka titullin *Frika dhe jeta e shtytësve*, kurse në shqipe është përkthyer *Frika dhe jeta e pasioneve*. Në të njëjtin kapitull thuhet: *Pikërisht këtij veprimi i është dhënë emërtimi pasion (Trieb)*. Pasioni ka domethënie tjetër nga shtytësi dhe nga instinkti. Pasion mund të jenë: ambicja, dashuria, urrejtja, etj. Pasioni dallon nga shtytësi, sepse ky i fundit është më pak i gjendjes emocionale dhe më shumë ka karakter të ngacmuesit të njeriut për veprimtari të caktuar. Në shqipërimin e përmbajtjes së temës së njëjtë përdoret edhe termi instinkt për termin e gjermanishtes *Der Trieb*. Poashtu, në shqipërimin e temës *Teoria e libidos dhe narcizmi* domethënia e termit *shtysë* emërtohet me termin instinkt. Në përkthimin e veprës *Frika* për domethënien e termit *shtytës* a *shtys* është përdorur prap termi instinkt. Po kështu është përdorur termi instinkt në vend të termit *shtytës* a *shtysë* në përkthim të veprës *Metapsikologjia*, ku, ndër të tjera, dallohet thënia: "...instinktët janë motori i vërtetë i progresit që kanë çuar sistemin nervor, me gjithë potencialet e pakufijshme, në shkallën e sotme të zhvillimit". Shtytësi,

siç kemi theksuar ka domethënie tjetër nga domethënia e termit instinkt. Instinktet kanë karakter biologjik, kurse shtytësit a shtyesit kanë karakter organik – psikik. Megjithë dallimet domethënëse ndërmjet termit shtytës, instinkt e passion, këto tri terma kanë elemente të përbashkëta dhe elemente specifike, të cilat bëjnë dallime domethënëse ndërmjet tyre.

Ka raste ku domethënia e termit shtys është emërtuar me termin prirje. Këtë e hasim në disa vende, ndër të cilët përmendim thënien: “...atë mund ta quajmë shprehje të prirjes drejt vdekjes (Todestrieb).... Për shtytësin agresiv është përdor termi prirje agresive. Në përkthimin e veprës *Dostojevski e atëvrasja* domethënia e termit shtysë është emërtuar me termin instinkt, ndërkaq, për të njëjtin koncept a nocion në një vepër jetër të përkthyer është përdor termi pasion. Ka edhe raste ku termi shtytës a shtys është përkthyer me termin dëshirë. Termi dëshirë, poashtu ka elemente domethënëse të përbashkëta me termin shtytës, por dëshira në kuptimin e psikologjisë klasike ka kuptim të synimit psikik të vetëdijshëm, kurse shtytësi me atributet e tija si edhe me energjinë e vet kalon prej organikës në sferën e psikikës. Nga vështrimi i këtillë i përkthimit të termit të gjermanishtes së Z. Frojdit *Trieb* del se në shqipe domethënia e këtij termi u emërtua me pesë terma shqip, që nuk mund të jenë terma sinonimik. Ndër këta, termi instinkt është përdorur më tepër për të emërtuar domethënien e termit shtytës. Megjithëse termi instinkt është më i afërmi me termin shtysë, madje në anglishte përdoret më tepër termi instinkt se *driver* për domethënien e termit *Trieb* ndërmjet domethënies së termit instinkt dhe termit shtytës a shtyes, siç pamë, ka dallime.

Por, edhe përkthyesit e veprave të Z. Frojdit në gjuhë të tjera kanë bërë gabime të ngjashme. Kështu për përkthuesin Xhejms Strejçi, përkthyesi kritik më i mirë i veprave integrale të Z. Frojdit në anglishte, është thenë: “ka bërë disa gabime konkrete, që janë të njohura qysh atëherë: *Trieb* është përkthyer me instinkt...”.

Jokoherenca e mosqëndrueshmëria e përdorimit të termit shqip shtysë për të emërtuar konceptet a nocionet themelore të dinamikës së personalitetit të lidhur drejtpërdrejtë dhe tërthorazi me shtytësit e brendshëm e kanë bërë përkthimin që ka të bëjë me dinamikë të personalitetit një përkthim të vështirë për t’u kuptuar, kurse për hyrësit në psikanalizë, në psikiatri dhe në psikologji përkthimi i kësaj pjese

të veprave të Z. Frojdit është gati i pakapshëm konceptualisht. Por, në shqipe është përdor edhe termi *epsh* për të emërtuar domethënien e termit *shtytës* a *shtysë*. Ndërkaq, në shqipe termi “*epsh*” përdorët kryesisht për të emërtuar “dëshirën e madhe për të plotësuar kënaqësitë seksuale”. Prandaj, për *shtytësin* seksual në shqipe pjesërisht mund të përdoret termi *epshi* seksual. Lidhur me domethënien e termit *epsh* Eqrem Çabej në studimet etimologjike e ka shpjeguar domethënien e termit *epsh*. Sipas këtij shpjegimi *epshi* është “zjarr i madh i mishit e i gjakut, qejfet e shqisave”. Ky shpjegim i afrohet domethënies së termit *shtytës* i brendshëm, sepse *shtytësi* ka “energji termike” që përçon jo vetëm muskujt e gjakun, por gjithë organizmin. Termi “*qejf* i shqisave” nga këndvështrimi i terminologjisë psikologjike të sotme është i pakapshëm. Për këtë shkak domethënies së termit *shtytës* i brendshëm i përgjigjet pjesërisht termi *epsh*, por, siç u tha, në shqipe ky term përdoret kryesisht për të emërtuar në rend të parë kënaqësitë seksuale; në shqipe nuk do të mund të kuptohej termi *epshi* agresiv, *epshi* vetëmbrojtës, *epshi* destruktiv!.

Pra, termat *pasion*, *instinkt*, *prirje*, *impuls* dhe *dëshirë*, si edhe termi *epsh*, kanë domethënie tjetër dhe nuk mund ta zëvendësojnë domethënien e termit *shtytës* a *shtys* të psikanalizës.

3. *Sasia e energjisë së shtytësve dhe termat e koncepteve themelore të saj*

Për të kuptuar dukuritë e proceset psikike si edhe sjelljet e sistemin e sjelljeve të njeriut nevojitet njohje jo vetëm e *shtytësve* të brendshëm, e afekteve dhe e konflikteve ndërmjet *shtytësve*, por edhe njohje e sasisë së energjisë së *shtytësve* që janë në konflikt. Karakterin e konfliktit e përcakton sasia e energjisë së *shtytësve* që janë në konflikt. Kjo çështje është e lidhur me pikëpamjen ekonomike të Z. Frojdit për zhvillim të personalitetit. Në kuadrin e kësaj pikëpamjeje dallojmë termin e konceptit *shtytës* me sasi të energjisë së saj me të cilën njeriu e pushton objektin, përfytyrimin, idenë, etj. si edhe sasinë e energjisë së *shtytësit* tjetër me të cilën ai i kundërvëhët pushtimit të atij objekti, përfytyrimi e ideje. Lidhur me sasinë e energjisë së *shtysave* dhe me raportin e kësaj energjie në pushtimin ose refuzimin e një objekti, përfytyrimi e ideje rendësi të veçantë për të kuptuar dinamikën dhe zhvillimin e personalitetit kanë termat e këtyre koncepteve:

shtytësi seksual, shtytësi i vdekjes, shtytësit e egos dhe raportet energjetike ndërmjet tyre.

Shtytësi seksual është koncepti dhe termi themelor i psikanalizës së Z. Frojdit, që shfaqet në veprimtarinë e njeriut, është i lindur dhe e karakterizon edhe botën njerëzore. Energjinë e tij, siç pamë, Z. Frojdi e ka emërtuar me termin “libido”. Në shqipe, siç thamë, termi i konceptit shtytës seksual është përkthyer kryesisht me termin “instinkti seksual” ...Meqë në psikanalizë termi “shtytës seksual” ka domethënie të gjerë duhet shtuar se ky shtytës ka katër komponente të integruara: burimin, qëllimin, energjinë, dhe objektin e vet. Për këto komponente njeriu i rritur normal është i vetëdijshëm dhe shi për këtë termi instink seksual është përkthim i papërshtatshëm; shtytësi seksual është ekuivalenti domethënës i shqipes për strukturën biopsikologjike, që e vë në veprim, e drejton dhe e organizon veprimtarinë e individit drejtë partnerit të gjinisë së kundërt.

Termi “shtytësi i vdekjes” është i lindur me fuqi vepruese të kundërt nga ai i shtytësit seksual; këtë fuqi e ka të drejtuar kah shkatërrimi, shkrirja e njësive të gjalla të organizmit dhe kthimi i organizmit në gjendje inorganike. Këtë term Z. Frojdi e ka përdorur në teorinë e dytë të tij duke ia kundërvënë domethënies së termit “eros”, me të cilin Z. Frojdi pas vitit 1925 ka emërtuar të gjithë shtytësit e egos dhe ata të ruajtjes së gjinisë njerëzore. Shtytësi i vdekjes i ka të gjitha komponentet e shtytësit seksual të njeriut dhe manifestohet në sjelljet agresive të shkatërrimit të vetes dhe të mjedisit e përbërësve të tij. Shtytësi i vdekjes në shqipe, siç përmendëm, është përkthyer zakonisht me termin instinkti i vdekjes. Te njeriu fuqia shkatërruese shfaqet në tendencën e keqësimit të proceseve metabolike dhe të asgjësimit të vet këtyre njësive të organizmit; kjo tendencë e organizmit të gjallë të njeriut nuk ka formë stereotipe dhe është e lidhur me përkujdesje të veçantë të njeriut dhe të të afërmeve të tij për pengimin e ngadalsimit të procesit shkatërrues. Madje, përkujdesja e drejtuar kah marrja e masave për pengimin veprues të këtij procesi shkatërrues në kulturë të ndryshme ka trajta të shumëllojshme. Këto trajta nuk lindin, por mësohen. Prandaj, termi *Todestrieb* i gjermanishtes, përkatësisht *death drive* i anglishtes duhet të përkthehet në shqipe me termin shtytës i vdekjes dhe jo prirje, instinkt, pasion i vdekjes.

Shtytësit e egos është termi me të cilin emërtohen të gjitha synimet e egos që i kundërvëhen shtytësit seksual si edhe atij të agresivitetit, përkatësisht të vdekjes. Këto janë synimet dhe afektet e egos së njeriut me energji të drejtuar kah realiteti, vënia nën kontroll të shtytësve që kanë për bazë vetëm parimin e kënaqësisë me çdo kusht, sidmos vënien nën kontroll të shtytësit seksual të drejtuar dhe të përqendruar në pushtimin e objektit seksual të ndaluar. *Shtytësit e egos* në shqipe janë përkthyer me termin joekuivalent “instinktet e unit”.

Literatura e përzgjedhur

- Adler, A.: **Psikologjia individuale në shkollë dhe psikologjia e edukimit**, Tiranë, 2005.
- Caprara, V. G.: **Personality – Determinants, Dynamics and Potentials**, University of Cambridge 2000.
- Çarls, B.: **Themelet e psikanalizës**, Tiranë, 2003.
- Einstein, A. - Freud, S.: *Warum Krieg?*, **Diogenes**, Zürich, 1972.
- Eysenck, H. J.: **Upotreba i zloupotreba psihologije**, Zagreb, 1980.
- Fairbairn, W. R.: **Psihoanalitičke studije ličnosti**, Naprijed, Biblioteka Psiha, Zagreb, 1982.
- Filozofija – Psihologjia – Sociologjia**, Populamaja Enciklopedija, Psihoanaliza, Moskva, 1998.
- Frejzer, G.: **Zlatna grana**, Zagreb, 1967.
- Freud, S.: **Autobiografija**, Zora, Zagreb, 1970
- Freud, S.: **Konsiderata aktuale mbi luftën dhe vdekjen**, Uegen, Tiranë, 2006
- Frojd, Z.: **Shakaja dhe lidhja e saj me të pavetëdijshmen**, Fan Noli, Tiranë 2005.
- Frojd, Z.: **Frika**, Fan Noli, Tiranë, 2003.
- Frojd, Z.: **Përtej parimit të kënaqësisë**, Fan Noli, Tiranë, 2004.
- Frojd, Z.: **Mbi letërsinë dhe artet**, Fan Noli, Tiranë, 2005.
- Frojd, Z.: **Bullit, W.C.: Presidenti Uillson vëllimi 1 e 2**, Fan Noli, Tiranë, 2005.
- Frojd, Z.: **Qëndresa dhe shtypja**, Fan Noli, Tiranë, 1997.
- Frojd, Z.: **Ese mbi psikanalizën**, Fan Noli, Tiranë, 2006.
- Frojd, Z.: **Psikologjia e turmave dhe analiza e unit**, Fan Noli, Tiranë, 1998.
- Frojd, S.: **Kompletan uvod u psihoanalizu**, Nova knjiga, Podgorica, 2006.
- Fromm, E.: **Današnja kriza psihoanalize**, Praxis, Zagreb, 3/ 1967.
- Fromm, E.: **Misioni i Zigmund Frojdit**, Dituria, Tiranë, 2003.
- Fromm, E.: **Arratisje nga liria**, Tiranë, 1998.
- Fromm, E.: **Njeriu për vete - Gjurmim në psikologjinë e etikës**, Phoenix, Tiranë, 2003.
- Fromm, E.: **Kriza psihoanalize**, Naprijed, Zagreb, 1986.
- Fromm, E.: **Nëntë skica psikologjike**, PL, Tiranë, 2005.
- Fromm, E.: **Veličina i granice Frojdove misli**, Naprijed, Zagreb, 1986.
- Fromm, E.: **Shpirti i njeriut**, Fan Noli, Tiranë, 2006.
- Fromm, E.: **Teoria e Frojdit: madhështia dhe kufizimet**, Fan Noli, Tiranë, 2009.
- Gardiner, M.: **Čovjek - vuk i Sigmund Freud**, Naprijed, Biblioteka Psiha, Zagreb, 1981.
- Ismajli, R.: **Shumësia e tekstit**, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Jung, G. C.: **Psikologjia e së pavetëdijes**, Vëllimi 1, Vëllimi 2, Fan Noli, Tiranë.
- Jung, G. K.: **Psikologjia analitike**, Fan Noli, Tiranë, 2006.
- Koliqi, E.: **Tregime**, Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.
- Korač, Ž.: **Frankfurtska škola i psihoanaliza**, - Psihologija -, Beograd, 4/1981.
- Lakan, Ž.: **Çetiri temeljna zakona pojma psihoanalize**, Naprijed, Zagreb, 1986.
- Laplanche, J. P. : **Das Vokabular der Psychoanalyse**, Suhrkamp, Frankfurt am Main, 1972.
- Merxhani, B. : **Një libër mbi psikologji**, Minerva, Tiranë, 1934.
- Nushi, Dr. P.: **Psikanaliza dhe mendimi psikologjik shqiptar**, Libri Shkollor, Prishtinë, 2006.
- Pak, dr. V.: **Trodimenzionalni model ljudskog ponašanja**, Beograd, 2006.
- Pashku, A.: **Oh**, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Pervin, L. A., John, O. P.: **Personality. Theory and research**, New York-Chichester - Brisbane- Toronto- Singapore, 1997.
- Prifti, Dr. Shk. L.: **Psikanaliza sot- psikologjia e thellësive**, Uegen, Tiranë, 2006.
- Raifi, M.: **Fan Noli dhe Migjeni**, Prishtinë, 1974.
- Roudinesco E. et Plon, M.: **Dictionnaire de la Psychoanalyse**, Fayard, Paris, 1997.
- Stevens, A.: **Jung – një hyrje e shkurtër**, botimet ideart, Tiranë, 2007.

Pajazit NUSHI, Kosova Academy of Sciences and Arts, Prishtina

SEMANTICS OF PSYCHOLANALYSIS THEORY AND ADOPTION OF ITS CONCEPTS IN ALBANIAN

Summary

The works of Sigmund Freud – the founder of psychoanalysis – were translated into Albanian at the end of XX and the beginning of XXI century. Almost all his works were translated into Albanian. The translated works have created “The psychoanalysis library”. Translation of these works into Albanian has several characteristics.

The rhythm of translation of these works into Albanian is disproportional with the development of psychoanalytic thought. The origin of psychoanalytic thought among Albanians was related with the development of literature and the sociological and psychoanalytic thoughts among the Albanians of Albania in the third decade of the last century. Later on, this trend was interrupted by the grave consequences of the World War II and the ignoring attitude of the monist system towards psychoanalysis, when ideological and political attitudes in Albanian became an anti-psychoanalytic doctrine, whereas among Albanians the in former Yugoslavia and diaspora it related to their rights to education and cultural development. Re-occurrence of psychoanalysis among Albanians began with the translated works of Sigmund Freud upon the fall of the monist system.

In their efforts to find equivalent terms in Albanian for psychoanalytic notions or concepts, translators made mistakes. There are also wrong translations of fundamental concepts of the psychoanalytic theory in Albanian. Those mistakes were reflected on dark explanations of the content of the psychoanalytic theory. The mistakes were noticed especially in the explanation of the structure and dynamics of various forms of normal and abnormal behaviour of humans.

The translation of the works of Sigmund Freud into Albanian carries an unstable terminology, and non-equivalent terms of psychoanalysis. This kind of translation consisting of inadequate technical terminology, wrong notions or concepts, led to the limited use of these works for professional and scientific needs of psychologists, psychiatrists, sociologists, etc.

Hajrullah KOLIQI, Universiteti i Prishtinës

MENDIMI PEDAGOGJIK I HASAN TAHSINIT

KUD 37:28

929(496.5) Tahsini, Hasan

Në 200-vjetorin e lindjes dhe 130 vjetorin e vdekjes

Abstrakt

Hasan Tahsini, filozof dhe shkencëtar me formim lindor dhe perëndimor, është njëri nga themeluesit dhe vizionarët e arsimit dhe të pedagogjisë së Rilindjes Kombëtare. Ishte altruist dhe humanist, pa paragjykime për popujt dhe religjionet e tjera. Njerëzimin e konsideronte si një familje dhe njerëzit vëllezër. Ishte iluminist i madh, por njëkohësisht edhe luftëtar për dije shkencore, pozitiviste, eksperimentale. Tahsini kishte besim të madh te fuqia e edukatës, ai ishte ithtar i optimizmit pedagogjik. Synonte një shkollë dhe arsim modern, sipas modelit të shkollës dhe arsimit evropian. Kraharsimit shkollor, Tahsini angazhohej edhe për arsimimin gjatë tërë jetës. Ky pedagog me personalitet, i ditur, novator dhe orator elokuent tërë jetën ishte nxënës, studiues dhe mësues. Ishte mësimit i mësimit të tij. Ndikimi pedagogjik i tij ishte i jashtëzakonshëm. Ishte mësues i korifejve të tjerë të Rilindjes Kombëtare.

Fjalët çelësa: Rilindja kombëtare, mendimi pedagogjik, humanizmi, iluminizmi, pozitivizmi, optimizmi pedagogjik, shkolla moderne, arsimimi gjatë gjithë jetës.

Të gjitha për kombin shqiptar, atë turk dhe për njerëzimin, asgjë për veten e tij. Si rrallëkush u identifikua me profesionin fisnik të tij: profesor. Kështu mund të përkufizohet me pak fjalë portreti i filozofit, shkencëtarit, poetit, përkthyesit, profesorit dhe pedagogut të madh të Rilindjes Kombëtare, Hoxhë Hasan Tahsinit. Ai ishte pedagog i pedagogëve të Rilindjes, vepra dhe mendimi i të cilit zënë një vend prijës në historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar. Është nga të parët që solli pedagogjinë dhe psikologjinë “moderne në Stamboll dhe në Perandorinë Osmane”.¹ Pa ndriçimin dhe afirmimin e dimensionit pedagogjik të veprës së Hasan Tahsinit, figura poliedrike e tij nuk do të ishte e plotë.² Fjala është për një personalitet tepër të

¹ N. P. Alpan – N. Kaçi: **Shqiptarët në Perandorinë Osmane**, Albin, Tiranë, 1997, f. 91.

² Përkritazi me veprën dhe mendimin pedagogjik të Hasan Tahsinit kanë shkruar: Osmani, 1983, f. 669-670; Kraja, 1993, f.12-122; Rexhepagiq, 2005, f. 55-80;

veçantë të Çamërisë dhe të mbarë Shqipërisë, i cili nderon dy kombe dhe një Perandori.

Për mendimin pedagogjik të Hasan Tahsinit mësojmë dhe gjykojmë në bazë të veprave të shkruara³, të punës dhe të personalitetit të tij, si dhe në bazë të dëshmive të bashkëkohësve të tij dhe të hulumtimeve të gjertanishme përkitazi me rilindësin tonë të madh.⁴

Që në fillim duhet theksuar se Hasan Tahsini ishte njëri nga *themeluesit dhe vizionarët e arsimit dhe të pedagogjisë së Rilindjes Kombëtare*. Ajo ishte pedagogji e idealit kombëtar, e mendjes (së ndriçuar), e zemrës (së pastër) dhe e dorës (së shkathët), e cila sublimohet natyrshëm në veprën dhe personalitetin e Hasan Tahsinit.

Hasan Tahsini qe “një nga intelektualët e parë, përkrah rilindësve të tjerë shqiptarë të Stambollit, që kuptoi rëndësinë e përhapjes së dritës së diturisë tek masat e gjera të popullit shqiptar, duke e çmuar atë si çështjen më kryesore. Dhe kësaj çështje iu kushtua me aq sa mundi dhe natyrisht aq sa e lejoni rrethanat historike-politike të kohës së Perandorisë Osmane”.⁵ Hasan Tahsini u identifikua me Kombin e tij dhe doli në ballë të interesit kombëtar. Sami Frashëri shkruan: “Dashuria për Atdheun dhe kombësinë është tepër e fortë në shpirtin e tij. Inteligjenca e tij tepër e gjerë dukej sikur do të përfshinte gjithë diturinë, për t’ia kushtuar ekskluzivisht Atdheut, interesin e të cilit e

Koliqi, 2002, f. 240-247, si dhe studiues tjerë.

³ Deri më sot dihet se Hasan Tahsini është autor i 18 vepra të ndryshme, siç janë: *Të fshehtat e ujit dhe të ajrit* (1893), *Psikologjia ose shkenca e psikikës* (1894), *Historia e krijimit të botës* (1894), *Bazat e astronomisë* (1895), *Edukimi i fëmijëve* (bashkë me Mahmud Nedim), disa tabela astronomike etj. Është edhe autor i *Afabetit metodik shqiptar* (Alphabet methodique Albanais), të cilin e botoi në Paris më 1872. Duhet shtuar se “nga burime të ndryshme mësojmë se më 1877 ai ka bërë një abetare shqip, shkarazi përmendet e po bën përpjekje për hartimin e një fjalori dhe gramatike të shqipes, por gjurmë të këtyre nuk i gjejmë dot sot për sot...Ka bërë një divan me vjersha turqisht që i ka mbetur pa botuar. Gjithashtu sot njihen disa strofa të veçanta poezish turqisht, por gjejmë edhe në frëngjisht dhe shqip. Pleqtë çamë i dinin përmendsh poezitë e tij turqisht deri në ditët tona.” Botoi edhe artikuj të ndryshëm në shtypin e kohës. U mor edhe me përkthime. (Bica, vëllimi I, 2009, f. 108.).

⁴ Punë me vlerë shumë të madhe për ndriçimin e veprës dhe të mendimit shkencor të Hasan Tahsinit kanë dhënë sidomos Ibrahim D.Hoxha, dr. Laurant Bica, Nuri Abdiu, Jashar Rexhepagiqi etj.

⁵ Janina, 2009, f. 69).

vinte mbi të gjitha.”⁶ U përpoq t’i shërbente kombit dhe atdheut, në radhë parë, nëpërmjet dijes, arsimit. “Të gjithë njerëzit e qytetëruar (shkruan ai - H.K.) kanë përparuar duke shkruar a lexuar (studime shkencore) në gjuhën e vet, kurse ata njerëz që nuk kanë lexuar dhe shkruar në gjuhën e tyre, kanë mbetur injorantë dhe barbarë. Shqiptarët, ndërkaq, (vazhdoi ai - H.K.) i kaluan, deri më tani, më se 3000 vjet që nuk janë duke e përdorur shkrim-leximin në gjuhën e vet amtare. Përkundrazi, duke u qytetëruar (mësuar dhe shkruar) në gjuhët e huaja, studimet e shqiptarëve shkuan huq (kot) dhe kurrfarë dobie shqiptarët nuk patën prej tyre”.⁷

Për rilindjen dhe zhvillimin kulturor të kombit të tij, për të arritur kombet e tjerë të qytetëruarë, Hasan Tahsini theksoi me forcë “domosdoshmërinë e zhvillimit pedagogjik e gjithshkencor të gjuhës sonë shqipe”.⁸ Punoi shumë për t’i ofruar kombit shqiptar “veglat” e gjuhës amtare (siç kishte për të thënë Veqilharxhi), të cilën e dëshoi aq shumë dhe e vlerësoi si gjuhën më të përsosur “nga gjuhët tjera të Europës.”⁹ Vështirë ishte asokohe¹⁰ të gjendej një klerik tjetër mysliman, siç ishte Hasan Tahsini, që të argumentonte (duke u mbështetur në natyrën e gjuhës, në shkencë dhe në doktrinën islame) se gjuha shqipe nuk mund të shkruhet me “jazinë e Allahut”,¹¹ por me një alfabet “me shkronja të reja”, origjinal, unikal, ashtu siç janë edhe gjuha shqipe,

⁶ Cituar pas N. Çabej: **Zhvillimi i shkencës në Shqipëri** (Bica, 2009 vëllimi 3, f. 426).

⁷ Cituar sipas Skënder Rizaj, 2009 (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 213-214).

⁸ Kondi, 1998, f. 7.

⁹ Lito, 2009 (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 336).

¹⁰ Këto pikëpamje të Hasan Tahsinit për alfabetin origjinal të gjuhës shqipe marrin peshë edhe më të madhe, kur dihet se vetë sulltan Abdyl Hamiti II (1876-1909), prej se mori pushtetin në duart e tij, konsideronte se përdorimi i gjuhës osmane si gjuhë zyrtare në Perandorinë Turke është e domosdoshme. Lidhur me këtë ai shprehet: “Gjuha arabe është një gjuhë e bukur. Ah, sikur ta kishim përdorur atë si gjuhë zyrtare më parë!” (Salabi, 2009, f. 457).

¹¹ Jani Vreto konfirmon se Hasan Tahsini, ndër të tjera, thoshte: “Nuk duhet të preferojmë alfabetin arab ngase ne muslimanët nderojmë biblën e fesë sonë, Kuranin, që është shkruar në gjuhën arabe. Le të mendojmë: Profeti ynë, Muhameti, ishte arab, fliste arabisht dhe Kurani u shkruajt në gjuhën arabe. Unë e kam mësuar gjuhën arabe, Kuranin e kam lexuar shumë here dhe e kam me vete. Në të thuhet se Perëndia nuk dërgoi asnjë misionar që të mos dinte gjuhën e popullit të cilit i predikoi; se në çdo komb dërgoi misionarë të ndryshëm. Në Kuran thuhet se vepër e mrekullueshme e Perëndisë është krijimi i qiejve dhe i tokës si dhe i gjuhëve të shumta e të ndryshme (ashtu si edhe ngjyrat) që të mund të mësojnë të gjithë.” (Hoxha, 1998, f. 75).

kultura dhe kombi shqiptar. Po për këtë qëllim, ai hartoi alfabetin fonetik të shqipes, një abetare dhe një gramatikë të kësaj gjuhe, mori pjesë edhe në shumë takime për alfabetin e përbashkët kombëtar dhe punoi për përhapjen e tij, ishte njëri nga themeluesit dhe kryetar i Akademisë së Shkencëtarëve Shqiptarë, ishte anëtar i Shoqërisë të Shtypurit Shkronja Shqip, mësues i rilindësve të tjerë etj. Ideali i Hasan Tahsinit ishte i qartë: “Në doni të bëhemi komb i qytetëruar; ashtu si kombet e Europës, duhet të shkruajmë gjuhën, të krijojmë letërsinë tonë kombëtare.”¹² Gjuhët më të pasura janë “ato që i ndihmojnë më shumë përparimit material dhe moral të njeriut. Të mirat që sjell gjuha, mund të gëzohen nga të gjithë, kur gjuha është e kuptueshme nga të gjithë.”¹³ Realisht, Hasan Tahsini ishte prekursori dhe mësuesi i mirëfilltë i mirëkuptimit dhe i integritetit ndërfetar dhe ndërkrahinor të shqiptarëve në të mirë të idealit kombëtar – shqiptarizëm.

Emri i Hasan Tahsinit ishte Njeri, mbiemri - Shqiptar. Ai ishte altruist dhe humanist i madh, pa asnjë paragjykim për popujt apo religjionet tjera. Njeriun “e koncepton si një qenie shoqërore...”¹⁴, ndërsa “njerëzinë e konsideronte si një familje, gjithë njerëzit si vëllezër”.¹⁵ Kjo të kujton Pestalocin e madh, sipas të cilit njeriu është bir i familjes së madhe njerëzore, vëlla i njerëzve të tjerë, por edhe Sami Frashërin, i cili, ndonëse shtetet fqinje përpiqeshin ta zhbënin popullin shqiptar, ai projektonte arsimim përkatës kombëtar edhe për popujt pakicë në Shqipërinë e katër vilajeteve shqiptare. “Tahsini bashkon racat dhe popujt duke treguar kulturën e njerëzimit si një të tërë...”¹⁶ I pëlqente shumë thënia e Viktor Hygosë: “Laicizmi është të respektosh gjithë religjionet e botës.”¹⁷ Veç të tjerave, në seminarin që ai hapi në medresenë e tij në Stamboll (1869-1872) merrnin pjesë jo vetëm rilindësit shqiptarë, por edhe të tjerë, “si armenë, arabë e ndonjë rilindës turk, si Abdylhak Hamiti. Aty ai jepte mësim shkence dhe patriotizmi, i ushqente me idetë e lirisë, demokracisë, përparimit.”¹⁸ “Iniciativë fisnike” e cilëson idenë e Lajbnicit dhe të tjerëve “që të krijonin një gjuhë universale”, e cila “do t’i afronte njerëzit njëri me tjetrin dhe që të

¹² Cituar pas A. Neqallari: *Alfabeti i Hasan Tahsinit* (Bica 2009, v., f.466-467).

¹³ Tahsinl, 1894, f. 25 (Abdiu, 2007, f. 227).

¹⁴ Abdiu, 2007, f. 96.

¹⁵ Dilo 2009, në Bica 2009., vëllimi 3, f. 508.

¹⁶ Moikom Zeqo: *Kryemjeshtri intelektual Hoxhë Hasan Tahsini* (Hoxha, 1998, f. 8.

¹⁷ Cituar sipas Allpan, te Hoxha, 1998, f. 31.

¹⁸ Bica, 2009, f. 85.

forconte lidhjet midis syresh”.¹⁹ Ai ishte njëri nga ata që i shërbeu tërë njerëzimit²⁰, thotë Dervish Hima.

Mendimi pedagogjik i Hasan Tahsinit është *thellësisht iluminist*. Ky njohës i thellë i mësimave kuranore dhe profetike për diturinë dhe studiues i “shkencave të reja” në qendrën e iluminizmit evropian (Paris) e vlerësoi lart rëndësinë universale të diturisë për njeriun, kombin dhe njerëzimin. Diturinë e çmoi më shumë se arin.²¹ Paditurinë e cilësoi si mëkatin më të rëndë të njeriut, ndërsa nga ky mëkat, njeriu, sipas tij, mund të shpëtojë, duke u shkolluar, arsimuar.²² Hasan Tahsini vlerëson se dekadencia e popujve myslimanë “rrjedh nga mungesa e kulturës moderne”.²³ Ai jo vetëm dëshiron dhe punon që “drita” të lindë nga perëndon, siç vjershëronte Naimi, por vetë ai ishte produkt i kësaj drite iluministe, simbol dhe predikues i saj në Stamboll, Shqipëri e gjetkë. Profeti Muhamed mësonte: “Diturinë kërkoje qoftë edhe në Kinë”, Hasan Tahsini udhëzonte: “Nëse do të mësohesh vrapo në Paris.”

Pedagogjia e Hasan Tahsinit i kaloi caqet e një pedagogjie thjesht iluministe. Në plan të parë nxori të vëtetën shkencore, shkencat e natyrës, dituritë “pozitive”, hulumtimin e tyre me metoda më bashkëkohore empirike (vrojtimi dhe eksperimenti). Ishte kundër spekulimeve idealiste dhe metafizike edhe në fushën e shkencave natyrore, të psikologjisë, të historisë²⁴ etj., ashtu si pozitivistët e tjerë evropian: O. Konti, Xh. Milli, H. Spenseri etj. Hasan Tahsini është pedagog pozitivist, sipas të cilit “pjesa më e mirë e arsimit”²⁵ janë shkencat e natyrës. Ky luftëtar i madh kundër fanatizmit fetar, në mënyrë pozitiviste e zgjidhi edhe raportin midis fesë dhe shkencës, duke afirmuar vlerat e mirëfillta të tyre. Ai u akuzua si i “pafë”, sepse u shkëput nga skolastika mesjetare dhe doktrinën e fesë islame e interpretoi sipas filozofisë pozitiviste të kohës, në të mirë të hapjes së rrugës së përparimit të kombit të tij dhe më gjerë. Sami Frashëri kon-

¹⁹ Tahsin, 1894, f. 28 (Abdiu, 2007, f. 233).

²⁰ Ali Vishko: *Disa të dhëna mbi veprimtarinë e Hoxha Hasan Tahsinit*, në: Bica, 2009, f. 232.

²¹ Hoxha, 2009 (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 101.

²² Po aty, f. 85.

²³ Haki Sharofi: *Veteranët e klerit musliman* (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 62).

²⁴ “Ishte kundër trajtimit tradicional të histories. Në këtë lëndë, sipas tij, jepeshin të dhëna vetëm për dinastitë, në vend që të mësohej historia e njerëzimit”. (Osmani, 1983, f. 670).

²⁵ Hoxha, 2009 (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 91.

firmen se ai “në kuvendimet dhe në fjalimet e tij” theksonte se feja islame e mirëfilltë nuk e pengon përparimin dhe qytetërimin, por përkundrazi iu ndihmon atyre. Këtë e bënte “duke u mbështetur në ajetet, hadiset dhe në normat e sheriatit.”²⁶

Me iluminizmin dhe pozitivizmin pedagogjik të Hasan Tahsinit lidhet edhe *optimizmi pedagogjik* i tij. Sipas tij, qytetërimi është ai i cili bëri që njeriu të “qëndrojë më lartë se kafshët.”²⁷ Çmoi faktorin e trashëgimit, por edhe rolin dhe rëndësinë e faktorëve të jashtëm dhe të aktivitetit të njeriut në formimin e personalitetit të tij. Ai shkruan: “Jeta e brendshme është si edukatori në familje, kurse ajo e jashtëmja është plotësuesja e saj”²⁸, për të shtuar se “Mendja vijimisht kërkon të zbulojë të vërtetën”.²⁹ Edhe në veprën pedagogjike *Edukimi i fëmijëve* paraqiten ide “për rolin dhe rëndësinë e edukatës, për përsosjen e arsyes njerëzore, rreth ndikimit të prindërve dhe edukatorëve të tjerë në edukimin e fëmijës, mbi shkollën si institucion arsimor e edukativ etj.”³⁰ Theksonte, gjithashtu, rëndësinë edukative të shembullit pozitiv. Vetë Hasan Tahsini ishte mësim i mësimi të tij. “Në vend të shumë e shumë xhamive ai ishte i mendimit të ngriheshin shumë e shumë shkolla dhe gjithmonë ishte mbrojtësi i dobisë së tyre.”³¹ Shkollën shqipe e konsideronte “si një armë të fuqishme në shërbim të luftës për çlirim (dhe përparim - H.K.) kombëtar.”³²

Model të shkollës kombëtare Hasan Tahsini kishte *shkollën evropiane, me përmbajtje dhe metodologji mësimore moderne*. Procesin e edukimit e mbështet në njohjen dhe respektimin e aftësive natyrore dhe të prirjeve të individit³³. *Alfabetin metodik të shqipes*, hartuar sipas parimit fonetik, përpiqet t’ua përshtatë aftësive kuptimore të fëmijëve, në mënyrë që atë ta përvetësojnë më lehtë e më mirë. Edhe fuqia e trurit (intelektuale) “formohet dhe zhvillohet ca nga ca”,³⁴ shkruan ai. Metodologjinë moderne të mësimi të lidhi ngusht me konkretizimin e tij, për të cilën gjë dëshmojnë

²⁶ Shemseddin-Sami Frashëri: *Hoxhë Tahsini* (Hoxha, 1998, f. 70).

²⁷ Tahsin, 1894, f. 12 (Abdiu, 2007, f. 201).

²⁸ Tahsin, 1894, f. 16 (Abdiu, 2007, f. 209).

²⁹ Tahsin, 1894, f.7 (Abdiu, 2007. f. 191).

³⁰ Më gjerësisht, shih Rexhepagiq, 2005, f. 55-80.

³¹ Sadi Borak: *Hoxhë Tahsini* (Hoxha, 1998, f.87).

³² Lito 2009 (Bica, 2009, vëllimi 3, f. 336).

³³ Përkitazi me psikologjinë e H. Tahsinit shih Abdiu, 2007.

³⁴ Tahsin, 1894, f. 5 (Abdiu, 2007, f. 187).

edhe mjetet dhe pajisjet e ndryshme shkencore-mësimore të sjellura ose të krijuara dhe të përdorura prej tij. Duke iu referuar tabelës astronomike *Pasqyra e rruzullimit*, ai thotë se: “pamja e kësaj figure është më e dobishme nga këndimi i njëmijë librave.”³⁵ Parim tjetër i punës mësimore të Hasan Tahsinit ishte edhe ndërlidhja e teorisë me praktikën. Shprehimisht thuhet: “Çdo gjë që fliste, gjithmonë e lidhte me praktikën”.³⁶ U shqua, gjithashtu, për “metoda aktive pedagogjike”. Ai “përpara popullit e studentëve”³⁷ përdori edhe metodën e bashkëbisedimit, të demonstrimit, të eksperimentit, të cilat për kohën dhe mjedisin shoqëror-arsimor obskurantist hamidian ishin vërtetë metoda revolucionare të mësimt.

Krahas zhvillimit intelektual, formimit kombëtar e fetar, Hasan Tahsini shquhej edhe për virtyte të larta morale, për punë me përkushtim dhe të frutshme, për paraqitje dhe rregullim estetik të mjedisit të punës dhe të jetës së tij.

“Mësuesi dhe nxënësi janë partnerë në mirësi”, është një thënie profetike. I tillë ishte raporti midis profesorit Tahsin dhe nxënësve të tij. Ndërsa me bashkëbiseduesit injorantë dhe fanatikë shpesh përdorte edhe metodën sokratike (ironinë dhe majeutikën). Turku Ismail Habib vlerëson: “Zotësia e tij (Tahsinit - H.K.) si profesor dhe arsimtar ishte më e fortë se sa penda.”³⁸

Hasan Tahsini e ndjente si detyrim dhe nevojë për *t'u arsmuar (mësuar) gjatë tërë jetës*. Për atë nuk vlente filozofia tradicionale: “të mësosh vonë është vonë”, por vlente hadithi profetik “Kërkoje diturinë prej djepi deri në varr” (Utlubul ‘ilme minel mehdi ilel lahdi). Kuptimplotë është dëshmia e Sami Frashërit, kur thotë se Hasan Tahsini “mësimin e filluar që në shkollën foshnjore (fillore - H.K.) me shqiptimin e a-së dhe të vazhduar në bankat e të atit të tij, në medresenë stambollite dhe universitetin parisian, e la vetëm atëherë kur dha shpirt.”³⁹ Ky pedagog me personalitet, i ditur, novator dhe orator elokuent, tërë jetën ishte nxënës, studiues dhe mësues. Libri ishte pjesë e jetës dhe simbol i qenies së tij.

Ndikimi (pedagogjik) i Hasan Tahsinit. Ndikimi i tij ishte i

³⁵ Hoxha, 1998, f. 121.

³⁶ Hoxha, 1998, vëllimi. 3, f. 92).

³⁷ Alpan: *Hoxhë Hasan Tahsini mësues i shquar shqiptar* (Bica 2009, vëll. 3, f. 38.

³⁸ Ismail Habib: *Hoxha Tahsini* (Hoxha, 1998, f. 91).

³⁹ Shemseddin Sami Frashëri: *Hoxhë Tahsini* (Hoxha, 1998, f. 73).

jashtëzakonshëm dhe shumëplanësh. Jeta e tij “nuk ishte gjë tjetër, veçse një mësim që vazhdoi gjatë pesëdhjetë vjetëve; të gjithë ato vite i kaloi duke u vetëmësuar dhe duke mësuar të tjerët.”⁴⁰ Thuhet se me mijëra nxënës, studentë dhe pasues të tij, shqiptarë, turq dhe të tjerë përfituan nga vizioni dhe mësimet e tij.

Ishte bashkëpunëtor dhe mësues i veprimtarëve të tjerë të arsimit shqip dhe të mendimit pedagogjik shqiptar. Ai ndezi dritat dhe zemrat e korifejve të tjerë të Rilindjes, siç ishin: Pashko Vasa, Ismail Qemali, Konstandin Kristoforidhi, Jani Vreto, Sami, Abdyl e Naim Frashëri, Dhanil Adam Oparakut (shok i Naimit), Mehmet Ali Vrioni, Ibrahim Vreto (Bërzeshita), Babë Dudë Karbunara dhe shqiptarë të tjerë. Pra, “gatuesi i tërë atij brezi atdhetarësh të zjarrtë dhe dijetarësh të shquar ka qenë pikërisht Hoxhë Hasan – Tahsin Efendiu. Kjo ka qenë edhe arsyeja që të gjithë ata e në mënyrë të veçantë Shemseddin-Sami Frashëri, nxënësi më i zoti i tij – nuk e ka hequr kurrë nga goja, po e kanë çmuar dhe nderuar si askënd tjetër.”⁴¹

Ky mësues i madh, ashtu si sofistët e lashtë, gjatë udhëtimeve e shtegtimeve të tij, pa pyetur për sakrifica e vështirësi, la gjurmë iluministe e atdhetare jo vetëm në Stamboll dhe në Paris, por edhe në treva të ndryshme të Shqipërisë (Toskërisë dhe gegërisë), si në: Shkodër, Tiranë, Ninat, Delvinë, Filat, Sarandë, Ulqin, Prizren (1879) e gjetkë.

Hasan Tahsini, ky filozof dhe shkencëtar me formim lindor dhe perëndimor, ky mësues, profesor dhe rektor universiteti, autor veprash psikologjike-pedagogjike, mësim i mësimi të tij, ishte njëri nga projektuesit dhe bartësit e pedagogjisë së Rilindjes sonë Kombëtare dhe asaj turke. Pedagogjia e tij për shumëçka, është aktuale edhe sot. Ajo është pasuri kombëtare, e cila rron dhe frymëzon.

⁴⁰ Shemseddin-Sami Frashëri: *Hasan Tahsini* (Hoxha, 1998, f. 72).

⁴¹ Hoxha, 2998, f. 20.

Bibliografia

- ABDIU, prof. dr. Nuri (2007): **“Psikologjia” e Hasan Tahsinit**, UFO University Press, Tiranë.
- BICA, Laurant (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëll. 1, vëll.3, West Print, Tiranë.
- DILLO, Lefter: *Veprimtaria didaktike e mësimore e Hasan Tahsinit në Universitetin e Stambollit*, në Laurant Bica (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëllimi 3, West Press, Tiranë.
- HOXHA, Ibrahim D. (1998): **Hoxhë Hasan Tahsin – Efendiu – Të tjerët për të**, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islamik, Tiranë.
- JANINA, Mykerem: *Hoxhë Hasan Tahsini patriot dhe shkencëtar i shqua*, në: Laurant Bica (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëll. 3, West Print, Tiranë
- KOLIQI, Hajrullah (2002): **Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar**, Universiteti i Prishtinës & Libri Shkollor, Prishtinë.
- KONDI, Sejdi (1998): **Ylli i Çamërisë Hasan Tahsini**, Tiranë.
- KRAJA, Musa (1993): **Mësuesit për kombin shqiptar**, Tiranë.
- LITO, prof. dr. Zana: *Shoqëria e Stambollit dhe Hasan Tahsini*, në: Laurant Bica (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëllimi 3, West Print, Tiranë.
- NEQALLARI, Androkli: *Alfabeti i Hasan Tahsinit*, në: Laurant Bica (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëllimi III, West Press, Tiranë.
- OSMANI, Shefik (1983): **Fjalor i pedagogjisë**, 8 Nëntori, Tiranë.
- TAHSIN, Hoxha (1894): *Psikologji ose “Ilmi ruh”- “Dituri mbi shpirtin”*, në Abdiu, prof. dr. Nuri (2007): **Psikologjia e Hasan Tahsinit**, UFO University Press, Tiranë.
- REXHEPAGIQ, Jashar (1995): **Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare**, ASHAK, Prishtinë.
- RIZAJ, prof. dr. Skender: *Çfarë ishte “Akademia” e Shqiptarëve e Stambollit?*, në: Laurant Bica (2009): **Profesor Hasan Tahsini**, vëllimi 3, West Print, Tiranë.
- SALABI, dr. Ali Muhamed (2009): **Perandoria Osmane**, Fjala e Bukur, Prishtinë.

Hajrullah KOLIQI, University of Prishtina

PEDAGOGICAL THOUGHT OF HASAN TAHSINI

Summary

Hasan Tahsini was one of the greatest personalities of the Albanian National Renaissance. Having completed his education in Istanbul and Paris, he was one of the greatest scholars, and one of the most educated teachers of the Ottoman Empire of the nineteenth century. He was a scientist, philosopher, psychologist, pedagogue, author of several works and a man of action.

Among other things, Tahsini conceived a very important and advanced system of pedagogical ideas.

As a great humanist, he emphasized human being, his reason, values, welfare, dignity and the human fulfillment. Tahsini was a scholar of great knowledge and an extraordinary supporter of education. He insisted on seeking the truth and discovering knowledge by searching. Tahsini esteemed the importance of the positive facts and phenomena, experiment and experimental knowledge, especially in the physical sciences.

Tahsini was a representative of pedagogical optimism. In his opinion, education was a very important factor for human development and his capacities. In this context, Tahsini admired the European school-work. He wanted to modernize Ottoman and Albanian education by adopting contemporary methodologies and programs of European school. Tahsini advised: "If you want to acquire knowledge, go to Paris."

Lifelong learning was another pedagogical idea of Hasan Tahsini. In his opinion, there was no end of learning. Personally, he was a model student, a model of lifelong learner.

As a general conclusion, Hasan Tahsini was a progressive pedagogue. He was a leader attempting to improve teaching quality and efficiency in education in the Ottoman Empire. His professional career was dedicated to fulfill the needs of pupils and to the advancement of teaching methodology.

Tahsini had a great pedagogical influence on all Albanian patriotic leaders and teachers of the Albanian National Renaissance in the nineteenth century. During the later half of the nineteenth century, the first Albanian - national schools were established

Gjergj SINANI, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

DASEIN DHE QENIA - E VËRTETË SIPAS ARISTOTELIT

KUD 14

Abstrakt

Kumtesa që po paraqes bazohet në një leksion të Haidegerit të mbajtur në dhjetor të vitit 1924, i cili u gjet nga Thomas Shehan në fletët e një studenti të ri të Haidegerit, Franz Josef Brecht. Në 2007 ky tekst u përkthye në anglisht dhe në 2008 edhe në frëngjisht. Ky leksion bën pjesë në një seri leksionesh që Haidegeri mbajti, nga fundi i vitit 1924 para shoqatave kantiane në gjashtë qytete gjermane në rajonin e Rurit. Në të njëjtën kohë, ky leksion flet edhe për interesin e Haidegerit për filozofinë e Aristotelit.

Por, ky leksion ka rëndësi për të kuptuar gjenezën e mendimit haidegerian, sepse këtu shikojmë qartazi, për herë të parë në publik, një analizë filozofike ndërmjet dy tipeve të konceptimit të të vërtetës, e vërteta si nxjerrje në dritë, dhe e vërteta si prani, moment përcaktues i përvetësimit haidegerian të filozofisë greke dhe të kuptimit të rrugës së tij të mendimit.

Në përputhje me tezat që Haidegeri përpiquej të përpunonte, ai tregon se e vërteta ka qenë errësuar nga tradita, dhe në mënyrë të veçantë nga tradita skolastike, që e kishte kufizuar të vërtetën në pohimet apofantike (term i përdorur nga Aristoteli për të karakterizuar, midis pohimeve verbale që kanë një kuptim ato që mund të quhen të vërteta ose të rreme, në dallim nga një dëshirë, një lutje, një denominim. Ky term ngandonjëherë përdoret si substantiv, në kuptimin e teorisë logjike të propozicioneve), dhe në qëndrime propozicionale të tilla si, gjykimi, besimi ose shfaqja. Në dallim nga kjo doktrinë tradicionale, Haideggeri do të tregojë se, fillimisht e vërteta nuk është një mundësi e *logos-it*, por një mënyrë e të qenit i mundshëm i *Dasein-it* njerëzor. Problemi i të vërtetës nuk del vetëm e vetëm nga fusha e logjikës, por më shumë nga ajo e një analize ekzistenciale që shtron pyetjet; si “rënjësohet” e vërteta te *Dasein*? Ose, çfarë do të thotë, për *Dasein*, të jetosh sipas të vërtetës? Këtyre pyetjeve mund t’u jepet përgjigje në qoftë se *Dasein* kuptohet në “situatën” e vet thelbësore, si qenie-në-botë, në mënyrë të tillë që qenia-e vërtetë të mund

të tregojë mënyrën e të qenit, sipas së cilës *Dasein* zbulon botën. Prej këtej dalin dy përfundime të rëndësishme; së pari, është bota në tërësinë e saj, dhe jo të qenit aty, që mund të çlirohet prej errësimit të saj, nga ana tjetër, në mënyrë thelbësore, e vërteta është një karakteristikë e realitetit – të të qenëve, të qenies dhe të botës – dhe jo mendime dhe pohime propozicionale.

Një aspekt tjetër për të kuptuar gjenezën e mendimit hajdegerian ka të bëjë me mënyrat e errësimit të qenies, e cila ka tre tipe shkaqesh, nga opinionet ku lëviz jeta e përditshme, nga injoranca dhe kur një gjë ka qenë zbuluar më parë, por errësohet rishtazi dhe njerëzit e thonë dhe ua përsërisin edhe të tjetërve derisa ajo të bëhet e “vlefshme”. Në tërë veprën e Haidegerit e shikojmë këtë shqetësim për studimin e mënyrave të ndryshme të fshehjes së të vërtetës.

Le të ndalemi më konkretisht në leksionin në fjalë. Që në fillim ai e bën të qartë synimin e vet. Ai do të sjellë disa qartësime mbi konceptin e të vërtetës ashtu siç gjendet në filozofinë greke, ose siç shfaqet “në ndërgjegjen e jetës së natyrshme të përditshme të grekëve”⁴². Ky qartësim i kuptimit të së vërtetës (ose qenies-i vërtetë) nuk bëhet thjesht për kuriozitet për antikitetin, por ai na fton për një meditim thelbësor dhe radikal në kuadrin e një pyetjeje thelbësore që ka të bëjë me shkencën dhe, në mënyrë më të përgjithshme dhe themelore, me ekzistencën njerëzore. Sipas tij, veprat e filozofëve grekë jo vetëm që kanë hedhur bazat e filozofisë bashkëkohore, por edhe ato të shkencave, ku veprat e Aristotelit kanë një vend të veçantë. Por ne, na thotë Haideggeri, shpesh nuk e kemi ndërgjegjen e këtyre origjinave dhe vazhdojmë rrugën tonë midis “banalitetëve, konceptëve boshe nga çdo kuptim ose fjalë që janë shkëputur nga rrënjët e tyre”. Prandaj na takon ne që t’i bëjmë transparente këto themele historike që ne të mos e trajtojmë historinë si një koleksion të thjeshtë antikitetesh. “Para së gjithash na duhet të kuptojmë se historia nuk qëndron pas nesh si një objekt, por më shumë në kuptimin se jemi ne vetë historia dhe se, për pasojë, jemi ne përgjegjës për mënyrën se si e trajtojmë atë – dhe vetëm atëherë debati ynë me të kaluarën historike, domethënë me vetë neve, mund të bëhet me të vërtetë një çështje djegëse”.⁴³ Përfundim

⁴² Martin Heidegger, *Dasein et être-vrai selon Aristote*, **Philosophie**, 97, 2008, f. 7.

⁴³ Po aty, f. 7-8.

mjaft i vërtetë dhe aktual edhe për kohën tonë ku, në qoftë se do të përdorim gjuhën e Haideggerit, banalitetet na e kanë fshehur zbulimin e qenies së të qenit tonë.

Objektivi i Haideggerit në këtë leksion është që t'i japë Aristotelit mënyrat për të folur rishtazi në lidhje me mënyrën se si t'i shikojmë gjërat dhe për mënyrën se si t'i shtrojmë pyetjet për subjektin përkatës.

Para së gjithsh ne e shikojmë të vërtetën si veti të ndërgjegjes. Megjithatë ne shtrojmë pyetjet: çfarë nënkupton fjala “e vërtetë”? Me çfarë gjendje fakti mund t'i atribuojmë predikativit “me qenë-i vërtetë” një sens fillestar? Ose e thënë ndryshe, ku është e vërteta? Ku gjendet pikërisht trualli i saj? Në përputhje me këto pyetje, Haideggeri e strukturon leksionin në çështjet e mëposhtme:

I. E vërteta si karakteristikë themelore e gjykimit sipas traditës.

II. E vërteta dhe *Dasein*.

III. Mundësitë dhe format e ndryshme të predikativit “me qenë i vërtetë” sipas mënyrës së Aristotelit.

I. Gjykimi – Fjala - *Logos*

Kur flet për traditën, Haideggeri ka parasysh idenë se është gjykimi që mund të quhet i vërtetë, në masën që të njohësh do të thotë të gjykos. Aristoteli ishte i pari që e mendoj të vërtetën si përcaktim të gjykimit. Ishte po ai që e përcaktoi të vërtetën si korespondencë të mendimit me një objekt të realitetit. Ky përcaktim për të vërtetën është një interpretim i të vërtetës që përshtatet më mirë me mendimin e zakonshëm.

Këtu Haideggeri thekson disa vështirësi që janë shfaqur gjatë historisë së filozofisë. Si mund të vendoset një korespondencë e mendimit me realitetin, në qoftë se mendimi është një ngjarje që prodhohet te subjekti, në ndërgjegje ose në shpirt? Si mund ta mas atë që del nga psikika ose ndërgjegjja, duke e rregulluar veten në botën e jashtme, në qoftë se unë nuk e kam pranuar botën e jashtme si shkallë matëse? Por, në qoftë se e pranoj botën e jashtme si shkallë matëse, atëherë pse duhet të pyes ende për një korespondencë? Ishin këto vërejtje, na thotë Haideggeri, që e shtynë Kantin të thoshte se koncepti për të vërtetën, i përcaktuar kështu, nuk shpjegon asgjë, por presupozon se duhet kërkuar të shpjegohet. Pra, duhet gjetur një rrugëdalje.

Për të dalë nga këto vështirësi, Haidegeri na thotë se duhet të distancohemi nga besimet e mëposhtme: (a) besimin, sipas të cilit njohja, në përgjithësi, është në gjendje që të dalë [nga koka] e subjektit ku ajo, në një farë mënyrë, ndodhet si në një kapsollë; (b) besimi, sipas të cilit njohja është e vërtetë vetëm në masën që ajo është në përputhje me ligjet e mendimit si të tilla. Këto dy konceptione kanë marrë emrin e realizmit dhe idealizmit dhe, sipas tij, kanë të njëjtat presupozime: “domethënë, nga njëra anë, atë të një subjekti që do të shoqërohej nga këto të jetuar të ndër-gjegjes dhe, nga ana tjetër, atë të një objekti, në drejtim të të cilit do të na takonte, në një farë mënyrë, që të kërcenim”.⁴⁴ Sipas Haideggerit, i vetmi dallim ndërmjet këtyre dy konceptioneve qëndron në atë se idealizmi e mohon se mund të kërcëhet përtej murit të ndër-gjegjes, ndërsa realizmi beson se një gjë e tillë është e mundshme. Ky presupozim është në zemër edhe të realizmit kritik.

Haidegrin e intereson mendimi i Aristotelit dhe sidomos pohimi i tij se e vërteta “nuk është aspak çështje “gjykimi””. Bëhet fjalë për “logosin” dhe “logosi” nuk nënkupton aspak “gjykim”, as “arsye” ose “koncept”, por “fjalë”. Sipas Aristotelit, çdo fjalë ka si karakteristikë që të jetë e kapshme nga arsyeja, por kjo nuk do të thotë se çdo fjalë komunikon një njohje si të tillë, por më shumë se ajo është e pajisur me një kuptueshmëri specifike. Për ta ilustruar, Haidegeri merr fjalën greke që tregon “kërkesë” apo “dëshirë”. Kur unë shpreh një dëshirë kjo si e tillë nuk është as e vërtetë as e rreme. Prej kësaj del se, ekzistojnë fjalë që më së pari nuk përmbajnë aspak tipare të asaj që është e vërtetë ose e gabuar. Kështu, na thotë Aristoteli jo çdo fjalë është mendim. E thënë ndryshe, çdo fjalë nuk është e tillë që ajo jepet për tu parë. Ky është kuptimi i termit grek. Ky term i përket vetë të qenurit, “është të bërit-të dukshëm te vetë këtij të qenuri. Çdo fjalë nuk është një të bërë-të dukshëm, një të treguar; mënyra jonë e përditshme dhe natyrore e të folurit [përgjithësisht] jep një qëllim shumë të ndryshëm nga ai i të treguarit të kulluar të vetë gjërave”⁴⁵. Prej kësaj del, sipas Haideggerit, se këtu nuk janë gjykimet në lojë, por më shumë fjala dhe se qenia-e vërtetë nuk e ka trullin te vetë fjala si e tillë, pasi duket se vetëm një nga mënyrat e fjalës përmban mundësinë e të qenurit e vërtetë.

Megjithatë, thotë Haidegeri, na duhet të pyesim se me çfarë ngjan

⁴⁴ Po aty, f. 8.

⁴⁵ Po aty, f. 10.

kjo fjalë që nuk konsiston në vetvete në një të treguar, fjalë që është e ekzistencës së përditshme, “të qenies-një-me-tjetrin të njerëzve”. Por ky problem nuk shtrihet te grekët. Megjithatë, këto fenomene janë trajtuar nga Aristoteli te *Retorika*, ku na jep interpretimin e fenomenit themelor të folurit-të njerit-me-tjetrin. Nga kjo analizë Haidegeri thekson tre mënyra themelore të lidhjes së fjalëve me rrethanat të jashtzakonshme: “marrja e fjalës politike, marrja e fjalës në kuadrin e një gjyqi dhe marrja e fjalës me rastin e festave. Të gjitha këto na lidhin me forma të ndryshme të jetës, siç i gjejmë në jetën e përditshme; [sistemi i të cilave] përbën mënyrën themelore të qenies tonë-një-me-tjetrin. Duke marrë si udhërrëfyes Aristotelin dhe duke e ngushtuar shqyrtimin rreth këtyre tre mënyrave të marrjes së fjalës, ne do të dëshironim të qrtësonim atë se *të flasësh do të thotë atje ku fjala është gjithmonë fjala e dikujt që flet në drejtim të tjetrit që i flet*”⁴⁶.

Termi qëllim tregon tjetrin që dëgjon. Sfida është që ta drejtosh tjetrin që dëgjon që të provojë një tonalitet të caktuar afektiv, i cili favorizon zhvillimin e një tipi të caktuar bindjeje. Pra, kuptimi i tyre është që të “bindë”. Kështu, marrja e fjalës politike synon, më së pari, që të bindë auditorin për të marrë një vendim në lidhje me luftën ose paqen. “Oratori që shprehet në sheshin publik nuk synon [vetëm e vetëm] t’i mësojë auditorit çdo lloj gjëje për ndonjë subjekt, por kërkon më shumë që të *veprojë* mbi auditorin në mënyrë që ata të rreshtohen me pohimin e tij”⁴⁷. Po kështu edhe në gjyq apo në rastin e festimeve. Kjo është arsyeja pse personi që flet, thotë Haidegeri, duhet të jetë i vëmendshëm për mjetet që përdor për t’ia arritur qëllimit.

Aristoteli, na thotë Haidegeri, dallon tre mënyra për të bërë të tjerët që të besojnë në favor të gjësë që bëhet fjalë. Këto janë; së pari, tonaliteti afektiv i atij që flet. Së dyti, oratori duhet të duket i besueshëm dhe kompetent. Së treti, midis mundësive që mund të flasin në favor të një gjëje, duhet cilësuar mënyra e të treguarit brenda këtij diskutimi. Kjo mënyrë e të treguarit nuk ka karakterin e një demonstrimi, pasi oratori përmes shembujve të fortë do të prekë drejtpërdrejt zemrat. Të gjitha këto mënyra na shpien te *Dasein* i përditshëm.

II. Qenia e vërtetë dhe *Dasein*.

⁴⁶ Po aty, f. 11.

⁴⁷ Po aty, f. 12.

Qenia-një-me-tjetrin e njerëzve, në thelb është “qenia-një-me-tjetrin në llogaritje”. Nisur nga analiza e Aristotelit në lidhje me *Dasein* e përditshëm, Haidegeri do të theksojë natyrën pavetore të *Dasein* të përditshëm, në kuptimin e shihet, gjykohet, dëshirohet, ka nevoja, madje edhe flitet. Pavetorja është një fenomen karakteristik i *Dasein*.

Kjo do të thotë se *Dasein* i përditshëm e shikon botën dhe veten në perspektivën e opinionit, dhe që është një mënyrë e caktuar e të parit të botës. Grekët, na thotë Haidegeri e kishin parasysh këtë veçanësi, prandaj e përcaktuan njeriun si qenie e gjallë që flet. Pasi tregon keqkuptimin për termin *logos* si “arsye” gjatë historisë së filozofisë, Haidegeri thekson revolucionin që bënë Sokrati dhe Platoni, të cilët për herë të parë në historinë e mendimit e tronditën peshën e llogaritjes, për të depërtuar nga llogaritja te vetë gjërat. Edhe pse Platoni nuk e realizoi këtë detyrë, ai ka meritën e tronditjes së peshës së opinionit, pasi është opinionin që na mban në injorancë.

Duke e marrë fjalën si një përcaktim thelbësor të *Dasein*, Haidegeri ndalet në mundësinë që fjala, *logos*, të bëhet e vërtetë, që në greqisht do të thotë me lënë që të shikohet, domethënë që të çlirojë realitetin nga fshehja (occultation) që vjen nga opinionin duke e shkëputur të qenurit nga kjo fshehje. “E tillë është sjellja themelore e qenies-të vërtetë të *Dasein* njerëzor”, thotë Haideger. Kjo fshehje ka të bëjë me opinionet, brenda së cilës lëviz jeta e përditshme. Fshehja e botës dhe e vetë *Dasein* njerëzor mund të bëhet përmes tre mënyrash të ndryshme. Këtu Haidegeri shkon përtej koncepteve të Aristotelit.

Së pari, fshehja mund të vijë nga fakti i opinionëve. Së dyti, një fshehje direkte, së cilës i korespondojnë “injanca, mungesa e çdo familjariteti me një fushë të të qenurit”, mund të zbulohet. Së treti, një fshehje mund të prodhohet kur një gjë, në të kaluarën ka qenë zbuluar, por që errësohet rishtazi dhe paraqitet si më e vlefshme. Ndërmjet këtyre tre tipeve, ky i fundit është më i rrezikshmi, pasi paraqitet sikur kuptohet vetvetiu duke e bërë të kotë çdo diskutim.

Këto janë tre modalitetet thelbësore që i ofrohen *Dasein* për të qenë i vërtetë, domethënë për të zbuluar fshehjen e botës. Duhet të jetë e qartë, thotë Haidegeri, se të qenurit-i vërtetë është një mënyrë e të qenurit i

mundur i vetë *Dasein* njerëzor. Më saktë; “që qenia-e vërtetë nuk është një mundësi e *logos* si *logos*, por që (zbulimi i fshehjes) të kryhet në *logos*”⁴⁸.

Sipas Aristotelit, qenia-e vërtetë cilëson diçka që shpirti e mban në vetvete dhe që i jep një prirje të caktuar. Pra, shpirti ka në dispozicion një numër të caktuar mundësish tepër të përcaktuara të zbulimit të botës dhe të zbulimit të vetë jetës njerëzore. Këtu Haidegeri sqaron edhe kuptimin që ka Aristoteli për shpirtin. Për të shpirti nuk është një substancë ose një “energji”, një aparat që do të funksiononte në këtë ose atë mënyrë; *entelechia*, për Aristotelin, në asnjë mënyrë nuk është një koncept, por koncepti ku mbahet e tërë filozofia e tij. Për Aristotelin ekzistojnë pesë mënyra të qarta për të qenë i vërtetë.

IV. Mënyrat e të qenurit-i vërtetë dhe mundësitë e tyre të qarta

Cilat janë këto pesë mënyra?

1. ἐπιστήμη: Dija
2. τέχνη: fjalë që cilëson një mënyrë për të njohur sipas mënyrës së përdorimit të gjërave.
3. φρόνησις: hedhje vështrimi, ose më mirë hedhje vështrimi të dyshimtë.
4. σοφία: kuptimi i kulluar.
5. νόϋς: shqetësimi i kulluar.

To the east, however, in Greek Thrace, where there is a Pomak population, a different set of contestations is being played out. Here, Turkish is the only recognized minority language and Muslim is the only recognized minority ethnicity. Because the Greek state recognizes minorities on the basis of religion rather than language, Pomaks have no educational institutions and send their children to Turkish-language schools on religious grounds. (Macedonian-speaking Muslims in western Macedonia sometimes send their children to Albanian or Turkish schools, the crucial difference being that in Macedonia there are schools available in the chil-

dren's native language, so that a conflict arises between ideology and best educational practice.) While the Greek government continues to discourage Macedonian, however, it has recently permitted the publication of school materials in *pomakika* using the Latin alphabet and based on the Rhodopian Slavic dialects of Greek Thrace. (In Bulgaria, these dialects are considered Bulgarian and are spoken by both Christians and Muslims.)

The influence of Turkish vocabulary on the languages of the former Ottoman Empire has been tremendous and, in the colloquial Balkan languages of the early nineteenth century, its position was not unlike that of the French lexicon in English. With the rise of Balkan standard languages, however, large numbers of Turkish words were stylistically lowered and limited to colloquial usage or made obsolete. The process was repeated as each language standardized, e.g., for Greek, Bulgarian and Romanian beginning with in the nineteenth century and Macedonian and Albanian in the twentieth. It is worth noting that many of these same words were eliminated from Turkish starting in the 1920s owing to the fact that they are ultimately of Arabo-Persian origin, and even in languages that standardized in the nineteenth century, anti-Turkism campaigns were also carried out in the twentieth. After 1989, however, there was a resurgence in the use of Turkisms in formal discourse in all the ex-communist Balkan countries except on the territory of the former Serbo-Croatian. Outside of those territories, Turkisms were associated with the colloquial and therefore with democracy, whereas on the territory of the former Serbo-Croatian, Bosnian language planners laid claim to the Turkish heritage of Serbo-Croatian as specifically theirs on the basis of the association of Turkish with Islam.

In the case of Romani and Aromanian, however, since literary norms are currently in the process of elaboration, the colloquial nature of Turkisms means that they are in competition with neologisms or loanwords from related languages and are available for language planners. The use of Turkisms in official documents indicates that the function of Turkisms in Romani and Aromanian are following their own path of development and are more resistant to stylistic lowering.

One can say, however, that in the context of the Balkans, English is the Turkish of the twenty-first century: it has become the lingua franca and, as elsewhere in the world, it is also the source of puristic anxieties. Because English is the vehicle of new technologies as well as the principal language of international politics and trade, in the Balkans, as elsewhere, language

establishments are expressing concern over the effect of English, especially on the lexicon. The power and prestige of English have resulted in a flood of new words and phrases, but the basic grammatical structures of the Balkan languages are no more affected by English than they were by Turkish. Concerns with purism now, as in the past, reflect anxieties about social and political control and intergenerational competition.

As knowledge of English has increased dramatically in the Balkans, especially among young people, more people now know English than the languages of their neighbors. Moreover, owing to the influences of national ideologies and the compartmentalization of language instruction and language study, students in the Balkans are taught differences and not shown the structural similarities that resulted from centuries of multilingualism and, arguably, peaceful coexistence. Native speakers of a language are not aware of its underlying structures unless they learn it as an object of study, which is also the case with regard to structural similarities for multilingual speakers in countries such as Macedonia, studying the different languages in isolation, or learning them without formal instruction. It is thus the case that instruction in Balkan linguistics has considerable potential for creating a sense of mutuality, a potential that might still be realized.

This brings us back to the position of the Balkans in Europe. Recent research on language change and language contact has challenged Balkan linguistics from two opposing directions. On the one hand, arguments that structural borrowing does not occur or is extremely rare are bolstered by phonological data, although the data themselves all involve English, and the reliance of some approaches on the notion of “imperfect learning” locates structural change in a realm perilously close to nineteenth-century ideas of “impurity.” On the other hand, typological approaches to areal linguistics that I call “Eurological” argue for Europe as a convergence area with the center located at the Romance-Germanic border from Holland to Northern Italy, of which the Balkan *Sprachbund* is a periphery.

Balkan Slavic dialectological data, however, show that precisely the superficiality of morphosyntactic phenomena makes them amenable to structural borrowing, while at the same time phonological diffusion takes place without the transmission of structural constraints. Salient examples occur along the Albanian-Slavic contact zone. Thus, while we can speak of a shared Balkan morphosyntax, it is more appropriate to speak of Balkan phonologies rather than Balkan phonology.

Finally, the dialectology and history of these phenomena demonstrate that while “Eurology” has ideological value and current interest, an attempt to project the present onto the past by conflating areal and typological linguistics obscures the role of the Ottoman Empire in Balkan linguistic convergence. We know from documentary evidence that it was precisely during the Ottoman period - when everyday communication within southeastern Europe was relatively free - that the Balkan linguistic league took its modern shape independently of developments in Western Europe. Now that these regions are in a new and intensive multilateral contact we can expect different developments, and the past can be harnessed to inform the present in constructive ways, especially if we examine the development of Balkan linguistic mutuality as it developed during the early modern period. It provides a model that can be both ideologically rewarding and academically significant.

Victor A. FRIEDMAN, Universiteti i Chicago-s

POLITIKA GJUHËSORE DHE POLITIKAT E GJUHËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR BASHKËKOHOR: PASKAJORET, TURQIZMAT DHE EUROLINGUISTIKA

Rezyme

Në këtë shqyrtim diskutohen zhvillime të reja në hapësirën gjuhësore ballkanike dhe në fushën e ideologjisë gjuhësore në ndërlidhje me disa ndryshime të vona politike. Bëhen krahasime në këtë drejtim dhe me zhvillimet në të kaluarën në hapësirën europiane: Mund të thuhet madje se ideologjia gjuhësore e EU-së për përfshirjen mund të jetë reflektuar në disa lloje hulumtimi linguistik dhe ndikuar në periferializimin e Ballkanit. Për t'i parë të gjitha këto zhvillohen diskutime konkrete lidhur me shfaqje si infinitivi apo turqizmat në Ballkan dhe lidhur me zhvillimet ballkanistike në përgjithësi.

Kjo na kthen te pozita e Ballkanit në Europë. Këto diskutime shihen nëpër prizmin e diskutimeve për (pa)mundësinë e huazimeve strukturore dhe për shqyrtimet tipologjike në raport me gjuhësinë areale, që këtu quhet Eurologjike, e që nënkupton Europën nga kufiri romano-gjermanik e deri në Holandë dhe deri në Itali si zonë konvergjence, duke lënë Sprachbundin ballkanik si periferi.

Dialektologjia dhe historia e fenomeneve të ndryshme në fushë të fonologjive ballkanike dhe të morfosintaksës dëshmojnë se, derisa 'Eurologjia' mund të ketë vlerë ideologjike dhe interesa aktualë, tendenca për të projektuar të tashmen në të kaluarën përmes konflacionit gjuhësor areal dhe tipologjik e errëson rolin e Perandorisë Osmane në konvergjencën gjuhësore ballkanike. Nga historia e dokumentuar e dimë se në Perandorinë Osmane ndodhte komunikimi i përditshëm i lirë në jetën e përditshme në sajë të të cilit mori formë moderne lidhja gjuhësore ballkanike pavarësisht nga zhvillimet në Europën Perëndimore. Në rrethanat e reja mund të priten zhvillime të ndryshme.

Sedat KUÇI, Universiteti i Prishtinës

DESNICKAJA DHE STUDIMET ALBANISTIKE¹

KUD 81-26

Abstrakt

Në këtë artikull jepet një përmbledhje e veprimtarisë së albanologes së njohur A. V. Desnickaja. Studimet e saj janë shtrirë në fushat vijuese: gramatika historike e gjuhës shqipe, struktura e saj e sotme, studimet ballkanistike dhe vështrimet krahasimtare. Ndihamsat e A.V. Desnickajas kanë qenë me rëndësi për studimet e gjuhësisë, të letërsisë, të dialektologjisë, linguistics, dhe të folklorit.. Çështjet kryesore në fushën e gjuhësisë kanë qenë: prejardhja e gjuhës shqipe, studimet dialektore dhe kategoria e emrit.

Desnickaja mbronte qëndrimin se shqiptarët dhe gjuha e tyre ishin pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve dhe gjuhës së tyre. Sa i përket fonetikës dhe fonologjisë, ajo u mor me to në kuadër të dialektologjisë gege e toske dhe të të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës e diasporës tjetër.

A.V. Desnickaja e kishte theksuar rëndësinë e studimeve të strukturës gramatikore të shqipes si fushë me peshë jo vetëm për studimet krahasimtare të gjuhëve indoeuropiane, por edhe për tipologjinë. Ajo po ashtu i kishte vështruar çështjet e shqipes në kuadër të studimeve ballkanistike.

A.V. Desnickaja ishte figurë me vlera të mëdha shkencore, gjuhëtare e pranuar në qarqet shkencore.

Albanologjia në BRSS (Rusi) u zhvillua më intensivisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe lidhet ngushtë me emrin e Agnja Vasiljevna Desnickajas. Në fillim të viteve '90 të shekullit XX përfundoi veprimtaria e saj e begatshme, duke lënë prapa shumë nxënës.

Shënime biografike dhe kontakti i parë me Shqipërinë dhe shqiptarët

A. V. Desnickaja, anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave të BRSS-së, figura qendrore e studimeve albanologjike në këtë vend, u lind më 1912 në Sednjev të krahinës së Çernigovës (Rusi). Rrjedh nga një familje intelektualësh. Babai i saj Vasilij A. Desnickij ishte i njohur në fushën e letërsisë. Ishte bashkëluftëtar dhe shok i shkrimtarit Maksim Gorki. Nëna e Desnickajas - Aleksandra Mitrofanovna ishte mjeke. I vëllai - Aleksej ishte

¹ Në 100-vjetorin e lindjes së albanologes së shquar.

letrar, e motra - Olga ishte piktore. Në zgjedhjen e profesionit të Desnickajas ndikim të madh ka pasur i ati.

Desnickaja mbaroi studimet e filologjisë gjermane nga viti 1928 deri më 1931 në Institutin Pedagogjik A. I. Hercen të Leningradit. U punësua në Insitutin e Gjuhës dhe të Mendimit, i cili nga viti 1950 u transformua në Institutin e Gjuhësisë të ASH të BRSS-së - Dega e Leningradit. Në vitin 1935 mbrojti punimin e magjistraturës në temën "Alternimi i zanoreve në gjuhët gjermanike (ablauti)". Në vitin 1946 mbrojti disertacionin e doktoratës me temën "Zhvillimi i kategorisë së kundrinës së drejtë në gjuhët indoevropiane". Interesimet e saj shkencore dolën jashtë kuadrit të gjermanistikës; ajo interesohet për gjuhët e ndryshme të familjes indoevropiane dhe të gjuhëve që nuk i përkisnin kësaj familjeje gjuhësh. Desnickaja gëzonte mbështetjen e pakursyer të dijetarëve të njohur L. V. Shçerba, I. I. Tolstoi, A. P. Baranikov, etj. Nga shkencëtari A. A. Bokarev² Desnickaja u njoh më afër me gjuhën avare dhe me gjuhët e ndryshme të Dagestanit.³

Dëshira e madhe e saj që të njihet drejtpërsëdrejti me të arriturat shkencore të popujve të ndryshëm në fushat e ndryshme të gjuhësisë e shtyri atë që të mësojë shumë gjuhë. Në vitin 1946 Desnickaja qëndroi në Shqipëri me një delegacion sovjetik të grave. Kjo vizitë ngjalli tek ajo një dashuri si për popullin shqiptar ashtu edhe për Shqipërinë. Kështu ajo iu përvesh mësimit të gjuhës shqipe. Studioi çdo gjë që lidhej me shqiptarët dhe vendin e tyre - gjuhën, historinë, letërsinë, folklorin, etnografinë, artin. Desnickaja u mor me studimet e albanologjisë gjithë jetën.

Vizitën e parë (viti 1946) dhe të fundit (viti 1990) jashtë vendlindjes Desnickaja e pati bërë në Shqipëri. Në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë ka qenë më 1977, 1980, 1983, 1985, 1986. Desnickaja ndërroi jetë më 18. 4. 1992 në Sankt-Peterburg në moshën 80 vjeçare.

Meritë e madhe e saj është krijimi i traditës shkencore të albanologëve në Bashkimin Sovjetik, si dhe hapja e Degës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Universitetin Shtetëror të Peterburgut (Leningradit), pastaj formimi i qendrave të ndryshme shkencore, ku thellohen studimet albanologjike, siç janë: Instituti i Gjuhësisë në Akademinë e Shkencave të Bashkimit Sovjetik (dega e

² A. A. Bokarev ishte bashkëshorti i A.V. Desnickajas. U vra në Frontin e Leningradit në luftën për mbrojtjen e atdheut (Lufta e Dytë Botërore).

³ Dagestani është Krahinë Autonome në bregun e Detit të Zi në kuadër të Federatës Ruse. Në të jetojnë rreth 2 milionë banorë me etni të ndryshme, fliten më se 30 gjuhë.

Peterburgut), Universiteti Shtetëror i Peterburgut, Universiteti Shtetëror i Moskës, Instituti i Gjuhësisë e Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik në Moskë, etj. Desnickaja bëri një punë të madhe në përgatitjen e kuadrit shkencor, i cili bashkë me te do t'i rreket më vonë hulumtimit të gjuhësisë e letërsisë shqiptare në qendra të ndryshme studimore në Bashkimin Sovjetik. Nxënësit e saj G. Ejntrej, A. Zhugra, I. Voronina, A. Sitov, J. Llopashov, M. Gabinski e të tjerë, me punën e tyre shkencore zënë një vend të rëndësishëm në albanologjinë e krijuar jashtë arealit Shqiptar. Kontributi i Desnickajas në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të dialektologjisë dhe të folkloristikës shqiptare është i madh. Temat për të cilat ajo ka shkruar në fushën e gjuhësisë janë: prejardhja e gjuhës shqipe, dialektologjia dhe kategoria e emrit. Historia e popullit shqiptar, struktura e gjuhës shqipe dhe gjuhësia shqiptare në përgjithësi zunë një vend të rëndësishëm në jetën shkencore të A.V. Desnickajas.

Me këtë rast do të sjellim në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e saj në albanistikë, në ballkanologji dhe në komparativistikë.

Studimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe

Përcaktimi i vendit të gjuhës shqipe në kuadrin e familjes së gjuhëve indoevropiane ishte ndër temat e para me të cilat u mor Desnickaja.⁴ A.V. Zhugra në pasqyrën bibliografike për Desnickajan⁵ ndër të tjera shkruan se në arkivin e ASH të Rusisë gjendet një dorëshkrim i saj me karakter historiografik "që përfshin etapat themelore të albanologjisë si disiplinë e veçantë që nga zanafilla (nga periudha parahistorike deri në shekullin XIX)".⁶ Studimi për lidhjet e lashta gjermano-shqiptare nxjerr në dritë interesimet e saj për studimet e problemeve të gjermanistikës dhe të gjuhësisë krahasimtare.⁷

Sa i përket prejardhjes së shqiptarëve Desnickaja ka mbrojtur tezën se shqiptarët janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve. Sipas saj kombi shqiptar është formuar nga fiset e pavarura ilire të Jugut dhe fiset gjysmë të romanizuara në provincën e dikurshme romake - Ilirikum.⁸ Po kështu edhe

⁴ A.V. Desnickaja, *Albanskij jazyk v istorii sravnitel'nogo jazykoznanija*, **Balkanskaja filologija**, Leningrad, 1970.

⁵ Agnija Vasilevna Desnickaja, **Bibliografičeskij očerk**, përgatitur nga A. V. Zhugra, A. N. Anfertjeva, I. A. Magin, Sankt-Peterburg, 2002.

⁶ Po aty, f.44.

⁷ A.V. Desnickaja, *Drevnie germano-albanskije jazykovye svyazi v svete problem indoevropejskoj areal'noj lingvistiki*, **Voprosy jazykoznanija**, 6, Moskva, 1965, f. 24-43.

⁸ A.V. Desnickaja, *K probleme obrazovaniya albanskogo jazyka i albanskoj narodnosti*, në **Albanskaja literatura i albanskij jazyk**, Leningrad, 1987, f. 204-257.

gjuha shqipe "ka lindur si rezultat i shkrirjes së dy trajtave të ilirishtes - njëra nga të cilat ka pasur një leksik shumë të romanizuar, ndërsa tjetra ka pasur një forcë dhe origjinalitet gjuhësor që është parë në begatinë e leksikut të traditës së lashtë popullore të fiseve ilire".⁹ Mbi bazën e pranisë së hershme e të theksuar të latinizmave në gjuhën shqipe u ngrit hipoteza për dëshminë e argumentuar të formimit të lashtë të etnosit shqiptar dhe të gjuhës shqipe. Ky proces përfundoi në shek. V-VI të epokës sonë, para se sllavët të vinin në Gadishullin Ballkanik.

Në fushën e historisë së gjuhës Desnickaja u mor me tema si: periodizimi i historisë së shqipes (proto-shqipja - shqipja e lashtë, shqipja e vjetër, shqipja e mesme, shqipja e re)¹⁰, zhdukja e kategorisë së gjinisë asnjëse (1976), formimi i kategorisë së "masës së përcaktuar" (1977), formimi i dy tipave të mbiemrave (1960), kategoria e admirativit (1987).

Studimi i A. V. Desnickajas "Lidhjet e vjetra gjuhësore gjermano-shqiptare në dritën e problemeve të gjuhësisë areale indoevropiane"¹¹ është ndër të parët e këtij lloji. Për herë të parë në albanologjinë sovjetike u bë krahasimi i tipareve të përbashkëta strukturore të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera, që nuk kanë burim të përbashkët indoevropian. Sipas autores, tiparet e përbashkëta janë pasojë e lidhjeve të vjetra.

Në studimin "Rindërtimi i elementeve të shqipes së lashtë dhe problemet me karakter të përgjithshëm ballkanik"¹² Desnickaja shtjellon çështje të historisë së brendshme të gjuhës shqipe. Me karakter historik janë edhe këta artikuj shkencorë të saj: "Gjinia asnjëse apo kategoria e masës së përcaktuar"¹³, "Kategoria e "përmbledhësisë" dhe kategoria e masës në historinë e sistemit gramatikor të gjuhës shqipe"¹⁴, "Mbi prejardhjen e disa elementeve të fleksionit të shqipes".¹⁵ Në këto studime autorja ndriçon një sërë

⁹ Po aty, f. 250.

¹⁰ A.V. Desnickaja, **Rekonstrukcija elementov drevnealbanskogo jazyka i obščebalkanskije lingvističeskie problemy**, 1966.

¹¹ Desnickaja A. V. *Drevnie germano-albanskije jazykovye svyazi v svete problem indoevropejskoj areal'noj lingvistiki*, **Voprosy jazykoznanija**. 6, 1965, f. 24-43.

¹² Desnickaja A.V. *Rekonstrukcija elementov drevnealbanskogo jazyka i obščebalkanskije problemy*, **Doklad na I kongresse balkanskij issledovanij**. Sofia, 1966.) Moskva, 1966.

¹³ Desnickaja A.V. "Srednij rod" ili kategorija "opredele-anno massy". Në **Balkanskij lingvističeskij sbornik**, Moskë. 1977, f. 275-293.

¹⁴ Desnickaja A.V. *Kategorija sobiratel'nosti i kategorija massy v istorii grammatičeskogo stroja albanskogo jazyka*. Në **Grammatičeskij stroj balkanskij jazykov**. Leningrad, 1976, f. 5-104.

¹⁵ Desnickaja A.V. *O proishozdenii nekotoryh elementov fleksii v albanskom jazyke*, **Linguistique balkanique**. T-19, nom.3.

problemesh kyçe siç janë: problemi i të ashtuquajturës gjini asnjëse, diferencimi i temave emërore të njëjësit dhe të shumës, problemi i lokativit etj. që i përkasin historisë së trajtëformimit emëror. Studimet e cekura janë të karakterit teorik në lëmin e gramatikës historike.

Studimet në fushën e fonetikës - fonologjisë

Problemet e fonetikës, përkatësisht të fonologjisë së shqipes Desnickaja i shqyrton në kuadër të dialekteve: gegë e toskë, ose përmes të folmes së shqiptarëve të Ukrainës e të disa vendeve jashtë arealit shqiptar.

Në studimin *Mbi problemin e të ashtuquajturit palatalizim të buzoreve në disa dialekte të shqipes dhe të ballkanoromanistikës*¹⁶ Desnickaja shqyrton çështjen e palatalizimit të buzoreve në disa të folme të shqipes. Në të folmen e krahinës së Dibrës dhe të shqiptarëve të Maqedonisë Veriperëndimore vërehet një dukuri fonetike, që nuk ekziston në të folmet e tjera të shqipes. Fjala është për palatalizimin e dybuzoreve mbylltore p, b, m (buzore + j): *pj > px' > pħ > ħ > ; bj > bħ > ħ > ; mj > mġ > ħ*. Grupet konsonantike *pl', bl', fl'*, japin *pj', bj, fj*.

Në studimin "Mbi disa çështje të morfonologjisë"¹⁷ flet për shfrytëzimin morfolojik të dallimeve fonologjike. Në grupin e gjuhëve që kanë një shkallë të lartë të morfolojizimit të opozicioneve fonologjike Desnickaja fut edhe gjuhën shqipe. Sipas saj në gjuhën shqipe vërehet një dukuri origjinale, që deri më sot nuk është hasur në gjuhët indoevropiane. Fjala është për bartjen e alternimeve të tingujve nga një paradigmë në tjetrën, që kushtëzohet jo nga kushtet fonetike, por nga struktura e shqipes.

Studimet në fushën e dialektologjisë

Problemet gjuhësore, qofshin të fonetikës, morfolojisë a sintaksës, nuk mund të zgjidhen nëse nuk merren parasysh të dhënat e dialekteve bashkëkohore. Aq më tepër, këto të dhëna kanë rëndësi kur dihet fakti se gjuha shqipe ka një traditë relativisht të vonshme të shkrimit.

Në vitin 1968 Desnickaja botoi studimin monografik *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*.¹⁸ Në të përmbodhi të dhënat e dialekteve të shqipes. Një kapitull të veçantë ua kushtoi të folmeve jashtë arealit shqiptar: të folmeve toske të vendbanimeve shqiptare në Greqi, Bullgari, Ukrainë dhe Itali. Ky

¹⁶ Desnickaja A.V. *K voprosu o tak nazyvaemoj palatalizacii gubnyh v nekotoryh albanskix i balkanoromanskix dialektax*. **Fonetika, fonologija, grammatika**. Moskva, 1971, 50-58.

¹⁷ Desnickaja A.V. *Nekotorye voprosy morfonologii*. Në librin **Istoriko-filologičeskie issledovanija**. 1967, f. 86-91.

¹⁸ Desnickaja A.V. **Albanskij jazyk i ego dialekty**. Leningrad, 1968.

libër ka vlerë të madhe shkencore për gjuhëtarët që merren me fonetikën historike, gramatikën, leksikologjinë shqiptare dhe për ballkanologët.

Të folmet shqipe të diasporës

Në studimin e saj "Kolonitë shqiptare në Itali"¹⁹, A.V. Desnickaja, përveç përshkrimit të kohës së shpërnguljes të shqiptarëve, kushteve sociokulturore të tyre në vendbanimet arbëreshe, bën edhe përshkrimin e tipareve fonetike të të folmeve italo-arbëreshe. Studimi i kolonive shqiptare në Itali është i rëndësishëm për këto tri momente:

- Për shkak të dokumenteve të shkruara në kolonitë italo-arbëreshe. Ato dëshmojnë për një gjendje më të hershme të të folmeve të jugut, e që përbëjnë bazën e gjuhës së sotme letrare.

- Poetët romantikë të shek. XIX në letërsinë shqiptare njihen si klasikë të letërsisë bashkëkohore. Poetët italo-arbëreshë janë bartësit e letërsisë së Rilindjes Kombëtare.

- Folklori i italo-arbëreshëve është i pasur dhe në përmbajtjen e vet ka shumë motive karakteristike edhe për popuj të tjerë të Ballkanit.

Struktura morfologjike e shqipes së sotme

Ndër artikujt e parë, që shkroi A. V. Desnickaja, është studimi "Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe".²⁰ Këtu bën fjalë për mjetet formale të lakimit e të zgjedhimit. Krahas përshkrimit të strukturës së paradigmave, në disa raste autorja bën edhe interpretimin historik të trajtave gramatikore. Përveç kësaj, na dalin disa ide me rëndësi teorike mbi veçoritë e procesit të kalimit nga faza e lashtë të gjendja e sotme e sistemit gramatikor. Vihet në spikamë bashkekzistenca e relikteve të fleksionit të vjetër indoevropian me trajtat e reja flektive në paradigmën e emrit dhe të foljes në gjuhën shqipe.²¹ Ajo konstaton se studimi i strukturës gramatikore të shqipes është i rëndësishëm jo vetëm për gramatikën krahasimtare të gjuhëve indoevropiane, por edhe për tipologjinë gramatikore të tyre. Struktura e shqipes ka rëndësi edhe për përcaktimin e kaheve të zhvillimit dhe të ndërtimit gramatikor të

¹⁹ A.V. Desnickaja, *Albanojazyčnyje poselenija Italii*, në **Osnovy balkanskogo jazykoznanija, Jazyki balkanskogo regiona**, Leningrad, 1990, f.100-113.

²⁰ Desnickaja A.V. *O morfologiceskoj strukture albanskogo jazyka. Voprosy jazykoznanija*, 5, 1958, f. 11-23. Shqipe në **BUT** 1959, Nr. 3, f. 213-226.

²¹ A.V. Desnickaja, *O morfologičeskoj strukture albanskogo jazyka*, në **Voprosy jazykoznanija**, 5, Moskë, 1958, f. 11-23.

gjuhëve të veçanta indoevropiane.

Në studimin "Mbi kategorinë e numrit në formimin e temave emërore në gjuhën shqipe" ajo flet për tipet e formimit të temave emërore të shumësit të emrave mashkullorë dhe femërorë. Ajo thotë se eptimi emëror në gjuhën shqipe ndihmon rindërtimin e sistemit të temave dhe fleksioneve të trashëguar nga gjendja gjithindoevropiane.

Gjuha shqipe, që ruan tipin flektiv të strukturës, ashtu si edhe disa gjuhë të tjera indoevropiane (gjermanikishtja, gjuhët sllave) tregon një tendencë të ndarjes së qartë të kategorisë gramatikore të gjinisë (mashkullore dhe femërore; asnjësi në gjuhën shqipe është një kategori në zhdukje e sipër) dhe të numrit (njëjës dhe shumës). Në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme shqipe është e theksuar tendenca e dallimit formal të temave në kategorinë e gjinisë dhe të numrit.

Në studimin e saj "Gjinia asnjëse" ose kategoria "e masës së përcaktuar" A. V. Desnickaja thotë se në gjininë asnjëse hyjnë emrat që marrin formë specifike të nyjës në rasat emërore dhe kallëzore të njëjësit. Duke marrë parasysh treguesit morfologjikë, si dhe veçoritë semantike të emrave që i përkasin këtij grupi, mund të flitet për ekzistencën e kategorisë gramatikore të gjinisë asnjëse në gjuhën shqipe. Në grupin e emrave të gjinisë asnjëse, sipas saj, bëjnë pjesë: a. emrat lëndorë ; b. një grup emrash abstraktë të formuar me procesin e substantivimit të mbiemrave dhe pjesoreve. Eptimi i tyre bëhet sipas paradigmës së gjinisë mashkullore, ndërsa sipas paradigmës së gjinisë femërore haset vetëm në disa të folme.²²

Çështjes së mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm, Desnickaja ia kushtoi studimin me titullin "Dy tipe të mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe".²³ Konstruktet e ndërtuara nga mbiemrat dhe emrat në rasën gjinore përnga struktura janë plotësisht të ngjashme: pusi i thellë (trajta e shquar e nominativit njëjës të emrit të gjinisë mashkullore pus + nyja lidhëse në rasën, numrin dhe gjininë e njëjtë + mbiemri) dhe pusi i fshatit (trajta e njëjtë e emrit + trajta e njëjtë e nyjës + trajta e shquar e rasës gjinore të njëjësit e emrit fshat) ose shtëpia e bukur dhe shtëpia e fshatarit. Me këtë rast nyja përputhet me emrin në rasë, në numër e në gjini.

²² A. V. Desnickaja, "Srednij rod" ili kategorija "opredeljennoj massy"?, në **Balkanskij lingvističeskij sbornik**, 1977, f. 276, 277, 278, 279.

²³ A. V. Desnickaja, *Dva tipa prilagatel'nyh v sovremenom albanskom jazyke*. Në përmbledhjen **Voprosy grammatiki**, Moskë-Leningrad, 1960, f. 291-309.

Konstruktet e ndërtuara me nyje janë të domosdoshme për shumicën e mbiemrave jo vetëm të trashëguar nga e kaluara, por edhe për mbiemrat e ndërtuar sipas gjedheve produktive. Desnickaja thotë se ky tip i sintagmave përcaktuese (mbiemrat e nyjshëm v.j.) është formuar në periudhën historike parashkrimore të shqipes dhe mund të thuhet se është një nga elementet më karakteristike të sistemit gramatikor të saj.

Në gjuhën shqipe ekziston ndërtimi që në gramatikë quhet *mbiemra të panyjshëm*. Karakteristikë e këtij ndërtimi është se formohet me sintagminin e drejtpërdrejtë të emrit që përcaktohet dhe mbiemrit. Pra, mungon nyja. Mbiemri përputhet me emrin vetëm në numër e gjini, në rasë kurrë.

Folja

Në studimin e saj "Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen"²⁴ A.V. Desnickaja, ndër të tjera, thekson se një problem që del këtu është paqartësia e kuptimit gramatikor të admirativit dhe futja e tij në paradigmen tradicionale të kategorive foljore. Cilësimi i kësaj kategorie gramatikore si "mënyrë" vazhdon të jetë çështje e diskutueshme, thotë ajo. Admirativi ka përdorim fakultativ, kurrë nuk është i detyrueshëm. Kjo e vështirëson përcaktimin e përmbajtjes gramatikore të tij. Mungojnë kontekstet semantike ose sintaksore ku rregullat gramatikore do ta kushtëzonin përdorimin e trajtave të admirativit. Shpeshtësia e përdorimit të trajtave të tij varet nga mënyra individuale e stilit të folësit dhe nga situata e aktit gjuhësor, thotë më tutje Desnickaja. Ajo thotë se kemi të bëjmë me një shembull të qartë të një kategorie nga fusha e gramatikës stilistike. Këtë e ilustron me spektrin e tërë të nuancave kuptimore që nuk përfshihen në kuptimin e habitës, të presupozuar me "admirativin" ose "mënyrën habitore".

Admirativin e shqipes e karakterizon "një kontrast i çuditshëm midis rregullsisë së jashtme në korrelacionin morfologjik të trajtave dhe mungesës së rregullsisë në përdorimin e tyre, i cili nuk i nënshtrohet dot asnjë kërkimi sintaktiko-semantik", konstaton A. V. Desnickaja. Kjo kontradiktë e bën admirativin e shqipes kategori gramatikore shumë origjinale. Edhe sa i përket rregullimit sintaktik, thotë autorja, admirativi i shqipes tregon një përcaktim më të dukshëm.

²⁴ A. V. Desnickaja, *Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen*, **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, nr. 12, Prishtinë, 1987.

Desnickaja për gjuhën letrare shqipe

Gjuhës letrare shqipe dhe kushteve të formimit të saj A. V Desnickaja ia kushtoi dy studime shkencore.

Në studimin me titull: *Gjuha letrare shqipe dhe dy trajtat e saj dialektore*²⁵ ajo thotë se një ndër çështjet e gjuhësisë teorike është çështja e kushteve dhe formave të zhvillimit të gjuhëve të ndryshme letrare. Zakonisht, formimin e gjuhës letrare e përcjellin luftëra të ndryshme mendimesh të shkencëtarëve të lëmenjve të ndryshëm. Një specifikë e problematikës së formimit të gjuhës letrare shqipe është se ajo ekziston në dy forma, që secila për vete ka bazën dialektore.

Në studimin e dytë me titullin: *Mbi kushtet e formimit të gjuhës letrare shqipe*²⁶ Desnickaja ndër të tjera shkruan se edhe pse vepra e parë e shkruar në gjuhën shqipe, *Meshari* i Gjon Buzukut, i takon mesit të shek. XVI, gjuha letrare shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve me traditë të vonshme shkrimi. Fakti se gjuha letrare shqipe ekziston në dy variante rajonale - të jugut (toskë) dhe të veriut (gegë) edhe më shumë e ndërlikon gjendjen gjuhësore të Shqipërisë. Është i qartë dominimi i variantit të jugut - toskë mbi dialektin e veriut në dy shekuj të fundit.

Desnickaja si ballkanologe

Aspekti ballkanistik i studimit është kaherë i pranishëm në hulumtimin e gjuhës shqipe. Desnickaja në këtë fushë hyri përmes albanologjisë.

Në vitin 1966 botoi studimin me titullin "Rindërtimi i elementeve të shqipes së lashtë dhe problemet e përgjithshme gjuhësore ballkanike"²⁷ ku, ndër të tjera, thekson rëndësinë e maq dhe që ka shqipja për hulumtimet ballkanistike.

Në vitin 1987 A.V. Desnickaja shkroi artikullin "Mbi studimin e elementeve latine në leksikun e gjuhëve të Ballkanit"²⁸ në të cilin përshkruan

²⁵ A.V. Desnickaja, *Literaturnyj albanskij jazyk v ego dvuh dialektnyh formah*, në **Problemy sovremennoj filologii**, Moskva, 1965, f. 108-115.

²⁶ A.V. Desnickaja, *O predposylkah obrazovanija albanskogo literaturnogo jazyka*, në **Balkanskoe jazykoznanie**, Moskva, 1973, f. 283-300.

²⁷ A.V. Desnickaja, *Rekonstrukcija drevnealbanskogo jazyka i obshcebalkanskije lingvističeskie problemy*, në **Doklady sovjetskoj delegacii**, Moskva, 1966, 27 f.

²⁸ A.V. Desnickaja, *K izučeniju latinskih elementov v leksike balkanskih jazykov*, në *Romano-Balkanica: Voprosy adaptacii latinskogo jazykovogo elementa v balkanskom areale*, Leningrad, 1987, f.3-37.

karakterin e kontakteve të dy kulturave gjuhësore në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të parë të epokës sonë.

Në vitin 1988 Desnickaja botoi studimin me titullin "Llojet e lidhjeve reciproke të leksikut dhe çështjet e formimit të lidhjes gjuhësore ballkanike"²⁹, në të cilin shfaq pikëpamjen se problemet e ngjashmërive gramatikore të gjuhëve të Ballkanit janë rezultat i mbindërtimit mbi bazën leksikore. Këtë bazë leksikore e përbënin elementet e përbashkëta në gjithë llojlojshmërinë, pasurinë dhe përzierjen e ndërlikuar.³⁰ Ajo bëri ndarjen e huazimeve leksikore në gjuhët e Ballkanit në dy grupe. Grupin e parë e përbëjnë huazimet kulturore-historike, të cilat nuk kanë të bëjnë me kontaktin e drejtpërdrejtë të popujve të ndryshëm të Ballkanit. Grupin e dytë, sipas saj, e përbëjnë huazimet leksikore, përkatësisht shtresat e tëra leksikore, të cilat kanë depërtuar nga një gjuhë në gjuhën tjetër.

A. V. Desnickaja në punimin "Studimi i elementeve latine në leksikun e gjuhëve ballkanike"³¹ analizon elementet latine në leksikun e gjuhëve të ballkanit: në grupin e gjuhëve romane të lindjes (rumanishtja, moldavishtja, arumunishtja), në gjuhën shqipe, në gjuhën greke, në familjen e gjuhëve sllave të Ballkanit (serbokroatishtja, sllovenishtja, bullgarishtja, maqedonishtja). Elementet latine në leksikun e shqipes janë futur, sipas Desnickajas, që në kohët e sundimit të Perandorisë Romake në Ballkan. Pjesën më të madhe të fjalëve të shqipes me prejardhje latine e përbën kategoria e emrave, pastaj mbiemrat cilësorë, disa numërorë, shumë folje, parafjalë, etj. Këtu bën pjesë edhe një numër i konsiderueshëm i formanteve fjalëformuese.

Desnickaja konsideron se "Përcaktimi i rolit historik që ka pasur substrati latin në procesin e formimit të përbërjes leksikore të gjuhës shqipe është një detyrë shkencore, që paraqet interes të madh jo vetëm për albanologjinë dhe ballkanistikën, por edhe për gjuhësinë në përgjithësi".

Temën e huazimeve sllave në gjuhën shqipe A. V. Desnickaja e trajtoi në "Huazimet sllave në gjuhën shqipe". Në të ajo jep një pasqyrë të punimeve shkencore të studiuesve të ndryshëm për huazimet sllave në gjuhën shqipe dhe sjell ndihmesën e saj me vlerë në këtë fushë.

Nën redaktimin e A. V. Desnickajas, në vitin 1990 u botua vëllimi i

²⁹ A.V. Desnickaja, Tipy leksičeskikh vzaimosvjazej i voprosy obrazovanija balkanskogo jazykovogo sojuza, në **Doklady sovjetskoj delegacii**, Moskva, 1988, f.131-151.

³⁰ Po aty.

³¹ A.V. Desnickaja, K izučeniju latinskih elementov v leksike balkanskih jazykov, në **Romano-balkanica**, Leningrad, 1987, f. 3-36.

parë i përmbledhjes së përbashkët "Bazat e gjuhësisë ballkanike"³², ndërsa vëllimi i dytë doli nga shtypi në vitin 1998, pas vdekjes së saj.

V. Desnickaja si gjermaniste dhe komparativiste

Desnickaja shqyrtoi problemin e strukturës nominale të gjuhëve të ndryshme indoevropiane dhe ndërtoi pikëpamjen e vet për gjenezën e saj. Me këtë rast ajo u mbështet në analizën e materialit gjuhësor të greqishtes së vjetër. Ajo kundërshtoi tezën sipas së cilës struktura nominale e gjuhëve të vjetra indoevropiane formohet nga struktura ergative. Studimet në fushën e gjuhësisë krahasimtare-historike kanë zënë një vend të rëndësishëm në jetën shkencore të Desnickajas. Pjesën më të madhe të studimeve në fushën e gjuhësisë indoevropiane ajo ia ka kushtuar gjuhës shqipe dhe lidhjeve të saj me gjuhët e tjera indoevropiane. Ajo në fillim i studioi këto lidhje me gjuhët e tjera të periudhës paraballkanike, p.sh. lidhjet e shqipes me gjuhët gjermanike dhe gjuhët baltike.³³ Desnickaja konsideronte se tiparet e përbashkëta të strukturës gjuhësore të shqipes dhe të gjuhëve gjermanike janë rezultat i kontakteve të përbashkëta zhvillimore. Në këtë kuadër ajo studioi paralelizmin e metafonisë (umlautit), transformimin e fleksionit indoevropian, ngjashmëritë në sistemin foljor. Për lidhjet e shqipes me gjuhët baltike Desnickaja sjell një mori ngjashmërish leksikore të periudhës paleoballkanike,³⁴ pastaj zhdukjen e kategorisë së gjinisë asnjane.³⁵

Në studimin me titullin "Gjuha shqipe në historinë e gjuhësisë krahasimtare"³⁶ A. V. Desnickaja analizon punimet shkencore të studiuesve që trajtojnë temën e lidhjeve gjenetike të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera në etapën e parë të zhvillimit të saj. Komparativistët e shek. XIX kanë treguar një interesim të vogël për studimin e gjuhës shqipe për shkak se Shqipëria asokohe ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe vështirë depërtohej atje. Interesimi i komparativistëve u rrit më vonë nga shkak se shqipja ishte e vetmja gjuhë e gjallë që kishte mbetur nga grupi "paleoballkanik".

³² *Osnovy balkanskogo jazykoznanija; Jazyki balkanskogo regiona, I*. Red. Përgj. A.V. Desnickaja, Leningrad, 1990, 297 f.

³³ A.V. Desnickaja, *Drevnie germano-albanskije jazykovye svyazi v svete problem indoevropejskoj arealnoj lingvistiki* në *Voprosy jazykoznanija*, 1965, f.24-43.

³⁴ A.V. Desnickaja, *Drevnie balkano-baltijskie sootvetstviya i albanskij jazyk*, në *Sravnitel'noe jazykoznanie i istoriya jazykov*, Leningrad, 1984, f.192-210.

³⁵ Po aty.

³⁶ A.V. Desnickaja, *Albanskij jazyk v istorii sravnitel'nogo jazykoznanija*, në *Balkanskaja filologija*, Leningrad, 1970, f. 38-61.

Në studimin me titullin "Lidhjet e vjetra gjuhësore gjermano-shqiptare në dritën e problemeve të gjuhësisë areale indoevropiane"³⁷ Desnickaja analizon ngjashmëritë e shqipes me gjuhët gjermanike në lëmin e etimologjisë, të gramatikës e të strukturës morfologjike.

Duke u bazuar në veprën e J. Pokornyt,³⁸ A. V. Desnickaja sjell këto ngjashmëri në fushën e etimologjisë: - shq. *barrë*, -a f. (i.e. **bhornā*); got., gjerm. e vj., island. e vj. *barn* "fëmijë", psh. shprehjet: shq. *me barrë* - angl. e vj. *beón* mid *bearne* etj.

Sa u përket ngjashmërive në fushën e gramatikës, A.V. Desnickaja thotë se ato ekzistojnë si në ruajtjen e disa tipareve specifike të fleksionit të vjetër indoevropian, ashtu edhe në ngjashmërinë tipologjike të rindërtimit të tyre. Kjo më së miri vërehet në sistemin e foljes, që është sistem më i qëndrueshëm se sistemi i fleksionit emëror. Sistemi foljor, shkruan Desnickaja, ruan elementet e strukturës morfologjike të trashëguara nga gjendja e përgjithshme indoevropiane: i.e. **e*: > shq. *o*, *mbledh* - *mblodha*, *dredh* - *drodha*, *bredh* - *brodha*, por edhe *siell* - *solla*.

Ngjashmëri të mëdha vërehen edhe në strukturën morfologjike të shqipes e gjuhëve gjermanike. Alternimi i zanoreve, që shfrytëzohet në morfologjinë e shqipes dhe gjuhëve gjermanike është mjaft i ngjashëm midis tyre.

Në eptimin emëror, si në shqipe, ashtu edhe në gjuhët gjermanike, alternimi i zanoreve (metafonia) shërben për formimin e temave të shumësit të emrave: shq. *dash* - *deshë*, *natë* - *netë*, gjerm. *Gast* - sh. *Gäste*, *Nacht* - sh. *Nächte*, ndërsa në eptimin foljor ka një përdorim të gjerë në formimin e vetës, të numrit dhe të temave kohore, p.sh. shq. *marr*, *merr* në gjerm. (*ich*) *nehme*, (*du*) *nimmst*.

Përfundim

A. V. Desnickaja ishte një personalitet me vlera të mëdha shkencore, një gjuhëtare e pranuar kudo në qarqet shkencore, e cila studimeve krahasimtare-historike, gjermanistikës, indoevropëistikës, ballkanologjisë e sidomos albanistikës i ka lënë trashëgim vepra të çmueshme shkencore.

³⁷ A.V. Desnickaja, *Drevnie germano-albanskije jazykovye svyazi v svete problem indoevropejskoj areal'noj lingvistiki*, në **Voprosy jazykoznaniya**, 6, Moskva, 1965, f. 24-43.

³⁸ J. Pokorny. **Indogermanisches etymologisches Wörterbuch**.I. Bern, 1959.

Bibliografi

- Desnickaja, A. Vasilevna: *Soobščenie o naučnoj komandirovke v Albanskuju Narodnuju Respubliku*, **Izvestija ANSSSR**, 1957.
- Desnickaja, A. V.: O morfoložičeskoj strukture albanskogo jazyka**, **Voprosy jazykoznanija**, 5, Moskva, 1958.
- Desnickaja, A. V.: *Dva tipa prilagatel'nyh v sovremennom albanskom jazyke*, **Voprosy grammatiki**, Moskva - Leningrad, 1960.
- Desnickaja, A. V.: **Slavjanskije zaimstvovanija v albanskom jazyke**, (Doklady sovetskoj delegacii), ANSSSR, Moskva, 1963.
- Desnickaja, A. V.: *O kategorii čisla v obrazovanii imennyh osnov albanskogo jazyka*, **Problemy sravnitelnoj filologii**, Moskva - Leningrad, 1964.
- Desnickaja, A. V.: *Drevnie germano-albanskije jazykovye svyazi v svete problem indoevropejskoj arealnoj lingvistiki*, **Voprosy jazykoznanija**, nr.6, Moskva, 1965.
- Desnickaja, A. V.: *Literaturnyj albanskij jazyk v ego dvuh dialektnyh formah*, **Problemy sovremennoj filologii**, Moskva, 1965.
- Desnickaja, A. V.: *Slavjano-albanskije jazykovye otnosenija i albanskaja dialektologija*, **Slavjanskoe jazykoznanie**, Moskva, 1965.
- Desnickaja, A. V.: *Nekotorye voprosy morfonologii*, **Istoriko-filologičeskije issledovanija**, Moskva, 1967.
- Desnickaja, A. V.: *Albanskij jazyk v istorii sravnitel'nogo jazykoznanija*, **Balkanskaja filologija**, Leningrad, 1970.
- Desnickaja, A. V.: *K voprosu o tak nazyvaemoj palatalizacii gubnyh v nekotoryh albanskijh i balkanoromanskijh dialektah*, **Fonetika, Fonologija, Grammatika**, Moskva, 1971.
- Desnickaja, A. V.: **Gjuha shqipe dhe dialektet e saj**, përktheu Z. Sadiku, Prishtinë, 1972.
- Desnickaja, A. V.: *O predposylkah obrazovanija albanskogo literaturnogo jazyka*, **Balkanskoe jazykoznanie**, Moskva, 1973.
- desnickaja, A. V.: *Kategorija sobiratelnosti i kategorija massy v istorii grammatičeskogo stroja albanskogo jazyka*, **Grammatičeskij stroj balkanskijh jazykov**, Leningrad, 1976.
- Desnickaja, A. V.: *"Srednij rod" ili kategorija "opredelennoj massy"?*, **Balkanskij lingvističeskij sbornik**, Moskva, 1977.
- Desnickaja, A. V.: **Sravnitel'noe jazykoznanie i istorija jazykov**, Leningrad, 1984.
- Desnickaja, A. V.: **Albanskaja literatura i albanskij jazyk**, Leningrad, 1987.
- Desnickaja, A. V.: *K izučeniju latinskijh elementov v leksike balkanskijh jazykov*, **Romano-Balcanica**, Leningrad, 1987.
- Desnickaja, A. V.: *Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen*, **Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, Prishtinë, 1987.
- Desnickaja, A. V.: *Tipy leksiceskijh vzaimosvjazej i voprosy obrazovanija balkanskogo jazykovogo sojuza*, **Slavjanskoe jazykoznanie**, Moskva, 1988.
- Desnickaja, A. V.: *Albanojazyčnye poselenija Italii*, **Osnovy balkanskogo jazykoznanija**, Leningrad, 1990.
- Gosturani, Xheladin: **Historia e albanologjisë**, Tiranë, 1999.
- Ismajli, Rexhep: **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987.
- Kastrati, Jup: **Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)**, Prishtinë, 1980.
- Kastrati, Jup: **Historia e albanologjisë (1497-1997)**, Tiranë, 2000.
- Studime 1**, 1994, Prishtinë.
- Studime filologjike**, 4, 1964.
- Studime filologjike**, 2, 1966.
- Studia linguistica et balcanica**, *Pamjati A. V. Desnickoj (1912-1992)*, S.-Peterburg, 2001.
- Zhugra, A. V. Etj.: A. V. Desnickaja, **Bibliografičeskij očerk**, Sankt-Peterburg, 2002.

Sedat KUÇI, University of Prishtina

DESNICKAJA AND ALBANIAN LINGUISTICS

Summary

The present study gives a summary of the work of the well-known Albanologist, A.V. Desnickaja. Her projects have been classified into the following categories: historical grammar of the Albanian language, its current structure, balkanology and comparativism. Albanology in the USSR developed after the Second World War and was closely linked with Desnickaja's name. The beginning of 1990s in the twentieth century marks the end of the Soviet period and of A. V. Desnickaja's activity, who was the central figure of the Albanological studies there.

A.V. Desnickaja's contribution was important in the fields of linguistics, literature, dialectology and Albanian folklore. The main topics in the field of linguistics she wrote about include: the origin of Albanian, its dialectology and its noun category. The history of Albanians, the structure of the Albanian language and linguistics in general present an important part of her scientific work.

Desnickaja promoted the view that Albanians and their language were the direct descendants of Illyrians and their language. Desnickaja tackled the problems of Albanian phonetics and phonology in its dialects: *Gheg* and *Tosk*, discussed the language spoken by Albanians living in Ukraine and other countries. It is almost impossible to solve linguistic problems, no matter that may these problems fall in the category of phonetics, morphology or syntax, without taking into account the information on contemporary dialects. Moreover, these data are important when regarding the fact that the Albanian language had a relatively belated tradition of documented writing (*Meshari* by Gjon Buzuku, 1555.)

A.V. Desnickaja stressed the importance of studying the grammatical structure of the Albanian language. She concluded that studying the grammatical structure of the Albanian language was important not only for the comparative grammar of Indo-European languages but also for their grammar typology. Her studying Albanian from the Balkanistics point of view was present for a long time in the researching circles. Desnickaja entered this field through Albanology (*Reconstruction of Albanian language elements and general linguistic issues in the languages of the Balkans, by studying the latin elements in the Balkans' languages word.*

The studies in the field of comparative-historical linguistics were an important part of A.V. Desnickaja's scientific work. She dedicated to the Albanian language most of her studies in the field of Indo-European linguistics - its relations with other Indo-European languages, such as Germanic and Baltic languages.

A.V. Desnickaja was a figure who possessed great scientific values, a linguist admitted in scientific circles by leaving everywhere a legacy of a precious scientific worker in the fields of comparative-historical studies, Germanics, Indo-European studies, Balkanology, and especially in Albanology – Albanian linguistics.

Shaban SINANI, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

SHAKAJA E NDALUAR OSE ROMANI I FSHEHUR

KUD 821.18-31.09

Disa çështje ndërtekstorësie në romanin *Arka e djallit*

Romani *Arka e djallit*, i shkruar në dy kohë, në vitet 1980 dhe një dekadë më pas, përveçse për raportet e shkrimtarit me lirinë dhe me censurën, paraqet interes edhe për teknikën e të shkruarit³⁹. Rrëfimi e rrëfyesi, ose më saktë alteriteti i autorësisë; si dhe raportet e tyre me lexuesin, njoftojnë për dukurinë e një eksperimentimi të paracaktuar të disa formave dhe shkallëve të ndërtekstorësisë prej autorit.

“Dritëro Agolli të romani “*Arka e djallit*” është përqendruar maksimalisht drejt realizimit të një projekti romanor përmasash madhore, ka futur në të tërë përvojën jetësore, letrare, filozofike për të zhbiruar një botë, një ekzistencë, një gjithësi”⁴⁰.

Autorësia shumëshkallëshe, të cilën kemi pasur rast të vështrojmë si shprehje të një lirie disashkallëshe⁴¹, është njëherësh shprehje e ndërthurjeve teknike të paratekstit, intertekstit, hipotekstit e perittekstit. *Arka e djallit* – si vepër letrare dhe në kuptimin e figurshëm – *sënduku i djallit* – mban brenda një roman tjetër, të cilën autori e ka quajtur *Shakaja e ndaluar* ose *Njeriu që e frenojnë kur qesh*. Ky “roman brenda romanit” – tekst që i brendashkruhet në formë fragmentare veprës – paraqitet si një vepër e fshehur, prej së cilës gjendet vetëm fletorja e parë e një shtojcë, dhe për këtë arsye figurativisht njoftohet si një vepër e pambaruar. Autorësia e romanit të fshehur, formalisht e artistikisht, i atribuohet njërit prej personazheve të veprës, Bamkë Dynjasë, njeri me

³⁹ Për herë të parë titullin e këtij romani autori e ka përmendur në një intervistë dhënë revistës *Nëntori* në nëntor 1989: “*Kam shkruar mjaft, por në përgjithësi kam botuar pak ... Jam duke përfunduar dy romane, me titujt e përkohshëm “Dështaku” dhe “Arka e djallit”*. Shih intervistë e Dritëro Agollit: “*Dialog të hapur e të singertë me bashkëkohësin e vërtetë*”, *Nëntori* 1989/11, f. 7-10 (ribotuar në gazetën **Tirana**).

⁴⁰ Ali Aliu, *Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*, **Milosao**, 16 maj 2011.

⁴¹ Sh. Sinani, “*Bütün Dünya*”, “*Le Monde*” dhe bota shqiptare ndërmjet - një libër me liri shumëkatëshe - *Romani “Arka e djallit” i Dritëro Agollit, një referencë cilësie në letërsinë shqipe*, **Perla** 1997/4.

interesa në folklor e në traditat gojore. *Shakaja e ndaluar* që në titull të sjell në mendje *Shakanë* gjithashtu të ndaluar të M. Kundera-s, një shkrimtar i njohur disident. Adresimi tek kjo vepër përmes titullit përforcohet prej nëntitullit: *Njeriu që e frenojnë kur qesh*, që duket sikur është vënë pikërisht si titull rezervë, alternativ, nëse titulli i parë përfitohet me aludim. Siç është krejt normale në procedimet letrare moderne, “romani brenda romanit”, autorësia e të cilit fshihet përmes bartjes së narracionit tek dytisi, autori i nënkuptuar, është shkruar në formën e një letre të gjatë drejtuar shkrimtarit humorist Hyskë Borobojka dhe është copëtuar pjesë-pjesë në gjithë veprën, duke u tretur brenda saj deri në shuarjen e kufijve midis ligjërimeve të disa narratorëve.

I paraqitur në këtë mënyrë, me rimarrje fragmentare, duket se shkrimtari ka dashur ta mbrojë veprën e vet prej akuzave të mundshme për një fshehje të vërtetë të saj. I. Kadare, romanit të tij *Tre K*, të depozituar në *Banque de Cité* i dha autorësinë e shkrimtarit bashkëkohës gjerman Zigfrid Lenz, kurse D. Agolli preferon si heteronim emrin e një amatori të dijes dhe letërsisë në një qytezë periferike. Romani i Kadaresë depozitohet si pjesë e një trilogjie, së cilës i qëndrojnë në lidhje strukturore edhe *Pasar-dhësi* dhe *Vajza e Agamemnonit*, kurse *Shakaja e ndaluar* i largohet idesë për të qenë një vepër në ruajtje për botim⁴². Por të dy veprat ngjajnë shumë sa i takon pozicionit në strukturën tërësore të veprës së shkrimtarëve. *Hija*, siç është pohuar dhe nga autori, është roman i dalë prej një romani tjetër, *Koncert në fund të stinës*; kurse *Shakaja e ndaluar* roman i ndërfutur në përmbajtjen e një tjetri, *Arka e djallit*. Romani i fshehur i D. Agollit, pavarësisht kujdesjeve të autorit për ta larguar nga vetja, përmes distancave që përcaktohen nga shkallët e rrëfimit, mund të konsiderohet vepër që mund të funksionojë më vete, mund të dalë nga *Arka e djallit* pa e rrezikuar vet-veten, ndonëse romanit matricë mund t’i shkaktojë deformime e mangësi.

⁴² Këtë qëllim të shkrimtarit, për ta fshehur formalisht autorësinë, me qëllim që të kishte mbrojtje prej censurës, sidomos prej qortimeve para botimit, e vëren më së miri studiuesi Ali Aliu: “Në këtë lojë të rrezikshme, me siguri Dritëroi paskësh qenë djalli, epitete që autori nuk përtonte t’ia ngjiste vetes në ambiente gazmore apo frymëzimi poetik, për të cilin, rojet e ideologjisë mbase mund të ishin të ndërgjegjshëm se sa e vështirë ishte ta fusje përfundimisht në hulli atë. Duhet të besohet se shkrimtari Dritëro, me talent të fuqishëm, ta ketë vërejtur se pushteti i cili ia mban zap gojën e shakasë, me siguri e ka të qartë se ky shkrimtar me shpirt rebeli që e ka në majë të gjuhës shakanë në kuptimin qesh e ngjesh, është një djall ndaj të cilit duhet qenë përherë syçelë”. Shih Ali Aliu, *Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*, **Milosao**, 16 maj 2011.

Leximi vijimor dhe i pavarur i *Shakasë së ndaluar* mundëson të kuptohet gjithashtu se fragmentarizmi është i parazgjedhur nga autori, dhe sipas të gjitha gjasave edhe ky veprim është në funksion të përgënjeshtimit të ekzistencës së saj.

Ka qenë një përvojë e njohur në shoqëritë e kontrolluara, sidomos në historinë e letërsisë shqipe, që autori të mendonte dhe për një profilaksi të veprës ndaj vigjilencës, dhe një prej procedimeve më të njohura ishte mashtrimi përmes tipologjisë së llojit, duke i paraqitur romanet si novela (rasti i shumicës së veprave të I. Kadaresë në fundin e viteve 1980) ose veprat e plota si fragmente rastësore ose të pambaruara (dy romanet humoristikë të D. Agollit, *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* dhe *Arka e djallit*, që u nisën si fejtone në të vetmen revistë humorit të vendit)⁴³.

Ikja prej autorësisë në romanin e fshehur mund të jetë një prej këtyre përpjekjeve. “Sa shaka të tilla, kunderiane, me zarar, të kenë përfunduar në buzët e Dritëroit, për të përfunduar ato në arkën e studios së tij? Mbase janë shtresuar e bërë palimpsest ato brenda kësaj arke, aq sa një ditë do të ushtronin ngacmim krijues që s’mund t’i rezistohet ... Ose, diktatura-palë dhe shkrimtari-palë, gjatë tërë kohës kanë ushqyer mosbesim të ndërsjellë, duke pasur kujdes e duke qenë vazhdimisht vigjilent të mos ia hedhin njëri-tjetrit”⁴⁴.

Ndërtekstorësia në këtë roman shfaqet si dukuri paralele me disa shkallë autorësie formale që përmban vepra. D. Agolli është emri gjithëpërfshirës i autorësive të shumëfishta brenda romanit. Kësaj vepre i bren-dashkruhet romani “Shakaja e ndaluar”, me autorësi formale Bamkë Dyanjanë, që nuk është gjithnjë një heteronim i thjeshtë. Dy autorëve me auto-

⁴³ Romani *Kalorësi lakuriq*, sipas pohimit të autorit, është një vepër e shkruar “në një kohë tjetër” (D. Agolli, *Kompromisi dhe frika – vdekje e ngadaltë për shkrimtarin*, intervistë e botuar në **Koha jonë**, 15 gusht 1996); “është shkruar kryesisht në vitin 1979” dhe “në fillim të viteve ’80-të është botuar në revistën **Hosteni** vetëm kapitulli i parë, me këmbënguljen e kryeredaktorit të atëhershëm Niko Nikolla, si gjithmonë dashamirës ndaj meje”. Më tej D. Agolli saktëson: “Në fund të vitit 1990 është dhënë në gazetën **Drita** një variant disi i shkurtër i romanit, me titullin **I nëmuri**, i cili nisi të botohej që në muajt e parë të vitit 1991 në disa numra njëri pas tjetrit”. Sipas autorit, një kapitull i romanit “është botuar fare i shkurtuar” te **Drita** dhe në vitin 1996 libri “botohet i plotë, siç është shkruar atëherë”. Ky pohim merr rëndësi për të kuptuar se ç’rol mund të ketë luajtur *Arka vetjake e djallit* - romani i ndaluar apo i vetëndaluar, libri i fshehtë - në ndërtimin e karaktereve dhe sidomos në fshehjen formale të autorësisë. D. Agolli, **Kalorësi lakuriq**, Tiranë 1996, f. 102.

⁴⁴ Ali Aliu, po aty, art. i cituar.

rësi të nënrenditur u shtohet një rrëfim i shkurtër dypjesësh në formën e një letre anonime prej Maxhunit të Bilishtit, karakter i përbashkët i të dyja veprave. Të dy rrëfejnë përmes ligjërimit të Bamkë Dynjasë dhe paraqiten si ndërmjetës të tij. Të dy autorët, i tekstit tërësor dhe i tekstit të brenda-shkruar, ngjajnë po aq sa dallohen. Të dy paraqiten si narratorë të vetvetes dhe njëherësh si bartës të narracionit të një subjekti të tretë, Cute Babules, personazhit simpatik që i është ndaluar e qeshura.

Vetë Cute Babulja invokon në ligjërimin e tij urtësinë popullore dhe sidomos folklorin e ri. Autorësi në ligjërim të drejtë prej Cute Babules rikrijimet në stilin folklorik dhe dy koleksione ndërtimesh parremiologjike, në formën e sentencave, aformizmave, fjalëve të urta të risemantizuara në rendin e përkundërt; si dhe disa improvizime, në të cilat karakteri vijon në mënyrë krijuese vargjet popullore.

Në një shkallë më të nënrenditur autorësie paraqitet rapsodi Gjok Çoku, poezitë e të cilit ndërpresin tekstin romanor duke ruajtur një stil ligjërimi të dallueshëm. Gjok Çoku ftohet të alternojë rrëfimin si nga autori vetë, ashtu dhe nga ndërmjetësit e tij.

Në status narratori paraqiten dhe Selmani e Anthulla, dy karaktere që bëjnë jetë të pavarur në dy romanet. Si narratorë të ndërmjetëm ata lehtësojnë kalimin nga vepra e mbyllur në veprën e hapur.

“Shakaja e ndaluar” ose “Romani i fshehur”

“Na shëron e bukura Anthullë, doktoresha më lozonjare që kam njohur në Ballkan! Ajo do të na marrë në gji e do të na ngrohë po të ftohemi - dhe këndoi”⁴⁵:

*U çmenda po lidhmëni,
Tek Anthulla hidhmëni
Ajo di e bën raki
Me mollët që ka në gji*⁴⁶.

Anthulla e ndërpreu leximin dhe u egërsua në fytyrën e saj të bukur. Plakut i ranë djersë të ftohta nga balli, ndërsa plaka vuri dorën para gojës që të mbante të qeshurën”⁴⁷.

⁴⁵ Autorësia i tejkohet Bamkë Dynjasë - teksti “riprodhohet” sipas fletores së tij - i cili e mbivendos veten ndaj narratorit formal.

⁴⁶ Autorësia e poezisë i atribuohet Cute Babules, rikrijim në frymën popullore.

⁴⁷ Autori ia rikthen vetvetes funksionin e narratorit - teksti ndahet dhe formalisht prej dorëshkrimit të fletores së Bamkë Dynjasë.

Në dy-tre paragrafë të njëpasnjëshëm shfaqen këto shkallë autorësie dhe narracioni:

Në gjithë tekstin, autori, D. Agolli. Në paragrafin e parë autor është Bamkë Dynjaja, që nënshkruan letrën për Hyskë Borobojkën. Në paragrafin e dytë autor është Cute Babulja, por në gjysmën e atij paragrafi ligjëratës së tij i brendashkruhet ajo e rapsodit popullor. Në paragrafin e fundmë autorësia është e drejtpërdrejtë, por kalimi bëhet përmes karaktereve, zbuluesve të “Shakasë së ndaluar”, plakut dhe Anthullës, që e kthen rrëfimin tek shkrimtari:

- Qenka pa moral! Pusht qenka! E heqka veten letrar! Mirë ia kanë bërë që e kanë dënuar! - tha Anthulla dhe u ngrit”.

Në mënyrë të skematizuar shkallët e autorësisë në romanin “Arka e djallit” dhe të mbivendosjes së teksteve gjegjës do të ishin:

nr	Vepra	Autori	Raporti me tekstin autorial
1.	<i>Arka e djallit</i>	Dritëro Agolli	Tekst autorial.
2.	<i>Shakaja e ndaluar</i>	Bamkë Dynjaja	Intertekst I, që i brendashkruhet romanit të autorit.
3.	Dy letra ⁴⁸	Maxhuni i Bilishtit	Intertekst II, që i brendashkruhet romanit të autorit.
4.	Fragment ⁴⁹	Fletorja e dytë e Bamkë Dynjasë	Intertekst III, që i brendashkruhet romanit të autorit.
5.	Aforizmat ⁵⁰	Cute Babulja	Intertekst I, brendashkruar romanit të fshehur.
6.	Rapsoditë në formë - rikrijimesh ⁵¹	Cute Babulja	Intertekst II, i brendashkruhet romanit të fshehur.
7.	Rapsodi popullore ⁵²	Cute Babulja	Intertekst III, i brendashkruhet romanit të fshehur dhe pjesërisht tekstit autorial.
8.	Rapsoditë ⁵³	Gjok Çoku	Intertekst IV, i brendashkruhet romanit të fshehur.

48 Përshkruhet në një stil denoncues udhëtimi i dytë i Cute Babules. Letra e parë për gostitë dhe zifafetet e Cute Babules në fshat, f. 109. Fragmenti në trajtë rrëfimi - pjesë prej fletores së dytë të humbur të Bamkë Dynjasë, ruajtur prej Maxhunit të Bilishtit, episodi i parodisë me tufëzimin, f. 241. Letra e dytë, përsëri përqeshje e tufëzimit, f. 382-399.

49 Shih shenjimin paraardhës.

50 Paraqiten në autorësi të drejtpërdrejtë të Cute Babules si ligjërim gojor: f. 92-96. Një koleksion i dytë - tre cikle aformizmash (shoqërore, politike dhe kulturore), i brendashkruhen romanit të ndaluar si tekste të shkruara në bllokun e Cute Babules, f. 328-331. Rasti i vetëm kur Mitro Karapataqi shenjohej si ndërmjetës (i padëshiruar, kurreshtar, tinëzar) i mendimeve të autorit. Krhs me këtë karakter Zyrap Kandin në **Kalorësi lakuriq** dhe vetë Mitro Karapataqin prej romanit **Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo**. Të dyve u pranëvihen dy karaktere të ngjashëm: Sotir Kucka e Adnan Abrashi.

⁵¹ *Lulushja e kapedanit*, f. 52; *Lepurush, o lepurush*, f. 247; *Zerdeli në portë*, f. 384.

⁵² Gjenden me shumicë në të dy tekstet.

9.	Rikrijime ⁵⁴	Cute Babulja	Intertekst V, i brendashkruhet romanit të fshehur.
10	Rikrijime II ⁵⁵	Cute Babulja	Intertekst VI, i brendashkruhet romanit të fshehur.
11	Artikull në <i>Vorioepi-riotis</i> ⁵⁶	Pa autor	Intertekst VII, i brendashkruhet romanit të fshehur.
12	Artikull në <i>Bütün Dünya</i> ⁵⁷	Mehmet Durgutoglu	Intertekst VIII, i brendashkruhet romanit të fshehur.
13	Artikuj në <i>Cumhurriyet</i> , ⁵⁸ <i>Meclis</i> , ⁵⁹ <i>Sport</i> ⁶⁰	Pa autorë	Intertekst IX, i brenda-shkruhet romanit të fshehur.
14	Artikull në <i>Herald Tribune</i> ⁶¹	Bob Cesterfild	Intertekst X, i brenda-shkruhet romanit të fshehur.

⁵³ *Çka me pa e çka me thanë*, rapsodi humoristike për modën, f. 37; *Nj'ai prag i ngrohtë i Bamkës*, rapsodi për mikpritjen kushtuar mikut Bamkë Dynjaja, f. 85; *Përmbi male shkrep agimi*, rapsodi optimiste për tufëzimin (në stilin e Gjok Çokut), f. 251; "*Çka me pa e çka me thanë / për njat horr Bamkë Dynjanë*" (bis, pas rënies), f. 423. Krhs gjithashtu karakterin e Dane Gajtani dhe poezitë/bejtet e tij në romanin **Kalorësi lakuriq**: *Në studion me libra të rrallë, M'u shfaqën në ëndërr nja tri hije, Tufëzim, ngjitje në shkallën e lartë të qiellit, Jam flutur e natës rreth llambës, M'u shkrep të mbaj një kumtesë, Të mora të rritesh i gjallë, Kur ikja larg, drejt teje vija, Vërtitet një re e zezë mbi botë, Ju flamujt e mi, lamtumirë dhe shartime të tjera të poezisë me prozën*". Në disa raste Gjok Çoku paraqitet si alter ego e shkrimtarit. Shih, për shembull, poezinë që i brendashkruhet artikullit të mirënjohur të D. Agollit *Traditë, natyrisht, por jo shtampë*, ku autori përqesh poezinë e vjetër folklorizante: "*Cucat dibrane posi dhi t'egra / lëvrijnë në punë si blea / Këndojnë djelmoçat kangë kolonjare / e mali vrik ia kthen / Përkundruell fshatit ia nisin çupat / e kanga i rrëmben / Përgjigjen ambël dhe mirditorët / ushton lugina mbarë / Në punë sot doli me kangë e valle / gjithë populli shqiptar / Ç'i duam ne zanat e shtojzovallet / të gjalla ja ku janë / Dragojt, që tmerrshëm sulmojnë kuçedrën / këtu kanë ardhë të tanë*". Shih D. Agolli, art. cit., botuar në **Drita**, 27 gusht dhe 3 shtator 1961.

⁵⁴ Një shumicë dialogjesh dhe inkursionesh filozofike të Cute Babules shtjellohen në formën e rrëfimeve popullore me shembëllyra, përmes aktualizimit të ngjarjeve historike të ndodhura e të përshkruara në këngë historike etj.

⁵⁵ "*Mëmëdhe quhetë toka*" (variacion humoristik sipas poezisë së Çajupit), f. 144; "*Të gjitha dashuritë janë ura për dashurinë hyjnore*" (variacion në prozë i vargjeve të Rumiut), f. 203; "*Si Lindja, ashtu dhe Perëndimi, janë të Allahut*" (perifrazim në prozë i masnavisë së Rumiut), f. 205. Masnavi të tjera të Rumiut përshatën në formë proverbash shqip në f. 231. "*O sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia*", variacion humoristik mbi vargjet e Naimit - parodi për tufëzimin, f. 247. Për praninë e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të masnavive dhe filozofisë së Rumiut në këtë roman shih: Shaban Sinani, *Personaliteti i Rumiut në romanin "Arka e djallit"*, në **Perla**, 2007/4, f. 117-126.

⁵⁶ "*Skandal shqiptarçe*", f. 164-165.

⁵⁷ Me titull në gjuhën turke dhe një paragraf të cituar pa përkthim: "*Sema, yi ilmi yonden tektik ettigi ...*", f. 208, perifrastuar më tej shqip në f. 220-222.

⁵⁸ "*Tre dogmatikë arnautë në grindje në mes të kullës së Gallatës. I katërti me kokë të lidhur nëpër Stamboll*", f. 347.

⁵⁹ "*Arnautët zullmqarë të femrave, dinsëzë, të pasajdisur dhe sojsëzë*", f. 347.

⁶⁰ "*Pehlivani karagoz, arnauti Cute Babule*", f. 347.

15	Letër ndjese ⁶²	Forja, shoferi	Intertekst XI, i brenda-shkruhet romanit të fshehur.
16	<i>Shakaja e ndaluar</i>	Sherif Abeceja ⁶³	Kërkues i dorëshkrimit
17	<i>Shakaja e ndaluar</i>	Spiro Arhitari	Fshehës i dorëshkrimit
18	<i>Shakaja e ndaluar</i>	Anthulla, mësuesi ⁶⁴	Lexuesit e parë, komentues
19	<i>Shakaja e ndaluar</i>	Hyskë Borobojka	Autor i munguar.

Narratorët shfaqen në shkallë të ndryshme hierarkie ndaj autorit vetë, ashtu si dhe shkallët e ndryshme të ndërtekstorësisë:

Autori	Narratori	Shkalla e hierarkisë
Dritëro Agolli	Bamkë Dynjaja	Alter ego - empati, heteronim i autorit
Dritëro Agolli	Sherif Abeceja	Pjesërisht I. Kadare ⁶⁵ - pjesërisht alter ego - heteronim
Dritëro Agolli	Cute Babulja	Pjesërisht alter ego, pjesërisht vijim i karakterit të Zylos ⁶⁶
Dritëro Agolli	Maxhuni i Bilishtit	Raport përjashtues
Dritëro Agolli	Naimi, Rumi, Çajupi	Raport mbivendosjeje ⁶⁷
Dritëro Agolli	Xhibilet Xhibiletovi	Raport përjashtues
Dritëro Agolli	Gjok Çoku	Raportet alternohen - humor, refuzim
Dritëro Agolli	Folklori i ri	Raport refuzues
Dritëro Agolli	Forja (letra)	Thuaje alter ego
Dritëro Agolli	Anonim, gazeta <i>Vorioepiriotis</i>	Raport satirizues
Dritëro Agolli	Anonim, gazeta turke <i>Bütün</i>	Raport satirizues

61 “*Shqiptari i çuditshëm Cute Babulja pushton kullën e Gallatës*”, f. 346.

62 “*Arka e djallit*”, Tiranë 1996, f. 353. Të gjitha citimet janë prej këtij botimi.

63 Ky karakter del qysh në fragmentet e botuara në “*Hosteni*” prej romanit “*Kalorësi lakuriq*”. Për ngjashmërinë e tij në dy romanet shih: D. Agolli, vep. cit..

64 Shkallë të ndryshme autorësie dhe narracioni bartin dhe dy karakteret e tjerë, Anthulla dhe mësuesi Selman Thana, lexuesit e romanit në dorëshkrim dhe njëherësh rrëfyes në formë rithënëse të përmbytjes së tij.

65 Shih të njëjtin karakter në “*Kalorësi lakuriq*”. Krhs gjithashtu pasionin rinor të I. Kadaresë për zbulimin e dorëshkrimeve të vjetra në “*Ditë kafenesh*”, kërkimin e tij dhe të miqve të rinisë për veprën e humbur të A. Z. Çajupit “*Këngë e vome*”.

66 Krhs pasionin e dy karaktereve - Zylo Kamberit dhe Cute Babules - për aforizmat, esetë dhe *esquise*-t, që edhe në romanin “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*” kanë pavarësi formale. Në romanin “*Arka e djallit*” karakteret përveçohen dhe në raport me prototipat, por, siç u shpjegua më herët, në këtë studim raporti i shkrimtarit me karakterin shihet kryesisht si raport i autorit me narratorin. Sa i takon raportit karakter-protagonit, D. Agolli, në pashënien e romanit të vet, me titull “*Pak histori dhe pak kujtesë për lexuesin*”, në *Arka e djallit*, Tiranë 2007, f. 459, Cute Babulen e njëson me mikun e tij gazetar Sotir Papuli. Ligjërimi i Cute Babules si autor aforizmesh, esesh (fr. “*essais*”), eskizesh (fr. “*esquise*”) njësohet deri në barazim me ligjërimin e shkrimtarit edhe në intervistën humoristike “*Pyesim shkurt për të qeshur gjatë...*”, botuar në *Drita*, 1 janar 1984: “*Po të këshilloheshin dhentë me dhitë, do ta mbanin bishtin përpjetë*”; “*Qimja në kokë nuk bëhet tra, koka bëhet tra*”; “*Mos i jepni frazës të pijë shumë ujë, se fryhet e dembeloset*”; “*Fleta është e lehtë, por mban lirin*”; “*Llafazani ka dy gjuhë: një të tijën dhe një të shokut*”; “*Heshija është flori, por jo në provime*”.


67 Më gjerë te Sh. Sinani, *Personaliteti i Rumiut në romanin “Arka e djallit” të Dritëro Agollit*, në *Perla* 2007/4, f. 117-126.

	<i>Dünya</i>	
Dritëro Agolli	Mehmet Durgutoglu, <i>Cumhuriyet</i>	Raport satirizues
Dritëro Agolli	Bob Chesterfield, <i>Herald Tribune</i>	Raport afrie, simpatie

Mund të thuhet se një nga arsyet që autori e ka deleguar autorësinë e vet në një shumësi zërash është një procedë e përsëritur tek D. Agolli, i cili në të njëjtën mënyrë, polifonike, e realizon dhe romanin “Komisari Memo”, në të cilin jeta e komisarit zbulohet me ndërmjetësimin e karaktereve të romanit, kapitull pas kapitulli.

Shkallët e ndryshme të autorësisë së deleguar, prej alterimit (krijimit të alter ego-ve, të pjesshme e të plota) dhe mbivendosjes, deri tek narratori kundërshtar, e kanë ndihmuar shkrimtarin të krijojë një profilaksi për romanin e vet të ndaluar, por njëkohësisht kjo kthehet në një vlerë të papërsëritshme të ligjërimit dhe ndërtekstorësisë.

Ndryshe prej romaneve të I. Kadaresë, ku ndërtekstorësia vjen në formën e stileve të ndryshme të ligjërimit (ditare, kronika, pjesë nga shtypi, perifrazime të autorëve të vjetër), në romanin “Arka e djallit” kryesisht shtegton veta e ligjërimit dhe ndryshohet ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë. Në fund të fundit, gjithë teksti është i autorit, pavarësisht se cili prej karaktereve të tij është ftuar të luajë rolin e narratorit. Kështu shkrimtari e vë veten në provën e alternimit të stilit: nga shkrimtar parimor në shkrimtar kritik (e ndoshta të ndaluar), nga Ezop në Nastradin, nga një kërkues province në një njeri të lirë në metropol, nga letrashkrues vullnetar në rapsod, nga rapsod në folklorizant, nga gazetar provincial vorioepirotas në një gazetar sensacional turk, nga studiues konformist sovjetik në një gazetar liberal amerikan, nga kërkues dorëshkrimesh në rrezikues dorëshkrimesh, nga lexues i parë në botues. Kjo nuk është diçka e papërsëritshme në krijimtarinë e D. Agollit. Në gusht të vitit 1998 kam pasur rastin të dëgjoj prej tij një mbrëmje festive në Çorovodë improvizimin e një poezie me hardhinë, hënën, verën dhe njeriun në stilin e simbolistëve, romantikëve, sentimentalistëve, natyralistëve, verizmit, neorealizmit, formalistëve rusë, realizmit socialist dhe në disa forma të tjera. E gjitha kjo ndodhi brenda 30 minutash, me një gotë verë në duar dhe me një tryezë të mbushur plot me miq, një prej të cilëve dhe unë. Por, të nesërmen në mëngjes, as autori, as ndokush prej të pranishmëve, për fat të keq, këto poezi nuk i mbante mend ...



Përmes shkallëve të ndryshme të tejçuarjes së autorësisë: dyts, heteronim, alter ego, mbivendosje e pjesshme, bashkautorësi, bashkautorësi me karaktere të veprave të mëparshme, citime, citime të perifrazuara, ligjëratë e drejtë, ligjëratë e drejtë e pamirëfilltë, ligjëratë e zhdrejtë, perifraksim, rikrijim në stilin e një tradite, kundërtëkst (autorësi e refuzuar), satirizim, humor miqësor, empati, simpati - shkrimtari jo vetëm përcakton raportet e veta me karakteret, por u mundëson lexuesve të kenë në duar një vepër polistilistike, shumëzërëshe, polifonike, teknikisht të realizuar si një palimpsest.

Në këtë vepër, ndryshe prej palimpsesteve klasikë, ku shtresa i mbivendoset shtresës, këtu autorësia i brendashkruhet autorësisë, duke formuar kështu një shumësi rrathësh të valëzuar horizontalisht. Ndërtëkstoria është tipologjikisht dyllorëshe: ashtu siç kuptohet sot në studimet teorike, si “kujtesë e tekstit të tjetrit”, proces i përjetshëm rikrijimi; dhe njëherësh një ndërtekstorësi e provuar përmes delegimit të autorësisë apo alterimit të krijuesit.

Shaban SINANI, Centre for Albanian Studies, Tirana

“FORBIDDEN JOKE” OR “HIDDEN NOVEL”

Summary

The devil's box contains a novel within the novel. The author called it “Forbidden Joke” or “The man who is not allowed to laugh”, and this recalls M. Kundëra's (also) forbidden “Joke”. The authorship alterity indicates the phenomenon of experimenting several forms and stages of intertextuality. The multistage authorship is also an expression of technical combination of pre-text, intertext, hypotext and peritext. In the controlled societies, the author had to think about a prophylaxis of the work and to stay vigilant. One of the known ways was presentation of full works as casual or uncompleted fragments. The escape from authorship in the hidden novel can be one of these efforts. Different stages of delegated authorship, from alterity (creation of alter ego-s, partial or full) and superposition up to the opponent narrator, helped the writer to do a masterwork, from the textual and speech aspect. Unlike I. Kadare's novels in which intertextuality comes in the form of different styles of speech (diaries, chronicles, press clippings, periphrases of old authors), in the novel “Devil's box” mainly peregrinates a common form of speech. The writer tries to alternate the style: from a writer who writes based on principles into a critical writer (perhaps forbidden), from Aesop to Nastradin, from a provincial researcher into a free metropolitan man, from a letter writing volunteer into a rhapsodist, from a rhapsodist into a folklorist, from a journalist from Northern Epirus into a sensational Turkish journalist, from a Soviet conformist scholar into an American liberal scholar. Through different stages of the transfer of authorship: heteronyms, alter ego, partial superposition, co-authorship, co-authorship with characters of previous works, quotations, periphrastic quotations, direct speech, improper direct speech, indirect speech, periphrasis, re-creation in the style of a tradition, counter-text (refused authorship), satirization, friendly humor, empathy, sympathy-the writer not only that determines his relations with the characters but also enables readers to have in their hands a stylistic, polyphonic and realized work as a palimpsest. Unlike classic palimpsests, the intertextuality here is typologically of two kinds: as “memory of the other's text” and delegation of authorship or alterity of the author.

Abdullah ZYMBERI, Universiteti i Prishtinës

LEKSIKU TE VEPRAT E PORADECIT

KUD 811.18-26

Te veprat e Lasgush Poradecit ndeshet një shtresë e pastër dhe e pasur leksikore me burim të shqipes. Një pjesë bukur e mirë e kësaj shtrese leksikore ka mbetur pa u përfshirë te *Fjalori i Gjuhës Shqipe* (Tiranë, 2006).

Lasgush Poradeci i këndon shqipes dhe shqiptarizms. Këtë vjer-shërim e mvësh me fjalë të shqipes, e mvësh me një laryshi parashtesash e prapashtesash dhe me mënyra të tjera të fjalëformimit si pakkush tjetër. Ai i ikën të përdorurit të fjalës së huaj dhe përherë e vë në ballë fjalën shqipe.

Përderisa ndajfolja e burimit grek *tani* dhe shprehja ndajfoljore *tani për tani* kanë gjetur përdorim në Fjalor, te Poradeci rron ndajfolja me bu-rim të shqipes – *tashi- tashti* dhe shprehja ndajfoljore *tashti për tashti*:

Po tashi: Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri.... Tashi ah! Dje-lli vate e shkoj. Kështu dhe – tashti – për çështjen e çlirimit kishtar të orto-doksizms Naçua Vendosi, si rendërisht, njëherë e mirë ta kapë demin prej brirësh (f. 441). Veprimin e tyre ata e kishin përfunduar tashti për tashti, duke shtypur abetare, dhe duke i shpërndarë dhe përhapur në Rumani, Shqipëri dhe kudo gjetiu që mundnin (f. 386). ... më s'jepte tashti për tashti shenja të hapta ringjalljeje dhe pra as kish nevojë ushqimi libror nga ana e Kolonisë (f. 408).

Fjala e burimit turk *dyqan* ka përdorim të gjerë, kurse Poradeci përdorte fjalën e burimit shqip *tregtore*:

*Puna e tij ishte detyra e përditshme e djersës së ballit të tij në tregtoren e një atdhetari...(374). Poradeci nuk e ka përdorur as fol. e burimit sllav – bisedoj -, por atë me burim latin – kuvendoj, si: Më kuvendo me zë të tretur (135). ... për të cilët miku i tij i kuvendonte se kishin filluar të loznin nga vendi pas bujës së lidhjes së Prizrenit.. (f. 423). Sot e ka marrë dhenë në të folurit e përditshëm fjala e burimit turk *ajran*, ndërsa poeti ynë para sa kohe e përdorte fjalën e burimit shqip – dhallë, si: Kosi, atij, i ngjan me dhallë të trashë (18).*

Nga sistemi emëror leksikor kemi veçuar: femërorët që dalin me prapashtesën -ëz(z)(ë), si:

...një mjergullëz e re (149), ...ma çik qepallëzën e fjetur (135), ...moj motërza bujare (127), ...e që gojëzën e hapi, ... nëpër bimëzat e tyre(7), ..Unë shoh me gas të qetë këngëzën e përvëluar (17), ... Zotëriut q'i la folezën(41), ... Lyen pushkëzën e vjetër (43), ...nër njato lëndinëza(67), Si qesh një foshnjë e vogël me lodrëzat e veta(74), E ritet... ritet mi gropëzën e shkret(92), Dridhet mun në fund të ti zembërëz' e vrrarë(95), T'i fry napëzën anijes, T'i shty lundrëzën njeriut(104), Lëshon gropëza nër faqe (153), Ja! Dhe shkollëza mitare(155), Kur për herëzën e parë vetë filli ti më poqe(157), O klithmëz e tingëllit t'im(167), Nënë thembërëzat e tua përgëzohet trendelina(173) etj.

Mashkullorët me prapashtesën -th, si: "Në vallthin blerimtar plot dumbushere"(VL 330). "Ndjej vajtimthin e një shpesi" (VL, 87). "Bukuri e Mëmëdhethit do të ngjante e pashijuar" (29)

Pra, me prapashtesën e zvogëlimit -th Poradeci ka sajuar pak fjalë.

c) Asnjansësit qoftë prejmbiemërorë të emëruar, qoftë prejpjesorë të emëruar, si:

<i>Të pat falur dashurija në të qarët, (f.8)</i>	<i>...dit' e nat' i lodhe ballet, (29)</i>
<i>Vallë- a mos u ndreq të folët, (29)</i>	<i>Qan e heq në të kënduar, (31)</i>
<i>Ndaj shëmtion fjal' e të folur, (31)</i>	<i>E pse dot më s'gjet të prehur, (31)</i>
<i>Bubu! Shtatë jetas të kam për të gjetur (57)</i>	<i>Po me t'u ndarë vet e vet, (71)</i>
<i>E s'kam të keqtë- e shpirtit ah!, (74)</i>	<i>Kjo ditë lumtërie që muku ka të ngjarë. (75)</i>
<i>Kur vjen të mugëtit e qetë., (77)</i>	<i>Mos bëj të keq, (79)</i>
<i>Pa të pandehur nat'- për-natë; (79)</i>	<i>M'a ndrit me një të parë fytyrën, (84)</i>
<i>...pa të sosur, pa njomë kurrëkund (85)</i>	<i>Të ritë- e viteve të mi (titulli i poezisë), (87)</i>
<i>.....me kaq të ngjethur të pafaj (89)</i>	<i>...q' e treti në të ri, (92)</i>
<i>Breng që s'ka të ngjarë, (95)</i>	<i>E si kurrë s'ka të shuar, (97)</i>
<i>Marr të rëndët që përdhe, (103)</i>	<i>Marr të fellët nënë dhe, (103)</i>
<i>C'u mbush sheshi me të pare, (45)</i>	<i>Kush e dha për të kremtuar, ... (148)</i>
<i>Ti na dhe për të kremtuar, (148)</i>	<i>Kombin për t'a kombësuar, .. (149)</i>
<i>Shqipen për t'a shqipëzuar, (149)</i>	<i>Se të kam për të pushtuar, .. (159)</i>
<i>E së-rish ah! me t'u ndarë, (164)</i>	<i>Ndrin Yll' i të riturit t'im, .. (180)</i>
<i>Zbret Yll' i të riturit t'im, (181)</i>	<i>Kur të pashë për të vluar, (189)</i>
<i>Ti bën një vrap për t'udhëtuar, (205)</i>	<i>E pa t'u tharë pika lot, (205)</i>
<i>Edhe shpejt kur me të dalë, (214)</i>	<i>Pa të kundroj si bën të shkruar nër ato rrugë, (237)</i>
<i>Që me t'u ndezur flak' e ditës, (259)</i>	<i>...me t'-u përgjigjur vetvetiu, . (261)</i>
<i>Lulet lulëzuan... me të parë djellë, (263)</i>	<i>I mburrej vesa lotit me një të shkrepur, (266)</i>
<i>Dhe bën sulm për t'u përfytyr, (285)</i>	<i>Për t'u therrur, për t'u mbytur, (285)</i>
<i>Shokët për t'i përqafuar, (285)</i>	<i>Nuk di lot, nuk di të qarë, (286)</i>
<i>Për t'i tundur, për t'i shkundur, (325)</i>	<i>Mundësi për t'u fjalosur, (325)</i>
<i>Tru e mënd për të menduar, (325)</i>	<i>Përmbi fron për të më mbajtur, (328)</i>
<i>Populli ka për t'u ngritur, (328)</i>	<i>Posi bar për t'i kositur, (328)</i>

Plot duft për të luftuar, (354)

Kosovës për t'iu falë, (354)

Që vjen për t'u dëshmuar, (354)

Gati për të sulmuar, (360)

Ç) Disa emërzime kompozitash mbiemërore, si:

E shastisur po nga flaka pendëshkruarëza flutur (V.1.32)/ Se ç'm'i shkel balukprera këto kopshte ku fryn era (V.1.51)/ Un' hijemvrëjturi në zi, Ti flokëndritura flori (V.1.227)/ Ah! lesh-verdhëza –si- ftua,/ Gji-mburuara- si- krua,/ Shtat-lëkundura- pallua,/ Më ka përvëlur mua. (V.1, f. 187)/ Të kërкова me qiri,/ Mes-këputura – gargi (V.1.f. 216)/ Del me vrap, as del përjashta/ Ti moj sykaprolleja! (VL. F. 122)

d) Disa emra me prejardhje parashteso-prapashtesore. Nga ky tip prejardhjeje kemi veçuar emrat: *përbrendësi, përjashtësi, përzjarrje, paemërsi dhe çpemëzim*. Ja pak shembuj:

Bashkohesh brenda me përjashtësi,/ Bashkohesh jashta me përbrëndësi (215)

... duke mbetur së jashtmi në paemërsi (anonimat) (436).

Mbulon mërisht përzjarrjen në të parë (256).

një lëmë të përshtatur çpemëzimi politik kundër-shqiptar(440).

Sa bukur e ka sajuar Poradeci fjalën – *paemërsi* (për -anonim, anonimat)! Edhe nga ndajfoljet *jashtë* dhe *brenda* i ka sajuar femërorët – *përjashtësi* (ana e jashtme, nga ana e jashtme) dhe *përbrëndësi* (ana e brendshme, nga ana e brendshme).

dh) Disa emra me prejardhje prapashtesore. Nga ky nëntip prejardhjeje i kemi veçuar këta emra: *meshim, ndalestar, pendëtar, mjaftësi* etj. Ja disa shembuj:

Atje, në kërkesën e bërë për qeverinë qëllimi kishte qënë thjeshtësisht lypja dhe dhënia e së drejtës së meshimit shqip. (f.444)/ ... i cili po përgatitej të ndahej nga vargonjtë e shumtë ndalestarë (pengues) drejt mëvetësisë së tij kombëtare dhe shtetërore(445)/ Gjuha greke dhe gjuha turke, tehu i dyanshëm i shpatës kanosëse mbi kombësinë e shqiptarit, u muar vlerësisht në shërbim nga pendëatrëti e Rilindjes për qëllimin fundor.(390)/ ...mbi mënyrën e punës dhe mjaftësinë e propagandës...(392).

Emrin *meshë* e ka Fjalori i Shqipes, mirëpo mashkullori *meshim* i mungon. Edhe emri *mjaftësi*, dalë nga ndajfolja *mjaft*, është një krijim i autorit që do të duhej të futej në Fjalorin e shqipes. Edhe fjala *ndalestar* na duket me interes, sepse autori e ka përdorur si sinonim të

fjalës *pengues*. Kjo fjalë nga ana morfemore do zbërthyer kështu: *ndal-es-tar*.

Për fjalën *lukuni* e ka përdorur sinonimin *zhgan*, si: *Në greminat e Kalasë/ Zu po vjen një zhgan gjermanë* (294).

Nga sistemi mbiemëror kemi veçuar: a) Fjalën – *e greminuar*, si: *E greminuar si rrufe/ Kjo jeta ime* (248).

Fjalori e ka emrin *greminë*, mirëpo mbiemri i mungon. Poradeci e ka përdorur edhe foljen *greminoj*. Autori ynë sajton qëllimshëm sinonime leksikore edhe në fushën e mbiemrave. Po përmendim këtu fjalën *lindjak*, formuar me prapashtesën *-ak* “Këtë thënie përkëdheljeje të vendit të tij lindjak e dëgjoi aty pranë Nikolla Naçua dhe qeshi nën buzë” (422). Leksemën mbiemërore *i, e zjarrtë* Poradeci e përdor me formën *i, e zjarrshëm-shme*: “të heshtur dhe të zjarrshme shqiptare” (485). Fjalori e ka emrin *gjurmë* dhe foljen *gjurmoj*, mirëpo i mungon fjala mbiemërore *i, e gjurmshëm-shme*: “Shkaku i mosveprimit të saj – të gjurmshëm – varet prej gjindjes së udhëheqësve, të cilët s’i jepnin drejtim shpirtëror dhe punë lëndore për të kryer” (430). Poradeci formon leksema mbiemërore *përbind* (çuditërisht): „Ky atdhetar i pamërshtëm (i panjohur në masë) është Gjergj Naçua i Piteshit” (424). Fjalorit, si zakonisht, i mungon.

b) Disa leksema mbiemërore të nyjshme (mbiemra të nyjshëm + prapashtesa dhe parashtesa të ndryshme), si:

i atdheshëm, e perëndishme, e shkretëtirtë, i përbujshëm, i këqyrshëm, e sulur, e vdarë, e skëtërruar, i natuar, i përikur, i parasjellë, i çdohershëm, i bashkëkohshëm, i përndershëm, e përmbivarrshme, i llaftarisur, i shkrepëtimtë, i dimëruar etj.

Ja disa shembuj: “... me frymëzimin e fjalës së perëndishme dhe të atdheshme të qëllimit të tij prej misionari.

Vdiq nepërka pikëlore ndaj blatisht e shkretëtirtë (86)./ *Që prej zallit të përbujshëm/ Nisen lundrat levorashe* (92)./ *O ju qiej shkretëtirash tej-përtej aq të këqyrshëm* (93)./ *E sakaq dëshir e sulur/ gushë e faqe t’i përflaku/ Unë mbeta krye-ulur, / Varfanjaku* (166)./ *Gjuh’ e ëmbël e stërgjiyshve do të dukej gjuh’ e vdarë*(73)/ *Do të dukej i skëtërruar më një mjegull zemërate*(73)./ *Nga varr i natuar/ Del flakë e harbuar* (253)./ *Si mërgimtar i përikur që ishte* (424)./ *Eshtë adhurimi i Kombit, i parasjellë në altarin e faltores së Dërgimtarëve të tij nga më të parët* (367)./ *Vërtet, asnjë nga*

shoqëritë e çdohershme, duke mbaruar gjasërisht, nuk heshti fare me atë lloj mbarimi ose zëvendësimi. (415)./ ... kurse anasjelltas historiografimi i saj i dokumentuar do kthjelltësojë në burimin e vetë të bashkëkohshëm (375)/ Vasil Zografi ia tërheq mendimin atit të përndershëm rreth At-dheut... (359)./ Që nga tumbë e përmbivarrshme ku do shihje për-matanë (73). Kur të pashë si perri/ Mbeta i llaftarisur(261)./ Me vështrim të shkrepëtimtë/ Alurin mbi shkëmb çakalli (89)./ Ndaj po zbardhet dal-nga-dale/ Kjo krahinë e dimëruar (88).

Asnjërën nga këto leksema mbiemërore nuk e ka Fjalori i 2006-ës.

Disa leksema mbiemërore sajuar me prapashtesa, si: *voglore, vetore, vullkanor, nënore, rastore, shokërishte, vetëtimtare, rrotullore, brymarake, dhemshurishte, vraparake, mjerush, verbimtar, buçimtar* etj.

Ja shembujt nga Poradeci:

...për nevoja voglore të radhës së dytë (426)./ Ndërsa fitimet vetore Nikolla Naçua në kohën e vdekjes i kishte prishur që të gjitha, sepse i derdhte menjëherë në dobi të çështjes kombëtare... (425)./ Atë butësi natyre Gjergj Naçua ia kushtoi të vëllait vullkanor Nikolla Naços (425)./ ... në gjuhën e ëmbël nënore... (373)/ ...kam shënuar se shtytja rastore për të bërë atë himn pat ardhur prej korit të kishës shqipe të Bukureshtit(373)./ Bënte botën zilitare/ Zembr'e bukur shokërishte" (230)./ O zjarr që më përflakesh si yll vetëtimtar(60)./ Me dritat varg e varg/ Vetëtimtare(325)/ Ajo endej nëpër qiej,/ Nëpër sferat rrotullore (299)./ Prej së lartrash brymarake/ Ze-i përhap dëbora fjetet (88)./ Syt' e tu – shkëlqim gazmuar i skëterrës dhemshurishte(130)./ E flakën vraparake nër kraha do ta marr(60)./ Fjalim' i mallit tim mjerush (54)./ Si pah verbimtar i dëborës/ Sërish po më ndrin një pluhur (175).

Shënim: nuk gjenden te Fjalori i Gjuhës Shipe (Tiranë, 2006).

ç) Disa kompozita leksikore mbiemërore:

Ky sistem është mjaft i pasur me kompozita leksikore, si: *bukuriplote, gjëmëplot, zemërvalë, krahfluturushe, syvetullushe, syperënduar, syqengjërushë, llërëkulluar, gjibardhoshe, kujtimmirë, qepallë-lënduar, truenitur, shpirtluaneshë, dëshirëplot, famëmirë, fat-miroshë*. Nuk gjenden te Fjalori i Gjuhës shqipe (2006).

Ja disa shembuj nga Poradeci:

Që lind e ndritur krejt/ Bukuriplote (258)./ Buçimi gjëmëplot / I zemrës sime (347)./ Vështruar sy ndër sy,/ zemërë-valë (333)./ Në krah më flutu-

ron/ Krahfluturushe (339)./ Me sy me vetullon/ Sy-vetullushe (339)./ Push-tuar gj- për- gj-/ Sy-perënduar (333)./ M'hedh sytë kur-e-kur,/ Sy-qengjërushë (341)./ E hepura si bar/ Llërë-kulluar (340)./ Gush e llërë e gj-bardhoshe (199)./ Nga ças- i ditës kujtimmirë (136)./ E nj'aty një tru-venitur që mban dije për një fije (77)./ ...Kjo, që e kish emrin Taso dhe ish një shpirtluaneshë (419). / ... për fshatrat famëmira ku janë hapur ose atje ku mësohej gjuha shqip(400)./ Sesa i pashëmbëllyer, sesa dëshirëplot/ Zu të ma njomë syrin një varg prej pikash lot!..(150). Ha! Fjala fat-miroshe... (150).

Nga sistemi numëror kemi veçuar numërorin e gjinisë femërore tri me prapashtesën e zvogëlimit – zë, si: *Me ç'fuqi t'i shkruash, kur lodhesh vetëm pasi pate sgermitur dy a trizë fjalë?*

Poradeci e ka përdorur dendur prapashtesën e zvogëlimit -zë, pra, edhe te përemri – tri. *Se a e ka bërë këtë për shkak tingëllimash ... vetëm një Zot mund ta dijë!*

Nga sistemi foljor leksikor kemi veçuar disa fjalë me parashtesat për-, ç-, ndër-, si: *përvajtoj, përshebjet, përshekrep, përpikësoj, përlavduroj, çmaskoj, çrobëroj, ndërmendoj.*

Ja disa shembuj kontekstesh nga Poradeci:

Dy shpirtnat përmi ne/ më përvajtojnë(339)./ E ja! Përshebjet vrap i lik/ E bje përmbys përgjithënjë (232)./ Në zemrën time ca kujtime/ gjith ma përshekrepin dashurinë (265). / Këto cilësime rreth misionit të Naços me “Dritën” e tij, dhe të “Diturisë”, duhen theksuar mes fakteve gjer të përpikësohet më së miri fytyra e Kolonisë, për elementet historike të saj (416)./ ... shembull i cili përlavduron me të drejtë njëkohësisht autorin dhe qytetin tradicional të Jugut (367)/ ...kurse ai çmaskonte vetvetiu me atë përgjigjen e tij/ vrasëse (244). / ...kur këtheheshin përsëri në atdheun e robëruar për t'a çrobëruar me pushkë në dorë... (84).

Fjala përpikësohet, të cilën Fjalori s'e ka fare, na thotë mendja, është sinonime e foljes - përcaktohet, ndërsa fjalët e tjera kanë marrë ngjyrimë të vockla kuptimore nga parashtesa – për. Edhe fjala *ndërmendoj* (për 'sjell ndër mend') është me mjaft peshë, sepse me këtë kuptim s'e ka Fjalori. Në disa të folme popullore me shumëfjalëshin – *ta qes nermën*.

Formimin e një fjale me siparashtesën – para: *parablej*.

Ja brenda kontekstit poradecian:

... biletat s'gjindeshin dot- ato parablimeshin me një etje të madhe... (90).

Kjo leksemë do futur ngutazi në mjetet i informacionit, sepse për të mund të gjenden shtigje përdorimi sa të duam.

Formimin e disa fjalëve me prapashtesat -0, (ë)so, (ë)-zo, si: *pedantëson, melodioj, sendësoj, shpirtëzoj, qjellëson, djellëson, botëson, kombëson, shqipëzon, çinçërron, llaftaroj, zjarrmoj, himnon, hepohet, fatësoj, greminon* etj. Ja disa shembuj të këtyre fjalëve kontekstesh të ndryshme nga Poradeci:

Ata më emëruan profesor, më pedantësuan obskurantërisht, po unë nuk u betova... (483).

... dyke sendësuar shpesh herë vepra më të kuximshme dhe më të rëndësishme (205).

Transfigurimi i Kutelit është toni unitar i përmallshëm në të cilin përshkohet fabula, gama minore që e shpirtëzon së gjithash fund e krejt me drithmën e saj,...(34).

Në det, që mendjen ty ta llaftaron,/ Në qjell, që mendjen ty ta qjellëson,/ Në djellë, mendjen që ta djellëson,/ Në botë, mendjen që ta botëson (217)./ Pate shkruar e punuar/ Kombin për ta kombësuar,/ Shqipen për ta shqipëzuar (106)./ Në lisa larg, po çinçërron gjinkalla(85)./ “Ay u zjarrmua me ardhjen e Luigj Gurakuqit dhe me mbledhjen madhështore të Shoqërisë,... (218). / Himnuan si n'altar, /Me himn të dliër (333)./ Njeriu i anijes përjetë/ Hepohet...anohet.... valon (222)./ Përveç kësaj, një masë e pamenduar mirë e Komitetit, gjatë mbledhjes, ish fatësuar ta shtojë që në fillim mosmarrëveshjen... (393)./ E greminohet si rrufë,/ Kjo jeta ime (276)./

ç) Foljen fundem pa ndajshtesa:

Drejt në zemër ndaj fundet/ Mall' i përvëluar (153).

d) Kompozitën – *keqflas*:

...u keqfol si agjent i Vllehëve –Maqedonas, sivëllezërve t'anë...(244).

Nga sistemi ndajfoljor i kemi veçuar disa fjalë që dalin me prapashtesën -(i)sht, si:

brëndërisht, çkëlqimërisht, çquarësisht, çpërblimërisht, dëshpërimisht, eminentërisht, estetikërisht, favorisht, filozofisht, finokërisht, fundërisht, guximtarisht, gjasërisht, gjeratërisht, gjithërisht, hundërisht,

imediataërisht, instinktërisht, jashtërendërisht, keqdashërisht, komikërisht, konfortërisht, krishtërisht, lavdërisht, lëndërisht, llaftarisht, majestetërisht, mjaftësisht, mistikërisht, nevojërisht, njëmënyrësisht, njëmendësisht, okcidentërisht, palcërisht, pasonjësisht, plotërisht, paligjërisht, pavarrursisht, pamunguarisht, papërgjigjësisht, përbotërisht, përfundërisht, prerërisht, prindërisht, qjellorisht, rëndërisht, rëndësisht, rrjedhësisht, stikërisht, studentërisht, shkëlqimërisht, shpirtërisht, shprehjesisht, shtëpijakërisht, vendërisht, vendimtarisht, vetërisht, vetëdashurisht, vetëkuptimërisht, virgjërisht, vlerësisht.

b) Disa ndajfolje dhe shprehje ndajfollore të kohës, si:

përvjet (dhe jo çdo vit), paras, tashi-tashti, dikurherë, djethnaj (ngadje), ditë për ditë (dhe jo -për çdo ditë), natë për natë (dhe jo- për çdo natë), tashti për tashti (dhe jo- tani për tani), mot për mot (dhe jo- për çdo mot), etj.

Ja disa shembuj nga Poradeci:

Në pritë e në mejdan përvjet (kështu edhe shumë të folme të Kosovës)/ Nga një pasha t'i vrasë (291)./ ... siç u shfaq paras në Bukuresht... (386)./ E si rron në gji të dherit dit-për-dit a nat-për-natë(48)./ Më çfaqesh n'ëngjëllim/ Si dikurherë (309)./ Djethnaj të dërgova një Nr.të "Shqipërisë së re"(481)./ ... që jipet mot për mot si çmim për letërsinë rumune(91)./ Veprimin e tyre ata e kishin përfunduar tashti për tashti, duke shtypur abetare...(386)./ Vdes përkohë e lind përjetë (236).

c) Disa leksema ndajfoljore (mënyre e vendi), dalë me prapashtesën - zë: *kështuzë, ashtuzë, këtuzë*. Ja disa shembuj nga Poradeci:

Ha! Tek bëj kështuzë,/ Hop! Të shoh këtuzë!/ Ha! Tek bën ashtuzë,/ Hop! Buzë-për-buzë. (230).

Këso leksemash ndajfoljore kemi ndeshur edhe në fshatin Burojë të Drenicës. Sipas mendimit tonë Poradeci e ka përdorur prapashtesën -zë edhe te sistemi ndajfoljor për shkaqe të ndryshme stilistike.

Me prapashtesën – *zaj, -za* si variante të prapashtesës -zë, dalin këto leksema ndajfoljore: *ëmbëlzaj, një vitzaj, njëditëzaj, tinzaj, këtejza* etj. Ja disa shembuj nga Poradeci:

Përmbi shkëmbenj ndaj pata pare/Të gdhëndur ëmbëlzaj një emër (269)./ ... d.m.th. shtypur po aty një vitëzaj gjithë ëmbëlsirën dhe/ gjithë hidhë-

rimin e dashurisë rastore të fatosit Till (12)./ T'a flasin mallin tinëzaj më-nj'-anë... (223)./ Kur të shkosh këtejza pranë/ Që të çmallërosh (246)./

Ç) Disa leksema ndajfoljore të vendit, si: *përposh, nj'atje, përdrejt, afërtas*. Ja shembujt nga Poradeci:

Kur hapet perëndimi pas maleve përposh... (81)./ Në hije të kasolles që nxin nj'atje mbi mal,... (63)./ Thonë, vjen përdrejt në Vlorë(145)./ ...aq afërtas prekur pas aq mundimesh (447).

Është me interes të përmendim se leksema ndajfoljore *përposh* është përdorur që te Buzuku e edhe sot e kësaj dite ka përdorim të gjerë në të folmen e Krajës. Leksema ndajfoljore *-atje*, përdorur te Poradeci me formën *nj'atje*, pra, me parashtesën *nj-* ka përdorim të dendur me të njëjtën formë edhe në viset shqiptare të Malit të Zi.

Në të përmbyllur të këtij vështrimi pa u hamendur mund të shtojmë se ajkën kryesore të fjalësit të veprave të Poradecit e kemi vjelë me përkushtim, mirëpo thellësitë e tjera kuptimore do t'u mbessin barrë brezave të ardhshëm. Poradeci mund të kundrohet nga shumë kënde.

Literatura:

Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006

Lasgush Poradeci: **Vepra letrare**, BT, Tiranë.

Lasgush Poradeci: **Vepra 1**, Onufri, Tiranë, 1999.

Lasgush Poradeci: **Vepra-2**, Onufri, Tiranë, 1999.

Abdullah ZYMBERI, University of Prishtina

THE LEXICON OF THE PORADECI'S WORKS

Summary

The stratum of words in Poradeci's works presents a richness of Albanian lexicography. The major part of this stratum of words hasn't been included into Albanian dictionaries. We also should mention that Poradeci used intentionally in his works the words of Albanian origin. He used the adverb *tashi* or *tashti* and the adverbial phrase *tani për tani*. Poradeci also used the word *tregtizë* instead of the word *shitore*. The Albanian Dictionary contains the name *greminë* but Poradeci also used the adjective *i greminuar* and the verb *greminoj*.

As regards suffixation we have to mention the feminine suffixes *-ëz* and *-zë*: i.e. *mjergullëz*, *qepallëzë*, *gojëzë*, *folezë* and the masculine suffix *-thi*: i.e. *vallthi*, *vajtimthi*, *mëmëdhethi* etc. The neuter gender also was used by Poradeci in his works, which are important in the field of Albanian grammar: i.e. *ballët*, *të qarët*, *të folët*, *të keq*, *të parë*, *të shuar*, *të mugëtit*, *të ngjarët*, *të sosurit*, etc.

As regards the compounds, we have highlighted some substantivizations of adjective compounds: i.e. *flokëndritura*, *balukprera*, *gjimburuara*, *shtatlëkundura*, *meskëputura*, etc.

In his works, Poradeci formed a subgroup of new words which cannot be found in the Albanian Dictionary. We would like to mention the Albanian word *paemërsi* which was used instead of the word *anonim*.

As regards the ways of word formation, we should mention: prefixes, suffixes, affixes, articles, compounds, etc.

In my opinion, the richness of words that were used by Poradeci should be included in the Albanian Dictionary as soon as possible.

Rrahman PAÇARIZI, Universiteti i Prishtinës

PIKËPAMJET E SELMAN RIZËS PËR STANDARDIN DHE STANDARDIZIMIN E SHQIPES NGA PERSPEKTIVA E SOTME¹

KUD 811.18°26

Që në fillim dua të arsyetoj titullin e këtij punimi, duke arsyetuar shqyrtimin e teorisë së Selman Rizës mbështetur mbi tezën për moslënien pasdore të toskërishtes në procesin e standardizimit të shqipes dhe më pas të tezës për pangëgnishten. Titulli që del nga punimi nuk është zgjedhur as për konvencë konference dhe as për lehtësimi analizimi nga një perspektivë e gjysmë shekulli më pas.

Teza e Selman Rizës se toskërishtja ishte më kompakte, nuk e arsyeton aspak atë që ende interpretohet si anim i tij kah toskërishtja si bazë dialektore e shqipes, një tezë kjo e lansuar në vitin 1936. Në fakt, toskërishtja ishte zhvilluar lirshëm dhe duke mos pasur një traditë të gjatë e të konsoliduar shkrimi, ajo u ishte nënshtuar proceseve të ndryshimeve dhe përafrimeve të brendshme, meqë kishin ndryshuar rrethanat shoqërore dhe lëvizjet më shumë brenda një territori përafërsisht kompakt dhe jo shumë të zgjeruar, sa për të mos komunikuar mes vete. Ndërkaq, gegërishtja, e cila bartte me vete, thënë kushtimisht, peshën e kryqit të traditës më të lashtë shkrimore të trashëguar nga dhe përmes klerit katolik të Shkodrës, llogariste pikërisht në një rrugë të shtruar shkrimi e cila duhej ndjekur, meqë ishte më e gatshme. Në fakt gegërishtes po i ndodhte ajo që Selman Riza e tha më Tri monografinat më 1944 për latinishten e standardizuar, se (standardi gjuhësor) “pajos letrarishten me një gramatikë, ku gjanat e punët e gjuhës futen gati-gati vetvetiu në kallëpin e normave; ungjin si të thuesh qafën, po si shtazë të zbutuna, ndënë zgjedhën e paradigmes”. Në këtë kuptim, gegërishtja nuk kishte arritur të reformohej se brend-

¹ Kumtesë e lexuar në Konferencën shkencore për veprën e S. Rizës të mbajtur në Tiranë, me organizim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 2009.

shmi dhe të evoluonte dhe alfabeti me të cilin shkruhej ishte gati-gati një alfabet etimologjik (si ai i sotmi i anglishtes e frëngjishtes) që nuk po respektonte ndryshimet progresive të vetë gegërishtes, si reduktimi i pjesores dhe kjo reflektohej në shkrimin e mbiemrave prejpjesorë me paradigma gati se të çuditshme të cilat madje shkaktonin hendek të thellë ndërmjet gjuhës së shkruar dhe asaj të folur.

Studiuesi Riza e kishte vërejtur këtë, por duket që nuk kishte mjaft guxim për ta thënë këtë, ndoshta ishte e vetmja gjë në jetën e tij që nuk kishte dashur ta thoshte, meqë e donte aq tepër. Sidoqoftë, ai e gjeti mënyrën për ta shprehur këtë shqetësim, përmes një qasjeje sociolinguistike që merr parasysh evolucionin gjuhësor për ta vënë në shërbim të ikjes nga një traditë shkrimi që po i bëhej zinxhir gjuhës dhe zhvillimit të saj. Gegërishtja ishte pakrahasimisht më e madhe sesa toskërishtja, qoftë në kuptim të folësve, qoftë në kuptim të shtrirjes territoriale. Rrethanat gjeografike, historike dhe administrative nuk i kishin siguruar gegërishtes kompaktësinë që e kishte toskërishtja, që madje kishte funksionuar brenda një vilajeti të vetëm nën sundimin turk, e Desnickaja mendon se pikërisht periudha e sundimit turk ishte periudha ku kishin ndodhur ndarjet më të thella ndërmjet dy dialekteve të shqipes. Kësaj teze dua t'i besoj dhe për këtë kam një shembull që mund të duket banal – afërsia e jashtëzakonshme e trajtave kohore të foljeve të parregullta anembanë shqipes. Kjo tezë më duket se është e qëndrueshme pikërisht për faktin se këto trajta duke mos iu nënshtruar paradigmave kanë arritur të ruhen si të tilla dhe nuk u janë nënshtruar ndryshimeve dhe rrafshimeve që u janë nënshtruar paradigmave të trajtave kohore të foljeve të rregullta.

Së këndejmi, teoria e Selman Rizës për pangëgnishten, sado që është quajtur si një hap prapa drejt njëjtësismit dhe standardizimit të shqipes, kishte brenda vetes logjikën e proceseve sociolinguistike. Ai kërkonte që të bëhej një gegërishte standarde, meqë kjo nuk ishte bërë për shkak të rrethanave socio-politike dhe administrative dhe vetëm shkodranishtja në fakt kishte atributet e traditës shkrimore si argument për ngritjen në normë, sipas disa praktikave të standardizimit të disa gjuhëve, përfshirë italishten, gjermanishten etj. Kështu, Riza besonte që duke pasur një gegnishte të standardizuar në njërën anë dhe një toskërishte që ishte zhvilluar natyrshëm dhe në një fazë të caktuar kishte arritur të shkruhej brenda një standardi ta paformalizuar por funksio-

nal toskë, do të mund të arrihej të nxirrej një standard tani panshqiptar, edhe pse nuk e kishte quajtur asnjëherë të tillë. Duke u marrë aq shumë me latinishten dhe zhdukjen e saj si të tillë, si dhe evoluimin e popullloreve latine në disa gjuhë neolatine (latinët i quanin vullgaro-latino) që arritën të standardizohen duke pasur rrethana më të mira sociolinguistike pasi ishin zhvilluar natyrshëm deri në një fazë kur standardizimi ishte bërë i lehtë dhe i thjeshtë, Riza dëshironte që edhe gegërishtja të prodhonte një standard më të lirshëm dhe jo si ai i shkodranishtes që ishte shndërruar pothuajse në një latinishte, apo gegërishte letrare që nuk komunikonte me gegërishten që flitej asokohe në mesin e shekullit 20.

Në anën tjetër, sado kundërthënëse apo edhe po të duam evolutive të konsiderohen teoritë e Rizës, fillimisht pro toskërishtes për bazë dialektore të shqipes standarde më 1936, dhe kjo e 1944 për Pan-gegnishten, kjo besoj do një analizë më të thellë se kaq. Madje, mund të thuhet me siguri se Selman Riza asnjëherë nuk hoqi dorë nga teoria e tij për standardizimin e shqipes mbështetur në parime sociolinguistike, edhe pse asokohe kjo disiplinë shkencore ishte në fillimet e saj, e në shkencën shqiptare gati e panjohur. Në këta aspekt, Riza del si njëfarë legalisti fanatik që dëshiron të respektojë deri në fund procedurat dhe parimet për standardizimin. Nuk mund të kishte standardizim të mirëfilltë pa pasur dialektet të zhvilluara në masën e duhur, pa pasur një shkallë arsimore të duhur, tekefundit pa pasur një masë kritike shkencëtarësh që do të merreshin me përzgjedhjen e bazës dialektore dhe përpunimin e saj të detajuar, deri në masën sa shqipja eventuale standarde të bëhej e pranueshme, e akceptueshme dhe e implementueshme gjithandej territoreve të banuara nga shqiptarët.

Riza e kishte kundërshtuar elbanishten e cila kishte dofarë bazash edhe shkencore, ndonëse shpejt e shpejt të përpunuara nga Pekmezi, Lambertzi e Nachtigali. Ai e kishte kundërshtuar elbanishten e cila kishte dalë si një kompromis i realizuar përmes një konspiracioni të elitës politike dhe kulturore, siç ndodh me standardet gjuhësore gjithandej. Mirëpo, rrethanat sociopolitike në të cilat Riza po e zhvillonte teorinë e tij ishin krejt të pafavorshme për të arritur përfundimin e dëshiruar. Elita politike që erdhi në pushtet në Shqipëri, rrethanat politike në të cilat jetonin shqiptarët në Kosovë dhe në viset e tjera të ish-Jugosllavisë, duke e pasur Prishtinën si qendër kulturore, bënë që

të përsëriten përfundimet nga Kongresi i Arësimit i Lushnjës më 1920 – sërisht për standardin vendosi elita politike, e tumirur nga elita kulturore, as përafësisht e gatshme për t'u marrë me standardizimin e mirëfilltë të shqipes. Përderisa një elitë kulturore e shkolluar në Austri dhe e mbështetur nga një elitë politike me origjinë gege vuri elbasanishten në bazën e shqipes standarde me arsyetimet se ishte një dialekt i mesëm, elita kulturore e gjysmës së dytë të shekullit 20 e nxitur nga elita politike me origjinë toske, e vuri toskërishten në bazën e shqipes standarde, duke e arsytuar marrjen e pëlqimit nga elita kulturore gjysmë e shkolluar e Kosovës me arsye krejtësisht politike. Natyrisht që njëri ndër studiuesit më prodhimtar dhe më serioz të shqipes Eqrem Çabej ishte anashkaluar, ndërsa studiuesi tjetër po aq prodhimtar dhe vizionar, Selman Riza tashmë po vuante internimin dhe ekskomunikimin pas persekutimeve nga të dyja anët e kufirit. Sa për ilustrim të përmendim se Çabej nuk kishte arritur ta përfundonte hartimin e atlasit gjuhësor të shqipes, ndërsa Riza nuk kishte arritur ta çonte në fund projektin e tij për ndërtimin e shqipes standarde mbi bazën e dy kryedialekteve.

Teoria e Pangegnishtes ishte keqinterpretuar dhe keqpërdorur, herë me qëllim e herë nga mosdija nga gjuhëtarë të ndryshëm, partizanë të standardit aktual. Kjo teori e Selman Rizës ishte rruga kalimtare dhe fundi i rrugës. Ai e arsyttoi toskërishten si bazë dialektore të shqipes standarde madje dhe duke e shkruar vetë – të njëjtën gjë bëri edhe me gegnishten. Nuk deshi që akëcili nga kryedialektet “të mos jetë i destinuar të bjerë në radhën e një së foluri vetëm dhe thjesht popullor”, siç shkroi Riza pikërisht në Tri monografinat më 1944, kur lansoi Teorinë e Pangegnishtes.

Mendoj se Riza është lexuar më së miri nga Rexhep Ismajli, i cili në librin “Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës” botuar sivjet (2009) ndër të tjera, i sheh të munguara në standardin aktual të shqipes për shkak të ekskomunikimit të Rizës, qëndrimet e tij për: demonstrimin e suksesshëm të karakterit kulturor, të krijuar e artificial të gjuhës letrare, si dhe urtësinë e sugjerimit për zgjidhje të shkallë-shkallshme, me çka do të evitoheshin një sërë dëmesh të mundshme në të kundërtën. Natyrisht, këto dëme ndodhën, ndër të tjera edhe për shkak se njerëz më të përgatitur për t'u marrë me standardin dhe standardizimin e shqipes, Selman Riza, në kohën kur u realizua projekti i dytë i stan-

dardizimit të shqipes, ndodhej i internuar dhe i privuar nga veprimtaria botuese shkencore.

Perspektiva e sotme për standardin aktual të shqipes, në një masë e shpjegon gjendjen e sotme të standardit të shqipes, ndërtuar mbi teza të mbështetura në parime sociolinguistike e psikolinguistike që dëshmojnë dëmet që i janë shkaktuar standardit për shkak të detyrimit të lënies përgjysmë të projektit të Selman Rizës për standardizimin e shqipes si një proces, nga i cili do të dilte standardi i shqipes. Një nga teoritë që e ka origjinën në pellgun lingustik të Prishtinës përafrohet me besimin e Selman Rizës për Pangegnishten para se të njësohet shqipja apo para se të riformohet një shqipe e përbashkët si kjo e 1972-shit. Në të vërtetë, kjo teori e mbështetur nga një grup lingvistësh rrymash të ndryshme konsiston në faktin se njëjtësimi i shqipes më 1972 ishte i ngutshëm pasi paraprakisht nuk ishin formësuar sa duhet në traditë të vazhdueshme shkrimi dy dialektet letrare apo të standardizuara. Gjithashtu, nga perspektiva e sotme tumiret projekti i Rizës për ndjekjen e parimeve për standardizimin e gjuhës mbështetur mbi modele dhe parime shkencore, për qasje evolutive dhe kompetitive dhe për nevojën e pasjes para vetes të gramatikave të dy dialekteve kryesore të shqipes të standardizuara sado-kudo. Mosmarrja parasysh e këtyre parimeve sado vonë të jetë, nuk i siguron standardit aktual të shqipes pranueshmëri të gjerë dhe nuk e bën atë një infrastrukturë të qëndrueshme në rrjedhat e globalizmit.

Rrahman PAÇARIZI, University of Prishtina

SELMAN RIZA'S VIEWPOINTS ON STANDARD AND STANDARDIZATION OF ALBANIAN FROM THE ACTUAL PERSPECTIVE

Summary

The actual perspective on actual standard Albanian explains to a certain degree the current position of standard Albanian. This perspective was built on theses that were based on sociolinguistic and psycholinguistic principles. These theses prove the damages caused to the standard because of the fact that Selman Riza's project to standardize Albanian as a process, from which would derive standard Albanian, was not completed. One of the theories that derives from linguistic circle of Prishtina supports Selman Riza's viewpoint on pan-Gege before unification of Albanian or before creation of a common language in 1972. In fact, this theory, supported by a group of linguists of different movements, supports the fact that the unification of Albanian in 1972 was in haste because the writing of two literary or standardized dialects hasn't been practiced sufficiently and in consequence it hasn't become preliminarily a continuous tradition. Looking from the actual perspective, it is supported Riza's project to follow principles of language standardization based on scientific models and principles, evolutionary and competitive approach and the need to have standardized grammars of both key Albanian dialects. If these principles will not be taken into account (no matter whether it is late or not) then it can not be guaranteed that the actual standard Albanian will be accepted widely and consequently it will not have a sustainable infrastructure in the course of globalization.

Shkumbin MUNISHI , Universiteti i Prishtinës

VËSHTRIM SOCIOLOGJIK I PIKËPAMJEVE TË SELMAN RIZËS PËR FORMIMIN E SHQIPES STANDARDE¹

Sfondi

Shfaqja e ideologjisë nacionaliste dhe krijimi shteteve kombëtare në Europën e shekullit XIX ka pasur ndikim të fuqishëm jo vetëm në zhvillimet politike, ekonomike dhe kulturore, por edhe në ato gjuhësore. Homogjeniteti i njësisë kombëtare qëndronte në themel të ideologjisë nacionaliste të elitave politike e kulturore europiane, të cilat synonin krijimin e entiteteve unitare shoqërore dhe shtetërore. Në këtë kuadër, si përbërës thelbësorë i këtyre njësisë unitare kanë shërbyer tiparet e kulturore, tradicionale, historike, fetare dhe, sidomos, afria gjuhësore. Këto zhvillime përcilleshin edhe me zhvillimet teknologjike dhe me transformimin e shoqërive evropiane, nga shoqëritë e predominuara rurale, në shoqëri të tipit urban, me koncentrim më masiv të popullsisë në këto qendra urbane. Në një situatë të tillë, komunikimi gjuhësor dhe nevoja për të pasur një kod të unifikuar gjuhësor, i cili do ta lehtësonte komunikimin përbrenda këtyre qendrave, bëhej domosdoshmëri e kohës. Ishte filozofi gjerman Johann Gottfried Herder (1744-1803), i cili e potencoi i pari rëndësinë e gjuhës për krijimin dhe forcimin e ndjenjës kombëtare. Studiuesi i mirënjohur Einar Haugen e sheh varësinë funksionale të protoelitave të reja të gjuha si nevojë për të komunikuar me popullatat e reja të urbanizuara, por që ende ishin të paarsimuara dhe gjuhësisht heterogjene. Në ato rrethana, gjuha bëhet simboli kryesor dhe më i rëndësishëm i identitetit kombëtar, madje edhe më i rëndësishëm se religjioni, territori dhe çdo tipar tjetër shoqëror. Më tutje, Haugeni thekson se nacionalizmi e glorifikon vernakularin (gjuhën) në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke nderuar

¹ Kumtesë e lexuar në Konferencën shkencore për veprën e S. Rizës të mbajtur në Tiranë, me organizim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 2009.

dhe duke i përjetuar si simbol të madhështisë kolektive krijimet letrare nga e kaluara. Kjo lidhje e nacionalizmit dhe letërsisë së krijuar një vernakular të caktuar është një hapësirë e re e ndikimit të nacionalizmit në planifikimin gjuhësor. Format leksikore, morfologjike e sintaksore, të cilat ishin popullarizuar në krijime letrare të periudhave të ndritura është mjaft vështirë të anashkalohen nga planifikuesit e gjuhës (Haugen, 1973).

Promovimi i vlerave të krijimeve letrare dhe ndërtimi i gjuhëve standarde mbi këto vlera ka qenë rruga e përgjithshme që kanë ndjekur pjesa më e madhe e gjuhëve standarde evropiane. Por, problemi është shfaqur tek ata popuj të cilët letërsia kombëtare ka qenë më e vonë dhe më pak e konsoliduar.

Përndryshe, standardizimi i gjuhëve si pjesë e planifikimit gjuhësor dhe politikës gjuhësore ka zënë një vend qendror në studimet sociolinguistike që nga krijimi i kësaj disipline. Studiues të ndryshëm kanë hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të këtij procesi mjaft kompleks, i cili ngërthen në vete faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Janë trajtuar etapat e këtij procesi, rrugët e ndryshme që janë ndjekur, kriteret që janë përdorur, tiparet dhe aspektet e tjera të gjuhëve standarde si produkte të planifikimit gjuhësor. Këtu po përmendim vetëm disa prej tyre. Kështu, Punya Sloka Ray, për shembull, përmend si aspekte shumë të rëndësishme eficientë, racionalitetin dhe përbashkësinë (Punya Sloka Ray, cit. sipas Byron, 1976), ndërsa Einar Haugen krahas përshkrimit të etapave të standardizimit, identifikon eficientë, adekuacitetin dhe pranimin si aspekte shumë të rëndësishme të këtij procesi. Joshua Fishman, midis faktorëve tjerë ka parasysh, autonominë, historicitetin dhe vitalitetin (Fishman, 1978), ndërsa William Downes, përveç tipareve që u cekën, përmend edhe dimensionin ideologjik, rolin e elitës kombëtare, traditën letrare, autonominë, historicitetin, vlerën utilitare dhe vitalitetin (Downes, 1984). Më poshtë, në vazhdim të këtij punimi, do të përpiqemi që pikëpamjet e Selman Rizës për shqipen standarde t'i trajtojmë në dritë të këtyre aspekteve e tipareve për gjuhën standarde, të cilat u përmenden këtu.

Fryma e ideologjisë nacionaliste e përhapur në Europën e shekullit XIX, ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë edhe në fillimet e procesit të standardizimit të shqipes. Përfaqësuesit më eminentë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të ndikuar dhe të motivuar nga zhvillimet e atëhershme politike ideologjike në Europën Perëndimore, nuk reshtën për

asnjë çast së propaguari rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës amtare, por edhe nevojën për unifikimin e gjuhës shqipe. Në këtë periudhë e kanë zanafillën idetë e para për formimin e shqipes standarde, ndonëse jo të elaboruara sa duhet.

Përndryshe, në rrjedhat e standardizimit të shqipes, të cilat, siç u tha, e kanë burimin që nga Rilindja Kombëtare, janë shfaqur mendime e pikëpamje të ndryshme lidhur me mënyrën e formimit të shqipes standarde dhe mbi varietetin dialektore që do të duhej të merrej për bazë të gjuhës standarde shqipe. Që në fillimet e hershme të standardizimit të shqipes u shfaqën tre lloj pikëpamjesh kryesore sa i përket përzgjedhjes së bazës dialektore të shqipes standarde (Byron, 1976: 56). Pikëpamja e parë ishte se gjuha standarde do të duhej të formohej me kombinimin e tipareve të gegërishtes dhe toskërishtes. Grupi i dytë përbëhej nga ata studiues që mendonin se në bazë të gjuhës standarde do të duhej të ishte toskërishtja, sepse paraqitej më e konsoliduar dhe me një traditë më të pasur letrare. Ndër të parët që shpërfaqte këtë pikëpamje ishte Aleksandër Xhuvani, i cili më 1905 doli me idenë se për bazë të gjuhës standarde shqipe do të duhej të merrej dialekti i Jugut (Xhuvani, 1905: 3). Por, një vit më pas, duke e parë ndjeshmërinë e përzgjedhjes së bazës dialektore, ai hoqi dorë nga mendimi i tij, duke theksuar se do të ishte e udhës që secili të shkruante në dialektin e vet (Xhuvani, 1906: 8-9). Grupi i dytë, i cili u shfaq kryesisht në periudhën e veprimtarisë së Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1917), përfaqësonte idenë se për bazë të gjuhës standarde shqipe do të duhej të merrej gegërishtja e mesme, ose më saktë elbësanishtja, pasi që ky dialekt qëndronte midis toskërishtes dhe gegërishtes (Laimet e Komisionit Letrar të Shkodrës, 1918: 2-10). Varieteti i elbësanishtes i promovuar nga Komisioni, i mbështetur nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe i dekretuar si gjuhë zyrtare nga Qeveria e Shqipërisë, më 1923, i fitoi pothuajse të gjitha tiparet e gjuhës standarde dhe u përdor si e tillë deri më 1945.

Kishte edhe autorë të tjerë që shprehën pikëpamjet e tyre lidhur me mënyrën e formimit të shqipes standarde, por këtu nuk do të ndalemi më tepër në shtjellimin e atyre pikëpamjeve.

Idetë e Selman Rizës për formimin e shqipes standarde

Nga fundi i vitit 1944, në opinionin shqiptar del në dritë vepra e Selman Rizës me titull “Tri monografina albanologjike”, në të cilën shfaqet njëra nga idetë më origjinale për formimin e gjuhës letrare shqipe. Ishte

kjo ideja e “pangegënishtes”.

Për arsytet që e kanë shtyrë Rizën të mendojë për formimin e gjuhës letrare shqipe ai shprehet qartë: “Konstatimi se ndën gegënishtet kanë evolue me një mënyrë fort asynkronike dhe divergjente ndërmjet veti, më ka frymëzue me idenë që të përfitonjë prej kësaj gjendjeje ndën dialektale të kryedialektit verijuer për të sëndergjue një gegënishte letrare e cila të jetë përfundim i bashkëpunimit të ndëngegnishteve të ndryshme simbas kriterit, ku të jetë e mundshme, të njëjtësimit dhe, ku të mos jetë, të gjegjësimit të drejtëpërdrejtëshëm me tosknishiten letrare” (Riza, 1944: 2-4). Pra, Riza konstatonte zhvillimin divergjent të dy dialekteve të shqipes, sidomos variacionin më të theksuar gjuhësor përbrenda dialektit të veriut dhe prandaj kërkonte që formimit të shqipes standarde t’i paraprijë njëjtësimi i gegërishtes.

Në anën tjetër, Riza gjithashtu konstatonte se toskërishtja paraqitej më e unifikuar dhe me një traditë tashmë të konsoliduar letrare të krijuar sidomos nga Rilindja e këndej. Në këtë kuptim, Riza thekson: “Toskët tue pasë të gatshëme prej shumë kohe e të sajuene për faqe të bardhë letrarishten e vet, shkojnë me shpirt të qetë e, sa për këtë punë, me mënde të fjetun drejtë udhës së prodhimit letrar dhe popullorizimit dijtunuer, pa ndi nevojën me u lodhë sadopak për çeshtjen gjuhësore të rëndit t’ânë e pa u turbullue aspak prej mospërfilljeve e përbuzjeve, prej kallximeve e kërcnimeve, përgjegjësinë e të cilëve ky apo aj gjuhëtar Gegë e ka quejt punë të mendshëme e madjë atdhetare me marrë përsipër kundër kryedialektit juguer të shqipes...Gegët, në vënd që të përpqeshin për me zgjidhë endë të pazgjidhunin problem gjuhësor të Gegënisë, pa prâ, pa u kursye, vrasin mënden, trazojnë shpirtin, përpushen e valaviten për me zgjidhë problemin gjuhësor të mbarë Shqipnisë” (po aty, 108). Riza e shihte qartë se gegërishtja ende nuk ishte njësuar sa duhet për të kryer funksionin e gjuhës letrare për mbarë kombin. Sipas tij, këtë nuk ishte në gjendje ta bënte as dialekti i mesëm, për të cilin Riza thoshte: “po due me thânë, me çfrÿ në të kështuquejtunën gjuhë të mesëme, që, vertë, deri sod, nuk ka pasë, si me thânë, kërthokllat e duhuna për të zânë vëndin, jo toskënishtes, por as shkodranishtes; mirë po që ka përmbledhë në vedi gjithë requisitet e duhun për t’u bâ gjuha zyrtare e krejt vëndit t’ânë e madjë, n’e lânshim me ndjekë udhën që ka marrë, do të jetë edhe fort e zonja me bâ shqipen shkollore, do me thânë, një mishmash për të mos ngrânë as

qëjt e rrugës, një kullë Babeli për të mos mundë jo mediokriteti i gramatikanëve vëndësa por as gjenialiteti i albanologëve të huejë me gjetë gjânave fillin, me rá punëvet dum” (f. 111).

Për këto arsye që posa u përmendën, Riza ishte i mendimit se së pari duhej të bëhej njësimi i gegërishtes, në mënyrë që më pas kjo gegërishte e njësuar, të cilën ai e quajti ‘pangegnishte’, të afrohej me toskërishten. “Gramatikisht, letrarishtja e veriut do të sendërgjohet, simbas mundësinave për një pjesë tue u njëjtësue e për pjesën tjetër tue u gjegjësue me letrarishten e jugut me anë të bashkëpunimit vetëm ndërmjet të të gjithave ndëngegënishtevet me kusht që kësi s’u afrueni prej toskënishtes gegënishtja të mos dali as e vorfënuene as e bastardhuene...Do të njëjtësojmë gegënishten letrare me toskënishten letrare tue mënjane evolutat partikulariste” (f. 112-113), shkruante Riza dhe konkludonte: “Pangegënishtja do të përbâhet prej tejtrajtimesh njëkohësisht ndëgegë e letraro-toskë dhe prej shqiptarismash së lashta ende të gjalla më ndonjënen prej ndëngegënishtevet” (f. 196).

Qëndrimi i Selman Rizës ishte që dallimet midis dialekteve të shqipes në rrafshin fonologjik-fonetik, në rrafshin morfo-sintaksor dhe në atë leksikor nuk ishin aq të mëdha dhe të papërballueshme. Ai konsideronte se do të mund të gjendeshin format e përbashkëta gjuhësore nëse kërkoheshin në të folme të ndryshme të shqipe. Riza shprehej se në pangegërishten e tij do të futeshin të gjitha ato forma e njësi gjuhësore të gegërishtes, të cilat ose gjendeshin në toskërishte, ose ishin të përafërta me të. Ai i kërkonte këto forma në të gjitha varietetet veriore: në elbsanishte, në kosovarishte dhe në shkodranishte (shih për më tepër Riza, 1944).

Duhet thënë që përpjekja e Rizës për të sendërtuar pangegërishten e tij, e shprehur në “Tri monografinë albanologjike”, mbështetej në pjesën më të madhe në faktorë linguistikë, në mundësitë e kombinimit të elementeve sistemore të varieteteve të gegërishtes, për ta reduktuar variacionin e saj dhe në përpjekjet për ta afruar një varietet të tillë të përbashkët të gegërishtes me toskërishten letrare, të cilën ai e konsideronte më njëformëshe dhe më të konsoliduar.

Në artikullin tjetër të e tij “Shqipja dhe shqiponja” (1936), Selman Riza ka parasysh faktorët e ndryshëm jashtëgjuhësorë krahas atyre gjuhësorë, të cilët e bëjnë të nxjerrë përfundime të tjera. Ai konsideron se në perceptimet për gjuhën shqipe, nuk ka gjuhë toskërishte

dhe gjuhë gegërishte, por ka vetëm gjuhë shqipe me dy kryedilakete dhe nuk shihte ndonjë rrezik kombëtar nga kjo gjendje (f. 218).

Ky autor konsideronte që problemi i dualizmit dialektor të shqipës mund të zgjidhej në tri mënyra:

“1.- Të ngrehim njërin dialekt në lartësinë e një gjuhe shkrimi të përbashkët dhe të lëmë tjetrin jashtë përdorimit zyrtar, shkollor dhe letrar, kështu që të prapset dita ditës, të zhduket dalngadalë, në saje të përhapjes s’arsimit botor dhe të letërsisë kombëtare.

2.- Të gatujmë bashkë një idiomë eklektike nga brumi i dy kryedialektave.

3.- Të privilegjojmë një nëndialekt, për hir të një situatë gjeografikisht të mesëme, së cilës besojmë që ay t’i detyrojë një analogji bipolare me dy kryedialektet fqinj” (f. 219)

Riza konsideronte se që të tri këto rrugë vështirë se do të na çonin te krijimi i gjuhës standarde shqipe të përbashkët. Problemi i elbaskanishtes ishte se ky varietet ishte “një nëndialekt me një domethënie kulturore të cektë, me një pasuri idiomatike të paktë, dhe sidomos me një shvillim letrar pothuajse të paqenë” (f. 219). Problemi i krijimit të gjuhës standarde si një idiomë eklektike qëndronte në artificialitetin e saj dhe vështirë që do të pranohej (f. 220). Dhe, së fundi, problemi i ngritjes së njërit dialekt qëndron në faktin se as faktorët politikë, as letrarë, nuk i kishin dhënë ndonjë përparësi toskërishtes apo gegërishtes, në mënyrë që njëri nga dy kryedialektet të ngrihej në gjuhë standarde (f. 220). Prandaj, duke qenë i vetëdijshëm për ndjesinë e problemit të gjuhës letrare dhe duke vlerësuar drejt gjendjen e toskërishtes, Riza shprehej: “Për hatër të një begatie idiomatike të barabartë me folklorin e gegërishtes, për hatër të një orthografie më të plotë dhe të një fonetike më muzikale, për hatër të një syntakse më t’evoluuar drejt shprehjes analytike, dhe sado anëtar të jem – për arsyet e çfaqura më sipër të një fizionomie të njëllorshme dhe të një homogjeniteti në cipët – nuk munt veçse të përgëzohem botërisht që në saje të prestigjit të kryeshkrimtarëve dhe të mbrohtësisë së publikut toskë, toskërishtja të mos jetë destinuar të bjerë në rradhën e një të foluri vetëm thjesht popullor. Shkabën e flamurit e kemi me dy krerë. Gjuhën e kombit do ta kemi me dy kryedialekte” (f. 222).

Si mund të trajtohen pikëpamjet e Selman Rizës dhe mbi cilat teza mbështeten idetë e tij për shqipen standarde? Në radhë të parë, Riza kishte dije dhe njohuri shkencore të kohës për proceset e standardizimit të gjuhëve. Ai njihte rrjedhat e formimit të koinesë greke dhe zhvillimin e latinishtes, si dy gjuhë antike të standardizuara ndër të parat. Së dyti, Riza konstatoje me të drejtë ekzistencën dualizmit dialektor në gjuhën shqipe, por përmes fakteve gjuhësore argumentonte se dy dialektet e shqipes nuk ishin edhe aq të largët nga njëri-tjetri. Së treti, Riza kishte parasysh rolin e traditës së kaluar letrare në krijimin e gjuhës standarde. Ndonëse përmendte prodhimtarinë letrare të autorëve të Jugut dhe të atyre shkodranë, me të drejtë konstatoje se asnjëra traditë letrare, as ajo e Jugut, as ajo e Shkodrës, nuk kishte nxjerrë ndonjë autor a vepër, e cila do të influenconte fuqishëm gjuhën e ardhshme standarde. Në këtë pikë ai kishte plotë të drejtë, pasi që krijimtaria letrare e autorëve të Jugut dhe atyre shkodranë e periudhës së Rilindjes Kombëtare ishte e kohërave më të vonshme dhe ishte krijuar pothuajse paralelisht me nismën e përpjekjeve për standardizimin e shqipes. Ndërkaq, letërsia e autorëve të vjetër shqiptarë (Buzuku, Budi, Bogdani, Matranga, Bardhi) kishte mbetur anakronike, pa ndonjë jehonë të fuqishme brenda popullit shqiptar dhe format gjuhësore të këtyre autorëve tashmë ishin bërë mjaft të largëta me gjuhën e gjallë të folur.

Pasi kishte konstatuar këto fakte, Riza i kthehet sistemit gjuhësor të shqipes dhe zgjidhjen e problemit e kërkon kryesisht në rrafshin gjuhësor. Për këtë arsye ai përpaket të japë kontributin dhe shembullin personal, duke sendërtuar pangegënishten e tij – varietetin e përbashkët të gegërishtes, i cili pasi të afrohej dhe përqasej me toskërishten letrare, përmes njësive e formave të përbashkëta gjuhësore, do të ngrihej në gjuhë standarde për tërë kombin. Riza këtu ka parasysh tiparet sociolinguistike, adekuacitetin e këtij kodi dhe tiparet e përbashkësisë dhe të vitalitetit, sepse pangegënishtja e tij do të ishte shumë e afërt me toskërishten letrare. Mendoj që kjo qasje linguistike e Rizës për krijimin e shqipes standarde ishte plotësisht e drejtë. Kur merret parasysh fakti që mungonte një traditë letrare e shkruar në njërin dialekt të shqipes, e cila të kishte epërsi ndaj veprave letrare të shkruara në dialektin tjetër, si dhe kur mungonte epërsia politike dhe kulturore e folësve të njërit dialekt ndaj folësve të dialektit tjetër dhe kur nuk kishte një

elitë të konsoliduar, e vetmja zgjidhje mbetet që problemi të shtrohej në rrafshin lingistik dhe zgjidhja të kërkohej brenda sistemit gjuhësor të shqipes.

Megjithë përpjekjet e tij të sinqerta për t'i dhënë një zgjidhje gjuhësore problemit të shqipes standarde, Riza përsëri bëhet i vetëdijshëm për ndikimin e faktorëve shoqërorë jashtëgjuhësore dhe për ndjesinë e këtij problemi. Për këtë arsye, te “Shqipja dhe shqiponja” Riza shprehet në favor të një politike gjuhësore liberale, duke shprehur respektin për të dy dialektet e shqipes dhe duke parapëlqyer zhvillimin evolutiv të shqipes standarde. Më lart u cek se edhe Aleksandër Xhuvani, pasi ishte shprehur njëherë në favor të ngritjes së toskërishtes në gjuhë standarde, kishte hequr dorë nga kjo ide dhe e kishte arsyetuar vazhdimin e bidialektizmit në gjuhën shqipe.

Nga e tëra që u tha më lart, shihet qartë se cilat ishin konceptet e S. Rizës për formimin e gjuhës standarde shqipe. Nga citatet e mësipërme dhe nga këto që u thanë, askund nuk mund gjendet shkas për të dyshuar se S. Riza ishte kundër formimit të një gjuhe standarde gjithëkombëtare. Megjithatë, idetë e tij jo vetëm që nuk ishin perceptuar drejtë gjatë gjithë periudhës së diktaturës, por edhe ishin stigmatizuar në masë të madhe. Fjalët e tij në citatin: “Shkabën e flamurit e kemi me dy krerë. Gjuhën e kombit do ta kemi me dy kryedialekte”, u bënë shkas që ai të sulmohej egër nga personalitete të ndryshme të shkencës në Shqipërinë e periudhës komuniste, si një kundërshtar i formimit të gjuhës letrare shqipe. Ky stigmatizim nuk ka munguar as në Kosovë. Për konceptin e Rizës, Idriz Ajeti, duke u mbështetur në qëndrimet që kishte shprehur më parë A. Kostallari, shkruante se kjo “ishte shfaqje e një koncepti anakronik, që në efekt të tij të fundit kërkonte të hiqej dorë nga çdo përpjekje për njësimin e gjuhës letrare shqipe” (Ajeti, 1975: 10). Konsideroj që kritikën që i janë bërë Rizës në të kaluarën nuk kanë qenë kritika të bazuara në fakte e argumente shkencore, por kanë qenë kritika të motivuara ideologjikisht. Duke shfletuar shkrimet për idetë e Rizës, kemi fituar përshtypjen se ai shpesh ose është kritikuar ose është harruar me qëllim nga autorë shqiptarë si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, vetëm e vetëm që t'i ikej konfrontimit me qëndrimet e atëhershme zyrtare për gjuhën letrare, të cilat ishin bërë *par excellence* në gjuhësinë shqiptare të asaj kohe.

Megjithë sulmet që në të kaluarën i janë bërë Rizës, ne mendojmë se idetë e tij autentike kishin një qëllim të vetëm – që të arrihej

formimi i gjuhës letrare shqipe. Në këtë kuptim, Rexhep Ismajli shpreh: “Të mendoje më 1944 për krijimin e një gegërishteje të përbashkët letrare, e cila nuk do të ishte identike me asnjërën prej gegërishteve lokale, dhe ta mendoje këtë pak a shumë duke pasur parasysh tashmë të krijuar toskërishten letrare dhe duke kërkuar shprehimisht që këto dy variante letrare të afroheshin sa më shumë, me synim të njësimi më vonë, me “elementet që e bëjnë atë shumë t’afërt me koinenë jugore, në plan të drejtshkrimit, në fushën e fonetikës, të gramatikës e të fjalëformimit”, kjo nuk do të thoshte të ishte kundër krijimit të një gjuhe letrare të vetme. Puna ishte te vetë konceptimi i njasaj gjuhe letrare të vetme” (Ismajli 1998: 53). Pikëpamjet dhe idetë e tij për formimin e shqipes standarde mund të vlerësohen si përpjekje e bazuar në kombinimin e tre faktorëve: në vetëdijen e tij kombëtare, në idealizmin personal dhe në njohuritë e tij të pamohueshme prej gjuhëtari.

Literatura

- Ajeti, Idriz (1975). *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, **Gjurmime albanologjike III**-1973, Prishtinë.
- Byron, Janet L. (1976). **Selection Among Alternates in Language Standardization: The case of Albanian**, Mouton The Hague, Paris.
- Downes, William (1984). **Language and society**, Fontana Paperbacks, London.
- Fishman, Joshua (1973). **Language and Nationalism, Nationalism in Europe, 1815 to Present**, Edited by: Stuart Woolf, Routledge, London and New York, First published in 1996, this edition in the Taylor & Francis e-Library, 2003.
- Fishman, Joshua A. (1978). **Sociologija jezika**, Svijetlost, Sarajevo.
- Haugen, Einar (1966) *Dialect, Language, Nation, Sociolinguistics – selected readings*, Eds.: J.B. Pride and J. Holmes, Penguin books, Ringwood, Victoria, Australia, 1972.
- Ismajli, Rexhep (1988). **“Në gjuhë” dhe “për gjuhë”**, Dukagjini, Pejë.
- Laimet e Komissit Letrare Shqipe në Shkodër**, Numër I, Kallënder 1918.
- Riza, Selman (1944). Tri monografina albanologjike, **Vepra 1**, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Xhuvani, Aleksandër (1905). *Për themelimin e një gjuhe letrare*, **Vepra I**, Tiranë, 1980.
- Xhuvani, Aleksandër (1906). *Përmi themelimin të një gjuhe letrare shqipe*, **Vepra I**, Tiranë, 1980.

Shkumbin MUNISHI, University of Prishtina

THE SOCIOLINGUISTIC OVERVIEW OF SELMAN RIZA'S VIEWPOINTS ON THE ESTABLISHMENT OF STANDARD AL- BANIAN

Summary

Selman Riza's viewpoints on the establishment of standard Albanian should be looked at from two aspects which are also connected with two of his key works treating the issue of standard Albanian, "Three Albanological Monographs", and "The Eagle and the Albanian". When he speaks about formation of standard language in "Three Albanological Monographs", Riza mainly relies on linguistic issues and makes efforts to find a solution to the issues of norm but he also makes efforts to offer linguistic arguments for these solutions and at the same time to be less concentrated on nonlinguistic factors. Meanwhile, in conclusions in his work "The Eagle and the Albanian", Riza took more into account social factors which are not linguistic and really sensitive to the issue of standard Albanian. His effort to build a pan-Ghegë was an effort to find a solution to linguistic variation which was expressed in the Ghegë dialect and to bring it closer to the literary Toskë dialect. He thought of the possibility, following rapprochement between pan-Ghegë and Toskë dialect during the second phase, that the pan-Ghegë dialect would become a standard language for the entire nation. Riza's arguments are supported by sociolinguistic features of adequacy, unity and vitality of a norm built within the pan-Ghegë. Riza's efforts cannot be considered differently but as his personal idealistic efforts, based on national motives, to solve the problem of standard Albanian. His effort to bring closer the dialects of Albanian language, based on common linguistic solutions, presents a positive personal example of a precious erudite and intellectual of our nation. His linguistic approach can also serve in the current time context especially as regards the efforts of the Albanian society to consider and keep the standard language norm.

Blertë ISMAJLI, Universiteti i Prishtinës

KONCEPTI I SELMAN RIZËS PËR MËNYRAT E FOLJEVE

KUD 811.18-36

Abstrakt

Një vështrim kritik teorik për konceptin tradicional të mënyrës – i cili mbizotëron në gramatikën e shqipes – e gjejmë në “Sistemin foljor të letrarishtes shqiptare” të Selman Rizës (hartuar më 1966 por botuar vetëm më 1994). Ai duke synuar përkufizimin abstrakt të mënyrës foljore kritikonte përkufizimin e mënyrave përmes “vargënimit të funksioneve” dhe përshkrimin e mënyrës si shprehje të raportit të veprimit ndaj realitetit. Sipas tij në vend të konceptit realitet do të duhej të qëndronte koncepti ekzistencë sepse e vetmja mënyrë për shprehjen e realitetit është dëftorja, prandaj nëse flasim për mënyrën si shprehje të raportit të veprimit ndaj realitetit, atëherë përkufizimin e mënyrave të tjera foljore e bëjmë të varur nga dëftorja. Synimi i Rizës drejt një koncepti abstrakt për mënyrën e foljes shfaqet paralelisht me zhvillime të ngjashme në gjuhësinë evropiane të kohës.

Ndryshe nga Gramatika e Gjuhës Shqipe e ASHSH, Riza në grupin e mënyrave përfshin edhe format e pashtjelluara të foljes: paskajoren, përcjelloren dhe pjesoren. Paskajores dhe përcjellores Riza ua njihte karakterin e mirëfilltë mënyror, ndërsa pjesores nuk i njihej karakter i mirëfilltë mënyror meqë këto forma nuk shprehin asnjë raport të fenomenit ndaj egzistencës, e që ishte përkufizimi që Riza i bënte mënyrës foljore.

Synimi i Rizës për një koncept abstrakt të mënyrës si dhe vërejtjet e tij për ndërlidhjen e mënyrës me konceptin realitet janë në linjë të njëjtë me trajtimet e mënyrave dhe modalitetit në gjuhësinë evropiane të gjysmës së dytë të shek. XX.

Fjalët çelësa: Mënyra, modalitet, forma të pashtjelluara, realitet, habitore

Modaliteti si kategori semantike dhe mënyra si mjet gramatikor për shprehjen e tij paraqesin komponentet kryesore e më komplekse të sistemit foljor të një gjuhe. Megjithë studimet e shumta, këto dy nocione vazhdojnë të ridefinohen në studimet teorike, gjithnjë me qëllim të arritjes së një përkufizimi më gjithpërfshirës. Definicioni që hasim në leksikonet e gjuhësisë, modalitetin e përshkruan si kategori semantike që shpreh qëndrimin e folësit ndaj vlefshmërisë së veprimit a gjendjes së shprehur me foljen kryesore. Ndërsa mënyra përkulizohet

si “kategori gramatikore e foljes, përmes së cilës folësi shpreh qëndrimin subjektiv ndaj veprimit të shprehur”¹. Sipas përkufizimit tradicional të mënyrës dëftorja është mënyra e sigurisë së folësit për realitetin, urdhërorja mënyra e kërkesës, lidhorja mënyra që paraqet përmbajtjen e një shprehjeje si joreale (diçka e përfytyruar, e dëshiruar) ose pjesërisht të vlefshme (e mundshme). Ky përkufizim tradicional i mënyrës bazohet në numërimin e llojeve të përdorimit/ funksioneve të formave të ndryshme foljore. Në studimet bashkëkohore termi mënyrë i referohet paradigmave foljore përmes së cilave folësi shpreh qëndrimin subjektiv ndaj veprimit të shprehur, duke e cilësuar atë si real ose joreal.²

Në studimet e shqipes për mënyrët e foljes mbizotëron edhe sot përkufizimi tradicional i mënyrave. Për dallim nga këto, në studimet e tij për sistemin foljor të shqipes, Selman Riza që në vitet ’60 bënte një përkufizim të avancuar të sistemit të mënyrave të shqipes. Ai në “Sistemin foljor të letrarishtes shqiptare bashkëkohore” (hartuar më 1966, por botuar vetëm më 1994 për shkak të përndjekjes së autorit) shprehte vërejtje për përkufizimin e mënyrave përmes “vargënimit të funksioneve”, gjë që pjesërisht haset edhe sot në gramtika. Sipas tij “në bazën e përkufizimit të cilësdo kategori gramatikore duhet vënë një i vetëm koncept themelor”. Në monografinë e tij Riza fillimisht paraqiste përkufizimet e konceptit mënyrë nga gramatikanë frengë, gjermanë e sovjetikë të kohës³, të cilët mënyrën e shihnin si “lloje paraqitjeje të idesë foljore” a “karakter i një trajte foljore të aftë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj procesit foljor”, ndërsa mënyrën dëftore e përshkruanin si raport të veprimit ndaj realitetit ose si pohim a mohim të një veprimi. Riza vërente theksimin e momentit subjektiv të kategorisë së mënyrës nga këta autorë, e në anën tjetër mungesën e një përkufizimi të mënyrës si “një e dhënë në vetëvehte objektive”, pra mungesën e një përkufizimi të përgjithshëm të mënyrës foljore, të cilën edhe vetë ai e sheh si një nga konceptet më abstrakte e më të vështira për t’u përkufizuar. Kritikën e Rizës ishin të lidhura me dy momente të përshkrimit të mënyrave: vështirimin e mënyrës dëftore, e për pasojë edhe të mënyrave të tjera, nisur nga koncepti i pohim-mo-

¹ Bußmann 1990: 496

² Glück 2005: 419

³ Riza 1997: 127ff.

himit, gjë që ndodhte në Gramatikën e rusishtes, e në anën tjetër vështrimin e mënyrave si shprehje e raportit të veprimit ndaj realitetit. Riza me të drejtë ishte i mendimit se koncepti i pohim-mohimit nuk ka të bëjë aspak me kategorinë e mënyrës foljore meqë nuk është dëftorja si e tillë që pohon a mohon një veprim, por pëkundrazi secila mënyrë foljore përmes pjesëzave përkatëse mohuese mund të mohojë një veprim të shprehur nga folja. Ndërsa pikën tjetër, përshkrimin e kategorisë së mënyrës si shprehje të raportit të verpimit ndaj realitetit, Riza e kundërshtonte duke e konsideruar të ngushtë konceptin realitet. Sipas tij këtu do të duhej të qëndronte koncepti **ekzistencë**, qoftë e konstatueshme qoftë e prezumueshme. Këtë ai e argumentonte me faktin se e vetmja mënyrë që shpreh realitetin është dëftorja e, për pasojë, nëse flasim për mënyrën si shprehje të raportit të veprimit ndaj realitetit, atëherë përkufizimin e mënyrave të tjera foljore e bëjmë të varur nga dëftorja. Prandaj nuk arrijmë tek një koncept i përgjithshëm dhe mjaft abstrakt që do të mundësonte përshkrimin e mënyrave foljore (përfshirë edhe atë dëftore) në mënyrë të barabartë. Pas kritikës së konceptit tradicional, Riza bënte një përkufizim të kategorisë së mënyrës si shprehje e raportit të verpimit ndaj ekzistencës. Tentimin për të arritur një shkallë abstraksioni në përshkrimin e mënyrave foljore e hasim edhe sot në studimet për mënyrat. Pra, kjo vërejtje e Rizës është në linjë të njëjtë me trajtimet e viteve të fundit të mënyrave dhe modalitetit që synojnë përkufizimin abstrakt të mënyrës foljore. Një qasje të tillë ka Peter Wunderli në modelin e tij të aktualizimit.⁴ Hulumtimet

⁴ Wunderli 1976: 1-26: Wunderli në vitet '70 duke bërë përshkrimin e lidhës së frengjishtes krijonte një model të përshkrimit të mënyrave varësisht nga tiparet e realizuara gramatikore. Wunderli vë re se paskajorja nuk bën ndonjë markim gramatikor të semantemës, ajo jep vetëm informatë leksikore; pjesorja i karakterizon format gramatikore sa i përket gjendjes “përmbushje vs. e përmbushur”; në lidhoren bëhet fiksimi i kategorisë gramatikore të vetës, ndërsa në dëftoren shtohet kategoria gramatikore e kohës, pra bëhet specifikimi sa i përket origos deiktike kohore të folësit. Këtë shprehje të ndryshme të informatave gramatikore Wunderli e quan *aktualizim*. Varësisht nga kategoritë e realizuara gramatikore, format foljore klasifikohen si vijon: paskajorja – aktualizim zero; pjesorja – aktualizim minimal; lidhorja – aktualizim i pjesshëm; dëftorja – aktualizim i plotë. Ky model – i njohur si “modeli i aktualizimit” – mundëson një përkufizim abstrakt të mënyrave të veçanta në rrafshin e “gjuhës (langue)”, ndërsa në rrafshin e “të folurit (parole)” kësaj vlere themelore i përgjigjen funksionet/ variantet e kuptimit. Format me aktualizim të plotë dhe jo të plotë Wunderli i interpreton si aspekt ekonomik të gjuhës. Përmes përdorimit të një forme me aktualizim të

e 40 viteve të fundit për mënyrat, duke tentuar të krijojnë një koncept abstrakt për mënyrën – jo përmes përshkrimit të funksioneve, e vendosin në plan të parë vlerësimin e fakticitetit, jo qëndrimin subjektiv të folësit ndaj vlefshmërisë së veprimit të verbalizuar.

Argumenti tjetër i Rizës është se mënyrat foljore mund të shprehin edhe një ekzistencë vetëm të prezumueshme, vetëm fiktive, d. m. th. jo domosdoshmërisht një realitet të konstatueshëm. Kjo e bën të vështirë pranimin e konceptit të mënyrës si shprehje të raportit të veprimit ndaj realitetit. Sipas Rizës, *“mënyrët e ndryshme të një foljeje u përgjigjen llojevet të ndryshëm të ekzistencës së fenomenit përkatës. [...] me mënyrën dëftore folësi shpreh një fenomen për ta konstatuar si efektivisht egzistues, përkundrazi me mënyrët habitore, kushtore, lidhore, dëshirore, lidhore-habitore dhe urdhërore folësi shpreh nga një fenomen për ta prezumuar si potencialisht egzistues dmth. si qëndruar në këtë apo atë raport ndaj ekzistencës efektive prkt. si lëvizës në këto apo ato rrethana drejt ekzistencës efektive”*.⁵

Në monografinë e tij Riza shfaqte edhe propozimet e tij për ndryshime në terminologji: ai ishte i mendimit se dëftorja më saktë do të duhej të quhej *mënyrë kumtore* ndërsa lidhorja *mënyrë nënrendore*. Siç vërente ai, karakter kumtues kanë edhe foljet në mënyrat e tjera, por fjalitë me folje në dëftore kanë karakter kumtues *pa asnjë cilësim kufizues* e prandaj ky karakter është kategorik në rastin e dëftores. Ndërsa riemërimin e lidhore e mbështeste në terminologjinë greke (“egklisis hypotaktike”) e latine (“modus subiunctivus”), ku këto nocione ishin stabilizuar bazuar në një kriter thjesht sintaksor: folja në mënyrën lidhore shfaqet shumicën e herave në fjali të varur, pra në fjali të nënrenditur. Përveç propozimeve për riemërim, Riza pas ndarjes së mënyrave të shqipes në dy grupe (në të parin bënte pjesë mënyra dëftore/ kumtore, ndërsa në të dytin mënyra habitore, kushtore, lidhore, dëshirore, lidhore-habitore e urdhërore) shfaqte edhe idenë e tij se mënyrat habitore dhe kushtore duhen parë si hallkë lidhëse mes dëftores dhe mënyrave të tjera jodëftore. Këtë ai e mbështeste në fak-

plotë në një kontekst specifikohet raporti kohor ndaj origos së folësit, prandaj mund të përdoren forma të paaktualizuara që i referohen formës së aktualizuar. Karakteristikë e formave me aktualizim të pjesshëm është varësia e tyre nga një element tjetër në fjali ose nga vetë origoja.

⁵ Riza 1997: 131

tin se habitorja dhe kushtorja mohohen me pjesëzën *nuk* të dëftores, ndërsa mënyrat e tjera mohohen me pjesëzën *mos*.

Riza, njësoj siç ndodh tek Standard Albanian më se një dekadë më vonë⁶, përfshinte lidhore-habitorën në grupin e mënyrave, e cila në Gramatikën e ASHSH nuk trajtohet si mënyrë e veçantë meqë kemi të bëjmë me forma të habitores të prira nga pjesëza *të* e lidhores, të cilat sipas Gramatikës për nga modaliteti anojnë kah mënyra lidhore dhe përdoren si sinonime të formave të lidhores në fjali të varura⁷. Në grupin e mënyrave të shqipes sipas Rizës bënin pjesë edhe format e pashtjelluara të foljes, të quajtura nga ai “mënyrët pavehtjore a të pashtjell(uar)a”: paskajorja, përcjellorja dhe pjesorja. Paskajores dhe përcjellores Riza ua njihte karakterin e mirëfilltë mënyror. Sipas tij argument për karakterin mënyror të paskajores ishte zëvendësimi i paskajores së vjetër me lidhoren në mbarë gjuhën shqipe e në anën tjetër “kundërzëvendësueshmëria” e lidhores me paskajoren e re në gegërishten si dhe mundësia e saj për të marrë markues të diatezës pësore (me **u** la) dhe të kohës së shkuar (me **pasë** la). Edhe karakteri mënyror i përcjellores argumentohet nga Riza me mundësinë e këmbimit të saj me mënyra të tjera foljore si dhe me mundësinë e saj për të marrë trajta të ndryshme kohore (duke **pasë** menduar) dhe të diatezës (duke **u** menduar). Ndërkaq pjesores nuk i njihej karakter i mirëfilltë mënyror meqë këto forma nuk shprehin asnjë raport të fenomenit ndaj egzistencës, e që ishte përkufizimi që Riza i bënte mënyrës foljore. Në Gramatikën normuese të gjuhës shqipe të ASHSH formave të pashtjelluara nuk u njohet karakteri mënyror. Ato ndahen në dy grupe: në të parin përfshihet pjesorja dhe format e ndërtuara mi bazë të saj (përcjellorja dhe forma e pashtjelluar mohore), ndërsa në të dytin format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *me të larë*. Paskajorja mbetet e patrajtuar përkatësisht trajtohet fare sipërfaqësisht duke përmendur vetëm se “në të folmet veriore (gege) përdoret edhe forma e tipit të pashtjelluar *me la* me vlerë paskajoreje”⁸.

Dëshiroj të përmend këtu përshkrimin e mënyrës habitore nga Riza si një shembull për thellësinë dhe karakterin gjithpërfshirës të studimeve të tij. Në gramikat e shqipes habitorja përshkruhet si më-

⁶ Newmark et al. 1977: 35

⁷ Agalliu et al. 2002: 327

⁸ Agalliu et al. 2002: 301

nyrë që përdoret për të shprehur habi ose kundërshti të folësit për veprimin e shprehur.⁹ Në studimet e tij, habitoren Riza e përkufizonte kështu: *Folësi foljen e ve në këte mënyrë për të shprehur vetëm këte rrethanë se ndodhja (përndryshja e pranuar prej tij pa asnjë tjetër cilësim kufizues) e fenomenit përkatës – është në mospajtim a kundërshtim me pritjen e tij, e se ate prandaj këjo ndodhje e çudit a habit.*¹⁰ Përshkrimi që i bën Riza habitores sjell edhe një risi në studimet për gramatikën e gjuhës shqipe: ai krahas funksionit eksklamativ të habitores (shprehjes së habisë) vërente edhe funksionin referativ të saj: *[...] folësi mund të shprehë edhe këte kuptim (jo të njëjtë me të parin) se ndodhja e fenomenit – origjinarisht është kumtuar nga një tjetër folës, të cilit prandaj edhe i lihet përgjegjësia e këtij kumtimi; - kuptim ky, të cilin na do ta quajmë: referativ*¹¹. Ky funksion i habitores është analog me atë të ligjëratës së zhdrejtë, e cila sipas Rizës riprodhohet më kënaqshëm me mënyrën habitore të funksionit referativ. Riza jepte për krahasim këto dy fjali:

Këtë punë ai e mbaruaka vetëm mbas një viti. (krhs. me ligjëratën e drejtë: Petriti tha: “Këtë punë unë do ta mbaroj mbas një viti”).

Siç vërente Wilfried Fiedler në kumtesën e tij në sesionin shkencor organizuar me rastin e rivarrimit të mbetjeve të S. Rizës në Gjakovë, në kohën kur Riza e vërente këtë fakt, ai kishte në dispozicion përshkrime të pakta gramatikore të shqipes, në të cilat nuk flitej për funksion tjetër të habitores përpos atij të shprehjes së habisë. Prandaj mund të pohohet se Riza ishte i pari që vërejti tiparin e referativitetit të mënyrës habitore, i cili është në thelb funksioni kryesor i habitores: shprehja e habisë është rezultat i referimit, i marrjes së një informate nga një burim. Referativiteti vihet në pah më vonë, kryesisht në vitet '80, nga Fiedler, Desnickaja e sidomos Friedman. Ky fakt flet për thellësinë dhe gjithpërfshirjen e studimeve gramatikore të Rizës.

Funksioni referativ i habitores, i vërejtur nga Riza, nuk është përfshirë në Gramatikën e gjuhës shqipe të ASHSH, e për më tepër ka mbetur njësoj si koncepti i tij për mënyrën thuaja i pavërejtur në gjuhësinë shqiptare ku edhe sot mbizotëron përshkrimi gjuhësor tradicio-

⁹ Agalliu et al. 2002: 318ff.

¹⁰ Riza 1997: 133

¹¹ poaty

nal. Duhet theksuar se kritika e Rizës për përkufizimin e mënyrës ndodh në të njëjtën kohë me fillet e vështirimit kritik të kësaj kategorie në gjuhësinë evropiane, çka flet për nivelin e studimeve të Rizës, lehtësisht të krahasueshme me studimet evropiane jo vetëm të kohës por edhe ato bashkëkohore. 100-vjetori i lindjes së Selman Rizës do të duhej të na jepte shkas për rishikimin e në shumë raste zbulimin shumë të vonshëm të kësaj trashëgimie të çmuar, për të ardhur në përfundimin se në shumë fusha të studimeve albanistike duhet të kthehemi e të vazhdojmë pikërisht nga pika ku i kishte sjellë këto studime ai.

Bibliografia

- Agalliu F., Angoni E., Demiraj Sh., Dhrimo A., Hysa E., Lafë E., Likaj E.: **Gramatika e gjuhës shqipe. Morfologjia**. Tiranë 2002
- Buchholz Oda, Fiedler Wilfried: **Albanische Grammatik**. Leipzig 1987
- Bussman Hadumond: **Lexikon der Sprachwissenschaft**. Stuttgart 1990
- Camaj Martin: **Albanian Grammar**. Wiesbaden 1984
- Desnickaja Agnja V.: Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen. **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 12**. Prishtinë 1987
- Friedman Victor A.: **Studies on Albanian and other Balkan Languages**. Pejë 2004
- Glück Helmut: **Metzler Lexikon Sprache. 3.**, neubearbeitete Aufl. Stuttgart 2005
- Ismajli Rexhep: **Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës**. Prishtinë 2009
- Newmark L., Hubbard Ph., Prifti P.: **Standard Albanian**. Stanford 1977
- Riza Selman: **Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore**. Vepra 2. Prishtinë 1997
- Riza Selman: **Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme**. Prishtinë 2009
- Wunderli Peter: **Modus und Tempus. Beiträge zur synchronischen und diachronischen Morphosyntax der romanischen Sprachen**. Tübingen 1976

Blertë ISMAJLI, Universität Prishtina

DER BEGRIFF *VERBMODUS* BEI SELMAN RIZA

Zusammenfassung

In der albanischen Grammatik ist noch heute eine traditionelle Moduskonzeption vorherrschend. Diese traditionelle Auffassung vom Verbmodus fand jedoch bereits in den 60er Jahren des 20. Jh. eine Kritik in Selman Rizas "Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare" (1966 verfasst, aber erst 1994 veröffentlicht). Diese Kritik bezieht sich auf den Modusbegriff, der auf eine Aufzählung der Funktionen basiert, und auf die Beschreibung des Modus als einen Ausdruck der Relation zwischen einer Handlung und der Realität. Laut Riza sollte statt dem Begriff *Realität* der Begriff *Existenz* verwendet werden, weil der einzige Modus zur Äußerung der Realität der Indikativ ist, und falls der Modus als eine Äußerung der Beziehung zwischen der Handlung und der Realität verstanden wird, dann wird die Beschreibung anderer Modi des Verbs dem Indikativ untergeordnet. Auf dieser Weise gelangt man zu keiner abstrakten Modusdefinition. Rizas Streben nach einer abstrakten Modusdefinition sowie seine Kritik über die Korrelation zwischen Modus und der Realität stehen auf derselben Linie mit Untersuchungen über den Modus und die Modalität in der europäischen Sprachwissenschaft der 2. Hälfte des 20. Jh.

Agni DIKA & Visar SHEHU, Universiteti i Prishtinës

SHFRYTËZIMI I VIZIONIT KOMPJUTERIK GJATË KATEGORIZIMIT AUTOMATIK TË OBJEKTEVE

KUD 004

Hyrje

Vizioni kompjuterik është një fushë e veçantë në shkencat kompjuterike në të cilën tentohet që të *implementohet një sistem i ngjashëm me shikimin e njeriut me qëllim të njohjes ose kategorizimit të objekteve*. Hulumtimi i paraqitur në këtë punim, bën përpjekje që të zgjidhë një problem specifik që njeriu e ka shumë të lehtë ta zgjidhë: atë të *kategorizimit automatik të objekteve*. Më specifikisht, truri i njeriut në mënyrë shumë efektive mund t'i klasifikojë objektet e shumta që përfaqësohen në një fotografi. Kështu, p.sh. në fotografinë e cila është dhënë në Fig.1, njeriu me lehtësi i dallon katrorin, rrethin, pikat etj. Por, truri i njeriut nuk kufizohet me kaq, sepse me lehtësi i përpunon dhe në mënyrë efikase i dallon edhe objektet që janë të ngjashëm me njëri tjetrin, si në rastet kur ne dallojmë se cilin person e kemi përpara, ose edhe e njohim individualisht çdo person në një album fotografik. Klasa e objekteve që njeriu mund t'i dallojë është shumë e madhe, gjatë si cilës ai i shfrytëzon tiparet specifike të tyre.

Fig.1 Objekti me dukje si fytyra e njeriut



Ky punim, nuk provon të zhvillojë një sistem i cili do të jetë në gjendje t'i klasifikojë të gjithë objektet e mundshëm. Qëllimi është që të zhvillohet një kornizë, e cila na mundëson *klasifikimin sa më të saktë, por edhe të shpejtë të një bashkësie të caktuar objektesh*.

Vizioni kompjuterik gjen aplikim të gjerë. Në mjekësi shfrytëzohet për analizën e incizimeve të trupit të njeriut dhe identifikimin e çrregullimeve, siç është kanceri. Në biometrikë gjen aplikim në identifikimin e gishtërinjve, ose njerëzve etj. Vizioni

kompjuterik përdoret dhe në edukim, *sistemet për njohje të shkrimit* (OCR – Optical Character Recognition), ose në *sistemet për kontrollimin automatik të testeve* (OMR - Optical Mark Recognition). Vitet e fundit janë bërë shumë përpjekje të *zhvillimit të sistemeve argëtuese* si dhe të sistemeve ku vizioni kompjuterik shfrytëzohet si bazë për interaksionin njeri - kompjuter.

Definimi i problemit

Aftësia e njeriut për t'i klasifikuar objektet ndihmohet shumë nga kapaciteti jonë për të mësuar dhe në këtë mënyrë për ta shfrytëzuar përvojën tonë të mëparshme në klasifikimin e objekteve që nuk i kemi parë ndonjëherë. Këtë përvojë të njeriut një sistem kompjuterik mund ta imitojë duke marrë më shumë fotografi të një objekti dhe duke i regjistruar në një bazë të të dhënave.

Fotografitë digjitale nuk janë asgjë më shumë se një varg dydimensional i pikselëve (pikave elementare), ku çdo piksel është numër i plotë që përfaqëson një ngjyrë. Problemi i parë që duhet të zgjidhet është gjetja e mënyrave për të ekstraktuar objektet nga një fotografi. Më vonë, nga çdo objekt duhet të veçohen tipare karakteristike me qëllim që ai të krahasohet me grumbullin e objekteve të përfshira në një bazë me objekte dhe ta dallojë tipin e tij. Ka më shumë metoda që mundësojnë veçimin e tipareve specifike të një objekti. Ndër më të përdorurat janë: detektimi i këndeve, detektimi i kufijve, detektimi i ngjyrës, detektimi i tipareve tjera gjeometrike brenda objektit etj.

Detektimi i objekteve paraqet dallimin e një objekti specifik nga një numër objektësh në një fotografi. Sidoqoftë, që të dallohet një objekt, sistemi duhet të ketë informata për tiparet që e specifikojnë atë objekt, për dallim nga objektet e tjera. Ekzistojnë mjaft algoritme që mundësojnë një gjë të tillë, por në këtë hulumtim shqyrtohen dy algoritme që përdoren më shpesh:

- HAAR klasifikuesit [1] dhe
- detektimi i objekteve sipas SIFT tipareve [2].

Një veçori e klasifikuesve HAAR është shpejtësia e madhe e detektimit të objekteve specifike dhe saktësia e klasifikimit. Kjo metodë përdoret shumë në detektimin e fytyrave nga një fotografi dhe rezulton me saktësi prej 100%. Dobësi e këtij algoritmi është numri i madh i objekteve të tjera që trajton si fytyra, rreth 40%. Në Fig.1 e kemi një

rast ku një objekt është detektuar si fytyrë njeriu për shkak të disa tipareve të ngjashme që i ka me fytyrën e njeriut.

Sidoqoftë, sado që këta klasifikues janë efikasë në detektimin e objektit, një ndër problemet më të mëdha të tyre paraqitet në *fazën e trajnimit të klasifikuesit*. Që të trajnohet një klasifikues, duhet të shfrytëzohet një numër shumë i madh i fotografive pozitive (fotografi ku paraqitet objekti) dhe fotografive negative (fotografi, ku nuk paraqitet). Në rastin e klasifikuesit të fytyrave, janë shfrytëzuar mbi 5000 fotografi pozitive dhe po aq negative [3].

Ky kufizim i HAAR klasifikuesve e pamundëson përdorimin e tyre në raste kur duam të detektojmë objekte të klasave të ndryshme. Gjithashtu kjo metodë është e ndijshme kur tentohet të detektohen objekte që kanë madhësi ose rotacione të ndryshme. Klasifikuesit HAAR nuk janë në gjendje të identifikojnë objektin e gjetur. P.sh., nëse gjendet një fytyrë, nuk mund të tregohet se kush është personi me atë fytyrë. Për ta realizuar këtë duhen metoda të tjera, ndër të cilat më të përdorura janë: PCA (Principal Component Analysis) [4], LDA (Linear Discriminant Analysis) [5], rrjetet neurale etj.

Zgjidhje e këtyre problemeve është dhënë në punimin e publikuar nga Lowe [2]. Në te ai propozon një qasje e cila e simulon vizionin e njeriut, ku tentohet që nga një objekt të njihen tiparet specifike të tij, tipare të cilat do të shfrytëzohen më vonë për njohjen e plotë të objektit. Transformimet në objektin në fjalë, si p.sh., madhësia, rotacioni ose ndryshimet në kualitetin dhe ndriçimin e objektit nuk kanë efekt të madh në detektimin e tij. Kjo është edhe arsyeja për emërimin e tyre si SIFT përshkrues (nga ang. Scale Invariant Feature Transform).

Kjo metodë mund të ndahet në disa faza: gjetja e tipareve, eliminimi i tipareve të parëndësishme dhe indeksimi / shfrytëzimi i tipareve të gjetura për detektim të objektit.

Qëllimi i këtij algoritmi është që të gjinden tipare stabile, që nuk ndryshojnë edhe nëse objekti i fotografuar ka pësuar transformime në madhësi ose rotacion. Për këtë qëllim përdoret funksioni i ashtuquajtur Dallimi Gaussian, përmes së cilit gjenerohet Piramide Gausiane. Një fotografi mund të trajtohet si një matricë $R \times M$, ku R është numri i rreshtave dhe M është numri i kolonave dhe ku çdo element i matricës paraqet një *piksel*.

Niveli i parë i Piramidës Gausiane paraqet fotografinë aktuale, pa as-

një transformim në shkallë si në hapësirë. Niveli i ardhshëm i piramidës kalkullohet me metodën që përshkruhet me kodin e dhënë në Fig.2.

Fig. 2 Kodi për kalkulim të nivelit vijues në Piramidën Gausiane

Ajo që fitohet paraqet një fotografi të mjegulluar të paraprakes, ku çdo piksel i ri është mesatarja e pikselëve në një dritare 4x4, e krahasuar me fotografinë origjinale. Shembulli i dy niveleve të kësaj piramide mund të shihet në Fig.3, ku, për ta ilustruar efektin e mjegullimit, është përdorur dritarja me dimension 10x10.



Fig. 3 Dy nivele të një fotografie nga Piramida Gausiane

Për çdo fotografi, procesi i dhënë më sipër përsëritet deri në disa nivele. Kurse diferencat mes çdo dy niveleve llogariten duke e shfrytëzuar kodin e dhënë në Fig.4 dhe si të tilla regjistrohen si një fotografi e re.

```
function GetNextLevel(old_image)
Image new_image;
for i = 0 to R
  for j = 0 to C
    new_image(i,j) = average(old_image_pixels(window(5,5)))
  end for
end for
blured_images.add(new_image)
end function
```


Fig. 4 Kodi përmes së cilit llogariten diferencat mes dy niveleve

Sipas kësaj metode, nëse një fotografi mjegullohet 5 herë, do të kemi

```
function CalculateDifference(Level)
Image image1 = blured_images(level-1)
Image image2 = blured_images(level)
for i = 0 to R
  for j = 0 to C
    image_difference(i,j) = image1(i,j) - image2(i,j)
  end for
end for
end function
```

gjithsej 4 fotografi (matrica RxM) të cilat do ta paraqesin diferencën midis niveleve të njëpasnjëshme (rezultati p.sh. mund të duket si në Fig. 5).

Fig. 5 Diferencat mes nivelit të parë dhe dytë



Ky proces vazhdon të përsëritet me fotografi të përgjysmuara të fotografisë origjinale derisa të jetë e nevojshme. Pas kësaj detektohen vlerat ekstreme (minimale dhe maksimale) ku çdo piksel krahasohet me 8 pikselët fqinjë nga fotografia ku gjendet ai piksel, 9 pikselë nga fotografia në nivelin paraprak dhe 9 nga fotografia në nivelin pasues, gjë që rezulton në gjithsej 26 pikselë që krahasohen. *Pikseli i tillë merret si tipar vetëm nëse është më i madhi ose më i vogli nga të gjithë pikselët e krahasuar.* Numri i tipareve të fituar është mjaft i madh. Por, ne e përdorim *metodën e detektimit të tipareve devijuese* (outlier detection) [6] për t'i eliminuar tiparet që mendojmë se nuk janë interesante. Të gjithë këto tipare regjistrohen në një bazë të të dhënave, ku ruhen edhe të dhëna tjera që ndërlidhen me atë objekt.

Për çdo fotografi të re që do të gjendet përsëritet procesi i detektimit të tipareve. Pasi të paraqiten tiparet në rrafshin Euklidian, mund të krahasohen distancat ndërmjet tipareve, ashtu që të shihet nëse bëhet fjalë për tipare të njëjta. *Sa më i madh të jetë numri i tipareve të njëjta të detektuara, aq më të mëdha janë gjasat që dy objektet të jenë të njëjta.*

Rezultatet e fituara në rrugë eksperimentale

Për ta testuar algoritmin, gjatë procesit të eksperimentimit e kemi përdorur një fotografi me disa variacione të transformuara të saj, ashtu si shihet në Fig. 6.

				
Fotografia origjinale	Fotografia e rrotulluar për 750	Fotografia e dëmtuar	Fotografia e përgjysmuar	Fotografi tjetër

Fig.6 Fotografitë e shfrytëzuara gjatë eksperimentimit

Me qëllim të përfshirjes në procesin eksperimentues dhe vërtetimit të dështimit të njohjes së objekteve që nuk i përngjajnë objektit që kërkohet, në kolonën e fundit të tabelës shihet edhe një fotografi e cila nuk ka të bëjë aspak me katër fotografitë tjera.

Tiparet e fituara në procesin e ekstraktimit regjistrohen në bazën e të dhënave. Pas testimeve të bëra, rezultatet që fitohen janë dhënë në tabelën e cila shihet në Fig.7.

	Fotografia origjinale	Fotografia e përgjysmuar	Fotografia e rrotulluar për 75°	Fotografia e dëmtuar	Fotografi tjetër
Tiparet e krahasuara (gjithsej / gabime)	1328 / 0	307 / 6	900 / 5	267 / 36	13/13

Fig.7 Rezultatet e fituara në rrugë eksperimentale

Nga këto rezultate shihet qartë efikasiteti i metodës së prekantuar, meqë në katër rastet e para, kur kemi të bëjmë me fotografinë e njëjtë, por të rrotulluar për një kënd të caktuar, ose të dëmtuar me vija të shumta (figura e tretë), gabimet janë të vogla, gjë që nuk ndodh me fotografinë e fundit. Me qëllim të paraqitjes vizuale të 20% të tipareve të përbashkëta të dy fotografive, të cilat janë rrotulluar për kënde të caktuara, në Fig.8 tiparet janë lidhur mes veti me vijat përkatëse.




Fig. 8 Vizualizimi i tipareve të përbashkëta përmes lidhjes së tyre me vija

Mundësi të tjera

Detektorët SIFT paraqesin një metodë shumë efikase për detektimin e objekteve. Si hapësirë e mëtejshme zhvillimi mund të konsiderohet *optimizimi i gjetjes së tipareve përshkruese*, duke përdorur meto-

da paralele të ekzekutimit. Edhe kërkimi i tipareve të ngjashme në rrafshin Euklidian, mund të përmirësohet duke shfrytëzuar *algoritmet për kërkim të fqinjëve më të afërt* (Nearest Neighbors). Këtu mendojmë se mjaft efektive janë metodat e indeksimit, si *pemët KD* [7], ose *hash funksionet* e tipit LSH (Location Sensitive Hashing) [8].

Algoritmi i shfrytëzuar *mund të përmirësojë saktësinë e detektimit*, nëse shfrytëzohen më shumë fotografi për objektin e njëjtë. Kjo mund ta rrisë mundësinë e detektimit të objekteve edhe nëse këndi i fotografimit është i ndryshëm.

Bibliografia

- [1]. *Rapid Object Detection using a Boosted Cascade of Simple Features*. **Paul Viola, Michael J. Jones**. s.l. : IEEE CVPR, 2001.
- [2]. *Object recognition from local scale-invariant features*. **Lowe, David G.** Corfu, Greece: International Conference on Computer Vision, 1999.
- [3]. *An Empirical Analysis of Boosting Algorithms for Rapid Objects With an Extended Set of Haar-like Features*. **Alexander Kuranov, Rainer Lienhart, Vadim Pisarevsky**. 2002, Intel Technical Report MRL-TR-July02-01.
- [4]. *Eigenfaces for Recognition*. **M. Turk, A. Pentland**. 1, s.l.: Journal of Cognitive Neuroscience, 1991, Vol. 3.
- [5]. *Discriminant Analysis for Recognition of Human Face Images*. **K. Etemad, R. Chellappa**. 8, s.l.: Journal of the Optical Society of America A, 1997, Vol. 14.
- [6]. **Barnett, V. and Lewis, T.** *Outliers in Statistical Data, 3rd Edition*. s.l.: John Wiley & Sons.
- [7]. *trees, Worst-case analysis for region and partial region searches in multidimensional binary search trees and balanced quad*. **Lee, D. T. and Wong, C. K.** s.l.: Acta Informatica, 1977.
- [8]. *Near-Optimal Hashing Algorithms for Near Neighbor Problem in High Dimensions*. **Indyk, Alexandr Andoniw Piotr**. s.l.: Proceedings of the Symposium on Foundations of Computer Science, 2006.
- [9]. *Using real time computer vision algorithms in automatic attendance management systems*. **Shehu, V. and Dika, A.** Cavtat, Croatia: Information Technology Interfaces (ITI), 2010.

PËRURIME

Rexhep ISMAJLI

KOSOVA, VËSHTRIM MONOGRAFIK¹

KUD 908(496.51)

Libri që po përurojmë sot në shtëpinë e re të hapur pak muaj më parë është fryt i një pune intensive kolektive të zhvilluar me vullnet e përkushtim në mjediset e pamjaftueshme për punë të ish ndërtesës së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Motivi që kishte shtyrë nismëtarët për hartimin e një projekti të këtillë ishte i qartë. Në dy dekadat e fundit, paralelisht me rritjen e qëndrestarisë dhe të luftës për çlirim, me çlirimin dhe luftën për pavarësim të vendit, botimet për Kosovën, për aspekte të ndryshme të jetës, të së tashmes e të shkuarës, për kulturën e për historinë, për përpjekjet për liri, për politikën, për zhvillimin ekonomik e vështirësitë që po ndesh ai, për raportet brenda vendit dhe me fqinjët, për impaktin ndërkombëtar të Kosovës, në vend dhe në botë kanë qenë më të shumta se kurrë ndonjëherë më parë. Në vend këto botime kanë ndjekur interesat e zhvillimeve të brendshme, nevojat për ndriçime të segmenteve të ndryshme të së sotmes dhe të së kaluarës, ndërsa në botë këto botime kanë ndjekur lakoren e interesave dhe të interesimeve të mjedisëve përkatëse. Mund të thuhet se ka pasur shumë botime të përshkuara me mirëkuptim e simpati për vendin që po kalonte nëpër një periudhë të vështirë të pavarësimit, botime të përqendruara në aspektet më aktuale që e shpjegojnë këtë dalje të vendit në arenën ndërkombëtare sipas perspektivave përkatëse. Ka pasur dhe botime jo të pakta serbe me tone të theksuara propagandistike dhe negative për synimet dhe realizimin e pavarësisë. Megjithatë, në opinionin hetohej nevoja për botime të natyrës enciklopedike për Kosovën, ku do të përfshiheshin të dhënat më të rëndësishme dhe të përgjithshme për aspektet e ndryshme të realitetit, të së kaluarës, të jetës dhe të zhvillimeve në Kosovë, sa më të plota, mundësisht të verifikuara dhe të pangarkuara me barrën e propagandës. Kjo nevojë erdhi e u shtua me pavarësimin e shtetit të Kosovës, ndërkohë që të dhëna për vendin mund të gjendeshin të pasistemuara dhe të shpërndara në anë të ndryshme, apo për një pjesë të përfshira në botime të mëhershme me të tjera horizonte. Mungesa e një enciklopedie të Kosovës apo e ndonjë qendre, që do të merrej me vjeljen dhe sistemimin e informatave, krijonte dhe vazhdon të krijojë vështirësi për gjetjen e të dhënave dhe linte hapësirë për interpretime të ndryshme. Në gamën në rritje të botimeve për Kosovën, ndër to dhe të atilla që paraqesin vlera e interes për dijen, zëri që vjen nga Kosova dëgjohet kryesisht përmes individëve, studiuesve të veçantë.

Në vitet '70-'80 të shekullit XX ka pasur disa botime monografike për Kosovën, por gjithmonë në horizontin e shtetit dhe të sistemit që i përdorte ato për të legjitimuar veten në këtë vend. Ka pasur madje një redaksi për Kosovën të Enciklopedisë së Jugosllavisë, që ka

¹ Fjalë e mbajtur me rastin e përrurimit të veprës në mjediset e Akademisë në Prishtinë më 30 qershor 2011.

vepruar për rreth një dekadë. Sot nga ajo punë gati dhjetëvjeçare e ekipeve dhe institucionit të veçantë të Redaksisë për Kosovën (me zyra dhe shërbime) nuk kemi trashëguar asgjë nga arkivi, madje as alfabetarin e thjeshtë. Natyrisht, botimi i vëllimit të parë shqip dhe botimi i plotë serbokroatisht i asaj Enciklopedie nuk mund të shihen dhe nuk janë në pajtim me kërkesat, pritjet, horizontin e njohjeve, realitetin e vendit, madje as për kohën e atëhershme, po të kemi parasysh zhvillimet tashmë të bëra publike që kanë ndodhur rreth saj dhe hartimit të teksteve themelore për shqiptarët. Botimi i dytë i Enciklopedisë së Jugosllavisë, i bërë me marrëveshje të 8 njësive federale, nuk hiqte dorë nga botimi i parë, ku një nga parimet prijës kishte qenë synimi që aty të “bëhet fjalë për gjithë popujt sllavë të Jugut”, për njohjen se ku qëndron “shpëtimi i popujve sllavë të Jugut”, që ajo të jetë “pasqyrë e kulturës dhe e qytetërimit të të gjithë popujve sllavë të jugut”, etj., po vetëm shtonte se botimi i ri “do të shënonte të gjitha ndërrimet qenësore të bëra në këtë ndërkohë”, përfshirë dhe shtesat për kombësitë (të gjitha citimet nga botimi shqip 1984). Edhe kur fliste për Kosovën dhe popullin e saj, apo për shqiptarët, kjo Enciklopedi, më parë se afirmimin e tyre në botë, siç pretendonte dhe bënte për shtetin jugosllav dhe popujt sllavë, bënte legjitimimin e strukturës shtetërore. Ndërkohë numri i botimeve me tone të pafshehura propagandistike serbe ka qenë i madh. Nevoja për burime të dhënash sa më pak të ngarkuara me aspekte të atilla ishte dhe vazhdon të jetë vetëfolëse.

Për t’iu përgjigjur së paku pjesërisht dhe përkohësisht nevojave të tilla, pa mëtuar zëvendësimin e botimeve tanimë shumë të nevojshme të natyrës enciklopedike, megjithë vështirësitë për vjeljen e shpejtë të të dhënave, pa staf të krijuar për të tilla botime, ASHAK vendosi t’i hynte hartimit të një teksti me vështtrim, natyrë dhe synime monografike për Kosovën, ku të përmbledheshin të dhëna themelore sa më të sakta që të jetë e mundur në këto rrethana për aspektet e ndryshme të jetës. Botimi konkret qysh në fillim u mendua i ndërtuar sipas fushave, çka do të thotë se mbisundonte synimi monografik. Nga ana tjetër, ishte vendosur që tekste për fushat e ndryshme të ishin të përmbledhura dhe sintetizuese, në mënyrë që ta lehtësonin përdorimin dhe leximin e shpejtë. Duke pasur parasysh të gjitha këto u vendos që botimi të quhej dhe të trajtohej si vështtrim monografik. Kjo do të thotë se botimi duhej të kishte natyrë shkencore, sa u përket të dhënave dhe interpretimit të tyre, informative dhe të integruar në tërësinë dhe enciklopedike jo argumentuese, sa i përket paraqitjes. Krijimi i bazës së të dhënave jo trallë e jo për pak fusha dilte një çështje me peshë, ndërsa nevoja për t’i dhënë lexuesit një botim që do të përmbushte në një shkallë sado të vogël mungesën e botimeve enciklopedike erdhi e u bë njësoj e rëndësishme për hartimin e botimit. Kështu doli i domosdoshëm kombinimi i prosedevë të ndryshëm për hartimin e monografisë: vështtrimi shkencor si themel për të dhënat dhe interpretimin e tyre, në një anë, dhe paraqitja shpesh publicistike, ndonjëherë me natyrë popullarizuese, në anën tjetër. Jo çdo herë baraspesha ishte e lehtë, sepse e tërë puna bëhej paralelisht në disa binarë: të mbledhjes së materialeve, të hartimit, të ripunimit, të plotësimit me çështje të reja dhe të redaktimit në tri shkallë.

Kështu, në bërthamën e saj, u ndërtua ideja për një vështtrim që do të përfshinte të dhënat më të përgjithshme nga të gjitha fushat, duke filluar me fushat ku ka më pak interpretime, si pozita gjeografike, reliefi, klima, flora, fauna, popullsia, vendbanimet, qytetet dhe arkitektura e tyre, zejet, për të vazhduar pastaj me çështje për të cilat interpretimi ka rëndësi, si: historia e lashtë, mesjeta, koha e re dhe koha më e re. Ekonomia me burimet, transicionin ekonomik, tregun financiar, tregun e punës, etj. ishte një nga aspektet ku duhet të ngulej këmbë, paçka se mungesa e shënimeve të përgatitura nga

institucionet e specializuara ishte vetëfolëse. Fushat e arsimit me historinë e tij, arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm dhe arsimit të lartë, të shëndetësisë me historinë e mjekësisë, kujdesin mjekësor parësor, dytësor e tretësor, të institucioneve të shkencës, pastaj të gjuhëve dhe kulturave me aspektet e tyre të kulturës popullore, të letërsisë, të muzikës, të arteve figurative, të teatrit, të filmit zunë një vend të dukshëm në këtë punë. Një përfshirje përkatëse e zhvillimeve politike e shoqërore të periudhës së autonomisë, pastaj të viteve nëntëdhjetë të shekullit XX dhe pas vitit 1999 ishte po ashtu e nevojshme. Ishte e qartë se një punë e tillë me pretendimet që u theksuan nuk mund të bëhej nga një ekip i vogël njerëzish, prandaj u pa e nevojshme të angazhoheshin ekspertë të fushave të ndryshme, në mënyrë që pastaj redaksitë përkatëse të mund ta bënin punën e tyre. Aspekti shkencor i trajtimit u pa e nevojshme t'u lihej në dorë ekspertëve përkatës, sepse thjesht nuk kishim ekupe të parapërgatitura për një punë të tillë. Atyre iu dhanë kontura e botimit, orientimet parimore, ndërsa përzgjedhja e materies për paraqitje dhe paraqitja duhej të bëheshin në thelb nga ata. Ata morën për detyrë të hartonin tekstin përkatës duke iu pëmbajtur kërkesave të tyre dhe disa kërkesave themelore të shtruar nga Këshilli bashkërendues, ndërsa Redaksitë do të bënin harmonizimin eventual të teksteve në shkallën e të mundshmes, gjithë duke ruajtur bazën shkencore dhe autorësinë e një paraqitjeje të këtillë. Për arsye të këtij rendi Redaksia vendosi që nga tekstet të hiqeshin referimet bibliografike, të evitoheshin citimet e të zvogëloheshin vështirësitë e leximit të teksteve. Meqë ishte fjala për autorë nga më të njohurit në fushat e tyre përkatëse, Redaksia këtu kënaqej me paraqitjen e tyre. Në fund të veprës Redaksia vendosi bibliografinë e nevojshme për tekstet përkatëse të plotësuar me njësi të përgjithshme e të përzgjedhura, në mënyrë që lexuesi të jetë në gjendje të orientohet më mirë. Për ta bërë tërë punën në 69 zëra u angazhuan 56 autorë, disa prej të cilëve u desh të hartonin nga dy njësi (vetëm dy nga tri njësi).

Ideja për hartimin e një vepre të këtillë lindi në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në pjesën e dytë të vitit 2007 dhe propozimi i Grupit nismëtar ndërseksional për tërë këtë punë mori formë zyrtare në fund të vitit 2007, ndërsa në vijim, me vendime të Kuvendit të ASHAK, pas shqyrtimit të projektit nëpër të gjitha seksionet, nisma u shndërrua në projekt afatmesëm të Akademisë. Këshilli bashkërendues i përbërë nga Mehmet Kraja, Hivzi Islami, Feriz Krasniqi dhe Rexhep Ferri, hartoi konceptin e përgjithshëm të veprës, propozoi përbërjen e redaksisë dhe përcaktoi parametrat e financimit. Në përbërjen e redaksisë u përfshinë anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të saj, në varësi nga fushat përkatëse, e këta janë: Hivzi Islami për pjesën e **gjeografisë**, Fehmi Rexhepi për **historinë**, Esat Stavileci për **zhvillimet politike dhe shoqërore**, Isa Mustafa për **ekonominë**, Jashar Rexhepagiq për **arsimin**, Isuf Dedushaj për **shëndetësinë**, Mehmet Kraja për **kulturën** dhe Afrim Spahiu për **fotografinë**.

Punën përgatitore: përzgjedhjen e autorëve, kontaktet me secilin prej tyre, Këshilli bashkërendues dhe Redaksia e kanë kryer brenda vitit 2008, ndërsa brenda vitit 2009 ishte mblodhur pjesa më e madhe e materialeve të kërkuara në formë të hartimit paraprak. Vetëm pastaj u emëruan Kryeredaktorët Rexhep Ismajli e Mehmet Kraja, të cilët duhej të punonin bashkë me Redaksitë mbi materialet që ishin në dispozicion dhe të përgatitura sipas parime të caktuara nga ekupe të tjera. Kryeredaktorët, megjithatë, kërkuar që ndërkohë të shtoheshin zëra në disa fusha, çka u desh të bëhej paralelisht me procesin e redaktimit të shkallës së dytë të bërë nga Feriz Krasniqi, Pajazit Nushi, Hivzi Islami, Eqrem Basha dhe Mehmet Kraja. Koha në

dispozicion ishte e shkurtë. Po të kishte ende kohë mund të jetë që numri i zërave do të rritej, ashtu si sasia e disa prej njësive. Në mesin e vitit 2010 Redaksia kishte në dorë tekstin e plotë.

Koha e shkurtër dhe rrethanat në të cilat u realizua i tërë ky projekt, pa infrastrukturë të nevojshme për punë të këtilla, jo çdo herë lejonin punë komode në të gjitha instancat e me renditjen e nevojshme. Shpesh bëhej e domosdoshme të punohej paralelisht ose në mënyrë të kryqëzuar në nivele e instanca të ndryshme. Kjo përvojë e parë në punë të këtij lloji u kurorëzua me një rezultat që në të ardhmen duhet të përmirësohet, por mbi të gjitha e theksoi edhe më shumë nevojën e ngritjes së njësive institucionale që do të merrej në mënyrë sistematike me krijimin e veprave të këtij lloji, të monografive komplekse, të fjalorëve enciklopedikë e të enciklopedive. Receptimi i këtij botimi nga lexuesit do t'ua bëjë të mundshme Redaksisë dhe instancave të tjera që u morën me këtë punë ta shohin me distancë rezultatin e këtij angazhimi intensiv, suksesin, por edhe mangësitë, nevojën për thellime të mëtejme dhe, të shpresojmë, të shërbejë si nxitje për vazhdim të punës me begatim të përmbajtjeve e zgjerim të veprimtarisë. Në këtë hapësirë kohore Redaksia është mjaftuar me trajtimin e përmbajtjeve për të cilat ka mundur të siguronte bashkëpunim cilësor, në botimet eventuale pastaj mund të shtohen zërat. Natyrisht, është rendi të krijohet së pari infrastruktura.

Puna e mundimshme teknike mori jo pak energji. Gjetja, krijimi dhe procedimi teknik i materialit cilësor e të gjerë fotografik mori një periudhë të gjatë kohe të punës. Të shpresojmë se edhe kjo vepër do të shërbejë si nxitje po ashtu që në të ardhmen të krijohet një qendër dokumentacioni me informacione më të sistemuara për punë të këtij lloji. Kjo mund dhe duhet të bëhet në Qendrën Leksikografike-Enciklopedike tashmë të themeluar brenda ASHAK, funksionalizimi i së cilës varet nga mbështetja që do t'i ofrojë Qeveria dhe shoqëria e Kosovës. Një nga projektet e para afatmesme të saj do të jetë hartimi i Fjalorit Enciklopedik e pastaj i Enciklopedisë së Kosovës, për të cilën tashmë kanë lindur nismat.

Më lejoni tani të përmend autorët dhe fushat përkatëse të tërë kësaj pune:

Në pjesën e gjeografisë me redaktor Hivzi Islamin, njësitet **Pozita gjeografike, Karakteristikat gjeologjike dhe Karakteristikat morfologjike e pedologjike** i ka punuar Vahdet Pruthi; **Ujërat, Klima dhe Vlerat e trashëgimisë natyrore** – Ruzhdi Pllana; njësinë **Fauna** e ka hartuar Esad Dauti, ndërsa njësitet **Flora** dhe **Vegjetacioni** Feriz Krasniqi; njësinë **Mjedisi** e ka hartuar Zeqir Veselaj, ndërsa **Tipet dhe funksionet e vendbanimeve** Ibrahim Ramadani, **Qytetet** – Jusuf Osmani; njësitet **Popullsia** dhe **Diaspora** janë hartuar nga Hivzi Islami dhe **Femra** nga Mimoza Dushi.

Në pjesën e historisë, të redaktuar nga Fehmi Rexhepi, njësinë **Parahistoria dhe antika** e ka hartuar Edi Shukriu, ndërsa njësinë **Mesjeta** Pëllumb Xhufi; njësinë **Pushtimi osman** e ka hartuar Ferid Duka, ndërsa njësitet **Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1978-1881)** dhe **Lëvizja kombëtare 1908–1912** – Jusuf Bajraktari; **Zhvillimet pas Lidhjes së Prizrenit** i ka paraqitur Kristaq Prifti, kurse periudhën **Nën sundimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë** Lush Culaj; Fehmi Rexhepi i ka hartuar njësitet **Në Luftën e Dytë Botërore** dhe **Lëvizja çlirimtare dhe lufta për pavarësi**. Me këtë pjesë të ndjeshme janë marrë 7 historianë tashmë të dëshmuar me punën e tyre në një rrafsh më të gjerë dhe para publikut kanë sjellë njohjet për të kaluarën e Kosovës që ata i kanë konsideruar të nevojshme në suazat e këtij botimi.

Në pjesën për zhvillimet politiko-juridike të redaktuar nga Esat Stavileci, njësitë **Historia politike e çështjes dhe Shtet sovran dhe i pavarur** janë hartuar nga Esat Stavileci, ndërsa njësitë **Historia kushtetuese dhe Administrimi ndërkombëtar** nga Arsim Bajrami, të dy autorë të njohur në fushat përkatëse.

Në pjesën për Ekonominë, të redaktuar nga Isa Mustafa, **Zhvillimi ekonomik deri në vitin 1999** është hartuar po nga Isa Mustafa, **Ecuritë sipas degëve ekonomike** nga Isa Mustafa & Behxhet Brajshori & Minir Dushi, **Spektori privat dhe publik** nga Petrit Gashi e Besnik Krasniqi, **Spektori financiar** nga Gazmend Luboteni e Gazmend Toçi, **Tregu i punës dhe emigracioni** nga Avdullah Hoti, **Bujqësia, blegtoria, pylltaria** nga Latif Susuri e Skender Kaçi, ndërsa **Faktorët e rritjes ekonomike** nga Muhamet Mustafa. Në këtë fushë ndjehej shumë mungesa e të dhënave që prodhojnë institucionet e specializuara. Ekipi hartues është përzgjedhur jo pa qëllim nga ata ekspertë dhe studiues të rrjedhave ekonomike që jo vetëm i njohin rrjedhat, por edhe marrin pjesë në zhvillimet aktuale apo në projektimet për të ardhmen.

Në fushën e Arsimit dhe shkencës, të redaktuar nga i ndjeri Jashar Rexhepagiq, njësinë **Arsimi deri në vitin 1945** e ka hartuar Abdullah Vokrri, njësinë **Edukimi parashkollor** – Halim Hyseni, **Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm** – Bajram Shatri, njësitë **Arsimi i lartë dhe Arsimi i të rriturve** Hajrullah Koliqi dhe **Zhvillimet në fushën e shkencës** Rexhep Ismajli.

Pjesa për Shëndetësinë është redaktuar nga Isuf Dedushaj, ndërsa njësinë **Historia e mjekësisë** e ka hartuar ai vetë; **Kujdesi parësor shëndetësor** është hartuar nga Valdet Hashani, **Kujdesi dytësor shëndetësor** nga Bedri Zahiti, **Kujdesi tretësor shëndetësor** nga Avdyl Krasniqi dhe **Shëndetësia publike dhe qendrat rehabilituese** nga Naser Ramadani.

Në pjesën **Kultura**, të redaktuar nga Mehmet Kraja, njësinë **Trashëgimia kulturore** e ka hartuar Edi Shukriu, njësinë **Arkitektura popullore** – Mark Krasniqi, **Arkitektura e qyteteve** – Emin Riza, **Etnografia dhe Zejet** – Shpresa Siqeca, **Letërsia popullore** – Sadri Fetiu, **Etnomuzikologjia** – Rexhep Munishi, **Gjuhët** – Rexhep Ismajli, **Letërsia shqipe** – Ali Aliu, **Letërsia në gjuhët sllave** – Ismet Markoviq-Plavnik, **Letërsia turke** – Irfan Morina, **Muzika** – Zeqirja Ballata dhe Engjëll Berisha, **Artet pamore** – i ndjeri Mustafa Ferizi, **Teatri** – Fadil Hysaj. Për kinematografinë, librin dhe bibliotekat u kërkua ndihma e drejtuesve të institucioneve përkatëse: **Kinematografia** – Gani Mehmetaj, **Libri dhe bibliotekat** – Sali Bashota, ndërsa për informimin, religjionin e sportin prapë ndihma e ekspertëve: **Informimi** – Ibrahim Berisha, **Religjioni dhe toleranca fetare** – Pajazit Nushi dhe Anton K. Berishaj, ndërsa **Sporti** nga Xhavit Kajtazi.

Bibliografinë e ka hartuar Rexhep Ismajli duke shtuar njësitë e me autorëve të ndihmesave. Kështu ajo pasqyron bibliografinë e të gjitha pjesëve bashkë, por përmban edhe shumë njësi të tjera për Kosovën dhe çështjet që lidhen me të, për shkak se të tillat thjesht mungojnë.

Për materialet fotografike është kujdesur redaktori Afrim Spahiu, ndërsa për hartat është kujdesur Ismail Gagica. Lektor: Shefqet Riza; Dizajni: Edi Agagjyshi

Forma e tashme e botimit, sa i përket konceptimit, do të ruhet. Redaksia është e vetëdijshme se në këtë punë të vëllimshme dhe profilesh kaq të ndryshme nuk është e mundur të mos ketë mungesa, lëshime e gabime të paqëllimshme. Disa prej tyre do të ndreqeshin po të kishim pasur në dispozicion shërbim të korrekturës dhe staf tjetër të specializuar për botime të tilla.

Në fund fare dhe një falënderim: Mehmet Kraja dhe unë, në cilësinë e Kryeredaktorëve e ndjejmë të nevojshme t'u shprehim falënderim anëtarëve të Këshillit nismëtar, Redaksisë, Redaktorëve, Autorëve të teksteve, të gjithë bashkëpunëtorëve, Kryesisë së ASHAK-ut dhe stafit teknik të Akademisë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e sinqertë, pa të cilin kjo punë nuk mund të realizohej. Dua t'i shpreh falënderim dhe z. Imer Goxhufi nga shtypshkronja Focus-Print Shkup-Prishtinë, i cili në asnjë moment nuk ka ngurruar ta ofrojë ndihmën e tij maksimale që botimi të merrte formën që ka.

PËRURIMI I VEPRËS SË NORBERT JOKL:
STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE
FJALËFORMIMIN SHQIP

Besim BOKSHI, ASHAK, Prishtinë

FJALA E HAPJES SË PËRURIMIT TË VEPRËS SË JOKLIT: *STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFOMIMIN SHQIP*

Zonja e zotërinj të nderuar, mirë se erdhët në përurimin e veprës së Norbert Joklit. Falënderoj akademik Kolec Topallin e profesor Seit Mansakun që erdhën nga Tirana për të marrë pjesë në këtë përurim.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në projektin e saj për të sjellë në gjuhën shqipe veprat e albanologëve më të njohur të jashtëm të traditës e të sotëm, ka publikuar tërë veprën albanologjike të W. Cimochoowskit, të F. Miclosichit, të H. Pedersenit e të E. Hampit dhe dy vepra të W. Fiedlerit. Në këtë synim u realizua edhe ky vëllim i parë nga vepra e gjerë albanologjike e Norbert Joklit: *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip* me përkujdesjen e përkushtuar të akademik Rexhep Ismajlit, i cili paralelisht e ka organizuar punën e përkthimit të studimeve të tjera të këtij autori. Me këtë veprimtari Akademia shpreh respektin e saj ndaj kontributit të këtyre studiuesve në zhvillimin e mendimit shkencor për shqipen dhe u ofron ndihmë studiuesve tanë të rinj të shqipes, duke ua sjellë të përmbledhura trajtesat e këtyre albanologëve të publikuara nëpër revistat shkencore të kohës, që është vështirë të gjenden.

Pasi ka shënuar se “vija kryesore e etimologjisë shqipe deri në kohën e Luftës së Dytë Botërore karakterizohet nga emrat Miklosich – Gustav Meyer – Pedersen - Jokl”, Eqrem Çabej i ka veçuar studimet etimologjike të profesorit të tij të çmuar, duke vlerësuar se “i pajisur me bagazhin e elementeve të reja dhe duke i shikuar studimet gjuhësore shqiptare në lidhje më të gjerë, Norbert Jokli në ditët tona e ka zgjeruar e thelluar në një masë të rëndësishme gjurmimin etimologjik, sidomos të fondit të trashëguar të shqipes, duke i vënë baza të forta si anës morfologjike ashtu edhe anës historike- kulturore të gjurmimit të fjalës”.

Vrasja e Joklit nga nazistët më 1942 qe një fatkeqësi e rëndë për studimet albanologjike e bashkë me të edhe fatkeqësia e humbjes së fjalorit të tij etimologjik të shqipes, për të cilin, siç shënon Çabej, ai punoi tërë jetën me zell asketik.

Norbert Jokli në studimet albanologjike erdhi, si askush para tij, zotërues i tërë problematikës studimore të gjuhës shqipe dhe solli, siç është thënë, trajtime të reja në tërë gjerësinë tematike, duke “e zgjeruar e thelluar esencialisht njohjen gjuhësore të shqipes”.

Rezultatet e rëndësishme të tij në studimet diakronike, morfologjike e fonetike, ai i ka begatuar edhe me synimin për të përcaktuar kronologjinë e dukurive gjuhësore dhe këtë synim e ka ngritur në pjesë të nevojshme në shqyrtimin e zhvillimeve të strukturës së gjuhës dhe e ka bërë sugjerues.

Sot botimi dhe promovimi i këtij libri shqip e gjermanisht në 100-vjetorin e publikimit të parë në gjuhën gjermane përbën një solemnitet, me të cilin edhe koha jonë i shpreh mirënjohje Norbert Joklit, që pjesën më të madhe të kohës së tij shkencore ia fali trajtimit të gjithanshëm të çështjeve të shqipes e që la në trashëgim gjithë atë lartësi të trajtimit shkencor të gjuhës sonë. Kjo mirënjohje do të fuqizohet me botimin e gjithë veprës së tij për shqipen. Ne e kujtojmë me kënaqësi që Norbert Jokli pa se çmohet e nderohet për veprën e tij të madhe për shqipen me rastin dekorimin nga Mbreti Zog me urdhrin e lartë “Skënderbe” në 25-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Qe një fat për zhvillimin e studimeve të shqipes që Jokli, mbasi u mor me studimin e gjuhëve ugrofine, sllave e baltike, vendosi t’i përkushtohej vetëm studimit të shqipes, në të cilin solli gjithë atë përparim dhe qe po ashtu fat që për student e pati Eqrem Çabejnë me aftësi të veçanta krijuese, i cili në fushën e etimologjisë së shqipes e bëri të vazhduar punën e Joklit e të plotësuar e të zhvilluar me origjinalitete të tij.

Fjalën përruese për veprën e Norbert Joklit *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, do ta thotë akademik Rexhep Ismajli.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

STUDIMET ALBANISTIKE TË NORBERT JOKLIT

KUD 811.18-26

Në historinë e studimeve gjuhësore për shqipen vepra e dietarit austriak Norbert Jokl zë vendin e një njeje të veçantë. Lindi në Çeki, me shtetësi ishte gjerman, gjuhë amtare kishte gjermanishten, me besim judaik, jetoi dhe punoi në Austri. Konkretisht lindi më 1877 në Bisenz (Bzenec, Moravi Jugore), ndërsa shumë herët u shpërngul në Vjenë, ku vijoi shkollimin. Fillimisht studioi për jurisprudencë dhe u doktorua në këto shkenca më 1901. Në moshën 25-vjeçare iu kthye studimeve të rregullta për gjuhësi të krahasuar indoeuropiane dhe sllave, gjermanike, romane, tek autoritetet e mëdha të kohës. Nga viti 1903 deri më 1923 punoi si bibliotekar kryesor në Universitetin e Vjenës dhe paralelisht zhvilloi studime e mësimdhënie për fushat e gjuhësisë ugro-fine e të filologjisë sllave-baltike-shqiptare. Më 1929 u zgjodh anëtar i Akademisë Rumune të Shkencave, ndërsa më 1936, në kohën kur indoeuropeisti dhe albanologu i shquar Holger Pedersen ishte kryetar i Akademisë Daneze, u zgjodh anëtar i saj. Më 1937 Mbreti Zog i dha “Urdhnin e Skanderbeut”. Universiteti i Vjenës pas vdekjes më 1980 e vuri në tabelën e të merituarve. Më 1942, në valën e përndjekjeve naziste të hebrenjve, Norbert Jokl-i ishte vënë në pozitë të vështirë. Miq e kolegë austriakë, italianë e shqiptarë, dhe zyrtarë shqiptarë, kishin bërë përpjekje për ta shpëtuar albanologun e madh, por pa sukses.

Bota shqiptare e ka respektuar figurën dhe veprën e N. Jokl-it. Në organet shkencore janë botuar studime të veçanta të tij, përfshirë dorëshkrime. Në Konferencën me rastin e 30-vjetorit të vdekjes së N. Jokl-it në Innsbruck më 1972 morën pjesë me kumtesa delegacionet nga Shqipëria dhe nga Kosova.¹ Për aspektet e ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së Norbert Jokl-it tani kemi një monografi të hartuar nga gjuhëtari shkodran dr. Petrit Kotrri dhe të botuar gjermanisht te Dukagjini², ndërsa shqip në Shkodër. Vepra dhe idetë e tij në albanistikë janë përhapur sidomos falë ndërmjetësimit dhe interpretimeve të Eqrem Çabejtë. Deri tash nuk është botuar ndonjë vepër e tij e plotë o përmbledhje studimesh, të domosdoshme për çdo albanolog.

¹ Në atë konferencë morën pjesë ose dërguan kumtesë nga Shqipëria: Mahir Domi, Eqrem Çabej (Referati kryesor), Shaban Demiraj, Spiro Floqi, Josif Kole, Jorgji Gjinari, Androkli Kostallari, Bahri Beci, Xhevat Lloshi, Emil Lafë, Jani Thomaj. Nga Kosova: Idriz Ajeti, Hasan Kaleshi, Rexhep Ismajli, Latif Mulaku, Zef Mirdita, Shefqet Pllana, Ali Hadri. Shih **Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972**, zum Gedächtnis an Norbert Jokl, Herausgegeben von Hermenn Ölberg, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, Innsbruck 1977.

² Petrit Kotrri: **Norbert Jokl und seine Studien zur Albanischen Sprache**, Dukagjini Publishing House, Dukagjini Balkan Books, Pejë, 2003, ff. 192.

Gjatë jetës së tij Norbert Jokl-i ka botuar dy vepra të veçanta: *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, Wien, 1911 dhe *Linguistisch- kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, Berlin / Leipzig, 1923. Pas vdekjes së tij Oskar E. Pfeiffer nga dorëshkrimet e mbetura botoi si vëllim më vete *Sprachliche Beiträge zur Paläo-ethnologie der Balkanhalbinsel* Wien, 1984. Ka lënë një varg studimesh të çmuara nëpër revista të specializuara si *Indogermanische Forschungen*, *Wörter und Sachen*, *Zeitschrift für slawische Philologie*, *Indogermanisches Jahrbuch*, nëpër botime homazhesh për studiues të shquar, në tekste themelore studimesh të fushës apo në leksikonë të mëdhenj, etj., gjithsesi vështirë të arritshme për breza studiuesish, si për aspektin thjesht fizik, ashtu dhe për atë tjetrin gjuhësor.

Norbert Jokli studimet për shqipen i bëri objekt kryesor të punës hulumtuese të tërë jetës së tij, pati për pasion historinë dhe studimet krahasimtare të gjuhës shqipe. Sipas Çabejtë, ky mjeshtër solli një frymë të re në këto studime në raport me paraardhësit e tij të mëdhenj, solli gjerësinë e vështrimeve, solli risi në metodën e hulumtimit, e thelloi qenësisht njohjen e gjuhës shqipe.

Derisa po bënte historinë e studimeve të shqipes në kuadër të historisë së gjuhësisë indoeuropiane më 1917 Jokl-i kishte vlerësuar se shqipja kishte mbetur ende “fëmijë jetim i gjuhësisë indoeuropiane. Derisa në fushën e disa gjuhëve motra një tufë e tërë hulumtuesish në një garë të rreptë shtron gati të gjitha problemet që i dalin përpara historisë dhe përshkrimit të gjuhës dhe shpesh jep zgjidhje, në fushën e shqipes një numër jashtëzakonisht i madh detyrash ende pret zgjidhjen”.³ Sipas E. P. Hamp, ky vlerësim i Jokl-it mund të njehej i saktë dhe në vitet '60 të sh. XX. Ky vlerësim flet për peshën e veprës së Joklit për studimet shqiptare.⁴

Vepra e parë e madhe e Jokl-it ishte kjo që botojmë tani – **Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes**. Në të ai kishte inauguruar vështrimin etimologjik që merrte parasysh tërësinë e zhvillimeve të leksikut. Kishte privilegjuar etimologjinë dhe historinë e fjalës, por burimin etimologjik synonte ta mbështeste në një pamje sa më të plotë të saj, të formimit dhe të historisë së fjalës në të gjitha zhvillimet. Pos thellësisë, shqyrtimit të gjithanshëm, studimet etimologjike të Jokl-it i shquan shoshitja e elementeve të kulturës materiale. Ai ishte ndjekës i drejtimit studiues të njohur me emrin “Fjalët dhe sendet” në vijën e R. Meringer-it. Ky orientim u bë më i theksuar në kryeveprën e tij *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, 1923. Duke vepruar kështu ai ishte i shtrënguar të merrej me shumë aspekte të studimit të realieve, sidomos të etnografisë, të gjeografisë, për çka shpesh i hynte në punë dija e tij juridike,

³ Norbert Jokl, *Albanisch*, në *Geschichte der indogermanische Sprachwissenschaft*, 2.3.2, Strassburg 1917, f. 109: “Die Sprache der Albaner oder Škipetaren ist bis heute ein Stiefkind der idg. Sprachwissenschaft geblieben. Während auf dem Gebiete mancher Schwestersprache eine unermüdliche Schar von Forschern in eifrigem Wettbewerbe fast alle Probleme, die Sprachgeschichte und Sprachbeschreibung bieten, förderten und vielfach der Lösung zuführten, harren auf dem Gebiete des Albanischen noch ausserordentlich zahlreiche Aufgaben ihrer Lösung”.

⁴ Eric P. Hamp, *Albanian*, në *Current Trends in Linguistics*, ed. Th. Sebeok, vol. 9. Linguistics in Western Europe. Mouton, The Hague-Paris, 1972. Part two: The Study of Languages. Albanian, f. 1626. Shih Eric P. Hamp: *Shqipja, në Studime krahasuese për shqipen*, përgatiti dhe redaktoi R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 23.

sidomos në fushën e së drejtës zakonore, të kanunit dhe të marrëdhënieve farefisnore. Për këto nevoja ai i drejtohej diskutimit me mikun e tij, etnologun e shquar dhe njohësin e botës shqiptare, baron F. Nopcsa, ashtu si dhe të njohurve shqiptarë të shquar. Sot në këtë pikë mund të jetë dhe një burim informimi.

Norbert Jokl-i në studimet e tij kishte bërë kthesën e madhe që shqipen ta shihnte në radhë të parë nga brenda dhe jo më vetëm nga aspekti i raporteve të saj me gjuhët e tjera. Ky vështrim i solli një sërë rezultatesh parimore, ndër to vlerësimin se përmasat e huazimeve dhe të elementeve të huaja në shqipen ishin ndjeshëm më të vogla se ato që ishin thënë në studimet e mëparme, në radhë të parë prej G. Meyer-it. Ishte thënë, madje, në botime shkencore si *Die lateinischen Elemente im Albanesischen* nga G. Meyer, se shqipja ishte gjuhë në të cilën huazimet latine në ilirishten e atëhershme kishin qenë cilësisht dhe sasiisht aq të rëndësishme sa që vetëm ato më vete e meritojnë interesimin nga romanistët. Zhvillimet paslatine, madje, shfaqnin përkime me të romaneve. “Më në fund, latinishtja luan një rol aq të madh edhe në fjalëformim, sa që shqipen jo pa të drejtë e kanë cilësuar si një *gjuhë e përzier gjysmëromane*”.⁵ Meyer-i, pra, fjalën e kishte për ndikimet latine jo vetëm në leksik, po edhe në gramatikën e shqipes. Le të themi se Jokl-i në këto çështje ishte në vijën e Holger Pedersen-it, që, menjëherë në dekadën vijuese, tregoi se në fakt ndikimi latino-roman në gramatikën e shqipes ishte shumë më pak i gjerë se ç’supozonte Meyer-i.⁶ Jokl-i, duke e shpënë më tej këtë vijë të Pedersen-it në fushën e leksikut, ishte studiuesi që solli ndihmesa të reja sa u përket huazimeve latine të shqipes, sa i përket përshtatjes e zhvillimit të tyre brenda shqipes, apo edhe si fjalë që më parë nuk ishin njohur të tilla, por edhe kishte treguar se mjaft syresh mund të kishin burim vendës.

Në studimet etimologjike të N. Joklit vend të posaçëm zënë ndriçimet e tij për fjalët e trashëguara indoeuropiane, ndjeshëm më të numërta se te G. Meyer-i. Në vijim ai mori në shqyrtim fjalët e huazuara nga greqishtja e vjetër, duke plotësuar inventarin e bërë nga A. Thumb.⁷ Shtresa tjetër e leksikut të shqipes, shtresa sllave, pas studimit të rëndësishëm, por për shumëçka të njëanshëm, të A. M. Selishçevit,⁸ kishte gjetur te N. Jokl-i interpretuesin historikisht të saktë dhe gjuhësisht të

⁵ “Aber die damals in das Altillyrische eingedrungenen lateinischen Fremdwörter sind qualitativ und quantitativ so bedeutsam, dass sie allein schon verdienen, das Interesse des Romanisten auf sich zu ziehen. Zudem zeigt die nachlateinische Entwicklung mancherlei Übereinstimmungen mit dem Romanischen. Endlich spielt auch in der Wortbildung das lateinische eine so grosse Rolle, das man das Albanesische nicht imt Unrecht als eine halbromanische Mischsprache bezeichnet hat”, Gustav Meyer: *Die lateinischen Elemente im Albanesischen*, neubearbeitet von Wilhelm Meyer-Lübke, në **Gröbers Grundriss der Romanischen Sprachwissenschaft**, Abschnitt Romanische Sprachwissenschaft, Die romanischen Sprachen, I, botimi II 1904-1906, f. 1039. Botimi i parë i nënshkruar vetëm nga G. Meyer këtu ka pësuar disa ndryshime, që Pedersen i kishte vënë në pah. Pedersen kishte shënuar gjithashtu se një pjesë e ndryshimeve të bëra nga Meuyer-Lübke “duket një reagim kundër mbivlerësimit të rëndësisë së elementit latin nga ana e G. Meyer-it”, Pedersen, *Shqip*, (përkthyer nga Ali Dhrimo) në **Studime për gjuhën shqipe**, ASHAK Prishtinë, 2003, f. 119..

⁶ “Pra, ndikimi latin mbi fleksionin e shqipes është i barabartë me zero. Përkundrazi, ky ndikim nuk është i vogël mbi fjalëformimin”. Pedersen, po aty, f. 125.

⁷ Albert Thumb: *Altgriechische Elemente des Albanesischen*, në **Indogermanische Forschungen** 26, 1909, ff. 1-20.

⁸ A. M. Селищев: **Славянское население в Албании**, София, 1931.

mbështetur. Këtë kuadër ai e kishte plotësuar me interpretimet krahasimtare të lidhjeve të hershme shqiptare-sllave.⁹ Për të bërë hulumtime kështu të gjera etimologjike atij i dilte e nevojshme të ndërthurte gjurmimin gramatikor-etimologjik me vështrimet për historinë e kulturës materiale, të shikonte literaturën etnologjike, gjeografike, juridike, ekonomike e të filozofisë fetare; të thellohej në vështrimin e lidhjeve semantike të fjalëve, të përmbledhte referimet e sakta të historisë së çdo fjale, ashtu si të çdo fenomeni gramatikor, të bënte grupimin morfologjik e semantik, të veçonte fjalët e trashëguara nga të huazuarat, të ndërtonte një teori për temat nominale të shqipes, çka atij i dukej themelore për hartimin e një fjalori etimologjik. Më në fund, ai nuk linte pa theksuar se i interesonte “qysh janë bashkue e kryqëzue pikërisht në shqipen sferat e veçanta të ndikimit gjuhësor”, duke vënë në pah kështu vështrimin ballkanologjik.

Përveç studimeve etimologjike me konceptim kështu të gjerë, N. Jokl-i ka lënë një varg studimesh të thelluara për aspekte të ndryshme të fonetikës dhe të morfologjisë historike të shqipes, si ato për çështjet e historisë gramatikore, për diftongjet ue/ua, për dialektet dhe gjuhën e gjallë, për tekstet e vjetra; ka lënë dhe një numër studimesh me vlerë për gjuhët e lashta të Ballkanit – ilirishtja, trakishtja, makedonishtja dhe për raportet e shqipes me to, ashtu si me frigishten e më tej me armenishten, në një anë, dhe me gjuhët indoeuropiane veriore baltike e sllave, gjermanike dhe keltike, në anën tjetër.

Indoeuropeist dhe komparatist i zoti, N. Jokl-i ka lënë studime nga më të rëndësishmet për raportet e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane e për vendin e shqipes midis tyre. Këtu ai shihet pasardhës i mirëfilltë i G. Meyer-it. Në këtë aspekt Jokl-i solli njohje të reja, sidomos sa u përket raporteve të shqipes me gjuhët baltike, sllave, por pa lënë anash as ato me gjuhët kelte në perëndim e greke-armene në jug.

Siç e ka përmbledhur Çabej, për pyetjen se nga doli shqipja, në atë kohë ishin në qarkullim dy përgjigje themelore: 1. nga ilirishtja, ose 2. nga trakishtja. Jokl-i solli këtu argumente me rëndësi, si shqyrtimet onomastike, raportet e shqipes së lashtë me gjuhët greke e latine, me gjuhët sllave dhe ndërlidhjet në kuadrin ballkanik, etj. Ai kishte arritur të nxirrte përfundimin e tretë, që shqipja ishte pasardhëse e ilirishtes, po më vete kishte një komponent të trakishtes, që Çabej e quante sintezë të dy tezave të mëparme. Më tej Jokl-i djepin e hershëm të shqipes e shihte më parë drejt Dardanisë, çka i jepte mundësi për shpjegimin e elementit të supozuar trakas e të relacioneve me rumanishten. Në veprën *Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel*, Jokl-i kishte nxjerrë këtë përfundim: “Po të përmbledhim atë që del nga materiali leksikor i shqyrtuar këtu, del se, shqipja është gjuha e një populli që qysh në Lashtësi, dhe gjithsesi në kohët para-romake ashtu si në kohët romake, kishte shkëmbim gjuhësor me greqishten, se më tej shqipja dhe ilirishtja përkasin bashkë”.¹⁰ Në këtë pikë ai i kundërshtonte qëndrimet e studiuesve rumunë

⁹ N. Jokl: *Slaven und Albaner*, në *Slavia* 13, 1934, ff. 281-325, 609-645.

¹⁰ “Ziehen wir somit aus dem angeführten Wortmaterial die Summe, so ergibt sich, dass das Alb. Die Sprache eines Volkes ist, das schon im Altertum, und zwar sowohl in vorrömischer als in römischer Zeit mit dem Gr. in sprachlichem Austausch stand, des weiteren, daß Alb. Und Illyr. Zusam-

që përjashtonin shqiptarët nga rrethi i popujve vendës në Ballkan qysh në lashtësi. Dhe aty nxirrte përfundimin tjetër: *“Kontaktet gjuhësore të shqyrtuara këtu të shqipes me greqishten dhe latinishten, siç mund të besoj unë, u japin fund të gjitha hipotezave të këtij lloji. Objekt i studimeve të ardhme do të jetë të përcaktojnë se cilit prej dy popujve të Sijudhesës Ballkanike - shqiptarëve dhe grekëve – i përket e drejta e të parit”*.¹¹

Jokl-i mendonte të përfundonte një gramatikë historike-krahasuese të shqipes dhe një fjalor të madh etimologjik, për çka tashmë i kishte bërë parapërgatitjet. Mendohet se në një kopje të Fjalorit etimologjik të Meyer-it ai kishte vënë shënimet e plota për fjalorin e tij etimologjik, por ajo kopje nuk është gjetur.

Ndihmesa e Jokl-it për studimet shqiptare është shumë e madhe: në studimet e fonetikës historike dhe të vendosjes së kronologjive relative të ndryshimeve fonetike, në studimet e morfologjisë historike, në fushën e historisë së fjalëve dhe të etimologjisë. Interesimet e tij ishin në rritje dhe për aspektet e gjuhës së shkruar dhe të gjuhës së sotme, pra, në tërësi për gjithëçka që lidhet me shqipen. Posaçërisht me vlerë janë edhe sot studimet e tij për raportet e shqipes me gjuhët fqinje, me latinitetin ballkanik, me rumanishten e gjuhët romane, me gjuhët sllave të jugut, me greqishten e vjetër e të re. Studimet e tij për gjuhët e lashta të Ballkanit, për trakishten e për ilirishten, dhe për raportet e tyre me shqipen nuk mund të mos konsultohen as sot.

Deri sot vepra e Norbert Jokl-it nuk është ribotuar e përmbledhur as gjermanisht, as shqip. Në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë ruhet një numër përkthimesh të veprave të tij, që janë bërë kryesisht për të qenë në shërbim të studiuesve të atij instituti. Aty ruhet dhe përkthimi i veprës që po botojmë i bërë nga albanologu më i madh i kohës, Eqrem Çabej. Për botim në ASHAK me rastin e 100-vjetorit të botimit të parë të veprës dhe në fillim të serisë, QSA në Tiranë na vuri në dispozicion përkthimin e E. Çabejtë dhe disa përkthime të tjera. Me këtë rast QSA-së në Tiranë i shprehim publikisht falënderimin tonë. Tekstin shqip nga dorëshkrimi i shkruar me makinë dhe pa shenja të veçanta, e kontrolluam vetë, duke i shtuar shenjat diakritike sipas origjinalit. Përkthimi nga Çabej është bërë në shqipen e fundit të viteve '50. Jemi përpjekur ta ruajmë në tërësi dhe në detaje gjuhën dhe shkrimin e Çabejtë.

Profesor dr. Heiner Eichner nga Universiteti i Vjenës, komparatist që ka merita për studimet albanistike në Institutin e Gjuhësisë së Krahasuar, na ndihmoi të siguronim fotokopje cilësore të botimit të **Studien zur albanesische Etymologie und Wortbildung** në të cilën Jokl-i kishte shënuar në faqen përbri plotësime dhe

mengenhören”. Norbert Jokl: **Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel** (Zur Frage der Ältesten griechisch-albanischen Beziehungen), Aus dem Nachlass herausgegeben von Oskar E. Pfeifer, mit einem Vorwort von Georg R. Solta, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien 1984, f. 46

¹¹ “Die hier besprochenen sprachlichen Berührungen des Alb. Zum Gr. Und Lat. bereiten, wie ich glauben möchte, allen derartigen Hypothesen ein Ende. Gegenstand weiterer Untersuchung wird es sein festzustellen, welchem von die beiden Völker – Albanern und Griechen – auf der Balkanhalbinsel das Erstgeburtsrecht zukommt“, aty, f. 47.

vërejtje të ndryshme për zërat e veçantë. Vendosëm që, krahas faqes së botimit, të vëmë ato me shënime me dorë të Jokl-it. Kështu, besojmë, po bëhet një botim i ri edhe i origjinalit gjermanisht. Përfitojmë nga rasti që Profesor Eichner-it t'i shprehim falënderimet tona të përzemërta për këtë ndihmë.

Kolec TOPALLI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

SHËNIME PËR VEPRËN “STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN SHQIP”

KUD 811.18'373.611

Falë interesimit dhe punës së përkujdesshme të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, pa dritën e botimit pas një shekulli “*Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*”, vepra e parë e Norbert Joklit, albanologut më të madh të kohës së tij. Dhe kjo është një punë me vlera të mëdha, që Akademia e ka nisur prej kohësh, duke e konkretizuar me emrat e gjuhëtarëve më të mëdhenj të dy shekujve të fundit.

Megjithëse Jokli nuk ishte më shumë se 34 vjeç kur shkroi këtë vepër, për objektin e saj, gjerësinë e trajtimit të materialit dhe metodën me të cilën punoi, ajo qëndron krahas veprave të tjera të mëvonshme duke e paraqitur atë që në fillimet e tij me pjekurinë, thellësinë dhe maturinë e një shkencëtari të vërtetë.

Në kohën kur u botua kjo vepër, studimet për historinë e gjuhës shqipe kishin njohur disa emra të shquar në fushën e indoeuropianistikës dhe ballkanologjisë, si: Franc Bopp, Gustav Meyer, Holger Pedersen, Franc Miklošić e ndonjë tjetër. Ishin skicuar vijat kryesore të studimit historik të shqipes, si një gjuhë e familjes indoeuropiane me një rrugë të veçantë zhvillimi. Por tezat e mësipërme kishin nevojë për mbështetje të reja, për argumentime më të plota, për studime më të thelluara. Këtë e bëri Jokli me gjuhëtarë të tjerë që punuan në të njëjtën kohë, me artikuj studimorë e vepra të plota, njëra nga të cilat është edhe kjo që po paraqitet sot.

Duke menduar se për jetën e autorit dhe kontributet e tij në alba-nologji do të flasin kolegët e mi, në këtë kumtesë do të trajtojmë disa prej zërave etimologjikë të kësaj vepre, të cilët jo vetëm kanë korrigjuar shpjegimet e dhëna nga albanologët e mëparshëm, por edhe i kanë rezistuar kohës, duke nxjerrë në shesh ndihmesën e Joklit për shpjegimin e tyre. Sigurisht, një gjë e tillë mund të mos jetë fort e përshtatshme për një auditor të specializuar në fusha të tjera, por lënda e kësaj vepre është e tillë, që merret vetëm me etimologji.

Emrin *an ~ anë* mashkullor e asnjansës për të sotmen “enë”, në kundërshtim me Gustav Meyerin që e lidhte me *anë* “krah”, Jokli e lidhi me rrënjën ie.**auq̥nā*, duke e bashkuar me ind. vj. *ukhā-h*, “vorbë”, lat. *aulla* “vegsh”, got. *auhns* “sobë, stuftë”. Ndryshe nga Jokli, Çabej e nxjerr këtë fjalë nga një bazë **annom* kjo nga një më e lashtë *angom* duke e lidhur me gr. *ἄνωγος, ἀγγελῶν*. Të dyja këto etimologji qëndrojnë nga ana kuptimore, por etimologjia e supozuar nga Çabej paraqet dy vështirësi fonetike për t’u pranuar: e para, nëse zanorja *a-* është ndjekur nga sonantja hundore *-n*, në dialektin e Jugut duhej të ishte errësuar në *-ë*; e dyta: grupi bashkëtingëllor *-ng* nuk është kthyer në një *-n-* të thjeshtë në gjuhën shqipe; khs. *i angësht* për “i ngushtë”, që lidhet me lat. *angustus* me të njëjtin kuptim, gr. *ἄλγω* “shtrëngoje me gjalmë, mbyt”, gjerm. *eng* “i ngushtë”. Nga grupet bashkë-

tingëllore vetëm ato me një dhëmbore, /nt/ e /nd/, kanë dhënë /n/; prandaj skema ka qenë *bashkëtingëllore* + -n. Kjo na çon te burimi i shënuar nga Jokli në veprën që po analizojmë.

Për emrin *bresë* “radhiqe, lat. Cichoria”, Jokli është i pari që e lidhi përbrenda gjuhës me foljen *brej* dhe këtë të fundit me lat. *forāre*, gjerm. 1. vj. *baron*, gjerm. sotme *bohren* duke u bashkuar emri me foljen sipas kuptimit “i mprehtë, që të pret” e duke marrë prapashtesën –së si në *gërresë* nga folja *gërryej*, të cilën e ka trajtuar edhe si zë më vete në këtë vepër. Kjo etimologji është pranuar gjithandej në studimet e mëvonshme.

Emrin *byk* Jokli e lidhi me foljen *mbij* dhe emrin *bimë* të formuar prej saj, nga një rrënjë *b^hū-* me kuptimin “rritem, mbij”, që ka marrë prapashtesën -k. Gjuhëtarët e tjerë, ndër të cilët edhe Çabej, e kanë miratuar këtë etimologji.

Për foljen *derdh*, në kundërshtim me Gustav Meyerin që e afroi me sll. vj. kisht. *drъrbъ* dhe Pedersenin që e lidhi me ind. vj. *srjati*, Jokli mendon një afrim me ind. vj. *dhārā* “lumë, derdhje” që ka marrë prapashtesën -d. Kjo etimologji, ndonëse është pranuar me rezerva më vonë, mbetet më e besueshmja. Çabej merr si më të vjetër formën *dardh* të Buzukut, pa u shprehur për etimologjinë e saj, por pa kundërshtuar etimologjinë e Joklit, duke e quajtur fjalën me burim të paqartë.

Emrin *det*, ndryshe nga paraardhësit e tij (Kamarda, Meyer etj.), që e lidhnin me gr. *θέτις*, hyjnesha e detit, ose me gr. *θαλασσα*, Jokli e nxori nga një bazë parashqiptare **deub-eto*, të formuar me prapashtesën -et nga rrënja indoeuropiane që shënon të thellit, një **deub-*, që krahasohet me got. *diups*, gjerm. *tief*, lit. *dubùs*, të gjitha me kuptimin “i thellë”. Këtë burim e mbështet zanorja e gjatë që ka dalë nga tkurrja e dy zanoreve pas rënies së bashkëtingëllores së zëshme grykore, ashtu si te emri *kūt* nga lat. *cubitus*. Kjo etimologji, që mban emrin e Joklit, është vlerësuar pozitivisht nga të gjithë gjuhëtarët e mëvonshëm.

Për emrin *djathë*, ndërsa Meyeri shënon vetëm gjininë mashkullore dhe asnjansë pa dhënë ndonjë shpjegim etimologjik, Jokli është i pari që e lidhi atë me ind. vj. *dādhi* “dhallë”, prus. vj. *dadān* e gr. *θήνιον* “qumësht”, lat. *felo* “e mënd, i jap qumësht”. Kjo etimologji, që shkon si nga kuptimi, ashtu edhe nga ana fonetike, ka gjetur miratim edhe nga gjuhëtarët e tjerë duke përfshirë edhe Çabejn.

Emrin *dhunë* Jokli e lidhi me ind. vj. *dū* “vuajtje”, *dunōti* “e mundon” e anglosaksonishten *tēona*, duke vendosur si bazë të shqipes një **dusn-* me një lidhje përbrenda gjuhës me *i derë* në *derëzi*. Ndonëse krahas këtij shpjegimi kanë dalë edhe të tjerë, ajo është pranuar nga shumë gjuhëtarë, si: Walde-Pokorny, Walde-Hofmann, Cimochowski, Barići, Boisacqu etj., dhe, megjithëse fjala mbahet me burim të paqartë, etimologjia e dhënë nga Jokli metet më e mundshme.

Emrin *thep* “shkëmb me majë” Jokli e lidhi me grupin e lat. *cippus* “shtyllë e gurtë ose e druajtë me majë” duke ndërtuar një bazë **koipo*. Edhe kjo etimologji është miratuar nga gjuhëtarët e tjerë dhe ka zënë vend në studimet e kësaj fushe.

Emrin *gacë*, që Meyeri e la pa shpjegim, Jokli e shtjelloi në këtë vepër duke e lidhur me rrënjën ie. *g^{ug}er-* / *g^{uh}or-*, prej së cilës kanë dalë emrat *zjarr* e *gjirmë* dhe foljet *ngroh* e *nxeh*. Kjo etimologji është pranuar gjithandej në studimet etimologjike.

Foljen *gdhend*, duke u nisur nga forma më e thjeshtë *dhend* dhe nga kuptimi “rrah”, Jokli e afroi me nord. vj. *detta* “çaj”, *datta* “rrah”, në gjuhët gjermanike *dentan*. Është një shpjegim pa të meta, i pranuar edhe sot e kësaj dite pas një shekulli.

Foljen *gëdhij* Jokli e lidhi me të drejtë me emrin *ditë*, meqenëse pranë *gëdhihet* ka edhe *dihet* me të njëjtin kuptim. Ndërsa emri ka marrë prapashtesën emërore *-t(ë)*, folja ka marrë prapashtesën foljore *-n*, që shfaqet edhe në të kryerën e thjeshtë *gëdhina*.

Emrin *gjellë* dhe foljen *gëllinj* Jokli i bashkoi me të drejtë me mbiemrin *i gjallë* sipas lidhjes që ekziston edhe në italishte ndërmjet emrit *vivanda* dhe foljes *vi-vere*. Burimi i mëtejshëm lidhjet në shkallë indoeuropiane me lat. *salvus* e gr. *ὄλος* me kuptimin “i tërë, i plotë”.

Një etimologji tjetër që Jokli e përcaktoi me dorë të sigurt është përqasja që i bëri emrit *gjemb*, me lit. *geliù*, *gélti* “shpoj, ther”, në mbështetje të formave dialektore, geg. *gem*, arbërishtja e Greqisë *glimp*, një etimologji që ka hyrë në të gjithë fjalorët etimologjikë. Ai pa me mprehtësi se format e mësipërme paraqesin trajta dialektore, që kanë dalë nga evolucioni i grupit *gl-*, të cilat pa të drejtë Meyeri i kishte ndarë nga njëra tjetra.

Emrin *kënjem* të së folmes së Beratit Jokli e lidhi me gr. *ἀνεμος*, ku me rënien e zanores nistore dhe diftongimin e */e/-së* së shkurtër në */je/* ka dhënë *njem*, që del në Fjalorin e Bardhit. Fonetikisht, ky shpjegim është pa të metë. Kundërshtimi nga ana e Çabejt, që e nxjerr nga gr. *θύμιαμα*, kalon nëpër disa procese fonetike që nuk janë të natyrës së shqipes, meqenëse nuk vërtetohen me raste të tjera; prandaj duhet të kthehemi tek etimologjia e Joklit. Por ndërkaq mbetet për t’u sqaruar nëse kemi të bëjmë me një fjalë të trashëguar, apo me një huazim nga greqishtja e mesme bizantine.

Mbiemrin *i thjeshtë* Jokli e lidhi me foljen *kthiell*, ku *kë-* është parashtesë, kurse elementi *-shtë* është prapashtesë, që ka formuar një grup prej tri bashkëtingëlloresh duke shkaktuar rënien e njëres prej tyre. Shpjegimet e mëvonshme kanë ecur në këtë hulli, të çelur më së pari prej dijetarit austriak.

Foljen *lej*, ndryshe nga supozimi i Meyerit që e nxjerr nga lat. *levāre*, Jokli e bashkoi përbrenda gjuhës me *lind* dhe të dyja këto i lidhi me rrënjën ie. *leud^h*- “rri-tem, ngrihem”, prej së cilës kanë dalë lat. *liberī-ōrum* “fëmijët”, got. *liudan* “rri-tem”, gjerm. *Leute* “njerëz, popull”, sll. vj. kisht. *ljudojje* “gjinde, njerëz”. Përkundrejt këtij shpjegimi, Çabej parashtron një tjetër: *lej* nga ie. *legnjo* duke e afruar me *lagje* përbrenda shqipes e përjashta saj me lat. *lectus* e irl. vj. *lige* “shtrat, varr”. Kjo etimologji, që qëndron më larg nga ana kuptimore, nuk merr parasysh faktin se grykorja e zëshme është ruajtur në fjalë të trashëguara, khs. *zog*, *shtog*, *lag*, si edhe *lagje* nga kjo rrënjë. Prandaj duhet të kthehemi tek etimologjia e propozuar nga Jokli, me të cilën shpjegohet më mirë burimi i fjalës, e cila ka një paralele të shënueshme në gjuhën shqipe: *lej~lind* nga një **leud-*, sikurse *be~bind* nga një **bejd-*. Në rastin e parë, te *lej* e *be*, ka rënë dhëmborja e zëshme fundore, kurse në rastin e

dytë, te *lind* e *bind*, para saj është shtuar si infiks sonantja *-n-*, me të cilën është krijuar një grup bashkëtingëllore, që është ruajtur në gjuhën shqipe.

Së fundi, foljen *mbys* ~ *mbyt*, të cilën Meyeri e la pa shpjegim etimologjik, Jokli, duke u nisur nga kuptimi “rrah, godas”, e lidhi me lat. *confūtare* “rrëzoj” dhe isl. vj. *bauta* “rrah, shtyj”. Dija e mëvonshme e ka miratuar këtë burim.

Përparësinë e shpjegimeve etimologjike Jokli e ka edhe për fjalët: *mor*, *mund*, *nge*, *plang*, *rri*, *shpall*, *shtie*, *shtoras*, *tartallis*, *çyshtje*, *i zi* ~ *e zezë* e shumë të tjera, si edhe për mjaft huazime, për të cilat nuk do të zgjatëm për të mos shpërdoruar vëmendjen dhe durimin e auditorit.

Përgëzoj Akademinë për këtë arritje duke i uruar edhe përkthime dhe paraqitje të tjera.

Seit MANSAKU, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

NORBERT JOKLI NË GJUHËN SHQIPE

KUD 811.18-26

Përrurimi i këtij vëllimi me studime “Për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip” me rastin e 100-vjetorit të botimit për herë të parë të tij nga albanologu i shquar dhe miku i shqiptarëve Norbert Jokli, jep rastin e lumtur për të theksuar dy gjëra themelore:

Së pari unë dëshiroj të përgëzoj dhe të falënderoj Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për nismën e lavdërueshme që ka ndërmarrë prej disa vitesh për të sjellë në shqip dhe në gjuhët përkatëse trashëgiminë albanologjike të së kaluarës dhe të së sotmes që na kanë lënë dhe vijnë të sjellin ende studiues të shquar të gjuhës shqipe, të historisë e të kulturës shqiptare. Kjo Akademi ka qenë gjithmonë e hapur për të krijuar hapësirat e nevojshme dhe klimën e përshtatshme për të afruar albanologë të vendeve të ndryshme, për të vlerësuar dhe botuar veprat e tyre.

Botimi i kësaj trashëgimie albanologjike është jo vetëm një akt i vërtetë qytetarie për t’u shprehur nderimin dhe vlerësimin tonë të gjithë atyre studiuesve që punuan me përkushtim dhe vunë në shërbim të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dijet e energjitë e tyre intelektuale për të ndriçuar probleme të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe e të kulturës sonë kombëtare, por është edhe një punë shumë e dobishme për të krijuar një fond themelor dijesh e arritjesh, një bazë e domosdoshme ku mund të mbështeten e të çohen më tej përpara kërkimet e brezave të sotëm dhe të ardhshëm në fushën e shkencave albanologjike.

Ideja për të përkthyer dhe për të botuar në shqip trashëgiminë albanologjike ka lindur që në vitet ’30 kur intelektualë të shquar nisën të mendojnë për institucionalizimin e veprimtarisë shkencore në fushën e studimeve shqiptare. Madje botimi i kësaj trashëgimie ka qenë një nga detyrat themelore që shtroi Kongresi i parë i studimeve shqiptare që u mbledh në Tiranë në fillim të viteve ’40 të shekullit që lamë pas. Pas Luftës së dytë Botërore institucionet shkencore që u krijuan në Tiranë dhe në Prishtinë kanë ndërmarrë përgatitje dhe botim dokumentesh kryesisht për historinë e Shqipërisë. Në fushën e gjuhësisë janë bërë përkthime të pjesshme nga specialistë e intelektualë të kohës që kishin mësuar gjuhë të huaja gjatë studimeve jashtë vendit, të cilat kanë pasuruar arkivat. Pjesë e kësaj pune ka qenë edhe përkthimi nga Eqrem Çabej i kësaj vepre që është përgatitur e botuar prej jush nga një redaksi kompetente e përbërë nga akademikë të shquar si Rexhep Ismajli, Besim Bokshi dhe Idriz Ajeti dhe prof. dr. Heiner Fichner që me personalitetin e tyre ia shtojnë rëndësinë dhe vlerat kësaj vepre që po paraqitet sot. Përkthimi nga një

personalitet i madh i shkencës dhe i kulturës sonë kombëtare si E. Çabej është një vlerë e shtuar për këtë botim.

Punime të veçanta të albanologëve të huaj a pjesë të tyre janë përzgjedhur edhe botuar në revista shkencore, por sidoqoftë nuk është bërë një punë e organizuar mirë dhe sistematike për të sjellë në shqip dhe për të botuar trashëgiminë albanologjike gjuhësore, të paktën të asaj që vjen që nga mesi i shekullit XIX, kur gjuha shqipe fillon e studiohet me metoda shkencore. Kjo ka qenë një mangësi që nuk ka ndihmuar sa duhet në njohjen dhe përparimin e studimeve gjuhësore shqiptare. Ka shumë arsye që e shpjegojnë këtë mangësi, por kryesorja besoj të ketë qenë klima jo e favorshme për t'i lënë hapësirë literaturës së huaj perëndimore. Në vitin 1956 Selman Riza, duke propozuar pranë Institutit të historisë dhe gjuhësisë ndërmarrjen e një vlerësimi kritik të punimeve të deriatëhershme në lëmin e gjuhësisë, do të vinte në dukje si më poshtë: “Ka afro një shekull që kur gjuha shqipe është bërë objekt studjimi nga një numër i madh linguistësh të huaj: Bopp, G. Meyer, Miklosich, H. Pedersen, Jokli etj. dhe filologësh vendas: Dh. Kamarda, K. Kristoforidhi, S. Frashëri, A. Xanoni, A. Xhuvani etj., prapëseprapë...albanologjia gjuhësore ka mbetur ende sod e kësaj dite larg së qenuri e formuar në tërësi”. Duke shtjelluar më tej arsyet e kësaj prapambetjeje, autori përmend si një nga shkaqet e kësaj gjendjeje “mosfamiljarizimin e linguistëve të huaj me të dhënat e filologjisë shqipe dhe mosshfrytëzimin e punimeve të linguistëve të huaj nga ana e filologëve vendas”¹².

Në këtë kuadër, nisma e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për të botuar trashëgiminë shkencore albanologjike merr një vlerë të veçantë. Kjo Akademi ka botuar vetëm këto vitet e fundit një varg veprash të rëndësishme të albanologëve më në zë si vepra e Franz Miklosichit, e Waclav Cimochowskit, e Holger Pedersenit, e Eric Hampit, e Wlfrid Fiedlerit, e Victor Friedmanit etj., këtë të N. Joklit që po përurojmë sot pa harruar dhe veprat e autorëve shqiptarë, midis të cilave duhet përmendur si punë madhore të kohëve të fundit, përgatitja dhe botimi i veprës së prof. Selman Rizës në pesë vëllime të mëdha nga akademikët Rexhep Ismajli dhe Besim Bokshi. Po të shtyhem më tej në kohë, nuk do të linim pa përmendur botimin këtu në Prishtinë të veprës së E. Çabejt në shtatë vëllime nga “Rilindja”, nën një redaksi të përbërë nga Ahmet Kelmendi, Sulejman Drini dhe i ndjeri Mehmet Gjevari, të cilët meritojnë mirënjohjen tonë të thellë. Pa këtë botim as autori nuk do të kishte atë njohje e popullaritet shkencor që ka sot, as shkenca gjuhësore e albanologjike në përgjithësi nuk do të kishte nxjerrë ato përfitime që ofron kjo vepër madhore për shkencën e kulturën shqiptare.

Së dyti, përirimi i këtij botimi jep rastin për të rivlerësuar sado shkurt e në vija të përgjithshme veprën albanologjike dhe personalitetin e Norbert Joklit, gjë që e ka bërë me kompetencë profesionale dhe me dashamirësi e mirënjohje akademiku Rexhep Ismajli në parathënie të këtij botimi. E bëri dhe sot në parashtrësën e tij të ngjeshur.

Sot jemi mbledhur për të përruar botimin në shqip dhe në gjermanisht të njëjës prej veprave themelore të albanologut të shquar austriak Norbert Joklit, i cili ia kushtoi tërë

¹² Rexhep Ismajli, **Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës**, Prishtinë 2009, f. 91-92

jetën e tij që, fatkeqësisht përfundoi në mënyrë tragjike, studimit të gjuhës shqipe. Norbert Jokli ka qenë dhe mbetet një figurë shumë e njohur, e dashur dhe e vlerësuar në botën shkencore e kulturore shqiptare, mund të thuhet një figurë e familjarizuar, e shqiptarizuar në shkencën gjuhësore shqiptare. Kjo për shkak të përkushtimit të tij të plotë ndaj studimeve shqiptare dhe trajtimit shkencor, objektiv e dashamirës të problemeve themelore e të mprehta të historisë së gjuhës shqipe e të popullit shqiptar, për shkak të ndikimit të fuqishëm që kërkimet e tij shkencore kanë ushtruar në studimet gjuhësore shqiptare, për shkak të lidhjeve të ngushta e të bashkëpunimit shkencor e njerëzor që ai pati me personalitete të shquara të shkencës sonë gjuhësore si Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, Aleks Buda etj. Janë të njohura përpjekjet që u bënë në fillim të viteve '40 nga autoritete shtetërore e personalitete shkencore e kulturore shqiptare për ta sjellë atë në Shqipëri dhe për ta shpëtuar atë nga përndjekjet e nazistëve.

Kam pasur rastin të lexoj dhe të komentoj letërkëmbimin e Norbert Joklit me Aleksandër Xhuvanit, para humbjes së tij tragjike dhe aty del shumë qartë se sa me interes i ndiqte Norbert Jokli zhvillimet shkencore e kulturore në Shqipëri dhe me sa dashamirësi i priste dhe i vlerësonte ato. Ai gëzohej sinqerisht me botimet e përparimet gjuhësore e kulturore të botës shqiptare të kohës. Kjo duket edhe nga recensioneimet që u bënte ai botimeve për gjuhën shqipe, për historinë, për letërsinë dhe kulturën shqiptare në periodikët më të autoritetshëm e prestigjiozë të shkencës europiane të kohës. Në mënyrë të veçantë prania dhe ndikimi shkencor i Norbert Joklit në botën shkencore e kulturore shqiptare ka qenë dhe mbetet i madh dhe kjo prani është realizuar sigurisht në radhë të parë nga veprat që ka lënë, por edhe përmes veprës së Eqrem Çabejt, i cili, siç dihet, duke qenë student dhe dishepull i tij, nuk ka lënë rast pa vënë në dukje kontributet shkencore dhe vlerat njerëzore të këtij personaliteti që është bërë pjesë e botës shkencore e kulturore shqiptare.

Norbert Jokli në veprën e tij të gjerë për gjuhën shqipe trajtoi pothuajse të gjitha problemet më të mprehta e më të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe, problemin e autoktonisë së shqiptarëve dhe të prejardhjes së gjuhës shqipe, të vendit të saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane, të marrëdhënieve të saj me gjuhë të ndryshme të kësaj familjeje, probleme të fonetikës e të gramatikës historike, të leksikologjisë historike, të etimologjisë dhe të fjalëformimit, të filologjisë së teksteve të vjetra etj. dhe në të gjitha këto fusha ai ka lënë kontribute të rëndësishme në metodologjinë e kërkimit shkencor e në rezultate konkrete dhe ka sjellë risi që i kanë qëndruar kohës në pjesën më të madhe të tyre. Është i njohur qëndrimi i Norbert Joklit në mbështetje të tezës iliro-trake të gjuhës shqipe dhe të autoktonisë së shqiptarëve. Për këtë çështjen e dytë, siç dihet, ai mbajti një qëndrim të veçantë, duke e vendosur djepin e lashtë të shqiptarëve në Dardani, një zonë që lejonte të shpjegoheshin tri rrethana të rëndësishme të historisë së shqipes: lidhjet tripalëshe midis ilirishtes, trakishtes dhe shqipes, lidhjet e shqipes me rumanishten dhe numrin relativisht të vogël të huazimeve greke të vjetra në gjuhën shqipe. Sipas kësaj teze shqiptarët u shtrinë më vonë në viset bregdetare perëndimore, por gjithsesi para ardhjes së sllavëve. Më vonë autori e saktësoi dhe e plotësoi mendimin e tij për vendbanimin e hershëm të të parëve të shqiptarëve. Në një dorëshkrim me titull "Shëni-

me gjuhësore për historinë e lashtë të shqiptarëve”, gjetur në Bibliotekën e Vjenës nga Eqrem Çabej dhe Androkli Kostallari dhe botuar në Revistën “Studime filologjike” ai është shprehur qartë se shqiptarët në periudhën greko-romake gjendeshin që prej kohësh në kontakt të drejtpërdrejtë me grekët e romakët dhe se shqipja, siç e ka provuar i pari Albert Thumbi në *Ind. Forschungen*, tom 25 1909, ruan huazime nga greqishtja e vjetër. Artikujt a zërat e tij për Ilirët, arbërit dhe shqiptarët dhe për gjuhën shqipe në veprën prestigjioze *Eberts Reallexicon der Vorgeschichte*, Berlin 1924, janë cituar dhe citohen gjithandej si burime të autoritetshme dhe kanë bërë të njohur për botën shkencore e kulturore çështjet themelore të historisë së lashtë të shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre.

Nuk është vendi për t’u ndalur në vlerësimin dhe në analizën kritike të kësaj teze, të cilën edhe Eqrem Çabej e ka konsideruar të vërtetë, por të pjesshme. Ajo që desha të theksoj këtu është se në gjysmën e dytë të shekullit XX debati shkencor për autoktoninë e shqiptarëve u shndërrua shumë herë në një debat politik midis shkencës shqiptare dhe asaj sllave. Në këtë kohë e në këtë kontekst historik e politik teza e N. Joklit, dhe për këtë është dëshmitare pjesa më e madhe e këtij auditori, na ka shërbyer si argument themelor shkencor për të mbrojtur autoktoninë e shqiptarëve në viset shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Pra, kjo tezë e N. Joklit, edhe pse pjesërisht e vërtetë, na ka shërbyer si aleate në përpjekjet tona për të ndriçuar çështje të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Me shumë të drejtë E. Çabej ka thënë për Joklin se u bë njëkohësisht dhe indirekt “një mbrojtës i të drejtave tona kombëtare.”¹³ Kujtoj atë kohë kur në Tiranë u përgatit një vëllim i posaçëm me studime dhe artikuj që trajtonin problemin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e veta dhe u mendua të përkthehej dhe të botohej recension i gjatë studimor i Norbert Joklit për librin e Selishçevit “*Popullsi sllave në Shqipëri*”. Në këtë recension që në të vërtetë është një studim i thelluar, u bëhej një kritikë serioze shkencore disa ideve e tezave të autorit të librit për raportet historike e gjuhësore të shqiptarëve me sllavët. U arrit të përkthehej ky studim i Joklit, por nuk u arrit të botohej dhe nuk është botuar ende edhe sot e kësaj dite thjesht sepse kërkon një angazhim për ta përgatitur e për ta bërë të botueshëm. Ky punim i tij pret ende të botohet. E përmenda këtë fakt edhe për të treguar se sa i rëndësishëm e i vlefshëm është angazhimi në punë të tilla si kjo që po përurohet sot.

Përsa i përket vendit të shqipes në familjen e gjuhëve indoeuropiane dhe marrëdhëniet e veçanta me gjuhë të ndryshme të kësaj familjeje, pas përcaktimit nga Franz Bopp të karakterit indoeuropian të shqipes dhe pozitës së mëvetësishme të saj në këtë familje gjuhësore si edhe pas saktësimeve të mëvonshme të vendit të saj, nga një anë, në gjuhët satem dhe, nga ana tjetër në gjuhët veriore, nga Gustav Meyeri dhe Holger Pedersen në çerekun e fundit të shekullit XIX, Norbert Jokli e shtjelloi më tej këtë tematikë duke u marrë sidomos me marrëdhëniet e veçanta, me konkordancat e pjesshme të shqipes me një varg gjuhësh indoeuropiane si me greqishten, me latinishten, me keltishten me gjuhët balto-sllave, me indoiranishten etj, duke nxjerr në

¹³ E. Çabej, *Në tridhjetëvjetorin e vdekjes së Norbert Joklit*, Studime gjuhësore, Prishtinë 1975, f. 207.

pah dhe duke analizuar një lëndë të pasur gjuhësore të fondit të trashëguar të shqipes dhe nga huazimet. Përfundimet kryesore të kërkimeve të tij në këtë fushë N. Jokli i ka paraqitur në një studim me titull *Marrëdhëniet e afrisë së shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane*, lënë në dorëshkrim dhe botuar pas vdekjes nga H. Kronasseri në revistën “Die Sprache” IX, 2, 1963. Ky studim është botuar në revistën “Studime filologjike” 1967, nr. 3, në përkthimin shqip të Ali Dhrimos. Ashtu si për problemin e prejardhjes së gjuhës shqipe ndaj të cilit N. Jokli mbajti një qëndrim të ndërmjetëm midis ilirishtes e trakishtes edhe për vendin e shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane ai ka një qëndrim të vetin kur pohon se: “në reflektimin grykoreve indoeuropiane, ne e shohim shqipen në vijën e kufitare midis grupit lindor dhe perëndimor”.

Ndryshe nga studimet krahasuese të kryera para tij për shqipen në gjysmën e dytë të shekullit XIX nga Franz Boppi, Dhimitër Kamarda, Franz Miklosichi etj., të cilët në vlerësimet dhe përfundimet e tyre për raportet e shqipes me gjuhët e tjera të familjes indoeuropiane ishin nisur kryesisht nga lënda e huazuar, N. Jokli i kushtoi vëmendje të posaçme analizës së fondit të trashëguar të shqipes; prandaj arriti për shumë çështje në rezultate të qëndrueshme. Ai pati besuar shumë në profecinë e bërë nga Hugo Schuchardt që në vitin 1872 se “kur të vijë dita që shqipes t’i jetë caktuar një vend i ngulët e i qëndrueshëm brenda indoeuropianishtes, atëherë ne, pas gjase, disa fjalë, të cilat ne sot me plot të drejtë i marrim për huazime do të detyrohemi t’ia kthejmë prapë asaj gjuhe si pasuri të lashtë të fondit të trashëguar. Norbert Jokli me veprën e tij ndihmoi fuqishëm për ta afruar këtë ditë dhe për ta vërtetuar këtë profeci të Hugo Schuchardit dhe për të arritur këtë ai vlerësonte si detyrë të domosdoshme njohjen e saktë të leksikut, të nuancave të kuptimit të fjalëve e të frazeologjisë shqipe dhe jo më pak edhe marrjen në konsideratë edhe të fakteve të folklorit.

Një përmasë të re cilësore solli N. Jokli në fillim të shekullit XX në fushën e studimeve etimologjike të shqipes. Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX si për të tejkaluar arritjet e gjuhësisë historike krahasuese të shekullit XIX, që besohej nga shumëkush se i kishte shterruar mundësitë e saj kërkimore, në shkencën gjuhësore europiane lindi një shkollë e re ose një drejtim i ri studimesh i quajtur *Wörter und Sachen* “Fjalët dhe sendet”, i orientuar kryesisht në kërkimet etimologjike, duke sjellë një konceptim të ri në metodën dhe në përmbajtjen e kësaj disipline. Përfaqësuesit e këtij drejtimi të ri mendonin se gjetja e burimit të fjalës, zbulimi i etimonit nuk ishte qëllimi i vetëm i etimologjisë. Sipas tyre Etimologjia si disiplinë e mirëfilltë historike duhej të merrej përveçse me burimin e fjalëve, edhe me historinë e tyre në lidhje të ngushtë me historinë e sendeve dhe të koncepteve që ato emërtojnë, përhapjen gjeografike të tyre, me lidhjet fjalëformuese të fjalëve etj. Norbert Jokli ishte një dishepull i kësaj shkolle dhe u përpoq të zbatonte parimet e saj në studimet etimologjike të shqipes. Rezultat i punës së tij me orientimet shkencore dhe metodologjinë e këtij drejtimi shkencor është edhe vepra që po paraqitet sot, e hartuar dhe e botuar në gjermanisht që në vitin 1911, para një shekulli. Me këtë metodë pune dhe nën ndikimin e drejtpërdrejtë të këtij drejtimi kërkimesh, por duke e pasuruar ndjeshëm atë, ka punuar edhe albanologu ynë i shquar Eqrem Çabej

gjatë hartimit të veprës së tij madhore: *Studime etimologjike në fushë të shqipes* në shtatë vëllime.

Eqrem Çabej në vëllimin I të kësaj vepre, që përmban historinë, parimet, metodat dhe rezultat e kryesore në fushën e kërkimeve etimologjike të shqipes, duke bërë një vlerësim sintetik të këtyre kërkimeve të kryera para tij nga studiues të huaj dhe shqiptarë, ndër të tjera, ka dhënë këtë vlerësim për N. Joklin, duke e parë punën e tij në lidhje edhe me kontributet e paraardhësve të tij, Boppit, Miklosichit, Meyerit e Pedersenit: Më komplekse paraqitet për shqipen veprimtaria e N. Joklit, i cili me kohë erdhi e u përqendrua në këtë fushë studimesh. Në ndryshim nga Boppi, i cili kish qenë mbi të gjitha një krahasimtar gjuhësh, nga Miklosichi që qe sllavist e ballkanist, nga Gustav Meyer, që përveç se albanist qe edhe greclist, e nga Pedersen, i cili mjerisht u largua që herët nga studimet shqiptare, interesat shkencore të Joklit përveçse nga problemi i burimit të shqipes dhe i lidhjeve të birërisë me gjuhët e lashta të Ballkanit, qenë drejtuar më fort nga etimologjia e historia e fjalëve se nga gramatika e mirëfilltë. Ai shfrytëzoi më shumë se paraardhësit e bashkëkohësit e tij materialin shqiptar, të shkruar dhe gojorin, e aty jo vetëm dëshmitë gjuhësore, po edhe “realitet”, pra edhe të dhënat e kulturës materiale e të etnografisë. Etimologjitë e Joklit shquhen për sqarimin e strukturës morfologjike të fjalës, në fushën fonetike për zbulimin e disa tipareve të apofonisë e të likuideve e nazaleve rrokjeformuese, silabike. Nga pikëpamja metodologjike etimologjitë e tij shquhen për zbatimin e vetëdijshëm të parimit të kërkimit të afrive përbrenda gjuhës përpara krahasimeve jashtë caqeve të saj”.¹⁴ Këto veçori e cilësi të punës kërkimore të Norbert Joklit vërehen edhe në veprën që po përrurohet sot, po ndoshta edhe më shumë në veprën e *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, botuar në Berlin dhe Leipzig në vitin 1923.

Vepra *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin* që po përrurohet sot, është e dobishme si për metodologjinë e kërkimeve shkencore në këtë fushë kërkimesh ashtu edhe për rezultatet konkrete. Vetë titulli sugjeron një dallim metodologjik parimor midis etimologjisë së mirëfilltë dhe fjalëformimit, dallim i rëndësishëm për shqipen në të cilën kufijtë midis këtyre disiplinave jo rrallëherë mund të mos jenë të qartë. Te Jokli dallohet një prirje e qartë për të vërtetuar edhe burimin autokton edhe të lashtë të fjalëve. Atij i atribuohet shprehja *ma ka anda me e qit, me e nxjerrë shqip këtë fjalë*. Ai pa dëmtuar trajtimin objektiv e shkencor të punës së tij kërkimore u përpoq me sa mundi që të shtonte numrin e fjalëve të shqipes që hynin në krahasime indoeuropiane, ndoshta i vinte keq që, siç pohonte ai vetë, shqipja kishte mbetur si fëmijë jetim i gjuhësisë indoeuropiane. Nganjëherë dëshira për ta nxjerrë edhe shqip edhe të vjetër ka çuar, do të thosha, në komplikime e përjasje të stërholluara e të vështira, ndoshta pa nevojë. Do të përmendja këtu etimologjinë e fjalës *mburr*, *mburrem* që trajtohet edhe në këtë vëllim. Jokli nuk kënaqet ta shpjegojë këtë fjalë me fjalën *burr* me parashtesën *m-* si *mplak mplakem*, por e lidh me foljen *mbahem* dhe bën krahasime me gjuhë të ndryshme që nuk duken bindëse.

Më në fund do të thosha që Redaksia ka bërë mirë që ka botuar bashkë me përkthimin shqip edhe tekstin origjinal në gjermanisht duke ruajtur edhe faqet e

¹⁴ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* I, Tiranë 1982, f. 30.

origjinalit duke u dhënë kështu mundësi përdoruesve të mund të citojnë si origjinalin ashtu edhe përkthimin.

Janë shumë të rëndësishme kontributet albanologjike të N. Joklit edhe në fusha të tjera të shpërndara në studime e artikuj të botuar në revista e periodikë shkencorë të gjysmës së parë të shekullit XX. Uroj që kjo nismë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të vijojë më tej, të shërbejë si nxitje edhe për inatitucione të tjera që merren me shkencat albanologjike, të cilat, duke bashkëpunuar njeri me tjetrin të mund të sjellin në shqip e të botojnë vepra të tjera të N. Joklit dhe të albanologëve të tjerë për ta plotësuar kolanën e botimit të trashëgimisë albanologjike.

PROMOVIMI I MONOGRAFISË PËR
REXHEP FERRIN

Besim BOKSHI, Prishtinë

FJALË ME RASTIN E PËRURIMIT TË VEPRËS SË DR. GËZIM QËNDROS PËR REXHEP FERRIN

Të nderuar pjesëmarrës në promovimin e librit të dr. Gëzim Qëndros për piktorin tonë, akademikun dhe mikun tonë të dashur e të respektuar Rexhep Ferri. Duke ndenjur përditë me të e me modestinë e tij, harrojmë që pranë nesh është një krijues i niveleve të larta në artin e pikturës, i çmuar si fillë edhe nga studiues të pikturës evropiane.

Zonja e zotërinj, qëndrojmë para një rrafshi të bardhë, nën të cilin ne nuk shohim asgjë. Vjen brusha e Rexhep Ferrit dhe i nxjerr në sipërfaqe lëvizjet e hijeve homoide nëpër dramat e tyre, nëpër shqetësimet, nëpër synimet, nëpër frikën e nëpër shpresën për të ecur nga njeriu. Dhe vijnë nga bota e tyre e na shqetësojnë për fatet tona e na sugjerojnë veprime për të ecur në jetë. Nga nivele të dashurisë e të shqetësimeve për njeriun piktura e Rexhep Ferrit qëndron njerëzisht e ndritur.

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e përgëzoj dr. Gëzim Qëndron që me kompetencë e me objektivitet ka përcaktuar gjithanshmërisht vlerat dhe nivelin artistik të pikturës së Rexhep Ferrit, që ka arritur të përcaktojë realisht vendin e lartë të pikturës së tij në zhvillimin e pikturës kombëtare dhe në pjesëmarrjen e saj të denjë në ecjet moderne të pikturës evropiane të kohës. Në këtë vepër zoti Qëndro na e sjell pikturën e Ferrit edhe si shpërthim të një energjie të veçantë me hijeshinë e origjinalitetit dhe e të qenit e ndryshme, si vepër të realizuar me një pasqyrim metaforik mjeshtëror të fateve të rënda të qenies njerëzore në pankroni. E çmojmë impenjimin e përgjegjshëm të zotit Gëzim Qëndro për të krijuar këtë vepër me vlera analizuese e çmuese, i motivuar nga dëshira për të nxjerrë në pah me dashuri nivelin e lartë të veprës së piktorëve kosovarë.

Mendoj se kjo vepër e zotit Qëndro do të mbetet në kohë vepër respekti të denjë ndaj personalitetit krijues të Rexhep Ferrit e ndaj vlerave të pikturës së tij dhe dëshmi e një trajtimi të qëndrueshëm shkencor.

Gëzim QËNDRO, Tiranë

MONOGRAFIA PËR FERRIN

KUD 72.071(496.51)(092)

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj për ftesën për të marrë pjesë në paraqitjen e monografisë së Prof. Rexhepi Ferrit, një personaliteti vërtet të spikatur të artit dhe kulturës shqiptare.

Po ashtu dua t'ju falënderoj që më ngarkuat detyrën për të shkruar njërin nga tekstet e monografisë së Prof. Rexhepi Ferrit, një punë të cilën u përpoqa ta kryej më të gjithë përkushtimin dhe përgjegjësinë që meritonte. Por duhet të them që punën për këtë monografi e kisha filluar më parë.

Profesori ka qenë një ndër të parët artistë që kam takuar në vitin 2000 kur erdha në Prishtinë me kërkesë të ish drejtorit të Galerisë z. Luan Mulliqi për të hapur një ekspozitë me vepra të Galerisë Kombëtare që i përkisnin periudhës së pavarësisë. Pas atij takimi e në vazhdim jemi parë dhe kemi folur shumë herë në Tiranë dhe Prishtinë dhe kuptohet për shkak të profesionit tim si kritik arti punën e tij e kisha ndjekur me shumë vëmendje. Më pas gjatë kohës që punoja në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë organizuam një ekspozitë me rreth tetëdhjetë punime. Në vitin 2006 profesori më kërkoi të shkruaja diçka për veprat e tij, por më kujtohet që nuk i premtova gjë pasi nuk e ndjeja që isha gati. Ndërkoha që pa i thënë bisedoja me të mbi procesin e punës, dhe dëgjoja shpjegimet e tij për tablo të ndryshme. Ndërkohë që vizitova edhe studion e tij për të parë veprat dhe mjedisin ku punonte. Jamesoni thotë diku se kritika e artit duhet të mbajë erën e bojës së studiove, por nuk duhet të zbresë në nivelin e diskutimit të kafeneve.

Kur profesori më kërkoi të punoja tekstin e monografisë pranova me kënaqësi sepse mendoja që pas gjithë kësaj kohe përgatitjeje isha tashmë në gjendje të analizoja veprën e tij. dhe kështu fillova punën. Duhet t'i shpreh prof. Rexhepit në këtë rast falënderimin tim për mbështetjen e pakursyer që më ka dhënë mbi çdo paqartësi apo pyetje që I drejtoja. Pa bashkëpunimin e tij do të ishte e vështirë ta shkruaja këtë monografi.

Tani më lejoni me dy fjalë të shpjegoj strukturën e analizës së veprës së profesor Ferrit.

Së pari kam filluar me një hyrje (paksa të gjatë) për të vendosur veprën e tij në një sfond historik dhe politik, pasi mendoj se vepra e tij nuk mund të nxirret jashtë këtij konteksti. Prof. Rexhepi i përket brezit të piktorëve modernistë të Kosovës dhe është njëri ndër personalitetet më të spikatura të tij përkrah artistësh të tjerë të shquar të këtij brezi si Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Engjëll Berisha, Agim Çavdarbasha, Nusret Saliamixhiq etj. Ata ishin të parët që krijuan një traditë të

lidhur ngushtë me zhvillimet bashkëkohore në kulturën e Evropës perëndimore duke krijuar një hapësirë emancipimi dhe lirie krijuese e cila nuk njihej ishte njohur më parë në artin pamor të Kosovës dhe më keq akoma, nuk pranohej në anën tjetër të kufirit ku kishte filluar vetizolimi absurd dhjetravjeçar.

Për t'i dhënë një kornizë referimi u nisa nga metaforë e goditur e Bernardit të Shartërs i cili citon Xhonin e Salisburit në vitin e largët 1124. Ai i krahason modernët me xhuxha të hipur mbi supe viganësh dhe për këtë arsye ata arrijnë të shohin më lart. Brezi i artistëve që përmendëm ditën të ngjiten mbi supet e viganëve të artit evropian të asaj kohe me një guxim dhe vullnet të admirueshëm dhe kjo është arsyeja mendoj që kjo periudhë në të ardhmen do të bëhet gjithnjë e më shumë objekt studimi për historianët dhe kritikët e artit.

Ndërkohë që pjesa e dytë lidhet me pyetjen: nëse vërtet vepra e Rexhep Ferrit është moderniste ku qëndrojnë tiparet që e klasifikojnë të tillë. Në këtë rast mendoj se mund të shërbente si kornizë referimi përcaktimi i qëlluar dhe elegant i kritikut të njohur amerikan Klement Grinberg i cili e përkufizon artin modernist si sulm me mjete karakteristike nga brenda disiplinës për ta shkatërruar, por për ta përforcuar më tej zonën e saj të kompetencës.

Gjatë kësaj analize jam përqendruar mbi sulmin tipik modernist mbi disiplinën që përdor Prof. Rexhepi me qëllim pikërisht për të përforcuar zonën e saj të kompetencës. Në këtë hulli janë diskutuar të gjithë elementet kryesore të gjuhës pamore si trajtimi i hapësirës dy dhe tri përmasore, optimumi perceptues, plasticiteti modal, përdorimi i mediumit si bartës kryesor, disa nga fazat e procesit krijues, përdorimi i ngjyrës, strukturat energjetike të rrafshit bazë topologjik, përdorimi i rrafshësisë si taktikë sulmi mbi disiplinën e pikturës, planariteti qerthullues, forma, hapësira kontekstuale.

Në rrafshin ideor mendoj se si kornizë referimi filozofike mund të shërbejë fare mirë esenca e filozofisë ekzistencialiste, më saktë ajo e krahut laik të përfaqësuar nga Niçeja, Hajdegeri, Sartri, Kamyja, Merlo-Pontija: pra, ekzistenca i paraprin thelbit. Figurat e Ferrit të kujtojnë pikërisht momentin kur kjo ekzistencë në formën e një qenieje humanoide, ajo që quajmë individ, pra, nga latinishtja *individus*, (e pandashme) është nisur gjatë një procesi vetrealizues në kërkim të thelbit të tij, duke e realizuar përmes zgjedhjesh të cilat përmbajnë atë që Sartri e quan ankth metafizik. Ky rrugëtim nomadi që nuk resht kurrë është metafora e Ferrit shpesh shoqërohet me rënie dhe arritje por nga i cili nuk heqim dorë kurrë.

Fundi i pjesës së tretë lidhet me diskutimin e tablosë *Maska*, për mendimin tim, njëra nga tablotë më enigmatike dhe më hermetike të krejt trashëgimisë tonë në pikturë. Pikërisht *Maska*, ajo që etruskët e quanin personam, pra askushi, e që në psikologji e quajmë person është roli që marrim në jetë, ajo që përvoja jonë na mëson, vula që lë koha, territori dhe kultura së cilës i përkasim. Është e vështirë që të përcaktohet se në ç'moment tregohet Humanoidi, përpara se të vendosë maskën, para ngjitjes në skenën e *Theatrum Mundi*, apo pasi ka zbritur duke e lënë në skenë. Për këtë nuk na ndihmon as vetë *Maska*. Me qëndrimin e saj sa lojçak aq edhe

armiqësor, sa kërcënues aq edhe ngashnjyes ajo bëhet pjesë e mëdyshjes tonë se në cilin moment mund ta klasifikojmë Homanoidin.

Mendoj se një vlerë tjetër veprës së Prof. Rexhepit është fakti që ai përpiket dhe nuk dorëzohet në fitimin e sfidës më të vështirë për një artist, atë të kohës. Ndonëse tablotë e tij mbajnë një matricë të qartë moderniste dhe vepra e tij mendoj se klasifikohet në tërësi si e tillë, në disa vepra të kohëve të fundit ai tregon një prirje të qartë post moderniste. Në ndërhyrjet që bën mbi vizatimet dhe tekstin e fletëve të ndryshme të librave, ai bën një ndërhyrje e cila është e kundërt me atë që Valter Benxhamini thotë në librin e tij të njohur *Vepra e artit në epokën e rirodhimit mekanik*. Ai thotë aty se origjinali e humbet aurën e tij gjatë shumëfishimit të veprës në shumë kopje të tjera. Me anë të kësaj Benxhamini besonte se kjo do të shkatërronte jo vetëm aurën por edhe autoritetin e origjinalit. Ndërhyrja tipike post-moderniste që bën Prof. Ferri lidhet me kthimin e kopjes përsëri në origjinal, duke kryer atë ndërhyrje të cilën Burjoja e quan me termin postproduksion, pra të marrësh punën e dikujt dhe ta vazhdosh aty ku e ka lënë ai duke krijuar një vepër tjetër.

Së fundi, do të doja t'ju falënderoja edhe një herë për ftesën por do të doja ta shihja përzgjedhjen time, pra, një kritiku arti nga Tirana për të shkruar një tekst për monografinë e një personaliteti të artit shqiptar si shfaqje e vullnetit dhe dëshirës gjithnjë në rritje për të bashkëpunuar, për të folur për veprat e njëri-tjetrit duke hequr sa më shpejt atë kufi të trashëguar nga një padrejtësi historike e cila shpresojmë të mbetet shumë shpejt vetëm një kujtim i hidhur i së shkuarës.

Ju uroj po ashtu ta gëzoni ndërtesën e re vërtet mbresëlënëse të Akademisë dhe suksese dhe punë të mbarë.

Ju faleminderit!

Eqrem BASHA, Prishtinë

PËR MONOGRAFINË PËR FERRIN

KUD 72.071(496.51)(092)

I nderuar Zoti Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,

Të nderuar zotërinj akademikë dhe pjesëmarrës të tjerë në këtë përurim!

Botimet monografike për artet figurative apo artet pamore në përgjithësi te ne janë të rralla jo vetëm pse kërkojnë rrethana të veçanta dhe standarde të larta të cilësisë grafike, të cilat kushtëzohen me kosto mbi ato të botimeve të tjera, por edhe për shkak se i nënshtrohen një procesi të ndërlikuar të përgatitjes: evidentimit, grumbullimit, përzgjedhjes, fotografimit, skanimit, përpunimit grafik, disenjit, që mëton kulmin dhe kompetencën e kërkesave të tilla, me qëllim që të krijohet pasqyra sa më besnike e punës së një piktori a skulptori, që ka mjet shprehjeje vijën, ngjyrën, teksturën apo dritën e hijen, të cilat nuk mund të komunikojnë dhe nuk mund të shijohen nëse nuk janë paraqitur me cilësi optimale.

Nga ana tjetër, janë gjithashtu të rrallë studiuesit, kritikët apo historianët e artit që i rreken me autoritet dhe njohuri një ndërmarrjeje të tillë, duke marrë parasysh nevojën e ndjekjes së vazhdueshme të punës së një krijuesi, njohjen e thellë të veprimtarisë dhe vlerësimin e gjithanshëm të opusit të tij.

Prandaj kjo vepër që po paraqesim sot, përveç se dëshmon përkushtimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të Seksionit të saj të Arteve, për t'u dhënë rëndësinë që meritojnë dhe për t'i përkrahur deri në fund këto lloj botimesh, paraqet njëkohësisht dhe një ngjarje kulturore për gjithë opinionin artdashës dhe kontribon për prezantimin sa më të denjë të figurave të rëndësishme të krijimtarisë sonë artistike të këtyre fushave të sjellë me penat e dalluara të këtyre shkrimeve dhe studimeve, siç është ajo e Gëzim Qëndros.

Rexhep Ferri dhe krijimtaria e tij e pasqyruar në këtë monografi, i takon brezit të artistëve, piktorëve, skulptorëve e grafistëve, që janë në themelet e modernes te ne dhe që konsiderohen bartës të zhvillimit të këtyre lëmenjve në këto 40-50 vjetët e fundit. Të dalë fillimisht nga bankat e shkollës së mesme të artit në Pejë dhe të shkolluar e të specializuar pastaj në qendrat e mëdha universitare të ish Jugosllavisë, me shumë mundësi komunikimesh dhe njohjesh të asaj që asokohe ishte aktuale në botë, ata sollën përvoja të reja dhe u formuan në personalitete të veçanta, secili në fushën e veprimtarisë dhe orgjinalitetin e tij, duke u ngritur në autoritete shtylla të zhvillimit të pikturës, skulpturës, grafikës dhe arteve aplikative. Muslim Mulliqi, Gjelosh Gjokaj, Rexhep Ferri, Tahir Emra, Nusret Salihamixhiqi, Xhevdet Xhafa, Agim Çavdarbasha dhe të tjerë, por edhe një plejadë e tërë që erdhën pas tyre dhe si rezultat i punës intensive pedagogjike të tyre, e fisnikëruan

dhe denjësuat artin figurativ të ne duke i bërë ata dhe dishepujt e tyre protagonistë të ngjarjeve të mëdha kulturore e artistike, tashmë jo vetëm në Prishtinë, Pejë, Gjakovë a Prizren, e as pak hapa më tutje, në Tiranë e gjetiu, por në shumë metropola europiane e botërore ku sot flitet me respekt për artistët pamorë të Kosovës.

Pa dashur të hyjmë në analizën më të gjerë të krijimtarisë së Ferrit, gjë që e ka bërë në mënyrë të gjithanshme dhe me shumë kompetencë Gëzim Qëndro, me shkathtësinë e studiuesit dhe vlerësuesit të përkushtuar, jo vetëm duke zbërthyer dhe interpretuar tablonë e tij, duke na e afruar e qartësuar, duke na udhëhequr me elokuencë brenda një bote komplekse dhe të nyjshme artistike, me shumë përmbajtje dhe formë të veçanta brenda një UNI, lexo – origjinaliteti, “nëpër labirintet, humbellat, guvat gjysëm-dritë, gjysëm-terr të ndërgjegjes së tij”, por edhe duke e vënë atë në kontekstin e zhvillimit të arteve pamore gjithandej nga flitet shqip, kthesave historike që sollën një zhvillim të ndryshëm të këtyre arteve në shtetin shqiptar dhe në Kosovë, si dhe duke i dhënë meritat e njërit nga pishtarët e modernes në historinë e artit dhe të kulturës sonë. Qëndro do të elaborojë nga dorë e parë dhe shkathtësinë e “zanatit”, domosdo, më afër dhe më qartë se ne që nuk jemi të penelit dhe daltës.

Ne mund të themi, të paktën, se kjo botë e Ferrit, për të cilën kemi pasur rast të pronocohe mi disa herë, nuk është dhe aq e largët, siç e dëshmon dhe studiuesi ynë, në veçanti ajo e kulmeve të pjekurisë artistike. Ferri ka një dorëshkrim të dalluar e të dallueshëm, origjinal dhe të papërsëritur. Ai është i njohur dhe i rinjohshëm në *metodën* e procedurës së tij artistik. Qartësia dhe konsekuenca e këtij dorëshkrimi, apo t’i themi kompozimi i tablojeve, është aq e veçantë sa pothuaj në të gjitha fazat e zhvillimit, cikël pas cikli, edhe në kapërcimet e moteve dhe subjekteve, ai mbetet gjithnjë këmbëngulës në rrugën që ka nisur një herë, në fillimet e tij, tash e më shumë se dyzet vjet më parë, në të cilën vazhdon të kërkojë burime të reja frymëzimi, të fokusojë stacione të reja, për të mos u ndalur të pushojë e të freskohet aty, por për të hapur hartat e për të kërkuar vazhdimet e kësaj rruge të pasur artistit. E gjithë karriera e tij, do të thoshim se nuk ka devijime të thella, nuk ka kapërcime që do të ndryshonin përcaktimin dhe konsekuencën. Dorështrënguar në ngjyrë, por gjithnjë e më i kujdesur në komunikimin e subjekteve, ai më parë duket se zbërthen mendimet në pëlhurë a në letër e bardhë, sesa kujdeset për saktësitë anatomike e fenotipike të këtyre “humanoidëve shëtitës”, siç i quan Gëzim Qëndro figurat e Ferrit.

Ne që e njohim nga afër e dimë mirë se kërkimet që bën ai, ndonjëherë brenda një tabloje, duke shkruar e mbishkruar mbi një *subjekt*, duke sakrifikuar një zgjidhje që duket interesante, për të kërkuar një tjetër, më ndryshe, nuk të lejojnë gjithmonë mundësinë e *leximit* përfundi, por ato mbrujnë një histori përpykjes dhe kërkimesh të cilat Ferri i ka pasur dhe i ka gjithnjë të dendura, herë-herë dhe brenda një tabloje, që dëshmojnë se nuk janë të çastit.

Duke mos pushuar edhe pas kaq vitesh, kur mund të pandehnim qetësinë dhe prehjen e lëvizjeve dinamike mbi sipërfaqet e pastruara me elegancë, jo më si ato të mëhershmet, në kohët kur kërkonte badh-e-zi-në e Bjeshkëve të Nemuna, lojën marramendëse të gajtanëve dhe qëndrimet malësorçe, bisedat, intimitën, kujtimet, heshtjet dhe brohoritjet, ai duket sikur kërkon me ngulm të na bindë se ka edhe

shumë për të thënë, ka edhe shumë për të gjetur, në atë botë të pasosur lëvizjesh e kërkimesh. Piktur i të kaltrës dhe të përhimtës, me ndonjë theks të të verdhës, okerit, të gjelbrës apo derivateve të tyre, Ferri ka një paletë koprrace, më shumë të ftohtë se të ngrohtë, çka bën që ndonjëherë të ndjehemi të mpirë e pa fjalë tek vështerojmë hijet, siluetat e mbetura si fosile të këtyre “humanoidëve nomadë”.

Disa herë-herë të krijohet përshtypja se Ferri që paralelisht merret dhe me poezi, ese e romane, në të cilat në të shumtën dominon ligjërimi sentencial, me shumë pyetje e dilema, në këtë mënyrë zbulon një anë të preokupimeve të tij edhe përmes vizatimit, të pasur e domethënës, të ngërthyer me një lojë dinamike, të qartë e të pastruar, pa e përfillur rrezikun e ilustrativizmit, të ngërthyer me labirinte kërkimesh mbi gërmadha, i bindur se loja asociative brenda figurave a portreteve, por edhe në mure e fasada, në gjetjet e papërsëritura dhe të papërsëritshme, thonë gjithashtu mendime, i përforcojnë ato variante e zgjidhje të reja që përcjellin vazhdimisht mesazhet e një pikpamjeje, më shumë se një ndjenje të çastit, e cila do të thuhej ndryshe në një qasje tjetër. Fundja kështu është cilësuar nga kritika e kohës në ekspozitat e pavarura apo kolektive, bashkë me kolegët e tij të gjeneratës, këtu e jashtë kufijve të sotëm, kur është tërhequr vëmendja se opusi i Ferrit i takon një semiotike të veçantë, një sistemi shenjash e domethëniesh të veçanta.

Një shëtitje nëpër tituj, të cilëve shpesh as që ua hedhim sytë, sikur zbulon një tendencë, e cila jo te të gjithë piktorët ka rëndësi. Por do ta ketë patjetër te një që shkruan vjersha e romane. Janë të rrallë titujt e papërcaktuar, edhe atëherë kur tabloja është një lojë kompozicionale, por do të gjejmë insistimin e autorit për të na orientuar tek synimi për t'i radhitur tablotë e tij në vargun e persiatjeve, kërkimeve, angazhimeve: *Me detin e deti larg, Në prag të harresës, Prekje e heshtur, Atdheu im torzo, Hapat e atyre që i kemi njohur, Ndoshta kujtimi, Portret nga Kodra e hutit, Një ditë më vonë, Një emër për dy figura...* A nuk duket se i flet poeti piktorit?

Ata që e njohin mirë karakterin psikologjik të vijës dhe fakturave, sipërfaqet e ngërthyera në lojën e shpërthimit të energjisë së krijuesit, që i ndjekin mesazhet në këto lëvizje apo edhe në sipërfaqe të qeta, të pastruara, me ngjyrë e fakturë, të ndalur aty këtu në theksime që krijojnë harmoninë e formave dhe qëndrimeve, qoftë të “humanoidëve”, (më pëlqen kjo gjetje e Qëndros), qoftë të mureve a gërmadhëve, atëherë kur ai rreket të merret me shkatërrimin të cilin e kemi kapërcyer dhe e mbajmë në kujtesë të gjithë, e dinë se këto janë gjurmët e angazhimit të tij edhe në shkrime, kjo është logjika në bisedat e tij me ne dhe me personazhet e imagjinuara, kjo është *filozofia e jetës së tij*, e qëndrimeve dhe raporteve që ka me rethin.

Monografia përfshin pothuaj gjithë opusin e Ferrit, biles edhe skicat, vizatimet aplikative, kopertina librash dhe pllakate, aktivitete me të cilat ishte marrë dendur në një periudhë më të hershme të krijimtarisë së tij. Ajo i ofron të gjitha llojet e informatave rreth tij dhe veprës së tij. Në raste të tjera, kur botimet e tilla do të ishin më të shpeshta, këto mbase mund të ishin mundësi për t'i paraqitur disa prej tyre veç e veç. Por ambicia e këtij botimi mëton të japë diagonalen e plotë të një jete dhe një krijimtarie ndaj mund të shihet dhe kështu.

Monografia e Rexhep Ferrit vjen pas asaj të Muslim Mulliqit dhe Agim Çavdarbashës. Kemi njohuri se janë në përgatitje monografia e Tahir Emrës dhe ajo e Gjelosh Gjokajt. Është meritë e Akademisë dhe Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe e Seksionit të Arteve që në programet e veta kanë pasur gjithmonë dhe vazhdon të ketë më tutje projekte të tilla që na mundësojnë një pasqyrë të qartë për një gjeneratë të dalluar artistësh mbi të cilën, dhe në sajë të angazhimit pedagogjik të së cilës, u ngrit një plejadë e tërë të rinjsh që sot kanë marrë botën.

PROMOVIMI I VEPRËS SË AKADEMIK MARK
KRASNIQIT *BESA NË TRADITËN SHQIPTARE*

Besim BOKSHI

FJALË E PËRSHËNDETJES

Me kënaqësi të veçantë i shpreh përgëzime akademik Mark Krasniqit për botimin e veprës *Besa në traditë shqiptare*, me të cilën e begatoi vëllimin e gjerë të veprave të tij shkencore dhe dëshmoi për funksionimin efektiv të energjisë së tij krijuese edhe në këtë moshë të shtyrë, duke na paralajmëuar, për gëzimin tonë, se vargu i veprave të tij nuk pëfundon këtu.

Sot po bëhet promovimi i kësaj vepre më të re të Mark Krasniqit, të personalitetit që e fisnikëroi jetën e tij me veprimtari krijuese të dalluar shkencore e letrare e me veprimtari po aq të dalluar patriotike. Ai eci nëpër jetë me ndjenjë të lartë të pëgjegjësisë shoqërore e kombëtare.

Gjithë veprën e tij shkencore pa përjashtim Marku e ka vënë në funksion të interesit kombëtar. Besa si shfaqje e raporteve të caktuara të botës fisnore, në veprën e Mark Krasniqit është vështruar e transformuar në virtyt të popullit shqiptar, ashtu siç janë vështruar më parë në libra të veçantë edhe mikpritja dhe toleranca, që formojnë një trilogji tematike lavdëruese për popullin shqiptar.

Përgëzoj edhe promovuesit e kësaj vepre: akademik Pajazit Nushi, akademik Esat Stavileci dhe zonja Shpresa Siqeca që do të na sjellin të argumentuara vlerat e kësaj vepre dhe vendin e saj në krijimtarinë shkencore të autorit dhe në trajtimet e kësaj teme nga autorë të tjerë.

Mirë u pafshim në promovime të tjera!

Pajazit NUSHI, Prishtinë

PËR LIBRIN E AKADEMIK MARK KRASNIQIT *BESA NË TRADITËN SHQIPTARE*

KUD 39(=18)

Libri më i ri i Akademik Mark Krasniqit *Besa në Traditën shqiptare* ka katër shtresa kuptimore të ndërlidhura: shtresa e parë është zbërthimi i kuptimit “Besë” dhe “Pabesi” në mendimin dhe në sjelljet e shqiptarëve në jetën familjare, në kohët e luftërave, në pajtim të gjaqeve, në mbrojtjen e të tjerëve, dhe në mbrojtjen e objekteve sakrale; shtresa e dytë i përket trajtimit të besës shqiptare te disa autorë të huaj dhe vendas, shtresa e tretë është frymëzimi i krijuesve popullor nga rëndësia e besës dhe e besnikërisë në raportet ndërshqiptare dhe ndërmjet shqiptarëve e të tjerëve, dhe shtresa e katërtë ka të bëjë me karakterin multidisiplinarë të studimeve për besën.

Sa i përket shtresës së parë të kuptimit që ka besa autori së pari ka konstatuar shtrirjen e besës në trevat shqiptare duke theksuar: “Besa është një fenomen me përmasa shumë të mëdha në gjithë popullin shqiptar, në të gjitha trevat etnike shqiptare, në jetën kolektive dhe individuale gjithmonë e pranishme, bile edhe në raste të parëndësishme, në biseda dhe në zhargon të përditshëm, por edhe në literaturë të gjinive ndryshme. Madje, besa është kandari më i shpeshtë me të cilin matet vlera familjare, apo, personale” 1 (1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Mark Krasniqi, *Besa në Traditën Shqiptare*”, Prishtinë, 2011, f. 9), Thelbin e domethënies autori e ka nxjerrë nga hulumtimi i literatures etnografike, historike, enciklopedike e folklorike. Me qëllim të saktësisimit të plotë të domethënies së fjalës termit etnologjik “Besë” autori ka analizuar numër të madh shembujsh të rolit të besës në zgjidhjen e situatave të ndryshme të jetës dhe të aktivitetit të shqiptarëve kryesisht në të kaluarën e shqiptarëve nën Perandorinë Osmane dhe më pas. Nga qasja e hulumtimit të zhvillimit të besës dhe e rezultateve të këtij hulumtimi kuptojmë gjenezën hyjnore të bekimit të ilirëve për lidhjen e njerëzve me anën e besës “si një akt që lartëson moralisht qenien njerëzore të popullit (të popullit ilir P. N.) duke e veçuar nga të tjerët të pabesë”. Në mbështetje të kësaj mënyre të nxjerrjes së domethënies së fjalës e termit besë, autori ia atribuon domethënien e plotë të kësaj fjale shqiptarëve e gjuhës shqipe, sepse fuqia kognitive, morale dhe vetëmohimi përmbledhen në domethënien e besës, e cila, sipas studiuesit Lange nuk mund të përkthet as në gjuhën gjermane, sepse në gjermanisht nuk gjendet term ku mbërthehet e vërteta, njerzoria dhe burrëria.

Duke theksuar se “në traditën shqiptare rolin kryesor e ka pasur *besa*” 2 (2, Po aty, f. 191), autori le të kuptojë se lexuesi i kësaj vepre më lehtë do të kuptojë

përmbajtjen e konceptit “Besë” nga roli moral e social i saj, se nga përkufizimi i shkurtër i domethënies së kësaj fjale, përkatësisht të këtij termi. Autori duke iu referuar më tepër pikëpamjes dhe domethënies së besës nga ana e të madhit Sami Frashëri mbështet domethënien e dhënë nga ana e tij. Në domethënien e tij përmendet më tepër roli i aktit të besës në bashkimin e shqiptarëve, si edhe lidhjen e besës, të besnikërisë e të tolerances fetare të shqiptarëve me karakterin e shqiptarëve duke veçuar besën e tolerancën fetare tipare qendrore të karakterit unik të shqiptarëve 3 (3, Po aty, f. 92). Nga autorët e mirëfilltë të disiplines së etnologjisë autori ka përmendur përcaktimin e domethënies së besës nga ana e etnologut bashkëkohor Mak Tirta, sipas të cilit “Besa është dukuri universale me natyrë etno – morale dhe etnojuridike në jetën e popujve të lashtë dhe të bashkësive fetare gjatë mesjetës. Besa si virtyt moral e ka zanafillën nga lashtësia, pra lindjes së shoqërisë së organizuar në shtet e të formacioneve shtetërore, si një mjet i shprehjes së solidaritetit të bashkësisë fisnore. Ajo mbështetet në kultin e fjalës së dhënë, e cila, sipas mendësisë së besimeve të lashta ishte akt hyjnor i pathyeshëm” 4 (4, Po aty, f. 12). Nga këndvështrimi i universalitetit të aktit të besës akademik Mark Krasniqi ka nxjerrë nisjen zhvillimore të aktit të besës te fiset ilire dhe zhvillimin e këtij virtyti moral te shqiptarët gjatë shekujve duke e trajtuar besën akt moral dhe institucion ligjor 5 (5, Po aty, f. 22). Njohjes së kuptimit, të rolit dhe të rëndësisë së besës në zhvillimin e raporteve ndëreshqiptare dhe raporteve të tyre me të tjerët i kontribuon posaçërisht antonimi “pabesi”. Analizës së pabesisë ose shkeljes së besës autori i ka kushtuar vëmendje të veçantë. Sipas autorit të kësaj vepre derisa besa e besnikëria janë karakteristika kryesore të moralit shqiptar, pabesia, shkelja e besës ose besthyerja, gjithashtu është njolla më e zezë në moralin e secilit 6 (6, Po aty, f. 117). Lidhur me pabesi autori ka shpjeguar disa raste, nga të cilat ka dalluar rastet e paraqitura në veprën e At Gjon Kmasit “Ndër malet tona”.

Në kuadrin e shtresës kuptimore të dytë të besës, autori ka shkruar gjerësisht për trajtimin e besës nga etnologët, historianët, juristët dhe sociologët e jashtëm. Këtu shohim një panoramë emrash të njohur të mendimit njerëzor, sidomos të albanologëve. Këtij regjistri i paraprijnë mendimet për besën të albanologëve Franc Baron Nopça e Johan Han dhe më pas regjistrohen mendimet për besën nga mendimtarët e disiplinave të ndryshme, si nga Gordon Bajron, Margaret Hasluk, Edith Durham, Zhysten Gotard, Justen Gotard, Zhak Olen, Valentino Gjuzepi, Dr. Jovan Erdelanoviq, Aleksandër Gilferding, Fransua Pukvil. Lovro Mihaçeviq, Hijecint Hekart, Mark Millan, Aleksa Bogosavleviq dhe Dimitrije Tucoviq. Këtij rrethi kuptimor i përket edhe trajtimi i besës në funksion të pajtimit të gjaqeve. Lidhur me këtë autori ka shkruar më shumë se njëmbëdhjetë faqe, ku ka vë në spikamë rolin e rëndësishëm të besës në zgjidhjen e konflikteve individuale, familjare dhe nder fisnore, sipas Kanunit të Lekë Dugagjinit, sipas të cilit “Besa ka qenë faktor vendimtar për zgjidhjen e shumë problemeve ndërnjerëzore, ndërfitnore dhe për zbatimin e vendimeve përkatëse kanunare” 7 (7, Po aty, f. 41). Nga kjo fushë autori në veprën e tij “Besa në Traditën Shqiptare” ka përmendur shumë shembuj konkret të zbatimit të

besës në zgjidhjen e situatave problemore të ndërlikuara familjare e sociale në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale.

Rolit të besës së shqiptarëve në kohëra të luftës akademik Mark Krasniqi i ka kushtuar kujdes të posaçëm. Kësaj çështjeje i ka kushtuar pjesën më të madhe të librit, sepse nga 194 faqe të tekstit të mirëfillët për besën 54 faqe ose mbi njëekatartha e gjithë vëllimit i kushtohet beslidhjeve duke filluar nga “Besëlidhja e Arbërisë më 1257 – 1259. Në këtë kuadër është shtjelluar roli i Besëlidhjes së shqiptarëve në Kuvendin e Lidhjes së Lezhës më 1444, të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Beslidhjes Shqiptare “Besa – Besë” të Pejës më 1899, të Kuvendit të Junikut në maj të vitit 1912, të Kuvendit të Murgullës më 16 – 19 qershor 1920, të rolit të besës në kryengritjen e malësorëve në krye me Gjo Dedë Lulin më 1910 e 1911, në Kuvendin e Verrave të Llukës, etj. Sipas autorit të gjitha kryengritjeve u ka prirë besa e zakonshme 8 (6, Po aty, f. 75). Autori vazhdimisht i referohet besës dhe trimërisë së Skënderbeut – si frymëzim i besës shqiptare dhe e adhuron madhësinë morale – shpirtërore të qenies kombëtare e historike të shqiptarëve. Më në fund edhe Kuvendi i shpalljes së pavarësisë në Vlorë është beslidhje shqiptare. Besa e dhënë në këto kuvende historike lidhet me besnikërin, nderin dhe trimërin e personaliteteve të këtyre kuvendeve, të Skënderbeut, Lekë Dugagjinit, të Pjetër Bogdanit, Abdyl Frashërit, Ali Pashë Gusion, Haxhi Zekës, Dedë Gjo Lulit, Mehmet Shpendit, Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Bajram Currit, Mul Deli Bajraktarit, Ramë Bllacës e të tjerëve. Autori i kësaj vepre ka gjurmuar edhe lidhjen ndërmjet besës shqiptare dhe mbrojtjes së hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore. Shpjegimin e mbrojtjes së hebrenjve autori e gjenë në besën e shqiptarëve, së cilës i ka kushtuar reth 3 faqe.

Shtresa e tretë kuptimore e besës dhe e rolit të saj në jetën dhe në aktivitetin e gjithmbarshëm të shqiptarëve është reflektimi i vlerës morale e shpirtërore të besës në krijimtarinë popullore dhe në atë artistike. Nga ky kënvështrim autori ka vë në spikamë krijimtarinë në prozë e në poezi për besën shqiptare të përmbledhur në shumë vepra, nga të cilat dallohen: Kujtime të një jete së kalueme të Dom Ndoc Nikajt, Ndër mallet tona të Atë Gjon Kamsit, Thesare Dujagjinase të Voc Dedajt, Mitologjia, doke e zakone shqiptare të Atë Bernardin Palajt, Proza popullore të Halil Kajtazit dhe vepra të shumë të tjerëve. Në këtë pjesë shqyrtuese të kësaj vepre autori ka shënuar shumë shembuj të besës nga poezia popullore, si: “Vrasja në Lezhë”, “Kanga e Kaçanikut”, “Kanga e Rugovës” e të tjera kryesisht të tipit “Mbledhen shqiptarët bytevi/Në Mitrovicë deri në Gusi/N`Kaçanik der n`Malsi/ N`verra të Llukës bajn pleqni/N`Verra të Llukës janë mbledhë t`tanë/ kanë lidhë besën për gjithë anë”. 8 (8, Po aty, f.167). Poashtu akademik Mark Krasniqi në veprën “Besa në Traditën Shqiptare” ka vë në spikamë krijimtarinë artistike lidhur me besën shqiptare ku ka përmendur dramën e Sami Frashërit “Besa”, baladën e famshme Konstandini e Doruntina të Ismail Kadaresë, dramën “Nita” të Josip Relës, etj.

Në shtresën kuptimore të katërt të besës, autori ka paraqitur kumtesën e tij me temën “Besa – temë studimesh shumë disiplinore” të botuar nga Akademia e Shken-

cave të Kroacisë më 1962, ku ka shtjelluar kuptimet “Besa në gjakmarrje”, “Besa në mbrojtjen kolektive”, Besa në etnopsikologjinë e shqiptarit dhe “Besa në folklorin popullor”. Studiuesit e etikës dhe të psikologjisë sociale të shqiptarëve dhe ata të mendimit enciklopedik shqiptar besën shqiptare e përpunojnë si koncept boshtor të këtyre disiplinave. Nga kjo vepër në rend të parë, del se në psikologji besa është vlerë sociale, që ka të bëjë me strukturën e brendshme të kultures së shqiptarëve, rreth së cilës integrohen qëllimet individuale dhe ato të bashkësisë shqiptare duke përfshirë zbatimin qëllimkeq të besës së dhënë. Sipas këtij përkufizimi besa nuk është kontratë e zakonshme, por besa është mbi të gjitha tipari kryesor i karakterit të shqiptarit, i fytyrës, i burrërisë dhe i prestigjit të tij. Zbërthimi i saj kuptimor shpie në përfundim se premtimi e zotimi i marrë me anë të besës nënkupton vetrespekt të nivelit të lartë, kurse pabesia vetshkatërrim përfundimtar të vetvetes; besa prodhon solidaritet, dashuri, miqësi, respekt e nderim, por edhe zhvlerësimin shkatërrues, madje edhe gjakmarrje. Nga vlerat e tjera ndryshon se besa është kategori mendore e lidhur drejtpërdrejtë me sjellje, me veprim. Sjellja e veprimi i njeriut ndaj një çështjeje e përcakton besnikërin e tij ndaj asaj çështjeje. Së këndejmi fuqia motivuese e besës në kuptimin bashkëkohor të motivit, është baza kognitive e besës e pandarë nga sjellja bestare apo nga sjellja jobestare dhe e shoqëruar me ndjenja morale të larta. Kjo tërësi procesesh kognitive, emocionale dhe motivuese të ndërlidhura do të ishte kualitet psikik i veçantë i besës shqiptare. Vepra e akademik Mark Krasniqit ka dhënë shkas hulumtimit të mendjes së vetëdijshme e të pavetëdijshme të besës shqiptare, e cila deri më sot ka ngelë të thuash e paprekur.

Esat STAVILECI, Prishtinë

BESA NË TRADITËN SHQIPTARE

KUD 39(=18)

Akademik Mark Krasniqi ka paraqitur dorëshkrimin për veprën nga etnografia kombëtare me titull “Besa në traditën shqiptare” të shkruar në 123 faqe kompjuterike me rreshta të shpeshtë. Dorëshkrimi ka këtë strukturë përmbajtësore: parathënie të titulluar “Dy fjalë në fillim” të shkruar nga autori në gati dy faqe dhe “Shënime biografike” ku është paraqitur bibliografia e përbërë nga tetë vepra shkencore, tri tekste shkollore, gjashtë shkrime publicistike, njëmbëdhjetë vepra letrare (poezi) dhe nëntë përkthime letrare të shkruara në rreth pesë faqe. Pjesa kryesore e kësaj vepre i kushtohet rezultateve hulumtuese të besës në traditën shqiptare.

Kjo pjesë ka trembëdhjetë tituj temash së bashku me tekstin “Rezyme” të përkthyer në gjuhën angleze dhe është e shtruar në njëqindetëmbëdhjetë faqe të kompjuterizuara. Autori ka gjurmuar shumë vepra dhe punime shkencore, të cilat kanë trajtuar traditën shqiptare sidomos besën dhe rolin e saj në traditën e popullit shqiptar. Shpjegimi i virtyteve dhe i vlerave të shqiptarëve ka qenë preokupim i përhershëm i autorit dhe lidhur me këtë akademik Mark Krasniqi ka publikur studime dhe punime të veçanta në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Autori i është referuar shumë burimeve shkencore. Referimi i veprave të cituara është shënuar në fund të secilës faqe dhe përbrenda përmbajtjes së secilës temë.

Struktura tematike e kësaj vepre ka këtë renditje: Kuptimi i fjalës “Besë”; Besa shqiptare te disa autorë të huaj; Besa në funksion të pajtimit të gjaqeve; Roli i besës në kohën e luftës; Besa – faktor i rëndësishëm i moralit shqiptar; Roli i besës në mbrojtjen e hebrenjve; Besa në mbrojtjen e objekteve sakrale; Mënyra e lidhjes së besës; Pabesia – shkelja e besës; Disa shembuj të besës në poezinë popullore; Besa shqiptare në jetën bashkëshortore; Besa – temë studimesh multidisiplinare dhe në fund është përmbajtja e tekstit “Rezyme” e shkruar, (siç përmendëm) në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Autori i është qasur gjurmimit të kësaj tradite shqiptare nga këndvështrimi zhvillimor i besës dhe i rolit të fjalës së dhënë, përkatësisht rolit të besës në jetën e përditshme të shqiptarëve, në marrëdhëniet e tyre sociale, morale, ndërpersonale, ndërfamiljare e ndër-fisnore duke përpunuar edhe rolin e saj jo vetëm në kuadrin e traditës shqiptare, por edhe në kuadrin e marrëdhënieve morale të shqiptarëve me popujt fqinjë dhe me të tjerët, sidomos me popullin hebraik dhe mbrojtjen e tyre nga nazifashizmi gjerman para, gjatë dhe pas Luftës II Botërore. Nga këndvështrimi i këtillë autori ka dalluar se për besën është shkruar nga ana e shumë studiuesve dhe krijuesve shqiptarë dhe nga të huajt. Këta studiues dhe krijues në forma të ndryshme e kanë vënë në spikamë thelbin kuptimor të besës shqiptare në mendimin popullor, etik, shkencor dhe në mendimin enciklopedik. Në kuadrin e trajtimit të këtillë të besës, kuptimi i saj është formuluar si obligim juridik zakonor ndaj sho-

qërisë, individit dhe ndaj vetes e moralit të tij. Kuptimi sintetik i besës është i formuluar në mendimin enciklopedik shqiptar, ku besa konsiderohet “institut i ligjit dokësor: mbajtja e fjalës së dhënë për diçka me rëndësi, ose fjala e nderit për të zbatuar medoemos një detyrim të marrë përsipër, gjithashtu për zbatimin e rregullave të marrëdhënieve të bashkëjetesës në krahinë, në përputhje me doket e zakonet e vendit”.

Qasja studimore e besës dhe e rolit të saj në jetën e shqiptarëve është shtrirë nga ana e autorit prej vitit gjashtë të erës së re deri në kohën më të re, prej fiseve të para ilire të pjesës qendrore e veriore të Ilirikut deri përtej Sremit, nga Danubi deri në lumin Mat. Në këtë vepër dallojmë interesimin e shumë studiuesve të huaj për njohjen dhe gjurmimin shkencor të besës. Ndër këta studiues dallohen F. Baron Nopça, B. Xhorxh Gordon, Thomas A Paskidhis, H Hekard, M. Hasluk, Edit Durham, Johan G. Han, J. Gotard, A. Joviçeviq, M. Milani, Dr. J. Erdelanoviq, D. Tucoviq, A. Gilferding, L. Mihaçeviq, etj. Pikëpamjet e tyre për besën lidhen drejtpërdrejtë ose indirekt me vlerësimin e studiuesit francez Zhusten Gotard, sipas të cilit “Feja e shqiptar është besa shqiptare”. Kjo pikëpamje përputhet me pikëpamjen e shumë studiuesve shqiptarë mbi besën, ndër të cilët autori ka përmendur disa studiues, ku dallohen S. Frashëri, A. Drenova, M. Tirta, Gj. Skiro, Pal Doçi dhe shumë të tjerë. Autorët e huaj dhe ata shqiptarë përmendin rolin e besës në rregullimin e marrëdhënieve juridike dokësore ndërmjet shqiptarëve dhe përshkruan dhe shpjeguan gjerësisht edhe rregullat praktike të zbatimit të besës në marrëdhëniet e shumfishta sociale, martesore, fetare, pronësore – ekonomike, të kryengritjeve shqiptare për liri duke u mbështetur në besën e dhënë. Nga ky këndvështrim duhet veçuar “Besëlidhjen e Arbërit”, “Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, “Lidhjen e Pejës” e njohur me emërtimin “Besa – besë”, kryengritjen e malësorëve në krye me Dedë Gjo Lulin, etj.

Autori me të drejtë e thekson rolin e besës në zhvillimin e marrëdhënieve morale duke e trajtuar besën faktor të rëndësishëm të moralit shqiptar dhe duke e lidhur këtë faktor me karakterin e shqiptarëve e me tiparet e zhvillimit dhe të formimit të karakterit dhe të psikologjisë së shqiptarëve. Tradita e ruajtjes së kishave në Kosovë dhe më gjerë është e lidhur me besën shqiptare. Lidhur me trajtimin e përgjithshëm të besës, akademik Mark Krasniqi ka vënë në spikamë shumë shembuj karakteristikë të besës shqiptare nga e kaluara e largët, e afërt dhe ndryshimet e besës në të tashmen. Në vend të përfundimit autori ka theksuar “Besa – temë studimesh shumëdisiplinare” duke i cytur në këtë mënyrë jo vetëm etnologët por edhe sociologët, psikologët, studiuesit e etikës, kulturologët, etj., për studim të gjithanshëm të besës shqiptare.

Shpresa SIQECA, Prizren

NJË LIBËR ETNOLOGJIK ME VLERA TË MËDHA SHKENCORE

Në të kaluarën jeta familjare dhe shoqërore zhvillohej sipas dokeve e ligjeve të pashkruara, shumica e të cilave gjenden të përfshira në Kanunin e Lekë Dukagjinit të mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi. Burrëria, mikpritja dhe besa janë virtyte, doke dhe institucione pozitive shqiptare dhe tregues të mirëfilltë etnikë. Besa është institucion i lartë moral i shqiptarëve, që është trashëguar nga ilirët. Shqiptarët, kudo që jetonin, më përpara vdisnin se sa shkelnin besën e dhënë. Besa jepej në raste të gjakmarrjes, pajtimit të gjaqeve, në raste luftërash, në dashuri etj.

Këto ditë, shkenca shqiptare në Kosovë u pasurua me librin “Besa në traditën shqiptare” të akademikut tonë të nderuar Mark Krasniqi /Botim i ASHAK, Prishtinë më 2011/.

Libri u hartua në bazë të hulumtimeve të bëra në hapësirën mbarëshqiptare. Libri u mbështetë në fakte dhe u punua me metodën e okservimit direkt në terren. Për hartimin e tij janë shfrytëzuar kujtimet e fëmijërisë, të dhënat gojore, shkrimet e rilindësve dhe të autorëve të huaj etj.

Libri i përket fushës së trashëgimisë kulturore. Ai është shkruar me stilin shkencor dhe ka karakter popullarizues edukativ dhe praktik. Në 200 faqe të librit janë përfshirë 12 punime me tematikë të besës shqiptare. Libri përcillet me parathënie, rezyme në gjuhën shqipe dhe angleze, shënime biografike e bibliografike, literaturë dhe fotografi dokumentare.

Punimi i parë e shpjegon kuptimin e besës dhe zanafillën e saj. Autori i kushton një rëndësi të posaçme vlersimit të besës shqiptare te disa autorë të huaj: Baron Nopça, Bajroni, Hekarti, Margaret Hasluk, Edith Durham, Dimitrije Tucoviq, Mark Milani, Fra Lovro Mihaçeviq etj.

Pasojnë punimet mbi besën në funksion të pajtimit të gjaqeve, roli i besës në kohën e luftës, mënyra e lidhjes së besës si dhe shkelja e saj.

Në punimin Besa-faktor i rëndësishëm i moralit shqiptar, autori thekson se besa ka luajtur një ndër rolet më të rëndësishme në besëlidhjen e Lezhës, në Lidhjen e Prizrenit, Lidhjen e Pejës, Besëlidhjen te Verrat e Llukës, në Kuvendin e Junikut etj. Në anën tjetër autori thekson se shqiptari në shumë raste bëhet rob i besës dhe i mikpritjes. Në libër autori analizon pikëpamjet e rilindësve mbi besën, duke theksuar se ata e vlerësuan lart besën si faktor mobilizues në luftën për pavarësi. Autori shtjellon gjerësisht veprat e Pashko Vasës, Sami Frashërit, Shtjefën Gjeçovit, J. De Radës, A. Z. Çajupit, Pal Doçit, Dom Ndoc Nikajt, Asdrenit, Konicës etj. Nga shkrimet e rilindësve rezulton se institucioni i besës në kohën e tyre ishte dobësuar, por kurrësi nuk kishte humbur. Janë interesante punimet mbi rolin e

besës në mbrojtjen e hebrenjve dhe në mbrojtjen e objekteve sakrale, sidomos të kishave ortodokse në Kosovë.

Në libër autori gjithashtu e trajton raportet e besës në jetën bashkëkohore. Ai konstaton se sot besa nuk e ka atë rëndësi që e kishte dikur për arsye të kushteve të reja të jetës. Mirëpo në pajtimin e gjaqeve besa edhe sot ka po atë rëndësi si para disa shekujsh.

Libri përfundon me punimin mbi besën si temë studimesh multidisiplinare, ku trajtohet besa në gjakmarrje, në mbrojtjen kolektive, në etnopsikologjinë e shqiptarit dhe në folklorin shqiptar. Sipas autorit, ndër shqiptarë besa është shprehja më e fuqishme e nderit dhe e burrërisë. Ajo e ka zbutur zakonin e gjakmarrjes dhe është faktori i fuqishëm në luftën çlirimtare kundër të huajve. Në folklorin shqiptar besa zë një vend të posaçëm. Për besën ka shumë të dhëna, gojëdhëna dhe këngë popullore të cilat mbështeten në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ai sjell disa shembuj të besës në poezitë më të njohura popullore që e ilustrojnë karakterin e saj.

Libri duhet të integrohet në planprogramet mbi trashëgiminë kulturore në shkolla fillore, të mesme dhe të larta. Ai duhet të vechet si literaturë bazë në Universitetin e Prishtinës: në Fakultetin Filozofik – Departamenti i Etnologjisë, në Fakultetin Ekonomik-Juridik etj. Ai gjithashtu duhet të prezantohet në Web faqe, për me qenë më afër opinionit më të gjerë publik. Përkthimi i rezimeve të punimeve në gjuhën angleze është i mirëseardhur për të arrijtë lexueshmëri më të madhe të huajt.

Në fund të themi se libri “Besa në traditën shqiptare” është studimi më i plotë për besën i publikuar deri më sot në Kosovë. Si i tillë i shtohet vlera shkencore, kulturore dhe edukative. Autori e trajton besën si një institucion shumë të rëndësishëm të kulturës popullore që i dallon ata nga popujt e tjerë. Prandaj ai e njofton opinionin për specifikat e saj, duke theksuar karakterin pozitiv në të shumtën e rasteve, por edhe karakterin negativ në raste të veçanta. Libri ofron një ndihmesë të madhe në studimin e trashëgimisë sonë dhe do të nxisë studiuesit e rinj për hulumtime të mëtejme dhe të vazhdueshme në këtë fushë.

Takimi im i parë me akademik Mark Krasniqin ka qenë në një ekspeditë etnologjike në Rrafshin e Dukagjinit në vitin 1979. Metodologjia e punës në terren dhe librat e tij kanë qenë frymëzim dhe udhërrëfyes gjatë punës sime 36 vjeçare në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në fund më lejoni të përgëzoj akademikun e nderuar për këtë vepër të vyer që ia dhuroi Kosovës.

KRITIKA DHE RECENSIONE

Dobrica ĆOSIĆ: VREME ZMIJA, botoi Službeni glasnik, Beograd, 2008.

Shkrimeve të akademikut serb Dobrica Qosiq iu shtua një vështrim mbi ngjarjet e vitit 1999, të cilat kanë të bëjnë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkësinë Evropiane e me Jugosllavinë e atyre viteve, në rend të parë me Kosovën dhe shqiptarët. Këtë vështrim autori e ka titulluar “Koha e gjarpërinjve” dhe e ka sistemuar në librin e gjashtë të karakterit të shënimeve ditore. Kjo vepër u strukturua në libër të veçantë nga shënimet kronologjike të luftës së Serbisë kundër atyre që kanë bërë orvatje për shpëtimin e shqiptarëve nga, si thotë ai, “katastrofa humanitare në Kosovë”. Nënkapitulli me mëtesë përgjithësimi është quajtur “Lufta e vogël botërore kundër serbëve”.

Libri i gjashtë ka përmbajtje tematike koherente. Në librin e pestë paraqiten zhvillimet politike e luftarake në Kosovë dhe në Serbi. Dallohet, pos të tjerash, saktësia vëzhguese e kronologjizuar, e përshkruar dhe e shpjeguar në mënyrë karakteristike. Prej përmbajtjes shpërfaqen qëndrimet politike, në rend të parë qëndrimet politike për Kosovën dhe shqiptarët. Shkrimet e viteve të fundit u quajten “roman intelektual i llojit të vet, i ndërtuar nga lënda dokumentare e karakterit të ditarit...” Themelin e këtyre vëzhgimeve e përbën përgjegjësia e autorit për fatin e Serbisë dhe të popullit serb. Besoj se kjo përgjegjësi me fuqi motivuese të jashtëzakonshme jo vetëm që e ka cytur autorin të përcaktojë çfarë të shënojë, por edhe si të angazhohet në zhvillimin e vendit dhe të popullit të vet në faza të ndryshme. Por kjo përgjegjësi ka ndikuar edhe në formimin e qëndrimeve negative, sidomos ndaj shqiptarëve. Shumë prej këtyre qëndrimeve përkojnë drejtpërdrejt me diskriminim, me urrejtje, e disa prej tyre shkojnë deri në shovinizëm.

Megjithë ndërlihdjet përmbajtësore të pesë librave paraprakë, sidomos të librit të pestë, libri i gjashtë ndryshon nga paraprakët në disa pikëpamje. Ngjarjet e vëzhguara, të përshkruara dhe të komentuara në librin e gjashtë i përkasin “pozitës më të rëndë të popullit serb pas Luftës II Botërore”. Sipas autorit, pozitën e këtillë e ka shkaktuar “lufta e vogël botërore kundër serbëve” e shekullit njëzet, kur “janë zhdukur njerëzit e mëdhenj. Demokracia u bë rend i mediokriteteve dhe i manipuluesve... *Fatamorganë* edhe e serbit të ngopur dhe të uritur”. Për këtë shkak, *Vreme zmija* ka më tepër përmbajtje dhe gjuhë politike me fare pak ose aspak shprehje artistike.

Ngjarjet e shënuara kapin kohën prej datës 21 mars, ditës së pranverës së vitit 1999, kur autori e ka vizituar Patrikun Pavle, me të cilin ka zhvilluar bisedime edhe për Kosovën, dhe përfundojnë më 1 janar 2000 – dita e parë e shekullit njëzetënjë dhe, siç e përmbyll ditarin e tij me dëshpërim, “e sigurt është: prapë njerëzve u fillon një kohë e re”.

Subjekti i këtij shkrimi prej 242 faqesh të dendura është i ndërlikuar, por mbi-sundon Kosova dhe çështja shqiptare në raportet serbo-shqiptare të fundviteve të shekullit njëzet. Kjo çështje vlen të studiohet nga profesionistët e disa disiplinave të shkencës, sidomos nga sociologët, historianët, politikologët, psikologët socialë etj., aq më parë kur autori i këtij libri është ndër krijuesit me ndikim politik, siç pohon vetë, “...është shkrimtar i gjuhës

serbe të të gjithë serbëve”, por jo “serb i Serbisë së Milosheviqit” dhe “i distancuar nga Serbia e çetnikëve”. Ka qëndrime relativisht konstante për Kosovën dhe shqiptarët. Qëndrimi për ndarjen e Kosovës është ndër më të përhershmit; këtë qëndrim e ka paralajmëruar në mënyrë karakteristike që prej fundit të majit të vitit 1968, por të formuluar botërisht edhe për botën e jashtme që nga vitit 1981, 1999 dhe të pandryshuar as sot. Qëndrimi për ndarjen e Kosovës u bë porosi për të gjithë, madje edhe për krerët e udhëheqjes ortodokse serbe të Kosovës në ditët më të vështira të luftës. Ndërkaq, publikut të gjerë, madje edhe atij të jashtëm, ky qëndrim së bashku me disa qëndrime të tjera i është bërë i njohur posaçërisht në “Apelin” drejtuar Francës dhe të botuar në gazetën “Figaro” të Parisit më 8 prill 1999.

Vreme zmija, ndonëse ka fakte ditore për pasojat e gjithë asaj që ndodhi me pushtetin e Serbisë dhe me popullin e saj gjatë vitit 1999, ka dhe krijime imagjinative të autorit që janë përpunuar dhe shtruar jo aq për bukuri artistike—letrare, sa për argumentim të asaj që i ndodhi Serbisë dhe popullit serb. Ka edhe qëndrime pozitive.

Qëndrimi i avancuar pozitiv i akademik D. Qosiq, që u përpunua në shkrimet të viteve 1999–2000 dhe u paraqit qartë në veprën që shqyrtohet është ai që ka të bëjë me dhënien e përgjigjes në çështje si: serbët ta vëzhgojnë vetveten dhe të shohin ku kanë gabuar duke bërë faje e krime dhe si t’i gjykojnë fajet e krimet e shqiptarëve, të muslimanëve dhe të kroatëve ndaj serbëve? Meqë qasja e këtillë e shpie në përcaktim të së vërtetës së mirëfilltë dhe, si thotë ai, të “të vërtetës së plotë” për fajin dhe krimin e serbëve ndaj muslimanëve, kroatëve dhe ndaj shqiptarëve, si edhe të tyre ndaj serbëve, kjo vepër ka dimension të rëndësishëm shkencor. E pohojmë këtë, sepse në mënyrë të kujdesshme metodike ka mbledhur fakte për atë që pësoi Serbia dhe populli serb dhe qëndrimet e tij për situatën e krijuar dhe për pasojat e rënda, të cilat i paraqiti në një sistem mendimesh sa koherent aq edhe kontradiktor. Në kuadrin e këtij sistemi dallohet orvatja për të kërkuar dhe përcaktuar fajin dhe krimin e popullit të vet ndaj kroatëve, muslimanëve dhe shqiptarëve.

Autori këtë e bëri më tepër për të kuptuar lexuesit e tij raportet e fajësisë së njëmendtë ndërmjet sulmuesit dhe të sulmuarve, përkatësisht ndërmjet serbëve - makinerisë ushtarake, policore e paramilitare - dhe kroatëve, muslimanëve e shqiptarëve dhe njërive e njësive të organizuara ushtarake e policore të tyre. Natyrisht, faktet janë paraqitur herë më shumë e herë më pak të ndërruara nga ideologjia dhe historia politike, por angazhimi për identifikim të së vërtetës së plotë është vlerë intelektuale për respekt.

Kosova, lufta dhe faji e krimi

Në hulumtim të mendimeve dhe të qëndrimeve të përmbajtjes së cilësdo vepër zbatohet metoda e analizës së përmbajtjes, ku vend të posaçëm kanë pyetjet: 1. Cilat janë qëndrimet e përpunuara nga autori, përkatësisht me çfarë kanë të bëjnë këto qëndrime?; 2. Kujt i adresohen ato?; 3. Cilat janë porositë e shprehura në këtë libër?

Lidhur me këto pyetje, kërkimi i përgjigjeve shpie në kërkim të njohjes së kuptimit të titullit *Vreme zmija*. Pas leximit të disa faqeve kuptova se shkaku që autori e ka emërtuar këtë libër me titullin e lartpërmendur është se në Nish dhe në malin Rtanj, por edhe në Kosovë, gjarpërinjtë e trembur nga bombardimet e NATO-s kanë dalë nga skutat e tyre dhe janë shpërndarë nëpër rrugët e parqet e qyteteve dhe në fshatra duke hyrë edhe në shtëpi të

qytetarëve dhe të fshatarëve. Në këtë situatë, problemi më i madh paska qenë sa mbrojtja nga bombardimet, aq edhe mbrojtja nga gjarpërinjtë. Shkak tjetër është se fjala “Taçi” – mbiemri i udhëheqësit shqiptar të UÇK-së - në serbishten kolokuale paska domethënien “gjarpër”. Pavarësisht nga vërtetësia e pohimeve të këtilla, është pak e besueshme që një ushtri, siç ishte ajo serbe, që shfrytëzoi armatimin modern të ish-Armatës Popullore të Jugosllavisë, dhe mbrojtja civile e organizuar sipas kërkesave mbrojtëse të fundshekullit njëzet, paska pasur kaq shumë probleme me gjarpërinj sa edhe këta të konsiderohen armiq të njëjtë të Serbisë dhe të popullit serb me ata të NATO-s dhe të UÇK-së.

Për njohësin e psikologjisë së K. Jungut, gjarpri mund të trajtohet simbol arketipor, konstrukt i pavetëdjshëm i rrezikut për jetën psikike të njeriut, që ka karakter dinamik në pavetëdijen individuale dhe kolektive të individëve të mjedisit social të caktuar. Në mitologjinë shqiptare ka dhe kuptimin e fuqisë mbrojtëse të pragut dhe nderit të shtëpisë e të familjes. Por këtu nuk është fjala për trajtim mitologjik të gjarprit. Megjithatë duhet përmendur se ligjërimi i kohës së gjarpërinjve ka të bëjë më tepër me simbolin e arketipit “gjarpër” – simbol i bishës së rrezikshme, që shkakton frikë e trishtim. Vetëm gjarpri ka gjuhë helmuese dhe sistem organesh tretëse që e helmojnë dhe e gëlltitin bishën më të madhe se goja e organet tretëse të tij. Ky emërtim ka raport domethënës me disa shprehje të tjera, nga të cilat dallohen: “Në vargun e absurdeve historike me të cilët përmbyllet shekulli 20 edhe një absurd amerikano-ballkanik: shteti më demokratik në botë e merr për aleat kryesor në zotërim të Ballkanit dhe në shkatërrimin e Serbisë – Arnautllukun më primitiv, etnosin fisnor, egërsinor dhe gjakpirës, ku njëzet e gjashtë mijë veta presin vrasjen për hakmarrje gjaku. Kjo fundrrinë shoqërore, politike e morale e Ballkanit tribal e barbar merr për aleatë Amerikën dhe Unionin Evropian në luftë kundër popullit më demokratik, më të civilizuar, më të qytetëruar dhe më të arsimuar të Ballkanit – popullin serb”!

Shprehje të ngjashme janë përdorur nga autori edhe në veprat e mëherëshme për Kosovën dhe shqiptarët, por në këtë libër shënimesh ditore këto shprehje janë me “bollëk” dhe të plotësuara shpesh me afsh urrejtës.

Me këto relacione mendimesh dhe shprehjesh akademiku D. Qosiq u është bashkuar në mënyrën e vet dhe në kohën civilizuese të shekullit njëzetënjë disa qëndrimeve të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (SANU) për shqiptarët dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare, ku me shkrimet e tyre janë dalluar: akademik V. Gjorgjeviq në vitin 1913, akademik J. Cvijiq më 1918, akademik V. Çubrilloviq më 1937 e 1944, akademik D. Bogdanoviq më 1985, akademik M. Garashanin më 1988 dhe akademik Kosta Mijailloviq më 2006, i cili shqiptarët i quajti “...shoqëri fisnore në masë të madhe me orientim të pronalitetit islam”. Akademik V. Gjorgjeviq i ka konsideruar shqiptarët me shkallë parahistorike të zhvillimit kulturor, kurse akademik D. Qosiq në fillim të shekullit njëzetënjë u atribuon atyre dhe krijimit të shtetit ballkanik më të pacivilizuar dhe më vital në Ballkan, cilësinë e *place d’arme* të fundamentalizmit islam. Cili është kuptimi kaq negativ i këtij kontinuiteti të mendimit dhe të qëndrimeve të akademikëve serbë më të njohur për shqiptarët dhe për Kosovën? Mendoj se këtu nuk është fjala për mendime dhe qëndrime sa për paragjykime, ose së paku për qëndrime negative të ngarkuara me elemente paragjykimesh, nga të cilat vështirë po arrijnë të lirohen edhe akademikët e kohës më të re të një institucioni me reno-

me shkencore në Serbi. Qëndrimet e këtilla, gjithësesi, nuk i bëjnë nder popullit serb dhe vlerave njerëzore e kombëtare të tij. Sa më parë të zbërthehen e të kuptohen këto qëndrime, përkatësisht sa më shpejt të vetëdijësohemi për këtë, tashmë sistem qëndrimesh dhe për rolin negativ të tyre në zhvillimin e përgjithshëm dhe në atë të mendimit objektiv, aq më shpejt do të hapet horizonti i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shqiptarëve e serbëve, sidomos kur është fjala për çështjen e Kosovës. Mendimi akademik qoftë për “arnautët”, qoftë për “shkijet” duhet të qërohet tërësisht nga qëndrimet negative me ngarkesa paragjyimesh.

Dialogu ndërakademik duhet të luajë rolin e një “filtri” mendor të arsyeshëm për këto çështje. Këtë duhet bërë aq më parë kur mendimi akademik për Kosovën dhe për shqiptarët ndryshon diametralisht nga mendimi akademik i shqiptarëve; për mendimin akademik më 1912 serbët e çliruan Kosovën, siç pohon autori në faqen 169, kurse për mendimin akademik shqiptar serbët pikërisht në këtë vit e okupuan Kosovën, etj.

Në veprën më të re të akademik D. Qosiq është përpunuar edhe një qëndrim i posaçëm, i cili tregon se ndërmjet përmbytjes së qëndrimeve të kësaj vepre për Kosovën dhe për shqiptarët dhe qëndrimeve të mëhershme të tij dhe të disa akademikëve të tjerë ka disa dallime. Ndër këto, si përmendëm më lart, dallohet qëndrimi i parapëlqyer i akademik D. Qosiq, kur thotë: “Ne sot jemi të detyruar të flasim të vërtetën e tërësishme për luftërat me kroatët, me myslimanët dhe me shqiptarët. Duhet t’i pranojmë fajet e krimet tona dhe t’i gjykojmë ato të tyre...”. Qëndrimin e këtillë e mbështet në disa fakte, nga të cilat dallojmë këtë: “Ushtria dhe policia jonë i ka dëbuar të gjithë shqiptarët nga Peja dhe Deçani; pjesa shqiptare e qytetit përtej Bistricës është djegur dhe është shkatërruar...nga Kosova vërtet nga ushtria, policia dhe nga vullnetarët janë dëbuar dhe kanë ikur shumica e shqiptarëve. Shumica prej tyre ka ngelur në Prishtinë. Nuk i kuptoj dëbimet e këtilla të shqiptarëve; vendimin e këtillë e konsideroj të çmendur, fatal, antiserb. Nëse ky është vërtet urdhër i Komandës Supreme dhe komandantit suprem, atëherë këta duhet dënuar në Beograd për krime lufte dhe për gjenocid ndaj shqiptarëve. A me spastrime etnike të Kosovës e Metohisë do ta përfundojmë luftën për mbrojtje të “tokës së shenjtë serbe”?! Këtë e kërkon, siç thotë ai, në faqen 227, “Ne duhet t’i pranojmë krimet tona vetëm për shkak të shëndetit tonë shpirtëror dhe moral”, sepse “Ne si komb nuk mund të shërohemi, nëse nuk flasim me ndërgjegje mbi dhunën dhe krimet që kemi bërë në Luftën e Dytë Botërore, në luftën qytetare, gjatë titoizmit, gjatë regjimit të Milosheviqit, luftërave me kroatët, me myslimanët, me shqiptarët. Nëse të gjithë heshtim, të gjithë jemi fajtorë. Krimi bëhet dukuri normale. I nënshtrohemi indiferencës dhe nihilizmit. I nënshtrohemi vdekjes morale”. Ky qëndrim i autorit buron nga përcaktimi i një tipi të katakterit të popullit serb, sipas të cilit: “serbët nuk janë të përgatitur për vetëgjykim dhe falje. Ata janë të vetëbindur, adhures, lakmues të famës. Të papërgatitur për falje dhe vetëkritikë, këto i konsiderojnë inferiore, zbulime të dobësive, të pakujdesive të tyre”. Megjithatë, autori ka pohuar: “Vështirësitë, të thuash të pakapërcyeshme të gjurmëve serbe për fajet e veta gjenden në qenien historike e morale të armiqve tanë: të kroatëve, të myslimanëve, të hungarezëve, sidomos të shqiptarëve, të cilët janë të përshkuar me urrejtje reziduale dhe nuk tregojnë shenja të vetëkritikës”.

Qëndrimi për pranimin e fajit dhe të krimit nga ana e tij është një qëndrim i guximshëm, të cilin e kanë thënë kohë më parë disa nga mendimtarët akademikë serbë, siç kanë qenë disa nga socialdemokratët serbë, si D. Tucović nga gjysma e parë e shekullit njëzet dhe V. Dedijer, M. Minić, etj. në gjysmën e dytë të këtij shekulli.

Nevoja vetëvëzhguese për faj dhe krime

Shkathësia mendore dhe përsosmëria shprehëse e mendimeve të D. Qosiqit në veprën *Vreme zmija* kërkon shqyrtim të posaçëm, sepse në shkrimet e tij të mëparshme ka bërë pak fjalë për fajin dhe krimet e popullit të tij, të popullit serb, kurse në këtë vepër nuk ka bërë fjalë vetëm për dëbimet dhe krimet e shqiptarëve, të kroatëve, të myslimanëve etj. ndaj serbëve, por, siç përmendëm, është angazhuar mendërisht të gjejë fajin dhe krimet e serbëve ndaj kroatëve, myslimanëve, shqiptarëve, etj. Duke konsideruar veten “serb pikërisht të kësaj Serbie të mundur (të vitit 1999 - P. N.), të koritur dhe të rënuar” gjithsesi për herë të parë konsideron se “Fajet e Serbisë janë faje të mia”. Për këtë shkak angazhohet t’i identifikojë mëkatet, fajet dhe krimet serbe ndaj të tjerëve. Me këtë qëndrim tregohet vërtet mendimtar i kërkimit të së vërtetës për popullin serb dhe vendin e tij, për të cilin, siç pohon: “...që nga kohët e hershme i ka përvetësuar viktimat (e Serbisë - P. N.), trimërinë, heroizmin, vlerat dhe virtytet e tij. Por edhe tërë krijimtarinë e tij”.

Me këtë kërkesë krijimtarisë së tij i ka atribuar një dimension që mendoj se i ka munguar; ky është dimension i drejtimit të ndryshuar të mendimit të një krijuesi, i cili në shkrimet e mëhershme, por edhe në përmbajtje të këtij libri, ngeli i prirë për të dalluar dhe shkruar më tepër për të tjerët, madje edhe me shprehje përmbajtjesh të rënda; më poshtë i rendisim disa sosh: “cinizmi arnaut”, “pastrimi etnik i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit (Metohisë) nga shqiptarët, të cilët po i dëbojnë serbët”, për “shfarosje të serbëve nga shqiptarët”, për “pushtim të tokës së shenjtë serbe nga shqiptarët”, “fitore e madhe e shqiptarëve me krijimin e Shqipërisë së Madhe”, “...krijimi i shtetit ballkanik më të pacivilizuar dhe më vital në Ballkan, i cili do të jetë *place d’armes* i fundamentalizmit islam...”, etj. Pavarësisht nga këto nënçmime, fyerje dhe denigrime të rënda dhe të padenja për mendimin akademik, është për t’u respektuar nevoja e identifikuar nga ana e tij, si dhe guximi për të dalluar të metat, fajet dhe krimin e popullit të vet, përbërës të të cilit e konsideron edhe veten në ngjarjet e mëdha të vitit 1999.

Në shkrimet e shqiptarëve rrallëkush ka marrë guxim intelektual të këtillë. Më të prirur jemi për vetëvëzhgim të sjelljeve pozitive dhe sjelljeve të të tjerëve sesa të gjendjeve dhe të sjelljeve tona negative. Por ka mendimtarë, të cilët i kanë trajtuar disa nga këto të meta dhe sjellje negative. Gjergj Fishta, Faik Konica dhe disa nga disidentët mendimtarë të kohës më të re kanë folur për disa të meta të shqiptarëve. Hulumtime empirike dhe teorike nga etika, psikologjia, antropologjia kulturore etj. gati nuk kemi. Kodi etik i Lekë Dukagjinit është diç tjetër, por edhe dëshmi e fuqishme se shqiptarët mund t’i vëzhgojnë sjelljet e tyre, t’i trajtojnë në mënyrë meritore, madje sjelljet dëmprurëse t’i urrejnë dhe t’i dënojnë në mënyrë drastike me dënime të para rrallë në mjediset e të tjerëve. Mirëpo ky kod i përket së kaluarës. Megjithatë, ne sot ndaj së vërtetës për gabimet, fajet dhe për krimet kemi ngelur në nivel të dijenive të pamjaftueshme dhe jo sa duhet të vetëdijshëm për to dhe për

efektin negativ të tyre për veten tonë dhe për marrëdhëniet me të tjerët, në rend të parë me fqinjët tanë.

Autori i veprës *Vreme zmija* jo me andje i është qasur njohjes dhe identifikimit të karakterit të serbëve dhe tipareve të përgjithshme të tij. Megjithëkëtë, i ka hyrë kësaj pune. Për njohjen e mendimit, për karakterin e tiparet e përgjithshme të karakterit të popullit serb i referohet shkrimtarit të madh rus Aleksandër I. Solzhenicin, por jo përmbajtjes së veprës *Karakterologjia Jugoslavena – Karakterologjia e jugosllavëve* të dr. Vladimir Dvornikoviçit, të botuar më 1939 dhe as që e përmend mbisundimin e tipit dinarik. Për të metat dhe tiparet negative të karakterit të qytetarit amerikan i referohet veprës së Herbert Markuzesë “Njeriu njëdimensional”, kurse për studimin e fajit dhe të krimit, shkrimeve të studiuesit të etikës dhe humanistit, filozofit, psikologut dhe psikiatrit të njohur gjerman Karl Jaspers.

Faji e krimi “gjerman” dhe faji e krimi “serb”

Karl Jaspers (1883 – 1969) është marrë me gjurmim dhe përcaktim të përgjegjësisë së gjermanëve gjatë rrjedhave historike të Gjermanisë së A. Hitlerit dhe pasojave të luftës së Gjermanisë naziste në veprat e tij, sidomos në veprat filozofike-psikologjike si *Allgemeine Psychopathologie – Psikopatologjia e përgjithshme, Psychologie der Weltanschauungen - Psikologjia e botëkuptimit, Vernunft und Existenzstans – Arsyea dhe ekzistenca*, etj. Por vepra më e rëndësishme për qasjen gjurmuese të D. Qosiq është vepra e K. Jaspersit *Çështja e fajit*. Në përmbajtjen e kësaj vepre akademik D. Qosiq e ka mbështetur nevojën dhe mënyrën e kërkimit dhe të identifikimit të fajit vetjak në sistemin e qëndrimeve të tij ndaj të tjerëve – ndaj kroatëve, myslimanëve dhe ndaj shqiptarëve. Për D. Qosiqin duket se edhe më e rëndësishme për qasjen e tij mendore ndaj hulumtimit të sjelljeve të popullit të vet është letra e K. Jaspersit dërguar studentes së tij, me të cilën ka polemizuar. Ka gjasë se pikërisht këtë letër D. Qosiqi e ka marrë model të krahasimit të përjetimeve të K. Jaspersit më 1946 për humbje të gjermanëve në Luftën II Botërore dhe të përjetimeve të D. Qosiqit për humbje të serbëve në luftë për Kosovën e vitit 1999, e cila, sipas tij, “ende nuk ka përfunduar”.

Njohja e rezultateve të këtij krahasimi ka rëndësi për të gjithë; ka rëndësi edhe për shqiptarët, sepse mendimi akademik serb ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e raporteve serbo-shqiptare. Të kujtojmë *Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave* të vitit 1986 dhe domethënien e tij për “albanizim” të tokës së shenjtë, të djepit dhe të vatrës së kulturës serbe etj. dhe mesazhin që doli nga përmbajtja e tij në kohën e konceptimit dhe të realizimit të politikës së S. Milosheviqit. Në këtë kohë akademik D. Qosiqi ka qenë kryetar i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve.

Më poshtë japim disa vëzhgime nga krahasimi i përjetimeve të këtyre dy mendimtarëve sojesh, etnish, kohësh, ideologjish të ndryshme, por të njësuar në përjetimet pas humbjes së luftërave të tyre: K. Jaspers pas debaklit të Gjermanisë në Luftën II Botërore dhe Qosiqit pas debaklit të Serbisë, siç thotë ai, nga “Lufta e vogël botërore kundër Serbisë”!

Sipas D. Qosiqit “Tokat serbe në Bosnjë dhe në Kosovë janë të okupuara, kurse Gjermania ka qenë agresore e drejtuar në okupim të tokave të huaja. Luftën me kroatë, me

myslimanë dhe me shqiptarë e kanë shkaktuar ata e jo serbët, kurse shkaktarë të Luftës II Botërore ishin gjermanët”.

“Ne (serbët - P. N.) si komb gjendemi në provë; rishqyrtimi i vetvetes... së pari duhet të bisedojmë me vetveten dhe të pasqyrohemi vërtetësisht. Dhe kështu të vetëvetëdijshëm të hyjmë në dialog me botën”.

D. Qosiq ndjek jo vetëm rrugën mendore të K. Jaspersit, por edhe mbështet disa qëndrimeve të tij. Këtë e dallojmë në pohimin sipas të cilit K. Jaspers ka thënë: “Pa përjashtim, të gjithë ne gjermanët kemi obligim që në mënyrë të qartë t’i vështrojmë fajet tona dhe të nxjerrim përfundime. Për këtë na obligon dinjiteti njerëzor... Përgjigja përbën themelin e vetëdijes sonë mbi qenësinë dhe vetëdijen tonë... Vetëm në shqyrtimin e çështjes së fajit mund të arrihet kthesa, e cila na shpie te lindja e përsëritur nga vetë burimi i qenies sonë”. D. Qosiq, duke iu referuar këtij pohimi, burimin e zhvillimit të qenësisë së popullit serb e sheh në fajin e popullit serb, sidomos në udhëheqjen e lartë të shtetit. Këtë e dallojmë në pohimin: “serbët janë më shumë fajtorë ndaj vetes... Esenca e çështjes serbe nuk është faji, por skuthëria (hipokrizia - P. N.), e cila ka qenë amëz edhe e krimin që e kemi bërë”. Rrjedhimisht, lidhur me këtë D. Qosiq përfundon: “ne nuk mund të arrijmë deri në vetëvetëdije të shëndoshë dhe racionale kombëtare derisa të mos i vështrojmë racionalisht skuthëritë tona... fajet tona kanë dalë nga skuthëritë tona... Për këtë ndriçim është i domosdoshëm historizmi”.

Historizmi, siç është e njohur, është metodë hulumtuese edhe e gjenezës, e zhvillimit dhe e formimit të vetëdijes kombëtare. Mirëpo vetëm historizmi i zbatuar në rrafshin e këtij hulumtimi ka të meta, për të cilat është folur në historinë e zhvillimit të mendimit njerëzor, sidomos nga disa mendimtarë të njohur, ndër të cilët dallohet Karl Popper.

Qasjes historike të kombit serb dhe të vetëdijes kombëtare autori i ka kushtuar kujdes të veçantë. Këtë e dallojmë në pohimin e tij: “Ne nuk mund të bëhemi komb i mirëfilltë historik derisa të mos flasim drejtpërdrejt, të paideologjizuar, të paanshëm për çdo veprimtari dhe joveprimtari në ngjarjet historike, posaçërisht në Luftën e Dytë Botërore dhe pastaj deri në ditët tona. Çështjet e fajit serb janë shumë, shumë të ndërlikuara dhe me rrënjë të thella në të kaluarën”.

Historizmi tashmë dihet, kërkon që proceset, raportet, sociale, ekonomike, politike etj. të vështrohen si diç që nuk është e dhënë një herë e përgjithmonë. Historizmi në trajtimin e Kosovës dhe të shqiptarëve nga ana e disa mendimtarëve serbë të fundshekullit njëzet kërkon marrje në shqyrtim serioz të individualitetit gjeografik, historik, kombëtar e politik të Kosovës, të kompaktësisë demografike dhe të ndryshimeve shumë a pak të madhe të saj. Madje historizmi kërkon sqarime për identifikim dhe vlerësim të rëndësisë së Kosovës për popullin serb njësoj sikur që vlerësohet rëndësia e Jeruzalemit për popullin hebraik. Cili është argumentimi arkeologjik, etnologjik, historik, sociologjik dhe psikologjik i këtij pohimi? Çfarë është raporti ndërmjet kësaj pikëpamjeje për Kosovën dhe zhvillimeve politike, ekonomike e sociale të Kosovës dhe rajonit të gjerë në mendimet bashkëkohore integruese dhe humaniste? Ku fillon dhe ku përfundon arsyeja për pozicion historik të rëndësisë së Kosovës për Serbi si vlerë e ngjashme me rëndësinë e Jeruzalemit për Izraelin?, etj. Këto janë vetëm disa nga çështjet që kërkojnë shpjegim të gjerë të së kaluarës

së Kosovës dhe të shqiptarëve të saj në relacion me njësinë e përbashkët kombëtare, historike, gjeografike, ekonomike e kulturore të tyre dhe, sot dhe nesër.

Për K. Jaspersin “aty ku fuqia nuk e kufizon vetveten lind dhuna dhe terrori dhe, në fund të fundit, shfarosja e qenësisë dhe e shpirtit njerëzor”. Ky pohim i saktë i duket i paktë akademik D. Qosiq dhe, me të drejtë, përmend edhe faktorë të tjerë të shfarosjes së qenësisë dhe të shpirtit njerëzor, duke i lidhur këta faktorë me nevojën e shqyrtimit të fajit dhe të krimit të popullit serb. Në kuadrin e këtij relacioni ai ka pohuar me të drejtë se “Gjermanët e kanë pasur Jaspersin; ne (fjala është për serbët - P. N.) nuk kemi Jaspersa”. Në kërkim të qasjes jaspersiane të fajit dhe krimit ndër mendimtarë të afërt ka hasur në mendimet e shkrimtarit të madh kroat M. Kërlezha, tek i cili nuk gjen qasje të këtillë për popullin e tij kroat dhe parashton pyetjen: “përse ai nuk ka shkruar për fajin e kroatëve”. Në gjurmim të këtyre relacioneve D. Qosiq i ka atribuuar faj të mundur Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, sepse nuk e ka konceptuar memorandumin e ri: “A ekziston faji serb dhe me çfarë ka të bëjë”?

Akademik D. Qosiq ka shkruar: “Në qoftë se vërtetohet se serbët kanë bërë krime për të cilat akuzohen dhe për të cilat flitet në Krushevc, botërisht do t’i dënojë kriminelët serbë. Kurrfarë patriotizmi nuk do të më detyrojë të hesht”. Lidhur me këtë pohim dhe për të arritur në realizimin e qëllimit të tij, akademik D. Qosiq, është pritur t’i marrë në shqyrtim disa nga të dhënat dhe faktet tashmë të njohura të fajit dhe të krimit të paramilitarëve në rend të parë, por edhe të policisë dhe të ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në kohën e rëndë të vitit 1999 aq më parë kur shqiptarët e Kosovës të kësaj kohe u detyruan të vihen në mbrojtje të substancës kombëtare të tyre.

Substanca e fajit dhe e krimit serb në vitin 1999

Sipas autorit “Serbia duhet t’i mobilizojë të gjitha forcat mendore, morale dhe fizike për t’i mundur armiqtë e shumtë...” dhe për t’i siguruar ekzistencë dhe zhvillim popullit më demokrat, më të civilizuar dhe më të ndritur të Ballkanit! Çfarë është pritur të gjejë vend në shënimet ditore të paraqitura në librin *Vreme zmija*? Është pritur të gjejnë vend faji e krimi për ndërmarrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjeve ekonomike dhe institucioneve të arsimit, të shëndetësisë, të kulturës, të shkencës dhe të informimit publik për shqiptarët e Kosovës. Sipas këtyre masave u mbyllën shkollat shqipe të të gjitha niveleve e tipave, institucionet kulturore, mediat shqipe, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Biblioteka Popullore e Universitare e Kosovës, Arkivi i Kosovës, etj. Mbyllja e këtyre institucioneve u bë me kërbaç policor ndaj mësuesve, arsimtarëve, profesorëve, akademikëve, ndaj invalidëve, grave shtatzënë, ndaj pleqve e plakave. Nuk përmenden as djegia dhe asgjësimi i burimeve historike dhe kulturore të shqiptarëve, ndër të cilat tashmë dihen: rrënimi dhe asgjësimi i Kompleksit Monumental të Lidhjes së Prizrenit, djegia e Çarshisë së Madhe në Gjakovë, ndryshimi i përmbajtjes së teksteve enciklopedike për zërin “Shqiptarët” dhe “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave” në Enciklopedi të Jugosllavisë të botuara dy herë brenda kohës prej vitit 1980 deri në vitin 1984. Kuptoni, katër vjet pas botimit të përmbajtjes së verifikuar nga dhjetë redaksitë e atëhershme dhe nga Redaksia Qendrore nën udhëheqjen e Drejtorit të Entit Leksikografik Jugosllav Miroslav

Kërlezhës, përmbajtja pëson ndryshime! Në këto ndryshime u shortua përmbajtja e historisë kombëtare të shqiptarëve dhe e vendit të tyre brenda katër vjetësh jo të plota. Po realizoheshin masat për rrënimin e kulturës, të traditës, të trashëgimisë, të historisë, të sistemit të vlerave dhe të tërë qenies kombëtare të popullit shqiptar. A mund t'i detyrojë shqiptarët politika diskriminuese e kohës, policia e ushtria e asaj politike, mendimi enciklopedik me variacione të gatshme për ndryshime dhe plotësime sipas kërkesave të politikës ditore, që këta të heqin dorë nga qenësia, nga vetja dhe nga historia kombëtare? Si mund ta mohojnë shqiptarët vetveten, qenësinë dhe historinë e zhvillimit kulturor sipas kërkesave politike të kohës së N. Garashaninit, të Karagjorgjeviqëve, të N. Pashiqit, të M. Nediqit, të A. Rankoviqit, të M. Nikezicit, të M. Markoviqit, të S. Milosheviqit? A mund të ndryshojë identiteti i një populli sipas sundesve të tij?

Krahas këtyre ndryshimeve enciklopedike për shqiptarët dhe për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, asgjësimeve të monumenteve të historisë dhe të kulturës etj., mjetet e informacionit publik, sidomos ekranet televizive të kompanive më të njohura informative kanë emetuar dëbimin e rreth tetëqind mijë qytetarëve shqiptarë nga vendi i të parëve të tyre dhe shqyerjen dhe asgjësimin e dokumentacionit personal të një numri të madh të tyre për të mos pasur të drejtë kthimi në vendin e vet, vrasjen e afër njëmbëdhjetë mijë vetave, zhdukjen e gjurmëve të krimit të 5.236 qytetarëve të zhdukur, nga të cilët ende nuk dihet fati i 1.918 qytetarëve, masakrat ndaj qytetarëve, fëmijëve, plakave e pleqve të Poklekut, të Krushës së Vogël, të Mehës, të Reçakut, të Skënderajt, të Suha Rekës, zhdukjen e familjeve të tëra në Drenicë, në Gjakovë, në Suha Rekë, etj. (familjet Jashari, Çerkezi, Delija, Berisha, Muçolli. etj.), rrënimin, djegien dhe asgjësimin e rreth 120.000 shtëpive, dyqaneve, magazinave, stallave të bagëtive, si edhe zhdukjen e shumë qytetarëve serbë pas 10 qershorit 1999, etj. Dëshpërimin e madh, vuajtjet shpirtërore, depresionin e familjarëve të të zhdukurve dhe relacionin e shpresës së tyre ndaj mbetjeve mortore të pagjetura, ndoshta edhe të djegura, ndoshta vetëm instanca metafizike është në gjendje ta kuptojë dhe ta gjykojë. Por këto nuk kanë gjetur vend dhe as skutën më të vogël në “Kohën e gjarpërinjve” të akademik D. Qosiqit. Çfarë të thuhet për fotografitë e zbuluara të krimit ndaj të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës? Përse nuk ka koment nga gjykimi i 143 të pandehurve në gjykatën e Nishit, kur këta u dënuan në mënyrë serike me një milenium e gjashtë shekuj e gjysmë burgim? Përse nuk i zë as me pak fjalë vrasjet - emrat e 6.318 shqiptarëve dhe të 423 serbëve e malazezëve të vrarë të botuar në Buletin të KMDLNJ nr. 11-12, mars – shtator 1999, që është botuar edhe në gjuhën serbe? Këto janë informacione tashmë të ditura dhe të vërtetuara dhe këto duan konsideruar vetëm fakte për të cilat duhet menduar e shkruar, por jo si fakte fluere për hakmarje. Kurrësi. Ndonëse ka edhe të tjera që kurrë nuk do të dihen. Çfarë të thuhet për argumentimin shkencor të hipotezës në veprën studimore “Rat u brojkama” (“Lufta në numra”), ku thuhet: “Argumentet statistikore e vërtetojnë hipotezën, sipas së cilës, forcat jugosllave kanë zbatuar fushatë sistematike të vrasjeve dhe të dëbimeve”.¹ Për këto “Evropa duhet të turpëropohet”, ka shkruar Johann Georg Stadtmüller në të përditëshmen “Frankfurter Allgemeine Zeitung” të 29 korrikut 1991, përkatësisht 8 vjet para se të shfaqeshim gjarpërnjtë në disa fshatra dhe qytete të trembur

¹ **Rat u brojkama**, Ewa Tabeare, Beograd, 2009, f. 1086.

nga gjëmimi i bombardimeve të NATO-s. Por në fundvitin e shekullit njëzet Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk u turpëruan si ngjau më 1913, kur Leo Frojndli (Leo Freundlich) botoi veprën “Albanians Golgotha”, ku, ndër të tjera, është shkruar: “Me dhjetra e mijëra burra të paarmatosur ishin masakruar; gratë ishin dhunuar, pleqtë dhe fëmijët ishin ngulfatur me zënie të frymës. Qindra fshatra ishin djegur, kurse Evropa akoma heshte”.

Këto fakte janë nxjerrë nga përvoja ose janë rezultat i përpunimit të tyre. Këto kanë për qëllim të nxisin mendimin për burimin e tyre të saktë si dhe të lëkundin sadopak paragjykimet dhe të mos i përkufizojmë në çështje personale, por të mbeten mjete mendore të përligjura dhe të pazëvendësueshme për studime shkencore.

Vepra *Vreme zmi*ja u botua më 2008, kur u zbuluan shumë krime dhe disa nga ata që i shkaktuan morën dënimin në Tribunalin e Hagës, kurse të tjerët presin të dënohen. Heshtja e këtyre krimeve nuk përkon me orvatjen e zbulimit të së vërtetës së plotë për Kosovën, por “as me bilancin moral (të autorit - P. N.) për të shkruar tërë të vërtetën për Kosovën”.

Qëndrimi i përgjithshëm i D. Qosiqit ndaj Kosovës është “ndarja e Kosovës” në bazë të kompromisit dhe të së drejtës historike dhe etnike. Këtë qëndrim e ka paralajmëruar qysh më 29 maj 1968 dhe nuk e ka ndryshuar as sot.

Në këtë vazhdë të qëndrimit kategorik për Kosovën dhe ndarjen e saj ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve sipas parimit historik dhe etnik akademik D. Qosiqi ka kërkuar që “të përvetësohet propozimi i tij për ndarjen e Kosovës dhe krijimin e shteteve të vocërra etnike dhe fetare; të këtilla ekzistojnë në Evropë –Andora, Lihtenshtajni...”.

Krimet, sipas skemës së koncepteve të krimeve të K. Jaspersit, i përkasin përgjegjësisë penale - instancë e të cilit është gjyqi, përgjegjësisë politike të shumicës (dy herë zgjidhet S. Milosheviqi president me shumicë votash), përgjegjësisë morale (nga shumë qytetarë serbë krimi është heshtur, është fshehur, përkrahur e ndihmuar) dhe përgjegjësisë metafizike – Zoti e di për të. Mendoj se “krimi” më i rëndë i luftës së vitit 1999 është humbja e besimit ndaj njëri-tjetrit. Cila instancë shoqërore a shtetërore do ta gjykojë këtë? Për këto shkaqe mendoj se akademik D. Qosiq ka të drejtë të kërkojë vetëvetëdijësimin e popullit serb dhe të vetëvetëdijësuar të fillojnë komunikimin me të tjerët. Këtë duhet ta bëjnë edhe shqiptarët. Kështu, të përgatitur serbët dhe shqiptarët, por edhe të tjerët, mund të gjejnë atë që asnjë luftë nuk e ka asgjësuar plotësisht - pajtimin dhe paqësimin. Por pajtimi dhe paqësimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve sot do të jetë gati i pamundur me ngarkesa qëndrimesh vetëm negative të shqiptarëve ndaj serbëve dhe të serbëve ndaj shqiptarëve, sidomos me ngarkesa paragjykimesh, duke sakrifikuar interesat kombëtare “për hir të globalizmit” dhe duke mos koordinuar mendimet dhe veprimet e përbashkëta me proceset zhvillimore ndërkombëtare.

Heshtja dhe “harresa” e fajeve dhe e krimeve nuk e arsyetojnë përgjegjësinë e mendimit dhe të sjelljeve akademike. Por heshtja e fajit dhe e krimeve ka edhe një pasojë tjetër: kjo trystohet, madje mund ta kalojë prapin e vetëdijes dhe të hyjë në mbretërinë e pavetëdijes ku mbisundon “parimi i kënaqësisë” dhe ku energjia e saj herë-herë orvatet të dalë në sferën e përmbytjes së vetëdijes, por kjo për shkaqe të ndryshme bën trysni mbi të. Të kër-

kojmë dhe të gjejmë energji psikike për të mos ngritur krye energjia e gjallë e fajit dhe e krimit kundër njerëzimit.

Më e ngushta e jetës është rruga e së vërtetës

A mund të gjendet rruga që na shpie për përcaktimin e së vërtetës për shqiptarët e Kosovës dhe për marrëdhëniet shqiptaro-serbe? Gjithsesi mund të gjendet, por duhet gjurmuar faktet dhe vlerësimet e argumentuara pa paragjykime, pa kurrfarë ngarkesash e super vlerash e vesesh të askujt dhe pa tensione emocionale. Sikur të postuloheshin të dhënat, faktet dhe vlerësimet nga burimet e sakta gjithsesi epilogu i vështirimit të autorit të librit *Vreme zmija* i vënë në fillim të librit do të ishte tjetër nga kjo që porositet nipi i i tij dhe gjenerata e tij.

Një rrugë mendore e arritjes së të vërtetës për shqiptarët dhe Kosovën do të ishte krahasimi i pikëpamjeve dhe i qëndrimeve të të pakrahueshmëve përbrenda Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve si, bie fjala, ndërmjet pikëpamjeve dhe qëndrimeve të akademik Vasa Çubrilloviqit dhe akademik Vladimir Dedijerit. Madje krahasimi ndërmjet pikëpamjeve dhe qëndrimeve shkencore të historianëve akademikë Bogdan Bogdanoviq – Kristo Frashëri ose krahasimi i pikëpamjeve dhe qëndrimeve ndërmjet ish dy kryetarëve, ish Kryetarit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (SANU) dhe ish Kryetarit të ndjerë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), përkatësisht ndërmjet akademik Dobrica Qosiq dhe akademik Aleks Buda pavarësisht dallimeve të fushave të interesimit të tyre, kohës kur kanë vepruar dhe kur kanë kryesuar institucionet e tyre akademike.

Do të ishte me interes krahasimi i pikëpamjeve dhe i qëndrimeve ndërmjet udhëpërshkrusve, politikanëve dhe informuesve të shtypit të përditshëm për vëzhgimet e tyre nga vendet tona. I këtillë do të ishte krahasimi ndërmjet pikëpamjeve dhe qëndrimeve të Dimitrije Tucoviqit dhe Lav Trockit, etj. Qasjet e këtilla studimore nuk i përkasin asnjë qeverie e parlamenti, as organeve të tyre, sa kanë të bëjnë me institucionet e larta studimore, sidomos me akademitë shkencore.

Në fund dua të theksoj mospajtimin më të madh midis autorit të këtyre rreshtave dhe autorit të librit në fjalë: autori i këtyre rreshtave nuk e arsyeton porosinë e dhënë në fillim të librit, ku thuhet se vepra i kushtohet nipit “Nikolla Vukiqit, nipit tim, të zgjuar, trim, të riut të bukur, i cili... me dinjitetin e tij e ka ngritur shpresën në gjeneratën e tij – të fortë, të drejtë, të njerëzve të mirë, të cilët më me zgjuarësi dhe më me shkathtësi se gjyshërit dhe baballarët e tyre do t'i rezistojnë historisë së egër”. A do të thotë kjo porosi se gjeneratat e reja do ta ndjekin mendimin edhe të disa akademikëve serbë në përputhje me ndriçimin e fakteve arkeologjike, toponomike, demografike, antroponomike etj. dhe me lëvizje të mendimit në relacion të drejtë me kushtet dhe me rrethanat gjithnjë të ndryshueshme?

Sot intelektualët krijues duhet të kërkojnë dhe të gjejnë balancin e pranishëm objektiv ndërmjet rrjedhave politike ndërkombëtare dhe zhvillimeve kombëtare serbe e shqiptare, si dhe të marrëdhënieve bashkëkohore ndërmjet tyre. Mbi themelet e këtij raporti të përpunuar nga intelektualët krijues, udhëheqësit e shoqërisë dhe të shtetit duhet të zhvillojnë politikën e paqes, të mirëkuptimit dhe të pajtimit ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve si

dhe të tyre ndaj të gjithë të tjerëve mbi themelin e argumenteve të sintetizuara në mendimin shkencor të qëndrueshëm. Besoj se gjeneratat pas nesh do ta realizojnë këtë dhe për këtë do të jenë krenarë.

Pajazit Nushi, Prishtinë

Oliver Jens SCHMITT: **KOSOVO. KURZE GESCHICHTE EINER ZENTRAL-BALKANISCHEN LANDSCHAFT**, Böhlau UTB, Wien. Köln. Weimar, 2008, ff. 393.

Në fund të verës 2010 në Prishtinë qëndroi Oliver Jens Schmitt, historian zviceran, profesor në Universitetin e Vjenës. Ai ishte ftuar nga organizatorët e Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, i cili për çdo vit mbahet në kryeqytetin e Kosovës. Seminari është një ngjarje me rëndësi të madhe kulturore, sepse bashkon shumicën e shkencëtarëve që merren me çështje të gjuhës, kulturës, letërsisë dhe historisë së shqiptarëve në Ballkan dhe më gjerë. Prandaj, ftesa që organizatorët ia bënë Oliver Jens Schmitt-it ishte e qëlluar. Institucionet kulturore në Tiranë nuk i kanë bërë një ftesë të tillë. Në Prishtinë Schmitt foli për mënyrën e shkrimit të historisë në Kosovë, për mangësitë e shumta dhe për shumë fusha që ende nuk janë trajtuar dhe lëvruar nga historianët shqiptarë. Kritika më e ashpër që Schmitt u bëri kolegëve të tij në Prishtinë ishte se shpeshherë trajtesat e tyre historike i kanë shkruar si përgjigje ndaj pamfleteve serbe dhe jo si përpjekje serioze shkencore. Me fjalë të tjera, sipas tij: mes historianëve serbë dhe shqiptarë është luajtur një lloj pingpongu kuazishkencor me qëllim që argumentet përjashtuese të tjetrit të goditen stuhishëm. Natyrisht Schmitt kritikën e tij e formuloi me modestinë dhe kujdesin e njohur, që karakterizon shumë zviceranë, sidomos ata të qarqeve akademike dhe publicistike.

Oliver Jens Schmitt është autor i biografisë kritike të Skënderbeut. Botimi i këtij libri në Tiranë kishte ngjallur debate mjaft të ashpra. Intelektualë të ndryshëm, ndonjëherë edhe pa e lexuar librin hodhën kritika të ashpra kundër autorit, duke e akuzuar se e kishte njollësuar figurën e Skënderbeut, sepse kishte përmendur lidhjet e familjes së tij me sllavët dhe kishte shkruar se njëri nga motivet e luftës së Gjergj Kastriotit kundër osmanëve kishte qenë edhe hakmarrja, për shkak se osmanët ia kishin vlarë të atin. Ka ende intelektualë dhe „aktivistë të çështjes kombëtare“ që vërtet besojnë se kur një historian apo publicist i huaj formulon ndonjë kritikë ndaj shqiptarëve, ai këtë e bën me „porosi“ të Beogradit. Jo pak historianë të Prishtinës preferuan ta bojkotonin ligjëratën e Schmitt-it. Njëri prej tyre deklaroi në media se nuk e kishte ndjekur ligjëratën për shkak se nuk dëshironte t'i jepte rëndësi autorit. Kritikën e tilla ndaj Schmitt-it e kanë shtyrë madje edhe historianin britanik Noel Malcolm të ndërhynte dhe t'ia tërhiqte vëmendjen opinionit se Schmitt është një historian serioz dhe njëri prej njohësve më të mirë të historisë së shqiptarëve. Krahës biografisë së Skënderbeut Schmitt ka shkruar dhe botuar në vitin 2008 një libër mbi historinë e Kosovës, vlera e të cilit është shumë e madhe. Gjatë ligjëratës së Schmitt-it në Prishtinë këtë libër e përmendi R. Ismajli, i cili i përcjell dhe i lexon botimet mbi çështjet shqiptare në botën perëndimore. Libri i Schmitt-it i dedikohet, në radhë të parë, opinionit të interesuar gjermanishtfolës, por do të ishte me rëndësi që kjo vepër të përkthehej edhe në gjuhën shqipe, sepse është një analizë brilante e historisë, e paanshme dhe e shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, larg vokabularit të

mërzitshëm shkencor (ose “fachchinesisch”, siç thuhet në gjermanisht, pra kinezish-te për ekspertë).

Kosova - Një trevë ballkanike.

Libri i profesor Schmitt-it për historinë e Kosovës mban këtë titull: “Kosovo – Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft” (në shqip: “Kosova – Histori e shkurtër e një trevë qendrore ballkanike”). Autori që në hyrje të librit e shpjegon se nocioni “trevë qendrore ballkanike” mbështetet në një formulim të ngjashëm të historianit Edgar Hösch, i cili me këtë emërtim i përthekon, para së gjithash, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë, Shqipërinë, Bullgarinë dhe Greqinë Veriore. Në libër Kosova nuk trajtohet si zonë e izoluar, por si trevë e Ballkanit, e cila gjatë historisë ka pasur kufij të ndryshëm, fundja, siç e theksoi Schmitt edhe gjatë ligjëratës në Prishtinë, Kosova në kufijtë e tanishëm ekziston tek pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Librit i paraprinë një paraqitje e imazheve historike të serbëve dhe shqiptarëve mbi Kosovën, imazhe këto që e përjashtojnë njëra-tjetrën. Grindja për atë se kush ka lindur i pari në Kosovë vazhdon të jetë pjesë e pandashme e konfliktit serbo-shqiptar. Kjo grindje në gjermanisht quhet “Streit um das Erstgeburtsrecht” (grindje për atë se kush ka lindur i pari në një vend) dhe është nocion i njohur për përshkrimin e konflikteve të ngjashme si ky në Kosovë. Siç u tha, kufijtë e tanishëm të Kosovës janë skicuar tek pas vitit 1945. Si zonë administrative Kosova u bë e njohur tek në vitin 1877 me krijimin e Vilajetit të Kosovës, i cili përfshinte pjesë të Maqedonisë, Serbisë dhe të Malit të Zi të sotëm. Qendër e Vilajetit fillimisht ishte Prishtina, më vonë Shkupi. Sipas profesor Schmitt kufiri i sotëm i Kosovës me Shqipërinë ishte caktuar në vitin 1913 duke pranuar interesat strategjike serbe.

Në fillim na ishte Dardania.

Perandoria Romake e pushtoi territorin e Kosovës së sotme tek në vitin 44 pas Krishtit (ose Erës së Re) dhe u takua me fise të ndryshme ilire, prej të cilëve më i njohuri ishte fisi i dardanëve. Gjeografët antikë dhe historianët i përshkruanin dardanët si barbarë: të pandershëm, të egër, por edhe të guximshëm dhe kryengritës. Perandoria Romake stacionoi një legjion në Shkupin e sotëm dhe filloi të rekrutojë dardanët për ushtrinë romake. Një njësi e tillë u vendos në Naissus (në Nishin e sotëm). Perandori romak Mark Aurel i përmend “plaçkitësit dardanë”. Bashkë me pushtimin romak filloi edhe kristianizimi i dardanëve; kjo ndodhte sidomos gjatë shërbimit në ushtrinë romake. Ai që përqaftonte fenë e krishterë integrohej më lehtë në Perandori. Schmitt shkruan se për shkak të mungesës së burimeve periudha mes përfundimit të sundimit romak (rreth vitit 600) dhe integritetit të Kosovës në Perandorinë Bizantine (1018) është pothuaj e pakapshme. Për këtë periudhë nuk ka asnjë dëshmi të pranishëm të sllavëve në Kosovë. Supozohet se para shekullit të 9-të në Kosovë nuk ka pasur ndonjë sistem të gjerë administrativ. Po ashtu, sipas Schmitt-it, duhet theksuar se Perandoria Bullgare, e cila shtrihej në territorin e Kosovës, në

shekullin e 9-të nuk ka qenë sllave; ajo ishte themeluar nga protobullgarët, të cilët flisnin një gjuhë turke. Protobullgarët u sllavizuan tek në shekullin e 10-të. Bizanti e zaptoi rajonin e Kosovës në vitin 1018, kur tashmë ishte zhbërë tradita romake dhe gjuha greke tashmë s'ishte e njohur. Popullsia i përkiste fesë ortodokse, por jo traditës së saj bizantino-greke, por bullgaro-sllave. Për t'u mbrojtur nga sulmet sllave Bizanti vendosi garnizone ushtarake në Lipjan dhe Prizren. Kriza e Perandorisë Bizantine e detyroi atë të tërhiqet drejt jugut. Në vitet 1093/94 zhupani serb Vukan pushtoi Kështjellën e Lipjanit, por pas një kohe ai u detyrua të ikte drejt veriut. Në shekullin e 12-të serbët arritën të depërtojnë luginës së lumit Ibër dhe të pushtojnë Kështjellën e Zveçanit. Deri në fund të shekullit të 12-të serbët mbajtën veriun, ndërsa rrafshin e Kosovës e kontrollonin bizantinët. Pak a shumë sikur sot: Serbët sundojnë veriun, në pjesën tjetër qeverisin autoritetet e Prishtinës. Tek në vitin 1190 serbët arritën të depërtojnë deri te Malet e Sharrit. Shkatërrimi i Bizantit i mundësoi serbëve që për 180 vjet të sundojnë në Kosovë.

Nën serbë.

Schmitt thekson se nga pikëpamja historike sundimi serb në Kosovë është shumë i shkurtër, prandaj ai në librin e tij këtë periudhë nuk e trajton si pushtim imperial. Të tilla konsiderohen pushtimet romake, bizantine dhe osmane. Për serbët pushtimi i Kosovës dhe Maqedonisë ishte zbulim i një bote të panjohur për ta. Schmitt shkruan se serbët e kanë parë për herë të parë kulturën qytetare bizantine tek pas pushtimit të rajoneve të Kosovës dhe Maqedonisë. Për kurorën serbe pushtimi i Kosovës ishte një shans i mirë për përparim ekonomik, sepse rajoni kishte fusha pjellore dhe miniera argjendi në Trepçë dhe Novobërdë. E njohur përtej rajonit në atë kohë ishte sidomos Novobërda (në gjermanisht: Neuberg, në italisht: Novomonte), e cila në atë kohë kishte një legjislacion të qytetit, gjë që ishte diçka e rrallë në Ballkan. Meqë serbët nuk kishin as kapital, as teknologji për të punuar në miniera, ata angazhuan tregtarë nga Dubrovniku dhe minatorë gjermanë nga Sllovakia e sotme. Schmitt shkruan se me zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe me përfitimet që nxirrin nga minierat Mbretërit serbë arritën të financojnë ndërtimin e shumë objekteve fetare në Kosovë. Përmes këtyre ndërtimeve serbët e asaj kohe lanë më shumë gjurmë në Kosovë se sa bizantinët. Schmitt në trajtimin e kësaj periudhe bën një dallim të qartë mes dinjitarëve dhe Mbretërve serbë nga njëra anë dhe popullsisë sllave në Kosovë në anën tjetër. Sipas tij nuk ekzistojnë burime mbi identitetin etnik të sllavëve të asaj kohe në Kosovë, pra nuk mund të thuhet se ata kanë qenë (vetëm) serbë. Me një fjalë: Elita ishte padyshim serbe, por kjo nuk mund të thuhet pa asnjë dyshim për popullsinë fshatare.

Nën osmanë.

Grindjet mes prijësve serbë të asaj kohe e dobësuan perandorinë e tyre, duke e bërë të pafuqishme për të përballuar osmanët, të cilët po përparonin drejt Ballkanit. Ishin tri fisnikëri që arritën të kenë pushtet në Kosovë. Në jug ishte Car Llazari, i cili zotëronte edhe minierat në Novobërdë. Në veriperëndim, në Drenicën e sotme, sundonin të bijtë e Branko Mladenoviqit, Brankoviqët. Këto dy familje dominuan

shekullin e fundit të shtetësisë serbe në Kosovë në Mesjetë, nënvizon Schmitt. Në Dukagjin (ose Metohi, siç quhej kjo pjesë e Kosovës nga sllavët) “u shfaq një fisnikëri tjetër, prejardhja etnike e së cilës (serbe, shqiptare, vllahe) është e paqartë: Balšići (shqip: Balshajt). Ambicia e tyre do ta hidhte Kosovën në greminë”, shkruan Schmitt. Zhvillimi i ngjarjeve në prag të pushtimit osman, gjithnjë sipas autorit, është si vijon: Gjergj Balsha II ishte në armiqësi me Mbretin e Bosnjës. Meqë vetë nuk ia merrte mendja të luftonte kundër tij Balsha II i thirri në ndihmë trupat osmane, por e humbi betejën bashkë me to në vitin 1388. Pas kësaj disfate nga boshnjakët Sulltan Murati I u përбетua se do të marrë hak. Për të marshuar drejt Bosnjës atij i duhej të kalonte nëpër Kosovë. Për të penguar kalimin e osmanëve fisnikët serbë lidhën aleancë me Mbretin e Bosnjës Tvrtko I. Në qershor të vitit 1389 u bashkuan fisnikët serbë, boshnjakë dhe një fisnik shqiptar nga Shqipëria jugore. Përleshja që pasoi në histori njihet si Beteja e Kosovës. Schmitt shkruan se përkundër pretendimit të historianëve shqiptarë se pjesëmarrës në Betejën e Kosovës ka qenë edhe Gjergj Balsha II, i cili prej po këtyre historianëve cilësohet si shqiptar, dihet se ai qëndroi në Kështjellën e tij detare në Ulqin, sepse kishte ngjallur zemërimin e të dy palëve në luftë. Koalicioni serb, boshnjak dhe pjesërisht shqiptar, siç dihet, e humbi betejën. Shumica e fisnikëve serbë u bënë vasal të osmanëve. Këtu e tutje osmanët dhe fisnikët serbë sundonin bashkë Kosovën. Integrimi i Kosovës në Perandorinë Osmane u vonua për disa vite për shkak të disfatës së Sulltan Bajazitit të I-rë kundër sundimtarit të mongolëve Timur Lenkut në betejën afër Ankarasë më 1402. Derisa osmanët ishin të angazhuar në fronte të tjera pushtetin në Kosovë arriti ta stabilizojë despoti serb Stefan Lazareviq, por as ky nuk pranoi të heq dorë nga vasaliteti ndaj osmanëve. Pasardhësi i tij Gjurgj Brankoviq, e bija e të cilit ishte gruaja e Sulltan Muratit II, në vitin 1439 u dëbua jashtë vendit dhe territoret serbe iu bashkëngjitën Perandorisë Osmane. Brankoviq organizoi në vitin 1443 bashkë me prijësin e ushtrisë hungareze Gjon Huniadin dhe me fisnikë shqiptarë (mes tyre edhe me Skënderbeun) sulme të shtuara kundër osmanëve, kështu që ata u detyruan t’ia kthejnë atij principatën vasale. Si princ ortodoks Brankoviqi mbante distancë ndaj katolikëve. Si vasal osman ai shpresonte se mund të evitonte si ndikimin perëndimor ashtu edhe dominimin osman. Për këtë shkak ai, sipas Schmitt, nuk mori pjesë në ofensivën e madhe kundër osmanëve të organizuar nga Huniadi dhe Skënderbeu. Në nëntor 1448 Murati II e mundi ushtrinë hungareze në Gazimestan, aty ku ishte zhvilluar Beteja e Kosovës në vitin 1389. Në luftën e vitit 1448 në Fushë-Kosovë nuk kishte arritur të merrte pjesë Skënderbeu, i cili gjatë rrugës ishte ngatërruar në konflikte të vogla në veri të Shqipërisë. Për dallim nga shumica e historianëve serbë, të cilët thonë se pushtimi i Kosovës nga osmanët ndodhi definitivisht në vitin 1389, Oliver Jens Schmitt mendon se tek pas Betejës së Dytë të Kosovës më 1448 u vulos përfundimisht fati i këtij rajoni. Despoti serb nuk e kishte përkrahur ushtrinë katolike dhe këtë e pagoi me humbjen e Kosovës (1455) dhe me fundosjen e gjithë principatës serbe. “Një pjesë e familjes së tij iku te Skënderbeu, i cili ishte i afërm me Brankoviqët. Një kundërthënie etnike mes serbëve dhe shqiptarëve nuk mund të konstatohet në elitën e Mesjetës – lidhjet e ngushta të fisnikërive serbe dhe shqiptare ortodokse e tregonin të kundërtën: Nëna e Skënderbeut ishte

me gjasë nga dera e Brankoviqeve, dhe i biri i tij (i Skënderbeut) Ivani (Gjoni) u martua me Irena Brankoviqin”.

Integrimi përmes ushtrisë.

Integrimi në shoqërinë osmane i shqiptarëve të Kosovës dhe më gjerë filloi përmes inkuadrimin të rinjve në ushtri. Ndonëse sulltanët në shekullin e 15-të nuk kërkonin që ushtarët të ndërrojnë fenë, megjithatë jo pak prej tyre këtë e bënë. Si të krishterë ata jo vetëm që merrnin paga më të ulëta, por ishin të diskriminuar edhe në forma të tjera. Shumica e ushtarëve në Kosovë rekrutoheshin për njësitë e kalorësisë (këta ushtarë quheshin timariotë ose spahi). Një arsye tjetër për të ndërruar fenë ishin gjasat më të mëdha për të përparuar në karrierë. Deri në fillim të shekullit 16-të këtë e kishin bërë shumica e timariotëve. Një metodë tjetër për integrimin e shqiptarëve ishte marrja peng/rekrutimi i dhunshëm i të rinjve (osmanisht: devşirme, shqip: haraç në gjak, gjermanisht: Knabenlese, serbisht: krvni danak). Pasi stacionoheshin nëpër kazerma të ushtrisë osmane të rinjtë s’kishin zgjidhje tjetër përveç se të kalonin në fenë islame. Prej tyre pastaj u krijua trupa elitare e ushtrisë, të ashtuquajturit jeniçerë. Kjo trupë përbëhej kryesisht prej boshnjakëve dhe shqiptarëve. Sipas Schmitt rasti i jeniçerëve tregon se shqiptarët si në kohën e Perandorisë Romake (Imperium Romanum) edhe në Perandorinë Osmane morën detyrën e njëjtë: ata përbënin bërthamën e trupave elitare. Madje shqiptarët e Kosovës kanë qenë pjesë e trupave osmane, të cilat mes shekujve 16-të dhe 18-të sulmuan Evropën e Mesme, për shembull gjatë rrethimit të dytë të Vjenës në vitin 1683. Sa i përket fesë: Schmitt thekson se pretendimi i disa historianëve shqiptarë se para islamizimit shqiptarët e Kosovës kanë qenë të gjithë katolikë nuk është korrekt: shqiptarët autoktonë, të cilët jetonin në Kosovë në Mesjetë, i përkisnin kryesisht besimit ortodoks. Një paradoks tjetër që Schmitt e përshkruan në librin e tij është rasti i fanëve, katolikë të ardhur në Kosovë nga Fani i Madh dhe Fani i Vogël. Në shekullin e 19-të ata u rekrutuan nga osmanët si polici ndihmëse. “Kështu malësorët shqipfolës katolikë i shërbyen Sulltanit besnikërisht edhe kundër shqiptarëve myslimanë, të cilët në vitin 1878 u rebeluan kundër Sulltanit”.

Disa fakte të tjera.

- Perandoria Osmane e bënte ndarjen territoriale të Kosovës sipas interesave të administratës së saj. Këtë e tregon shembulli i Vushtrrisë. Pas vitit 1541 ky qytet i takonte provincës Ofen (Buda, në Hungari). Më vonë Vushtrria iu kthye krahinës së Rumelisë.

- Një vështirësi gati e pakalueshme e osmanëve ishte pushtimi i zonave malore të banuara me shqiptarë. Një gjë e tillë ishte arritur sidomos në vitin 1466/67 pas vrasjeve masive dhe dëbimeve. Megjithatë, pas një kohë dhe në pamundësi të përballonin rezistencën e popullsisë lokale trupat osmane tërhiqeshin. Pikërisht në këto vise malore u krijua një traditë e administrimit dhe jetës larg shtetit. Në këtë kuadër duhet parë edhe të drejtën zakonore (Kanunin), i cili u përhap në shumë vise të banuara me shqiptarë. Sipas

Schmitt Kanuni është “shprehja më e qartë e distancës së madhe ndaj shtetit dhe institucioneve të tij”. Në Perandorinë Osmane vlente sheriat, pra e drejta fetare islame, e cila plotësohej nga e drejta perandorake e Sulltanit (kanun; nuk duhet të ngatërrohet me të drejtën zakonore shqiptare). Se shteti osman nuk kishte arritur pas shumë e shumë deceniesh të etablojë sistemin e tij juridik në Kosovë tregon ky shembull, të cilin Schmitt e sjell në librin e tij: “Në vitin 1890 Sulltan Abdylhamiti e ngarkoi gjeneralin e tij komandues në Kosovë, Et’hem Pashën, për të zgjidhur një zënkë mes fiseve Gashi dhe Shala. Gjenerali mbledhi parinë shqiptare-myslimane nga Gjakova dhe Peja si dhe krerët e fiseve të Junikut dhe Vokshit. Objekt i konfliktit ishte një mal i liruar nga tatimi, i cili i takonte Manastirit ortodoks të Deçanit. Banorët e fshatrave përreth gëzonin të drejtën që të presin dru në këtë mal. Por, në vitin 1716 banorët e fshatrave kishin filluar një ngatërresë me pjesëtarët e fisit Shala lidhur me kufizimin e saktë të pronësisë përkatëse të tokës. Në vitin 1870 shpërtheu një luftë e hapur, e cili kishte pushuar përkohësisht pas ndërmjetësimit të fiseve Berisha dhe Thaçi. 20 vjet më vonë konflikti shpërtheu sërish, kësaj radhe për shkak të vadave nga lumi i Bistricës për ujitjen e arave. Brenda një viti në fshatin Isniq (Shalë) u plagosën 38 burra dhe 25 u vranë, fshati Deçan kishte 43 të plagosur dhe 23 të vdekur. Në përgjithësi kjo fushatë hakmarrjeje brenda një viti ua mori jetën 128 viktimave”. Pra, gjeneral Et’hem Pasha më tepër ishte ndërmjetës se sa autoritet ekzekutiv i shtetit. Edhe në kapërcyell të shekullit 19-të osmanët nuk ishin në gjendje të zbatonin monopolin e pushtetit as në zonat e ulëta, e lëre më në male.

- Gjatë sundimit osman Prizreni ishte ndër qytetet më të bukura dhe më të rëndësishme të Perandorisë. Prizreni po ashtu deri gati në fund të shekullit 19-të ishte qendra e vetme vërtet urbane e Kosovës. Qyteti numëronte 28 xhami, prej të cilave e para ishte ndërtuar në vitin 1455.

- Gjatë sundimit osman Kosova ishte ndër rajonet më të trazuara. Në vitin 1831 në Bosnjë morën pushtetin myslimanët konservativë dhe pastaj ata u vërsulën në Kosovë, ku gjetën mbështetjen e myslimanëve shqiptarë, të cilët ishin kundërshtarë të reformave osmane. Së bashku myslimanët e Bosnjës dhe të Kosovës mposhtën një armatë të fuqishme osmane; në vitet 1831/32 trupat e Sulltanit sërish vendosën pushtetin e tyre. Kjo kryengritje, sipas Schmitt, tregon se “myslimanët e Kosovës ishin ndër armiqtë më të ashpër të çdo modernizimi të Perandorisë; (...) Kështu u krijua një bllok mysliman dhe armiqësor ndaj reformave në Ballkan kundër reformatorëve myslimanë në Stamboll”.

Hendeku mes kodrës dhe rrafshinës.

Gjatë sundimit osman dallimi më i madh në shoqërinë e Kosovës ishte ai mes atyre që banonin në kodra dhe të tjerëve që banonin në rrafshinë, kryesisht nëpër lokalitete si Prizreni, Peja, Gjakova, Prishtina, Vushtrria, Gjilani. Perandoria i shihte viset kodrinore si zona të egra, si periferi të parëndësishme, ku burrëria, trimëria dhe mbajtja e armëve ishin pjesë e botëkuptimit themelor të banorëve. Një botë tjetër ishte rrafshina, ku punonin zejtarë, ku përdorej shkrimi, ku punonte administrata etj. “Në fazën e vonshme të sundimit osman në qytet dhe në fshat jetonte një shumicë

shqiptaro-myslimane, e cila ishte e ndarë përmes përkatësisë së kulturës qytetare-osmane respektivisht fshatare shqipfolëse”, shkruan Schmitt. Në qytete u krijuan identitete të veçanta, siç është identiteti i turk-shqiptarit, i cili kishte një habitus (sjellje) osmane dhe kjo e dallonte atë nga shqiptarët që jetonin në fshatra.

Ekonomia

Rreth vitit 1450 në ekonominë e Kosovës rëndësi më të madhe kishte prodhimi i verës se sa mbjellja e të lashtave. Në gjysmën e dytë të shekullit të 16-të në Kosovë për herë të parë erdhi orizi. Prej kulturave të veçanta që mbilleshin në Kosovë dalloheshin: liri, shafrani dhe krimbi i mëndafshit. Në vitin 1595 në qarkun që e përfshinte gjykata e Prishtinës administrata tatimore osmane kishte regjistruar 150 mijë kafshë të vogla.

Kisha.

Sidomos ditëve të fundit, në prag, gjatë dhe pas inaugurimit të Patriarkut serb Irinej në Patriarkanën e Pejës u dëgjuan fjalë të mëdha nga arsenalit religjioz-patriotik-politik serb mbi Kosovën si “shpirtin e shpirtit të Serbisë”. Natyrisht që Kosova si trevë historike është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të identitetit, kulturës dhe historisë serbe. Por, jo rrallë feja në Kosovë është keqpërdorur në interes të politikës ditore. Ky trend negativ vazhdon edhe sot. Në librin e tij Oliver Jens Schmitt tërheq vëmendjen te disa fakte të rëndësishme. Pas pushtimit osman kisha serbe në Kosovë u ndalua, por më vonë, në vitin 1557, sërish u lejua hapja e Patriarkanës së Pejës. Njeriu që ndikoi në hapjen e saj ishte një serb i turqizuar, kryeveziri Mehmed Sokoloviq, i cili e emëroi Patriark vëllain e tij, Makarije, një murg nga Atosi (Greqia e sotme). Schmitt shkruan: “Mbështetja e ortodoksisë ishte tërësisht në interesin osman, sepse në përfundim të Kosovës gjendeshin teritore malore të banuara me shumicë katolike shqipfolëse, të cilat shpeshherë me përkrahje nga Perëndimi ndërmerrnin kryengritje kundër osmanëve”. Sipas Schmitt Patriarkati ortodoks në kohëra të caktuara ishte në shërbim të Perandorisë Osmane. Nga këndvështrimi nacional(ist) serb historia është shumë e thjeshtë: Serbët luftuan kundër osmanëve, shqiptarët bashkëpunuan me pushtuesit, duke bërë zullume ndaj sllavëve etj. Në vitet 1689 dhe 1737, sipas pikëpamjes serbe, Patriarkët Arsenije III dhe Arsenije IV i prinë rezistencës kundër osmanëve. Reagimi osman ishte i ashpër dhe në vitin 1766 pasoi mbyllja e Patriarkatit të Pejës. Sa e madhe ishte urrejtja ndaj osmanëve tregon një përshkrim nga viti 1660 i shkrimtarit Evlija Çelebi, i cili kishte udhëtuar nëpër Perandori. Sipas tij varri i Sulltan Muratit në Gazimestan ishte përherë i ndotur, sepse fshatarët e krishterë atje qëllimisht kryenin nevojën. Dhe kjo ndodhte gati 300 vjet pas Betejës së Kosovës.

Dyndje dhe gënjeshtria

Një ndër pikëpamjet më interesante të Schmitt-it në librin e tij është se deri në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të nuk mund të flitet për prani ekskluzive të

serbëve në Kosovë. Sipas tij shumë sllavishtfolës në Kosovë e shikonin Bullgarinë si pikë orientuese, jo Serbinë. Prandaj, shkruan Schmitt, për Kosovën paramoderne duhet të përdoret nocioni “sllavishtfolës”, i cili përfshinë serbët, bullgarët, vllahët, por edhe ndonjë shqiptar që mund të ketë folur sllavisht. Se jo të gjithë sllavishtfolësit në Kosovë ishin serbë e tregon një statistikë nga Prizreni e vitit 1903. Në atë vit në Sanxhakun e Prizrenit jetonin 17'232 të krishterë ortodoksë, të cilët e përqa-fonin Eksarhatin bullgar (zonë administrative kishtare). 22'550 të krishterë të tjerë ortodoksë të Kosovës, ndërkaq, përqafonin Patriarkatin e Konstantinopojës, kleri i të cilit në Kosovë ishte faktikisht nën kontrollin serb. Në shekullin e 6-të nuk ka pasur serbë në Ballkan, por sllavë. Prani e tyre në Kosovë është e evidente vetëm nga fundi i shekullit të 12-të. Qendër bashkësisë së tyre gjuhësore nuk ka qenë Kosova, por Rashka e sotme, pra rrethina e Novi Pazarit. Kosova deri në fund të shekullit 12 ka qenë pjesë e Bizantit dhe Perandorisë Bullgare. Sa i përket toponimeve sllave në Kosovë Schmitt shkruan se ardhacakët (sllavët) pasi përzunë popullsinë e vjetër ballkanike në kodra në vend të toponimeve të harruara antike i pagëzuan vendbanimet me toponime sllave. Një ndër përrallat më të çuditshme të nacionalistëve serbë është edhe pretendimi se pas “Dyndjes së Madhe Serbe” të vitit 1690 në Kosovën e zbra-zët erdhën shqiptarët nga veriu i Shqipërisë. Dyndja pasoi pasi, siç pretendon një pjesë e historiografisë serbe, Patriarku Arsenije Černojeviq drejtoi një kryengritje të serbëve kundër osmanëve. Pas disfatës ai i priu “40 mijë familjeve serbe” në rrugë drejt Hungarisë jugore (Vojvodinës së sotme). Schmitt e quan këtë rrëfim manipulim të fakteve historike. E para: Patriarku Černojeviq në kohën e kryengritjes nuk ishte në Kosovë, por në Mal të Zi. Kur refugjatët mbërrin në Danub ai ishte në Beograd. Atje ai u vendosë në krye të kolonës së refugjatëve dhe kaloi lumin; me atë rast nuk bëhej fjalë për 40 mijë familje, por për “40 mijë frymë”, siç e thekson edhe historiani gjerman Holm Sundhaussen. Schmitt shkruan: “Dyndja e Madhe nuk ka ndodhur ashtu siç iu kujtohet serbëve. Në krye të rezistencës kundër osmanëve nuk qëndroi Patriarku serb, por ipeshkvi katolik i Shkupit, shqiptari Pjetër Bogdani. Është e vështirë të përcaktohet se cila ka qenë përkatësia etnike e kryengritësve, por Prizreni, që ishte qendër e rezistencës, atëbotë kishte një shumicë shqiptare”. Në vitin 1737 pasoi kryengritja e radhës e popullsisë së krishterë të Kosovës kundër osmanëve, prijës i së cilës ishte Patriarku Arsenie Jovanoviq IV. Qendra të kryengritjes ishin Prishtina dhe Vushtrria. Pas shtypjes së kryengritjes mijëra serbë dhe rreth katër mijë shqiptarë të fisit Kelmendi u arratisën në territorin e Habsburgut. Luftëtarët vullnetarë të fisit Kelmendi u vendosën në Vojvodinën e sotme, kryesisht në fshatrat Hrtkovci, Nikinci dhe Jarak. Ata tashmë janë sllavizuar. Nuk është rastësi që në vitin 1992 lideri i radikalëve serbë Vojislav Sheshel shkoi pikërisht në Hrtkovci dhe mbajti një fjalim nationalist, ku u bëri thirrje kroatëve të këtij vendbanimi që të largoheshin. Dega e Partisë Radikale pastaj zhvilloi një fushatë agresive antikroate. Me gjasë disa prej këtyre kroatëve ishin pasardhës të fisit Kelmendi të ikur nga Kosova.

Miti

Miti i Kosovës është prodhim i shekullit 19-të, atëherë kur serbët, më herët se

shoqëritë tjera të Ballkanit, nisën rrugëtimin drejt zgjimit kombëtar dhe luftën për shtetin e tyre. Paralelisht me dobësimin e Perandorisë Osmane dhe forcimin e ambicieve serbe për shtet në Ballkan u shtuan gjasat e ndryshimeve të mëdha. Shqiptarët në këtë proces u vonuan pafalshëm, ata pothuaj nuk mund të vendosnin nëse dëshironin pavarësi të plotë apo autonomi nën Sulltanin, të cilit në faza të caktuara i kishin shërbyer me besnikëri të pashoq. Në vitin 1889 qeveria osmane lejoi hapjen e Konsullatës serbe në Prishtinë, e cila filloi të nxiste konflikte mes shqiptarëve me qëllim të destabilizimit të rajonit. Integrimi i Kosovës në Serbi, shkruan Schmitt, ka qenë i përgatitur mirë dhe gjatë nga Beogradi. Shkencëtarët serbë përpiluan sistematikisht epërsinë e interpretimit të historisë në raport me shqiptarët. Duke qenë se shqiptarët e Kosovës nuk kishin një elitë të arsimuar interpretimi serb paraqitej si mision civilizimi, pra opinionit ndërkombëtar i sugjerohej se në Kosovë Serbia synonte të rikthehej për të civilizuar një “popullsi barbare”. Për këtë u shpik toponimi “Stara Srbija” (Serbia e vjetër). Këtë terminologji, sipas Schmitt, qeveria serbe e kishte shpikur vetë dhe për këtë flet edhe fakti se harta e parë me këtë toponim (“Stara Srbija”) u shtyp në vitin 1889 me para të buxhetit serb. Një rol të madh për përhapjen e interpretimit serb të historisë luajtën gjeografi Jovan Cvijiq, i cili hulumtimet e tij i botonte në gjuhën gjermane dhe frënge, si dhe aventurieri Spiridon Gopçeviq, i cili është autor i tezës së “arnautashëve”, pra, sipas tij, mysimanët shqiptarë ishin serbë të islamizuar dhe të albanizuar. Kulmin e poshtërimit të shqiptarëve, sipas Schmitt, pa dyshim e arrin pamfleti i ish-kryeministrit serb Vladan Gjorgjeviq, botuar në Leipzig në vitin 1913, në të cilin ai i përshkruante shqiptarët si barbarë. Mendësia e Gjorgjeviqit ishte vetëm reflektim i disponimit racist të elitës së atëhershme serbe ndaj shqiptarëve. Në kapërcyell të shekullit 19-të shqiptarët e Kosovës nuk kishin elitë intelektuale, prijësit e tyre rajonalë, siç shkruan Schmitt, nuk ishin në gjendje të bënin dallimet themelore të zhvillimeve politike.

Sërisht nën Serbi.

Si asnjë historian i huaj deri më tani Oliver Jens Schmitt e kritikon pa pardon politikën serbe ndaj shqiptarëve pas zaptimit të Kosovës nga trupat serbe në vitin 1912. Sipas tij pushtimi i Kosovës nga serbët në vitin 1912 dhe brutaliteti i treguar kundër popullsisë civile ka shumë ngjashmëri me krimet serbe në fund të viteve 90-të. Brenda vitit 1912 forcat serbe thuhet të kenë vrarë 20 mijë deri në 25 mijë shqiptarë në Kosovë. Sundimtarë lokalë shpeshherë ishin kriminelët e pamëshirshëm dhe të ngjashëm me Arkanin, i cili në vitet 90-të me bekim të regjimit të Slobodan Milosheviqit terrorizonte popullsinë shumicë të Kosovës. Derisa zyrtarët seriozë serbë nuk pranonin të vinin në Kosovë, qeveria dërgonte kriminelë, aventurierë, paramilitarë dhe nëpunës të korruptuar. Schmitt shkruan se përballë krimeve kundër popullsisë, korrupsionit dhe keqmenaxhimit ishte cinike kur zyrtarët e lartë serbë thoshin se integrimi i Kosovës ishte mision për civilizimin e shqiptarëve. Pas pushtimit të Kosovës elitat serbe orientuan ambiciet e tyre drejt përvetësimit edhe të Bosnjë-Hercegovinës dhe krijimin e një shteti të përbashkët për të gjithë serbët. Llogaria e Serbisë doli e gabuar. Pas vrasjes së pretendentit të fronit austrohungarez në Sarajevë

më 1914 trupat e Perandorisë Austrohungareze dhe ushtria gjermane bashkë me Bullgarinë mposhtën Serbinë. Ushtria serbe iku përmes Kosovës dhe Shqipërisë drejt Korfuzit. Trupat austriake, hungareze, gjermane dhe bullgare sollën ndryshime në Kosovë. Monarkia danubiane hapi shkolla shqipe, punësoi zyrtarë shqiptarë dhe ndërtoi infrastrukturën. Shqiptarët i pritën me entuziazëm trupat e perandorisë austrohungareze. Një mijë vullnetarë shqiptarë shërbyen në frontin austriak kundër Rusisë, ndërsa dy mijë të tjerë iu bashkuan trupave austrohungareze në Shqipëri. Rezistencë kundër administratës austrohungareze bënte si domos popullsia e orientuar nga Serbia, por jo vetëm ajo. Schmitt shkruan: “Në veri (të Kosovës, v.j.) një kryengritës i ri i quajtur Azem Bejta dhe gruaja e tij Shote Galica bashkëpunonin me serbët lokalë kundër austriakëve dhe bashkë me prijësin e bandave çetnike Kosta Peqanac këshilloheshin për aksionet e përbashkëta. Në vjeshtë të vitit 1918 Azem Bejta arrestoi shumë ushtarë gjermanë dhe austrohungarezë (të cilët kishin shërbyer në frontin e Maqedonisë). Kjo duhet të theksohet për shkak se ky çift (Azem Bejta dhe Shote Galica, v.j.) pas vitit 1918 karakterizoi kryengritjen kundër kthimit të administratës serbe. Në fund të tetorit 1918 njësitë serbe dhe franceze marshuan në Prishtinë”.

Jugosllavia e parë.

Sipas historianit gjerman Holm Sundhaussen pushtimi i Kosovës dhe Maqedonisë së Vardarit paraqet një vendim tepër të gabuar të Serbisë. Schmitt i bashkohet këtij mendimi, duke shtuar se zhvillimet e mëvonshme në Kosovë flasin për vërtetësinë e këtij vlerësimi. Mes viteve 1912 dhe 1918 Serbia ishte në një gjendje të dehur nacionale. Vetëm shifrat mbi humbjet në njerëz flasin shumë: Në këtë periudhë Serbia humbi gati një milion (!) ushtarë. Në Kosovë dhe Maqedoni Serbia u shfaq si fuqi kolonialiste. Ndonëse aleatë me serbët në Luftën e Parë Botërore diplomatët britanikë paralajmëronin se politika pushtuese serbe do të kishte pasoja fatale. Por, zyrtarët serbë përgjigjeshin se edhe Britania kishte koloni dhe Serbia nuk e kishte ndërmend të përzihej, për shembull, në Indi. Schmitt shkruan se qëllim i Serbisë në Kosovë pas pushtimit të sërishëm më 1918 ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës, me fjalë të tjera dëbimi i shqiptarëve. Nuk synohej integrimi i shqiptarëve në Mbretërinë serbo-kroato-slllovene (SKS). Nën sundimin e Mbretërisë së SKS-së liderët e atëhershëm të Kosovës të tubuar në partinë e Xhemijetit u gjendën para dy alternativave: Të luftonin me armë kundër pushtetit ose të bashkoheshin me pakicat të tjera dhe të angazhoheshin për realizimin e të drejtave të tyre. Liderët kosovarë, kryesisht dinjitarë fetarë dhe pasanikë, përqaftuan alternativën e dytë dhe, në këtë mënyrë, pranuan pushtetin e ri. Në fillim të viteve 20-të deputetët e Xhemijetit me votat e tyre e mbanin në pushtet qeverinë e kryeministrit serb Nikola Pashiq. Shpresat e tyre se do t'i realizonin të drejtat e komunitetit shqiptar në Kosovë nuk u përmbushën. Në vitin 1924 Xhemijeti iu bashkua opozitës kundër regjimit të Beogradit, i cili reagoi me brutalitet kundër politikanëve të Xhemijetit. Njëkohësisht në nivel të Mbretërisë serbo-kroato-slllovene u thellua konflikti mes kroatëve që synonin më shumë autonomi dhe serbëve që dëshironin të dominonin nga Sllovenia deri në Maqedoni. Në qershor 1928 në parlamentin e SKS-së në Beograd u vra lideri kroat Stjepan Radiq. Vrasës ishte deputeti malazez Punisha Raçiq, i cili në vitin 1920 ishte zgjedhur deputet i Tetovës si kandidat i përbashkët i Xhemijetit dhe Partisë Radikale të Nikola Pashiqit. Më vonë Raçiq ishte angazhuar nga Beogradi kundër

shtypjes së rezistencës shqiptare në Kosovë. Paralelisht me Xhemijetin si përfaqësues të shqiptarëve u shfaqën edhe kaçakët, një lëvizje kryengritëse kundër terrorit serb. Pak a shumë ngjashëm sikur Xhemijeti edhe kaçakët kërkonin ndërprerjen e dhunës kundër shqiptarëve, dhënien fund të arbitraritetit të autoriteteve dhe hapjen e shkollave, të cilat i kishte mundësuar Perandoria Austrohungareze. Konflikti eskaloi kur në vitin 1920 Serbia i mori peng gratë dhe fëmijët e kaçakëve dhe i dërgoi në Serbi. Schmitt thekson se në këtë mënyrë politikanët serbë qëllimisht përdhosnin dinjitetin e kundërshtarëve të tyre shqiptarë. Gjatë konfliktit mes kaçakëve dhe pushtetit serb u shkatërruan 6 mijë shtëpi dhe 12'400 persona humbën jetën. Rreth 22 mijë njerëz u arrestuan. Lidhur me rolin e Shqipërisë në shekullin e 20-të ndaj konfliktit në Kosovë Schmitt nënvizon se ajo nuk ka luajtur rolin e fuqisë mbrojtëse të shqiptarëve të Kosovës. Një arsye për këtë abstenim të Shqipërisë Schmitt e sheh në faktin se “dy diktatorët më të rëndësishëm të Shqipërisë” Ahmet Zogu dhe Enver Hoxha morën pushtetin me ndihmën jugosllave dhe si kundërshtpërbllim për këtë në fillim të sundimit të tyre urdhëruan vrasjen e politikanëve opozitarë kosovarë ose ekstradimin e tyre në Jugosllavi. Schmitt përmend rastin e vrasjes së Hasan Prishtinës dhe përndjekjen e Bajram Currit, i cili bëri vetëvrasje. Nga perspektiva e sotme duket irituese se si në Kosovë disa aventurierë politikë ia festojnë ditëlindjen Enver Hoxhës dhe disa të tjerë e madhërojnë figurën e Ahmet Zogut pa asnjë shprehje të kritikës. Serbia gjeti po ashtu aleatë për dobësimin e Shqipërisë. Në vitin 1914 vendin e hodhi në krizë për interesa të Beogradit Esad Pashë Toptani, i cili më vonë do të vritej në Paris nga studenti Avni Rustemi. Gjithashtu Serbia nxiti tendencat separatiste në mesin e katolikëve të Shqipërisë së veriut. Shembulli më i çuditshëm është kryengritja e vitit 1920 në Mirditë. Kryengritësi analfabet Gjon Marka Gjoni shpalli “Republikën e Mirditës” dhe me ndihmën e Mbretërisë serbo-kroato-slllovene u përpoq të sigurojë njohjen e saj nga Lidhja e Kombeve, e cila ishte paraardhëse indirekte e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). “Republika e Mirditës” u furnizua me armë dhe me ushtarë nga serbët. Disa nga ushtarët ishin rusë, pjesëtarë të të ashtuquajturave “Trupa të bardha” të ushtrisë së Vrangelit, emëruar sipas Pjotër Nikolajeviq Vrangeli, një prijës i ushtrisë së bardhë antikomuniste në luftën civile ruse. Kryengritjen e bashkëpunëtorëve të serbëve në Mirditë e shtypi Bajram Curri me trupat e tij. Më 1924 vetë Zogu erdhi në pushtet me ndihmën e serbëve, por më vonë ai u përpoq t'i ikë ndikimit serb dhe kërkoi mbështetje nga Italia. Italia fashiste e Benito Mussolinit ishte tepër e interesuar në nxitjen e revoltës shqiptare në Kosovë me qëllim të dobësimit të Serbisë/ Jugosllavisë. Për këtë qëllim Mussolini kishte përkrahur edhe ustashtët kroatë, të cilët pjesërisht vepronin nga Italia. Përveç ushtrimit të dhunës Serbia në Kosovë filloi edhe një program të kolonizimit me serbë. Në shumë rajone të Kosovës përbërja etnike u ndryshua dukshëm në favor të serbëve. Schmitt shkruan se plani i shkencëtarit serb Vasa Çubriloviq për dëbimin e shqiptarëve “të kujton metodat e politikës asgjësuese nacional-socialiste në Evropën Lindore”, me fjalë të tjera strategjia serbe përbante elemente të nazizmit të Hitlerit. Sipas Schmitt kjo politikë ndaj shqiptarëve vazhdoi edhe mes viteve 1945 dhe 1966. Si arsye të racizmit serb ndaj shqiptarëve Schmitt e sheh injorancën e elitës intelektuale serbe, e cila shqiptarët i shihte si njerëz të rangut të ulët dhe kurrë nuk interesohej as për gjuhën, as për traditat, as për kulturën e tyre. Kush merrej me kulturën dhe traditën shqiptare jashtë strukturave shtetërore rrezikonte jetën e tij. Si shembull

Schmitt përmend vrasjen e Shtjefën Gjeçovit dhe të albanologut kroat Milan Shuflaj (Sufflay), i cili në vitin 1933 ishte vrarë në Zagreb nga agjentët e shërbimit sekret serb. Kundër vrasjes së profesor Shuflaj atëbotë protestuan shkencëtari Albert Einstein dhe autori gjerman Heinrich Mann (vëllau i madh i Thomas Mann-it, njërit prej autorëve më të njohur gjerman të shekullit 20-të dhe fitues i çmimit Nobel për Letërsi). Schmitt arrin në përfundimin se Kosova mes dy luftërave botërore ishte një koloni serbe: “Elita e Beogradit e dëshironte vendin, por jo edhe njerëzit që jetonin atje”.

Lufta e Dytë Botërore.

Me pushtimin e Kosovës nga trupat gjermane, italiane dhe bullgare pas vitit 1941 ndryshuan rrethanat për shqiptarët e Kosovës. Po ashtu Beogradi nuk arriti të realizojë planin për dëbimin e shqiptarëve në Turqi. Tani nën presion u gjendën serbët. Jo pak prej tyre iu nënshtruan dhunës shqiptare. Kjo dhunë drejtohej në radhë të parë ndaj kolonistëve, të cilët kishin fituar privilegje të mëdha nga Mbretëria serbo-kroato-slllovene. Schmitt i përmend disa arsye pse shqiptarët e Kosovës nuk iu bashkuan masivisht lëvizjes partizane. Shoqëria kosovare nuk kishte klasë punëtore, e cila do të identifikohet me ideologjinë komuniste dhe retorikën e saj për barazi. Shqiptarët nuk ishin as sllavë, as miq të komunistëve. Rrjedhimisht për të forcuar pozitën e Kosovës dhe për të evituar rrezikun e mbetjes së vendit përsëri nën sundimin serb shumë politikanë shqiptarë të Kosovës bashkëpunuan me trupat italiane. Në nëntor të vitit 1943 në Tiranë u krijua qeveria vasale ndaj italianëve, në krye të së cilës erdhi një kosovar, Rexhep Mitrovica. Bashkëpunëtor tjetër i italianëve dhe gjermanëve ishte edhe Xhafer Deva. Sipas Schmitt shqiptarët e Kosovës paguan një çmim të lartë për qëndrimin e tyre joarmiqësor ndaj italianëve dhe gjermanëve. “Deri në vitet 90-të të shekullit 20-të ata në Britaninë e Madhe dhe në Francë konsideroheshin si ‘kolaboracionistë’ me Forcat e Boshtit (Gjermani dhe Itali, v.j.). (...) Por, shqiptarët e Kosovës nuk dëshironin një shtet fashist, një ideologji e cila përplasej në strukturat tradicionale shoqërore ashtu si komunizmi”, shkruan Schmitt.

Jugosllavia e dytë.

Siç u theksua as Jugosllavia e dytë nuk ishte e gatshme që popullsisë shqiptare në Kosovë t’i jepte të drejta të merituar. Ndihamë nga Shqipëria nuk mund të pritej, sepse Partia Komuniste e Shqipërisë ishte një degë e komunistëve jugosllavë, ndikimi i të cilëve te Enver Hoxha ishte i madh deri në vitin 1948, kur diktatori shqiptar iu hodh në përqaftim Stalinit për të shmangur dominimin jugosllav. Përveç përshkrimit të zhvillimeve të njohura siç ishte represioni i ministrit të brendshëm Aleksandar Ranković Schmitt në librin e tij i kushton një rendësi edhe ndryshimeve të mëdha që e përfshinë Kosovën pas Luftës së Dytë Botërore. Siç dihet kthesa e parë serioze e politikës së Beogradit ndaj Kosovës ndodhi tek pas vitit 1966, pas rrëzimit të Rankovićit. Njëra ndër përpjekjet e para të pushtetit për t’i orientuar shqiptarët nga Jugosllavia ishte ideja e krijimit të një lloji “šiptarska narodnost”, për të theksuar dallimin me shqiptarët e Shqipërisë. Kjo përpjekje dështoi shpejt.

Shoqëria kosovare pas Luftës së Dytë Botërore ishte ende në nivelin postoman të zhvillimit, pra pothuaj e paprekur nga modernizmi. Kosova siç e njohim sot është prodhim i komunizmit jugosllav. Këtu duhet përmendur rrugët, shkollat, fakultetet, rrjetin elektrik, objektet komunale, sallat e sportit, termocentralet, fabrikat. Derisa shkalla e analfabetizmit në vitin 1948 në Kosovë ishte 62,5 përqind në vitin 1991 kjo shkallë zbriti në 11,9 përqind. Në vitin 1945 bibliotekat në Kosovë kishin një fond prej 6 mijë librave, më 1970 ky fond arriti në 500 mijë. Schmitt shkruan se Universiteti i Kosovës (më vonë i Prishtinës) simbolizonte emancipimin kulturor të shqiptarëve, por ai është kritik sa i përket cilësisë së mësimi. Kosova me decenie ka prodhuar një “proletariat akademik”, i cili kryesisht studionte histori dhe letërsi dhe nuk ishte i gatshëm të kryente punë tjetër përveç se në zyrë. Sipas autorit mendësia dhe metodat e punës të jo pak intelektualëve në Prishtinë edhe sot janë të ndikuara nga modelet nacionaliste-staliniste të diktaturës së Enver Hoxhës dhe kjo, mes tjerash, shihet edhe si pasojë e angazhimit të disa profesorëve nga Tirana, të cilët në vitet 70-të ligjëronin në Universitetin e Kosovës. Përkundër këtyre deformimeve mbase të pashmangshme zhvillimi i Kosovës ishte i pamohueshëm. Derisa në vitin 1920 shoqëria kosovare përfaqësohej nga bejlerët, luftëtarët dhe bajraktarët në vitet 70-të ajo përfaqësohej nga funksionarët e Lidhjes Komuniste, nga drejtorët e fabrikave dhe nga profesorët e Universitetit. Prej një elite postomane tani Kosova kishte arritur të ketë një elitë nacionale. Schmitt e përshkruan me ton pesimist industrializimin e Kosovës. Shumë ndërmarrje u hapën shpejt e shpejt, pa planifikim të mirë, prandaj edhe dështimi i tyre ishte i programuar. Një ndër arsytet e dështimit mund të ketë qenë edhe një lloj dembelizmi i klasës punëtore kosovare. Schmitt përmend rastin e fabrikës së tekstit “Kosovska” në Prishtinë, e cila kishte 1700 punëtorë, por mesatarisht për çdo ditë në punë mungonin 250 veta. Njëfarë përparimi u shënua në bujqësi. Si shembull për këtë mund të shërbejë numri i traktorëve: në vitin 1952 Kosova kishte 68 traktorë, në vitin 1971 ky numër arriti në 2231. Megjithatë, në vitin 1987 ekonomia e Kosovës mund të mategj vetëm me atë të Bregut të Fildishtë në Afrikë. Përmaset e zhvillimit mund të shihen, megjithatë, në numrin e banorëve. Derisa në vitin 1961 asnjë qytet i Kosovës nuk kishte më shumë se 50 mijë banorë, në vitet 70-të dhe 80-të kjo gjendje ndryshoi. Njëkohësisht u rrit edhe nataliteti. Si shembull Schmitt përmend Istogun: Brenda 9 viteve (mes 1953 dhe 1961) numri i banorëve të kësaj komune u shtua për 346,2 për qind ose prej 597 persona në 2664. Në vitin 1957 në Kosovë nuk kishte asnjë televizor. Në vitin 1970 në 10 mijë banorë kishte vetëm 50 lidhje telefonike. Më 1965 filloi punën aeroporti i Prishtinës (me tri fluturime në javë në vijën Prishtinë-Beograd). Dallimi mes fshatit dhe qytetit mbeti ende i madh, përkundër urbanizimit të shpejtë. Nën qytete jetonte një shoqëri urbane e ndikuar nga kultura jugosllave, ndërsa në fshat ende mbijetonte bota post-osmane-fshatare. Schmitt shkruan se derisa në Drenicë një bir i një bujku me emrin Adem Jashari dëgjonte këngë kombëtare dhe serbët i njihte vetëm nga tradita e kryengritjes së paraardhësve të tij, në Prishtinë shqiptarët dhe serbët luanin bashkë basketboll. Zhvillimi më i madh përfshiu sektorin e shëndetësisë. Derisa në vitin 1945 Kosova kishte vetëm një stomatolog, më vonë numri i mjekëve të dhëm-

bëve u shumëfishua, po ashtu edhe i mjekëve të përgjithshëm dhe specialistë. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor ndikoi dukshëm në uljen e vdekshmërisë së foshnjave.

Vizioni nga viti 1973.

Në vitin 1973 në Kosovë u botua një libër, i cili mbante titullin: “Kosova – dikur dhe tani”. Kjo vepër përmban edhe një vizion si do të duket Kosova në vitin 2000. Si e parashihnin ekspertët shqiptarë dhe serbë Kosovën në vitin 2000? Thuhej se Kosova do të kishte 2,1 deri në 2,3 milionë banorë, synohej ulja e natalitetit dhe e numrit të të punësuarve në bujqësi nga 51 përqind në 24. Urbanizimi do të arrinte 50 përqind, vetëm 35-40 përqind e banorëve do të jetonin në fshat. Kosova do të kishte 2300 kilometra rrugë moderne, mes tyre 300 kilometra autostradë. Parashikohej dhjetëfishimi i prodhimit të qymyrit në 32 milionë tonelata në vit dhe prodhimi i energjisë deri në 16 miliardë kilovatë në orë. Të gjithë banorët do të kishin qasje në ujë të pijshëm. Problemi i ujitjes në lindje të Kosovës do të zgjidhej përmes sistemit të “Ibër-Lepencit”, në sektorin e turizmit do të krijoheshin 30 mijë shtretër, prej tyre 15-16 mijë në qytete dhe 8 deri 13 mijë në Sharr, Rugovë dhe në Bjeshkët e Nemuna, do të ndërtoheshin 40 mijë banesa të reja dhe 180 deri në 200 ambulanca, numri i shtretërve në spitale do rritej prej 3400 në 13’500, secila familje do të kishte nga një radio, çdo e dyta televizor. Në këtë eufori planifikimi pothuaj askush nuk mund të parashikonte, së paku jo publikisht, luftërat në Ballkan. Socializmi vërtet ka pasur iluzione të bukura, por vetëm iluzione!

Demonstratat e vitit 1981.

Schmitt është kritik sa i përket demonstratave të vitit 1981 në Kosovë. Ai thotë se organizatorët ishin të ndikuar nga shërbimi sekret i Enver Hoxhës. Në prill të vitit 1980 Hoxha kishte ngarkuar shefin e ushtrisë Veli Llakaj të përgatis një plan sulmi ndaj Jugosllavisë (operacioni “Shpërthimi”). Sipas Schmitt shqiptarët e Kosovës paguan një çmim të lartë që pranuan të manipuloheshin nga elementë të tillë dhe të nxitnin kryengritje në Kosovë. Në këtë mënyrë u pengua ndryshimi i statusit të Kosovës konform Kushtetutës. Schmitt këtu më tepër përqafon argumentet e përfaqësuesve politikë shqiptar të përfshirë në Lidhjen Komuniste. Prijësit e demonstratave të vitit 1981 kanë një mendim krejt tjetër. Sipas tyre këto demonstrata i kanë hapur rrugë çlirimit të Kosovës. Ndoshta për këtë temë është herët të flitet, sepse ende nuk janë hapur shumë arkiva si në Tiranë ashtu edhe në Beograd.

“Gleichschaltung” i autonomisë.

Në fund të librit të tij Schmitt merret edhe me heqjen e autonomisë së Kosovës në fillim të viteve 90-të dhe me rezistencën paqësore të organizuar nga Ibrahim Rugova, të cilin pak a shumë e përshkruan si figurë tragjike, sepse politika e tij nuk gjeti mbështetje nga fuqitë perëndimore. Për heqjen e autonomisë së Kosovës Schmitt e përdorë qëllimisht termin “Gleichschaltung”, që është një term nga koha e nazizmit dhe ishte krijuar në vitin 1933, kur në Gjermani Adolf Hitleri filloi pro-

cesin e unifikimit të jetës shoqërore dhe politike. Qëllim i këtij projekti ishte pezullimi i pluralizmit, kufizimi i lirisë dhe personalitetit individual me qëllim të mobilizimit të masave. Çfarë ndodhi pastaj në Kosovë, në fund të viteve 90-të dhe në fillim të mijëvjeçarit të ri – dihet, mjaftojnë vetëm akronimet: LDK, UÇK, NATO, UNMIK, OSBE, BE, OKB, SHBA etj. Schmitt e përshkruan këtë periudhë telegrafikisht. - Historiani zviceran Oliver Jens Schmitt ka shkruar një libër brilant mbi historinë e Kosovës. Analizimi i ngjarjeve, faktet e prezantuara dhe mprehtësia e gjykit e bëjnë këtë vepër jashtëzakonisht të rëndësishme jo vetëm për opinionin gjermanishtfolës, të cilit i dedikohet, në radhë të parë. Ky libër do duhej të përkthehej edhe në gjuhën shqipe. Schmitt u lind në vitin 1973 në Basel të Zvicrës. Mes viteve 1993-2000 studioi bizantinistikën, neogreçizmin dhe historinë e Evropës Juglindore në Basel, Vjenë, Berlin dhe Mynih. Në vitin 2000 promovoi në Universitetin e Mynihut. Në vitet 2001-2004 ligjëroi në Institutin për historinë e Evropës Lindore dhe Juglindore në Universitetin e Mynihut. Që nga viti 2005 ai është profesor i historisë së Evropës Juglindore në Universitetin e Vjenës dhe anëtar korrespondent i Akademisë Austriake të Shkencave. Përveç librit “Kosova – Histori e shkurtër e një trevë qendrore ballkanike” dhe biografisë së Skënderbeut Schmitt ka shkruar edhe një studim me vlerë mbi marrëdhëniet e Arbërisë me Venedikun (“Das venezianische Albanien – 1392-1479, në shqip: *Arbëria venedike - 1392-1479*).

Enver Robelli, Zürich

GESCHICHTE SÜDOSTEUROPAS. VOM FRÜHEN MITTELALTER BIS**ZUR GEGENWART (Historia e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta e****hershme deri më sot), Herausgegeben von Konrad CLEWING/Oliver Jens****SCHMITT, me ndihmesa të: Ulf Brunnbauer, Konrad Clewing, Markus Koller,****Peter Mario Kreuter, Wim van Meurs, Michael Portman, Günter Prinzing, Oliver****Jens Schmitt, Gottfried Schramm, Holm Sundhaussen, Beatrix V Romhányi,****Harald Roth und Daniel Ursprung, Verlag Friedrich Pustet, 2011, 912 faqe.**

Në Evropën Perëndimore njohuritë për vendet e Evropës Juglindore ende nuk janë në nivelin e duhur dhe të përshtatshëm për kohërat aktuale. Kjo vlen sidomos për publikun e gjerë. Në dy shekujt e fundit rajoni i Evropës Juglindore ka qenë në fokus të shteteve të fuqishme evropiane kryesisht vetëm në raste kur ka shkaktuar kriza e luftëra, kur ka bërë bujë me atentate dhe tërmete të tjera politike. Përkundër distancës relative Evropa Juglindore është pashmangshëm e ndërlidhur dhe e ndërvarur me anën perëndimore të kontinentit të vjetër: ndikimi kulturor e politik i Vjenës, Londrës, Parisit dhe Berlinit në periferinë e Evropës, pra në Evropën Juglindore, ka qenë i madh – shumë më i madh se ç’janë të vetëdijshme opinionet publike në Evropën Juglindore. Derisa në qarqet akademike të vendeve gjermanishtfolëse, siç janë Gjermania, Austria dhe në pjesën më të madhe Zvicra, Evropës Juglindore vazhdon t’i kushtohet një kujdes, ndonëse jo në atë masë sa rajoneve të tjera të kontinentit, publiku i gjerë deri më tani nuk ka pasur në dorë një manual gjithëpërfshirës mbi historinë e rajonit.

Ndër botimet e pakta duhet të përmendet libri i profesorit të historisë së Evropës Lindore dhe Juglindore, Edgar Hösch-it, mbi historinë e Ballkanit, në të cilin ai saktë, shkurt dhe kuptueshëm skicon zhvillimin historik, shoqëror dhe politik të rajonit. Vepra e Hösch-it, e botuar më 2004, është e hollë, përmban vetëm 128 faqe. Për të arritur te të gjithë lexuesit dhe jo vetëm te rrethet e ngushta akademike historianët Konrad Clewing dhe Oliver Jens Schmitt kanë botuar në nëntor 2011 te shtëpia botuese “Friedrich Pustet” në Regensburg të Gjermanisë një manual të përbërë prej 912 faqesh mbi historinë e Evropës Juglindore (“Geschichte Südosteuropas. Vom frühen Mittelalter bis zur Gegenwart” – “Historia e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta e hershme deri më sot”). Krahas Clewing-ut dhe Schmitt-it në këtë vepër me studimet e tyre janë paraqitur edhe 12 autorë të tjerë, historianë të fuqshave të ndryshme, ekspertë të epokave përkatëse, shkencëtarë që merren me ballkanistikën, sllavistikën, osmanistikën, albanistikën. Kjo ndërmarrje enorme i tejkalon të gjitha botimet në formë doracaku që kanë parë dritën e publikimit deri më sot. Dhe për këtë merita të veçanta kanë Clewing dhe Schmitt, të cilët kanë mbikëqyrur projektin dhe janë përkujdesur për realizimin e tij. Vepra është rezultat i bashkëpunimit mes Institutit Juglindor nga Regensburgu dhe Institutit të Historisë së Evropës Juglindore të Universitetit të Vjenës. Se me çfarë serioziteti i janë qasur editorët

këtij projekti tregon edhe fakti se 40 faqet e para të këtij libri përmbajnë vetëm shpjegime mbi përmbajtjen, mbi theksimin e fjalëve të gjuhëve të Evropës Juglindore, mbi hartat, shkurtesat, konkordancën e toponimeve, të dhënat themelore kronologjike etj.

Që në fillim editorët Clewing dhe Schmitt, duke shpjeguar Evropën Juglindore nga aspekti i hapësirës dhe gjeografisë, theksojnë se shumica e popujve të rajonit nuk janë sllavishtfolës. Evropa Juglindore, sipas autorëve, nuk është “siujdhesë sllave”, ajo krahas kulturës greke dhe për dallim prej hapësirës së tanishme perëndimore dhe jugore sllave është pjesë e pandashme e “botës antike mesdhetare”. Clewing dhe Schmitt shpjegojnë se libri fillon të trajtojë historinë e rajonit nga Mesjeta e hershme për shkak se atëbotë ndodhi një kthesë që më pak kishte të bënte me lëvizjet e popullsive gjermanike dhe më shumë me zaptimin e trojeve nga sllavët dhe depërtimet e popujve të stepave (hunët, avarët, protobullgarët etj.) në atë që sot njihet si rajon i Evropës Juglindore. Ky zaptim shkatërroi civilizimin e vonshëm antik, qytetet dhe kishën e krishterë si bartëse të kulturës. Po ashtu ky zaptim mes shekujve 6 dhe 10 ndryshoi në mënyrë thelbësore përbërjen gjuhësore dhe kulturore të Panonisë dhe të Siujdhesës Ballkanike. Duke iu referuar historianit Edgar Hösch editorët dallojnë katër hapësira kulturore në Evropën Juglindore: 1. një civilizim ballkanik-bizantin me tipare të fuqishme orientale në territoret pranë rrugëve lidhëse; 2. një shoqëri patriarkale në regjionet malore të Ballkanit perëndimor, që karakterizohet nga ideali burror heroik; 3. një kulturë italo-sllave në Adriatik, kryesisht në Dalmaci; 4. një zonë të kulturës së Evropës së Mesme në Panoni si urë lidhëse me Evropën e Mesme.

Periudhën mes viteve 500 dhe 900 në librin “Historia e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta e hershme deri më sot” e trajton historiani i Universitetit të Freiburgut, Gottfried Schramm, ndërsa epokën e Bizantit dhe botën e shteteve të Evropës Juglindore e trajtojnë Günter Prinzing dhe Beatrix F. Romháni. Historiani Oliver Jens Schmitt, i njohur në opinionin shqiptar sidomos me veprat mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Venedikun dhe mbi jetën dhe veprat e Skënderbeut, përshkruan Mesjetën e vonshme në rajon, përfshirë edhe ngritjet dhe rëniet e mbretërve dhe sundimtarëve serbë të asaj kohe, që u pasuan me pushtimin nga një perandori tjetër, ajo osmane. Schmitt si pasojën më afatgjatë të pushtimit osman e sheh islamizimin e pjesëve të konsiderueshme të popullsive të Evropës Juglindore. Por, sipas tij, nuk është e vërtetë ajo që sugjerojnë, ta zëmë, mitet e myslimanëve të Bosnjës se pas ardhjes së osmanëve në Ballkan popullsitë lokale masivisht kaluan në fenë islame. Në punimin e tij të gjithanshëm Schmitt merr parasysh edhe rolin e Hungarisë si dhe zhvillimin e popullsisë dhe ekonomisë, me theks të veçantë bujqësisë, pastaj efektet në jetën urbane etj. Periudhën e konsolidimit të Perandorisë Osmane në Evropën Juglindore (mes shekujve 16 dhe 18) e analizon dhe përshkruan Markus Koller nga Universiteti i Bochumit (në bashkëpunim me Peter Mario Kreuter, bashkëpunëtor shkencor nga Institutin Juglindore në Regensburg). Në fund të kësaj periudhe shihen edhe shenjat e para që paralajmërojnë shkatërrimin e Perandorisë Osmane për shkak

të paaftësisë për reforma, por edhe si pasojë e zgjimeve të para kombëtare në Ballkan.

Profesori nga Berlina Holm Sundhaussen, autor i librit të bujshëm “Historia e Serbisë”, ku trajton historinë e serbëve nga fillimi i shekullit 18-të deri më sot, në kreun e shtatë të manualit “Historia e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta e hershme deri më sot” pasqyron historinë e shoqërisë dhe të kulturës së Evropës Juglindore nga fillimi i shekullit 19-të deri nga mesi i shekullit 20-të, duke shtjelluar modelet shoqërore, fiset dhe fshatrat, kryengritësit socialë dhe plaçkitësit, pastaj banditizmin social dhe fillet e krijimit të asaj që shihej si elitë, e cila më vonë do të përbënte thelbin e shteteve që do krijoheshin dhe të burokracive vendore. Këtu hyn edhe transformimi i sistemeve juridike dhe ndryshimet e zhvillimet në demografi. Shekullin e gjatë të 19-të nga aspekti i zhvillimeve shtetërore e përshkruan historiani Konrad Clewing, zëvendës drejtor i Institutit Juglindor në Regensburg. Në literaturën gjermane shekulli i 19-të quhet i gjatë, sepse llogaritet se shtrihet nga Revolucioni Francez deri në fund të Luftës së Parë Botërore. Gjatë këtij shekulli njëra Perandori e madhe, ajo osmane, bëhet gati të largohet për shkak të presionit gjithnjë e më të madh të popujve që kërkojnë pavarësi, dhe një Perandori tjetër, ajo austro-hungareze, merr nën kontroll disa pjesë në Ballkanit perëndimor. Michael Portmann, bashkëpunëtor i Komisionit për Histori të Akademisë Austriake të Shkencave, ofron – në kreun e nëntë – një histori politike të Evropës juglindore nga viti 1918 deri më 1945 – duke hedhur dritë mbi zhvillimin e secilit vend. Për opinionin shqiptar është me rëndësi që këtu të merret parasysh sidomos pjesa ku Portmann merret me situatën në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai thotë se mes shumë kontradiktave të brendshme në fund arsyeja qendrore pse nuk u arrit pajtimi mes partizanëve dhe ballistëve ishte mospajtimi mbi çështjen e Kosovës. Komunistët shqiptarë, sipas autorit, lëshuan pe nën presionin e Titos, prej të cilit ishin të varur totalisht, dhe hoqën dorë nga kërkesa për “Shqipërinë e Madhe” (Shqipërinë etnike, sipas këndvështrimit shqiptar). Për këtë arsye shqiptarët jashtë asaj që mund të quhej “Shqipëri e vjetër” (“Albanien”) nuk i dhanë më mbështetje lëvizjes partizane.

Në pjesën përfundimtare Ulf Brunnbauer, profesor i historisë së Evropës Juglindore dhe Lindore në Universitetin e Regensburgut si dhe drejtor i Institutit Juglindor, skicon zhvillimin politik të Evropës Juglindore nga viti 1945 deri më 1989/91. Brunnbauer shkruan se pas sukseseve në luftë kundër nazizmit lëvizjet partizane e komuniste fillimisht u koncentruan në eliminimin e rivalëve politikë. Në Jugosllavi deri në vitin 1947 u shkatërruan partitë politike jokomuniste. Njëjtë ishte edhe në Shqipëri. Atje Partia Komuniste në verë të vitit 1943 kishte një 700 anëtarë, në vitin 1944 rreth 2800, pra fare pak për një lëvizje që, siç propagandohej, paskësh qenë gjithëpopullore. Numri i komunistëve shqiptarë u shtua dhe shumëfishua tek pas luftës, duke arritur në 45 mijë në vitin 1948.

Në prezantimin e librit në faqen e saj në internet shtëpia botuese “Friedrich Pustet” bën të ditur se lexuesit po i ofrohet një pasqyrë e ndërlidhjeve të përgjithshme rajonale, rëndësia e të cilave mund të shpjegohet edhe kur shikojmë Peran-

doritë e mëdha (Bizantin, Habsburgun, Osmanët), të cilat me shekuj e kanë sunduar këtë rajon. Këtë premtim e kanë përmbushur editorët dhe autorët: vepra e tyre është një pasqyrë mbi zhvillimin historik, politik, kulturor dhe shoqëror të Evropës Juglindore – një rajoni që rrallë u sundua nga banorët e tij, ku kombi e feja, te pjesa më e madhe e popujve, luajtën rol të përbashkët, nganjëherë edhe fatal, dhe ku dhuna e ushtruar ndaj kombeve të tjera arsyetohej me të kaluarën. E kaluara qëndron si hije edhe sot mbi Evropën Juglindore. Sidomos në Ballkanin perëndimor, ku mungesa e infrastrukturës rrugore dhe urbane janë trashëgimi i sundimit osman. Trashëgimi e komunizmit mbetet shoqëria pa traditë demokratike, e cila s’e gjen vetin ende brenda kornizave të shtetit modern për shkak se për 50 vjet jo pak gjenerata janë edukuar në frymën e brohoritjes dhe nënshtrimit. Trashëgimi e luftërave të fundit në Ballkan mbetet ballafaqimi i drejtësisë me përgjegjësit politikë. Me trashëgimi të tilla popujt e Evropës Juglindore ende kanë shumë punë për të bërë derisa të sigurojnë paqen dhe të rrisin gjasat për integrim thelbësor në familjen evropiane.

Libri “Historia e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta e hershme deri më sot”, edituar nga historianët Konrad Clewing dhe Oliver Jens Schmitt, është një kontribut i vlefshëm për debatet mbi të kaluarën në Ballkan dhe mund të shërbejë si bazë e mirë që të nxirren leksione për të ardhmen. Duke qenë i tillë ky libër meriton vëmendje jo vetëm nga rrethet akademike në Prishtinë e Tiranë, por edhe nga të gjithë ata që (ndër)hyjnë në debate historike dhe politike.

Enver Robelli, Zürich

KOSOVA (Vështrim monografik), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, ff. 1-646. Në shtojcë një hartë e Kosovës, në shkallë 1:250 000.

Monografitë, leksionet dhe enciklopeditë mund të jenë të karakterit të përgjithshëm dhe të specializuar. Të specializuara janë p. sh. botimet e arkitekturës, të pikturës, të muzikës, të arkeologjisë, të mjekësisë, të filozofisë, të gjuhësisë etj., kurse publikimi Kosova – vështrim monografik është i karakterit të përgjithshëm, por mjaft specifik, sepse në të janë përfshirë disa fusha dhe probleme qenësore për Kosovën dhe të vërtetën e saj në të kaluarën dhe sot. Kjo është monografia e parë e këtij lloji në Kosovë dhe më gjerë. Kudo në botë botimet e tilla përgatiten kryesisht nga institucionet e veçanta shkencore dhe kulturore, të mbështetura nga vetë shteti. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, si institucion më i rëndësishëm i shkencave dhe i arteve, i hyri një pune të mundimshme dhe të guximshme, por shumë të vlefshme për hartimin dhe nxjerrjen në dritë të kësaj monografie, e cila përgjithësisht u prit shumë mirë nga të gjitha pjesët e opinionit.

Botimi plotësoi një nevojë të madhe shkencore, kombëtare, popullarizuese dhe informative për Kosovën dhe realitetin e saj. Në parathënien e redaksisë, përveç tjerash, thuhej se “botimi duhej të kishte natyrë shkencore sa u përket të dhënave dhe interpretimit të tyre, informative dhe të integruar në tërësinë dhe enciklopedike sa i përket paraqitjes. Krijimi i bazës së të dhënave jo rrallë e jo për pak fusha dilte një çështje me peshë, ndërsa nevoja për t’i dhënë lexuesit një botim që do të përmbushte në një shkallë mungesën e botimeve enciklopedike erdhi e u bë njësoj e rëndësishme për hartimin e botimit. Kështu doli i domosdoshëm kombinimi i prosedeeve të ndryshme për hartimin e monografisë: vështrimi shkencor si themel për të dhënat dhe interpretimin e tyre, në një anë, dhe paraqitja shpesh publicistike, ndonjëherë popullarizuese, në anën tjetër. Jo çdo herë baraspesha ishte e lehtë”.

Këshillin bashkërendues e organizoi punën, i vendosi kriteret e përgjithshme dhe synimet e botimit, propozoi përbërjen e redaksisë dhe përcaktoi parametrat e financimit. Këtë këshill e përbëjnë akademikët Mehmet Kraja nga Seksioni i Gjuhësisë dhe Lertërsisë (udhëheqës i Këshillit), akademik Hivzi Islami nga Seksioni i Shkencave Shoqërore, akademik Feriz Krasniqi nga Seksioni i Shkencave të Natyrës dhe akademik Rexhep Ferri nga Seksioni i Arteve. Puna është organizuar dhe botimi është përgatitur në kushte mjaft të vështira, para së gjithash financiare dhe hapësinore, në ndërtesën e vjetër (në një hapësirë 2 X 3 metra katrore). Pjesa më e madhe e zërave është hartuar në stilin dhe frymën monografiko-enciklopedike, por të shkruara me një ekonomi gjuhësore, pra shkurt, dendur dhe qartë.

Redaksia sipas fushave përbëhet nga akademik Hivzi Islami për gjeografi, dr. Fehmi Rexhepi për histori, anëtar i korresp. Isa Mustafa për ekonomi, akademik

Jashar Rexhepagiq për arsim dhe shkencë, dr. Isuf Dedushaj për shëndetësi, akademik Mehmet Kraja për kulturë, akademik Esat Stavileci për zhvillimet politike dhe shoqërore dhe mag. art. Afrim Spahiu për fotografi. Kryeredaktorë janë akademikët Rexhep Ismajli dhe Mehmet Kraja, redaktorë akademikët Feriz Krasniqi, Pajazit Nushi, Hivzi Islami, Eqrem Basha dhe Mehmet Kraja. Lektura gjuhësore është bërë nga mr. Shefqet Riza, dizajni nga Edi Agagjyshi dhe harta e Kosovës në shkallë 1:250 000 nga Ismail Gagica.

Ideja themelore ishte që të përfshiheshin në një botim të dhënat qenësore të përgjithshme nga fushat kryesore. Këshilli bashkërendues dhe nivelet e tjera të redaksisë së Akademisë kishin bërë gjithçka për t'i harmonizuar shkrimet e autorëve të fushave të ndryshme, gjithnjë duke ruajtur thelbin objektiv, shkencor dhe autorësinë e secilit ekspert. Është tashmë fakt i njohur se puna ekipore në këto lloje të publikimeve është e vështirë dhe merr shumë kohë derisa ta shohin dritën, por Akademia arriti që këtë projekt ta përfundojë brenda më pak se 4 vjetësh.

Pas një parathënie të redaksisë, gjithë materia është e shtrirë në shtatë fusha, me 56 autorë dhe 69 zëra. Siç thotë edhe vetë redaksia në parathënie, numri i zërave do të shtohet sikur të ishte koha më e gjatë e hartimit dhe e botimit të monografisë. Është për lakmi edhe përgatitja tekniko-grafike dhe ilustrative e këtij botimi: aty janë përfshirë fotografi të shumta, disa të rralla, që gjithsesi ia shtojnë vlerën dhe e bëjnë publikimin më të përdorshëm dhe më të dokumentuar për lexuesit e shtresave të ndryshme. Më poshtë po e japim pasqyrën e fushave, të zërave dhe autorëve të tyre:

1. *Gjeografia* (redaktor akademik Hivzi Islami): Pozita gjeografike, Karakteristikat gjeologjike dhe Karakteristikat morfologjike e pedologjike (dr. Vahdet Pruthi); Ujërat dhe Klima (dr. Ruzhdi Pllana); Fauna (dr. Esad Dauti); Flora dhe Vegjetacioni (akademik Feriz Krasniqi); Mjedis (dr. Zeqir Veselaj); Vlerat e trashëgimisë natyrore (dr. Ruzhdi Pllana); Tipet dhe funksionet e vendbanimeve (dr. Ibrahim Ramadani); Qytetet (dr. Jusuf Osmani); Popullsia dhe diaspora (akademik Hivzi Islami) dhe Femra (dr. Mimoza Dushi).

2. *Historia* (redaktor dr. Fehmi Rexhepi): Parahistoria dhe antika (dr. Edi Shukriu); Mesjeta (dr. Pëllumb Xhufi); Pushtimi osman (dr. Ferid Duka); Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1978-1881 (dr. Jusuf Bajraktari); Zhvillimet pas Lidhjes së Prizrenit (akademik Kristaq Prifti); Lëvizja kombëtare 1908-1912 (dr. Jusuf Bajraktari); Nën sundimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë (dr. Lush Culaj); Në Luftën e Dytë Botërore dhe Lëvizja Çlirimtare dhe lufta për pavarësi (dr. Fehmi Rexhepi).

3. *Zhvillimet politiko-juridike* (redaktor akademik Esat Stavileci): Historia politike e çështjes (akademik Esat Stavileci); Historia kushtetuese (dr. Arsim Bajrami); Administrimi ndërkombëtar (akademik Esat Stavileci); Shtet sovran dhe i pavarur (dr. Arsim Bajrami).

4. *Ekonomia* (redaktor anëtar i korrespondent i ASHAK-ut Isa Mustafa): Zhvillimi ekonomik deri në vitin 1999 (anëtar i korrespondent Isa Mustafa); Ecuritë sipas degëve ekonomike (akademik Minir Dushi, anëtar i korrespondent Isa Mustafa).

dhe dr. Behxhet Brajshori); Sektori privat dhe publik (dr. Petrit Gashi dhe mr. Besnik Krasniqi); Sektori financiar (dr. Gazmend Luboteni dhe dr. Valentin Toçi); Tregu i punës dhe emigracioni (dr. Avdullah Hoti); Bujqësia, blegtoria, pylltaria (akademik Latif Susuri dhe dr. Skender Kaçi); Faktorët e rritjes ekonomike (dr. Muhamet Mustafa).

5. *Arsimi dhe shkenca* (redaktor akademik jashar Rexhepagiq): Arsimi deri në vitin 1945 (dr. Abdullah Vokri); Edukimi parashkollor (Halim Hyseni); Arsimi filleor dhe Arsimi i mesëm (dr. Bajram Shatri); Arsimi i lartë dhe Arsimi i të rriturve (dr. Hajrullah Koliqi); Zhvillimet shkencore (akademik Rexhep Ismajli).

6. *Shëndetësia* (redaktor dr. Isuf Dedushaj): Historia e mjekësisë (dr. Isuf Dedushaj); Kujdesi parësor shëndetësor (dr. Valdet Hashani); Kujdesi dytësor shëndetësor (dr. Bedri Zahiti); Kujdesi tretësor shëndetësor (dr. Avdyl Krasniqi); Shëndetësia publike dhe qendrat rehabilituese (dr. Naser Ramadani).

7. *Kultura* (redaktor akademik Mehmet Kraja): Trashëgimia kulturore (dr. Edi Shukriu); Arkitektura popullore (akademik Mark Krasniqi); Arkitektura e qyteve (akademik Emin Riza); Etnografia (Shpresa Siqeca); Letërsia popullore (dr. Sadri Fetiu); Etnomuzikologjia (dr. Rexhep Munishi); Zejet (Shpresa Siqeca); Gjuhët (akademik Rexhep Ismajli); Letërsia shqipe (akademik Ali Aliu); Letërsia në gjuhët sllave (Ismet Markoviq-Plavnik); Letërsia turke (dr. Irfan Morina); Muzika (akademik Zeqirja Ballata dhe akademik Engjëll Berisha); Artet pamore (Mustafa Ferizi); Teatri (Fadil Hysaj); Kinematografia (Gani Mehmetaj); Libri dhe bibliotekat (dr. Sali Bashota); Informimi (dr. Ibrahim Berisha); Religjioni dhe toleranca fetare (akademik Pajazit Nushi dhe dr. Anton K. Berishaj); Sporti (Xhavit Kajtazi).

Në fund jepet një bibliografi, më e plotë deri tash, e hartuar nga akademik Rexhep Ismajli dhe autorët e ndihmesave.

Për çdo botim tjetër mund të priten lavdërime dhe shkrime afirmative, kurse mundësia për t'u lavdëruar monografitë a enciklopeditë apo botimi krejtësisht i veçantë, të cilin po e prezantojmë, gjithnjë është më e vogël: disa preken pse nuk janë angazhuar për të shkruar pjesë të tyre, disave u mbetet hatri pse nuk u është përmendur emri në ndonjë fushë etj. Natyra e shkrimeve të shkurta, përmblendhëse, ndonjëse është premisë e domosdoshme për popullarizimin e përgjithshëm të së vërtetës shkencore dhe afirmimin dhe përhapjen e kulturës themelore kombëtare, rrallë i kënaqin të gjithë profesionistët e dijeve të ndryshme, por edhe lexuesve të rëndomtë u bie radha të shprehin paknaqësi e kaprice nga më të ndryshmet.

Në fund, mund të thuhet se me daljen në dritë të botimit “KOSOVA – Vështrim monografik”, është bërë një punë shumë e vlefshme falë angazhimit, mundit dhe dijes së pakursyer të Këshillit bashkërendues, redaktorëve, kryeredaktorëve dhe autorëve e bashkëpunëtorëve tij. Prandaj mund të konsiderohet një vepër me vlerë monumentale për Kosovën dhe qytetarët e saj, veçanërisht për kulturën shqiptare. Me tërë materien e përfshirë, botimi mund t'u shërbejë profesionistëve, brezave të reja, studentëve dhe opinionit të gjerë lexues që të kenë një pasqyrë të drejtë shkencore për një mori çështjesh e zhvillimesh për Kosovën. Është botimi më i mirëse-

ardhur për çdo familje shqiptare. Me botimin “Kosova” është krijuar një bazë solide, një mbështetje që dijetarët e ardhshëm të mund të shkruajnë ndonjë enciklopedi a monografi më të plotë e më të mirë për Kosovën dhe shqiptarët.

Shefqet Riza, Prishtinë

Τίτος Π. ΓΙΟΧΑΛΑΣ, **Η ΑΡΒΑΝΙΤΙΑ ΣΤΟ ΜΟΡΙΑ – ΧΡΟΝΙΚΑ ΠΟΡΕΙΑΣ. τ. Α' + Β'.** Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα 2011, [Titos P. Johalas, *Arvanitasit në Morë – kronika rrugëtimi*. Vëll. A + B, f. 950 + CD. Botimet Pataqi, Athinë 2011].

Pesë vjet pas botimit të veprës dyvëllimshe kushtuar arvanitishtes së ishullit të Hidrës², albanologu i mirënjohur Titos Johalas ka vënë një tjetër gur themeli në serinë e kontributeve të çmuara të tij për elementin arbëror të Greqisë³, duke u zhvendosur kësaj here nga të folmet arvanitase ishullore (Andros, Eube, Hidra) në ato të siujdhezës së Peloponezitetit të “së bukurës Morë”.

Siç shkruhet në shënimin hyrës, kjo vepër është “kronikë e një rrugëtimi të dyfishtë”. Nga njëra anë, është vetë autori që, për vite me radhë, “u end në vatrat më të rëndësishme arvanitofone të Morësë, në Lakoní, Mesení, Argolidë ... dhe Korinti⁴”, ku mbledhi “toponimet e fshatrave, mbiemrat e banorëve, bestytinitë, rrëfenjat, këngët dhe vajet, botën mbarë të tyre”. Nga ana tjetër, lënda e botuar është pasqyrë e “zhvillimeve sociolinguistike të fshatrave (dikur) arvanitofone të Peloponezitetit”, e një situatë socio-linguistike që “tashmë ka ndryshuar rrënjësisht”. Libri, vazhdon autori, “përmban elemente të kulturës popullore, dhe po të marrim parasysh që greqishtja dhe shqipja janë dy gjuhë që fliten qysh së lashti në trojet ballkanike e se arritën të mbijetojnë, atëherë do të rrokim më mirë rëndësinë që kanë për shkencën gjuhësore (dhe jo vetëm për atë) të

² Τίτος Π. Γιόχλας, *Υδρα – Αημεμονημένη γλώσσα*. τ. Α' + Β'. Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα 2006, [Titos P. Johalas, *Hidra – Gjuha e harruar*. Vëll. A + B. Botimet Pataqi, Athinë 2006]. Shih edhe recensionin tonë në *Hylli i Dritës* 3 (258) 2008.

³ Përmendim ndër të tjera *Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland*, në *Dissertationes Albanicae*, München 1971, *Αλβανολογία και ερασιτεχνισμός. Αποκατάσταση αρβανίτικων κειμένων*, Αθήνα 1988 [Albanologjia dhe diletantizmi. Rehabilitim tekstesh arvanitase, Athinë 1988], *Αρβανίτικα παραμύθια και δοξασίες – Νεράιδες, δαίμονες, ζόρκια, ψυχιάσματα*, Αθήνα 1997 [Përralla dhe bestytini arvanitase - Shtojzovallë, demonë, yshije, namatisje, Athinë 1997], *Ανδρος - Αρβανίτες και Αρβανίτικα*, Αθήνα 2000 [Andros – Arvanitasit dhe Arvanitishtja, Athinë 2000], *Εύβοια – τα Αρβανίτικα*, Αθήνα 2004 [Eubeja – Arvanitishtja, Athinë 2004]. Shih edhe recensionin tonë në *Albanohellenica* 2 (2000-2001). Shtojmë se vepra e Johalas-it rrok edhe fusha të tjera të albanologjisë, siç duket edhe nga titujt vijues: *Ο Γεώργιος Καστριώτης - Σκεντέρμπεης εις την Νεοελληνικήν Ιστοριογραφίαν και Λογοτεχνίαν*, Θεσσαλονίκη 1975, β' έκδ. Αθήνα 1994 [Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në historiografinë dhe letërsinë e re greke, Selanik 1975, bot. i dytë Athinë 1994], *Το Έλλην - Αλβανικόν Λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη. Φιλολογική έκδοσις εκ του αυτογράφου*, εν Αθήναις 1980, β' έκδ. Αθήνα 1993 [Fjalori Greqisht – Shqip i Marko Boçarit, botim filologjik i autografit, Athinë 1980, bot. i dytë Athinë 1993], *Στοιχεία ελλην - αλβανικής γραμματικής και ελλην - αλβανικοί διάλογοι. Ανέκδοτο έργο του Ιωάννη Βηλαρά. Φιλολογική έκδοσις από τον αυτόγραφο κώδικα της Εθνικής Βιβλιοθήκης των Παρισίων*. Θεσσαλονίκη 1985 [Elemente të gramatikës greko – shqiptare dhe dialogje greqisht – shqip. Vepër e pabotuar e Jan Vilarit. Botim filologjik i kodikut autograf të Bibliotekës Kombëtare të Parisit. Selanik 1985], *Ελληνικά επώνυμα, ονόματα και τοπωνύμια των αλβανικών κοινοτήτων της Κάτω Ιταλίας και της Σικελίας*, Αθήνα 1993 [Mbiemra, emra dhe toponime greke të komuniteteve arbëreshe të Italisë së Poshtme dhe të Sicelisë, Athinë 1993], “Considerazioni sull' elemento Greco nell' arbëresh”, në *I dialetti Italo-Albanesi*, Roma 1994, *Αλβανο-Ιταλικά*, Αθήνα 1996 [(Studime) Albano-Italiane, Athinë 1996], *Στη γη του Πύρρου, Διαχρονικός Ελληνισμός στην Αλβανία*, κείμενα: Τίτος Π. Γιόχλας, φωτογραφίες: Λίζα Έβερτ, Αθήνα 1993 [Në dheun e Pirros. Helenizëm diakronik në Shqipëri, tekstet: Titos P. Johalas, fotografite: Liza Evert, Athinë 1993].

⁴ Autori sqaron se nuk ka mbledhur lëndë nga rajoni i Ahajjës. Ndërkaq ka përfshirë një shtojcë me material prej fshatit Perahóra të Korinitit, që ndonëse gjeografikisht nuk i përket Peloponezitetit, gjuhësisht lidhet me të folmet arvanitase të Moresë.

folmet arvanitase të vendit tonë [Greqisë], më së shumti të keqkuptuara e më së shpeshti të përçmuara e të përbuzura (deri edhe nga ata që i flasin)” (f. 19).

Vepra nyjëtohet në dy vëllime, prej të cilëve i pari përmban një varg të gjatë tekstesh të regjistruara nga autori në vise të ndryshme të Peloponezit, shoqëruar me përkthimin integral në greqisht dhe me shënime sqaruese. Pa hyrë në hollësi dhe pa bërë fjalë për kohën e mundin që janë dashur për zbardhjen e teksteve, mund të themi plot gojën se *kemi të bëjmë me një materie gjuhësore me densitet të papërsëritshëm e larmi të pashoqe, më të pasurën e më kompleksen nga çka njohim deri më sot në këtë lëmë*, e cila përbën dëshminë më autentike e më rrëzëllitëse të “vërshimit” arbëror në viset helene, në Thesali, Beoti, Eube, Andros, Atikë, e më pas në Peloponez, e prej këtu në Italinë e Jugut (“O e bukura Moré...”). Kjo pasuri e jash-tëzakonshme lidhet sigurisht me rrethanat specifike gjeografike, historike dhe socio-linguistike të Peloponezit, ku, me sa duket, kanë zbritur valë të herë-pas-hershme folësish të shqipes mesjetare, të cilat ose u mbivendosën në të njëjtat territore ose u ngulën në rajone të ndryshme të Moresë.

Lënda e paraqitur bazohet në përshkrimin e çasteve kulmore të jetës së njeriut (lindja, martesë, vdekja) dhe të anëve më të rëndësishme të kulturës materiale (gati-mi dhe pjekja e bukës, zënia e djathit, vjelja e rrushit dhe nxjerrja e verës, mjekësia tradicionale, etj.) e shpirtërore (përralla, rrëfenja e këngë, bestytini etj.) të tij. Interesante janë gjithashtu rrëfimet në vetën e parë të ngjarjeve që janë skalitur thellë në kujtesën e njerëzve të thjeshtë. Në një numër rastesh, autori, gjatë viteve 1981-89, pati fatin të vjelë lëndë gjuhësore prej subjekteve që duket se vijnë nga thellësitë e shekujve e që s’janë prekur pothuajse fare prej jetës moderne. Vini re, p.sh., mënyrën si e përshkruajnë *tënëzonë* (‘qiellin’) këta bij të vërtetë të natyrës:

Në inëzot shomë shumë punë. Shomë shëgjezënë, shomë parmendëzënë, shomë illë të ditësë, shomë edhe ljumënë, çë e pret tënëzonë në mes. Ia thomi ljumi inëzotit. (f. 214).

Në shënimet hyrëse të çdo kreu, pas të dhënave historike për ngulimet arvanitase, autori paraqet në mënyrë të përmbledhur e jo shteruese edhe disa nga tiparet dalluese për secilën prej të folmeve që përshkruan. Kreu I (f. 23 – 88) u kushtohet fshatrave arvanitofone në Záraka të Lakonisë, në të cilat janë ruajtur grupet *bl*, *gl*, *kl* dhe bashkëtingëlloret *rr* e *ll*, ndërsa diftongu *ua* theksohet në përbërësin e dytë të tij: *gruá*, *duártë* etj. (f. 42). Kreu II (f. 89 – 130) përmban lëndë nga fshatrat e Mesenisë, ku bie në sy prania e pjesoreve më *-ójturë* në vend të *-úarë*, pjesëzat *o* dhe *to* të së ardhmes, pjesëza *tóko* e gerundit, parafrasa *ka* në vend të *nga*, konstrukti *ka ndë Rripësi* ‘nga Rripësi’ si përgjigje ndaj pyetjes *ka ku jeni?* (të cilin autori e konsideron “të vështirë për t’u shpjeguar” dhe që mendojmë se lidhet me gr. από ποῦ εἴστε; si dhe εἶμαι από τη Πίπεση / πάω στη Πίπεση = jam **ka** Rripësi / shkonj **ndë** Rripës), konstruktet *atia burrit* / *asáne grúasë*, të cilat shihen si “jo të rregullta gramatikisht”, etj. Në kreun III përshkruhet arvanitishtja e Argolidës, e cila edhe për nga numri i faqeve (f. 131 – 479) zë vend qendror në vepër, ngaqë, siç shënon autori, “asnjë tjetër rajon i vendit [Greqisë], ku mbijetoi arvanitishtja, nuk na ofron një

larushi kaq të pasur trajtash dialektore dhe dukurish fonetike e morfologjike” (f. 131). Mes tyre veçohen mbizotërimi i diftongut *-úo* në fshatrat rreth Argosit, mbarresa *-nja* e së pakryerës, parafjala *në* me emërore (*në aj véndi*), trajtat përemërore *náve*, *návenë* ‘ne’, *énë* ‘unë’, *tinë* ‘ti’. Sipas autorit, “fshatrat arvanitofone të Ermionidës, Trizinisë dhe të Methanës paraqesin një ‘alergji’ të përgjithshme ndaj përdorimit të *ll-së*, që bjerret ose shndërrohet në *u* ose *v* (apo edhe *gh* në krye të fjalës), dhe që shtrihet deri në fshatrat e Korintisë jugore si Ajáni dhe Athíqia. E njëjta dukuri vërehet gjithashtu në Hidra dhe Speces dhe ... dëfton afrinë e ngushtë ‘prej gjaku’ të speco-hidriotëve me popullsinë shqipfolëse të rajonit më të gjerë të Ermionidës lindore” (f. 131 - 132). Katundet arvanitofone të Korintisë përshkruhen në Kreun IV (f. 480 – 515). Vëllimi I mbyllet me lëndën e mbledhur në Perahóra të Korintisë, prej së cilës po japim fragmentin e mëposhtëm:

Tërë javënë ishinë e këndojnë. Tërë javënë! [...] Të shtunë ghambrói [=dhëndri], atë të javënë nuku vej fare ne nusea. Po vej ne nusea, e grrapinë vashazit, shtrojnë një skorsë përdhënë edhe e dhiplósinë [=mbështillnin] në skorsë bërðha! (Ish një enë [=rrobë] gha dhi, meleshë të dhirë). E vijnë atje bërðha, ku të vej ghambrói? Edhe kanonísinë [=merreshin vesh] të vej të shtunë. Të shtunë vej ghambrói, me shokëtë, me órganatë [=veglat muzikore], me tërëve. Edhe bëjnë një trapéz ne nusea, tërë natënë! (f. 530).

Duke shfletuar faqet e librit dhe duke kaluar nga njëra hapësirë në tjetrën të bën përshtypje karakteri konservativ dhe arkaik, por edhe risitë apo trajtat hibride të përfuara nën tryshninë e greqishtes. Është një spektër i gjerë dukurish që mund të bëhen objekt studimesh të disiplinave të ndryshme gjuhësore duke filluar nga historia e gjuhës e dialektologjia deri te gjuhët në kontakt dhe sociolinguistika. Sa për të krijuar një ide, po përmendim faktin se në tekstet e Moresë kemi hasur konstrakte si *Jeshënë e rruajnë dhen* (f. 318) dhe *Tërë javënë ishinë e këndojnë* (f. 530), që deri më sot janë venduar në të folmet arbëreshe (shih, ndër të tjera, W. Breu, *Forme verbali perifrastiche arbërisht* në (F. Altimari e L. M. Savoia) *Dialetti Italo-Albanesi*, Bulzoni editore, Roma 1994). Po kështu, nëse rënia e *ll-së* ndërzanore apo shndërrimi i saj në *gh*, *f*, *r*, *v* dhe *u* konsideroheshin prej autorit si veçori të së folmes arvanitase të ishullit Hidra, tani, me lëndën e re, duket se ky tipar u bart prej banorëve të ardhur në ishull nga viset lindore të Peloponezit, ku *ll-ja* ka patur të njëjtin fat. Ky konstatim bëhet edhe më interesant po të mbahet parasysh se *ll-ja* e trojeve kompakte të shqipes nuk njih zhvillime të ngjashme dhe se, nga ana tjetër, ato hasen në disa nga të folmet arvanitase të Peloponezit dhe pjesërisht në të folmet arbëreshe. Për sa i përket origjinës së kësaj dukurie, çështja zhvillim i brendshëm apo i shkaktuar nga faktorë të jashtëm kërkon shqyrtim të mëtejshëm. Megjithatë, fakti që kemi zhvillime të ngjashme në cakonishten, dialekt tejet arkaik i greqishtes dhe vazhdues i dorishtes së Lakonisë, e lë të hapur mundësinë që arvanitishtja e trojeve lindore të Peloponezit të jetë ndikuar nga gjuha anase në kuadrin e gjuhëve në kontakt, e mandej të ketë shtegtuar tek arbëreshët në motet kur këta lanë pas Morenë e përmallshme. Në këtë pikë ia vlen të përmendet edhe rasti i fjalës arvanitase *kërkë* ‘këngë’, të cilën Johalas-i e jep për arvanitishten e Argolidës, ndërsa N. Liosis e ven-

don me këtë kuptim edhe në Lakoni dhe e lidh bindshëm me dorishten *καναχά* 'tingull' (N. Λιόσης, *Ετυμολογικές παρατηρήσεις στα αρβανίτικα* [Vëzhgime etimologjike në të folmet arvanitase], *Albanohellenica* 4 (2011) 22).

Vëllimi II përmban tre glosarë të të folmeve arvanitase të Moresë, të cilët, edhe pse shtrihen në rreth 350 faqe (f. 559 deri 904), nuk pasqyrojnë shterueshëm lëndën e teksteve të vëllimit I, por përfshijnë gjithashtu edhe fjalë të regjistruara prej autorit, të cilat nuk gjenden në tekstet e botuara. Në po këtë vëllim gjenden treguesit e emrave të fshatrave dhe të personave prej nga është vjelë lënda e botuar, bibliografia e përdorur dhe lista e punimeve-botimeve të autorit.

Në vazhden e një tradite të mëparshme dhe falë mundësive që ofron teknologjia e sotme, vëllimi II shoqërohet edhe nga një CD ku gjendet e regjistruar lënda e pasqyruar/zbardhur në vëllimin I. Është një "dhuratë" e çmuar, që mundëson ndërmarrjen e punimeve edhe në fusha të tjera, si fonetika e fonologjia, pa qenë kurdoherë e nevojshme kryerja e vëzhgimeve apo regjistrimeve *in situ*.

Me daljen në dritë edhe të kësaj vepre, si dhe të kontributeve të tjera të pritshme të Johalas-it, zënë e ravijëzohen gjithnjë e më qartë tiparet e të folmeve arvanitase dhe krijohen dalngadalë kushtet për hartimin e një vepre sintetizuese e përgjithësuese⁵, që ndoshta do të shërbente si një shtojcë e ADGJSH, duke plotësuar mangësitë e mundshme të tij, por edhe duke u plotësuar ajo vetë në kuadër të dialekteve të mbarë shqipes.

Njëkohësisht, është koha të mendohet seriozisht për hartimin e një fjalori të të folmeve arvanitase, bazuar kryesisht në lëndën e mbledhur nga Johalas-i, por edhe në burime të tjera, më të hershme a më të vona.

Së fundi, ia vlen të vihet në dukje përkujdesja e posaçme e autorit për paraqitjen grafike dhe fotografike të lëndës dhe të bartësve të saj. Shfletimi i veprës të jep kënaqësi estetike të veçantë, duke filluar që nga ballinat e duke u futur në brendësi të vëllimeve. Në pjesën e brendshme të kopertinës së pasme të vëllimit I, autori ka vënë një pikturë me titull "Οι Αλβανοί χορεύοντες" (Shqiptarët duke hedhur valle) të piktorit të njohur popullor grek Theofilos, datuar më 1932, e cila tregon sa të ndërkallura janë bota greke dhe ajo shqiptare dhe sa punë mbetet për t'u kryer akoma për t'i nxjerrë në dritë këto lidhje të qëmoçme.

Edhe me raste të tjera e kemi theksuar sa e dobishme do të ishte nëse, me dëshirën e mirë për t'i bërë të njohura në një rreth më të gjerë të interesuarish, do të ndërmerrej, me miratimin dhe nën drejtimin ndoshta të vetë autorit, ribotimi i këtyre teksteve posaçërisht për lexuesit e trojeve shqipfolëse. E them këtë sepse mosnjohja e greqishtes e vështirëson dhe shpesh e bën të pamundur leximin (dhe shfrytëzimin) e lëndës nga ata që, tek e fundit, kanë qenë krijuesit diakronikë të saj.

Po qe se ky sugjerim ndesh në vështirësi të natyrës praktike, duhet parë mundësia që, së paku në botimet e ardhshme, fjalët, shprehjet a konstruktet e greqishtes

⁵ Për fat të keq, projekti ambicioz i H. J. Sasse-s, nisur me vëllimin I të veprës *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*. Teil 1. Otto Harrassowitz - Wiesbaden, 1991, ka mbetur deri më sot i papërbushur.

që hasen në tekstet origjinale të arvanitishtes, të shoqërohen me shënime a përkthime filluese. Është një punë që kërkon kohë shumëfish më të pakët nga ajo që i është dashur autorit për përkthimin e teksteve në gjuhën greke dhe që do të siguronte një numër shumëfish më të madh lexuesish të veprës.

Do të desha ta mbyll këtë paraqitje të shkurtër të veprës së Johalas-it me një urim të nxjerrë mes teksteve të mbledhura prej tij: “*Të jetë hekurimtë*” (f. 534) e të mos e ndalë rrugëtimin drejt Itakës së tij (dhe tonës), “gluhësë dhe botësë arbërore”.

Dhori Q. Qirjazi, Universiteti i Selanikut

Ibrahim RAMADANI, **MJEDISI JETËSOR. Roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva**, Prishtinë, 2011, ff. 417.

Rritja e shpejtë e numrit të popullsisë botërore dhe tendencat për të siguruar e përmirësuar mirëqenien sociale dhe ekonomike përmes zhvillimit të industrisë, bujqësisë dhe degëve tjera të ekonomisë shkaktojnë shpenzimin e resurseve natyrore dhe ndotjen e mjedisit jetësor. Andaj njëra nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet sot shoqëria njerëzore është tendenca për të mbrojtur resurset natyrore dhe për të siguruar një mjedis të shëndoshë jetësor. Kosova si një shtet i ri dhe në fazën e konsolidimit përpos problemeve të shumta të natyrës sociale dhe ekonomike përballlet edhe me problemet mjedisore të cilat tanimë paraqesin një brengë alarmuese. Një kusht shumë i rëndësishëm për përballjen e suksesshme të shoqërisë kosovare me problemet mjedisore është njohja e opinionit profesionist dhe atij më të gjërë mbi konceptet teorike të mjedisit jetësor, ligjshmëritë ekologjike, baraspeshën evolutive në mes sistemeve natyrore, zhvillimin e qëndrueshëm si paradigmë e shoqërisë moderne, metodat dhe strategjitë për një menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mjedisit jetësor, aktivitetet në rrafshin ndërkombëtarë të opinionit shkencor dhe qeveritar për zgjidhjen e problemeve mjedisore etj.

Libri “Mjedisi Jetësor – Roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva” i autorit Dr. Ibrahim Ramadani, profesor i asociuar në Departamentin e Gjeografisë të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës i ndihmon shumë arritjes së qëllimeve të lartpërmendura dhe paraqet një hap shumë të guximshëm e serioz për të përmbushur një boshllëk të kahmotshëm që ka ekzistuar në literaturën shkencore kosovare dhe në përgjithësi shqiptare mbi çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me resurset natyrore dhe mjedisin jetësor. Libri ka 417 faqe tekst, i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme dhe i dokumentuar me 65 figura, 20 grafikone dhe 32 tabela.

Libri është rezultat i përvojës së begatshme akademike në mësimdhënie dhe i një numri të konsiderueshëm të punimeve shkencore dhe profesionale të cilat autori i ka botuar brenda dhe jashtë vendit përkitazi me këtë fushë studimi. Konceptet teorike, ligjshmëritë natyrore-ekologjike, sferat natyrore dhe ekosistemet, strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konventat ndërkombëtare, së bashku me një bibliografi të pasur, paraqesin një tërësi të përsosur, e cila lehtë përcillet, mbahet në mend dhe interpretohet.

Në pjesën e parë të librit autori shtjellon pikëpamjet e ndryshme mbi mjedisin, ku përfshihen kuptimet e nocioneve dhe terminologjisë, faktorët ekologjikë në mjedis, dimensionet themelore të gjeohapësirës dhe elementet natyrore në organizimin shoqëror. Në pjesën e dytë flitet për ekologjinë në sistemin e shkencave të natyrës, objektin e studimit, ndarjen e ekologjisë në disiplina të veçanta duke u fokusuar tek Ekologjia Humane, objekti i saj i studimit dhe njësitë organizative ekolog-

gjike. Në kuadër të kësaj pjese autori shtjellon bashkëveprimin e sferave të ndryshme natyrore në kuadër të ekosferës, pastaj ekosistemin me karakteristikat themelore të tij, ciklet biogjeokimike dhe rrjedhjen e energjisë në ekosistem.

Autori një vëmendje të posaçme në kuadër të pjesës së tretë të librit ia kushton rolit të njeriut në mjedis, ku me një kompetencë shkencore e profesionale, përmes shumë shembujve dhe studimeve të rastit, paraqet rolin destruktiv të njeriut në mjedis. Në këtë pjesë gjithashtu flitet për rritjen e popullacionit njerëzor në Tokë, harrhimin e resurseve natyrore, procesin e urbanizimit dhe strukturën hapësinore ekologjike në qytet. Në pjesën e katërt trajtohen konceptet e përgjithshme mbi degradimin e mjedisit, ndotjen e atmosferës, ndotjen e hidrosferës, degradimin e tokave dhe rrezikimin e biodiversitetit nga aktivitetet e njeriut.

Në pjesën e pestë dhe të fundit të librit autori shpjegon konceptet teorike mbi zhvillimin e qëndrueshëm si një qasje të re e cila synon të baraspeshojë zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor përmes aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike dhe mjedisore. Zhvillimi i baraspeshuar në mes të sferave të lartpërmendura mundë të arrihet përmes adoptimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mjedisit jetësor, të cilat autori i shtjellon hollësisht në këtë pjesë.

Për herë të parë në kuadër të një teksti që shtjellon problemet mjedisore janë përfshirë konventat dhe traktatet mjedisore të dala nga konferencat dhe takimet ndërkombëtare, në aneksin e librit si: Konventa e Rio's, Konventa e Biodiversitetit, Deklarata ministrore e Bergenit për zhvillim të qëndrueshëm etj., të cilat paraqesin një material shumë të rëndësishëm jo vetëm për opinionin profesionist por edhe atë më të gjerë.

Përmbajtja e pasur, shembujt konkretë, ilustrimet adekuate, autenticiteti dhe kompetenca shkencore-profesionale e autorit e bëjnë librin "Mjedisi jetësor – Roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva" një burim të rëndësishëm të informacionit dhe pikë të referencës për studentë, profesionistë, vendimmarrës etj.

Edhe pse libri në radhë të parë është përgatitur për nevojat e studentëve, begatia e informacioneve, mjeshtëria dhe origjinaliteti shkencor i shtjellimit të problemeve, në njërën anë, dhe interesi gjithnjë e në rritje i shoqërisë për materien që shtjellohet, në anën tjetër, e bënë atë një tekst mjaft të kërkuar në tregun e literaturës shkencore dhe profesionale në Kosovë dhe më gjerë.

Arsim Ejupi, Prishtinë

Zymer Ujkan NEZIRI, **STUDIME PËR FOLKLORIN, II, EPIKA GOJORE DHE ETNOKULTURA**, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, 329 f.

Studiuesi Zymer Neziri në këtë libër merret me çështje të trashëgimisë sonë kulturore. Në pjesën e parë shtron probleme të epikës gojore, duke analizuar punën e katër studiuesve të njohur: Faik Konica, Maksimilian Lamerc, Eqrem Çabej dhe Enver Mehmeti, e në vijim sjell të dhëna për shtrirjen e Eposit të Kreshnikëve, shtron çështjen e fenomenit të lashtë ndër shqiptarë për antroponimet dhe patronimet e epizuara, si dhe për rolin mobilizues të epikës kundër robërisë. Në pjesën e dytë të librit janë edhe pesë punime nga fusha e etnokulturës, kushtuar Antonio Bellushit (dy) dhe Mark Tirtës (tri).

Z. Neziri ballafaqon idetë, mendimet dhe shpesh merr rolin e seleksionuesit të mendimit të tyre, nëse mendimi mbi eposin nuk argumentohet fuqishëm nëpërmjet fakticitetit dhe punës objektive. Legjendariteti lidhet me fushën e eposit heroik, kurse pjesa historike lidhet fuqishëm me argumentimin se e dyta është një trashëgimi e së parës në materie dhe esencë, formë dhe përmbajtje, pra epika historike është trashëgimie e epikës legjendare.

Te Konica, ai vlerëson punën prej studiuesi e kontribuesi për kulturën dhe mendimin mbi letërsinë, por edhe heton një mungesë të pahetuar deri tani në veprimtarinë e Konicës, pra mungon pikëpamja teorike e Konicës mbi eposin tonë. Konica në gjithë veprimtarinë e tij nuk mbledh edhe Epos të Kreshnikëve. Ai me rivishtë e tij *Albania* do të kontribuojë në botimin e krijimtarisë popullore, por në rivishtë e tij nuk do të zë vend botimi i asnjë kënge nga Cikli i Kreshnikëve, ndonëse aty kishte botuar rreth 60 këngë lirike dhe historike, po edhe proverba e gojëdhëna. Z. Neziri e arsyeton mungesën e mendimit të Konicës mbi eposin me moskompletimin e bibliografisë së tij të plotë.

Gjatë qëndrimit studimor në Vjenë (2004), Z. Neziri hetoi dhe analizoi shkriimet e studiuesit Maksimilian Lamerc në letrat shqipe, sidomos dorëshkrimet e tij. Lamerci është folklorist e etnolog, studiues i shquar i eposit shqiptar, që mbledhi këngë popullore lirike, historike dhe të kreshnikëve. Kërkimet e Lamercit shtrihen në totalitetin e jetës shqiptare si dëshmi e një jete autentike me shenja të pastra shqiptare.

Ai ka shprehur mendime dhe gjykime edhe për mendimtarin e Eqrem Çabejtë mbi eposin. Ai thotë se Çabej e lidh vjetërsinë e epikës me vjetërsinë e kombit.

Kërkimet letrare në fushën e epikës legjendare janë preokupim edhe i studiuesit Enver Mehmeti. Z. Neziri i sheh kërkimet e E. Mehmetit në dy rrafshë: në rrafshin e studimit të eposit si vlerë në letërsi dhe në ballafaqimin e pikëpamjeve të studiuesve për eposin. Në studimin e tij vend të veçantë zë figura e gruas në këngët kreshnike. Gruaja në këngët kreshnike paraqitet si nënë e kreshnikut që është e aftë

të zgjidhë probleme familjare, madje zëri i saj është autoritativ në familje, kur kreshniku duhet të merret me çështje të luftës. Ky është funksioni esencial, por gruaja, sipas E. Mehmetit, paraqitet edhe si motër e kreshnikut, grua, nënë dhe dashnore. Ky është funksioni hierarkik i gruas në jetën e kreshnikëve. Motra e kreshnikut përbën një motiv dhe temë për studime të mëtejme të eposit legjendar, kur ajo kërkohet për martesë, motra ka një kusht për kreshnikun që dëshiron ta marrë. Ajo vë kusht që nëse i është vrarë vëllai, duhet që t'i merret haku nga kreshniku që shpreh dëshirë të martohet me të. Kërkohet marrja e gjakut si kusht për marrjen e saj, ky është kushti që i vihet botës antagonistë të kreshnikëve.

Eposi është vlerë e trashëgimisë kulturore, thekson studiuesi Z. Neziri. Shënjat e tij mbijetojnë edhe sot në etninë shqiptare. Mbijetesa e eposit kërkon punën tonë individuale, kolektive dhe institucionale. Alternativa më e mirë sipas Z. Nezirit për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të eposit do të ishte: themelimi i një institucioni shkencor për Eposin e Kreshnikëve; marrja në mbrojtje nga UNESCO; mbajtja e një festivali të veçantë të lahutarëve; përfshirja e eposit si lëndë mësimore në fakultet; iniciativa e krijimit të shoqatës së lahutarëve dhe lahutapunuesve etj.

Z. Neziri analizon librin e Antonio Bellushit: *Arbërorët, arvanitë – një popull i padukshëm*. Aty kemi temën e zbehjes së identitetit gjuhësor të arvanitasve. Kjo zbehje e identitetit gjuhësor theksohet nga vetë arvanitët, Vangjel Ljapisi në moshën 70- vjeçare thekson: “ rinia nuk e di gjuhën, pleqëria po, por nuk e flet”. Në veprën e Bellushit, Z. Neziri studion e analizon veprën në brendi e thellësi të saj, jetën arvanitase si: doket, zakonet, këngët e dasmës, lindjes, vdekjes. Një jetëshkrim i kulturës tradicionale i analizuar në një sistem komunikimi si teori dhe një praxis aktual i frymës së ndonjërës prej tyre.

Në veprën e etnologut Mark Tirta mbi migrimet shqiptare gjatë shekujve heton dy lloj migrimesh: brenda dhe jashtë atdheut, ky është rrafshi i parë i analizës strukturore të veprës.

Vepra *Studime për folklorin, II, epika gojore dhe etnokultura*, është përgatitur sipas standardeve shkencore. Pas çdo punimi pason bibliografia e zgjedhur dhe rezy-meja në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, por edhe gjermanisht, frëngjisht, italisht, polonisht. Vepra ka parathënien, shkruar nga studiuesi i njohur nga Tirana, Shaban Sinani, që në fund të librit botohet edhe në gjuhën angleze, si pashënje. Vepra ka edhe hyrjen, treguesin e emrave të njerëzve e të vendeve, treguesin e termave, të nocioneve, të emrave të personazheve epike legjendare dhe të figurave mitike.

Fitim Veliu, Prishtinë

In Memoriam

ISTVÁN SCHÜTZ - MIK I SHQIPTARËVE, ALBANOLOG E BALLKANOLOG

Më 27 nëntor 2010 u nda nga jeta miku i shqiptarëve dhe studiuesi e përhapësi më i shquar i gjuhës shqipe në botën hungareze - István Schütz. I lindur më 1923 në një fshat hungarezo-rumun të Rumanisë, i shkolluar për gjuhë dhe letërsi hungareze e gjuhë latine, njohës i rumanishtes dhe i gjuhëve moderne europiane, në takimet e punës me studentët shqiptarë në Budapest në vitin e largët 1948 István Schütz nisi të mësonte shqip në mënyrë që gjithë jetën e tij pastaj të merrej me këtë gjuhë dhe kulturën e historinë e këtij populli. Në një vend ku më parë kishte pasur interes për botën shqiptare (të përmendim Ludwig von Thallóczy-n, baron Ferenc Nopcsa-n, interesat e Austro-Hungarisë për botën shqiptare, lidhjet e familjes aristokratike Aponji me mbretin shqiptar Zogu, studime të ndryshme në kuadër të ballkanistikës), megjithatë për gjuhën shqipe vetëm një fjalorth të Laszlo Zoltán të vitit 1913, ndihmesat e studiuesve pas LDB-së, në kohën kur Shqipëria ishte në botën e lindjes komuniste bashkë me Hungarinë, nuk mbetën pa u hetuar: nën drejtimin e Lajos Támas Akademia Hungareze më 1953 botoi *Fjalorin shqip-hungarisht*, ndërsa një ndër bashkautorët e tij ishte edhe István Schütz, tashmë njohës i gjuhës shqipe. István Schütz kishte vazhduar punën e tij prej përhapësi të kulturës shqiptare me përkthimet hungarisht të *Antologjisë së poetëve shqiptarë*, 1952, të përrallave, 1957, të lirikës popullore, 1968, të romanit të Kadaresë *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* 1972, të disa veprave të tjera në prozë, përfshirë edhe *Zylon* e Agollit. Në vitet '70-'80 ishte Seminari ynë dhe Prishtina qendra që afroi studiues dhe dashamirë të shqipes duke u ofruar mundësi e rrethana për studimet e tyre. Ndër ta ishte dhe István Schütz, i cili ndërkohë i kishte hyrë hartimit të fjalorit të madh hungarisht-shqip me mbi 70.000 fjalë, e të cilin ia doli ta përfundonte, dhe krahas punës me studentët e tij të shqipes, ndër të cilët është dhe ambasadori aktual i Hungarisë në Kosovë, shkëlqesia e tij Loránt Bálla, ndërmori hartimin e librit për mësimin e shqipes *Albán Nyelvkönyv*, 2002 me një mbarështim metodik që përfshin dhe kulturën e historinë shqiptare me mbi 4.000 fjalë të përfshira në të dhe botoi librin *Fehér foltok a Balkánon*, Budapest 2002, ff. 223.



Derisa *Libri për gjuhën shqipe*, me 177 faqet e tij të formatit A4 ka natyrë teksti të gjerë për mësimin e gjuhës, studimet e ndryshme të botuara në periodik dhe vepra tjetër e tij – *Njolla të bardha në Ballkan*, 2002 kanë natyrë shkencore dhe më-

tojnë të sqarojnë çështje të ndryshme që lidhen me kulturën, historinë, gjuhën dhe të kaluarën shqiptare në Ballkan, të para dhe në kuadër të historive të përbashkëta.

Kjo vepër e István Schütz-it është konceptuar po ashtu si një manual për studentët, duke synuar të paraqesë në mënyrë të përmbledhur rezultatet e studimeve në fusha të ndryshme, si histori, filologji e krahasuar, mitologji, etnografi, e në funksion të ndriçimit të së kaluarës së lashtë të kësaj hapësire shumë të trazuar të Ballkanit. Njohës i mirë i shqipes dhe rumanishtes, István Schütz-i ka ndarë që si kapitull të parë të librit të tij *Njolla të bardha në Ballkan* të vendosë shqyrtimin e gjerë për vokabularin e përbashkët midis shqipes e rumanishtes, për të hyrë kështu në vetë thelbin e konceptimeve ballkanistike të dy shekujve të fundit - të Lidhjes Gjuhësore Ballkanike, si një prej çështjeve me peshë të filologjisë ballkanike. Duke mos e miratuar konceptin e Unionit (Sprachbund), sepse nuk ia ka dalë të japë përgjigje të pranueshme për 'zhvillimet konvergjente' të gjuhëve të rajonit. Shpjegimet e tij nisen nga konstatimet se unionin në fjalë e përbëjnë gjuhë të lashta si shqipja e greqishtja, pastaj rumanishtja e formuar pas sh. 7 dhe gjuhët sllave të jugut pas sh. 6, për të vazhduar me bindjen e tij se në fakt kemi të bëjmë jo me ndonjë lidhje po me ndikim të vazhdueshëm të shqipes mbi ato gjuhë gjatë një simbioze shumëshekullore. Këtë simbiozë e përdëshmojnë më qartë, mendon ai, 125 fjalët e vokabularit të përbashkët të rumanishtes e të shqipes dhe elementet me pamje të përbashkët latine midis këtyre dy gjuhëve. Ai nuk pajtohet me konceptin për të ashtuquajturin substrat të përbashkët midis këtyre dy gjuhëve të parapëlqyer në Rumani, sepse në rastin e shqipes nuk mund të flitet për substrat, pasi nuk ka pasur ndryshim gjuhe si në rastin e rumanishtes. Ndër tiparet e përbashkëta të këtyre gjuhëve ai numëron paralele morfologjike, si nyja e prapavendosur, përdorimin e nyjës te mbiemrat, ashtu si ndikimin e rrjedhore shqipe në formimin e mbiemrave në rumanishten (Țepeș, Verdeș, Mancaș, cinsteș). Sa i përket nyjës së prapavendosur të maqedonishtes, nuk duket i qëlluar konstatimi se ajo do të jetë më e vjetër se e bullgarishtes, sepse aty e kemi ende të ruajtur elementin deiktik (кукава, кукана, куката), si në armenishten. Përkundrazi, ky element mund të flasë më parë për një proces ende të papërfunduar të krijimit të nyjës nga dëftorët. Meqenëse latinishtja e kishte humbur asnjëherë para sh. IV, István Schütz mendon se në rumanishten e formuar pas sh. 7 asnjëherë do të jetë formuar nën ndikimin e shqipes. Më tej merret me shqyrtimin e përsëritjes së trajtave të shkurta të paremrave, për të vazhduar me diskutime për dëftorët, vetorët, pronorët, numërorët, formimin e ndajfoljeve, çështje të zgjedhimit foljor (futuri analitik, mungesa e infinitivit, përdorimi i pjesores me duhet), për të vazhduar më tej në vështirimet për kompozimin e fjalëve, etj. Përtej këtyre shqyrtimeve rumuno-shqiptare në fushë të gjuhës, ai merret dhe me çështje të mitologjisë, të besimeve popullore, etj.

Pjesa e dytë e librit, më e gjera, merret me paraqitjen e ndryshimeve etnike dhe të migrameve në Ballkan qysh prej periudhës së fundit të neolitikut deri tek ardhja e turqve. Kjo histori e ngjeshur e Ballkanit për një periudhë kaq të gjatë mëton që, përmes pasqyrit të rrethanave të ofruara nga perandoritë e mëdha njëra pas tjetrës dhe invazioneve të barbarëve në kampanjat e tyre militare shkatërruese, të tregojë arsyet e migrameve dhe të

përzierjeve etnike. Në këtë vazhde ai merret me fazat e errëta të dëshmvive të pranisë së shqipes në këto hapësira, pastaj me dëshmitë për trakasit e për ilirët, për dardanët, për historinë e kolonive greke, për luftërat e Romës, etj. Romanizimi që ai e quan i diferencuar i popujve ballkanikë dhe për pasojë lindja e rumanishtes dhe e dalmatishtes zënë një hapësirë jo të vogël në këtë shqyrtim. Më tej ka ndjekur romanizimin dhe braktisjen e Dakisë Trajane, zhvillimet me ndarjen e Perandorisë së Romës e të Bizantit, depërtimet sllave, pastaj të kumanëve e peçenegëve, etj. Vëmendjen e tij e kanë tërhequr rrethanat kishtarë në Bizant e në hapësirat shqiptare, krijimi i Arbanonit të Progonit, pastaj i shtetit Nemanjid e deri te pushtimi otoman.

Pjesa e tretë e këtij libri merret me etnogjenezën e shqiptarëve, të rumunëve dhe të maqedonasve, që, sipas tij, është problemi më i mprehtë i regjionit. Sa i përket shqipes ai mbështetet te studimet e Eqrem Çabejtë, duke parapëlqyer tezën e prejardhjes ilire të shqipes dhe duke kundërshtuar sidomos tezat e studiuesit rumun I. I. Russu për ndonjë prejardhje trakase apo nga Karpët. Ai diskuton gjerësisht dhe për idetë e historianit gjerman Gottfried Schramm për prejardhjen e shqiptarëve nga besët trakas dhe, duke i lënë anash ato si të paargumentuara, përpiket të tregojë se një rol në këto çështje do të ketë luajtur dhe gjuha e dardanëve, që nuk ishin romanizuar tërësisht.

Vëmendjen e István Schütz-it e ka tërhequr në këtë pjesë çështja e prejardhjes së rumunëve, madje herëherë me tone polemizuese. Ndër tri hipotezat e avancuara, të kontinuitetit etniko-gjeografik dako-rumun, të teorisë migracioniste, që do të thotë të formimit të rumunëve dhe të rumanishtes në jug të Danubit, dhe të teorisë pas së cilës një pjesë e popullatës së romanizuar do të ketë mbetur në Dakinë Trajane dhe më vonë asaj do t'i jetë bashkuar popullata nga zonat në jug të Danubit, ai përpiket të sjellë argumente për formimin e rumunëve në jug të Danubit, ku do të ketë ndodhur dhe kontakti me shqipen, që do t'i shpjegonte ngjashmëritë midis dy gjuhëve. Një hapësirë të madhe në këtë pjesë ai i ka kushtuar lidhjes që ai supozon midis theksimit të teorisë së kontinuitetit dhe nevojave të arsyes së shtetit (*raison d'Etat*) pas bashkimit të Transilvanisë me Rumaninë, mbështetjes së kësaj teze nga komunistët e kohës së Ceaușescu-t, etj.

Lidhur me maqedonishten ai rithekson atë që ai e quan mbijetesë të formave të lashta të nyjës së prapavendosur e të elementeve të tjera që e largojnë nga bullgarishtja, për të anuar nga mundësia që kjo gjuhë të jetë formuar në kohën e valëve të para sllave të sh. V, pra para sllavizmit të bullgaro-turqishtes. Natyrisht, dokumentimi i shkruar i sllavishtes nga rrethet e Selanikut në sh. IX nuk flet në favor të kësaj hipoteze, ashtu si e tërë historia e kësaj gjuhe.

Libri ka një bibliografi të pasur dhe 17 harta historike, rezyme më të gjera në anglisht, frëngjisht e gjermanisht dhe indeksin e emrave.

Duket qartë se kjo do të jetë vepra më e rëndësishme e István Schütz-it. Botimi i saj hungarisht ia ka kufizuar qarkullimin, sepse, megjithë rezymetë në gjuhët europiane, për ata që nuk e dinë këtë gjuhë nuk është e mundur të ndiqet në

detaje argumentimi i tij, sidomos për çështje si ato që kanë të bëjnë me raportet midis shqipes e rumanishtes, ku duket të ketë më shumë origjinalitet.

Veprimtaria kulturore e përhapjes së shqipes në Hungari, e paraqitjes së kulturës shqiptare në këtë vend, veprimtaria leksikografike për shqipen e hungarishten, puna e gjerë për mësimdhënien e shqipes, studimet albanologjike dhe ballkanologjike, e bëjnë figurën e István Schütz-it me rëndësi jo vetëm për kulturën hungareze, ku albanistika ka pasur më pak hapësirë, po edhe albanologjinë në përgjithësi. Dashuria e tij për botën shqiptare, e manifestuar shumë herë publikisht dhe në mediet e Kosovës na bëjnë që këtë figurë ta kujtojmë vazhdimisht me pietet.

Rexhep Ismajli

Zija BYLYKBASHI, Prishtinë
KRONIKA/ 2010

PËRURUHET OBJEKTI I RI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Besim Bokshi, kryeministri i Qeverisë së Kosovës, z. Hashim Thaçi, ministri i Ministrisë së Administratës Publike, dr. Arsim Bajrami, dhe ministri i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, dr. Enver Hoxhaj, më 15 janar 2010, prenë shiritin e përrurimit të godinës së re të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Para të pranishmëve fjalë rasti mbajtën kryetari Bokshi dhe kryeministri Thaçi.

Kryeakademiku Bokshi, në fjalën e tij, ndër të tjera, tha: "I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, i nderuar ministër i Administratës Publike, zoti Arsim Bajrami, të nderuara personalitete shtetërore, shoqërore, punëtorë të shkencës, të arsimit e të artit, zonja e zotërinj, erdhi koha që në 35-vjetorin e themelimit Akademia të ketë godinën e ndërtuar enkas për të. Të gjitha strukturat e Akademisë i shprehin falënderim e miradije Qeverisë, që u tregua e vendosur për ta përfunduar këtë punë të nisur mjaft kohë përpara. Mirënjohja jonë i shkon edhe personalisht kryeministrit, zotit Hashim Thaçi dhe ministrit të Administratës Publike, zotit Arsim Bajrami, që dhanë vendosmërinë e tyre për krijimin e kësaj vepre, që e nderon edhe Republikën e Kosovës. Ne besojmë se me ndërtimin e kësaj godine sinjalizohet një qasje më frytdhënëse e organeve përkatëse qeveritare ndaj Akademisë dhe punës së saj.

Gjendja dhe pozita e përgjithshme e shkencës dhe e arteve në shoqërinë aktuale të Kosovës bëjnë që Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës të ndeshë vështirësi në begatimin e veprimtarisë së saj shkencore e artistike. Pas periudhës së mbijetesës, duke rrumbullakuar rregullimin ligjor, në këtë fazë të zhvillimeve shoqërore Akademia ndodhet para nevojës për veprime më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse, para një intensifikimit e punëve në aspektin e transformimit të mekanizmave të hulumtimeve shkencore, në përmbajtjet që na e afrojnë hapin me të tjerët dhe në zgjerimin e gamës së bashkëpunimit me akademitë e rajonit e të Evropës. Kjo mund të arrihet paralelisht me krijimin e rrethanave më të mira për zhbillimin e shkencës te ne, me një organizim adekuat të bërthamave dhe njërive hulumtuese shkencore dhe krijuese të artit në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e shoqërisë pas krijimit të Kosovës shtet i pavarur. Ato do të imponojnë krijimin e një infrastrukture adekuate, me laboratorë, me pajisje e me mjedise për hulumtime, me sigurimin e informacioneve më të plota për gjendjen e dijeve, me një njohje më thelbësore të zhvillimeve globale shkencore. Kjo e shton nevojën për përgatitjen e të rinjve në Universitetin tonë për bashkëpunim e mobilitet më të madh, duke u krijuar kështu shanse për shumë aspekte hulumtimi. Nevojitet të krijohet një bazë ligjore për

të kaluar drejt një rrjeti efektiv e dinamik hulumtues, duke kërkuar edhe ndihma më substanciale nga programet evropiane e botërore për veprimtari shkencore.

Edhe Akademia jonë, si të gjitha akademitë evropiane, është para obligimit për të ecur në drejtim të rekomandimeve të ALLEA-s, Unionit të Akademive të Evropës, anëtare e të cilit është që nga viti 2004. Këto rekomandime janë: trimërimi dhe zhvillimi i programeve për rritjen e interesit për shkencë në një moshë më të re, stimulimi i femrave për të ndërmarrë një karrierë shkencore, investime në infrastrukturën e hulumtimit, në lehtësimin teknologjik, në ndërlidhjet kompjuterike edhe në mundësinë e qarkullimit të shkencëtarëve përmes fondeve të veçanta ose me ndihmën e mekanizmave evropianë, krijimi i hapësirës së mjaftueshme për hulumtim të lirë shkencor, bazik.

Këto, Akademia mund t'i arrijë vetëm me veprim të përbashkët me institutet ekzistuese dhe komunitetin shkencor dhe me strukturat përkatëse universitare e shtetërore, ashtu siç veprohet në vende të tjera.

Zonja e zotërinj, shpresojmë se nuk do të vonohet sigurimi i orendive, që na e bëjnë të mundur fillimin e punës në këtë godinë të bukur e funksionale, me të cilën po nderohen Akademia e Qeveria, po nderohet shkenca e arti dhe funksioni i tyre i lartë shoqëror.

Në këtë ditë të shënueshme për Akademinë kujtojmë me pietet gjashtëmbëdhjetë kolegët tanë, që nuk janë më midis nesh, të cilët, në rrethana tepër të vështira nëpër të cilat kaloi Akademia, dhanë energjinë e tyre krijuese për të ngritur lart prestigjin shkencor e artistik të këtij institucioni, ndihmuan zhvillimin e mendimit kritik shkencor në shoqëri, dhanë kontributin e tyre për promovimin e pavarësisë së veprimit shkencor e artistik dhe kontributin e tyre për rrjedhat e përgjithshme të pavarësimit të vendit.

Zonja e zotërinj, ju ftoj që me duartrokitje të shprehim gëzimin tonë të përbashkët për këtë vepër, që Akademisë i jep mundësi dhe e obligon për një punë edhe më të frytshme e shoqërinë për mbështetje të synimeve kësaj Akademie për lartësime të nivelit të veprave shkencore e artistike. E gëzofshim!”

Kryeministri Thaçi deklaroi se ndjehet i lumtur që në prag të dyvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës po inaugurohet objekti “më modern në rajon për një Akademi të shkencave”. Në vazhdim ai theksoi: “E përgëzoj kryetarin Bokshi dhe gjithë akademikët e respektuar të Republikës së Kosovës, për angazhimin e tyre historik, fillimisht në kultivimin e Akademisë, apo jetës akademike në Republikën e Kosovës, në angazhimet e tyre shtetformuese... Sot, secili kosovar, vetë shteti i Kosovës, ndihet krenar për këtë vepër madhështore, mund të them për njerëzit e dijes, shkencës, shtetformimit dhe të ideve të reja”.

Pas fjalëve përuruese, pjesëmarrësit vizituan mjediset e Akademisë, të cilat së shpejti pritet të pajisen me inventar dhe me pajisje përkatëse elektronike.

MINISTRI VALTON BEQIRI PRET ANËTARË TË ASHAK-ut

Me kërkesë të z. Valton Beqiri, ministër i Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, akademikët Mark Krasniqi, Pajazit Nushi (sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore) dhe Rexhep Ferri morën pjesë

në një takim, që u mbajt më 11 shkurt 2010, në kabinetin e ministrit Beqiri.

Botimi i paradokohshëm i monografisë “*Trashëgimia botërore e Serbisë*”, në të cilën prezantohen katër objekte të trashëgimisë kulturore të Kosovës (Manastiri i Deçanit, Manastiri i Graçanicës, Kisha e Shën Prenës në Prizren dhe Patrikana e Pejës) si trashëgimi e Serbisë ka qenë temë e takimit në fjalë. Ministri Beqiri ka kërkuar nga akademikët bazën argumentuese shkencore mbi të cilën do të mbështetej reagimi institucional ndaj përvetësimit nga Serbia të kësaj pasurie kulturore të Kosovës. Akademikët kanë shprehur gatishmërinë për të dhënë kontributin e tyre.

SHËNOHET 20-VJETORI I THEMELIMIT TË AKADEMISË EUROPIANE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Në Salzburg të Austrisë, më 5-6 mars 2010, u mbajt mbledhja vjetore e Kuvendit të Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve kushtuar 20-vjetorit të themelimit të saj. Në mbledhje mori pjesë edhe akademik Rexhep Ismajli. Mbledhja pati karakter pune dhe festiv. Në mbledhjen e Senatit të Akademisë u diskutuan çështjet e veprimtarisë së Akademisë, u propozuan dhe u zgjodhën nënkryetarët, anëtarët e rinj të Senatit dhe udhëheqësit e klasave të Akademisë – dekanët, ndërsa anëtarë të mëhershëm të Senatit u propozuan për anëtarë nderi të Senatit.

MBAHET KONFERENCA e 11-të E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ALLEA-s

Në cilësinë e përfaqësuesit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Latif Susuri ka marrë pjesë në Konferencën XI të Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s (11th ALLEA General Assembly Conference), mbajtur më 15 dhe 16 prill 2010, dhe në Asamblenë e Përgjithshme të ALLEA 2010, mbajtur më 17.4.2010 (ALLEA General Assembly Business Meeting 2010). Nga Raporti i akademik Susurit veçnam:

“Në hapje të Konferencës morën pjesë edhe: Peter Honeth, ministër për edukim të lartë dhe shkencë i Suedisë; Jüri Engelbrecht, president i ALLEA-s, Svante Lindqvist, president i Akademisë Mbretërore Suedeze të Shkencës. Në ditën e parë të Konferencës u mbajtën disa tema, që kishin të bënin me shkencën dhe edukimin në shkollat suedeze (Sven-Olof Holmgren); Olimpiadat e matematikës – rasti i Piedmontit (Franco Pastrone), Rrjeti i Universiteteve të Fëmijëve të Evropës (Karoline Iber & Christian Gary), etj. Ditën e dytë, më 16. 4.2010, janë trajtuar shumë tema shkencore, që kanë të bëjnë me edukimin dhe shkencën: Një vizion për punën shkencore në universitetet e Evropës (Geoffrey Boulton); Evoluimi i edukimit të lartë dhe shkencës në Evropën Qendrore dhe Lindore – shembulli i Rumanisë (Ionel Haiduc); Universiteti modern dhe shkenca (Björn Wittrock); Reformat e edukimit të lartë në Japoni (Yoshikawa Yumiko), etj.

Në vijim u theksua se për edukimin në nivel kombëtar duhet të ekzistojnë pilot projekte me tema konkrete të edukimit fillor, të mesëm dhe universitar. Pranë ALLEA-s ekzistojnë grupe pune dhe kërkimore dhe u kërkua që secila akademi ta ketë përfaqësuesin e vet për edukim dhe shkencë. Për këto çështje pritet të ketë shu-

më takime, siç janë: takimi i ministrave të arsimit në Grenobël më 8-9 korrik, Konferenca për edukim të mesëm, më 27-29 tetor 2010, në Angli, etj.

Më 17. 4. 2010, është mbajtur Asambleja e Përgjithshme e ALLEA-s në Akademinë Suedeze të Shkencave të Inxhinierisë në Stockholm, me këto aktivitete: Raporti financiar për vitin 2009; Aktivitetet e ALLEA-s në vitin 2009; Amendamentet në Statutin e ALLEA-s; Plani financiar; Plani Strategjik i ALLEA-s për vitin 2010-2015; Ftesë për të shprehur interesimin për vendvendosjen e Sekretariatit të ALLEA-s; Ftesë për të caktuar vendin e mbajtjes të takimit të ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s; Përbërja e Komitetit Drejtues. Ka pasur propozime konkrete nga disa akademi të Evropës për bashkëpunim dhe aktivitet shkencor, sidomos për shkencat humanitare. U theksua se ALLEA ka vendosur kontakte edhe me akademitë e disa shteteve aziatike (Kina) dhe ato të Amerikës Latine. U theksua nevoja e zgjerimit të bashkëpunimit midis akademive të shteteve të Mesdheut. siç janë: Bullgaria, Shqipëria, Serbia, Rumania, Kosova, Bosnja, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Greqia, etj., kjo për shkak të së kaluarës së përbashkët historike, kulturore, ekonomike etj. U tha se këto shtete duhet t'i kenë përfaqësuesit e tyre në Këshillin Drejtues të ALLEA-s (Steering committee). Për ndryshimin e disa pikave të Statutit secila akademi anëtare mund të japë propozimet e saj përmes Sekretarisë së ALLEA-s. Për ndryshime të mundshme do të diskutohet në Asamble, që do të mbahet në muajin nëntor 2010. U konstatua se ALLEA, për 10 vjet, është ndihmuar financiarisht nga Qeveria holandeze, ndërkaq aktualisht është vendosur që financimi të bëhet nga anëtarët e ALLEA-s. Shuma e anëtarësisë është e ndryshme, varësisht nga shteti. Kështu, për ASHAK-un, suma vjetore e anëtarësisë është 1000 euro”.

VIZITË PUNE NË AKADEMINË SLOVENE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Akademik Rexhep Ismajli, në kuadër të përgatitjes së projektit të përbashkët të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë Slovene të Shkencave dhe të Arteve për botimin e veprës albanologjike të R. Nachtigal-it dhe në kuadër të projektit të tij hulumtues për raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit, nga 20-30 prill 2010 ka qëndruar në Akademinë Slovene. Ka punuar në institutin “Fran Ramovsh”, që e kishte ftuar. Akademia ia ka mundur fotokopjimin e materialeve përkatëse, të cilat i ka sjellë në Akademinë tonë.

Akademik Ismajli është pritur nga kryetari i Akademisë Slovene akademik Jože Trontelj dhe nga kryetari i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, akademik prof. dr. Janez Stanovnik, i cili, po ashtu, ka vlerësuar bashkëpunimin midis dy akademive tona. Ai bëri shpjegime edhe për procedurat që ka ndjekur Akademia Slovene lidhur me rivlerësimet që janë bërë në atë akademi më 1945 dhe hapat që ishin ndërmarrë në atë akademi për rindrejtjen e padrejtësive të bëra atëherë dhe rehabilitimin e anëtarëve të trajtuar padrejtësisht. Takime pune ka pasur edhe me akademikun prof. dr. Janez Orešnik. Përveç materialeve për R. Nachtigal-in, në bibliotekat e Lubjanës ai ka hulumtuar literaturën, që mungon në Prishtinë.

PËRFAQËSUESIT E BASHKËSIVE ISLAME TË RAJONIT PËR VIZITË NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Të enjten paradite, më 13 maj, liderët islamë nga rajoni, të prirë nga kryetari i DIJANET-it (Bashkësia Islame e Turqisë), prof. dr. Ali Bardakogu e të shoqëruar edhe nga mikpritësi, myftiu i Kosovës, mr. Naim Tërnavë, vizituan Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku u pritën nga kryetari akad. Besim Bokshi dhe bashkëpunëtorët e tij, akademik Hivzi Islami, nënkryetar, akademik Engjëll Berisha, sekretar i përgjithshëm, dhe nga mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Akad. Bokshi, pasi u uroi mirëseardhjen, mysafirët- liderët islamë të rajonit, i njohu shkurtimisht me historikun e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me organizimin, me projektet që ka realizuar deri më tash dhe ato që janë në realizim e sipër.

Akademik Bokshi foli edhe për bashkëpunimin që ka Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës me akademitë e huaja dhe potencoi faktin se vitin e kaluar ASHAK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Akademinë e Shkencave të Turqisë.

Në emër të liderëve islamë foli kryetari i DIJANET-it, dr. Ali Bardakoglu, i cili, pasi falënderoi akademikët kosovarë për pritjen e ngrohtë, u interesua për formën e organizmit të Akademisë, marrëdhëniet e saj me Universitetin e Prishtinës dhe me institucione të tjera shkencore e kërkimore, si dhe me mënyrën e zgjedhjes së akademikëve.

Kryetari Bardakoglu, akademikët kosovarë i njohu edhe me ekzistimin e instituteve kërkimore e shkencore në kuadër të DIJANET-it dhe shprehu interesimin që të shihet mundësia e bashkëpunimit me ASHAK-un. Ai tha se në kuadër të DIJANET-it ekziston biblioteka më e madhe në Turqi, pastaj përmendi edhe Qendrën Kërkimore e Studimore "ISAM", e cila është duke përgatitur Enciklopedinë Islame.

AKADEMI PËRKUJTIMORE ME RASTIN E VDEKJES SË AKADEMIK MUHARREM BERISHËS

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës organizoi më 16. 5.2010, në mjediset e saj, akademi përkujtimore në nderim të akademikut të ndjerë Muharrem Berisha. Në akademi morën pjesë anëtarë të Akademisë, familjarë të akademikut Berisha, profesorë të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, miq e dashamirë të profesorit Berisha dhe përfaqësues të medieve. Akademinë përkujtimore e shpalli të hapur akademik Besim Bokshi, kryetar i Akademisë. Nga fjala e tij e hapjes veçam:

"E pikëlluara familje Berisha, zonja e zotërinj,

dje morëm lajmin e hidhur e pikëllues se pas një sëmundje të gjatë e të rëndë u nda nga jeta anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Muharrem Berisha. U nda nga ne një koleg e mik i dashur, një personalitet i nderuar, që dha gjithnjë kontributin e tij për mbarëvajtje të punëve në Akademi, në përkrahje të punës krijuese të kolegëve e për avancimin e veprimtarisë shkencore e

artistike të Akademisë, për ngritjen e prestigjit krijues e shoqëror të këtij institucioni të lartë. Që nga pranimi si anëtar korrespondent, më 1996, e anëtar i rregullt në vitin 2000 e pastaj si sekretar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe si anëtar i Kryesisë së Akademisë në dy mandate nga viti 2002 deri në vitin 2008 akademik Muharrem Berisha që mbështetës dhe nxitës i veprimeve konstruktive dhe i ecjeve kolegjiale të mirëkuptimit. Ai në Akademi erdhi me autoritetin e një shkencëtari të afirmuar në fushat e disiplinave matematikore e si profesor i zellshëm e i respektuar, që shpalosi energjinë e tij krijuese me nivele të larta shkencore edhe në veprat e botuara në Akademi. Si kryeredaktor i revistës së Seksionit të Shkencave Natyrore “*Kërkime*”, me punën e tij të përkushtuar e bëri të jetë revistë tërheqëse, të hapur për studiues të jashtëm, duke nxitur ambiciet e tyre për hulumtime të mirëfillta shkencore.

U nda nga ne kolegu që rrezatonte dashamirësi e sinqeritet, me të cilat ndikonte në krijimin e një atmosfere të këndshme për punë e veprim në forumet e Akademisë dhe jashtë tyre”.

Të pranishmit iu përgjigjen ftesës së kryetarit Bokshi që në shenjë nderimi ndaj personalitetit të akademik Muharrem Berishës të mbajmë një minutë heshtje.

Fjalën përkujtimore e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Latif Susuri. Fillimisht ai shpalosi biografinë dhe bibliografinë e akademik Berishës, duke theksuar se ai, fillimisht punoi si mësues. Pas diplomimit në matematikë, punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë, dhe njëherësh u angazhua të mbajë ushtrimet nga analiza Matematika I në Katedrën e matematikës të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Nga viti 1968 ka punuar në Katedrën e matematikës të Universitetit të Prishtinës si asistent, ligjërues, profesor inordinar dhe profesor ordinar. Ka qenë mentor i shumë magjistrantëve dhe doktorantëve. Po ashtu, ka qenë prodekan dhe dekan në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore.

Ka qëndruar në specializime në universitetin “Lomonosov” të Moskës (1978/79), në universitetet e Tiranës, të Moskës, Sofjes, Jenës. Në vitin 1996, zgjidhet anëtar korrespondent, ndërsa më 2000 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ka qenë anëtar i Kryesisë së Akademisë, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, kryeredaktor i revistës “*Kërkime – Research*” të ASHAK-ut. Përveç punës së tij arsimore, ka publikuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit shumë punime shkencore dhe punime profesionale dhe ka hartuar numër të madh tekstesh shkollore dhe universitare.

Akademik Muharrem Berisha është shpërblyer me mirënjohje të ndryshme dhe është laureat i çmimit të dhjetorit.

Akademik Susuri e përmbylli fjalën e tij me konstatimin se “me vdekjen e hershme të akademik Muharrem Berishës familjarët humbën njeriun më të dashur të tyre, miqtë, kolegët, Akademia, në veçanti Seksioni i Shkencave të Natyrës, përgjithësisht shkencat e matematikës, Universiteti i Prishtinës, shkencëtarin e shquar, ndërsa studentët pedagogun e mirëfilltë, i cili te këta, me dekada, mbolli farën e dijes në fushën e matematikës. Megjithatë, vepra voluminoze e akademik Muharrem Berishës, e cila do të jetojë dhe do t’u shërbejë edhe shumë gjeneratave të reja që do të

vijnë, mbetet ngushëllim për të gjithë ne”.

Në varrezat e Prishtinës, para një numri të madh akademikësh, profesorësh , studentësh, bashkëpunëtorësh dhe dashamirësh, për herë të fundit nga akademik Muharrem Berisha u nda, me një fjalë rasti akademik Minir Dushi. Nga fjala e tij veçam:

“Qytetarë të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Jemi tubuar pranë varrit të hapur të profesorit e shkencëtarit të çmuar akademik Muharrem Berisha që të gjithë së bashku të shprehim dhimbjen e thellë për vdekjen e qetë e të shenjtë të bashkëpunëtorit e shokut tonë të nderuar.

Akademik Muharrem Berisha, pedagogu dhe lëvruesi i njohur i studimeve të shkencave matematikore, me plot talent e durim i ka kontribuar shumë shkollës sonë dhe shkencës shqiptare”. “...Shembëlltyra e tij e ndritshme do të mbetet gjallë dhe e pashlyeshme jo vetëm në ASHAK, e cila humbi anëtarin e vet të palodhshëm në punët shkencore, por edhe në kujtesën e shumë gjeneratave të studentëve të Fakulteteve të Shkencave të Natyrës të UP dhe UT, ku me vite të tëra ligjëroi lëndën e matematikës, por edhe te gjeneratat e shumta të nxënësve të shkollave të mesme.

Duke përfunduar këtë fjalë të përmortshme për akademik Muharrem Berishën, le të jenë këto fjalë një homazh e një nderim i thellë për akademikun e shquar, njeriun e mrekullueshëm, për shokun e shtrenjtë e të paharrueshëm. Populli shqiptar ka një fjalë të urtë, që thotë: “Nuk vdes ai që mbulohet, por ai që harrohet”. Akademik Muharrem Berisha, me punën produktive, këmbëngulëse e me veprat që ka lënë pas, mbetet gjithmonë i paharrueshëm në opinionin shkencor e arsimor.

Shembëlltyra e tij e ndritshme do të mbetet gjallë dhe e pashlyer në ASHAK dhe e në UP”.

HULUMTIME PËR N. JOKLIN NË VJENË

Me ftesë të Albanien-Institut dhe në emër të Balkan-Komission akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Akademinë e Shkencave të Austrisë në Vjenë në kuadër të programit të Akademisë Austriake për shkëmbime në fushën hulumtuese shkencore (nga 1-14 maj 2010). Programi themelor i punës ka qenë vjelja e materialeve për përgatitjen për botim të veprës së Norbert Joklit. Tërë puna është bërë në Institutin e Gjuhësisë së Krahësuar dhe me mbështetjen e plotë të drejtorit të tij prof. dr. Heiner Eichner, me të cilin deri tash është zhvilluar i tërë bashkëpunimi konkret. Akademik Ismajli ka pasur kontakte pune dhe në Balkan-Komission dhe me Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Ka marrë fotokopje të tërë veprës së Joklit, të botuar në revistat *Indogermanische Fforschungen*, *Glotta*, *Balkan-Archiv*, *Die Sprache*, pastaj në numra të veçantë revistash apo në përmbledhje të ndryshme studimesh indoeuropiane, në *Reallexicon der Vorgeschichte* të Ebert, etj. Materialet e fotokopjuara do të vihen në dizpozicion të Akademisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I AKADEMISË SLLOVENE LIGJËRON PARA AKADEMIKËVE KOSOVARË

I ftuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës akademik Andrej Kranc, karstolog i njohur dhe sekretar i përgjithshëm i Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve, para anëtarëve të ASHAK-ut dhe profesorëve të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës, në mjediset e Akademisë, më 21 maj 2010, mbajti ligjëratën me temë: “2000 vjet të ndikimit të njeriut në natyrë”, duke elaboruar shembullin e Liqenit të Cerknices. Akademiku Kranjc u falënderua për pritjen që i është bërë dhe njëherësh shprehu dëshirën që Kryetari apo dikush nga autoritetet e ASHAK-ut të jetë mysafir i Akademisë së tyre.

AKADEMIKU BRANKO STANOVNIK LIGJËRON PËR METODOLOGJITË E REJA NË FUSHËN E SINTEZËS ORGANIKE

Akademiku Branko Stanovnik, anëtar i rregullt i Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve, aktualisht përgjegjës i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Koordinim Shkencor i kësaj Akademie, mbajti më 25 qershor 2010, në mjediset e ASHAK, ligjëratën me temë: “*Metodologji të reja në fushën e sintezës organike: nga heterociklet te prodhimet natyrore*”.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Besim Bokshi, kryetar i Akademisë. Në vazhdim akademiku Stanovnik elaburoi temën e ligjëratës së tij për metodologjitë e reja në fushën e sintezës organike. Ligjëratat u ndoq nga anëtarë të ASHAK-ut, profesorë të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore – Departamenti i Kimisë dhe nga të interesuar të tjerë. Pas përfundimit të ligjëratës, akademiku Stanovnik u përgjigj në pyetjet që i shtruan profesorët e Departamentit të Kimisë të FSHMN-së. Si përgjegjës i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Koordinim Shkencor të Akademisë Sllovene, ai foli edhe për bashkëpunimin e kësaj Akademie me akademitë e tjera. Ai theksoi se aktualisht kanë marrëveshje bashkëpunimi me 27 akademi të ndryshme, prej tyre më së shumti me ato të Europës, por edhe me Shtetet e Bashkuara, Japoninë, Kinën etj. Bashkëpunojnë edhe me institucione shkencore të Sllovenisë. Pranojnë studiues të rinj, të huaj, në bazë të rekomandimeve të akademive të vendeve përkatëse (vizita të shkurtra 1-2 javore, më së shumti 1 mujore). Foli për bashkëpunimin e mirë me Akademinë tonë. Theksoi se edhe Akademia e tyre, si e jona, nuk janë inatitucione hulumtuese dhe detyrimisht duhet t’u referohemi institucioneve ku kryhen veprimtari hulumtuese për bashkëpunim.

ALB-SHKENCA NDERON AKADEMIKUN MUSA HAXHIU

Në Tiranë, më 2-5 shtator 2010, janë mbajtur Takimet e pesta të Institutit Alb-Shkenca, ndërsa më 4 shtator është mbajtur një sesion i veçantë, i cili i është kushtuar veprës së akademikut të ndjerë Musa Haxhiu. Në këtë sesion, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e ka përfaqësuar anëtar i saj korrespondent Isuf Krasniqi. Me këtë rast ai ka mbajtur një fjalë rasti, nga e cila veçuam:

“Më lejoni që në emër të Akademisë së Shkencës dhe të Arteve të Kosovës t’i them disa fjalë për akademikun tonë të çmuar, Musa Haxhiu.

Akademik Musa Haxhiu u lind në Pejë më 15 mars 1939. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Fakultetin e mjekësisë e mbaroi në Beograd, më 1963. Specializimin nga fusha e sëmundjeve të mushkërive e kreu në Beograd, më 1968. Studimet pasuniversitare i përfundoi gjithashtu në Beograd, në vitin 1973, në lëmin e kardiologjisë. Më 1973, në Universitetin e Zagrebit mbron tezën e doktoratës dhe promovohet doktor i shkencave të mjekësisë. Në vitet 1973-1975, zgjidhet dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, dhe kjo periudhë ishte periudha më e ndritur e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të këtij Fakulteti. Në vitin 1977, zgjidhet profesor inordinar, ndërsa në vitin 1983 profesor ordinar i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve 1975/76, qëndroi në specializim në Pennsylvania University, Philadelphia, SHBA. Bazuar në të arriturat shkencore dhe profesionale, në vitin 1979 zgjidhet anëtar korrespondent, ndërsa në vitin 1986 zgjidhet anëtar i rregullt i ASHAK-ut në Prishtinë. Në vitin 1990, zgjidhet kryetar i ASHAK-ut.

I ndjeri akademik Musa Haxhiu, menjëherë pas kryerjes së studimeve, u angazhua me tërë qenien e tij në punën mësimore dhe shkencore. Pikërisht angazhimi i tij i përhershëm rezultoi që ai dita-ditës të kontribuojë në sferën e tij shkencore dhe profesionale, kontribut ky i vlerësuar nga ekspertët më të njohur të vendit dhe atyre ndërkombëtarë. Me një punë të jashtëzakonshme kreative, ku duhet veçuar botimin e disa teksteve universitare me vlera të qëndrueshme dhe mbi 400 publikime në revistat shkencore në vend dhe në ato ndërkombëtare, prof. dr. Musa Haxhiu bëhet emër i njohur i shkencës mjekësore. Është fatkeqësi vdekja e hershme e akademikut të nderuar, sepse ai kishte potencial dhe vullnet për t'i kontribuar shkencës edhe më tutje. Ai do të ndihmonte avancimin e shkencave mjekësore në përgjithësi e posaçërisht do të ndihmonte avancimin e kuadrove të reja entuziaste mbarëshqiptare.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe të gjitha trevat shqiptare kanë humbur një shkencëtar dhe bashkëpunëtor të pasqorë. Me këtë rast, në emër të ASHAK-ut, i shpreh mirënjohje Institutit Alb Shkenca për organizimin e Simpoziumit me përkushtim të veçantë veprës kolosale të akademik Musa Haxhiut.

Dëshiroj që personaliteti i akademik Musa Haxhiut të jetë shembull frymëzimi për gjeneratat e reja”.

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE *JETA DHE VEPRJA E NËNËS TEREZË*

Nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë, në 100-vjetorin e lindjes së humanistes së madhe Nënës Terezë, organizuan më 7 shtator 2010 (në mjediset e “Grand Hotel Prishtina”) Konferencën ndërkombëtare shkencore me temë: *Jeta dhe vepra e Nënës Terezë*. Konferencën e realizoi Këshilli organizues i përbërë nga: prof. dr. Jusuf Bajraktari, kryetar, dr. Frashër Demaj, sekretar, akademik Pajazit Nushi, anëtar, dr. Don Lush Gjergji, anëtar, akademik Beqir Meta, anëtar, Shefki Ukaj anëtar, prof. dr. Hysen Matoshi, anëtar, prof. dr. Selim Daci, anëtar.

Sesionin e parë e drejtoi Kryesia e Punës e përbërë nga: prof. dr. Jusuf Bajraktari, dr.

Don Lush Gjergji, akademik Pajazit Nushi, Resmie Kryeziu dhe Arben Prendi. Fjalën e hapjes e mbajti akademik Pajazit Nushi, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nga e cila veçuan:” Kjo është Konferenca e parë shkencore ndërkombëtare, që i kushtohet shpjegimit të jetës dhe aktivitetit të Nënës Terezë, mënyrave të mendimit dhe veprimeve bamirëse, humaniste dhe paqedashëse të Anjeza Gonxhe Bojaxhiut...”

“Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës së bashku me Institutin e Historisë të Prishtinës na ka mbledhur sot jo vetëm për ta kujtuar dhe nderuar personalitetin, që i dha kuptim dhe formë humanizmit dhe historisë së shekullit njëzet, por për të shpjeguar kuptimin që Nënë Tereza i dha jetës dhe dinjitetit të njeriut në kohët më të vështira, sidomos të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar...”

“Nënë Tereza, me veprën e saj përforcoi dhe ngriti lart imazhin e popullit shqiptar në botë. Ne, duke shpjeguar filozofinë dhe psikologjinë e personalitetit kaq të lartë të Nënë Terezës dhe të veprës së saj, synojmë njëkohësisht frymëzimin e përbashkët për bamirësi e paqe ndërmjet nesh dhe të të gjithëve në botë, sepse nga gatishmëria dhe angazhimi i drejtpërdrejtë në fushën e bamirësisë, të dashurisë ndërmjerëzore dhe të humanizmit të marrëdhënieve sociale, ekonomike e politike, sipas shembullit të Nënë Terezës, varet ardhmëria jonë...”

Në emër të presidentit të Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu dhe në emër të Qeverisë së Kosovës Konferencën e përshëndeti z. Lutfi Haziri, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili, ndër të tjera, tha:

“Figura dhe veprat e Nënës Terezë u pasqyruan me admirimin dhe pietet të thellë në qindra botime në mbarë globin. Kjo trashëgimi shpirtërore e saj, e obligoi botën ta shpërblente atë edhe me Çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979, dhe gjithashtu të gjunjëzohej para arkivolit të saj gjatë varrimit më 13 shtator 2007. Mirëpo, mirënjohja më e madhe për këtë humaniste me famë botërore është dëshmuar në lumturimin e saj në Vatikan, më 19 tetor 2003, ku bijtë dhe bijat e saj nga vendet, konfesionet e ndryshme fetare, kulturat, traditat, gjuhët e ndryshme, ishin bashkuar me vlerësimin unik se *Nëna Terezë është e pavdekshme dhe Nënë Universale e Dashurisë për mbarë botën ...*

Në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të lindjes së Nënës Terezë, Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, deri në fund të dhjetorit të këtij viti, do të organizojë edhe një mori aktivitete artistike e kulturore me admirim për figurën e Nënës Terezë, siç janë përgatitja e foto ekspozitës dhe ekspozitës së librave. Meriton të veçohet edhe përgatitja e ekspozitës e arteve pamore, me temën “Jeta dhe vepra e Nënës Terezë”, ku nëpërmjet konkursit publik, piktorët tanë kanë bërë mbi 40 piktura për këtë figurë. Në organizim e sipër është edhe Java e filmave dokumentarë kushtuar Nënës Terezë.

Ndërkaq, më 19 tetor, nën patronazhin e MKRS-së, bashkë me organizatën joqeveritare *Ura e solidaritetit* realizohet projekti “Miq të Kosovës” dhe me këtë rast do të jepen 10 mirënjohje për individë dhe organizatat bamirëse ndërkombëtare, të cilat në rrethanat më të rënda e kanë ndihmuar në mënyra të ndryshme popullin e Kosovës. Gjithashtu, në gjysmën e dhjetorit do të bëhet promovimi i librave të botuar

nga Ministria e Kulturës për Nënë Terezë, si edhe do të mbahet Koncerti vokal – instrumental me vepra muzikore kushtuar Nënë Terezës”.

Në vazhdim kumtesat e tyre i paraqitën:

1. Dr. J. Bajraktari (Prishtinë), Dimension i historik i figurës së Nënë Terezës
2. Akademik P. Nushi (Prishtinë), Nënë Tereza dhe mendimi enciklopedik për jetën dhe veprën e saj
3. Dr. Don L. Gjergji (Prishtinë), Nënë Tereza dhe mendimi enciklopedik për jetën dhe veprën e saj
4. Dr. Don L. Gjergji (Prishtinë), Çdo gjë filloi në tokën time
5. Dr. G. Alpion (Londër), Nënë Tereza, kombi shqiptar dhe Ballkani.
6. S. Vazhakala (Kalkutë), Karizma e Nënë Terezës
7. Akademik E. Berisha (Prishtinë), Nënë Tereza në krijimtarinë muzikore të autorëve shqiptarë të Kosovës
8. Dr. Z. Chiaramonte (Palermo), Lazër Bojaxhiu në mjedisin arbëresh dhe pëshpëritjet për motrën e tij të madhe
9. Dr. I. Hoti (Prishtinë), Ndikimi i rrethanave kulturo-historike në formimin e personalitetit të Nënë Terezës
10. Dr. R. Kryeziu (Prishtinë), Figura e nënë Terezës në letërsinë shqipe
11. Dr. T. Kurti (Tiranë), Nënë Tereza në artet figurative

Sesioni i dytë u kryesua nga: Dr. Frashër Demaj, Dr. Teki Kurti, Dr. Resmie Kryeziu, Dr. Gëzim Alpion, Dr. Fehmi Rexhepi, ndërsa kumtesat e tyre i mbajtën:

1. Dr. I. Hasani (Prishtinë), Nënë Tereza bartëse e kauzës sociale
2. Dr. F. Demaj (Prishtinë), Nënë Tereza nobeliste
3. Dr. A. Nikë Berisha (Kozencë), Përmasa e hyjnit të Nënë Terezës
4. Dr. F. Rexhepi (Prishtinë), Nënë Tereza në tekstet shkollore të historisë
5. Mr. Q. I Morina (Prishtinë), Portreti i Nënë Terezës në shtypin arab
6. Dr. N. Dervishi (Tetovë), Figura e Nënë Terezës në mediet e Maqedonisë
7. B. Lika (Ulqin), Shtypi i Malit të Zi për Nënë Terezën
8. A. Prendi (Tiranë), Poezi e Nënë Terezës.

Nga kumtesa e P. Nushit veçuan: “Enciklopedistika dhe mendimi shkencor ka filluar të merret me gjurmimin e veprimtarisë së Nënë Terezës në fillim të viteve ‘60 të sh. 20, kur aktiviteti i saj bamirës dhe dashuria ndaj njerëzve përvuajtës, të sëmurë e para vdekjes u konsiderua e u afirmua në nivel të lartë të humanizmit”.

“Për këtë rast duhet theksuar tri gjykime vlerësuese: 1. Gati 1/3 e fundit e shekullit njëzet ka qenë koha e shkrimeve më të rëndësishme për Nënë Terezën, që i kanë paraprirë enciklopedistikës dhe pikërisht gjatë kësaj kohe Nënë Tereza u bë e njohur për shumë vende nëpërmes teksteve enciklopedike; 2. Nënë Tereza ka hyrë në enciklopedi për të gjallë të saj dhe 3. Zëri Nënë Tereza u bë njësi enciklopedike në fillim në tipin e enciklopedisë së përgjithshme dhe më pas në tipin e enciklopedisë kombëtare...”

“Enciklopedia e re Britanike argumentimin për veprimtari të Nënë Terezës dhe etikën e filozofisë së jetës së saj e ka dhënë duke u mbështetur në rend të parë në rëndësinë dhe domethënien e çmimeve më të larta ndërkombëtare të fituara nga Nënë Tereza. Enciklopedia e Re Britanike e ndërthurë mirë veprimtarinë kishtare me atë humanitare, duke mos lënë pa përmendur as, siç shkruan, se: “Më 1946, Motër

Tereza përjetoi “një thirrje”, të cilën e konsideroi inspirim hyjnor për t’iu përkushtuar kujdesit për të sëmurët dhe të varfrit...”

“Nënë Tereza ka synuar që nëpërmes të aktivitetit bamirës, humanitar dhe të paqes të pasqyruar në dashurinë ndaj zotit të saj dhe dashurinë ndaj të varfërve, të sëmurëve dhe të pashpresëve. Ky do të ishte caku përfundimtar i besimit dhe i bindjes për qenien njerëzore. Nënë Tereza, me aktivitetin e saj kishtar dhe me sakrificën e jashtëzakonshme të përqendruar në bamirësi, në humanizëm dhe në paqe, merr përmasa universale. Kështu, Nënë Tereza bëhet “Nënë universale...”

“Sakrifika dhe veprimtaria bamirëse e Nënë Terezës e shoqëruar me misionin e paqes në botë dhe të dashurisë ndërmjet njerëzve ka përkuar drejtpërdrejt me angazhimet njerëzore për të nderuar dhe respektuar dinjitetin e njeriut pa dallim race, kombi, gjinie e moshe...”

Prof. dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë, në fjalën përmbyllëse, në mbarim të Konferencës, theksoi se në Konferencë referuan kontributet e tyre studiues e njohës të veprës e të jetës së Nënës Terezë dhe vlerësoi lart kontributin e tyre, si në aspektin shkencor, po ashtu edhe në “...aspektin e rëndësisë shoqërore që pati ajo në Kosovë dhe në mediumet tona e të huaja”.

KONFERENCA SHKENCORE “*MARTIN CAMAJ NË KULTURËN SHQIPTARE*”

Më 24 shtator 2010, në Tiranë, me organizim të Qendrës së Studimeve Albanologjike, u mbajt Konferenca shkencore “Martin Camaj në kulturën shqiptare”, me rastin e 85-vjetorit të lindjes së këtij albanologu dhe shkrimtari të shquar.

Punimet e Konferencës u zhvilluan në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Përveç fjalëve të hapjes dhe të mbylljes, u lexuan 36 kumtesa dhe pati diskutime. Seancën e parë të hapjes, në të cilën u lexuan fjalët e drejtorit të Qendrës së Studimeve Albanologjike – dr. Ardian Marashi dhe akademik Kolec Topalli për figurën dhe veprën e Martin Camajt, përshëndetjet e zëvendësministrit të Kulturës të Shqipërisë, të shoqatës “Dukagjini” dhe të zonjës Erica Camaj, e drejtuan 5 veta, ndër të cilët dhe zonja Camaj, dy studiues nga Shqipëria, akademik Rexhep Ismajli dhe akademik Sabri Hamiti nga Kosova. Në seancën e letërsisë kumtesë lexoi akademik Sabri Hamiti. Në seancën e gjuhësisë akademik Rexhep Ismajli lexoi kumtesën: “Martin Camaj për shkrimet e hershme shqip”. Fjalën e përfundimeve të Konferencës e mbajti R. Ismajli, nga e cila veçuam: “...dëgjuam 36 kumtesa për aspekte të ndryshme të veprës së shkrimtarit dhe albanistit të shquar shqiptar të gjysmës II të sh. XX, Martin Camajt. U mbajtën dy fjalë të hyrjes, u sollën shënime të reja për jetën e tij dhe u dëgjua një fjalë e gjallë e Martinit... Në kulturën tonë të zhvilluar me kapërcime, golla, ndalesa, po kemi ende nevojë për të rehabilituar apo për të kthyer në jetë normale vepra e autorë të lënë anash, apo edhe më keq, të pamundësuar. Martin Camaj është studiues dhe shkrimtar që në kulturën shqiptare ishte dhe s’ishte. Si shkrimtar ai nisi në Prishtinë... Fazën e botimeve të Camajt në Mynih e karakterizon ajo që njihet si modernitet i Martin Camajt në poezi – vitet 1967-1992. ... U desh të priteshin vitet ’90 që letërsia e tij të vinte pak më çlirshëm në Kosovë dhe për herë të parë në Shqipëri. Më 1995, në Tiranë, pati një botim të veprës së Camajt në 5 vëllime nga Ardian Klosi dhe me atë rast nuk u

përfshinë 2 vëllimet e botuara në Prishtinë të viteve 1953-54. Në Prishtinë, në ato vite, pati botime veprash të veçanta, ndërsa në vitin 2000 “Dukagjini” i Pejës botoi të gjitha poezitë e M. Camjati në vëllimin “Lirika”, ku përfshiheshin dhe variantet dhe dorëshkrimet. Ndërkohë, përveç shkrimeve të shpërndara në formë artikujsh, studimesh, parathëniesh, për veprën letrare të Camajt u botuan dhe monografi, çka tregon se leximi i veprës është në rrjedhë dhe interesimi që ka zgjuar ajo nuk është i vogël. Vepra e Camajt qysh me të gjallë të tij, sidomos “Lirika”, ka përjetuar përkthime gjermanisht, italisht e anglisht në plotni më të madhe, ndërsa në antologjitë dhe përzgjedhjet e bëra ndërkohë në gjuhë të ndryshme poezia e tij është vazhdimisht e pranishme. Për këto aspekte në këtë konferencë nuk pati diskutime... Po shihet se vepra letrare e Martin Camajt tashmë po merr një dimensionim të ri. Në studimet albanistike Camaj spikat studiues i veprës dhe gjuhës së Gjon Buzukut dhe teksteve të vjetra shqipe. Si më parë, edhe në këtë konferencë me të drejtë u cilësua si një nga buzukologët e mëdhenj. Martin Camaj njihet si një nga studiuesit e shquar të historisë së fjalëformimit shqip, sidomos në suaza të sistemit emëror, për çka nuk u fol sot. Albanische Wortbildung e botuar më 1966 qe cilësuar e rëndësishme në atë kohë nga recensues të ndryshëm, ndër të cilët dhe I. Ajeti, dhe vazhdon të referohet edhe sot në studimet e specializuara. Mbase del e nevojshme të përkthehet nga gjermanishtja. Martin Camaj është shquar dhe për studimet e të folmeve arbëreshe, për çka pati disa diskutime, por mund të flitet edhe më shumë. Albanian Grammar e tij zë vend të veçantë në gramatologjinë e kohës... U diskutuan, gjithashtu, aspektet standardologjike të veprës së tij, aspektet e begatisë leksikore në veprën e Camajt, etj. Më duket se Konferencës do t’i rritej vlera edhe më shumë po të kishte pak më tepër hapësirë për diskutime. Mënyra e vetme që për autorë të shquar të kulturës sonë të mos na ndodhë më të na thuhet se nuk e kuptojnë për arsye nga më të ndryshmet është pikërisht kjo: të vihen në qarkullim normal veprat e tyre dhe të flitet për to pa paragjykime”.

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “MENAXHIMI – SFIDË MADHORE E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR” (15 TETOR 2010)

Në organizim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në kuadrin e Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet ASHSH dhe ASHAK për periudhën 2009-2011, pika 13) u mbajt në Tiranë më 15 tetor 2010 Konferenca shkencore ndërkombëtare “Menaxhimi – sfidë madhore e shërbimit shëndetësor”. Konferenca u përkrah nga USAID, Albania. Bashkorganizatorë të kësaj konference ishin Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë dhe Ministria e Shëndetësisë e Kosovës.

Në raportin që morëm nga ASHSH-ja, ndër të tjera, shënohet: “Konferenca punimet i zhvilloi në sallën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nën kujdestarinë e kryeministrit të Shqipërisë, prof. dr. Sali Berisha. Në të morën pjesë më se 100 pjesëmarrës, të vendit e të huaj, aktorë kryesorë të sistemit shëndetësor në Shqipëri e Kosovë (drejtues të spitaleve rajonale, drejtues të drejtorive rajonale të shëndetit publik etj.), si edhe ekspertë të lartë e personalitete të vendit e nga rajoni të fushës së shëndetësisë, si nga Maqedonia, Austria, Turqia, Italia, Britania e Madhe etj., Mi-

nistri i Shëndetësisë i Shqipërisë z. Petrit Vasili, ministri i Shëndetësisë i Kosovës z. Bujar Bukoshi, ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë z. Bujar Osmani, kryetari i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve, akademik Felix Unger, kryetari i Akademisë së Shkencave të Turqisë, akademik Yucel Kanpolat, akademiku maqedonas Momir Polenaković etj.

Konferencën e përshëndetën kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Gudar Beqiraj dhe sekretari i përgjithshëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Engjëll Berisha, në emër të Kryetarit të saj. Mori pjesë edhe akademik Latif Susuri, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut. Në fjalën e tij përshëndetëse sekretari i përgjithshëm i ASHAK-ut Berisha, ndër të tjera, tha: “I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha, i nderuar kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Gudar Beqiraj, të nderuar ministra respektivë të shëndetësisë të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë: Vasili, Bukoshi dhe Osmani, të nderuar autorë të kumtesave të kësaj Konferencë, zonja e zotërinj,

Jam i nderuar që në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mund ta përshëndes punën e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me temë: *Menaxhimi – sfidë madhore e shërbimit shëndetësor*, organizuar nga dy akademitë tona motra: Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Ky projekt i rëndësishëm nga fusha e shëndetësisë, i cili po realizohet sot është njëra prej më shumë se 30 pikave të Protokollit të bashkëpunimit tonë për vitet 2009 – 2011.

Numri i konsiderueshëm i autorëve të kumtesave dhe temat e larmishme, që do të paraqiten me kompetencë shkencore e profesionale në këtë Konferencë, na japin shpresë se problemet e shumta të shëndetësisë në vendet tona do të fillojnë të menaxhohen si duhet dhe gradualisht të zgjidhen, në të mirë të njerëzve në nevojë.

Duke përmbyllur këtë fjalë të shkurtër të rastit, më lejoni që Konferencës t’i uroj sukses të plotë!”

Ministri i Shëndetësisë i Shqipërisë, i Kosovës dhe ai i Maqedonisë referuan për çështjet prioritare të sistemit e të shërbimit shëndetësor në vendet përkatëse të tyre, ndërsa z. Joseph C. Williams, drejtor i Misionit USAID, Albania, theksoi vepërimitaritet, angazhimet dhe mbështetjen që jep misioni në fuqizimin e sistemeve shëndetësore në Shqipëri, si dhe vuri në dukje se është rritur transparenca dhe efienca në sistemin shëndetësor në Shqipëri.

Kryeministri i Shqipërisë, prof. dr. Sali Berisha, në fjalën e tij përgëzoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe atë të Kosovës për iniciativën e ndërmarrë, të cilën e quajti të shkëlqyer. Ai përgëzoi, gjithashtu, punonjësit e sistemit shëndetësor në Shqipëri, që ia dolën të rivendosin në baza të reja sistemin shëndetësor në vend e ta riorientojnë sistemin në tërësi, që të përballlet me sfidat e mëdha të kohës. Ai vuri në dukje gjithashtu disa tregues të rëndësishëm shëndetësorë, që janë arritur në vend.

Referimet e Konferencës, gjithsej 23, u grupuan sipas tematikave në katër seanca. Në to u shtjelluan çështje të larmishme, si: financimet e shërbimit shëndetësor,

kujdesi parësor shëndetësor, menaxhimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor, burimet njerëzore, edukimi i vazhdueshëm shëndetësor, akreditimi e cilësia në sistemin shëndetësor, menaxhimi i sistemit të informacionit shëndetësor, edukimi shëndetësor në distancë, sistemet e telemjekësisë e shumë çështje të tjera specifike. Përmbajtja kryesore e këtyre referimeve ishte përfshirë në librin e abstrakteve, që u botua përpara Konferencës dhe u fut në materialet që iu shpërndanë të gjithë pjesëmarrësve.

Në përfundim të Konferencës u firmos një Kartë e Konferencës. Ajo përmban formulimet dhe rekomandimet e Konferencës për përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit dhe të performancës së sistemeve shëndetësore të të tri vendeve, në përputhje me të gjitha rezolutat, deklaratat, kartat e konventat e mëparshme në bashkëpunim me OBSH-në dhe institucionet partnere ndërkombëtare. Karta u firmos nga ministri i Shëndetësisë i Shqipërisë, i Kosovës dhe ai i Maqedonisë, si dhe nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Akademia e Shkencave e Shqipërisë tani është në fazën e përgatitjes për botim të materialeve të plota të paraqitura në Konferencë.

Në vazhdim u miratua: *Karta e Konferencës “Menaxhimi – sfidë madhore e sistemit shëndetësor”*

SHËNOHET 90-VJETORI I LINDJES SË AKADEMIK MARK KRASNIQIT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shënoi, në mjediset e saj, më 19 tetor 2010, 90-vjetorin e lindjes së akademik Mark Krasniqit. Morën pjesë anëtarë të Akademisë, profesorë të Universitetit të Prishtinës, familjarë, miq dhe dashamirës të veprës së akademikut tonë të shquar, si dhe përfaqësues të medieeve. Fjalë përshëndetëse e mbajti akademik Besim Bokshi, kryetar i Akademisë. Për figurën dhe veprën e Akademik Mark krasniqit folën edhe akademik Pajazit Nushi, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, dhe dr. Xhevat Sylja. Fjalët e tyre botohen në këtë numër të revistës.

TRYEZA SHKENCORE “SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I PASURIVE NATYRORE”

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i Shkencave Shoqërore organizoi në mjediset e Akademisë, më 20 tetor 2010, tryezën shkencore me temë: *Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore*.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Pajazit Nushi, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, nga e cila veçuan: “Synimi i trajtimit të kësaj çështjeje të rëndësishme u mbështet në këto qëndrime:

1. Pasuritë natyrore të secilit vend, sidomos pasuritë natyrore të shtetit në ndërtim të Kosovës, përbëjnë komponentin themelore të tërësisë së zhvillimit ekonomik, social dhe politik të pavarësisht të plotë të shtetit – të Republikës së Kosovës.
2. Pasuritë natyrore janë të papërsëritshme dhe shi për këtë kërkohet konceptim i qartë, i balancuar i angazhimeve të koordinuara afatgjate dhe frytdhënëse për

brezin e tashëm dhe brezat e ardhshëm.

3. Për shkak se resurset natyrore janë të rralla dhe kapacitetet e tyre nuk janë të pafundme, për Kosovën me zhvillim demografik karakteristik dhe me synime integruese të gjera, shfrytëzimit të tyre duhet t'i paraprijë strategjia e balancuar dhe koordinuese e konceptuar mbi objektivat afatgjatë të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës.

Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën:

1. Akademik Minir Dushi, "Shfrytëzimi i pasurive minerale, dje sot dhe nesër"
2. Akademik L. Susuri dhe dr. sc. S. Kaçi, "Resurset bujqësore dhe zhvillimi rural i Kosovës"
3. Dr. M. Mustafa, "Mjedisi institucional për shfrytëzimin efektiv të burimeve natyrore"
4. Dr. I. Mustafa - anëtar korrespondent i ASHAK-ut, "Zhvillimi i qëndrueshëm dhe resurset e përsëritshme dhe të papërsëritshme"
5. Dr. R. Pllana dhe Dr. V. Pruthi, "Resurset ujore dhe sfidat ujore në Republikën e Kosovës"
6. Dr. A. Hajdari, "Rregullativa ligjore e shfrytëzimit të resurseve natyrore të Kosovës"
7. Dr. A. Hoti, "Ndikimi i pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik dhe në punësim"
8. Dr. P. Gashi, "Resurset natyrore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim: rekomandime për Kosovën"

Tryeza u përmyll me përfshirjen në diskutim të shumicës së pjesëmarrësve.

AMBASADORI I KROACISË VIZITON ASHAK-un

Me kërkesën e tij, ambasadori i Republikës së Kroacisë, z. Zlatko Kramariq, i shoqëruar nga përfaqësues të Entit Leksikografik "Miroslav Kërlezha" të Zagrebit: mr.sc. Vlaho Bogishiq, kryeredaktor, mr. sc. Bruno Kragiq, redaktor dhe docent Tomislav Brlek, bashkëpunëtor i jashtëm i këtij Enti, vizitoi më 1 nëntor 2010 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Mysafirët u pritën nga akademik Besim Bokshi, kryetar, akademik Hivzi Islami, nënkryetar dhe akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i ASHAK-ut. Kreyetari Bokshi u uroi mirëseardhjen mysafirëve dhe i informoi ata, në pika të shkurtra, për historikun dhe për punën e Akademisë, sidomos për bashkëpunimin e Akademisë sonë me akademitë e tjera. Shfaqti interesimin e Akademisë për bashkëpunim edhe me Akademinë Kroate të Shkencave dhe të Arteve, me të cilën kemi të nënshkruar një Marrëveshje kornizë të bashkëpunimit (1994).

Ambasadori Kramariq falënderoi për pritjen dhe për informatat mbi Akademinë dhe premtoi se do të angazhohet personalisht për rivënien e lidhjeve midis dy akademive dhe për bashkëpunim të gjithanshëm midis dy vendeve. Kryeredaktori Bogishiq foli për punën që po bën Enti Leksikografik "Miroslav Kërlezha", për bashkëpunimin e këtij Enti me vendet fqinje dhe me vendet e tjera, duke përfshirë këtu edhe Serbinë. Theksoi interesimin e tyre për bashkëpunim edhe me vendin tonë për shumë pika të interesit të ndërsjellë dhe për këtë qëllim ai me kolegët e tij, sot, kanë vizituar edhe disa institucione të kulturës në Prishtinë. Akademik Ismajli indormoi për ekzistimin (në themelim) e Qendrës Leksikografike-

Enciklopedike pranë ASHAK-ut, pastaj foli për traditën e bashkëpunimit me institucionet e Kroacisë, për nevojën e shfrytëzimit të përvojës së Entit Leksikografik të Zagrebit, e cila do të ndihmonte në realizimin e projektit *Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX*, për nevojën e një vizite në Zagreb me qëllim të konkretizimit të pikave të bashkëpunimit, për mungesën e botimeve të Akademisë Kroate dhe të Entit, etj.

Nënkryetari Islami u shpreh i bindur se ekzistojnë mundësit reale të bashkëpunimit.

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE ME RASTIN E 100-VJETORIT TË LINDJES SË ALEKS BUDËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Aleks Budës ka organizuar Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: *“ALEKS BUDA një jetë për albanologjinë”*. Konferenca u mbajt në Tiranë, më 25 tetor 2010.

Nga Kosova në Konferencë kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga ASHAK, akademikët Hivzi Islami, nënkryetar, dhe Rexhep Ismajli e Mehmet Kraja, anëtarë, nga Instituti i Historisë i Kosovës: historiani dhe drejtori dr. Jusuf Bajraktari dhe historiani dr. Fehmi Rexhepi, ndërsa nga Fakulteti Filozofik i Prishtinës, Dega e Historisë, mori pjesë prof. dr. Selim Daci.

Konferenca njëditore i zhvilloi punimet në mjediset e Akademisë, në sallën me emrin e Aleks Budës, i cili ishte në krye të këtij institucioni nga themelimi (1972) deri në fund të jetës së tij (1993). Fjalën e hapjes e mbajti zv. kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof. Muzafer Korkuti, ndërsa në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës Konferencën e përshëndeti nënkryetari i saj, akademik Hivzi Islami. Nënkryetari Islami, në fjalën e tij përshëndetëse, ndër të tjera, tha: “Më lejoni që në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës t’i përshëndes punimet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademikut dhe profesorit Aleks Buda, njërit nga personalitetet më të shquara shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX, i cili la gjurmë të thella në jetën shkencore, kulturore dhe kombëtare në Shqipëri dhe në gjithë botën shqiptare. Me veprimtarinë e tij shkencore dhe kulturën e përgjithshme që posedonte, prof. Buda ishte i njohur edhe në suaza ndërkombëtare, veçanërisht në qarqet arsimore e shkencore të Italisë dhe të Austrisë, ku edhe ishte shkolluar dhe formësuar si dijetar.

Për figurat e mëdha, pas shkuarjes së tyre, bashkëpunëtorët dhe pasuesit e tyre gjithmonë kanë çka thonë. Duke gjurmuar jetën dhe veprën e tyre ata gjejnë të dhëna dhe fakte të reja. Referuesit, që do të flasin sot në këtë konferencë për personalitetin e prof. Budës, pritjet të nxjerrin në dritë shumëçka nga jeta dhe veprimtaria e gjithanshme e tij.

Pjesëtarët e brezit tim nga Kosova nuk patën shumë mundësi ta njihnin për së afërmi prof. Aleks Budën, për arsye të dallimeve në formësimin intelektual, të dallimeve të mëdha në moshë dhe, së fundi, për shkaqe të mbylljes hermetike të kufirit Kosovë-Shqipëri pas vitit të madh për Kosovën dhe shqiptarët, 1981-shin. Pas vitit 1976, unë pata fatin ta takoja profesorin edhe një herë në korrik të vitit 1991 kur

situata në Shqipëri ishte shumë e rëndë, por edhe gjendja shëndetësore e tij ishte rënduar. Me dy miq shkuam që ta takonim, me mendimin që të qëndronim vetëm 10-15 minuta. Na priti, si gjithmonë, me butësinë, optimizmin dhe antropologjinë prej intelektual, duke na mbajtur 1 orë e gjysmë. Krejt në fund, më tha ju kemi mbetur borxh dhe nuk kemi bërë sa duhet për ju në Kosovë. Mendonte, besoj, në historiografi.

Vepra e prof. Budës, me rezultate të qëndrueshme shkencore, dhe veprimtaria e tij e jashtëzakonshme në organizimin e punës kërkimore-shkencore dhe të institucioneve shkencore e kulturore, mbeten pa dyshim burim reference dhe frymëzimi për brezat e sotëm dhe të nesërm. Këta breza do të jenë mirënjohës për tërë atë që ka bërë në fushën e dijeve albanologjike dhe në afirmimin e rezultateve të tyre jashtë kufijve shtetërorë e kombëtarë.

Qarqet shkencore dhe intelektuale në Kosovë kishin dhe kanë një respekt të madh për prof. Aleks Budën, si dijetar dhe si personalitet me kulturë të gjerë, por edhe me paraqitjet e tij publike ndaj zhvillimeve politike në Kosovë dhe ndaj çështjes së Kosovës pas agresivitetit serbo-jugosllav në fillim të viteve '80. Si polemist i mprehtë me bartësit e pikëpamjeve antishkencore dhe antishqiptare reagoi ndaj shkrimeve të sllavistëve francezë në "Le Monde" të Parisit më 1981 dhe ndaj librit "*Ilirët dhe shqiptarët*" të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve më 1985, ku shtrembëroheshin faktet historike e të tjera ndaj shqiptarëve të Kosovës. Për këto arsye, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në serinë e veprave të traditës albanologjike, në vitin 2006 botoi një përmbledhje studimesh e trajtesash historiografike të prof. Budës në një vëllim prej 600 faqesh. Botimi u përgatit nën përkujdesjen e prof. Fehmi Rexhepit, dr. Tatjana Haxhimihalit, e bija e profesor Budës, dhe timen. Parathënien për rrugën jetësore dhe shkencore të prof. Budës, që është një tekst studimor, e shkroi akademik Rexhep Ismajli".

Në Konferencë u mbajtën gjithsej 16 kumtesa, kryesisht nga historianët. 10 referues ishin nga Shqipëria, 3 nga Kosova dhe 3 të huaj (2 nga Gjermania dhe 1 nga Franca). Akademik Rexhep Ismajli mbajti kumtesën me titull "Çështja e prejardhjes së gjuhës shqipe – refleksë në nderim të prof. Aleks Budës". Dr. Jusuf Bajraktari lexoi kumtesën "Kontributi i prof. Aleks Budës për historinë e Kosovës", ndërkaq prof. Selim Daci mbajti kumtesën "Vendi i shqiptarëve në shek. VII-XVIII në historinë evropiane sipas prof. Aleks Budës".

PANELI NDËRAKADEMIK (IAP) ORGANIZON KONFERENCË SHKENCORE PËR ZBATIMIN E QASJES ZBULUESE NË MËSIMDHËNIË

Në Konferencën e Panelit Ndërakademik (IAP) për mësimdhënien e lëndëve shkencore në shkollën e mesme me temë: "Zbatimi i qasjes zbuluese në mësimdhënien e lëndëve shkencore në shkollën e mesme" (Taking Inquiry-Based Science Education (IBSE) into Secondary Education),

Akademikë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e ka përfaqësuar prof. dr. Dukagjin Pupovci. Konferenca u mbajt në York të Britanisë së Madhe prej 27-29 tetor 2010. Organizatorë të Konferencës ishin Paneli Ndërakademik (IAP), pjesë e

rrjetit global të akademive të shkencave, ndërsa sponsorë ishin Asociacioni i Akademive Evropiane të Shkencave (ALLEA), Akademia Mbretërore e Shkencave e Britanisë së Madhe, the Wellcome Trust dhe Qendra Kombëtare për Mësimin e Shkencave (NSLC) e Universitetit të Yorkut, ku edhe u mbajt Konferenca. Në Konferencë kanë marrë pjesë 74 pjesëmarrës nga shumë vende të botës me përfaqësim të balancuar të akademive të shkencave nga të pesë kontinentet.

Nga raporti i prof. Pupovciç veçuar: “Tema e Konferencës ishte mjaft aktuale për të gjitha akademitë pjesëmarrëse, sepse konsiderohej se nga niveli i njohurive bazike të lëndëve shkencore varet progresi dhe mirëqenia e përgjithshme e një shoqërie”.

“Derisa në një numër të konsiderueshëm vendesh kishte përvoja të mira me mësimdhënien zbuluese në arsimin fillor, disa prej tyre, në mesin e tyre edhe Kosova, as që kanë filluar të punojnë në këtë drejtim, përjashtoj disa nisma dhe projekte të izoluara. Prandaj, përfaqësuesit e akademive nga këto vende bënin përpjekje të mësojnë nga përvoja e vendeve që tanimë kanë kaluar në këtë proces, për të parë nëse këto përvoja janë të transmetueshme.

Edhe unë mora një pozicion të tillë. Gjatë ditëve të Konferencës bëra përpjekje të bisedoj me sa më shumë kolegë nga vende të zhvilluara dhe në zhvillim për të parë se deri ku kanë arritur dhe, me përjashtim të disa shteteve ku sistemi i arsimit është shumë i avancuar, problemet ishin, pak a shumë, të njëjta: 1) Përgatitja joadekuatë e mësimdhënësve; 2) Ngarkesa e planeve dhe programeve mësimore dhe jofleksibiliteti në realizimin e tyre; 3) Orientimi kah vlerësimi. Të gjitha këto çështje dhe shumë të tjera u diskutuan në sesionet plenare të Konferencës, si dhe në grupe të vogla, ku kishte më shumë hapësirë për dialog. Gjatë debateve të tilla u dhanë shembuj të mirë të zbatimit të qasjes zbuluese në mësimdhënien e shkencave nga vende të ndryshme, por edhe u bisedua për problemet në zbatimin e tyre”.

“Në qershor të vitit 2009, ALLEA ka krijuar një grup pune për mësimdhënien e shkencave me qëllim që t’i mobilizojë akademitë anëtare për të kontribuar në promovimin e qasjes zbuluese, sipas modelit të akademive të shkencave nga Amerika Jugore. Mbledhja e grupit të punës ishte në program më 29 tetor në orët e pasdites, ndërsa unë, për fat të keq, nuk munda të marr pjesë në të për shkak të orarit të fluturimit. Megjithatë, besoj se pjesëmarrja në dy ditët e Konferencës, ku u bisedua për këto probleme në vende të ndryshme të botës, e më së shumti në vende evropiane, më dha informacion të mjaftueshëm për pjesëmarrje të mëtutjeshme në këto aktivitete.

Në Kosovë është në proces zhvillimi i kurrikulit të ri për arsimin e përgjithshëm, i cili parasheh që shkencat të jenë një nga gjashtë fushat mësimore. Hëpërhë, janë duke u zhvilluar rezultatet e pritshme të të nxënësve sipas niveleve, ndërsa plani është që mësimdhënien të organizohet në formë të integruar, që është një sfidë jashtëzakonisht e madhe në Kosovë, si për shkak të strukturës kualifikuese të mësimdhënësve, ashtu edhe për shkak të teksteve mësimore, infrastrukturës dhe faktorëve të tjerë kufizues.

Duke pasur parasysh faktin se ASHAK ka një numër anëtarësh nga fusha e

shkencave që gëzojnë prestigj në shoqëri, por nuk janë drejtpërdrejt të angazhuar në procesin e zhvillimit të kurrikulit të ri, ia vlen të mendohet për vendosjen e një komunikimi me MASHT-in, që do të mund të rezultonte me një bashkëpunim në ndërtimin e një sistemi përkrahës për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies së shkencave në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Mendoj se roli i ASHAK-ut do të ishte më tepër i karakterit këshillues dhe promovues, duke i ngritur çështjet dhe duke marrë pjesë në diskutimin rreth tyre. Disa çështje të tilla mund të jenë:

1. Të ngrihet vetëdija te politikëbërësit dhe ekspertët se mësimdhënia e shkencave është shumë me rëndësi për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës, sepse prej saj varet nëse do të kemi një rini të arsimuar mirë dhe të përgatitur për qenë subjekt i këtij zhvillimi. Shkathtësitë që sjell qasja zbuluese në mësimdhënien e shkencave janë faktorë përcaktues në karrierën e të riut dhe në krijimin e një mase kritike të njerëzve, që mund të jenë pjesë e proceseve zhvillimore në shoqëri.

2. Zbatimi i qasjeve bashkëkohore në mësimdhënien e shkencave kërkon reformim rrënjësor të programeve të përgatitjes së mësimdhënësve në Universitet, si dhe ndërtim të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve ekzistues. Është e nevojshme të bëhet një lëvizje nga specializimi njëlëndor i studentëve, drejt specializimit në dy ose tri fusha, që mund të arrihet me përcaktimin e drejtë të kohëzgjatjes dhe programit të studimeve. Te mësimdhënësit e tanishëm dhe të ardhshëm duhet të zhvillohen shkathtësitë kërkimore dhe digjitale, nëse pritet prej tyre që këto t'i përcjellin te nxënësit.

3. Shkollat e Kosovës duhet të ofrojnë mundësi për mësimin aktiv të shkencave, përmes zbatimit të eksperimentit dhe të demonstrimit. Për këtë qëllim ato duhet të jenë të pajisura me infrastrukturë adekuate, ndërsa duhet të lejohet që të bëhen shmangie nga oraret e ngurta të mësimin kur një gjë e tillë është në dobi të përveçtësimit më të mirë të materialit.

4. ASHAK mund të angazhohet për ngritjen e cilësisë së teksteve mësimore dhe të materialeve mësimore nga disiplinat e shkencave, duke insistuar që këto tekste dhe materiale të ofrojnë ide për realizimin e eksperimenteve, demonstrimeve dhe vëzhgimeve, duke shfrytëzuar mjete që janë në dispozicion të shkollave dhe të nxënësve.

Sa i përket koordinimit me ALLEA-n, mendoj se roli i tyre do të jetë më tepër nxitës dhe përkrahës, nuk mund të pritet ndonjë aksion i përbashkët në të gjitha vendet pjesëmarrëse në program për shkak të kushteve të ndryshme, në të cilat gjenden sistemet shkollore të ndryshme. Pa marrë parasysh këtë, mendoj se ASHAK duhet të marrë pjesë edhe në takime të tjera të Grupit të Punës për Shkenca të Natyrës”.

PJESËMARRJE NË PANAIRIN E LIBRIT “TIRANA 2010”

Pas pjesëmarrjes në ceremoninë e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së akademik B. Bokshit, kryetar i ASHAK, organizuar nga Komuna e Gjakovës më 12 nëntor 2010, kur me atë rast iu dha çmimi “*Nderi i qytetit të Gjakovës*”, ne: akademik Hivzi Islami, nënkryetar i Akademisë, akademik R. Ismajli (foli me këtë rast për jetën dhe veprën e kryetarit Bokshi) dhe mr. Z. Bylykbashi, bashkë me shoferin e Akademisë,

udhëtuaam për në Tiranë dhe vizituam Panairin e librit “Tirana 2010”.

Në Tiranë arritëm në mbrëmje, ndërsa të nesërmen vizituam botimet e ekspozuara në Panair. Me qëllim të pasurimit të Bibliotekës së Akademisë me libra të rinj përzgjedhëm dhe blemë disa prej tyre, të cilët besojmë se do t’u hyjnë në punë anëtarëve të Akademisë. Brenda mjediseve të Pallatit të Kongreseve, ku u organizua Panairi, përveç anëtarëve të Akademisë sonë (Ali Aliun dhe Mehmet Krajën, të cilët ishin prezantuar me botimet më të reja të tyre), takuam edhe anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, punonjës të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe personalitete të rëndësishme të kulturës.

AKADEMIK PAJAZIT NUSHI NË SHËNIMIN E 80-VJETORIT TË LINDJES SË AKADEMIK BEDRI DEDJES

Në Konferencën jubilarë, që e organizoi Akademia e Shkencave e Shqipërisë në 80-vjetorin e lindjes së akademik Bedri Dedjes në Tiranë, më 19 nëntor 2010, mori pjesë dhe përshëndeti në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës akademik Pajazit Nushi, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut.

SHËNOHET 80-VJETORI I LINDJES SË AKADEMIK BESIM BOKSHIT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 24 nëntor 2010, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë, shënoi 80-vjetorin e lindjes së akademik Besim Bokshit, kryetar i Akademisë. Në solmnitetin e organizuar morën pjesë anëtarë të Akademisë, familjarë të akademik Bokshit, pedagogë e studiues të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës dhe të Universitetit të Tiranës, z. Pal Leka, kryetar i Komunës së Gjakovës, miq e dashamirë të profesor Bokshit dhe të veprës së tij, përfaqësues të medieve.

Fjalë rasti mbajti akademik Hivzi Islami, nënkryetar i Akademisë, akademik Rexhep Ismajli, akademik Idriz Ajeti, akademik Kolec Topalli, prof. Dr. Seit Mansaku, akademik Ethem Likaj, akademik Ali Aliu dhe prof. Dr. Imri Badallaj.

Manifestimi u mbyll me fjalën e jubilarit. Të gjitha fjalët botohen në këtë numër të revistës.

VIZITË PUNE NË AKADEMINË SLOVENE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Nënkryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami dhe këshilltari i Kryetarit të Akademisë mr. Zija Bylykbashi kanë vizituar Akademinë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve (ASSHA) nga 15-17 dhjetori 2010. Më 16 dhjetor, nga ora 10:00, në mjediset e Akademisë kanë pasur takim pune me z. Zoran Mezeg, drejtor i Administratës së Akademisë Sllovene.

Vizita ka pasur për qëllim njohjen me organizimin e administratës së Akademisë Sllovene, diskutimin lidhur me funksionimin e saj, numrin e punëtorëve, kualifikimet dhe përgjegjësitë e tyre, etj. Është diskutuar edhe për çështje të funksionimit të Akademisë, për organet drejtuese të saj, për financimin, mënyrën e realizimit të projekteve të caktuara të Akademisë. Të gjitha këto në funksion të përfitimit edhe të përvojave të reja, që do të na

hynin në punë me rastin e (ri)organizimit të Administratës së Akademisë sonë në kushte të reja të punës.

MBAHET NË DURRËS KONFERENCA SHKENCORE “SHQIPJA NË ETAPËN E SOTME: POLITIKAT E PËRMIRËSIMIT DHE TË PASURIMIT TË STANDARDIT.”

Në Konferencën shkencore “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, e cila, në organizim të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, më 15, 16 dhe 17 dhjetor 2010 u mbajt në Durrës, morën pjesë gjuhëtarë nga të gjitha hapësirat shqiptare dhe nga bota. Konferenca i zhvilloi punimet në 5 seanca me referate, kumtesa dhe diskutime: Seanca I, Historia e formimit të standardit. Standardi dhe legjislacioni; II, Probleme gramatikore të standardit; III, Probleme të drejtshkrimit dhe të pasurimit të standardit; IV, Marrëdhëniet e standardit me dialektet. Norma leksikore; V, Standardi dhe norma letrare. Të gjitha seancat u ndoqën me diskutime për kumtesat dhe në fund pjesëmarrësit miratuan dhe Përfundimet e Konferencës.

Nga ASHAK në Konferencë morën pjesë aktive akademik B. Bokshi me kumtesë dhe diskutime, akademik R. Ismajli me referat e diskutime, anëtari i jashtëm i ASHAK-ut W. Fiedler me kumtesë e diskutime. Ishte parashikuar dhe akademik S. Hamiti me kumtesë, por për arsye objektive nuk mundi të merrte pjesë. Në Konferencë kishte dhe pjesëmarrës të tjerë nga Kosova. Në kuadër të Konferencës pati dhe veprimtari të tjera. Në fund të Konferencës u bë promovimi i veprave albanologjike. Nga ASHAK me këtë rast u promovuan vepra e Bokshit “*Periodizimi i zhvillimeve morfologjike të shqipes*” dhe dy veprat e Fiedlerit të botuara nga ASHAK – Libri për foljet në gjuhën e Buzukut dhe libri për Shumësinë në gjuhën shqipe.

Pas mbarimit të Konferencës, tre anëtarët e ASHAK-ut (akademik Bokshi, akademik Ismajli dhe anëtari i jashtëm Fiedler) patën një pritje te ministri i Arsimit e Shkencës, z. M. Tafai në Tiranë dhe me atë rast u biseduan rezultatet e Konferencës dhe u theksua nevoja e bashkëpunimit të mëtejshëm.

PËRMBAJTJA

PËRVJETORË

NË 90-VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIK MARK KRASNIQIT	7
Besim BOKSHI: PËR 90-VJETORIN E LINDJES SË MARK KRASNIQIT.....	9
Pajazit NUSHI AKADEMIK MARK KRASNIQI DHE VEPRIMTARIA E TIJ SHKENCORE.....	13
Xhevat SYLA: KRONIKË E KOHËS QË JETUAM.....	19
NË 80-VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIK BESIM BOKSHIT	25
Hivzi ISLAMI: NË 80-VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIK BESIM BOKSHIT	27
Rexhep ISMAJLI: ALBANIST DHE INTELEKTUAL I SHQUAR.....	29
Idriz AJETI: NË 80-VJETORIN E BESIM BOKSHIT.....	37
Kolec TOPALLI: RRUGA E SUKSESSHME E NJË SHKENCËTARI	41
Seit MANSAKU: STUDIUES I SHQUAR I HISTORISË SË GJUHËS	45
Ethem LIKAJ: PËR NJË JETË AKADEMIKU	49
Ali ALIU: POEZIA E BESIM BOKSHIT.....	53
Imri BADALLAJ: MBI VEPRËN GJUHËSORE TË PROFESOR BESIM BOKSHIT ..	55
Besim BOKSHI: FJALA FALËNDERUESE NË 80-VJETORIN E LINDJES.....	59

ARTIKUJ, STUDIME	61
------------------------	----

Hivzi ISLAMI : LE KOSOVO: DE LA COLONIE CLASSIQUE SERBE À L'INDÉPENDANCE	63
Arsim EUPI: DIMENSIONI GJEOPOLITIK I ÇËSHTJES SË LUGINËS SË PRESHEVËS DHE IDEJA PËR SHKËMBIMIN E TERRITOREVE.....	85
Exhlale DOBRUNA-SALIHU: DY SARKOFAGËT E PUNUAR NË MERMER TË HUAJ NË DARDANI NGA <i>VENDENISI DHE ULPIANA</i>	95
Shpresa SIQECA: VESHJET QYTETARE TË PRIZRENIT NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX	111
Pajazit NUSHI, Prishtinë: SEMANTIKA E TEORISË SË PSIKANALIZËS DHE SHQIPËRIMI I KONCEPTEVE TË SAJ.....	125
Hajrullah KOLIQI: MENDIMI PEDAGOGJIK I HASAN TAHSINIT	141
Gjergj SINANI: DASEIN DHE QENIA - E VËRTETË SIPAS ARISTOTELIT ..	151
Gerti JANAQI: PARASHIKIMI DHE REDUKTIMI I PARAGJYKIMEVE NJË STANDARD I RI PËR PROFESIONIN E PSIKOLOGUT	161
Victor A. FRIEDMAN: LANGUAGE POLITICS AND LANGUAGE POLICIES IN THE CONTEMPORARY WESTERN BALKANS: INFINITIVES, TURKISMS AND EUROLINGUIST	175
Sedat KUÇI: DESNICKAJA DHE STUDIMET ALBANISTIKE	185
Shaban SINANI: “SHAKAJA E NDALUAR” OSE “ROMANI I FSHEHUR”	199

Abdullah ZYMBERI: Leksiku te Poradeci.....	209
Rrahman PAÇARIZI: PIKËPAMJET E SELMAN RIZËS PËR STANDARDIN DHE STANDARDIZIMIN E SHQIPES NGA PERSPEKTIVA E SOTME ...	219
Shkumbin MUNISHI: VËSHTRIM SOCIOLOGJIK I PIKËPAMJEVE TË SELMAN RIZËS PËR FORMIMIN E SHQIPES STANDARDE	225
Blertë ISMAJLI: KONCEPTI I S. RIZËS PËR MËNYRAT E FOLJEVE.....	237
Agni DIKA, Visar SHEHU: SHFRYTËZIMI I VIZIONIT KOMPJUTERIK GJATË KATEGORIZIMIT AUTOMATIK TË OBJEKTEVE.....	245
PROMOVIME.....	253
Kosova, Vështrim monografik.....	255
Norbert JOKL: <i>Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip</i>	261
Besim BOKSHI: Fjala e hapjes së përrimit të veprës së Joklit: <i>Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip</i>	263
Rexhep ISMAJLI: Studimet albanistike të norbert Joklit	265
Kolec TOPALLI: Shënime për veprën “studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip”	271
Seit MANSABU: Norbert Jokli në gjuhën shqipe.....	275
PROMOVIMI I MONOGRAFISË PËR REXHEP FERRIN	283
Besim BOKSHI: Fjalë me rastin e përrimit të veprës së dr. Gëzim Qëndros për Rexhep Ferrin.....	285
Gëzim QËNDRO: Monografia për Ferrin	287
Eqrem BASHA: Për monografinë për Ferrin.....	291
PROMOVIMI I VEPRËS SË AKADEMIK MARK KRASNIQIT <i>BESA NË TRADITËN SHQIPTARE</i>	295
Besim BOKSHI: Fjalë e përshëndetjes.....	297
Pajazit NUSHI: Për librin e akademik Mark Krasniqit <i>Besa në traditën shqiptare</i>	299
Esat STAVILECI: Besa në traditën shqiptare	303
Shpresa SIQECA: Një libër etnologjik me vlera të mëdha shkencore.....	305
KRITIKA DHE RECENSIONE.....	307
Pajazit Nushi: <i>Dobrica ĆOSIĆ: VREME ZMIJA, Beograd, 2008</i>	309
Enver Robelli: Oliver Jens SCHMITT: KOSOVO. KURZE GESCHICHTE EINER ZEN- TRALBALKANISCHEN LANDSCHAFT, Wien. Köln. Weimar, 2008, ff. 393.....	321
Enver Robelli: GESCHICHTE SÜDOSTEUROPA. VOM FRÜHEN MITTELALTER BIS ZUR GEGENWART , Herausgegeben von Konrad CLEWING/Oliver Jens SCHMITT, 2011.....	337
Shefqet Riza: KOSOVA (Vështrim monografik), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011	341

Dhori Q. Qirjazi: ΤΙΤΟΣ Π. ΓΙΟΧΑΛΑΣ, Η ΑΡΒΑΝΙΤΙΑ ΣΤΟ ΜΟΡΙΑ – ΧΡΟΝΙΚΑ ΠΟΡΕΙΑΣ. τ. Α΄ + Β΄. Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα 2011, [Titos P. Johalas, <i>Arvanitasit në Moré – kronika rrugëtimi</i> . Vëll. A + B, f. 950 + CD. Botimet Pataqi, Athinë 2011].....	345
Arsim Ejupi: Ibrahim RAMADANI, MJEDISI JETËSOR. Roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva, Prishtinë, 2011	351
Fitim Veliu: Zymer Ujkan NEZIRI, STUDIME PËR FOLKLORIN, II, EPIKA GOJORE DHE ETNOKULTURA, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008	353
In Memoriam: ISTVÁN SCHÜTZ	355
Zija Bylykbashi: KRONIKA/ 2010	359
Përmbajtja.....	381